

Rozafa Ferizi Shala Delvina Dylazeka Hajdari Burbuqe Gojani Kuqi

LIBRI I MADH I PLANIFIKIMEVE

për punën me fëmijët e grup-moshës 5-6 vjeç

Ky është një libër praktik, i cili i ofron edukatorit/es ide për ndërtimin (hartimin) e planifikimeve ditore të integruara brenda një teme javore. Përmes ndërlidhjes së aktiviteteve nga të gjitha fushat kurrikulare, edukatorit/es i jepet mundësia të zhvillojë veprimtari, të cilat ndihmojnë të nxënit e integruar të fëmijëve.

Libri është konceptuar sipas Kornizës Kurrikulare të Kosovës, Kurrikulës Bërthamë për nivelin përgatitor, gjithashtu është frymëzuar nga praktikat e mira të shteteve të zhvilluara, duke marrë parasysh edhe kontekstin vendor ku do të aplikohet ky libër. Qëllimi i këtij libri është që të ndihmojë edukatorin/en në nxitjen dhe krijimin e ideve kreative, të cilat mund t'i zhvillojë krahas ideve të paraqitura në libër. Gjithashtu, jep ide dhe mënyra të planifikimit dhe realizimit të aktiviteteve, të cilat u përgjigjen moshës 5-6 vjeç.

- Çdo gjë rreth nesh • Familja ime
- Emocionet • Stinët • Kafshët
- Ushqimet e shëndetshme • Shqisat
- Siguria dhe shëndeti • Rregullat dhe përgjegjësitë • Kujdesi për mjedisin
- Festat • Miqësia • Toka dhe hapësira
- Jeta e bimëve • Insektet • Libri im
- Profesionet • Transporti • Unë kursej
- Java muzikore, si dhe shumë tema të tjera.

- Modele planifikimi për **36** javë
- **175** tema ditore
- Mbi **1000** aktivitete argëtuese

+ Shtojca e materialeve dhe lojërave multifunkionale



BOTIME

pegi

Rozafa Ferizi Shala

Delvina Dylazeka Hajdari

Burbuqe Gojani Kuqi

LIBRI I MADH I PLANIFIKIMEVE

- Për punën me fëmijët e grup-moshës 5-6 vjeç -

BOTIME



Prishtinë, 2021

BOTIME



Drejtoi botimin: Valmira MUSHI, Arlinda RRUSHI
Redaktorë letrarë: Brunilda MENO, Arlon LIKO
Paraqitja grafike: Elvis BEJTJA, Enkeleda REXHA
Kopertina: Elidor KRUIJA
Shtypi: Shtypshkronja Pegi, Lundër, Tiranë
ISBN: 978-9951-786-39-3

Shënim: Fotografia e vondosur në kopertinën e librit është marrë nga projekti "SHPRESE", Caritasi Zvicëran.

© Botime Pegi sh. p.k, dega në Kosovë, tetor 2021
Të gjitha të drejtat për këtë botim në gjuhën shqipe janë tërësisht të zotëruara nga Botime Pegi sh.p.k. Ndalohet çdo riprodhim, fotokopjim, përshtatje, shfrytëzim ose çdo formë tjetër qarkullimi tregtar, pjesërisht ose tërësisht, pa miratimin paraprak nga botuesi.

Botime Pegi: tel: +355/ 042 468 833; cel: +355/ 069 40 075 02;
e-mail: botimepegi@botimepegi.al; web: www.botimepegi.al
Spektori i shpërndarjes: cel: +355/ 069 20 267 73; 069 60 778 14;
e-mail: marketing@botimepegi.al
Shtypshkronja Pegi: cel: +355/ 069 40 075 01;
e-mail: shtypshkronjapegi@yahoo.com

Përmbajtje

1.Hyrje	5
1.1. Ndërveprimi me fëmijë.....	6
1.2. Përgatitja e mjedisit.....	7
1.3. 10 strategjitë efektive për të nxënit e fëmijëve në moshën 5-6-vjeçare.....	9
1.4. Bashkëpunim mes kolegësh	10
1.5. Përfshirja e familjes dhe e komunitetit	11
2. Skema e temave javore	12
2.1. Organizimi i aktiviteteve ditore	12

Shtator

Çdo gjë rreth nesh	14
Familja ime	23
Emocionet	31
Stinët e vitit	41

Tetor

Ne dhe ngjyrat	50
Ne dhe format.....	60
Ushqimet e shëndetshme.....	70
Shqisat.....	79

Nëntor

Higjiena	89
Siguria dhe shëndeti.....	100
Rregullat dhe përgjegjësitë	110
28 Nëntori	120

Dhjetor

Kafshët	127
Miqësia	137
Festat.....	148

Janar

Acari	156
Toka dhe hapësira	168
Trupat dhe lëvizjet e tyre	183

Shkurt

Unë dhe trupi im	185
17 Shkurti.....	194
Vendi ku jetoj.....	201
Familjarët na vizitojnë.....	209

Mars

Jeta e bimëve	219
7-8 Marsi.....	229
Edhe unë ndihmoj	239
Insekte	249

Prill

Kujdesi për mjedisin	258
Libri.....	266
Rritemi së bashku	275

Maj

Profesionet	286
Transporti.....	294
Materialet që na rrethojnë.....	303
Unë kursej.....	311

Qershor

Fëmijët në lojë	319
Java muzikore	329
Shkolla na pret.....	336

3. Materiale ndihmëse për edukatorin/en.....	346
3.1. Lojëra për takimin në rreth	346
3.2. Loja me tabelë.....	347
3.3. Ide për integrimin e gjuhës angleze gjatë punës me fëmijët..	348
3.4. Vëzhgimi dhe vlerësimi.....	350
3.5. Lista e librave për lexim.....	353
Bibliografia	356
Rreth autoreve	358

1. Hyrje

Vitet e para të fëmijërisë luajnë një rol të rëndësishëm në zhvillimin njohës, social-emocional e motorik të fëmijëve dhe ndikojnë në zhvillimin e përgjithshëm të personalitetit të tyre. Për këtë arsye, cilësia e edukimit në këtë periudhë ka një vlerë dhe rëndësi të veçantë.

Ky libër është konceptuar sipas *Kornizës Kurrikulare të Kosovës*, Kurrikulës Bërthamë për klasën përgatitore, mbështetur në Standardet e zhvillimit dhe të mësuarit në fëmijërinë e hershme (0-6 vjeç). Gjithashtu, libri është frymëzuar nga praktikatat e mira të shteteve të zhvilluara, duke marrë parasysh edhe kontekstin vendor ku do të aplikohet.

Libri është i thjeshtë e praktik dhe i ofron edukatorit/es ide për ndërtimin e planifikimit ditor në mënyrë të integruar brenda një javë. Përmes ndërlidhjes së aktiviteteve të fushave kurrikulare, edukatorit/es i jepet mundësia të zhvillojë veprimtari, të cilat ndihmojnë të nxënit e integruar të fëmijës. Gjithashtu, edukatorët/et nxiten për krijimtari, përshtatshmëri dhe fleksibilitet në përputhje me karakteristikat/nevojat e fëmijëve. Libri ofron edhe të dhëna për çështjet e rëndësishme, të cilat ndihmojnë edukatorët/et për të organizuar dhe për të zhvilluar në mënyrë frytdhënëse punën e tyre me fëmijë.

Puna me fëmijët parashkollorë

Fëmijët e moshës 5-6-vjeçare kanë aftësi të jashtëzakonshme, kureshtje për të eksploruar dhe dëshirë për të marrë të dhëna nga mjedisi ku jetojnë. Prandaj është mjaft e rëndësishme që institucionet parashkollorë të krijojnë një mjedis inkurajues dhe stimulues për ta. Ata kanë nevojë të përballen me situata stimuluese dhe të nxiten drejt zgjidhjes së problemeve dhe të nxënit aktiv.

Edukatori/ja duhet ta zërthejë të nxënit në lojë të këndshme, si e vetmja rrugë e zbavitjes dhe e zhvillimit të fëmijëve. Prandaj, mbusheni

ditën e parashkollorëve me përvoja stimuluese, ndihmojini fëmijët të përjetojnë artin e të zhvillojnë komunikimin, përfshijini në lojëra konstruktive, jepuni mundësi të bëjnë muzikë dhe të vallëzojnë, të eksperimentojnë me shkencën, të kontribuojnë në një mori aktivitete mesimore dhe argëtuese, të mbushen me kënaqësi dhe emocione pozitive gjatë qëndrimit të tyre në institucion.

Si u hartua ky libër

Ky libër synon të paraqesë një formë më të thjeshtëzuar të mënyrës së planifikimit të aktiviteteve në fushën e edukimit parashkollor. Ndërlidhja e kompetencave kryesore për fushat kurrikulare me kompetencat për shkallë, si dhe ndërlidhja e planifikimeve me Standardet e *Zhvillimit dhe të Mësuarit në Fëmijëri të Hershme 0-6 vjeç*, paraqet një sfidë të re për mënyrën e punës me fëmijët e moshës 5-6 vjeç. Harmonizimi i kërkesave kurrikulare me këto standarde, duke pasuruar planifikimet me aktivitete tërheqëse që mundësojnë zhvillimin e kompetencave dhe arritjen e SZHMFH-së janë disa nga tiparet dalluese të këtij libri.

Libri ofron një model, që ndjek një linjë zhvillimi të mirëkonceptuar:

- Ndërtimi i planifikimit vjetor, bazuar në ngjarjet me rëndësi dhe festat për të ruajtur koherencën dhe kohezionin e zhvillimit të aktiviteteve.
- Ndërtimi i temave javore, bazuar në konceptet bazë që priten të zhvillohen.
- Ndërlidhja e aktiviteteve përgjatë temës javore në planifikimet ditore.
- Fleksibiliteti në zhvillimin e aktiviteteve bazuar në nevojat dhe kërkesat e fëmijëve.

1.1 Ndërveprimi me fëmijët

Ndërveprimi është segmenti bazë mbi të cilin ndërtohet e gjithë përvoja e fëmijës gjatë kohës së qëndrimit në klasën përgatitore. Edukatori/ja duhet jo vetëm të krijojë mundësi për ndërveprim të mirë me fëmijën, por edhe të kujdeset për ndërveprimin e mirë të tërë grupit; të ndikojë në krijimin e një atmosfere të mirë sociale ndërmjet fëmijëve, me njëri-tjetrin dhe në raport me të rriturit e tjerë në institucion. Ai/ajo duhet të ketë një strategji të mirë pune në organizimin e mjedisit për ndërveprimin e mirë të fëmijëve në varësi të nevojave të tyre.

Secili fëmijë brenda grupit parashkollor duhet të ndihet mirë, i sigurt dhe i pranuar. Ky është hapi i parë për të qenë i gatshëm në fillimin e procesit të të nxënies. Asnjë fëmijë, madje as një i rritur, nuk mund të jetësojë apo shprehë potencialin e tij, në rast se nuk ndihet mirë në një mjedis të caktuar.

Edukatori/ja është e pëlqyeshme që:	Me qëllim që fëmija të ndihet:
të thërrasë çdo fëmijë në emër;	i dëshiruar;
të ulet në nivelin e fëmijës gjatë komunikimit;	i barabartë;
të shikojë fëmijën në sy kur komunikon me të;	i rëndësishëm;
t'i kushtojë vëmendje fëmijës kur ai përpjeket të ndajë një informatë apo përvojë;	i pranuar;
të vlerësojë përpjekjen dhe jo produktin.	i vlerësuar.

Është shumë e rëndësishme që edukatori/ja ta trajtojë fëmijën si pjesëmarrës të drejtpërdrejtë gjatë gjithë veprimtarisë që zhvillohet në institucionin parashkollor, duke i mundësuar që:

- të shprehë lirshëm ndjenjat e tij;
- të shprehë opinionet dhe përvojat e tij;
- të shfaqë idetë dhe mendimin ndryshe pa ngurruar;
- të nisë zhvillimin e ndonjë aktiviteti ose ndryshimin e tij.

Takimi me fëmijët përpara se të fillojnë klasën përgatitore

Përpara se fëmijët të vijnë në klasën përgatitore, edukatori/ja duhet të bëjë përpjekje që të takohet me fëmijët dhe familjet e tyre. Nëse fëmijët vijnë në edukimin parashkollor të institucionalizuar në institucione parashkollore përpara moshës 5-6 vjeç, takimi me fëmijët dhe familjet e tyre është më lehtë i qashtëm. Në klasat përgatitore në kuadër të shkollave fillore, një gjë e tillë mund të realizohet gjatë kohës së regjistrimit të fëmijëve apo përmes formave të tjera alternative.


Eduktorët/et mund të caktojnë një kohë takimi për secilin fëmijë apo një kohë takimi me të gjithë fëmijët, për t'u njohur së bashku. Kjo mund të realizohet nëpërmjet:

- një shëtitje të përbashkët në mjediset ku do të zhvillohet veprimtaria edukative-arsimore;
- një ftesë drejtuar prindërve dhe fëmijëve për një festë të përbashkët joformale;
- takimeve individuale me fëmijët dhe prindërit etj.

1.2 Përgatitja e mjedisit

Edukatori/ja duhet t'i kushtojë kujdes përgatitjes së mjedisit për pritjen e fëmijëve në klasat përgatitore, sepse që nga dita e parë, fëmija duhet të krijojë idenë e përgjithshme mbi mënyrën e funksionimit të gjërave në grup.

Secilit fëmijë duhet t'i garantohet një hapësirë sado e vogël për vendosjen e gjërave personale. Që nga dita e parë, edukatori/ja dhe fëmijët e grupit përcaktojnë, zgjedhin simbolet e tyre përfaqësuese dhe hapësirat për vendosjen e gjërave personale dhe të mjeteve e materialeve didaktike. Çdo edukator/e mund ta përzgjedhë vetë mënyrën e fillimit të këtij procesi.



Çdo mjet, material që përdoret nga fëmijët dhe është në dispozicion të tyre, duhet të ketë vendin e tij të saktë dhe mbishkrimin e vendosur me fotografi dhe fjalë. Një gjë e tillë mundëson krijimin e një mjedisit ku fëmija mund të orientohet lehtësisht dhe të zhvillojë aktivitetin e tij në formë të pavarur. Gjithashtu, kjo i mundëson atij/asaj që të kujdeset gjithmonë për t'i kthyer materialet dhe mjetet e shfrytëzuara në vendin e tyre. Ndarja e gjërave me të tjerët në mënyrë të pavetëdijshme është një proces i përditshëm, i cili ndodh në mënyrë spontane.

Nëse edukatori/ja vëren se një pjesë e hapësirës së klasës apo e orendive paraqet pengesë për zhvillimin e aktiviteteve, atëherë ai/ajo së bashku me fëmijët mund të vendosë për riorganizimin e klasës, në mënyrë që të krijojë një mjedis më të mirë pune. Jo gjithmonë, një mënyrë e vendosjes së orendive, mund t'u përgjigjet nevojave të fëmijëve.

Një mjedis pune i organizuar mirë i ndihmon fëmijët të orientohen më lehtë gjatë aktiviteteve dhe edukatorin/en në mbajtjen e gjërave në rend dhe të jenë më të rregullt me gjërat e tyre personale. Në këtë mënyrë, te fëmija zhvillohen gradualisht shkathtësitë për jetë pa qenë e nevojshme të flitet për to.

Në varësi të hapësirës, edukatori/ja duhet të përpiqet që ta organizojë mjedisin në përputhje me nevojat dhe interesat e fëmijëve. Çdo ndryshim në mjedisin e të nxënimit mund të vijë si një mundësi e re në kuptim të riorganizimit më të mirë të tij. Mjedisin duhet të jetë gjithmonë i sigurt për fëmijën në aspektin fizik dhe emocional dhe nxitës në kuptimin zhvillimor.

Për një mjedis funksional:



- Secili fëmijë duhet të dijë me saktësi vendin për gjerat e tij personale, përfshirë këtu edhe punën që ai zhvillon (gardëroba, portofoli etj.).
- Çdo material brenda klasës duhet të ketë emërtim me vizatim dhe formë të shkruar, në mënyrë që fëmijët ta kenë të lehtë t'i përdorin materialet dhe t'i kthejnë përsëri në vendet e tyre.
- Përdorimi i mjeteve didaktike është mirë të bëhet në formë grupi, sepse kjo ndihmon që fëmijët të mësohen të shkëmbejnë gjërat me të tjerët në mënyrë të natyrshme.
- Brenda mjedisit duhet të ketë një kënd ekspozimi të punës së fëmijëve. Kjo mund të bëhet përmes një litari (si ai për tharje rrobash), tabelës magnetike apo ndonjë forme tjetër funksionale për grupin tuaj edukativ.
- Fëmijët duhet të kenë të shënuar dhe të paraqitur në formë të dukshme rutinën ditore.
- Fëmijët duhet të kenë një kënd të qetë të pajisur me libra dhe revista të përshtatshme për moshën, në mënyrë që t'i përdorin edhe atëherë kur kanë nevojë për të reflektuar apo për të menduar.
- Materialet për përdorim brenda klasës duhet të jenë të qasshme për të gjithë fëmijët dhe të jenë të grupuara sipas fushave përkatëse.
- Është shumë praktike që të organizohet një kënd (dollar, kuti kartoni etj.), për materialin e riciklueshëm që mund të sillet gjatë vitit nga fëmijët dhe të përdoret kur është nevoja.
- Që fëmijët të familjarizohen me riciklimin, krijoni tri shporta për mbeturina, që riciklimi të jetë një kulturë në grupin tuaj edukativ.

Mjedisi i jashtëm

Ashtu sikurse mjedisi brenda, edhe mjedisi i jashtëm duhet të jetë në funksion të zhvillimit dhe plotësimit të nevojave të fëmijës. Përdorni mjedisin e jashtëm në baza ditore, duke krijuar mundësi që fëmijët të jenë në kontakt të drejtpërdrejtë dhe të vazhdueshëm me natyrën.

Çdo herë që keni mundësi, mund të zhvilloni edhe takimin e përbashkët në hapësirat e jashtme.

Krijoni mundësi për lëvizje dhe lojë të organizuar në mjedisin e jashtëm (kërkoni

ndihmën e prindërve dhe komunitetit që të krijoni një mjedis i cili mund të përdoret periudha më të gjata kohore).

Krijoni një kënd për:

- ritjen dhe kultivimin e bimëve;
- stimulimin e zhvillimit fizik;
- zhvillimin e dramatizimit;
- lojëra me rërë dhe ujë etj.

1.3 10 strategjitë efektive për të nxënëit e fëmijëve parashkollorë

Një edukator/e i/e suksesshëm/suksesshme zgjedh me kujdes strategji adekuate për t'i përshtatur në situata të caktuara. Është e rëndësishme të shqyrtohet çka fëmijët tashmë dinë dhe çka mund të bëjnë, si dhe qëllimet e mësimin për situata specifike. Duke qenë të vëmendshëm dhe fleksibil, ju mund të caktoni se cila strategji mund të jetë më efektive. Nëse një strategji nuk funksionon, mund të përdoret një tjetër. Në këtë libër janë paraqitur 10 strategji të rekomanduara nga NAEYC. Zbatimi i tyre mund të ndihmojë punë e çdo edukatori/eje.

01 **Pranoni atë që fëmijët bëjnë ose thonë.**

Lëri fëmijët ta kuptojnë që ju i keni vëzhguar, duke iu dhënë vëmendje, duke i bërë komente, apo ndonjëherë vetëm duke iu ulur pranë e duke parë punën e tyre. ("Faleminderit, Kushtrim për ndihmën tënde!" "Ke gjetur një mënyrë tjetër për të na paraqitur numrin 5.")

02 **Nxitni këmbënguljen dhe përpjekjet e fëmijës,**

jo thjesht duke i vlerësuar e lavdëruar për punën e bërë. ("Ke menduar aq shumë fjalë për ta përshkruar qenin në histori. Le të vazhdojmë kështu, tani e tutje.")

03 **Jepni komente specifike dhe jo të përgjithshme:**

("Qesja me fasule nuk e ka përfunduar tërë rrotullimin me hollohop Toni, andaj duhet të provosh pak më fort.")

04 **Jepuni fëmijëve modeletë qëndrueshme:**

Mënyra e qasjes ndaj problemit dhe sjellja ndaj të tjerëve ndihmon më shumë, duke i bërë fëmijët që t'i shohin gjërat në praktikë e jo vetëm t'u tregohet. ("Hëm, kjo nuk funksionon dhe unë kam nevojë të mendohem dhe ta zbuloj përse." "Më fal, Beni, nuk isha e vëmendshme dhe humba pjesën kur shpjegove. Të lutem, ma thuaj përsëri!")

05 **Demonstroni mënyrën e duhur për të bërë diçka,**

që zakonisht përfshin një procedurë, e cila duhet të kryhet në mënyrë të caktuar, p.sh.: përdorimi i një instrumenti apo shkrimi i një shkronje.

06 **Krijoni ose shtoni sfida,**

në mënyrë që një detyrë të shkojë përtej asaj që fëmijët mund të bëjnë. P.sh.: Jepni një sasi guralecësh dhe numërojini ata së bashku. Pastaj largojini disa prej tyre dhe të kërkojuni fëmijëve të identifikojnë se sa kanë mbetur. Ata numërojnë guralecët e mbetur për të gjetur përgjigjen. Për ta bërë më sfiduese, ju mund t'i fshihni disa nga guralecët që keni lënë anash.

07 **Shtoni pyetje që nxisin të menduarit e fëmijëve.**

("Nëse nuk do të flisnit me shokun/shoqen tuaj, si mund ta kuptojë ai/ajo se çfarë duhet të bëjë?")

08 **Ofroni ndihmë**

(sugjerime dhe informacione shtesë) që fëmija të zhvillohet sipas kompetencave që ka. (A mund të mendosh ndonjë emër që rimon me emrin tënd? P.sh.: Zana-Hana.)

09 **Sigurojuni informacione,**

jepuni fëmijëve fakte të drejtpërdrejta, konkretizoni dhe ofroni informacionet e nevojshme. (P.sh.: Ky që duket si një mi i vogël me bisht të shkurtër quhet *mi fushe*.)

10 **Jepni udhëzime**

për veprimin e fëmijëve. ("Prekni çdo objekt vetëm një herë deri sa numëroni").

National Association for the Education of Young Children

<https://www.naeyc.org/resources/topics/dap/10-effective-dap-teaching-strategies>

1.4 Bashkëpunim mes kolegësh

Për të pasur një klimë sa më të mirë pune, edukatorit/es i duhet të bashkëpunojë dhe të ndërveprojë në mënyrë të vazhdueshme me kolegët/et brenda dhe jashtë institucionit. Disa nga mënyrat për ndërtimin dhe zhvillimin e bashkëpunimit mes kolegëve mund të jenë:

Shkëmbimi – Shkëmbimi i ideve, i materialeve, i fletëzave të punës, i mjeteve didaktike e shumë të tjera e lehtëson punën e edukatorit/es dhe e ndihmon atë gjatë realizimit të aktiviteteve.

Pranimi i ndryshimeve – Sot ritmi i zhvillimit të secilit sektor, jo vetëm në fushën e edukimit, por gjithandej, është shumë i shpejtë, prandaj sa më herët t'i përgjigjemi ndryshimit, aq më shpejt përmirësohen praktikat tona të punës dhe, sidomos, të përparojnë praktikat e punës me fëmijët. Ndryshimi është më i lehtë dhe më me vlerë kur bëhet bashkë me të tjerët.

Aplikimi i ndryshimeve – Trajnimet janë një mundësi e mirë për të krijuar ura të reja bashkëpunimi mes kolegësh. Ato kanë për qëllim që të njoftojnë pjesëmarrësit për ndryshime dhe praktika të reja, prandaj, përmes aplikimit të ndryshimeve dhe ndarjes së rezultateve me të tjerët ju mund të bëheni një model për

edukatorët/et e rinj/reja dhe një burim njerëzor me vlerë për institucionin ku punoni dhe për shoqërinë.

Krijoni mundësi për takime të përbashkëta

– Takimet e përbashkëta mund të jenë një mundësi e mirë për të biseduar rreth risive në profesion, sfidave dhe mundësive për tejkalimin e tyre. Ndonjëherë zgjidhjet bëhen më të lehta, atëherë kur ndihma është e afërt.

Bëhuni pjesë e ekipit

– Puna në grup gjithmonë sjell më shumë rezultate se puna individuale, prandaj është shumë e rëndësishme që punën tuaj ta ndani me të tjerët, duke shkëmbyer dhe duke ndërtuar ekipe të reja pune për çështje të ndryshme.

Merrni pjesë në punëtori, trajnime

– Zhvillimi i vazhdueshëm profesional është tejet i rëndësishëm për të qëndruar gjithmonë i freskët në profesion. Ndjekja e trajnimeve dhe aplikimi i risive, pjesëmarrja në trajnime të ndryshme brenda dhe jashtë vendit etj., mundësojnë që Edukatori/ja të ecë me hapin e ndryshimeve më shpejt dhe me më cilësi gjatë punës me fëmijët, si dhe të reflektojë më mirë mbi rolin e profesionit të tij/saj në shoqëri.



1.5 Përfshirja e familjes dhe e komunitetit

Përfshirja e familjes në fushën e edukimit parashkollor është e domosdoshme. Të gjitha metodologjitë e punës për fëmijë, në filozofinë e tyre të edukimit, përfshijnë familjen në jetën institucionale. Disa prej tyre përfshirjen e familjes e kanë pjesë përbërëse të programit që nga vendimmarrja e deri te veprimtaria e përditshme në klasë.

Përfshirja e familjes dhe e komunitetit në klasën përgatitore mund të realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme në varësi të vendndodhjes së klasës përgatitore. Edukatori/ja gjithmonë duhet ta njohë komunitetin përreth, në mënyrë që përfshirja e tij dhe e prindërve të jetë sa më efektive dhe e suksesshme.

Për një përfshirje të suksesshme:

Informoni prindërit për qëllimet e klasës përgatitore – Nëse prindërit informohen për qëllimet e klasës përgatitore, për të nxënë aktiv të fëmijës përmes lojës, ata e kanë më të lehtë të pranojnë të bashkëpunojnë me edukatorin/en.

Kërkoni përfshirjen e prindërve në mënyrë të hapur – Secili nga prindërit mund të kontribuojë në klasën përgatitore në mënyra të ndryshme. Edukatori/ja mund të përgatitë një listë për të orientuar prindërit se si mund të përfshihen edhe më tepër në edukim, p.sh.: lexim i tregimeve, ndihmë gjatë ekskursioneve, biseda me fëmijët për profesionin që kanë etj.

Krijoni një tablo të qartë për prindërit pse është e nevojshme përfshirja – Prindërit mund të mos e kuptojnë përse është e nevojshme përfshirja e tyre në aktivitete, prandaj komunikimi i mirë i edukatorit/es është i nevojshëm. Shpjegimi i detajuar për vlerat e përfshirjes mund ta bindë secilin prind që të caktojë vetë një veprimtari ku të marrë pjesë.

Përfshirja është reciproke – Edukatori/ja përveç krijimit të një plani të përfshirjes së prindërve, mund të bëjë edhe vizita në familjet e fëmijëve. Kjo mund të jetë një mënyrë e mirë për të filluar një bashkëpunim të qëndrueshëm ku gjithmonë vihen në pah interesat më të larta të fëmijës.

Gjithmonë ka një arsye për përfshirje – Përfshirja e prindërve asnjëherë nuk është e kufizuar, ata mund të jenë një vlerë e shtuar përgjatë organizimit të aktiviteteve të fëmijëve. Ata mund të vijnë për festa, për të ndërgjegjësuar fëmijët për rëndësinë e leximit, në aktivitete humanitare, në takime formale e jo formale etj.

Rolet e përmbytura – Kur prindërit gjatë bashkëpunimit vihen në rolin e edukatorit/es, ata fillojnë të reflektojnë më mirë mbi punën që ajo bën çdo ditë me fëmijët. Kjo është një mënyrë e mirë për të shmangur paragjykimet. Përveç kësaj, përmes përfshirjes së drejtpërdrejtë ata kanë mundësi të shohin fëmijët e tyre nga një tjetër perspektivë.

Institucioni parashkollor/ Shkolla udhëhiqet edhe nga prindërit – Secila shkollë ka bordin e saj dhe këshillin e prindërve, të cilët mund të ndihmojnë në komunitet dhe organe tjera më të larta për çështjet madhore që mund të ketë shkolla.

Përfshirja e komunitetit – Lagjja rreth shkollës apo institucionit parashkollor krijon mundësi të mirë për të eksploruar dhe bërë vizitat e para. Gjyshërit dhe anëtarët e tjerë të familjes mund të jenë pjesë e aktiviteteve që zhvillohen me fëmijët, prandaj edukatori/ja duhet të planifikojë përfshirjen e komunitetit në punën aktive me fëmijët.



2. Skema e temave javore

2.1 Organizimi i aktiviteteve ditore

Në edukimin parashkollor, sipas Kurrikulës Bërthamë për klasën përgatitore në versionin e rishikuar të saj (2016), aktivitetet zhvillohen të integruara me njëri-tjetrin dhe kalimi nga një aktivitet në tjetrin duhet të bëhet në mënyrë të natyrshme. Fëmijët janë aktivë në procesin e të nxënies që duhet të zhvillohet në mënyrë të integruar, duke i kushtuar një kujdes të veçantë të nxënies nëpërmjet lojës, si forma më e natyrshme e të nxënies në fëmijërinë e hershme.

Zhvillimi i aktiviteteve në klasën parafillore mund të ndjekë një rutinë të caktuar të zhvillimit të aktiviteteve, me kusht që rutina ditore të mos jetë monotone. Sekret i një rutine të mirë ditore ka të bëjë me mundësinë që i jepet fëmijës për t'u befusuar. Pra, mund të ruhet e njëjta linjë e zhvillimit të aktiviteteve, por ato asnjëherë nuk duhet të jenë të njëjta. Kjo e bën të veçantë klasën parafillore dhe i dhuron fëmijës të drejtën për t'u argëtuar e për të luajtur përgjatë procesit të të nxënies. Përgjatë planifikimeve ditore, edukatorët/et mund të gjejnë mjaft udhëzime dhe ide të reja se si mund ta bëjnë të nxënies një proces të dashur për fëmijët, në mënyrë që ata të rriten të lumtur dhe të ushqejnë dashuri për shkollën dhe të nxënies, gjatë gjithë jetës.

Organizimi i rutinës ditore, është bazuar në qasjen filozofike me fëmijën në qendër, përshtatur sipas kërkesave kurrikulare dhe programit për klasën përgatitore, është paraqitur si më poshtë:

- Edukatori/ja gjithmonë përgatit mjedisin për veprimtaritë që do të zhvillohen gjatë ditës.
- Gjatë kohës së pritjes së fëmijëve, ata janë të lirë të luajnë derisa të mblidhen të gjithë.
- Pasi të kenë ardhur të gjithë, edukatori/ja lajmëron fëmijët për takimin e përbashkët dhe pret derisa ata të mblidhen. Edukatori/ja mund të zgjedhë një këngë, zile, melodi, vjershë ritmike që të lajmërojë fillimin e kohës së takimit të përbashkët.
- **Takimi i përbashkët:** Takimi fillon me përshëndetjen, e cila duhet të jetë e ndërlidhur me aktivitetet që do të zhvillohen atë ditë, format e përshëndetjeve është mirë që të jenë të llojllojshme dhe të shoqëruara me mjete, materiale, lëvizje apo fjalë, të cilat natyrshëm krijojnë mundësinë për diskutim të përbashkët rreth temës ditore. Shpalosja e kalendarit duhet të bëhet në mënyrë sa më të thjeshtë. Ne nuk mund të presim që fëmijët të nxënë të gjithë në mënyrë të njëjtë prandaj duke iu përshtatur stileve të ndryshme të të nxënies, edukatori/ja gjen formën më të përshtatshme.
- Takimi vazhdon me një lojë, e cila është ngushtë e lidhur me temën ditore. Pas lojës, fëmijët tashmë janë përfshirë në zhvillimin e temës ditore.
- **Qendrat e aktiviteteve:** Pas takimit të përbashkët krijohet mundësia për zhvillimin e aktiviteteve në grupe të vogla ose në formë individuale në varësi të planifikimit, i cili në raste të caktuara edhe mund të ndryshojë në varësi të nevojave të fëmijëve. Organizimi i aktiviteteve mund të zhvillohet nëpër qendra të aktiviteteve në formë rotacioni ku të gjithë fëmijët do të kenë mundësi të zhvillojnë aktivitetet ditore në bazë të zgjedhjes së tyre individuale.

- **Takimi përmbyllës:** E veçanta e takimit përmbyllës është mundësia e secilit fëmijë për të paraqitur punën e bërë përgjatë aktiviteteve. Ky takim shërben për të reflektuar për punën e bërë dhe krijon mundësinë për ndërlidhjen me aktivitetet që do të zhvillohen ditën e nesërme. Kjo është koha kur fëmijët mund të marrin edhe ndonjë porosi, për shembull: “Nesër në mëngjes pasi të jeni zgjuar, dilni në ballkon dhe shikoni qiellin nëse është me re apo i hapur.”; “Kërkoni nga prindërit që nesër të visheni me rroba të rehatshme, sepse do të dalim në natyrë.” etj.
- Fëmijët nuk kanë detyra shtëpie, si në shkollë, një detyrë shtëpie për ta mund të jetë vëzhgimi i bimëve në oborrin e shtëpisë, plotësimi i kalendarit të pastërtisë së mëngjesit, sjellja e kapakëve të shisheve në klasë, etj. Përgjegjësi të tilla, në dukje të vogla, mjaftojnë që fëmija të zhvillojë përgjegjësinë për bartjen e informacionit dhe plotësimin e detyrës.
- Edukatorët çdo ditë duhet të krijojnë mundësi për vëzhgimin e fëmijës dhe vlerësimin e tij në mënyrë sa më objektive. Një edukator/e i/e mirë mat cilësinë e punës së tij/saj me progresin e fëmijëve gjatë tërë vitit.

Unë jam

Fusha kurrikulare:	Shoqëria dhe mjedisi
Kurrikula lëndore:	Shoqëria dhe mjedisi
Tema nga plani dymujor:	Unë dhe të tjerët
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):	I-3, 5; II-7; III-2, 3, 6; V-5
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):	Shoqëria dhe mjedisi: 1.1 Gjuhët dhe komunikimi: 1.1; 1.4 Matematika: 3.4
Rezultati i të nxënit të temës:	Përshkruan veten duke përdorur disa prej karakteristikave të tij bazë (p.sh.: emër, mbiemër, gjini, moshë, ngjyrën e flokëve dhe të syve).
Rezultatet e të nxënit të aktiviteteve:	<ul style="list-style-type: none"> • Prezanton veten para grupit. • Vizaton portretin e tij/saj në libër. • Luan me shokun/shoqen gjatë lojërave të tavolinës.
Kriteret e suksesit:	<ul style="list-style-type: none"> • Prezanto veten para grupit. • Vizato portretin tënd në libër. • Luaj me shokun/shoqen në lojën që ju pëlqen.
Burimet dhe materialet:	Skeda ngjithëse, lapsa, ngjyra, litar, kapëse rrobash.
Integrimi ndërfaqor:	Gjuhë shqipe, Matematikë.
Çështjet ndërkurrikulare:	Edukimi për qytetari demokratike.
Fjalë kyçe:	Unë, jam, i ndryshëm, i ngjashëm, ekspozim, ekspozitë, rregullore.
Organizimi i aktiviteteve:	Edukatori/ja fton fëmijët në rreth dhe pas mirëseardhjes reciton vjershën "Ne". Pastaj u kalon fëmijëve një "top" (mund të jetë edhe i sajuar), i fton me radhë që secili të prezantohet dhe të tregojë se çka i pëlqen të bëjë dhe në çka shkëlqen ai/ajo.

Ne
 Beni pëlqen të luajë me top.
 Hana bukur kërcen me hollohop.
 Dritoni në vrapim gjithmonë i pari,
 Petriti është kërcimtari.
 Të lexoj mua më pëlqen,
 secili nga ne diku shkëlqen.

Pas takimit të përbashkët, edukatori/ja i fton fëmijët të lëvizin në klasë dhe me këtë rast u paraqet fëmijëve hapësirën e klasës, qendrat e aktiviteteve dhe bashkërisht vendosin për përcaktimin e hapësirave

individuale të secilit. Fëmijët njihen me materialet dhe mjetet didaktike që do të përdorin gjatë gjithë vitit.

Fëmijëve u ofrohen skeda ngjitesë, të cilat mund të jenë me motive të ndryshme. Në to, fëmijët do të vizatojnë simbolet e tyre dhe do t'i ngjisin në dollapët e tyre për identifikim.

Inkurajohen fëmijët të luajnë në grupe të vogla me lojëra tavoline (edukatori/ja përgatit lojëra përkatëse për secilën qendër të aktivitetit, siç janë: sajuese, domino, lojëra memorieje etj.), që fëmijët të fillojnë të krijojnë një interaksion social më të madh njëri me tjetrin.

Më pas, fëmijët ftohen për punë individuale, duke i njohur ata me librat e punës ku do të vizatojnë portretin e tyre. Këto punime shkëputen nga libri dhe ekspozohen në litarin e këndit të ekspozitës.

Vlerësimi:

A mund ta prezantojnë veten fëmijët? A mund të bëjnë komente dhe pyetje për njëri-tjetrin? Shënoni të dhëna individuale për fëmijët, nëse keni mundësi. Si u ndienë ata gjatë ditës së parë?

Më shumë për të bërë:

Vendosni bashkërisht për rregullat e klasës. Teksa fëmijët japin ide, edukatori/ja mban shënime dhe në të ardhmen mund t'i bëjë të dukshme nëpërmjet ilustrimeve. Këto rregulla duhet të ekspozohen në një kënd të dukshëm brenda klasës (shih figurën).

Rregullat e takimit	
	Shiko me vëmendje
	Dëgjo me kujdes
	Kërko tjalën
	Ndihmo shokët dhe shoqet

Reflektimi:

Pushimet verore

Fusha kurrikulare: Artet

Kurrikula lëndore: Edukim figurativ

Tema nga plani dymujor: Vizatimi

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): **I-3, 5; II-1, 7; III-2, 6; IV; V-5; VI-1**

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):
 Artet: 1
 Gjuhët dhe komunikim: 1.1; 1.4
 Shkencat e natyrës: 4.2
 Matematika: 3.4

Rezultati i të nxënit të temës: Prezanton ndjenjat dhe idetë nëpërmjet artit dhe ndërtimit. Bën shkarravina, vizatime dhe më pas ua tregon të tjerëve punën e vet.

Rezultatet e të nxënit të aktiviteve:	<ul style="list-style-type: none"> • Përshkruan me fjalë pushimet e tij/saj verore. • Në fletëzën e punës, vizaton pamje/objekte nga pushimet e tij/saj. • Lëvizë gradualisht në formë të pavarur prej një qendre të aktivitetit në qendrën tjetër, sipas udhëzimeve.
Kriteret e suksesit:	<ul style="list-style-type: none"> • Përshkruaj me fjalë pushimet e tua verore. • Në fletëzën e punës, vizato pamje/objekte nga pushimet. • Ndiq udhëzimet e edukatorit/es për të kaluar nga njëra qendër e aktivitetit në tjetrën.
Burimet dhe materialet:	<i>Libri i fëmijës</i> , enë të mbushura me rërë, guaska, syze dielli, ngjyra, CD, radio, flluska sapuni.
Integrimi ndërfaqor:	Gjuhë shqipe, Njeriu dhe natyra, Matematikë.
Çështjet ndërkurrikulare:	Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.
Fjalë kyçe:	Pushime, pushime verore, unë, familja, guaska, lodra deti, vizita tek të afërmit, etj.
Organizimi i aktiviteve:	<p>Përshëndetja e ditës bëhet me një shtrëngim dore nga fëmijët. Çdo fëmijë i zgjat dorën tjetrit për prezantim dhe i thotë emrin e tij. ("Përshëndetje, unë jam Altini!"; Përshëndetje, unë jam Hana!") Përshëndetja zgjat deri te fëmija i fundit, aty ku bashkohet rrethi. Nëse ndonjëri nga fëmijët nuk ka dëshirë të prezantohet, edukatori/ja duhet ta mirëkuptojë dhe të presë momentin kur fëmija të jetë i gatshëm.</p> <p>Edukatori/ja ka përgatitur 4 enë të mbushura me rërë dhe brenda tyre ka fshehur aq objekte (guaska, lodra deti, syze dielli etj.) sa ka edhe fëmijë në klasë, në mënyrë që secili nga fëmijët sapo të gjejë një objekt, të kthehet përsëri në rreth. Enët me rërë duhet të jenë vendosur në katër kënde të klasës, në mënyrë që fëmijët të mos presin gjatë në radhë apo të krijohen kushte të pafavorshme pune. Pasi të kthehen të gjithë fëmijët në rreth, edukatori/ja u kërkon që të flasin më shumë rreth objektit të gjetur dhe vendit ku e kanë parë, gjetur, përdorur etj.</p> <p>Pasi përfundojnë diskutimin, edukatori/ja i ndan fëmijët në grupe të vogla dhe i ndihmon të kuptojnë sesi funksionon ndarja e qendrave të aktiviteve, duke e praktikuar atë. Kështu, fëmijët ndahen në 4 qendra të aktiviteve ku u ofrohen materiale të ndryshme pune.</p> <p>Pasi t'i kenë mbaruar të gjitha aktivitetet, fëmijët formojnë rrethin për takimin përmbyllës. Edukatori/ja vë muzikë ritmike dhe nën tingujt e muzikës bën flluska sapuni. Fëmijët ngrihen të kërcëjnë dhe të kapin flluskat e sapunit. Përmes këtij aktiviteti, edukatori/ja krijon një atmosferë pushimesh dhe argëtimi, çka e ndihmon fëmijën të ndihet mirë dhe i pranuar në grup.</p>
Vlerësimi:	Edukatori/ja vëzhgon aftësitë e fëmijëve për orientim hapësinor gjatë kohës që ata ngrihen nga rrethi për të gjetur objektet e fshehura në rërë dhe aftësitë e tyre motorike gjatë aktiviteve të zhvilluara.
Më shumë për të bërë:	Edukatori/ja kërkon nga fëmijët që të diskutojnë me prindërit fotografite e pushimeve: për vendin dhe karakteristikat tij, largësinë, ose të dikskutojnë për vendet që ata kanë vizituar, përfshirë vizitat te gjyshërit, te të afërmit në qytete dhe fshatëra të tjera etj.
Reflektimi:	_____

Njihem me institucionin parashkollor/shkollën time

Fusha kurrikulare:	Jeta dhe puna
Kurrikula lëndore:	Mjedisi shtëpiak, kopshti dhe shkolla
Tema nga plani dymujor:	Njihem me shkollën time
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):	I-3; II-7; III-2; V-5
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):	Jeta dhe puna: 1.1 Gjuhët dhe komunikimi: 1.3; 1.4 Matematikë: 3.4
Rezultati i të nxënit të temës:	Përshkruan objektet e ndryshme të banimit si shtëpitë, pallatet dhe nëpërmes lojës stimulon ndërtimin e objekteve, orendive.
Rezultatet e të nxënit të aktiviteteve:	<ul style="list-style-type: none"> • Përshkruan objektet e shkollës/institucionparashkollor me fjalët e tij/saj. • Paraqet përmes vizatimit rrugën për në shkollë/institucion parashkollor. • Shpjegon me fjalë atë që ka vizatuar.
Kriteret e suksesit:	<ul style="list-style-type: none"> • Përshkruaj objektet e shkollës/institucion parashkollor me fjalët e tua. • Paraqit me anë të vizatimit rrugën për në shkollë/institucion parashkollor. • Shpjego me fjalë atë që ke vizatuar.
Burimet dhe materialet:	Libri "Dita ime e parë në shkollë/institucion parashkollor", fletë të bardha, lapsa, ngjyra, top etj.
Integrimi ndërfaqor:	Matematikë, Gjuhë shqipe.
Çështjet ndërkurrikulare:	Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.
Fjalë kyçe:	Shkolla, klasa, fëmijët, edukatori/ja etj.
Organizimi i aktiviteteve:	<p>Edukatori/ja i fton të gjithë fëmijët të dalin së bashku në oborr. Ata formojnë rrethin dhe luajnë një lojë për zhvillimin e vëmendjes dhe të krijimit të një klime të mirë sociale. Edukatori/ja u tregon për lojën "Emrat tanë". Me ndihmën e një topi, edukatori/ja u shpjegon fëmijëve rregullat e lojës. Secili fëmijë do të prezantojë fillimisht veten dhe më pas fillon loja me top. Fëmijës që i hidhet topi do të tregojë emrat e fëmijëve që ka mbajtur mend; kështu do të vazhdohet derisa të gjithë fëmijët të presin nga një herë topin. Në këtë mënyrë, ata do të kenë më shumë mundësi të mësojnë më shpejt emrat e njëri-tjetrit.</p> <p>Pas lojës, edukatori/ja së bashku me fëmijët vizitojnë mjediset e shkollës/institucionit parashkollor, klasat, bibliotekën dhe drejtuesin/en në vendin e punës. Gjatë vizitës, ata drejtojnë pyetje të ndryshme lidhur me atë që shohin. Pas kthimit në klasë, fëmijët ulen në rreth dhe edukatori/ja vazhdon me leximin e librit "Dita ime e parë në shkollë/institucion parashkollor." (Ruga</p>

Sesam). Nxiten fëmijët përmes bashkëbisedimit të diskutojnë; bëjnë pyetje mbi historinë e lexuar.

Dita vazhdon në qendrat e aktivitetit ku fëmijët në grupe të vogla do të paraqesin përmes vizatimit rrugën nga shtëpia në institucion; do të ndërtojnë me rrugën blloqe, do të luajnë me lojëra tavoline të përgatitura nga edukatori/ja dhe me fotografi nga tregimi. Më pas, diskutojnë për to. Në takimin përmbyllës diskutohet ajo që fëmijët bënë gjatë ditës së sotme.

Vlerësimi:

Edukatori/ja vëzhgon fëmijët gjatë pjesëmarrjes së tyre në aktivitetet përkatëse. Ai/ajo fillon mbajtjen e shënimeve në ditarin reflektiv.

Më shumë për të bërë:

Fëmijët mund të pyesin prindërit për edukatorin/en që kanë pasur: *Si quhej ai/ajo? Si ishte?*

Kërkoni nga prindërit që të flasin me fëmijët për rrugën që bëjnë nga shtëpia për në shkollë/institucion parashkollor dhe anasjelltas. Kërkoni prej tyre që të shpjegojnë pikat orientuese që janë të rëndësishme për t'u njohur gjatë këtij udhëtimi.

Reflektimi:

Ditëlindja ime

Fusha kurrikulare: Matematikë

Kurrikula lëndore: Matematikë

Tema nga plani dymujor: Puna me të dhëna

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): **I-3, 8; II-7; III-2, 3, 6; V-5**

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): Matematika: 2.2; 3.5; 6.2
Gjuhët dhe komunikimi: 1.1.1; 1.4; 2.4
Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti: 1

Rezultati i të nxënit të temës: Vendos të dhëna të thjeshta me vizime të grumbulluara nga jeta e përditshme.

Rezultatet e të nxënit të aktiviteteve:

- Vendos skedën e tij/saj në kolonën e muajit në të cilin ka lindur.
- Tregon datën e lindjes.
- Plotëson në libër sa qirinj i nevojiten tortës së tij/saj për ditëlindje.

Kriteret e suksesit:

- Vendos skedën tënde në kolonën e muajit në të cilin ke lindur.
- Trego datën e lindjes.
- Plotëso në libër sa qirinj i nevojiten tortës sate për ditëlindje.

Burimet dhe materialet: Certifikatë lindjeje, fletë A2, lapsa, ngjyra, skeda ngjitëse.

Integrimi ndërfushor: Gjuhë shqipe, Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti.


Çështjet ndërkurrikulare: Njohja dhe respektimi i të drejtave të fëmijëve.

Fjalë kyçe: Ditëlindje, datë, kalendar, muaj viti, certifikatë e lindjes.

Organizimi i aktiviteteve: Edukatori/ja prezanton një certifikatë lindjeje, të cilën e ka mbështjellë në formë cilindrike me një fletë me ngjyrë dhe iu drejtohet fëmijëve duke i pyetur se çfarë ka në dorë.

Pas disa ideve që dalin nga fëmijët, prezantohet certifikata dhe u tregohet atyre që secili nga ne merr nga një letër të tillë të veçantë me rastin e lindjes, ku shkruhet emri dhe mbiemri ynë, i prindërve tanë dhe vendi ku kemi lindur.

Pastaj, edukatori/ja merr një kalendar dhe bashkë me fëmijët fillon emërtimin e muajve të vitit, ndërkohë fton të ngrihen në këmbë fëmijët që kanë lindur në muajt që emërtohen. Në këtë mënyrë, shihet se sa fëmijë kanë lindur në secilin prej muajve të vitit. Për t'i ilustruar ditëlindjet e fëmijëve, në një fletë A2 vizatojmë një tabelë me 12 kolona, në krye të së cilës shkruhet emri i muajit. Fëmijëve u jepen skeda ngjitëse, ku do të vizatojnë nga një ëmbëlsirë, brenda së cilës do të shkruajnë emrin dhe ditëlindjet e tyre (atyre që hasin vështirësi, u ofrohet ndihmë). Mandej, secili ngjit skedën e tij në kolonën e muajit kur ka lindur.



Në këtë formë realizohet puna me të dhëna, duke bërë grupimin në muaj, duke krahasuar dhe gjetur se në cilin muaj ka më shumë/më pak ditëlindje, duke i numëruar etj.

Edukatori/ja lexon vjershën:

Muajt e vitit

*Janari vjen i pari,
Shkurti ikën me vrap,
Marsi nënat na gëzon,
Prilli natyrën na gjelbëron.
Maji është plot ndriçim,
Qershori sjell pushimin tim,
Në korrik piqen mollët e ëmbla,
Në gusht fillon t'më përgatitë nëna.
Në shtator shkolla na pret,
Në tetor vjeshta troket,
Në nëntor vesh xhupin e nxehtë,
Dhjetori sjell një dordolec.*

Në vijim, fëmijët ndahen në grupe dhe ftohen të punojnë me librat e punës për fëmijë në fushën e matematikës. Ata do të plotësojnë fletëzën "Torta e ditëlindjes", duke ngjyrosur dhe vizatuar qirinjtë mbi tortë.

Në fund të ditës shihet kalendari i ditëlindjeve të fëmijëve. Ata pyeten se çka paraqet kalendari dhe emërtojnë muajt e vitit me radhë. Pastaj fëmijët nxiten që të ndajnë ndonjë kujtim të veçantë nga ditëlindja e tyre.

Vlerësimi: Ftojmë fëmijët të tregojnë ditëlindjen e plotë. Nëse është e nevojshme, mund t'u tregojmë muajin. Edukatori/ja dëgjon përgjigjet e nxënësve dhe mban shënime për mënyrën se si shprehen.

Më shumë për të bërë: Fëmijët mund të kërkojnë në shtëpi një koleksion me nga një fotografi për secilën ditëlindje dhe ta sjellin në klasë për ta ndarë me të tjerët, nëse kanë dëshirë.

Reflektimi:

Shkronja ime e veçantë

Fusha kurrikulare:	Gjuhë dhe komunikim
Kurrikula lëndore:	Gjuha shqipe
Tema nga plani dymujor:	Tinguj, shkronja, rrokje, fjalë, fjali
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):	I -3, 5; II -7; III -1, 2, 3, 6; V -5
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):	Gjuhët dhe komunikimi: 1.1; 1.4; 3.2 Artet: 1 Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti: 1
Rezultati i të nxënit të temës:	Shqiptojnë drejt tingujt (zanore e bashkëtingëllore) gjatë të shprehurit.
Rezultatet e të nxënit të aktiviteteve:	<ul style="list-style-type: none"> • Identifikon shkronjën e parë të emrit të tij/saj. • Vizaton simbolet sipas udhëzimeve.
Kriteret e suksesit:	<ul style="list-style-type: none"> • Identifikon shkronjën e parë të emrit tënd. • Vizato simbolet sipas udhëzimeve.
Burimet dhe materialet:	Kartonët e emrave, kartonë të vegjël, lapsa, ngjyra, ngjites, fleta dekorative, pjata plastike, miell.
Integrimi ndërfaqor:	Edukatë muzikore, Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti.
Çështjet ndërkurrikulare:	Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.
Fjalë kyçe:	Certifikatë e lindjes, datë, shkronjë, emër.
Organizimi i aktiviteteve:	Edukatori/ja përgatit (mund të përdor kartat në fund të librit ose vizaton me dorë të lirë) kartat e emrave për secilin fëmijë, p.sh.:



Përgatitni disa karta me shkronjat e para të emrit të secilit fëmijë (shkronjat mund të përsëriten sepse disa emra fillojnë me të njëjtën shkronjë). Mbani kartën e emrit në njërin dorë dhe një shkronjë nga emrat e fëmijëve në tjetrën. Fëmijët pyeten se cilit prej tyre i fillon emri me shkronjën që mbani në dorë, p.sh.: "Unë kam në dorë shkronjën K, emri i cilit prej jush fillon me shkronjën K?" "K-Klara". Pasi deklarohet fëmija në fjalë, shkronja nënvizohet dhe atij i thuhet: "Kjo është shkronja e parë e emrit dhe sot do të jetë shkronja jote e veçantë". Jepini fëmijës kartën e emrit dhe kërkoni nga fëmijët e tjerë që ta përsëritin: "Përsëritet Klara" dhe ajo t'u përgjigjet: "Përsëritet shokë dhe shoqe".

Pasi të kenë mbaruar të gjithë, fëmijët ndahen në grupe dhe zbukurojnë kartat e emrave të tyre me simbole të ndryshme (në një kënd mund të vendosni mjete të ndryshme, lapsa, ngjyra, gërrshërë, ngjitës fletë me ngjyra etj.), sipas parapëlqimeve.

Pasi fëmijët ulen në rreth, edukatori/ja fillon këngën e emrave. Përdorni melodinë e këngës B-I-N-G-O që mund ta gjeni në internet: https://www.youtube.com/watch?v=9mmF8zOlh_g dhe modifikojeni me tekstin e mëposhtëm, duke përdorur emrin e fëmijës që keni në krahun tuaj të djathtë. Loja përfundon pasi të gjithë fëmijët në rreth të kenë kënduar.

*Kam një shok dhe të gjithë e dinë,
Që emrin e ka Toni,
T-O-N-I, T-O-N-I, T-O-N-I,
Ky është emri tij.*

Fëmijët ndahen nëpër qendra të aktiviteteve. Ata do të lëvizin nëpër qendra për të eksploruar me materiale të ndryshme.

Në qendrën e artit, fëmijët do të modelojnë shkronjën e parë të emrit me letra me ngjyra dhe materiale, duke prerë dhe ngjitur.

Në qendrën e gjuhës, fëmija do të identifikojnë në revista shkronjat e emrit të tij/saj dhe më pas do të presë dhe bashkojë ato.

Ndërsa në një qendër tjetër, fëmija do të formojë gjurmët e shkronjës së tij/saj në pjata me miell.

Dita përmbyllet me diskutimin e përbashkët për punën e bërë gjatë ditës.

Vlerësimi:

Edukatori/ja vlerëson fëmijën kur ai/ajo provon të modelojë shkronjën e tij/saj të parë dhe të shokut/shoqes që ka pranë.

Më shumë për të bërë:

Kërkoni nga fëmijët që të pyesin dhe të zbulojnë në shtëpi shkronjat e para të anëtarëve të familjes. Kërkoni nga prindërit një fotografi të familjes e cila do të qëndrojë në institucion përgjatë vitit.

Reflektimi:

Çfarë është një familje?

Fusha kurrikulare:	Shoqëria dhe mjedisi
Kurrikula lëndore:	Shoqëria dhe mjedisi
Tema nga plani dymujor:	Unë dhe të tjerët
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):	I-3, 5; II-7; III-1, 2, 3; V-5
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):	Shoqëria dhe mjedisi: 1.1.1 Gjuhët dhe komunikimi: 1.1; 1.2; 1.4 Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti: 1
Rezultati i të nxënit të temës:	Tregon për anëtarët e familjes së ngushtë dhe të gjerë (p.sh.: emri, mbiemri, gjinia, mosha, profesionin etj.).
Rezultatet e të nxënit të aktiviteteve:	<ul style="list-style-type: none"> • Përshkruan personazhet e tregimit. • Tregon anëtarët familjes. • Respekton rregullat e lojës.
Kriteret e suksesit:	<ul style="list-style-type: none"> • Përshkruaj personazhet e tregimit. • Trego anëtarët e familjes. • Respekto rregullat e lojës.
Burimet dhe materialet:	Libër mbi familjen, libri i punës, kapele të ndryshme.
Integrimi ndërfaqor:	Gjuhë shqipe, Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti.
Çështjet ndërkurrikulare:	Edukimi për qytetari demokratike.
Fjalë kyçe:	Familja, mami, babi, motra, vëllai, gjyshi, gjyshja.
Organizimi i aktiviteteve:	<p>Pas përshëndetjes, takimi i përbashkët vazhdon me bisedën rreth familjes, fëmijët kanë sjellë fotografitë dhe sipas dëshirës, secili tregon për familjen e vet. Më pas, edukatori/ja u lexon fëmijëve librin "Vëllezër dhe motra" nga Dr. Catherine Dolto (mund të lexohet çdo libër tjetër për familjen, mund të sigurohen fotografi ilustruese me imazhet e familjeve të ndryshme etj.). Në vijim, zhvillohet diskutimi mbi tregimin e lexuar: "Ku zhvillohej ngjarja? Çfarë u pëlqeu më shumë? Cili personazh? Pse?" (Fëmijët shprehin mendimet e tyre.)</p> <p>Edukatori/ja nxit bisedën duke u drejtuar fëmijëve pyetje të hapura për familjet dhe anëtarët e tyre. Edukatori/ja mund të pyesë edhe për karakteristikat e familjarëve, për kujdesin që tregon çdo anëtar për njëri-tjetrin. (Fëmijët shprehin mendimet e tyre.)</p> <p>Pra, familje quhen të rritur dhe fëmijë që jetojnë së bashku. Ata e duan njëri-tjetrin dhe kujdesen për njëri-tjetrin; duke vendosur theksin në llojllojshmërinë dhe diversitetin në mes të strukturës së familjes; duke i ndihmuar fëmijët që të kuptojnë dhe pranojnë ndryshimet në mes tyre. Më pas, organizohet puna nëpër qendra të aktiviteteve ku fëmijët do të kenë mundësi të vazhdojnë aktivitetet.</p>

Njëri grup do të vizatojë anëtarët e familjes (fletëza në librin e fëmijës).

Grupi tjetër do të konstruktojë me material ndërtues shtëpinë.

Grupi i tretë do të dramatizojë tregimin e lexuar gjatë takimit.

Fëmijët do të kalojnë nga njëra qendër e aktivitetit në tjetrën sipas përzgjedhjes së tyre.

Dita vazhdon me "Lojën me kapelë", ku edukatori/ja siguron një numër të madh të kapelave të ndryshme (mund të jenë pjesë e rekuizitave të institucionit parashkollor/shkollës për dramatizim ose mund të sigurohen duke u kërkuar ndihmë prindërve), të cilat mund të përdoren nga anëtarët të ndryshëm të familjes. Fëmija do të përzgjedhë me sy mbyllur një kapele, dhe në varësi të kapelës, do të dramatizojë një veprim të caktuar, karakteristik për kapelën që ka vënë.

Loja përfundon pasi të jenë përfshirë të gjithë fëmijët. Meqë ndonjëherë është e pamundur që të gjenden aq kapele sa edhe fëmijë, atëherë kapelat vendosen përsëri në rreth për t'u përzgjedhur sërish.

Vlerësimi:

Edukatori/ja vlerëson pozitivisht (me fjalë) mendimet e fëmijëve dhe i inkurajon ata për t'u shprehur. Përmes shënimeve përkruese mund të mbaj shënim ndonjë të dhënë të veçantë për një grup fëmijësh.

Më shumë për të bërë:

Edukatori/ja mund të kërkojë nga prindërit të sjellin albumet familjare dhe t'i diskutojnë së bashku. Në një këndë të klasës mund të krijohet një kënd i veçantë ku vendosen fotografi të familjes. Kështu, fëmijët mund t'i kenë ato tërë kohës.

Reflektimi:

Anëtarët e familjes sime

Fusha kurrikulare: Artet

Kurrikula lëndore: Edukimi figurativ

Tema nga plani dymujor: Vizatimi

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): **I-3, 5; II-7; III-1, 2, 3; V-5**

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): Artet: 1
Gjuhët dhe komunikimi: 1.1; 1.4; 1.5
Matematikë: 3.4

Rezultati i të nxënit të temës: Prezanton ndjenjat dhe idetë nëpërmjet artit dhe ndërtimit.
Bën shkarravina, vizatime dhe punën e vet ua tregon të tjerëve.

Rezultatet e të nxënit të aktiviteteve:	<ul style="list-style-type: none"> • Tregon një ngjarje për familjen e tij/saj. • Krijon librin e familjes sipas udhëzimeve. • Vizaton anëtarët e familjes.
Kriteret e suksesit:	<ul style="list-style-type: none"> • Trego një ngjarje për familjen tënde. • Krijoj librin e familjes sipas udhëzimeve. • Vizato anëtarët e familjes.
Burimet dhe materialet:	Letër A4 e bardhë ose me ngjyrë, ngjyra, letra me ngjitës, gërshërë, ngjitës shirit, materiale të ndryshme të klasës.
Integrimi ndërfaqor:	Gjuhë shqipe, Matematikë.
Çështjet ndërkurrikulare:	Edukimi për qytetari demokratike.
Fjalë kyçe:	Familje, anëtar i familjes, mami, babi, motra, vëllai, libri, lodra etj.
Organizimi i aktiviteteve:	<p>Për përshëndetjen e përbashkët, sot fëmijët do të përshëndeten me njëri-tjetrin, siç përshëndeten me antarët e familjes. Pas përshëndetjes dhe kalendarit, edukatori/ja nxit fëmijët për të folur për familjen.</p> <p>Bisedohet për rendin familjar: “Çfarë bën familja juaj në mëngjes? Në drekë? Po në mbrëmje?” (Fëmijët shprehin mendimet e tyre lidhur me detyrat, përgjegjësitë dhe punët e anëtarëve të familjes.)</p> <p>Fëmijët që kanë sjellë albumet e tyre të fotografive i komentojnë individualisht ato, duke u ndihmuar me pyetje të tilla, si: <i>Kur keni dalë në fotografi? Me kë? Kush jeton me ju? Cila fotografi të pëlqen më shumë? Pse? etj.</i></p> <p>Pas komentimeve të albumeve, fëmijët arrijnë të shohin se secila familje qenka e ndryshme nga tjetra. Familjet tona nuk janë njësoj, ato janë të ndryshme!</p> <p>Edukatori/ja ka vendosur në një kënd të dukshëm të dhomës një varg materiale që fëmijët mund t’i përdorin për të ndërtuar apo për të dekoruar librat e familjes së tyre.</p> <p>Sipas dëshirës, fëmijët mund t’i prezantojnë librat e tyre në takimin përmbyllës. Ata që nuk kanë dëshirë t’i ndajnë me të tjerët, mund t’i vendosin në portfolat e tyre. Ata janë të lirë të përzgjedhin dhe të përdorin materiale të ndryshme pune, të cilat i ndihmojnë të shprehin më mirë iden e tyre. Sipas dëshirës, fëmijët mund t’i marrin me vete në shtëpi librat e ndërtuar, në mënyrë që t’i ndajnë me anëtarët e familjes.</p> <p>Edukatori/ja porositi fëmijët që të nesërmen të vijnë me veshje sportive, të marrin një shishe ujë dhe rroba të tjera të pastra me vete. Po ashtu, edukatori/ja njofton prindërit për aktivitetet që do të zhvillohen ditën tjetër dhe kërkon ndihmën e disa prindërve për realizimin e tyre.</p>



Vlerësimi:	Edukatori/ja vëzhgon fëmijët gjatë procesit të punës. Ai/ajo mund të pyesë fëmijët për gjërat e vizatuara apo të paraqitura, nëse ka nevojë për më shumë informacion.
Më shumë për të bërë:	Gjatë ndërtimit të librave inkurajoni fëmijët të përdorin fjalorin matematikor. Fëmijët të cilët përfundojnë me ndërtimin dhe dekorimin e librit të tyre, mund të hulumtojnë për familjen mes librash dhe materialeve të cilat gjenden në klasë.
Reflektimi:	

Familja sportive

Fusha kurrikulare:	Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti
Kurrikula lëndore:	Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti
Tema nga plani dymujor:	Njohja e vetes dhe e botës përreth
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):	I-3, 5; III-3; VI-1
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):	Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti: 1.2 Gjuhët dhe komunikimi: 1.1; 1.3; 1.4 Artet: 1 Matematika: 3.5
Rezultati i të nxënit të temës:	Shfaq emocione përmes lojës, aktiviteteve grupore, bashkëveprimit me edukatoren, fëmijët dhe të tjerët.
Rezultatet e të nxënit të aktiviteteve:	<ul style="list-style-type: none"> • Bën lëvizje trupore duke kënduar. • Interpreton lëvizjet sipas udhëzimeve të dhëna. • Përshkruan lojën e parapëlqyer.
Kriteret e suksesit:	<ul style="list-style-type: none"> • Bëj lëvizje trupore duke kënduar. • Interpretu lëvizjet sipas udhëzimeve të dhëna. • Përshkruaj lojën e parapëlqyer.
Burimet dhe materialet:	Libri i muzikës, rekuizita, topa, rrathë, shporta, thasë të mëdhenj, kuti e ndihmës së shpejtë, batanije.
Integrimi ndërfaqor:	Gjuhë shqipe, Edukatë muzikore, Matematikë.
Çështjet ndërkurrikulare:	Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

Fjalë kyçe: Sport, lojë sportive, sportist/e, sjellje sportive, garë, vrapim, poligon, lojëra.

Organizimi i aktiviteteve: Edukatori/ja njofton paraprakisht prindërit dhe i porositi që të vishen me veshje sportive. Lojërat mund të zhvillohen në sallën e sporteve ose në oborr.

Dita fillon me lëvizje trupore të shoqëruara me muzikë. Ju mund të këndonit këngën "Sportistë jemi ne" (nga libri i muzikës - Xhevat Ismajli).

Kënga shoqërohet me lëvizje trupore dhe kështu zhvillohet aktiviteti hyrës për lojërat sportive që do të zhvillohen sot.

Për të ndarë grupet, edukatori/ja përdorë bileta me ngjyra, në mënyrë që ndarja në ekipe të jetë rastësore.

Pas ndarjes së fëmijëve në katër ekipe, secili prej tyre vendos për emrin e tij. Ky proces monitorohet dhe ndihmohet nga prindërit-ndihmës.

Organizimi i aktivitete sportive:

Pas formimit të ekipeve, edukatori/ja bisedon me fëmijët se çfarë do të thotë sjellje sportive dhe si duhet të sillemi gjatë lojërave. Krijohet këndi i pushimit dhe i ndihmës së parë, në rast se ndonjëri nga fëmijët lëndohet. Për të gjitha këto bisedohet me fëmijët përpara se të fillojnë lojërat.

Loja: Ecje me thes

Fëmija dhe prindi mbajnë nga një këmbë në thes (të djathtat apo të majtat) dhe në momentin e dhënies së sinjalit, ecin deri te caku. Kështu vazhdojnë të gjithë lojtarët e skuadrës. Fillimisht luajnë dy skuadra, pastaj garën e vazhdojnë dy skuadrat e tjera. Skuadrat në pritje pushojnë dhe brohorasin si tifozë nga këndi i pushimit.

Loja: Ecje me top në mes të këmbëve

Loja përsëri zhvillohet nga dy ekipe ku fëmijët do të provojnë të ecin me top në mes të këmbëve deri te caku. Loja vazhdohet përsëri nga dy skuadrat e tjera.

Loja: Loja me poligon

Nga edukatori/ja me ndihmën e prindërve formohet një poligon ku fëmijët do të vrapojnë përmes objekteve deri te caku. Loja vazhdohet përsëri nga dy skuadrat e tjera.

Pas përfundimit të të gjitha lojërave nga fëmijët, kërkohet që t'i shtrëngojnë dorën njëri-tjetrit dhe të ulen në rreth për të biseduar rreth aktiviteteve të zhvilluara gjatë ditës së sotme. Edukatori/ja kujdeset që gjatë lojërave, fëmijët të jenë pjesë e skuadrave të ndryshme, në mënyrë që të gjithë të kenë mundësi të shoqërohen me njëri-tjetrin.

Vlerësimi: Edukatori/ja plotëson fletëzat e vëzhgimit mbi zhvillimin e muskujve të mëdhenj të trupit.

Më shumë për të bërë: Ju mund të përzgjidhni edhe aktivitete të tjera, të cilat i përgjigjen nevojave apo kërkesave të fëmijëve të grupit tuaj edukativ.

Nëse ndihma e prindërve mungon, zvogëloni numrin e grupeve ose thjeshtoni lojërat me qëllim të menaxhimit më të lehtë. Ju mund të kërkoni për më shumë lojëra edhe në linkun:

<https://youtu.be/FnVmwDdRjfA>

Reflektimi: _____

Shtëpia ime

Fusha kurrikulare:	Matematikë
Kurrikula lëndore:	Matematikë
Tema nga plani dymujor:	Orientimet
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):	I-3, 5; II-1; III-2. 3; V-5
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):	Matematika: 1.2 Gjuhët dhe komunikimi: 1.1.1; 1.2; 1.4 Jeta dhe puna: 1
Rezultati i të nxënit të temës:	Përshkruan vendndodhjen e një objekti, duke iu referuar një objekti tjetër ose vetes së tij dhe duke përdorur fjalë të jetës së përditshme: para – prapa; poshtë – lart; mbi – nën; majtas – djathtas; brenda – jashtë; afër – larg etj. Lëvizë në drejtime të caktuara, duke u orientuar nga fjalët; para, drejt, majtas, djathtas, prapa, afër, larg, nën etj.
Rezultatet e të nxënit të aktiviteteve:	<ul style="list-style-type: none"> • Tregon vendndodhjen e personazheve në ilustrim. • Identifikon vendndodhjen e një objekti në lidhje me një objekt të dhënë. • Krijon shtëpinë me blloqe.
Kriteret e suksesit:	<ul style="list-style-type: none"> • Trego vendndodhjen e personazheve në ilustrim. • Identifiko vendndodhjen e një objekti në lidhje me një objekt të dhënë. • Krijë shtëpinë me blloqe.
Burimet dhe materialet:	Libër ilustrues, blloqe etj.
Integrimi ndërfaqor:	Gjuhë shqipe, Shkathtësi për jetë.
Çështjet ndërkurrikulare:	Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.
Fjalë kyçe:	Shtëpi, majtas, djathtas, ec, ndalo etj.
Organizimi i aktiviteteve:	<p>Pas përshëndetjes dhe kalendarit luhet loja didaktike “Zbulimi i vetive”. Gjatë saj, fëmijët gjejnë sa më shumë fjalë për të përshkruar anëtarët e familjes.</p> <p>Secili fëmijë përshkruan anëtarët e familjes sipas mënyrës së tij. Edukatori/ja pranon mendimet e fëmijëve, duke i inkurajuar ata të respektojnë fjalën e njëri-tjetrit.</p> <p>Edukatori/ja u kërkon fëmijëve të marrin librat e tyre të punës dhe të kthehen sërish në rreth. Ai/ajo hap librin e saj dhe fëmijët librat e tyre (fusha e matematikës, fletëza “Orientimi”). Edukatori/ja paraqet ilustrimet prej të cilave fëmijët krijojnë një ngjarje.</p> <p>Gjatë kësaj faze, edukatori/ja thekson vendndodhjen e personazheve në raport me objektet “majtas-djathtas”. Ajo i lejon fëmijët që të shprehin opinionet e tyre lidhur me veprimet e paraqitura në ilustrim.</p>

Në vijim, fëmijët bëjnë punë të pavarur. Ata ndërtojnë një shtëpi me blloqe ose bëjnë një vizatim. Edukatori/ja duhet të ketë kujdes gjatë ndërtimit të blloqeve që të krijohen hapësirat e nevojshme, në mënyrë që fëmijët të mund të ecin në mes tyre.

Pas ndërtimit të shtëpive, edukatori/ja i udhëzon fëmijët që të ecin përgjatë tyre. Secili fëmijë qëndron te shtëpia që ka ndërtuar vetë dhe e përshkruan. Ecën, ndalon, përshkruan shtëpinë dhe familjen që jeton aty, kë ka majtas apo djathtas. Orientimi në hapësirë praktikohet për të gjithë fëmijët.

Edukatori/ja kujdeset të dokumentojë punën e çdo fëmije. Pas përfundimit të lojës, fëmijët udhëzohen t'i kthejnë blloqet dhe materialet e tjera në vendet përkatëse.

Më pas, edukatori/ja së bashku me fëmijët dalin në hapësirat e jashtme të institucionit dhe diskutojnë mbi orientimin në hapësirë dhe vendndodhjen e objekteve në oborrin e institucionit dhe lidhjen mes tyre.

Vlerësimi: Edukatori/ja mban shënime përshkruese për secilin fëmijë gjatë orientimit në hapësirën brenda klasës.

Më shumë për të bërë: Kërkoni nga prindërit që të praktikojnë lojëra të ndryshme për orientimin në hapësirë me fëmijët e tyre.

Reflektimi:

Historia e ariut Artur

Fusha kurrikulare: Gjuhë dhe komunikim

Kurrikula lëndore: Gjuha shqipe

Tema nga plani dymujor: Tinguj, shkronja, rrokje, fjalë, fjali

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I-3; II-7; III-2; V-5

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): Gjuhët dhe komunikim: 1.1; 1.3; 3.2
Matematika: 3.4
Shkencat e natyrës: 1
Artet: 1

Rezultati i të nxënit të temës: Shqiptojnë drejt tingujt (zanore dhe bashkëtingëllore) gjatë të shprehurit.

Rezultatet e të nxënit të aktiviteteve:	<ul style="list-style-type: none"> • Tregon historinë e Arturit në bazë të asaj që ka dëgjuar. • Emërton së paku një objekt, diçka që fillon me tingullin A. • Plotëson sipas modelit të dhënë shkronjën A.
Kriteret e suksesit:	<ul style="list-style-type: none"> • Trego historinë e Arturit në bazë të asaj që ke dëgjuar. • Emërto së paku një objekt, diçka që fillon me tingullin A. • Plotëso sipas modelit të dhënë shkronjën A.
Burimet dhe materialet:	Libri "Arta dhe ariu", pjata letre/plastike, lapsa, ngjyra.
Integrimi ndërfaqor:	Edukatë muzikore, Njeriu dhe natyra, Matematikë.
Çështjet ndërkurrikulare:	Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.
Fjalë kyçe:	Shkronja A, shkronjat, ariu, emri, lodër pelushi.
Organizimi i aktiviteteve:	<p>Edukatori/ja vendos një ari prej pelushi afër karriges së saj. Pasi vijnë të gjithë fëmijët në rreth për takimin e përbashkët, ai/ajo ua prezanton mikun ari të quajtur Artur. "Ariu Artur është i dashur me fëmijët dhe ka ardhur të na thotë një histori". Edukatori/ja, duke imituar ariun, fillon të lexojë tregimin "Arta dhe ariu". Ata bashkëbisedojnë mbi historinë e lexuar dhe edukatori/ja, pak nga pak, inkurajon fëmijët të identifikojnë shkronjën me të cilën fillojnë emrat: <i>Arta, Artur, ari</i> etj. Kështu, fëmijët nxiten që të identifikojnë shkronjat e para të emrave të tyre dhe ata me shkronjën A ngrihen në këmbë dhe bëjnë një përshkrim me gjeste, pa fjalë, të një diçkaje që fillon me shkronjën A. Fëmijët e tjerë përpiqen të gjejnë çka u përshkruhet. Më pas, të gjithë emërtojnë gjëra të ndryshme që fillojnë me shkronjën A. Fëmijët ndahen nëpër qendra të aktiviteteve.</p> <p>Në njërën qendër, ata do të plotësojnë fletëzen për shkronjën A. Në një tjetër, fëmijëve u ofrohen pjata me miell ku ata do të krijojnë gjurmët e shkronjave. Në qendrën tjetër, ata do të ndërtojnë me blloqe dhe materiale shoqëruese (shaje, boçe pishe, lodra të vogla etj.) pyllin dhe shtëpinë e Artës dhe Ariut.</p> <p>Në takimin përmbyllës luhet loja me shkronja.</p> <p>Sigurohen pjata letre/plastike aq sa fëmijë ka në grup. Në secilën pjatë shkruhet nga një shkronjë (shkronjat e para të emrave të fëmijëve). Pjatat vendosen në dysheme në formë rrethore dhe fëmijët vihen përçark. Në sfond, edukatori/ja lëshon muzikë ritmike dhe fëmijët do të vallëzojnë përreth pjatave. Në momentin që muzika ndalet, ata do të identifikojnë shkronjën që kanë përpara tyre.</p> <p>Nëse fëmijët kanë problem në identifikimin e ndonjë shkronje, edukatori/ja mund t'i ndihmojë sipas nevojës. Ndiurma mund të ofrohet në formë të tërthortë, p.sh.: duke i treguar një gjë që fillon me atë shkronjë, në mënyrë që fëmija ta identifikojë më lehtë.</p>
Vlerësimi:	Sa kanë arritur fëmijët të identifikojnë shkronjën A? A kanë arritur të ndjekin vijat udhëzuese për të shkruar shkronjën? Si gjenden ata brenda hapësirës së fletëzës për plotësim?
Më shumë për të bërë:	Edukatori/ja mund të organizojë edhe lojën: Çfarë ka në kuti? Në një kuti kartoni, vendosni disa objekte të ndryshme ndër to edhe disa të cilat fillojnë me shkronjën A. Me radhë, fëmijët nxjerrin objektet dhe i vendosin në mes të rrethit, më pas bashkërisht i emërtojnë dhe i grupojnë objektet që fillojnë me shkronjën A.
Reflektimi:	_____

Emocionet tona

Fusha kurrikulare:	Edukata fizike, sportet dhe shëndeti
Kurrikula lëndore:	Edukata fizike, sportet dhe shëndeti
Tema nga plani dymujor:	Njohja e vetës dhe botës
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):	I-3, 5, 8; II-7; III-6; V-5
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):	Edukata fizike, sportet dhe shëndeti: 1 Gjuhët dhe komunikimi: 1, 1; 1, 3; 1, 4 Artet: 1 Matematikë: 3.5
Rezultati i të nxënit të temës:	Shfaq emocione përmes lojës, aktiviteteve grupore, bashkëveprimit me edukatoren, fëmijët dhe të tjerët.
Rezultatet e të nxënit të aktiviteteve:	<ul style="list-style-type: none"> • Këndon këngën duke shoqëruar me lëvizje trupore. • Emërton gjendjen emocionale sipas ilustrimeve. • Paraqet me anë të vizatimit emocionin e dhënë.
Kriteret e suksesit:	<ul style="list-style-type: none"> • Këndo këngën duke shoqëruar me lëvizje trupore. • Emërto gjendjen emocionale sipas ilustrimeve. • Paraqit me anë të vizatimit emocionin e dhënë.
Burimet dhe materialet:	Fotografi të ilustruara, kubi, kuti, materiale recikluese (fasule, pulla, makarona) ngjyra, ngjitës etj.
Integrimi ndërfaqor:	Gjuhë shqipe, Edukim muzikor, Matematikë.
Çështjet ndërkurrikulare:	Emocion, pozitiv, negativ, ndjesi, reagim.
Fjalë kyçe:	Zhvillimi personal dhe shkathtësi për jetë.
Organizimi i aktiviteteve:	<p>Pas përshëndetjes, fëmijët ftohen në rreth dhe bashkërisht mësojmë këngën e mëposhtme.</p> <p>Nëse je vërtet i lumtur Nëse je vërtet i lumtur, përplas duart, nëse je vërtet i lumtur, përplas duart, nëse je vërtet i lumtur dhe fytyra ta tregon, nëse je vërtet i lumtur, përplas duart.</p> <p>Zëvendësoni fjalën <i>i lumtur</i> me emocionet tjera: i nervozuar – përplas këmbët i frikësuar – luaj gjunjët i gëzuar – bëj urra (hidhu lart) etj.</p> <p>Pas këngës fillon bashkëbisedimi për ndikimin e emocioneve në trupin tonë dhe për mënyrat se si mund t'i kontrollojmë ne reagimet tona që vijnë prej tyre.</p>

SI NDIHESH SOT?



Tregojuni fëmijëve disa fotografi me shprehje të ndryshme fytyrash dhe pastaj futini në një kuti. Ftojini fëmijët me radhë të marrin një fotografi nga kutia dhe të thonë se çfarë emocioni paraqet ajo. (Mund të printoni fotografi të tilla dhe t'i plastifikoni ato.)

Fëmijët ndahen në grupe të vogla pune: Edukatori/ja fton fëmijët të përzgjedhin në mënyrë rastësore një fotografi, e cila shpreh një emocion të caktuar. Më pas, fëmijët do të përzgjedhin këndin e aktivitetit. Edukatori/ja ka përgatitur tri kënde me materiale të ndryshme.

Në një kënd u ofrohen ngjyrat dhe vizatimi për të paraqitur emocionin e përzgjedhur.

Në këndin tjetër u ofrohen makarona, fasule, pulla, letër dhe ngjitës.

Në këndin tjetër u ofrohen fletëza me të cilat fëmijët do të formojnë emocionet. Gjatë kohës që fëmijët punojnë, edukatori/ja lëshon muzikë me zë të ulët në sfond. Kështun fëmijët do të paraqesim emocionet përmes shprehjes së tyre artistike.

Pasi të kenë përfunduar të gjithë, fëmijët ftohen për lojën "Kubi dhe mimika". Loja i jep mundësi secilit fëmijë të hedhë kubin dy herë. Hedhja e parë lëviz sytë, ndërsa e dyta lëviz buzët, sipas vizatimit në fletë.



Të gjithë së bashku përsërisin emocionet e mësuara dhe secili përshkruan vizatimin që e ka bërë gjatë lojës "Kubi dhe mimika". Në vijim, fëmijëve u kërkohet të përshkruajnë emocionet e tyre në situata të ndryshme.

Vlerësimi:

Fëmijët ftohen të shohin fotografi të ndryshme të shprehjeve të fytyrave (nga librat, revistat etj.), të emërtojnë emocionet që shprehin ato dhe t'i grupojnë në pozitive ose negative.

Më shumë për të bërë:

Kërkoni nga fëmijët që të zgjerojnë informacionet për emocionet, duke pyetur në familje, prindërit apo gjyshërit.

Reflektimi:

Libri im i ndjenjave

Fusha kurrikulare:	Shoqëria dhe mjedisi
Kurrikula lëndore:	Shoqëria dhe mjedisi
Tema nga plani dymujor:	Unë dhe të tjerët
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):	I-3, 5, 8; II-7; III-6; V-5
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):	Shoqëria dhe mjedisi: 1.2 Gjuhët dhe komunikimi: 1.1; 1.4 Matematikë: 3.5
Rezultati i të nxënit të temës:	Përshkruan emocionet e veta për situata të ndryshme.
Rezultatet e të nxënit të aktiviteteve:	<ul style="list-style-type: none"> • Imiton kafshën, njëren nga kafshët e dhëna. • Krijon librin e emocioneve sipas udhëzimeve. • Emërton emocionin sipas imazhit të dhënë.
Kriteret e suksesit:	<ul style="list-style-type: none"> • Imito njëren nga kafshët e dhëna. • Krijoj librin e emocioneve sipas udhëzimeve. • Emërto emocionin sipas imazhit të dhënë.
Burimet dhe materialet:	Libri i punës për fëmijë, kohëmatës, muzikë ritmike, gërshtë, ngjitës letre.
Integrimi ndërfaqor:	Gjuhë shqipe, Matematikë.
Çështjet ndërkurrikulare:	Edukimi për paqen.
Fjalë kyçe:	Emocion, çlodhje, ndjenjë, pozitive, negative, libër.
Organizimi i aktiviteteve:	<p>Edukatori/ja i pret fëmijët dhe i pyet si ndihen, çfarë emocionesh kanë. Pas përshëndetjeve për fillimin e ditës, vazhdohet me <i>ushtrimet për rregullimin e emocioneve</i>, të cilat janë ushtrime stimuluese që lirojnë fëmijën nga ngarkesat emocionale dhe nxitin të nxënit. Këto ushtrime i ndihmojnë fëmijët të fillojnë ditën në gjendje emocionale pozitive.</p> <p>Çfarë ju nevojitet?</p> <ul style="list-style-type: none"> • Një kohëmatës. • Muzikë ritmike. <p>Vendoseni kohëmatësin në 7 intervale prej 45 sekondash pune dhe 15 sekonda pushimesh (gjithsej 7 minuta).</p> <p>Përgatiteni muzikën ritmike gati për të kërcyer vullshëm dhe për të bërë ushtrime edhe ju së bashku me fëmijët. Demonstroniu atë që dëshironi të shihni prej tyre. Ata duhet të bëjnë sa më shumë ushtrime që të jetë e mundur në 45 sekonda. Në fund të 7 minutave të lojës, ju jeni duke marrë frymë thellë, zemrat ju rrahin fort dhe jeni të çliruar nga çdo emocion i padëshirueshëm.</p>

Ushtrimet që bëhen janë imitime të kafshëve të ndryshme në mënyrë zbavitëse e qesharake.

1. Kërcim bretkose
2. Ecje ariu
3. Lëvizje gorille
4. Kërcim yll deti
5. Vrapim leopardi
6. Lëvizje gaforreje
7. Lëvizje elefanti

Pasi përfundohen të gjitha imitimet, ndalet muzika dhe ftohen fëmijët të ulen dhe të marrin frymë thellë të gjithë së bashku për rreth 1 minutë, që të çlodhen e qetësohen.

Fëmijët pyeten se si u ndienë gjatë ushtrimeve dhe si po ndihen tani që janë në prehje. Emërtojmë bashkërisht disa emocione dhe ftojme fëmijët të ndërtojnë librin e tyre të ndjenjave (fletëza në librin e fëmijës, ushtrime për emocionet).

<https://hes-extraordinary.com/improve-emotional-regulation-just-7-minutes-per-day>

Fëmijët mund të luajnë me lojëra tavoline deri kur të gjithë të përfundojnë me librin e ndjenjave. Pasi të kenë përfunduar të gjithë, ftojme fëmijët në rreth dhe diskutojmë bashkërisht punën që kanë bërë te "Libri im".

Vlerësimi:

Realizimi i aktivitetit na tregon se sa i njohin ata emocionet e tyre dhe situatat që ua shkaktojnë ato. Edukatori/ja mban shënime sipas nevojës.

Më shumë për të bërë:

Praktikimi i ushtrimeve për rregullimin e emocioneve mund të bëhet një rutinë ditore që i ndihmon fëmijët të çlirohen nga ngarkesat emocionale dhe në klasë të mbizotërojë një energji pozitive.


Ju mund t'i referoheni edhe linkut të mëposhtëm, i cili përmban 5 aktivitete kreative të cilat mund të ndihmojnë fëmijët për ushtrimin e vetëkontrollit:

https://www.youtube.com/watch?v=H_O1brYwdSY

Reflektimi:

Luajmë dhe mësojmë

Fusha kurrikulare:	Jeta dhe puna
Kurrikula lëndore:	Shkathtësi për jetë
Tema nga plani dymujor:	Mjedisi shtëpiak
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):	I -3, 5, 6, 8; II -7; III -2, 6; V -5
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):	Jeta dhe puna: 1.2 Matematikë: 3.5 Gjuhët dhe komunikimi: 1.2; 1.5
Rezultati i të nxënit të temës:	Realizon aktivitete në bashkëpunim me të tjerët përmes lojës.
Rezultatet e të nxënit të aktiviteteve:	<ul style="list-style-type: none"> • Ndërton një tregim në bazë të fotografive të ilustruara. • Përshkruan shtëpinë sipas ilustrimeve. • Emërton së paku 5 emocione pozitive dhe negative.
Kriteret e suksesit:	<ul style="list-style-type: none"> • Ndërto një tregim në bazë të fotografive të ilustruara. • Përshkruaj shtëpinë sipas ilustrimeve. • Emërto së paku 5 emocione pozitive dhe negative.
Burimet dhe materialet:	Loja me tabelë, kubi, një histori e vizatuar/printuar në hapa.
Integrimi ndërfaqor:	Matematikë, Gjuhë shqipe.
Çështjet ndërkurrikulare:	Edukimi për paqe.
Fjalë kyçe:	Emocionet, pozitive, negative, skuadër.
Organizimi i aktiviteteve:	Dita fillon me pritjen e fëmijëve, duke u përqendruar te gjendja e tyre emocionale dhe duke i nxitur të përshkruajnë si ndihen. Pastaj fillon krijimi i historisë në bazë të fotografisë. Ju keni printuar ose vizatuar një histori të ngjashme si kjo më poshtë.



Fëmijëve u shpjegohen format e ndryshme të leximit, se si ata mund të ndërtojnë histori në bazë të fotografive. Komentohet tregimi dhe flitet për emocionet që përcjell personazhi kryesor i tij.

Loja me tabelë gjendet bashkangjitur me librin.

Ecuria:

Fëmijët ndahen në dy grupe të barabarta në numër. Si skuadër, ata emërtojnë së bashku grupin e tyre. Tabela vendoset në mes të klasës, dhe dy grupet e fëmijëve anash.


Secila skuadër vendos bashkërisht për një objekt identifikues me të cilin do të lëvizin në tabelë gjatë lojës, ky objekt mund të jetë kuti ngjyrash, gomë, ngjitës apo diçka tjetër. Me radhë, secili fëmijë



gjuan kubin dhe lëviz në tabelë aq herë sa tregon numri që bie. Kur objekti ndalet te kutia ku fillojnë shkallët, skuadra ngjitet lart aty ku përfundojnë shkallët. Kur objekti ndalet te bishti i gjarprit, ai duhet të zbresë te goja e tij, ndërsa kur ndalet te rubrika, në të cilën edukatori/ja ka ngjitur skedën me pyetje, fëmija që ka gjuajtur kubin duhet t'i përgjigjet pyetjeve.

Loja me tabelë ka edhe formën e kubit të hapur, të parapërgatitur, të cilën mund ta përdorni.

Përpiloni disa pyetje që lidhen me emocionet, si p.sh.:



- Emërto 5 emocione pozitive.
- Emërto 5 emocione negative.
- Trego një situatë që ju bezdis.
- Ndaj me shokët/shoqet një përvojë të bukur që të ka dhuruar shumë emocione pozitive.

(Këto pyetje mund të shkruhen në skeda ngjitëse dhe të vendosen nëpër hapësira të ndryshme brenda lojës me tabelë.)

Kjo lojë nxjerr një skuadër fituese. Fëmijët duhet të nxiten ta pranojnë fitoren e skuadrës kundërshtarë që të edukohen se në një lojë ka edhe fitues, edhe humbës.

Pas përfundimit të aktiviteteve ftojini fëmijët në diskutim për format e ndryshme të leximit, përsërisni edhe një herë historinë që u krijua në bazë të fotografive, flisni për lojën me tabelë, pyetini si u ndjenë kur morën vendime (për emrin e skuadrës, gjetjen e objekteve identifikuese të lojës) si e përjetuan fitoren/humbjen, çfarë ndjesish u përcolli loja etj. Dita përmbyllet me "Lojën me balonë". Fëmijët ndahen në grupe me nga 4-5 vetë. Të kapur dorë për dore, ata do të përpiqen ta mbajnë sa më gjatë balonën në ajër. Ju mund të vizatoni shprehje të ndryshme emocionale në balona. Loja nuk është garuese, qëllimi i saj është të sjellë një klimë pozitive në grup.

Vlerësimi:

A janë të gatshëm fëmijët të ndërtojnë histori në bazë të figurave? A kanë vështirësi në gjetjen e fjalëve për të përshkruar një fotografi?

A janë familjarizuar fëmijët me identifikimin e emocioneve? Si reagojnë ata në situata sfiduese gjatë lojës? Si e pranojnë humbjen dhe fitoren e njëri-tjetrit?

Më shumë për të bërë:

Loja me skuadra, në të cilën fëmijët përjetojnë humbjen, mund të sjellë edhe emocione të pakëndshme, prandaj këshillohet të shtoni ndonjë veprimtari çlodhëse ku të përfshihen të gjithë fëmijët si një grup i vetëm. Kjo veprimtari mund të jetë një vallëzim i thjeshtë me muzikë të këndshme që ndryshon gjendjen e tyre emocionale.

Reflektimi:

E – elefanti


Fusha kurrikulare:	Gjuhë dhe komunikim
Kurrikula lëndore:	Gjuhë shqipe
Tema nga plani dymujor:	Tinguj, shkronja, rrokje, fjalë, fjali
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):	I.3, 5, 6, 8; II.7; III.2, 6; V.5
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):	Gjuhët dhe komunikimi: 1.1; 1.2; 1.4; 1.5; 3.2 Shkenca dhe natyra: 1 Artet: 1
Rezultati i të nxënit të temës:	Përqendrohen në të dëgjuar e të folur për të kuptuar informacionin, këshillën, ngjarjen, tregimin, përrallën, përrallëzën etj.
Rezultatet e të nxënit të aktiviteteve:	<ul style="list-style-type: none"> • Emërton së paku një objekt që fillon me shkronjën E. • Tregon historinë e elefantit. • Plotëson modelin e shkronjës E në librin e punës.
Kriteret e suksesit:	<ul style="list-style-type: none"> • Emërto së paku një objekt që fillon me shkronjën E. • Trego historinë e elefantit. • Plotëso modelin e shkronjës E në librin e punës.
Burimet dhe materialet:	Libri i punës për fëmijë, fletë e madhe, lapsa, ngjyra, gërshtë, ngjitës, revista të vjetra.
Integrimi ndërfushor:	Njeriu dhe natyra, Edukim figurativ.
Çështjet ndërkurrikulare:	Arsim për zhvillim të qëndrueshëm.
Fjalë kyçe:	Elefant, emocion, besim, paaftësi, liri, tingulli E, shkronja E.
Organizimi i aktiviteteve:	<p>Në fillim të ditës, edukatori/ja pret fëmijët, të cilët ulen duke formuar një rreth, dhe i fton ata që të prezantohen me radhë dhe me zë të lartë. Fëmijët, emri i të cilëve fillon me shkronjën E, emërtojnë 3 gjëra që fillojnë me shkronjën E. Pasi fëmijët mbarojnë, ju mund të vendosni në mes të grupit një shkronjë E gjigante, në të cilën fëmijët mund të ngjisin figura që fillojnë me shkronjën E. Pasi ta plotësoni shkronjën gjigante me fotografi, vendosni së bashku për vendin ku do ta ekspozoni.</p> <p>Ftoni fëmijët që të dëgjojnë historinë e elefantit:</p> <p>“Historia e elefantit që nuk besonte aftësinë e tij”</p> <p><i>Një njeri po kalonte rrugës. Ai pa një elefant shumë të mërzitur. Elefanti e kishte këmbën të lidhur. Njeriu u ndal, i hutuar, duke menduar: “Pse ky elefant aq i madh nuk lëviz dot nga vendi? Ai është i lidhur vetëm me një litar i vogël në këmbë. Nuk ka zinxhirë, nuk ka kafaze. Elefanti është aq i fuqishëm, sa po të dojë e këput litarin. Pse nuk e bën?”</i></p>

Ai pyeti kujdestarin e elefantit aty pranë: "Pse elefanti rri aty dhe nuk përpiqet që të ikë?". "E po, - tha kujdestari, - kur ai ishte shumë i ri dhe shumë i vogël ne e lidhnim me këtë litar e ai nuk mund të ikte. Tani që është rritur ai beson se nuk e këput dot, prandaj nuk përpiqet të çlirohet."

Njeriu u habit. Elefanti mund ta çlironte vetë kur të donte nga litari, por ngaqë besonte se nuk mund ta bënte, rrinte aty në vend i mbërthyer.

Ashtu si elefanti, edhe ne nëse dështojmë herën e parë, vazhdojmë gjithnjë të besojmë se nuk mund ta bëjmë diçka.

Dështimi është pjesë e mësimit, ne kurrë nu duhet të heqim dorë nga përpjekjet në jetë.



Kjo histori, përveç mesazhit, përcjell te fëmijët edhe emocione të ndryshme. Ata ftohen të diskutojnë rreth saj: si e kuptuan historinë, si ndihej elefanti, çfarë besonte ai etj. Dita vazhdon me punën në qendrat e aktivitetit.

Në njërin grup, fëmijët do të plotësojnë fletëzat e punës.

Në grupin tjetër do të ndërtojnë elefantin me materiale të natyrës.

Në grupin e tretë, fëmijët do të eksperimentojnë të lirë me ngjyra uji.

Vlerësimi:

A i veçojnë dot fëmijët fotografitë me figura që përkojnë me shkronjën E? Sa interes kanë për të dëgjuar historinë pa ilustrime? A e kuptojnë mesazhin që përcjell historia? A janë të gatshëm ta komentojnë historinë dhe të marrin pjesë në bashkëbisedim? Reflekto!

Më shumë për të bërë:

Mund të kërkoni nga prindërit që t'u lexojnë fëmijëve së paku 15 minuta në ditë, në mënyrë që atyre t'u rritet interesi për librin dhe të zgjerojnë horizontin e dijes.

Reflektimi:

Treni ynë në udhëtim

Fusha kurrikulare:	Matematikë
Kurrikula lëndore:	Matematikë
Tema nga plani dymujor:	Orientimi
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):	I-3, 5; II-1; III-2, 3; V-5
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):	Matematika: 1.2 Gjuhët dhe komunikimi: 1.1; 1.5 Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti: 2.1
Rezultati i të nxënit të temës:	Fëmija përshkruan vendndodhjen e një objekti, duke iu referuar një objekti tjetër ose vetes dhe duke përdorur fjalët: <i>para - prapa, poshtë - lart, mbi - nën, majtas - djathtas, brenda - jashtë, afër - larg</i> etj.
Rezultatet e të nxënit të aktiviteteve:	<ul style="list-style-type: none"> • Vepron sipas udhëzimeve të lojës. • Lëviz sipas sinjalizimit në drejtimin e caktuar. • Përshkruan vendndodhjen e objektit duke iu referuar objektit tjetër.
Kriteret e suksesit:	<ul style="list-style-type: none"> • Vepron sipas udhëzimeve të lojës. • Lëviz sipas sinjalizimit në drejtimin e caktuar. • Përshkruaj vendndodhjen e objektit duke iu referuar objektit tjetër.
Burimet dhe materialet:	Shamia, blloqe druri, makinë lodër, kukull, pengesë.
Integrimi ndërfaqor:	Gjuhë shqipe, Edukatë fizike.
Çështjet ndërkurrikulare:	Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.
Fjalë kyçe:	Lojë, sfidë, fitore, orientim, anash, majtas, djathtas, drejt.
Organizimi i aktiviteteve:	<p>Kërkoni nga prindërit që t'i sjellin fëmijët të veshur me rroba të lirshme.</p> <p>Edukatori/ja bisedon me fëmijët dhe u thotë se sot kanë ditën e lojërave sfiduese. Ajo u tregon për rregullat dhe ecurinë e lojërave, për rëndësinë e respektimit të njëri-tjetrit, për pritjen në radhë, për kujdesin që duhet treguar që të mos lëndohet shoku/shoqja.</p> <p>Nëse moti është i mirë, fëmijët ftohen të dalin të gjithë së bashku në oborr dhe të ndahen në dy grupe. Secili grup e zgjedh vetë për emrin e tij.</p> <p>Loja "Treni në udhëtim"</p> <p>Edukatori/ja sigurohet që hapësira përreth është e sigurt dhe ndihmon fëmijët të organizohen.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Fëmijët rreshtohen njëri pas tjetrit. Përveç fëmijës së fundit në rresht, të gjithë të tjerët i lidhin sytë me shami me ndihmën e edukatores. Ata formojnë trenin, duke vendosur duart në supet e atij që kanë para.

- Fëmija në fund udhëzon shokët/shoqet me sinjalizim në supe duke ia drejtuar në rrugë.
- Vendosni disa pengesa në hapësirën përreth që loja të jetë më sfiduese.
- Treni duhet të udhëtojë pa prekur pengesat dhe pa u ndeshur me trenin tjetër.

Jepni sinjalizim për nisjen e trenit dhe nxitini fëmijët të japin udhëzime për orientim (ec anash, majtas, djathtas, kapërce etj.). Skuadra që has në pengesë, humb sfidën.

Pas përfundimit të lojës së trenit, fëmijët ftohen që të tokin duart me shokët/shoqet e skuadrës kundërshtare dhe t'i urojnë për fitoren. Pas kësaj, dy skuadrat formojnë një rresht/tren të gjatë. Edukatorja jep udhëzime orientuese për rrugën që do të bëjë treni deri në klasë (Nëse loja është zhvilluar në klasë, mund të shtohen disa pengesa dhe treni lëviz një ose dy minuta brenda klasës).

Kur loja përfundon, fëmijët ulen në rreth dhe diskutojnë për lojën e trenit. Fëmijët nxiten të bisedojnë dhe të reflektojnë rreth përvojës që patën me pyetje të tilla: Si janë ndier gjatë lojës me skuadra kundërshtare? Ku kanë hasur vështirësi? Sa i kanë ndjekur udhëzimet e lojës dhe çfarë rëndësie kanë ato? Si ndikuan në rezultatin përfundimtar? Kush nuk është ndierë mirë gjatë lojës dhe pse? Si mund ta përmirësojmë në të ardhmen?

Vëmendje të veçantë u kushtohet udhëzimeve orientuese që u dhanë gjatë lojës me tren, duke i përsëritur të gjitha së bashku. Në vijim, fëmijët ndahen në 4 grupe dhe u jepen kuba druri që të ndërtojnë një lagje. Pasi të kenë mbaruar, ata mund të luajnë lojë me role të vogla, duke përfshirë objekte si makina, trena, kukulla, kafshë të vogla etj. Kjo mundëson që fëmijët të zhvillojnë lojë të lirë sipas imagjinatës së tyre.

Edukatori/ja nxit fëmijët të bashkëbisedojnë për lojën e zhvilluar. Ata mund të shëtisin nga njëri grup në tjetrin për të parë lojën e zhvilluar nga secili grup (*shko anash, majtas, djathtas, bjeri përreth, shko sipër* etj.).

Vlerësimi:

Fëmijët vlerësohen në bazë të lëvizjes gjatë aktivitetit. Edukatori/ja mund të mbaj shënime anekdotike gjatë lojës së lirë të fëmijëve.

Më shumë për të bërë:

Për të organizuar aktivitete shtesë të orientimit hapësinor, ju mund t'i referoheni linkut të mëposhtëm:

<https://www.youtube.com/watch?v=ocVQvqN8IBQ>

Reflektimi:

Stinët

Fusha kurrikulare:	Artet
Kurrikula lëndore:	Edukata figurative
Tema nga plani dymujor:	Krijimet figurative
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):	I -3, 5; II -1, 7; III -2, 3; V -5
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):	Artet: 1 Gjuhët dhe komunikimi: 1.1; 1.4 Edukim fizik, sportet dhe shëndeti: 2.1
Rezultati i të nxënit të temës:	Fëmijët krijojnë dhe riciklojnë me materiale të ndryshme sipas fantazisë së tyre. Ata vizatojnë, ngjyrosin, modelojnë, duke përdorur format me ngjyra, pemët etj., për tema të ndryshme, duke shprehur imagjinatën dhe krijimtarinë e tyre.
Rezultatet e të nxënit të aktiviteteve:	<ul style="list-style-type: none"> • Tregon karakteristikat e stinës së parapëlqyer. • Përshkruan stinën që paraqet karta e përzgjedhur. • Krijon me materiale të ndryshme stinën përkatëse.
Kriteret e suksesit:	<ul style="list-style-type: none"> • Trego karakteristikat e stinës së parapëlqyer. • Përshkruaj stinën që paraqet karta e përzgjedhur. • Krijoj me materiale të ndryshme stinën përkatëse.
Burimet dhe materialet:	Enciklopedi për fëmijë, top, shportë me materiale të ndryshme (pambuk, copëza materiali, shkopinj, gjethe, lule të vogla, pipëza etj.), fletëza të bardha dhe me ngjyra, ngjyra, ngjites, gërshtë etj.
Integrimi ndërfaqor:	Gjuhë shqipe, Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti.
Çështjet ndërkurrikulare:	Arsim për zhvillim të qëndrueshëm.
Fjalë kyçe:	Stinë, pranverë, verë, vjeshtë, dimër, ndryshime etj.
Organizimi i aktiviteteve:	<p>Edukatori/ja e nis takimin e përbashkët me lojën me top, e cila organizohet në këtë formë: edukatori/ja kalon topin te njëri fëmijë dhe kërkon nga fëmija që të thonë emrin dhe të tregojnë se cila është stina e tij/saj e parapëlqyer. Loja vazhdon derisa të jenë përfshirë të gjithë fëmijët.</p> <p>Ai/ajo paraqet të dhëna nga enciklopedia për secilën stinë. Leximi zhvillohet duke ndërvepruar: fëmijëve u kërkohet të pyesin apo të përgjigjen rreth të dhënave që jepen.</p> <p>Edukatori/ja ka përgatitur karta të vogla për secilën stinë dhe kërkon nga fëmijët që të përzgjedhin njërin prej tyre. Secili duhet të tregojë stinën që paraqet karta e përzgjedhur. Numri i kartave duhet të jetë i njëjtë me numrin e fëmijëve dhe ndarja e kartave sipas stinëve duhet të jetë në përpjesëtim të drejtë.</p>

Në varësi të kartës që kanë përzgjedhur fëmijët ndahen në katër grupe për të vazhduar aktivitetet me grupe të vogla.

Edukatori/ja ka ekspozuar në mes të klasës materialet që do të përdoren, në mënyrë që secili grup të mund të marrë çka i duhet për të paraqitur stinën përkatëse në një punim të përbashkët. Edukatori/ja u shpërndan grupeve nga një fletë A2, që të punojnë në grupe njëerën nga stinët, sipas kartave që kanë.

Pas përfundimit të punës artistike, fëmijët udhëzohen të kujdesen për hapësirën e punës, në mënyrë që materialet e mbetura dhe mjetet e tjera të punës të dërgohen në vendet përkatëse.

Edukatori/ja dhe fëmijët ulen në formë rrethi, duke pasur përpara punimet e çdo grupi. Të gjithë së bashku diskutojnë sërish rreth karakteristikave të secilës stinë, duke e parë dhe në kalendarin e klasës. Në fund, edukatori/ja kërkon nga fëmijët që të flasin për stinën e tanishme dhe ndryshimet që ajo ka nga stinët e tjera.

Me miratimin e fëmijëve punimet ekspozohen në një kënd të klasës sipas rendit të stinëve.

Me muzikë në sfond, së bashku me edukatorin/en, fëmijët do të emitojnë lëvizjet sipas tingujve të natyrës. (Ju mund të kërkonit për inçizime në të cilat imitohen tingujt e natyrës: shiut, erës, valëve të detit, shtrëngatës etj.)

Vlerësimi: Edukatori/ja vëzhgon dhe mban shënime për ndërveprimin e fëmijëve në grup, vendimmarrjen, përzgjedhjen e materialeve dhe mënyrën si përfshihen në grup.

Më shumë për të bërë: Fëmijët udhëzohen të vëzhgojnë natyrën përreth gjatë vajtje-ardhjes në klasën përgatitore dhe ta krahasojnë me atë të disa kohëve më parë.

Udhëzoni fëmijët që të pyesin prindërit për ndryshimin e stinëve.

Gjatë diskutimit me fëmijët, edukatori/ja mund të përdorë libra apo ilustrime të ndryshme, mund të paraqesë fotografi karakteristike të stinëve në programin *Power Point* etj.

Reflektimi: _____

Vjeshta - të veçantat e saj

Fusha kurrikulare:	Shkenca dhe natyra
Kurrikula lëndore:	Njeriu dhe natyra
Tema nga plani dymujor:	Toka dhe hapësira
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):	I.3; II.1, 7; III.1, 3, 6; IV; V-5
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):	Shkenca dhe natyra: 1 Gjuhët dhe komunikimi: 1.1; 1.4 Matematikë: 6.2
Rezultati i të nxënit të temës:	Tregon karakteristikat themelore të stinëve gjatë vitit.
Rezultatet e të nxënit të aktiviteteve:	<ul style="list-style-type: none"> • Eksploron ndërtimin e gjethes përmes xhamit zmadhues. • Zbulon ndërtimin e gjethes përmes stampimit në fletë.
Kriteret e suksesit:	<ul style="list-style-type: none"> • Eksploro ndërtimin e gjethes përmes xhamit zmadhues. • Zbulon ndërtimin e gjethes përmes stampimit në fletë.
Burimet dhe materialet:	Gjethë natyrore, xham zmadhues, ngjyrë, fletë të bardha etj.
Integrimi ndërfaqor:	Gjuhë shqipe, Matematikë.
Çështjet ndërkurrikulare:	Arsim për zhvillim të qëndrueshëm.
Fjalë kyçe:	Vjeshtë, ndryshim, mot, natyrë, formë, madhësi etj.
Organizimi i aktiviteteve:	<p>Takimi i përbashkët fillon me "Lojën e kujtesës". Përdorni kartat e një dite më parë. Edukatori/ja përmes pyetjeve nxitëse kërkon nga fëmijët të flasin për punën e bërë një ditë më parë.</p> <p>Për të vazhduar diskutimin për ndryshimet e vjeshtës, edukatori/ja lexon për fëmijët një tregim për stinën e vjeshtës, pas diskutimit bashkë me fëmijët dalin në oborin e institucionit. Fëmijët udhëzohen të vëzhgojnë për qark dhe të mbledhin gjethë të llojeve të ndryshme për nga forma, ngjyra apo madhësia.</p> <p>Pasi kthehen në klasë, fëmijët përfshihen në aktivitetet e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Njëri grup i fëmijëve shikon ndërtimin e gjethes me xham zmadhues. Ata diskutojnë së bashku rreth saj dhe e krahasojnë me gjethet e tjera. • Grupi tjetër i fëmijëve merr një gjethë sipas dëshirës dhe e vendos mbi një fletë të bardhë. Ata ngjyrosin mbi të derisa gjethja të lërë gjurmë mbi fletën e bardhë. Fëmijët mund t'i presin gjurmët e gjethes në fletë.



**Vlerësimi:**

- Grupi i tretë merr lloje të ndryshme të gjetheve, diskuton për to, format e tyre, ngjyrën madhësinë. Fëmijët mund t'i numërojnë dhe ndërveprojnë me to.

Fëmijët do të kenë mundësi të përfshihen në të tria veprimtaritë e zhvilluara gjatë ditës së sotme. Në takimin përmbyllës, ata diskutojnë rreth përvojave që patën dhe njohurive që morën.

Vëzhgimi i vazhdueshëm dhe mbajtja e shënimeve; nëse ndonjëri nga fëmijët ka nevojë për më shumë përkrahje për t'u shprehur lirshëm, edukatori/ja e inkurajon atë në mënyrë të vazhdueshme.

Më shumë për të bërë:

Fëmijët udhëzohen të sjellin nga shtëpia gjethe të ndryshme nga ato që u panë në klasë dhe të pyesin prindërit për të veçantat e vjeshtës.

Reflektimi:

Gjethet

Fusha kurrikulare: Matematika

Kurrikula lëndore: Matematika

Tema nga plani dymujor: Bashkësitë dhe relacionet

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I-3; II-1, 4; III-2; V-5

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): Matematikë: 6.2
Gjuhët dhe komunikimi: 1.1; 1.4
Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti: 1

Rezultati i të nxënit të temës: Klasifikon sende dhe objekte sipas disa vetive: ngjyrës, formës dhe madhësisë.

Rezultatet e të nxënit të aktiviteteve:

- Klasifikon gjethet sipas kriterëve të njohura.
- Krahason gjethet duke numëruar.
- Ndërvepron me grupin për të realizuar punimin.


Kriteret e suksesit:

- Klasifiko gjethet sipas kriterëve të njohura.
- Krahaso gjethet duke numëruar.
- Ndërvepro me grupin për të realizuar punimin.

Burimet dhe materialet: Gjethet, ngjitës, ngjyra, gërshtë.

Integrimi ndërfaqor: Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti, Gjuha shqipe.

Çështjet ndërkurrikulare:	Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.
Fjalë kyçe:	Klasifikim, grupim, formë, madhësi, gjethe, shumëllojshmëri.
Organizimi i aktiviteteve:	Edukatori/ja përgatit mjedisin përpara se fëmijët të vijnë në klasën përgatitore, duke shpërndarë gjethe gjithandëj nëpër klasë. Ai/ajo ndërton një tabelë me shirit ngjitës, me qëllim klasifikimi, si në figurë.



Takimi i përbashkët hapet me diskutimin për gjethet që janë në klasë. Pse dhe si bien ato. Edukatori/ja kërkon nga fëmijët që të mbledhin të gjitha gjethet e shpërndara në klasë dhe t'i vendosin në mes të rrethit. Në fund, atyre u kërkohet që të mbajnë dy gjethet të ndryshme për të luajtur lojën "Gjethet tunden". Loja luhet në rreth dhe ka për qëllim aktivizimin fizik të fëmijëve dhe përvetësimin e koncepteve të ndryshme që jepen në formë të udhëzimesh përgjatë lojës.

Udhëzimet e lojës: Ashtu si edukatori/ja, secili fëmijë ka në duar dy gjethet. Të gjithë mbajnë duart lart dhe tundin gjethet derisa edukatori/ja të japë sinjalin:


- *Gjethet tunden, gjethet tunden dhe bien...*
- *Gjethet tunden, gjethet tunden dhe bien gjethet e verdha.*
- *Gjethet tunden, gjethet tunden dhe bien gjethet e kuqe.*
- *Gjethet tunden, gjethet tunden dhe bien gjethet e gjelbra.*

Vazhdohet kështu derisa të përdoren të gjitha karakteristikat e njohura.

Loja përsëritet në varësi të dinamikës së grupit.

Pas përfundimit të lojës, përdoret tabela e klasifikimit ku grupohen gjethet për nga lloji. Në tabelë vendosen modelet e gjethëve në bazë të të cilave bëhet klasifikimi.

Pas ndërtimit të tabelës, secili fëmijë vendos gjethet që ka në grafikun e ndërtuar.



Edukatori/ja nxit diskutimin për gjethet e vendosura në grafik, ndërkohë ndryshon kriteret e klasifikimit:

- sipas formës;
- sipas madhësisë;
- sipas ngjyrës etj.

Diskutimi vazhdon pas secilit klasifikim.

Në vijim, fëmijët ndahen në katër grupe të mëdha. Edukatori/ja në bashkëpunim me fëmijët përcaktohen kriteret e punës së përbashkët:

- Grupi i parë bën një portret me gjethe.
- Grupi i dytë bën spiralen e gjetheve që bien.
- Grupi i tretë ndërton me gjethe sipas dëshirës.
- Grupi i katërt ndërton me plastelinë.

Në diskutimin e takimit përmbyllës, edukatori/ja nxit fëmijët të bëjnë pyetje dhe t'i marrin përgjigjet nga shokët/shoqet.

Vlerësimi:

Edukatori/ja vëzhgon dhe mban shënime si ndërveprojnë fëmijët në grup.

Më shumë për të bërë:

Fëmijët mund të provojnë të bëjnë një punim me gjethe edhe në shtëpi. Sinjalet për lojën mund të jepen edhe nga fëmijët.

Edukatori/ja mund ta modifikojë aktivitetin sipas nevojës së grupit.

Edukatori/ja është i/e lirë të ndryshojë sipas kontekstit, kërkesave apo nevojave të fëmijëve aktivitetet grupore. Ai/ajo mund t'i lejojë grupet të përcaktojnë çfarë duan të paraqesin përmes përdorimit të gjetheve.

Reflektimi:

Iriqi në vjeshtë

Fusha kurrikulare:	Gjuhët dhe komunikimi
Kurrikula lëndore:	Gjuha shqipe
Tema nga plani dymujor:	Tinguj, shkronja, rrokje, fjalë, fjali
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):	I-3, 5, 6, 8; II-1, 7; III-2, 6; V-5
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):	Gjuhët dhe komunikimi: 1.1; 1.2; 1.4; 1.5; 3.2 Matematikë: 6.1 Edukim muzikor: 1 Shoqëria dhe mjedisi: 5
Rezultati i të nxënit të temës:	Përqendrohen në të dëgjuar e të folur për të kuptuar informacionin, këshillën, ngjarjen, tregimin, përrallën etj.
Rezultatet e të nxënit të aktiviteteve:	<ul style="list-style-type: none"> • Përshkruan veprimet e iriqtit përgjatë tregimit. • Provon të shkruajë shkronjën I në materiale të ndryshme. • Plotëson shkronjën I në fletëzën e punës.
Kriteret e suksesit:	<ul style="list-style-type: none"> • Përshkruaj veprimet e iriqtit përgjatë tregimit. • Provon të shkruajë shkronjën I në materiale të ndryshme. • Plotëso shkronjën I në fletëzën e punës.
Burimet dhe materialet:	Libër me tregime, libri i fëmijës, pjata letre, miell, sheqer, kripë, rërë, piper i kuq etj.
Integrimi ndërfaqor:	Matematikë, Edukim muzikor, Shoqëria dhe mjedisi.
Çështjet ndërkurrikulare:	Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.
Fjalë kyçe:	Tingulli I, shkronja I, iriqt, shtëpiza etj.
Organizimi i aktiviteteve:	<p>Pas përshëndetjes dhe përfundimit të kalendarit, edukatori/ja fton fëmijët në lojën "Pikat e shiut".</p> <p>Përmes lëvizjeve të duarve, të këmbëve dhe të të gjithë trupit imitohen pikat e shiut: në fillim të vogla dhe të lehta, pastaj të furishme. Për t'i qetësuar fëmijët nga imitimi i shiut të furishëm, edukatori/ja i udhëzon fëmijët që të kalojnë gradualisht sërish në imitim e shiut të ngadaltë derisa të ndalojnë. Përdoren edhe perkusionet për të ritmizuar tingujt e shiut. Fëmijët udhëzohen të marrin frymë thellë dhe të qetësohen për aktivitetin në vazhdim. Ata mund të rrinë në këmbë, të ulen në karrige ose dysheme, sipas mundësive dhe në përshtatje me mjedisin e klasës.</p> <p>Pas lojës, edukatori/ja lexon në pjesë të ndara tregimin "Shtëpiza e iriqtit të vogël", duke e diskutuar udhëtimin dhe sjelljen e iriqtit ndaj kafshëve të tjera gjatë vjeshtës dhe dimrit, si dhe sjelljen e kafshëve ndaj iriqtit në pranverë. Fëmijëve u kërkohet që të përshkruajnë veprimet e iriqtit pas takimit me secilën nga kafshët.</p>

Nga tregimi, edukatori/ja natyrshëm kalon te shkronja me të cilën fillon emri i iriqit. Ai/ajo u kërkon fëmijëve që të përmendin emra të tjerë që fillojnë me shkronjën I ose që e kanë në përbërje atë. Mandej, ata germëzojnë bashkë emra të ndryshëm për të dalluar tingullin I.

Në aktivitetet me grupe të vogla, edukatori/ja ofron 6 pjata të mbushura me materiale të ndryshme, që fëmijët të praktikojnë lëvizjen e dorës për shkrimin e shkronjës I.

Grupet ndërrohen me njëri-tjetrin, në mënyrë që secili fëmijë të praktikojë shkrimin e grafikut në materiale të ndryshme.

Në vijim, fëmijët marrin librat e punës për të plotësuar fletëzën e punës.

Gjatë plotësimit të librit, edukatori/ja lëshon muzikë në sfond. Më pas organizohet lojë dramatike dhe fëmijët janë të lirë në përzgjedhjen e grupit të lojës dhe materialeve me të cilat do ta dramatizojnë historinë e dëgjuar.

Në takimin përmbyllës, secili fëmijë paraqet punën e vet dhe tregon se cila pjesë e ditës i pëlqeu më shumë. Kjo është një mënyrë e mirë për të kuptuar se cili është aktiviteti i parapëlqyer i fëmijëve.

Vlerësimi:

Edukatori/ja vëzhgon nëse të gjithë fëmijët arrijnë ta shkruajnë shkronjën I.

Më shumë për të bërë:

Pyet prindërit se çfarë ndodh me kafshët e vogla sikurse iriqi apo zogjtë gjatë ditëve të ftohta.

Reflektimi:

Zogjtë

Fusha kurrikulare:

Jeta dhe puna

Kurrikula lëndore:

Shkathtësia për jetë

Tema nga plani dymujor:

Mjedisi shtëpiak, kopshti dhe shkolla

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):

I-3; II-3, 7; III-6; IV-3, 5; V-2, 5; VI-6

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):

Jeta dhe puna: 1.3
Gjuhët dhe komunikimi: 1.1; 1.3
Matematikë: 3.4

Rezultati i të nxënit të temës:


Realizon aktivitete në bashkëpunim me të tjerët përmes lojës.

Rezultatet e të nxënit të aktiviteteve:	<ul style="list-style-type: none"> • Tregon disa karakteristika të stinës së vjeshtës. • Konstrukton në bashkëpunim me shokun-shoqen folenë e zogut me materiale nga natyra.
Kriteret e suksesit:	<ul style="list-style-type: none"> • Trego disa karakteristika të stinës së vjeshtës. • Në bashkëpunim me shokun-shoqen, konstrukto folenë e zogut me materiale nga natyra.
Burimet dhe materialet:	Libri i punës së fëmijës, ngjyra, fleta, enciklopedi/libër/përralla që ka për temë zogjtë, zog model prej letre, materiale nga natyra (gjethe, kashtë, degë etj.), materiale të ripërdorshme etj.
Integrimi ndërfaqor:	Gjuhë shqipe, Matematikë.
Çështjet ndërkurrikulare:	Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.
Fjalë kyçe:	Zog, stinë, mot etj.
Organizimi i aktiviteteve:	<p>Edukatori/ja përgatit mjedisin paraprakisht, duke varur në portën hyrëse të klasës një ose disa zogj të konstruktuar.</p> <p>Në takimin e përbashkët hapet diskutimi mbi zogjtë, që fëmijët prekën dhe panë në hyrje të klasës (Ideja është që diskutimi për temën ditore të hapet nga fëmijët). Nga diskutimi, edukatori/ja përmes enciklopedisë/ librit nxit fëmijët të mendojnë mbi ndryshimet klimatike dhe jetën e zogjve, kur temperaturat ndryshojnë.</p> <p>Aty lexohen dhe diskutohen të dhënat së bashku me fëmijët.</p> <p>Edukatori/ja ka përgatitur mjedisin në katër qendra të aktiviteteve me materiale të ndryshme.</p> <p>Një njërën qendër është sjellë kashtë, degë, gjethe material nga natyra që fëmijët në formë grupe të ndërtojnë çerdhen e zogut.</p> <p>Në këndin tjetër fëmijët në grup do të konstruktojnë zogjtë me materiale të ndryshme të ripërdorshme.</p> <p>Në këndin tjetër ofrohen librat e punës për plotësimin e ndryshimeve në natyrë sipas stinëve.</p> <p>Në një kënd tjetër ofrohet mundësia që fëmijët të vizatojnë sipas imagjinatës së tyre për ndryshimet në natyrë në bazë të stinëve.</p> <p>Në përfundim të ditës, punimet e fëmijëve ekspozohen në një kënd.</p> <p>Në takimin përfundimor së bashku me fëmijët luajmë lojën "Fluturon, fluturon".</p> <p>Takimi përfundimor zhvillohet në formë turi fëmijë shohin punën me blloqe të grupeve.</p>
Vlerësimi:	<p>Përmes observimit, edukatori/ja arrin të mbledh të dhëna individuale mbi shkathtësitë e fëmijëve për punë të përbashkët.</p> <p>Po ashtu mban të dhëna anekdotike mbi shkathtësitë e fëmijëve në përfundimin e aktiviteteve të dhëna.</p>
Më shumë për të bërë:	Nxiten fëmijët që të pyesin prindërit për udhëtimin e zogjve dhe kohën e kthimit të tyre.
Reflektimi:	_____

Të njihemi me botën e ngjyrave

Fusha kurrikulare:	Arti
Kurrikula lëndore:	Edukimi figurativ
Tema nga plani dymujor:	Ngjyra
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):	I-3; II-1, 4; III-1, 2, 3, 6; V-5
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):	Artet: 1 Matematikë: 2.1 Gjuhët dhe komunikimi: 1.1; 1.4
Rezultati i të nxënit të temës:	Eksperimenton me mjetet dhe materialet e të shkruarit.
Rezultatet e të nxënit të aktiviteteve:	<ul style="list-style-type: none"> • Identifikon tri ngjyrat bazike. • Grupon figurat sipas ngjyrave në aktivitetin e dhënë.
Kriteret e suksesit:	<ul style="list-style-type: none"> • Identifiko tri ngjyrat bazike. • Grupo figurat sipas ngjyrave gjatë aktivitetit.
Burimet dhe materialet:	Libri i fëmijës, një shabllon i llojeve të ngjyrave, fletë A2, lapustil, fotografi të ndryshme me tri ngjyrat bazike, fletë me ngjyra, brumë ose plastelinë, sajuese të ndërtuara nga edukatori/ja.
Integrimi ndërfaqor:	Matematikë, Gjuhë shqipe.
Çështjet ndërkurrikulare:	Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.
Fjalë kyçe:	Ngjyrë, ngjyrë bazë, klasifikim, bashkësi.
Organizimi i aktiviteteve:	<p>Edukatori/ja zbukuron derën e klasës me një ylber që të tërheqë vëmendjen e fëmijëve teksa hyjnë në klasë. Ky do të ishte një fillim i këndshëm i javës, gjatë së cilës do të zbulohen dhe do të njihen ngjyrat.</p> <p>Shtroji pyetje nëse ndokush e vuri re ndryshimin në derën e klasës. Njoftoni fëmijët për temën ditore dhe ftojini në lojë, e cila gjithashtu ka të bëjë me ngjyrat.</p> <p>Loja “Postieri kërkon ngjyrat”</p> <p>Materialet: karrige për të gjithë fëmijët e grupi të vendosura në formë rrethi, muzikë ritmike.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Njërit nga fëmijët i kërkohet të thotë një numër. Edukatori/ja numëron fëmijët deri te numri që u dha. Fëmija me atë numër bëhet postieri dhe ftohet të hyjë në mes të rrethit që të fillojë lojën.

Rrethi i ngjyrave parësore



NGJYRAT



- Postieri thotë: "Kam ardhur për të gjithë ata që kanë ngjyrë të kuqe diku në trup". (Fëmija vendos vetë cilën ngjyrë të thërrasë.)
- Fëmijët që kanë diçka të kuqe në trup (rroba, flokë, vath etj.) ngrihen në këmbë. Në këtë moment, edukatori/ja largon një karrige nga rrethi dhe fton fëmijët që të lëvizin përqark nën ritmin e muzikës, derisa ai/ajo të ndalojë muzikën.
- Kur ndalon muzika, fëmijët duhet të zënë vendet e lira. Fëmijë që mbetet në këmbë bëhet postieri. Postieri i mëparshëm bëhet ndihmës i edukatores, për dhënien e komandave të muzikës.
- Loja përfundon pasi të jenë përfshirë të gjithë fëmijët.

Pas përfundimit të lojës, të gjithë ulen në karriget e rrethit për të diskutuar për lojën. Edukatori/ja i nxit fëmijët me pyetje të tilla, si: *A ju pëlqeu loja? Si u ndjetë? Cilat ngjyra përmendën postierët gjatë lojës? etj.*

Edukatori/ja flet për ngjyrat që na rrethojnë, për spektrin e tyre të gjerë dhe për tri ngjyrat parësore. Ai/ajo shpjegon se prej këtyre tri ngjyrave burojnë të gjitha ngjyrat e tjera të spektrit etj. (Për ta bërë sa më të qartë e më të lehtë shpjegimin, edukatori/ja ka parapërgatitur një poster me llojet e ngjyrave dhe një me tri ngjyra parësore.)

Aktivitetet organizohen nëpër grupe të vogla.

Në njërin grup fëmijët do të plotësojnë librin e fëmijës, ku do të presin dhe ngjisin duke grupuar fotografitë sipas 3 ngjyrave bazë.

Në grupin tjetër, fëmijët do të manipulojnë me lojëra sajuese të përgatitura paraprakisht nga edukatori/ja. Gjatë ndërtimit të sajueseve, fëmijët mund të ndërveprojnë me njëri-tjetrin.

Në grupin e tretë, fëmijët do të punojnë me brumë ose plastelinë.

Pasi të kenë përfunduar të gjithë fëmijët aktivitetet, organizohet takimi përmbyllës ku diskutohet për punën e ditës.

Vlerësimi:

Nga puna në libër vlerësohet aftësia e fëmijës për të grupuar fotografitë në tri grupet e ngjyrave bazike.

Më shumë për të bërë:

Nëse ka kompjuter në institucion, fëmijët mund të ftohen në përdorimin e lojërave digjitale të dizajnuara për të mësuar ngjyrat në nivelin parafillor.

Linku i mëposhtëm mund të përdoret në klasë ose mund të ndahet me prindërit e fëmijëve.

<http://www.sheppardsoftware.com/preschool/colors/colorgame.htm>

Reflektimi:

Magjia e ngjyrave

Fusha kurrikulare:	Shkencat natyrore
Kurrikula lëndore:	Njeriu dhe natyra
Tema nga plani dymujor:	Materialet dhe vetitë e tyre
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):	I -3, 5, 7; II -1, 4, 7; III -1, 2, 3, 6; IV -5; V -5
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):	Shkencat natyrore: 1 Gjuhët dhe komunikimi: 1.1; 1.4 Artet: 1 Matematikë: 2.2
Rezultati i të nxënit të temës:	Hulumton materialin e objekteve të njohura për të (letër, dru, metal, plastikë, tekstil, gur etj.).
Rezultatet e të nxënit të aktiviteteve:	<ul style="list-style-type: none"> • Emërton ngjyrat parësore (e kuqe, e verdhë, blu). • Kombinon ngjyrat parësore për të fituar ato dytësore (e portokalltë, e gjelbër dhe vjollcë). • Përshkruan ngjyrat dytësore të fituara gjatë eksperimentit.
Kriteret e suksesit:	<ul style="list-style-type: none"> • Emërto ngjyrat parësore. • Kombino ngjyrat parësore për të fituar ato dytësore. • Përshkruaj ngjyrat dytësore të fituara gjatë eksperimentit.
Burimet dhe materialet:	Ngjyra të lëngëta (për gatim ose tjetër), gota të tejudkshme, peceta të bardha, fletë me ngjyra, muzikë.
Integrimi ndërfaqor:	Gjuhë shqipe, Edukim muzikor, Matematikë.
Çështjet ndërkurrikulare:	Arsim për zhvillim të qëndrueshëm.
Fjalë kyçe:	Eksperiment, shkencë, ngjyra parësore/dytësore, shndërrim, ndryshim.
Organizimi i aktiviteteve:	Në takimin e përbashkët, fëmijët mësojnë këngën "Tri ngjyrat në dorën time". (Përdorni melodinë e këngës "Rrotat e autobusit".)

Tri ngjyrat në dorën time

Ngjyrat në dorën time janë
e kuqe, e verdhë, blu,
e kuqe, e verdhë, blu,
e kuqe, e verdhë, blu.

Ngjyrat në dorën time janë
e kuqe, e verdhë, blu
dhe këto janë ngjyrat parësore.

- Tregojuni fëmijëve tri ngjyrat që mbani në dorë (e kuqe, e verdhë, blu).
- Paraqiteni secilën me radhë dhe emërtojeni.
- Vendosini ngjyrat në dysheme dhe këndojeni këngën sërish bashkë me fëmijët.
- Shpjegoni ngjyrat parësore dhe përdorimin e tyre për të përfutur ngjyrat e tjera.



Edukatori/ja fton fëmijët që të eksperimentojnë me ngjyrat.

- Në këndin e shkencës vendosen pesë gota me ujë. Në tri prej tyre hidhni ngjyrat: e kuqe, e verdhë, blu, kurse dy të tjerat në mes tyre duhet të kenë vetëm ujë.
- Në secilën prej gotave vendoset nga një pecetë të bardhë, anët e së cilës duhet të zhyten në dy gota (në atë me ngjyrë dhe në atë me ujë), si në figurën e dhënë.
- Secila pecetë përthith ngjyrat duke i kaluar nga gota me ngjyrë në atë me ujë. Meqenëse aty zbrazen ngjyrat e dy gotave, ndodh dhe përzierja e tyre.

Fëmijëve u shpjegohet se eksperimenti do pak kohë të ndodhë, prandaj ndryshimet vëzhgohen kohë pas kohe. Në fund të ditës bëhet vëzhgimi përfundimtar dhe diskutohen rezultatet.

Edukatori/ja i fton fëmijët në lojën me muzikë.

Materialet: fletë me ngjyra dhe muzikë me ritëm të ecjes.

Zhvillimi:

- Mbani në dorë fletë me ngjyra të ndryshme dhe ftoni fëmijët të emërtojnë ngjyrat përkatëse.
- Vendosni fletat me ngjyra në dysHEME larg njëra-tjetrës.
- Vini muzikë dhe kërkoni nga fëmijët të ecin në rrugën me fletë, derisa të ndalojë muzika.
- Kur muzika ndalon, fëmijët ulen afër fletës më të afërt.
- Pyesni fëmijët se kush është ulur pranë një ngjyre të caktuar (të kaltër, të kuqe etj.). Fëmija ngrihet, emërton dhe tregon fletën.
- Loja vazhdon derisa të emërtohen të gjitha ngjyrat.

Fëmijëve iu ofrohen ngjyra pasteli dhe lihen të lirë të eksperimentojnë me përzierjen e ngjyrave dhe të pikturojnë sipas imagjinatës. Ju mund të përdorni edhe fletëzën e punës nga libri i fëmijës për krijimin e ngjyrave dytësore.

Në fund të ditës, të gjithë afrohen te këndi i shkencës për të vëzhguar eksperimentin dhe edukatori/ja nxit fëmijët të bëjnë pyetje. Ai/ajo shpjegon shkaqet e ngjyrimit të ujit në gotat e mesit, pse ngjyrat janë të ndryshme, si formohen ato, etj.

Dita përmbyllet me lojën "Gjej lodrën tënde". Edukatori/ja jep udhëzimet që fëmijët, për aq sa zgjat melodia, të gjejnë lodrën që pëlqejnë më shumë brenda dhomës së punës.

Pasi edukatori/ja ndal muzikën, fëmijët vijnë në rreth dhe secili prej tyre ka sjellë lodrën e tij të preferuar. Ata tregojnë arsyet e përzgjedhjes, edukatori/ja bënë pyetje të cilat kanë të bëjnë me grupimin rreth të veçantave dhe ngjashmërive të tyre. (Fëmijët nxiten të mendojnë më shumë mbi atë se: *Çfarë ngjyre ka? Me cilën lodër tjetër ngjan? Çfarë forme ka?* etj.).

Vlerësimi:

Fëmijët vëzhgohen përgjatë aktiviteteve.

Më shumë për të bërë:

Në gotat me ngjyra, të cilat na kanë mbetur nga eksperimenti, ju mund të vendosni lule të bardha (ose çfarëdo lule me ngjyrë të hapur) dhe t'i vendosni afër dritares, që fëmijët t'i vëzhgojnë në ditët në vijim.



Reflektimi:

Eksperimentojmë me ngjyrat

Fusha kurrikulare:	Shkathtësi për jetë
Kurrikula lëndore:	Jeta dhe puna
Tema nga plani dymujor:	Modelet
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):	I -3, 5, 7; II -1, 4, 7; III -1, 2, 3, 6; IV -5; V -5
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):	Jeta dhe puna: 4.8 Gjuhët dhe komunikimi: 1.1; 1.7 Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti: 2.1
Rezultati i të nxënit të temës:	Flet për disa profesione, identifikon veglat (veshjet, makinat) e punës që i përdorin ata.
Rezultatet e të nxënit të aktiviteteve:	<ul style="list-style-type: none"> • Eksperimenton përzierjen e ngjyrave në pjatën me qumësht. • Përshkruan me fjalë procesin e eksperimentit. • Numëron hapat e procesit të eksperimentit dhe materialet e përdorura.
Kriteret e suksesit:	<ul style="list-style-type: none"> • Eksperimento përzierjen e ngjyrave në pjatën me qumësht. • Përshkruaj me fjalë procesin e eksperimentit. • Trego si u zhvillua eksperimenti.
Burimet dhe materialet:	Pjata, qumësht, pipëza, detergjent për larjen e enëve, ngjyra të lëngshme, fletë të bardha, top.
Integrimi ndërfaqor:	Gjuhë shqipe, Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti.
Çështjet ndërkurrikulare:	Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.
Fjalë kyçe:	Reaksion, materie, përzierje, ngjyra, eksperiment.
Organizimi i aktiviteteve:	<p>Edukatori/ja mund të përdorë çdo ditë teknika të ndryshme të pritjes së fëmijëve në klasë. Muzika e këndshme shërben për krijimin e një atmosfere pozitive. Fëmijët vizitojnë këndin e shkencës për të parë rezultatet e ditës së djeshme.</p> <p>Sot, edukatori/ja ka ftuar një piktor/e (ai/ajo mund të jetë prind, mësimdhënës në shkollë ose pjesëtarë/e nga komuniteti i artistëve) i/e cili/a do të diskutojë me fëmijët për profesionin e tij/saj. Do të diskutohet për mjetet e punës, teknikat e ndryshme, dhe në veçanti do të flasin për ngjyrat dhe bashkërisht do të zhvillojnë eksperimentin e përzierjes së ngjyrave.</p> <p>Eksperimenti i përzierjes së ngjyrave</p> <p>Materialet:</p> <p>pjata, qumësht, pipëza, detergjent për larjen e enëve, ngjyra të lëngëta (për gatim ose tjetër), fletë të bardha.</p>

Ecuria:

- Secili fëmijë ka një pjatë në të cilën është hedhur pak qumësht.
- Me anë të pipëzës, ai merr ngjyra të ndryshme dhe i pikon në pjatë.
- Në vijim hedh në pjatë disa pika detergjenti.
- Fillon reaksioni i përzierjes së detergjentit me qumështin me ngjyrat.



Fëmijët vëzhgojnë reaksionet, pastaj secili merr nga një fletë të bardhë, sipërfaqen e së cilës e takojnë me qumështin e ngjyrosur (edukatori/ja e tregon procesin e punës në pjatën e saj). Secili përfiton një vepër arti të veçantë, fletën e mermertë. Punimet vendosen me kapëse në litarin e ekspozimit që të thahen. Ato do të përdoren të nesërmen.

Të gjithë fëmijët mblidhen afër këndit të artit, shohin punimet dhe diskutojnë eksperimentin, duke kujtuar tërë procesin që nga fillimi.

Të frymëzuar nga ngjyrat të gjithë bashkë dalin jashtë klasës për aktivitet fizik.

Fëmijët formojnë një rreth të madh me edukatorin/en në mes që mban një top në dorë dhe jep instruksionet e lojës.

- Fëmijët ia pasojnë topin njëri-tjetrit.
- Fëmija që pason topin duhet t'i drejtojë një pyetje shokut/shoqes.
- Fëmija që pret topin nuk mund ta pasojë pa iu përgjigjur pyetjes.
- Pyetjet duhet të jenë në lidhje me ngjyrat, p.sh.: *Cila është ngjyra jote e parapëlqyer? Çfarë ngjyre ka dhoma jote? Cila ngjyrë formohet nga përzierja e ngjyrës së verdhë me të kaltër? Sa ngjyra ka ylberi? Cilat janë ngjyrat parësore? etj.*
- Loja vazhdon derisa edukatori/ja sheh që janë përfshirë të gjithë fëmijët.

Në takimin përmbyllës diskutohen aktivitetet ditore, duke përsëritur edhe një herë konceptet kryesore.

Vlerësimi:

Edukatori/ja vëzhgon fëmijët gjatë lojës dhe mban shënime në ditarin reflektiv.

Më shumë për të bërë:

Kërkoni në internet për më shumë aktivitete rreth ngjyrave:

<http://earlylearning.momtrusted.com/themes/>

<http://raisinglittlesuperheroes.com/pom-pom-color-match-game/>

Reflektimi:

Ë – ëmbëlsira

Fusha kurrikulare:	Gjuhët dhe komunikimi
Kurrikula lëndore:	Gjuha shqipe
Tema nga plani dymujor:	Tinguj, shkronja, rrokje, fjalë, fjali
Rezultatet e të nxënimit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):	I -3, 4, 5; II -1, 4, 7; III -1, 2, 3, 6; V -5
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):	Gjuhët dhe komunikimi: 1.1; 1.2; 1.4; 2.2 Matematikë: 3.3 Shoqëria dhe mjedisi: 3
Rezultati i të nxënimit të temës:	Shqiptojnë drejt tingujt (zanore dhe bashkëtingëllore) gjatë të shprehurit.
Rezultatet e të nxënimit të aktiviteteve:	<ul style="list-style-type: none"> • Gjen së paku një fjalë që fillon ose ka në përbërje shkronjën “Ë”. • Vizato ëmbëlsirën sipas dëshirës.
Kriteret e suksesit:	<ul style="list-style-type: none"> • Gjejë së paku një fjalë që fillon ose ka në përbërje shkronjën “Ë”. • Vizato ëmbëlsirën sipas dëshirës.
Burimet dhe materialet:	Tregimi për ëmbëlsirën, libri i fëmijës, fotografi me ëmbëlsira, lapsa, ngjyra, fletë mermeri (të fituara nga eksperimenti i ditës së kaluar).
Integrimi ndërfaqor:	Matematikë, Shoqëria dhe mjedisi.
Çështjet ndërkurrikulare:	Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.
Fjalë kyçe:	Ëmbëlsirë, shkronja Ë, fletë mermeri (të fituara nga eksperimenti i ditës së kaluar), klasifikim.
Organizimi i aktiviteteve:	<p>Edukatori/ja pret fëmijët dhe pas leximit të kalendarit u paraqet atyre disa fotografi ëmbëlsirash dhe mjetesh kuzhine, duke i pyetur nëse u pëlqejnë ëmbëlsirat, a ndihmojnë në gatimin e tyre etj. Duke parë fotografitë e ëmbëlsirave, fëmijët formojnë bashkërisht një histori të thjeshtë. Edukatori/ja shpjegon se historitë lexohen edhe nëpërmjet fotografive, dhe se historia e sotme titullohet “Ë – ëmbëlsira”. Kështu fëmijët nxiten te tema e ditës.</p> <p>Me shkronjën “Ë” fillojnë edhe të tjera fjalë; fëmijët nxiten të emërtojnë sa më shumë fjalë që fillojnë dhe kanë në përbërje shkronjën “Ë”.</p> <p>Nga takimi në rreth, grupi zhvendoset te këndi i artit.</p> <p>Te këndi i artit marrin nga litari i ekspozitës fletët e ngjyrosura një ditë më parë (eksperimenti i përzjerjes së ngjyrave në pjatën me qumësht).</p> <p>Edukatori/ja u shpjegon fëmijëve se fletët që mbajnë në duar janë vepra arti, të cilat ndryshe quhen fletë mermeri.</p> <p>Fëmijët mësojnë se mënyra si i krijuan fletët e mermerit është një teknikë shumë e lashtë në historinë e artit. Në vijim, ata vizatojnë me ngjyra dylli se si do të duket ëmbëlsira e tyre dhe anash saj shkruajnë shkronjën “Ë”.</p>

Fëmijët mbarojnë punimet dhe i ekspozojnë sërish në litar. Ju mund të ofroni edhe fletëzat e punës për plotësim të shkronja E.

Edukatori/ja në bashkëpunim me prindërit ka siguruar materialet dhe bashkërisht me fëmijët do të përgatisin ëmbëlsira të vogla. Inkurajohen fëmijët që të përfshihen aktivisht në përcaktimin e masave dhe përgatitjen e tyre.

Secili fëmijë do të dekorojë ëmbëlsirën e tij/saj dhe së bashku do t'i shijojnë ato në takimin përmblyllës.

Në takimin përmblyllës, edukatori/ja ritregon bashkë me fëmijët historinë e krijuar në bazë të fotografive, të cilat i numërojnë dhe i përshkruajnë me fjalë. Emërtohen gjëra që fillojnë me shkronjën E dhe ndahen përshtypjet për aktivitetin e vizatimit të ëmbëlsirave sipër fletëve mermer. Shijojnë ëmbëlsirat të gjithë së bashku.

Vlerësimi:

Fëmijët vëzhgohen në ndërveprimin me njëri-tjetrin dhe ndërveprimin me materialet gjatë krijimit të ëmbëlsirave. Mund të dokumentoni me fotografi aktivitetet e bëra.

Më shumë për të bërë:

Nxitni fëmijët që të marrin pjesë në përgatitjen e ndonjë ëmbëlsire në shtëpi me prindërit dhe ta ndajnë përvojë me shokët dhe shoqet e klasës.

Reflektimi:

Ne dhe ngjyrat

Fusha kurrikulare:

Matematikë

Kurrikula lëndore:

Matematikë

Tema nga plani dymujor:

Puna me të dhëna

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):

I-3, 5, 7; **II**-1, 4, 7; **III**-1, 2, 3, 6; **IV**-5; **V**-5

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):

Matematikë: 1.1
Gjuhët dhe komunikimi: 1.1; 3.2
Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti: 1

Rezultati i të nxënit të temës:

Vendos të dhënat e thjeshta në vizatime të grumbulluara nga jeta e përditshme.

Rezultatet e të nxënit të aktiviteteve:

- Identifikon ngjyrat e rrobave të tij/saj.
- Numëron kapëset e mbledhura gjatë lojës.
- Grupon kapëset e rrobave sipas ngjyrave.

- Kriteret e suksesit:**
- Identifiko ngjyrat e rrobave të tua.
 - Numëro kapëset e mbledhura gjatë lojës.
 - Grupo kapëset e rrobave sipas ngjyrave.

Burimet dhe materialet: Fletë A2, lapustil, fotografi ariu, fotografi të rrobave të ndryshme, kapëse rrobash me ngjyra.

Integrimi ndërfaqshor: Gjuhë shqipe, Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti.










Çështjet ndërkurrikulare: Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

Fjalë kyçe: Rroba, ngjyra, kapëse, krahasim, vrapim, ritëm.

Organizimi i aktiviteteve: Në takimin e përbashkët, edukatori/ja u paraqet fëmijëve tabelën që ka përgatitur. (Një tabelë ku shënohen të dhënat për rrobat që kanë veshur fëmijët në bazë të ngjyrave.)

Tabela e të dhënave për veshjet tona

- Ftoni një fëmijë vullnetar që të afrohet pranë tabelës. Kërkoni nga fëmijët e tjerë të përshkruajnë veshjen e shokut/shoqes së tyre (rrobat një nga një dhe ngjyrën e tyre).
- Fëmija që doli vullnetar ka afër një kuti me ngjyra, të cilat i përdor për të shënuar në tabelë të dhënat për rrobat që ka veshur.
- Loja vazhdon derisa të gjithë fëmijët të jenë përfshirë.
- Në fund diskutohen rezultatet.

	Fustan	Këmishë	Pantallona	Pantallona të shkurtra	Xhinsa	Fund	Çorape, geta	Këpucë	Xhakëtë
									
E zezë	<input checked="" type="checkbox"/>								
Blu	<input checked="" type="checkbox"/>								
Kafe	<input checked="" type="checkbox"/>								
E gjelbër	<input type="checkbox"/>								
Rozë	<input type="checkbox"/>								
E portokalltë	<input type="checkbox"/>								
E kuqe	<input type="checkbox"/>								
E bardhë	<input type="checkbox"/>								
E verdhë	<input type="checkbox"/>								

Aktiviteti i radhës mund të realizohet jashtë klase, por në varësi të kushteve atmosferike, mund të zhvillohet edhe brenda klasës.

Loja "Gjuetarët e kapëseve"

Materialet e nevojshme: kapëse rrobash me ngjyra të ndryshme.

Ecuria:

- Fëmijëve u ofrohen nga pesë kapëse me ngjyra të ndryshme.
- Ata ndahen në çifte dhe secili i kap kapëset e tij në shpinën e shokut/shoqes që ka pranë.
- Në vijim, edukatori/ja jep sinjal për të filluar gjuetia e kapëseve.
- Fëmijët vrapojnë dhe marrin kapëset e njëri-tjetrit.
- Kapëset që arrijnë t'i marrin nga të tjerët i vendosin në pjesën e përparme të bluzave të veta.
- Fëmijët ndalojnë kur edukatori/ja jep sinjal për përfundimin e aktivitetit.
- Numërohen kapëset e secilit dhe përcaktohet se cili ka marrë më shumë e cili më pak.
- Fëmijët largojnë kapëset dhe i grupojnë në një kënd sipas ngjyrave.

Pasi fëmijët çlodhen, bëhet takimi përmbyllës ku diskutohen aktivitetet, emocionet që u morën prej tyre etj.

Vlerësimi:

Lojërat: "Tabela e të dhënave për veshjet tona", "Gjuetarët e kapëseve" janë një mënyrë e mirë për të vlerësuar pjesëmarrjen aktive të fëmijëve, sasinë e fjalëve që përdorin për të përshkruar, shkathtësinë për të grupuar sipas ngjyrave, përshtatjen në grup, etj.

Më shumë për të bërë:

Aktivitete të tjera fizike për fëmijë do t'i gjeni në linkun e mëposhtëm.

<https://youtu.be/TJZXz0S8SNM>


Reflektimi:

<https://www.youtube.com/watch?v=nFv4K4y9D3c&feature=youtu.be>

Format përreth nesh

Fusha kurrikulare:	Edukata fizike, sportet dhe shëndeti
Kurrikula lëndore:	Edukata fizike, sportet dhe shëndeti
Tema nga plani dymujor:	Njohja e vetes dhe e botës
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):	I -3, 5; II -1, 3, 4, 7; III -1, 2, 3, 6; IV ; V -5
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):	Edukata fizike, sportet dhe shëndeti: 1 Gjuhët dhe komunikimi: 1.1; 1.4 Matematikë: 6.1
Rezultati i të nxënit të temës:	Shpreh aftësitë krijuese me lëvizje, fjalë dhe krijime të ndryshme.
Rezultatet e të nxënit të aktiviteteve:	<ul style="list-style-type: none"> • Hulumton për format gjeometrike në klasë. • Identifikon karakteristikat dalluese të formave gjeometrike bazë. • Vizaton me dorë të lirë në hapësira të mëdha format gjeometrike bazë.
Kriteret e suksesit:	<ul style="list-style-type: none"> • Hulumto për format gjeometrike në klasë. • Identifiko karakteristikat dalluese të formave gjeometrike bazë. • Vizato me dorë të lirë në hapësira të mëdha format gjeometrike bazë.
Burimet dhe materialet:	Kartonë me formë rrethore, trekëndore, katrore, drejtkëndore, shkumësa me ngjyra.
Integrimi ndërfaqor:	Gjuhë shqipe, Matematikë.
Çështjet ndërkurrikulare:	Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.
Fjalë kyçe:	Figura gjeometrike, rreth, trekëndësh, katror, drejtkëndësh, dallime, ngjashmëri.
Organizimi i aktiviteteve:	<p>Edukatori/ja përshëndet fëmijët, u kërkon të tregojnë të veçantat e fundjavës dhe pastaj vazhdon me kalendarin ditor.</p> <p>Pas kalendarit, edukatori/ja organizon lojën: “Gjej objektin e fshehur”.</p> <p>Ecuria e lojës: Edukatori/ja vendos në një vezë plastike (nga ato të çokollatave) katër petëza të figurave gjeometrike (rreth, trekëndësh, katror dhe drejtkëndësh). Veza përcillet nga njëri fëmijë te tjetri, ku secili prej tyre jep mendimin e tij se çfarë fshihet brenda vezës. Edukatori/ja pret deri sa të përfundojnë të gjithë fëmijët mendimet e tyre. Në fund, veza hapet dhe zbulohet se çfarë ka brenda.</p> <p>Edukatori/ja hap vezën, vendos petëzat në rreth dhe i pyet fëmijët për ngjyrat dhe format.</p>

Për të demonstruar më mirë secilën formë, edukatori/ja ka përgatitur modele të figurave prej kartoni me madhësi të dukshme.



Për secilën formë jepen të dhënat mbi mënyrën e ndërtimit, vijat dhe sipërfaqen e tyre.

Edukatori/ja vë në mes të rrethit katër format dhe kërkon që secili fëmijë të kërkojë brenda klasës dhe të sjellë në rreth objekte në formë rrethi, trekëndëshi, katrori dhe drejtkëndëshi.

Secili nga fëmijët emërton objektet që ka gjetur dhe formën e tyre. Pasi kthejnë objektet në vendet e tyre, të gjithë dalin jashtë për të vëzhguar format gjeometrike në hapësirat e mëdha. Kështu, fëmijët mund të shohin praktikisht që figurat gjeometrike gjenden ngado në hapësirën rreth nesh, në klasë, jashtë saj, kudo në natyrë.

Për të zgjeruar idetë e fëmijëve, edukatori/ja i udhëzon ata që të vëzhgojnë retë dhe të shohin nëse gjatë lëvizjes krijojnë forma të ndryshme gjeometrike.

Fëmijëve u sigurohen shkumësa me ngjyrë për të vizatuar jashtë klasës (në oborrin e institucionit, në mjedisin e caktuar për edukimin fizik etj.); mund të përdoret edhe hapësira për edukatë fizike në oborrin e shkollës) format gjeometrike që mësuat dhe objekte të tjera të jetës së përditshme në lidhje me to.

Gjatë takimit përmbyllës, fëmijët paraqesin vizatimet e tyre.

Vlerësimi:

Edukatori/ja mban shënime për fëmijët nëse kanë arritur t'i vizatojnë të gjitha format ose jo. Ai/ajo lëviz gjatë gjithë kohës nëpër hapësirën ku fëmijët janë duke vizatuar, për t'u siguruar që secili prej tyre e ka të qartë si vizatohet. Fëmijëve u jepet ndihmë, nëse është e nevojshme.

Më shumë për të bërë:

Kërko nga prindërit që të kalojnë kohë me fëmijët e tyre për të hulumtuar format gjeometrike në shtëpi.

Reflektimi:

Forma pa mbarim

Fusha kurrikulare:	Matematika
Kurrikula lëndore:	Matematika
Tema nga plani dymujor:	Figurat gjeometrike
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):	I -3, 5; II -1, 3, 4, 7; III -1, 2, 3, 5; V -5
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):	Matematika: 2.1 Gjuhët dhe komunikimi: 1.1; 1.4 Jeta dhe puna: 2.8.1
Rezultati i të nxënit të temës:	Emërton figurat gjeometrike dydimensionale: katrorin, trekëndëshin, rrethin dhe drejtkëndëshin. Vizaton me dorë të lirë, pret me gërshërë, palos, përdor materiale të ndryshme (fije peri të ndryshme).
Rezultatet e të nxënit të aktiviteteve:	<ul style="list-style-type: none"> • Emërton figurën gjeometrike gjatë lojës “E gjej unë”. • Përshkruan ndërtimin e figurave gjeometrike. • Ndërton figurat gjeometrike (rreth, trekëndësh, katror, drejtkëndësh) me materialet e ofruara.
Kriteret e suksesit:	<ul style="list-style-type: none"> • Emërto figurën gjeometrike gjatë lojës “E gjej unë”. • Përshkruaj ndërtimin e figurave gjeometrike. • Ndërto figurat gjeometrike (rreth, trekëndësh, katror, drejtkëndësh) me materialin e dhënë.
Burimet dhe materialet:	Libri për figurat gjeometrike, materiale të ndryshme (guralecë, shkopinj, fije peri të trasha, kapakë shishesh, petëza etj.).
Integrimi ndërfaqor:	Gjuhë shqipe, Shkathtësi për jetë.
Çështjet ndërkurrikulare:	Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.
Fjalë kyçe:	Ndërtim, figurë gjeometrike, rreth, trekëndësh, katror, drejtkëndësh.
Organizimi i aktiviteteve:	<p>Edukatori/ja përgatit një kuti, brenda së cilës ka vendosur figura gjeometrike të madhësive dhe ngjyrave të ndryshme për të gjithë fëmijët.</p> <p>Pas përshëndetjes dhe kalendarit, edukatori/ja dhe fëmijët luajnë lojën “E gjeta unë”.</p> <p>Ecuria e lojës: Fëmijët tërheqin nga kutia një biletë, tregojnë se çfarë forme e ngjyre ka dhe emërtojnë një objekt me atë formë (p.sh.: <i>rrethore, e kaltër, ora ka formë rrethore</i>). Loja përfundon pasi të jenë përfshirë të gjithë fëmijët.</p> <p>Në vijim, edukatori/ja lexon dhe diskuton me fëmijët librin “Gjeometri për mua”. Aty, në formën e një vjershe, shpjegohen disa nga të dhënat bazë për secilën figurë gjeometrike. Secila nga vjershat lexohet dhe diskutohet me fëmijët.</p>

Më pas, fëmijët ndahen në grupe të vogla në bazë të biletave që përzgjedhën gjatë lojës "E gjeta unë". Grupet krijojnë figura të ndryshme me materialet e sistemuara në hapësirat e punës nga edukatori/ja.

- Grupi i parë krijon figurat gjeometrike me guralecë.
- Grupi i dytë krijon figurat gjeometrike me fije peri.
- Grupi i tretë krijon figurat gjeometrike me shkopinjtë e vegjël.
- Grupi i katërt krijon figurat gjeometrike me kapakët e shisheve.

Fëmijët ndryshojnë vendet e tyre në formë rotacioni, në mënyrë që secili të ketë mundësi të punojë me të gjitha materialet. Ata mund të zgjerojnë format, t'i bashkojnë ato, të shtojnë elemente të reja etj.

Vini re: Kur fëmijët do të punojnë me shkopinj, nuk do të kenë mundësi të formojnë rrethin. Nxitni fëmijët të mendojnë përse ndodh kjo. Diskutojeni në takimin e përbashkët në fund të ditës.

Në takimin përmbyllës diskutohet ndërtimi i figurave dhe dallimet mes tyre: *rrethi krahasuar me trekëndëshin, katrorin dhe drejtkëndëshin; trekëndëshi krahasuar me katrorin, drejtkëndëshin; katrori krahasuar me drejtkëndëshin*, si dhe puna e bërë gjatë gjithë ditës.

Vlerësimi:

Edukatori/ja vëzhgon fëmijët gjatë takimit të përbashkët përmes lojës "E gjeta unë" se sa nga fëmijët kanë arritur të përvetësojnë konceptin e figurës gjeometrike. Fëmijët që kanë nevojë për më shumë kohë ju ofrohet asistencë në ditët në vazhdim përmes aktiviteteve të tjera ndihmëse.

Më shumë për të bërë:

Edukatori/ja mund të gjejë forma të tjera alternative për zgjerimin e aktivitetit: romb, zemër, yll, ovale etj.

Kërkoni nga prindërit që t'i nxisin fëmijët të gjejnë format të tilla në objektet përreth.


Reflektimi:

Argëtohem me format

Fusha kurrikulare:	Art
Kurrikula lëndore:	Edukim figurativ
Tema nga plani dymujor:	Krijimet figurative
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):	I-3; II-3, 7; III-1, 3, 7; III-1, 2, 3, 6; IV-2; V-5
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):	Artet: 1 Gjuhët dhe komunikimi: 1.1; 3.2 Edukim fizik, sportet dhe shëndeti: 1 Shoqëria dhe mjedisi: 1.1.2
Rezultati i të nxënit të temës:	Krijojnë, riciklojnë, vizatojnë, ngjyrosin, modelojnë për tema të ndryshme që trajtohen në shkollë dhe jashtë saj, duke përdorur: format me ngjyra, pemët, lodrat dhe materiale të ndryshme, sipas fantazisë së tyre.
Rezultatet e të nxënit të aktiviteve:	<ul style="list-style-type: none"> • Gjen zgjidhje të përbashkëta me shokun/shoqen gjatë aktivitetit. • Përdor format gjeometrike nga sfungjeri për të krijuar një vepër arti. • Identifikon format gjeometrike gjatë aktivitetit.
Kriteret e suksesit:	<ul style="list-style-type: none"> • Gjej zgjidhje të përbashkëta me shokun/shoqen gjatë aktivitetit. • Përdor format gjeometrike nga sfungjeri për të krijuar një vepër arti. • Identifiko format gjeometrike gjatë aktivitetit.
Burimet dhe materialet:	Emrat e fëmijëve të shkruar dy nga dy në shirita letre, shirit ngjitës, sfungjerë, sfungjerë të prerë në forma gjeometrike, pjata plastike, letër A3, ngjyra të lëngshme, pipëza, radio, CD etj.
Integrimi ndërfaqshor:	Gjuhë shqipe, Edukim fizik, sportet dhe shëndeti, Shoqëria dhe mjedisi.
Çështjet ndërkurrikulare:	Ndërvarësia.
Fjalë kyçe:	Ndryshim, përfitim i ngjyrës së re, përfitim i formës së re, kombinim, ngjyrosje.
Organizimi i aktiviteve:	<p>Për përshëndetjen e ditës, edukatori/ja kërkon nga fëmijët që të mendojnë një përshëndetje të veçantë me të cilën do të dëshironin të përshëndesnin njëri-tjetrin. Ata mund të zgjedhin një shtrëngim dore, një kompliment, një toke-këtu, sipas dëshirës. Më pas, edukatori/ja ndihmon fëmijët në përsëritjen e ditëve të javës dhe plotësimin e kalendarit të ditës.</p> <p>Pas kalendarit, edukatori/ja ka vendosur në një kuti të gjithë emrat e fëmijëve dhe u shpjegon atyre veçantinë e ditës: Të gjitha aktivitetet <i>do të zhvillohen me shokun ose shoqen emri i së cilës do të jetë i shkruar në biletë.</i> (Nëse numri i fëmijëve në klasë është tek, edukatori/ja mund t'i zhvillojë aktivitetet në treshe. Qëllimi është që ata të shoqërohen më tepër dhe të njihen më mirë me njëri-tjetrin.)</p>

Pas leximit të emrave, edukatori/ja jep udhëzimet për lojë: secila dyshe e fëmijëve do të shkojë në këndin e klasës që i pëlqen më shumë. Njëri nga fëmijët do të jetë në rolin e tabelës, tjetri do të jetë në rolin e shkruarit. Shkruari do të vizatojë në shpinën e shokut/shoqes (tabelës) një figurë gjeometrike dhe ai/ajo do të përpiqet të gjejë formën e vizatuar në shpinën e vet. Pasi edukatori/ja shikon që fëmijët kanë luajtur mjaftueshëm për 2-3 minuta, kërkon që të ndërrojnë rolet.

Pas lojës, fëmijët kthehen në rreth. Aty edukatori/ja ka vendosur një numër të madh blloqesh dhe u kërkon të afrohen dhe të marrin disa prej tyre. Ai/ajo u kërkon dysheve të fëmijëve që me blloqet që kanë marrë, të përpiqen të formojnë figura të tjera gjeometrike (p.sh.: dy trekëndësha një katror, dy katrorë një drejtkëndësh, dy trekëndësha një romb etj.). Fëmijët lejohen të marrin edhe blloqe të tjera nëse e shohin të nevojshme. Kështu ata arrijnë të zbulojnë formimin e figurave të ndryshme gjeometrike, nëse pozicioni i tyre ndryshon.



Edukatori/ja ka përgatitur paraprakisht hapësirën me materialet e nevojshme për aktivitetin e artit. Aktiviteti zhvillohet nën tingujt e një muzike të lehtë me zë të ulët. Edukatori/ja udhëzon fëmijët që në dyshe të krijojnë një vizatim përmes përdorimit të sfungjerëve me forma në fleta A3. Nëse ndokush nga fëmijët dëshiron ta presë formën e sfungjerit vetë, lejoheni dhe inkurajoheni. Çdo dyshe përzgjedh së bashku ngjyrat, format, temën e vizatimit dhe gjithçka tjetër meqë punimi i tyre do të jetë i përbashkët.

Edukatori/ja udhëzon dhe ndihmon fëmijët për pastrimin e vendit për qark, pas punës me ngjyra të lëngshme. Një gjë e tillë është pjesë e përgjegjësisë, e cila duhet të kultivohet përmes punës së përbashkët.

Në takimin përmbyllës, edukatori/ja organizon një lojë, ku secila dyshe kalon nëpër format gjeometrike, duke i emërtuar ato. Gjatë këtij kalimi, dyshet janë të lidhura bashkë (edukatori/ja lidh këmbën e djathtë të njërit fëmijë me këmbën e majtë të tjetrit).

Figurat gjeometrike janë vizatuar në tokë me një shirit ngjites. Secila dyshe e fëmijëve kalon nëpër forma në këtë mënyrë. Loja sjell përsëritjen e formave në mënyrë argëtuese dhe vë në lëvizje muskujt e mëdhenj të trupit.

Vlerësimi:

Edukatori/ja përshkruan bashkëveprimin dhe ndërveprimin e fëmijëve. Shënimet merren për secilën dyshe veç e veç. Edukatori/ja mund të bëjë një plan paraprak se cila dyshe duhet të vëzhgohet, në varësi të specifikave të grupit.

Më shumë për të bërë:

Kërkoni nga prindërit t'i inkurajojnë fëmijët të përdorin fjalor matematikor në jetën e përditshme, për të zgjeruar fjalorin dhe shprehjet matematikore.

Reflektimi:

1, 2, 3 - me shkronja luajmë ne

Fusha kurrikulare:	Gjuhët dhe komunikimi
Kurrikula lëndore:	Gjuha shqipe
Tema nga plani dymujor:	Tinguj, shkronja, rrokje, fjalë, fjali
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):	I-3, 5; II-1, 7; III-1, 2, 3, 6; V-5
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):	Gjuhët dhe komunikimi: 3.2 Artet: 1 Matematikë: 3.3
Rezultati i të nxënit të temës:	Shqiptojnë drejt tingujt (zanore e bashkëtingëllore) gjatë të shprehurit.
Rezultatet e të nxënit të aktiviteteve:	<ul style="list-style-type: none"> • Përcjell këngën duke e shoqëruar atë me lëvizje trupore. • Praktikon modelimin e shkronjës O, bazuar në aktivitetet e zhvilluara. • Ndan në rrokje fjalët e gjetura.
Kriteret e suksesit:	<ul style="list-style-type: none"> • Përcill këngën duke e shoqëruar atë me lëvizje trupore. • Praktiko modelimin e shkronjës O gjatë aktiviteteve ditore. • Ndjaj në rrokje fjalët e gjetura.
Burimet dhe materialet:	Libri i punës, plastelinë, ngjyrë etj.
Integrimi ndërfaqor:	Edukim muzikor, Matematikë.
Çështjet ndërkurrikulare:	Arsim për zhvillim të qëndrueshëm.
Fjalë kyçe:	Rrethi, ora, shkronja O.
Organizimi i aktiviteteve:	Edukatori/ja fton fëmijët në rreth me këngën:

Bëj një rreth
Bëj një rreth të madh-madh-madh
Vogël-vogël-vogël-vogël-vogël-vogël.
Bëj një rreth të madh-madh-madh
Vogël-vogël-vogël-vogël-vogël-vogël.
Përsëritet, përsëritet.
Bëj një rreth duke u rrotulluar rrotull-rrotull rrotulluar.
Bëj një rreth duke u rrotulluar rrotull-rrotull rrotulluar.
Bëj një rreth lart-lart-lart, poshtë-poshtë-poshtë.
Bëj një rreth lartë lartë-lartë, poshtë-poshtë-poshtë dhe ulemiiii.

(Fëmijët bëjnë lëvizje trupore sipas tekstit.)

Të gjithë ulen në rreth i pyet çfarë kanë formuar dhe i këshillojnë të shikojnë nëse kanë ndonjë objekt të ngjashëm me rrethin aty pranë.

Fëmijët shprehin mendimet e tyre.

Edukatori/ja u lexon një gjëgjëzë:

“Pa zë heshtur numëron, askush punën s’ia mohon”. (Ora)

Pasi zbulohet gjëgjëza, ata gjejnë fjalë të tjera që fillojnë apo kanë në përbërje tingullin O.

Edukatori/ja ka përgatitur mjedisin në katër qendra të aktiviteteve ku fëmijët do të mund të realizojnë aktivitete të ndryshme që ndërlidhën me temën ditore.

Në njërin kënd, ata do të shfletojnë në revista dhe do të gjejnë fotografi të ndryshme që fillojnë ose kanë në përbërje shkronjën O, duke ndërtuar albumin e shkronjës O.

Në një tjetër, ata kanë mundësi që në pjatat me miell, oriz, rërë ose ndonjë material tjetër (tabakët sensorik) të praktikojnë modelin e shkronjës O dhe shkronjave të tjera që njohin.

Në një kënd tjetër do të mund të modelojnë me plastelinë.

Në tjetrin, fëmijët do të plotësojnë fletëzat e punës për shkronjën O.

Në takimin përmbyllës, edukatori/ja zhvillon aktivitetin “Ecje me rrokje”. Fëmijët ndajnë në rrokje fjalët që kanë përzgjedhur (p.sh. ora, oxhaku, Orgesi etj.). Ata ndajnë në rrokje duke ecur dhe numërojnë sa rrokje ka secila fjalë (më shumë, më pak). (Fëmijët e ulur në rreth numërojnë me gishtërinj.)

Vlerësimi:

Fëmijët vlerësohen sipas kritereve të vendosura në lista kontrolli.

Më shumë për të bërë:


Fëmijët mund të modelojnë një orë me letër me ndihmën e prindërve ose me ndihmën e fëmijëve fëmijët mund të ndërtojnë përmes vizatimit një listë me objekte që ata kanë në shtëpitë e tyre, të cilat fillojnë ose kanë në përbërje shkronjën O.

Reflektimi:

Figurat dhe trupat


Fusha kurrikulare:	Shkencat e natyrës
Kurrikula lëndore:	Njeriu dhe natyra
Tema nga plani dymujor:	Materialet dhe vetitë
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):	I -3, 5; II -1, 2, 3, 4, 7; III -1, 2, 3, 6; V -5
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):	Shkencat e natyrës: 1 Gjuhët dhe komunikimi: 1.1; 1.4 Matematikë: 6.2
Rezultati i të nxënit të temës:	Grupon lodrat dhe objektet përreth sipas ngjyrës, formës, peshës, fortësisë, temperaturës etj.
Rezultatet e të nxënit të aktiviteteve:	<ul style="list-style-type: none"> • Klasifikon format dydimensionale nga ato tredimensionale. • Vëzhgon ndërtimin e sipërfaqeve të trupave tredimensionale përmes lëngut të sapunit.
Kriteret e suksesit:	<ul style="list-style-type: none"> • Klasifiko format dydimensionale nga ato tredimensionale. • Vëzhgo ndërtimin e sipërfaqeve të trupave tredimensionale përmes lëngut të sapunit.
Burimet dhe materialet:	Kuti kartoni e zbukuruar, forma dydimensionale (petëza të figurave të ndryshme gjeometrike, forma gjeometrike të prera nga materiale), forma tredimensionale si kuba, sferë, pipëza, pipëza të lëvizshëm, fletë, enë plastike të thella, lëng sapuni.
Integrimi ndërfaqor:	Gjuhë shqipe, Matematikë.
Çështjet ndërkurrikulare:	Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.
Fjalë kyçe:	Figurë gjeometrike, trup gjeometrik, klasifikim, kub, sferë.
Organizimi i aktiviteteve:	<p>Pas përshëndetjes dhe kalendarit, edukatori/ja sjell përpara fëmijëve "Kutinë e fshehtë". Ai/ajo ka përgatitur paraprakisht një kuti të zbukuruar, e cila ka vetëm një hapësirë anash saj. Brenda ka aq objekte sa ka fëmijë në klasë. Objektet duhet të jenë dydimensionale (petëza të figurave të ndryshme gjeometrike, forma gjeometrike të prera nga materiale) dhe tredimensionale (kub, sferë etj.). Diskutimi zhvillohet në rreth. Fëmija i parë fut dorën në kuti, nxjerr objektin, flet për formën, ngjyrën dhe thotë se me çfarë ngjason. Vijon fëmija e dytë e kështu me radhë gjersa të përfshihen të gjithë fëmijët. Gjatë diskutimit, krahasohen edhe figurat e gjetura me njëra-tjetrën.</p> <p>Përmes pyetjeve, edukatori/ja nxit fëmijët të mendojnë për emërtimet e trupave gjeometrike (kub, cilindër, sferë etj.) dhe dallimet mes tyre.</p>

Edukatori/ja vendos në mes të rrethit një fletë të ndarë në mes. Në njërin anë, fëmijët vendosin figurat gjeometrike, ndërsa në tjetrën, trupat gjeometrikë.



Në vijim, fëmijët bëjnë klasifikimin e figurave dhe të trupave gjeometrikë edhe në fletëzat e punës përmes prerjes dhe ngjitjes në vendet përkatëse.


Pas përfundimit të librit të punës, fëmijët eksperimentojnë me trupat gjeometrikë përmes flluskave të sapunit për të parë sipërfaqet dhe si bashkohen ato me njëra-tjetrën. Edukatori/ja ka përgatitur paraprakisht hapësirën për eksperimentim dhe i ndan fëmijët në tri grupe të vogla.



Për grupin e parë, edukatori/ja ka lidhur bashkë afërsisht dhjetë pipëza, të cilat kur fryhen krijojnë grup sferash të lidhura me njëra-tjetrën.



Për grupin e dytë, pipëzat priten në formë të njëjtë dhe përmes një pipëze lëvizëse lidhen me njëra-tjetrën për të krijuar një kub. Përmes kubit me pipëza dhe vendosjes së tij në lëng sapuni, fëmijët mund të vëzhgojnë ndërtimin dhe lidhjen e sipërfaqeve me njëra-tjetrën.



Për grupin e tretë, pipëzat priten në formë të njëjtë dhe përmes një pipëze lëvizëse lidhen me njëra-tjetrën për të krijuar një piramidë. Përmes piramidës me pipëza dhe vendosjes së saj në lëng sapuni, fëmijët mund të vëzhgojnë ndërtimin dhe lidhjen e sipërfaqeve me njëra-tjetrën.

Fëmijët ndërrojnë vendet, në mënyrë që secili prej tyre të vëzhgojë ndërtimin e trupave gjeometrikë.

Në takimin përmbyllës, edukatori/ja u kërkon fëmijëve të nxjerrin përfundime nga vëzhgimi që bënë gjatë eksperimentit.

Vlerësimi:

Edukatori/ja sipas planit të vlerësimit bën vëzhgimin e fëmijëve.

Më shumë për të bërë:

Edukatori/ja mund të përdorë edhe [linkun https://www.education.com/game/2d-3d-shapes/](https://www.education.com/game/2d-3d-shapes/) që paraqet një lojë, e cila ka për qëllim klasifikimin e figurave dydimensionale dhe tredimensionale.

Nxit punën individuale për fëmijët që kanë nevojë për më shumë kohë në përvetësimin e koncepteve. Përdor gjeotabelën, plastelinën, blloqet, aktivitete të individualizuara etj.

Reflektimi:

Ne jemi çfarë hamë

Fusha kurrikulare:	Edukata fizike, sportet dhe shëndeti
Kurrikula lëndore:	Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti
Tema nga plani dymujor:	Ushqimi i shëndetshëm dhe kultura e të ushqyerit
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):	I-3, 5; II-7; III-3; V-3, 5; VI-6
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):	Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti: 3.1 Matematikë: 6.2 Gjuhët dhe komunikimi: 1.1; 1.5
Rezultati i të nxënit të temës:	Dallon llojet e ushqimeve që përdor.
Rezultatet e të nxënit të aktiviteteve:	<ul style="list-style-type: none"> • Shpjegon ndikimin e ushqimit në shëndetin e njeriut. • Njeh piramidën e ushqimeve. • Grupon ushqimet e shëndetshme dhe të pashëndetshme në tabelën e ushqimeve.
Kriteret e suksesit:	<ul style="list-style-type: none"> • Shpjego ndikimin e ushqimit në shëndetin e njeriut. • Konstruktin piramidën e ushqimeve. • Grupo ushqimet e shëndetshme dhe të pashëndetshme në tabelën e ushqimeve.
Burimet dhe materialet:	Poster i piramidës ushqimore, pjata, fotografi (figura) të ushqimeve.
Integrimi ndërfaqor:	Matematikë, Gjuhë shqipe.
Çështjet ndërkurrikulare:	Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.
Fjalë kyçe:	Shëndet, ushqim, i shëndetshëm, i pashëndetshëm, ushtrim fizik, grupim, bashkësi.
Organizimi i aktiviteteve:	Në takimin e përbashkët, fëmijët njihen me piramidën e ushqimeve. Edukatori/ja i pyet se çfarë shohin brenda trekëndëshit të madh, i njeh me temën javore dhe u paraqet mysafirin e ditës (një prind mjek/e, ose sportist. Në mungesë të prindit me profesion të tillë, mund të përfshini dikë nga komuniteti.)



I/e ftuari/a u flet fëmijëve për:

- piramidën e ushqimeve;
- për gjashtë grupet ushqimore të piramidës;
- ndikimin e ushqimit në shëndetin e njeriut;
- ushqimet e dëmshme dhe pasojat e tyre;
- rolin e aktivitetit sportiv në mirëritjen e fëmijëve etj.

Pjatat (aq sa fëmijë ka në grup), ku janë ngjitur fotografi të ndryshme të ushqimeve nga të gjashta grupet ushqimore, vendosen në formë rrethi në dysheme.

Fëmijët qëndrojnë përçark rrethit me pjata. Edukatori/ja vë muzikë ritmike dhe fton fëmijët që të kërcëjnë përçark rrethit me pjata. Kur ai/ajo ndërpret muzikën, fëmijët ndalojnë dhe marrin në dorë pjatën që kanë pranë, të cilën e vendosin në piramidë, në grupet ushqimore që përkasin.

Bashkësitë e ushqimeve të shëndetshme dhe të pashëndetshme

Fëmijët afrohen te kutia e materialeve të ripërdorueshme dhe kërkojnë për revista (shtojcat e reklamave të ushqimeve). Secili pret me gërshtë figura ushqimesh çfarëdo (fruta, perime, qumësht, çokollata, lëngje frutash etj.). Pas mbarojnë, i vendosin fotografitë në një kuti dhe i përziejnë. Secili me radhë fut dorën në kuti dhe pa parë përzgjedh një fotografi. Në vijim, përshkruan ushqimin që gjendet në fotografi (figurë) dhe e grupon te tabela e ushqimeve të shëndetshme ose tek ajo e ushqimeve të pashëndetshme.

E shëndetshme	E pashëndetshme

Kur arrijnë t'i ndajnë ushqimet në dy grupe të mëdha fëmijët njihen me konceptin e bashkësive. Edukatori/ja u shpjegon si formohen bashkësitë dhe si grupohen elementet sipas karakteristikave të ndryshme: formë, madhësi, cilësi etj.

Pasi përfundojnë grupimin e ushqimeve, fëmijët i mbledhin fotografitë që përdorën dhe i dërgojnë në kutinë e materialeve të ripërdorueshme. Kështu, ata edukohen për ripërdorimin e materialeve të ndryshme dhe për mbrojtjen e mjedisit.


Në fund të ditës, edukatori/ja i mbledh fëmijët në rreth. Secili përshkruan ditën vetëm me një fjalë. Pas përshkrimit, të gjithë së bashku përsërisin gjashtë grupet ushqimore të piramidës, bashkësitë e ushqimeve të shëndetshme dhe të pashëndetshme etj.

Edukatori/ja së bashku me fëmijët bëjnë disa ushtrime/lëvizje trupore. Pas lëvizjeve trupore të lehta për çlodhjen e muskujve, të duarve, të shpinës, të qafës etj., fëmijët udhëzohen që të marrin frymë thellë, sikur të ishin duke fryrë dhe shfryrë një tullumbace të madhe. Kështu, edukatori/ja dhe fëmijët çlodhen së bashku.

Para se të largohen, fëmijët njoftohen për aktivitetin e ditës së ardhshme: *Loja e dyqanit në klasën përgatitore, ku do të shiten dhe do të blihen fruta e perime.*

Vlerësimi:	Fëmijët vëzhgohen gjatë aktivitetit për klasifikimin e pjatave me ushqime në piramidë dhe për formimin e bashkësive në tabelën me dy ndarje (ushqime të shëndetshme/të pashëndetshme).
Më shumë për të bërë:	Edukatori/ja përgatit modele të piramidës ushqimore dhe ua shpërndan fëmijëve, të cilët i marrin në shtëpi dhe diskutojnë me prindërit rëndësinë e ushqimeve.
Reflektimi:	_____

Dyqani ynë i ushqimeve

Fusha kurrikulare:	Jeta dhe puna
Kurrikula lëndore:	Shkathësia për jetë
Tema nga plani dymujor:	Planifikimi i buxhetit familjar
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):	I -3, 5; -7; III -3; V -3, 5; VI -6
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):	Jeta dhe puna: 5.9.1 Gjuhët dhe komunikimi: 1.1; 1.4; 1, 6 Matematikë: 3.5
Rezultati i të nxënit të temës:	Stimulon shitjen e sendeve, duke krijuar tregun dhe duke luajtur rolin e shitësit dhe të blerësit.
Rezultatet e të nxënit të aktiviteve:	<ul style="list-style-type: none"> • Dramatizon punën e shit-blerjes në treg. • Grupon në bashkësi frutat dhe perimet.
Kriteret e suksesit:	<ul style="list-style-type: none"> • Dramatizo punën e shitblerjes në treg. • Grupo në bashkësi frutat dhe perimet.
Burimet dhe materialet:	Tavolinë, shportë me fotografi ushqimesh, kuti, peshore, fletë, gërshërë.
Integrimi ndërfaqor:	Gjuhë shqipe, Matematikë.
Çështjet ndërkurrikulare:	Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.
Fjalë kyçe:	Fruta, perime, treg, dyqan, monedha, bashkësi.
Organizimi i aktiviteve:	Fëmijët vijnë të informuar për dyqanin që do të ngrihet në klasë. Me këtë entuziazëm fillon dita, e cila vijon me kalendarin dhe përsëritjen e temës së ditës së kaluar. Diskutohet për përshtypjet nga vizita e të ftuarit në klasë, rishikohet piramida e ushqimeve, forma e saj trekëndore, i numërohen këndet dhe gjashtë grupet ushqimore.
	<p><i>Dyqani ynë i ushqimeve</i></p> <p>Fëmijët njoftohen për planin e ngritjes së dyqanit, çka i bën të ndihen të përfshirë në vendimmarrje, në organizimin e këndit të dramatizimit dhe në ndarjen e roleve:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Rregullojnë tavolinën. • Presin më gërshërë monedhat nga libri i fëmijës. • Marrin fotografitë e ushqimeve nga kutia e materialeve ricikluese. • Përdorin lodra të ndryshme: setin e frutave dhe të perimeve, peshoren lodër etj. • Ndajnë ushqimet në shporta të ndryshme, duke i klasifikuar ato. <p>Përgatiteni këndin e dramatizimit, sipas kushteve të klasës.</p>

Edukatori/ja merr pjesë aktive në dramatizim në mënyrë që, kohë pas kohe, t'i nxisë fëmijët për pjesëmarrje aktive dhe të arrijë përforcimin e koncepteve nëpërmjet lojës. Dramatizimi vazhdon derisa të kenë ndërruar rolet të gjithë fëmijët.

Këndi i dramatizimit mbetet në klasë deri në fund të javës dhe fëmijët mund t'i qasen gjatë kohës së lirë.

Pas përfundimit të dramatizimit, fëmijët dëgjojnë një këngë çlodhëse dhe mund të provojnë të bëjnë lëvizje trupore dhe ushtrime joga.

Në takimin përmbyllës diskutohet për përvojat gjatë lojës me role, si u ndie secili në role të ndryshme, ku ishte më lehtë më vështirë, çfarë u shit më shumë e çfarë më pak, sa i është dhënë rëndësi blerjes së ushqimeve të shëndetshme etj.

Vlerësimi:

Edukatori/ja vëzhgon pjesëmarrjen aktive në lojën me role.

Më shumë për të bërë:

Jepuni fëmijëve nga një shënim për t'ua dërguar prindërve. Aty do të informohen për temën javore dhe u kërkohet që të nesërmen fëmijët të sjellin me vete nga një frut.

Ju mund t'u dërgoni edhe *e-mail*, nëse kjo është një mënyrë më e lehtë për ju dhe ata.

Reflektimi:

Sallata jonë artistike

Fusha kurrikulare:

Shkencat natyrore

Kurrikula lëndore:

Njeriu dhe natyra

Tema nga plani dymujor:

Bimët, kafshët dhe njeriu

**Rezultatet e të nxënit
për kompetencat
kryesore të shkallës
(të synuara):**

I-3, 5; II-7; III-2, 3, 6; IV-4; V-3, 5; VI-6


**Rezultatet e fushës së
kurrikulës (të synuara):**

Shkencat natyrore: 2
Gjuhët dhe komunikimi: 1.1; 1.4
Matematikë: 4.1
Artet: 1

**Rezultati i të
nxënit të temës:**

Tregon nevojat themelore jetësore të njeriut (strehim, ushqim, ujë, ajër, dritë).

Rezultatet e të nxënit të aktiviteve:	<ul style="list-style-type: none"> • Përgatit vetë sallatën me fruta. • Realizon kolazh ushqimesh. • Ndërton me shkopinj druri dhe copëza molle.
Kriteret e suksesit:	<ul style="list-style-type: none"> • Përgatit vetë sallatën me fruta. • Realizo kolazh ushqimesh. • Ndërto me shkopinj druri dhe copëza molle.
Burimet dhe materialet:	Fruta, pjata plastike/letre, shkopinj druri, kartat e lojës së kujtesës.
Integrimi ndërfaqor:	Gjuhë shqipe, Matematikë, Edukim figurativ.
Çështjet ndërkurrikulare:	Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.
Fjalë kyçe:	Grupim, klasifikim, fruta, sallatë, kolazh, konstruksion.
Organizimi i aktiviteve:	<p>Duke qenë se janë të gjithë të përgatitur për aktivitetin e sotëm, edukatori/ja vendos disa shporta afër derës së klasës, që secili fëmijë teksa vjen, vendos frutin që ka sjellë. (Shportat vendosen te hyrja e klasës, në mënyrë që fëmijët të ndihen lirshëm, madje edhe ata që nuk e kanë sjellë).</p> <p>Pas takimit të përbashkët edukatori/ja fton fëmijët të sistemohen në këndin e klasës që është përgatitur për punimin e sallatave. Ata ndahen në grupe dhe edukatori/ja jep udhëzimet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • pastroni frutat; • kujdes në përdorimin e thikave; • copëtoni frutat; • gruponi në pjata të veçanta sipas ngjyrës; • vendosini në mes të grupit punues. <p>Fëmijëve u shpjegohet që sallatat e tyre do të jenë artistike, prandaj ata me copëza frutash do të formojnë në pjatat e tyre kolazhe të ndryshme sipas fantazisë (fytirëza, lule, zogj, zemra etj.)</p> <p>Ky proces mund të shoqërohet me muzikë të këndshme në sfond.</p> <p>Para se fëmijët të fillojnë punën, edukatori/ja kërkon që secili grup punues të ndajë në një pjatë nga dhjetë copëza të vogla molle. Atyre u ofrohet një pjatë me një skedë ku shkruhet: “Bashkësia e mollëve të copëtuara”. Copëzat e mollëve përdoren pas përfundimit të sallatave.</p> <p>Pasi mbarojnë, secili paraqet punën e bërë, tregon çfarë paraqet sallata/kolazh, sa copëza frutash ka përdorur, çfarë ngjyrash kanë frutat e kolazhit etj. (Edukatori/ja i nxit fëmijët në përshkrim të detajuar dhe përdorim të fjalëve përshkruese, duke e paraqitur i/e pari/a sallatën që ka bërë bashkë me fëmijët.)</p> <p>Pas prezantimit të kolazheve të frutave, fëmijët ulen dhe shijojnë sallatat e tyre nën tingujt e muzikës në sfond.</p> <p>Me copëzat e mollëve që ndan gjatë përgatitjes së sallatës, fëmijët ftohen të bëjnë konstruksionin e një ndërtese me mollë dhe shkopinj druri.</p> <p>Ideja e kësaj loje është që ata të punojnë në grup dhe të ndërveprojnë me njëri-tjetrin. Nxitet fryma bashkëpunuese e grupit dhe ftohen fëmijët që të ndërtojnë. Të gjitha grupeve u ofrohen të njëjtat mjete (shkopinj</p>



druri dhe copëza molle). Konstruksionet që do të krijohen, do të jenë tërësisht të ndryshme, varësisht prej strategjive të përdorura nga grupet e ndryshme të fëmijëve.

Në fund ngrihen të gjithë dhe shikojnë punimet e njëri-tjetrit.

Dita përmbyllet me rishikimin e të gjitha aktiviteteve të realizuara gjatë ditës.

Vlerësimi:

Gjatë përgatitjes së sallatës, edukatori/ja vëzhgon vazhdimisht punën e fëmijëve, duke u përqendruar te shkathësitë e prerjes së frutave, grupimi, krijimtaria në realizimin e kolazhit dhe te fondi i fjalëve që fëmijët përdorin për të përshkruar punën e tyre. Dokumenton përmes videos ose fotografisë punën e fëmijëve.

Më shumë për të bërë:

Fëmijëve mund t'u ofrohen lojëra për përgatitjen e ushqimeve në linkun e mëposhtëm:

<http://www.cookinggames.com/games/recipe/>

Reflektimi:

Ylberi ushqimor

Fusha kurrikulare:

Matematikë

Kurrikula lëndore:

Matematikë

Tema nga plani dymujor:

Bashkësitë dhe relacionet

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):

I-3; II-1, 4; III-2; V-5

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):

Matematikë: 6.1.2
Gjuhët dhe komunikimi: 1.1; 1.4
Artet: 1

Rezultati i të nxënit të temës:

Klasifikon sende dhe objekte sipas disa vetive: ngjyrës, formës dhe madhësisë.

Rezultatet e të nxënit të aktiviteteve:

- Numëron me gishtërinj sa grupe janë krijuar.
- Krijon grupe të elementeve me cilësi të përbashkët.
- Qarkon ilustrimet e njëjta për nga ngjyra.

Kriteret e suksesit:

- Numëro me gishtërinj sa grupe janë krijuar.
- Krijon grupe të elementeve me cilësi të përbashkët.
- Qarkon ilustrimet e njëjta për nga ngjyra.

Burimet dhe materialet:

Fotografi të frutave, të perimeve dhe të objekteve të ndryshme, fletë A2.


Integrimi ndërpushor: Gjuhë shqipe, Edukim muzikor.

Çështjet ndërkurrikulare: Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

Fjalë kyçe: Bashkësi, fruta, perime, grupe etj.


Organizimi i aktiviteteve: Edukatori/ja fton fëmijët të luajnë lojën “Vallëzime me vitamina” dhe jep udhëzimet.

Fëmijëve u shpërndahen imazhe të frutave dhe të perimeve dhe udhëzohen që të vallëzojnë sapo të fillojë muzika. Në momentin kur muzika ndalon, ata duhet të vendosen në vendet e caktuara sipas ngjyrave (e kuqe, e portokalltë, e verdhë, e gjelbër, vjollcë).



Edukatori/ja kujdeset që në çastin kur muzika ndalon, fëmijët të ulen sipas ngjyrave në rreth.

Ai/ajo nxit bisedën duke thënë: Sa grupe kemi fituar? Numëroni me gishtërinj. (Fëmijët shprehin mendimet e tyre.) Edukatori/ja largon materialet e përdorura dhe kërkon nga fëmijët që në dyshe të marrin nga mjedisi përreth dy gjëra të njëjta dhe t'i vendosin para vetes në fleta A2 (dy libra, dy lodra, dy topa, dy lule etj.). (Sa grupe kemi fituar? Fëmijët shprehin mendimet e tyre.). Edukatori/ja thekson se grupimet në matematikë ndryshe quhen bashkësi: bashkësia e luleve, bashkësia e librave etj.



Fëmijët ndahen në grupe të vogla. Njëri grup do të plotësojë fletëzën e punës tek “Ylberi ushqimor”. Grupi tjetër do të shoqërojë shkronjën e parë të frutit/perimit me frutin/perimin përkatës (aktivitet i përgatitur nga edukatori/ja). Grupi i fundit do të modelojë me plastelinë fruta dhe perime, sipas dëshirës.

Në takimin përmbyllës luhet loja garuese “Cili ekip gjen më shpejt objektet?”.

Fëmijët ndahen në dy ekipe, edukatori/ja ka përgatitur materiale pune, tiketa me fruta dhe perime dhe dy fotografi ku në njërën paraqitet toka, ndërsa në tjetrën, pema. Kështu, secili ekip do të provojë të klasifikojë tiketat me fruta dhe perime në varësi të vendit ku ato rriten. Dita përfundon me një përmbledhje të aktiviteteve të bëra.

Vlerësimi:

Fëmijët vëzhgohen përgjatë realizimit të aktiviteteve.

Më shumë për të bërë:

Udhëzohuni fëmijët të grupojnë objekte në shtëpi sipas karakteristikave të ndryshme: ngjyrës, formës etj.

Reflektimi:

Mua më pëlqen...

Fusha kurrikulare:

Gjuhët dhe komunikimi

Kurrikula lëndore:

Gjuha shqipe

Tema nga plani dymujor:

Tinguj, shkronja, rrokje, fjalë, fjali

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):

I-3, 5; II-7; III-1, 2, 3, 6; V-5

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):

Gjuhët dhe komunikimi: 1.1, 1.4; 3.2
Shoqëria dhe mjedisi: 1.1.1
Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti: 3.1

Rezultati i të nxënit të temës:

Shqiptojnë drejt tingujt (zanore e bashkëtingëllore) gjatë të shprehurit.

Rezultatet e të nxënit të aktiviteteve:

- Paraqet përmes fotografive nevojat dhe dëshirat.
- Modelon me plastelinë shkronjën "U".

Kriteret e suksesit:

- Paraqit përmes fotografive nevojat dhe dëshirat.
- Modelo me plastelinë shkronjën "U".

Burimet dhe materialet:

Libri i fëmijës, fletë, plastelinë, letër A2, fotografi të ndryshme, shkronja U.

Integrimi ndërfaqor:

Shoqëria dhe mjedisi, Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti.

Çështjet ndërkurrikulare:

Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

Fjalë kyçe:

Nevojë, dëshirë, shkronjë, shkronja "U", klasifikim, modelim.

Organizimi i aktiviteteve:

Dita fillon me përshëndetjen dhe kalendarin e motit. Edukatori/ja sot do të lexojë një histori, e cila ka të bëjë me nevojat dhe dëshirat. Pas leximit të historisë në rreth, edukatori/ja iu shpërndan fëmijëve fletëza me dy ngjyra, në njërën do të vizatojnë një nevojë, në tjetrën një dëshirë; secili nga fëmijët me radhë ndan me të tjerët punën e tij.

Aktiviteti vazhdon me punë në dy grupe. Edukatori/ja ka përgatitur fotografi të ndryshme, të cilat shprehin nevojat dhe dëshirat. Fëmijët do të punojnë në letër A2 duke vendosur ilustrimet në poster. Njëri grup "nevojat", kurse grupi tjetër "dëshirat".

Pas përfundimit të aktivitetit, të dyja grupet paraqesin posterat krahas për krahas me njëri-tjetrin dhe tregojnë për dallimet midis nevojave dhe dëshirave.

Njëra ndër nevojat bazë është edhe nevoja për ushqim.

Fëmijët janë njohur gjatë javës me ushqimet, prandaj, edukatori/ja natyrshëm paraqet përpara tyre shkronjën U dhe u kërkon të rikujtojnë nëse është e njohur kjo shkronjë për ta. Së bashku me fëmijët praktikojnë grafikun dhe më pas kalohet nëpër qendrat e aktiviteteve.

Një grup do të modelojë me plastelinë modelin e shkronjës U.

Një grup do të plotësojë fletëzën e punës për shkronjën U.

Një grup do të klasifikojë nevojat dhe dëshirat përmes materialeve të përgatitura nga edukatori/ja.

Pasi përfundimit të aktiviteteve, të gjithë fëmijët mblidhen për takimin përmbyllës.

Së bashku me fëmijët zhvillohet loja "Sallatë frutash". Secili fëmijë do të ketë një emër ushqimi, në këtë rast emër frute. Fëmijët do të ulen në rreth dhe njëri prej tyre do të qëndrojë në mes. Fëmija që është në mes do të japë udhëzimin. Fëmija do të emërtojë një frutë, p.sh.: mollën, dhe të gjithë fëmijët që kanë atë emërtim do të ndryshojnë vendet. Fëmija që mbetet në mes, vazhdon lojën në të njëjtën mënyrë. Kur fëmija thotë "sallatë frutash", të të gjithë fëmijët do të ndërrojnë vendet. Kështu loja vazhdon deri sa të gjithë fëmijët të kenë provuar së paku një herë dhënien e udhëzimeve. Loja mund të luhet në mjedis të brendshme ose në oborr. Ashtu në rreth siç jemi, reflektojmë dhe bashkëbisedojmë për aktivitetet e zhvilluara gjatë ditës së sotme.

Vlerësimi:

Fëmijët vëzhgohen gjatë aktivitetit "Nevojat-Dëshirat" (sa janë në gjendje të ndajnë nevojat nga dëshirat).

Më shumë për të bërë:

Ju mund të fshihni disa kopje të shkronjës U në hapësirat e klasës para fillimit të mësimin, dhe fëmijët mund të luajnë lojën e detektivit, për t'i gjetur shkronjat e fshehura.

Reflektimi:

Të njohim shqisat

Fusha kurrikulare:	Shkenca dhe natyra
Kurrikula lëndore:	Njeriu dhe natyra
Tema nga plani dymujor:	Bimët, kafshët dhe njeriu
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):	I-3, 5; II-7; III-2, 3, 6; IV-4; V-5; VI-6
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):	Shkenca dhe natyra: 1 Gjuhët dhe komunikimi: 1.1; 1.4 Matematikë: 2.1
Rezultati i të nxënit të temës:	Realizon veprime duke përdorur shqisën e caktuar (të parit, të dëgjuarit, të nuhaturit, të shijuarit, dhe të prekurit).
Rezultatet e të nxënit të aktiviteteve:	<ul style="list-style-type: none"> • Vëzhgon procesin e gatimit të kokoshkave/palagaqeve nga fillimi deri në fund. • Dallon 5 shqisat për nga funksioni i tyre. • Ndërton skemën e aktivizimit të shqisave gjatë procesit të gatimit të kokoshkave.
Kriteret e suksesit:	<ul style="list-style-type: none"> • Vëzhgo procesin e gatimit të kokoshkave /palagaqeve nga fillimi deri në fund. • Dallo 5 shqisat për nga funksioni i tyre. • Plotëso fletëzën e gatimit gjatë procesit të gatimit të kokoshkave/palagaqeve. (Fletëza: Eksperimentojmë me shqisat)
Burimet dhe materialet:	Furnelë elektrike, tenxhere, kokrra misri, vaj, enë të thella plastike (ose pjata plastike/letre), libri i punës së fëmijës.
Integrimi ndërfaqor:	Gjuhë shqipe, Matematikë.
Çështjet ndërkurrikulare:	Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.
Fjalë kyçe:	Shndërrim, ndikim i nxehtësisë, proces, gatim, shqisa e të prekurit, të parit, të dëgjuarit, të nuhaturit, të shijuarit, e fortë, e butë, e lëmuar, poroze.
Organizimi i aktiviteteve:	<p>Pas përshëndetjes dhe kalendarit, edukatori/ja kërkon nga fëmijët që të kalojnë dorë më dorë një qese të mbyllur të tejdukshme, brenda së cilës ka misër kokoshkash.</p> <p>Ndërkohë, ai/ajo u drejton fëmijëve pyetje të tilla: <i>Në cilin grup të ushqimeve bën pjesë misri? Cilës familje i takon? A mund të përmendni drithëra të tjera? Çfarë ushqimi mund të përgatitet në klasë me kokrra misri?</i> Fëmijët zbulojnë përgatitjen e kokoshkave.</p> <p>Edukatori/ja kërkon nga fëmijët të numërojnë mjetet që duhen për përgatitjen e tyre.</p>

Fillimisht, ai/ajo përshkruan gjithë procesin dhe u kërkon fëmijëve që të jenë të vëmendshëm në çdo fazë. Gjatë përgatitjes theksohet funksioni i çdo shqise, p.sh.: Si ju duket kokrra e misrit, kur e prekni? (E fortë.) Çfarë ngjyre ka kokrra e misrit? Dëgjoni zhurmën e zbrazjes dhe kërcitjet. Si shndërrohet kokrra e misrit nën ndikimin e nxehtësisë? Etj.

Në përfundim të procesit, fëmijët marrin kokoshka dhe të gjithë në rreth fillojnë t'i shijojnë ato. Edukatori/ja hap diskutimin për shqisat dhe pyet fëmijët rreth tyre.

Diskutohet i gjithë procesi dhe shqisat që u përdorën gjatë secilës fazë:

- *Të prekurit:* kokrrat e misrit: të forta, të lëmuara, të nxehta menjëherë pas gatimit, të buta, poroze.
- *Të dëgjuarit:* tingujt e ndryshëm para përgatitjes së kokoshkave, kërcitjet gjatë përgatitjes dhe tingujt që dëgjoen kur ato fërkohen me njëra-tjetrën pasi janë gatuar.
- *Të parit:* i tërë procesi i gatimit, kokoshkat para, gjatë gatimit dhe pas gatimit.
- *Të nuhaturit:* përpara se gatohen nuk kanë aromë, pas gatimit kanë aromë (aromë e mirë).
- *Të shijuarit:* shijimi i kokoshkave të gatuar me kripë (shije e njelmët).

Në këtë mënyrë, fëmijët mësojnë për shqisat përmes përdorimit të tyre.

Edukatori/ja u sjell sërish fëmijëve misër kokoshkash. Ai/ajo kërkon që secili prej tyre të marrë një kokërr misri dhe një kokoshkë, që t'i vendosë te këndi i punës për të plotësuar fletën e punës në librin e tij.

Pas përfundimit të fletës së punës, në takimin përmbyllës, edukatori/ja përmes "Lojës me top", kërkon nga fëmijët të tregojnë se cila qe pjesa e parapëlqyer e ditës, cilat shqisa përdorën më shumë etj.

Vlerësimi:

Edukatori/ja dokumenton procesin përmes videos apo fotografive, mban shënime për të dhënat me rëndësi.


Më shumë për të bërë:

Edukatori/ja kërkon nga fëmijët që të sjellin në klasë objekte, mjete të ndryshme që mund të përdoren në klasë gjatë aktiviteteve që kanë qëllim aktivizimin e shqisave.

Edukatori/ja kërkon ndihmën e prindërve për të grumbulluar materialet. Ai/ajo mund të hartojë edhe një listë.

Reflektimi:

Tingujt

Fusha kurrikulare:	Gjuhët dhe komunikimi
Kurrikula lëndore:	Gjuhë shqipe
Tema nga plani dymujor:	Tinguj, shkronja, rrokje, fjalë, fjali.
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):	I -3, 5; II -7; III -1, 2, 3, 6; V -5
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):	Gjuhët dhe komunikimi: 1.1; 1.4; 1.5; 3.2 Shoqëria dhe mjedisi: 1.1.2 Artet: 1
Rezultati i të nxënit të temës:	Shqiptojnë drejt tingujt (zanore e bashkëtingëllore) gjatë të shprehurit.
Rezultatet e të nxënit të aktiviteteve:	<ul style="list-style-type: none"> • Ritregon pjesëza nga tregimi i lexuar. • Modelon shkronjën C me materialet e dhëna. • Identifikon zërat e shokëve/shoqeve gjatë aktivitetit “Emërto këtë tingull”.
Kriteret e suksesit:	<ul style="list-style-type: none"> • Ritrego tregimin e lexuar. • Modelo grafikun e shkronjës C me materialet e dhëna. • Identifiko zërat e shokëve/shoqeve gjatë aktivitetit “Emërto këtë tingull”.
Burimet dhe materialet:	Libër për fëmijë, libri i punës i fëmijës, aplikacion telefoni për tingujt “Guess the sounds” ose të ngjashme, pjata letre, miell, kripë, sheqer, shami.
Integrimi ndërfaqor:	Shoqëria dhe mjedisi, Edukatë figurative.
Çështjet ndërkurrikulare:	Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.
Fjalë kyçe:	Dëgjim, vesh, tinguj, tingulli C, shkronja C.
Organizimi i aktiviteteve:	<p>Në takimin e përbashkët, edukatori/ja ka vendosur në mes të rrethit 5 shporta të vogla me nga një foto shqise në secilën. Fëmijët tregojnë me radhë objektin që kanë sjellë dhe e vendosin tek shporta përkatëse. (Disa nga materialet mund të bëjnë pjesë në më shumë se një shportë, prandaj edukatori/ja i nxit fëmijët që të mendojnë se si ne i përdorim shqisat gjatë gjithë kohës, në mënyrë të pandarë prej njëra-tjetrës.)</p>  <p>Pasi përfundojnë të gjithë fëmijët, edukatori/ja largon nga rrethi 4 shporta dhe lë para fëmijëve vetëm shportën që ka të bëjë me shqisën e të dëgjuarit.</p> <p>Edukatori/ja demonstroi secilin objekt dhe kërkon nga fëmijët që të mbyllin sytë e të mendojnë për tingujt që dëgjojnë. Fëmijët mund të</p>

qëndrojnë në pozicionin që janë, të ulen ose të shtrihen në dysHEME, si të dëshirojnë.

Dita vazhdon me aktivitetin tjetër të quajtur "Ilustro historinë e Dumbos në imagjinatën tënde" (Historia e Dumbos-Elefantit veshmadh). Secili fëmijë mund të shkojë në një pjesë të dhomës që i pëlqen, mund të shtrihet në dysHEME, të qëndrojnë afër edukatorit/es apo në ndonjë pjesë më të largët. Rregulla e vetme e aktivitetit është që fëmijët të mbyllin sytë dhe të imagjinojnë ngjarjen e tregimit të lexuar nga edukatori/ja. Pas përfundimit të leximit, fëmijët kthehen në rreth për diskutim.

Pas diskutimit të tregimit, edukatori/ja orienton fëmijët drejt tingullit C. Fëmijët mund të nxjerrin nga tregimi fjalët që fillojnë me shkronjën C dhe fjalët që në përbërjen e tyre kanë shkronjën C.

Më pas fëmijët praktikojnë modelimin e grafikut të shkronjës C në tri materiale të ndryshme (mund të jenë: miell, kripë, sheqer).

Fëmijët plotësojnë në librin e tyre të punës.

Luhet loja "Emërto këtë tingull". Fëmijët ulen në formë rrethi dhe njërit prej tyre i mbyllin sytë me shami. Një fëmijë tjetër nga rrethi imiton një kafshë, thotë ndonjë fjali, këndon refrenin e një kënge, apo dy vargje nga një vjershë. Fëmija i parë hap sytë dhe përpjeket të gjejë se zëri i cilit fëmijë ishte. Fëmijët inkurajohen të gjejnë imitime sa më interesante.

Në takimin përmbyllës rikujtohet veprimtaria e ditës, fëmijët dëgjojnë dhe identifikojnë tingujt e lëshuar.

Edukatori/ja mund të përdorë edhe ndonjë aplikacion në telefon për dëgjimin dhe identifikimin e tingujve.

Vlerësimi:

Vlerësohen në mënyrë verbale përpjekjet krijuese të fëmijës për të gjetur një mënyrë për të dëgjuar tregimin. Vlerësohen përpjekjet e fëmijës duke ia shpjeguar konkretisht se për çfarë po vlerësohet, p.sh.: "Më duket shumë i qëlluar vendi që zgjodhe për dëgjimin e tregimit, ndaj mendoj që je ndier më mirë; Sot po mban lapsin në formën e duhur etj.

Më shumë për të bërë:

Aktiviteti i shqisës së të dëgjuarit mund të zgjerohet duke u kombinuar edhe me aktivitete në natyrë, duke dëgjuar tingujt brenda dhe jashtë klasës, duke krahasuar dhe duke nxjerrë përfundime, duke përdorur tinguj të lartësive të ndryshme, notat muzikore etj.

Reflektimi:

Shikoj dhe mësoj

Fusha kurrikulare:	Edukata fizike, sportet dhe shëndeti
Kurrikula lëndore:	Edukata fizike, sportet dhe shëndeti
Tema nga plani dymujor:	Njohja e vetes dhe e botës
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):	I -3, 5, 6; II -2, 4, 7; III -2, 6; IV -2, 5; VI -6
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):	Edukata fizike, sportet dhe shëndeti: 1 Gjuhët dhe komunikimi: 1.1; 1.4 Artet: 1 Matematikë: 3.3
Rezultati i të nxënit të temës:	Shpreh krijimtarinë me lëvizje, fjalë dhe krijime të ndryshme.
Rezultatet e të nxënit të aktiviteteve:	<ul style="list-style-type: none"> • Diskuton për funksionin e shqisës së të parit. • Lëviz me sytë mbyllur në hapësirat e klasës, nën shoqërimin e shokut ose shoqes. • Përdor pasqyrën për të vizatuar autoportretin.
Kriteret e suksesit:	<ul style="list-style-type: none"> • Diskuto për funksionin e shqisës së të parit. • Lëviz me sytë mbyllur në hapësirat e klasës, nën shoqërimin e shokut ose shoqes. • Përdor pasqyrën për të vizatuar autoportretin.
Burimet dhe materialet:	Shportë me materiale të ndryshme, shami, letër, gërshtë, ngjites, pasqyrë, letra të tejdukshme me ngjyra, syze, teleskop, kaleidoskop etj. https://www.youtube.com/watch?v=T5CHfLP71T4
Integrimi ndërfaqor:	Gjuhë shqipe, Edukatë muzikore, Matematikë.
Çështjet ndërkurrikulare:	Zhvillimi personal dhe shkathtësitë për jetë.
Fjalë kyçe:	Shqisa e të parit, sy, shikim, funksion, kaleidoskop, teleskop, syze.
Organizimi i aktiviteteve:	<p>Pas përfundimit të përshëndetjes dhe të kalendarit, edukatori/ja vë melodinë e këngës së Barnit "5 shqisat": https://www.youtube.com/watch?v=T5CHfLP71T4 dhe bashkë me fëmijët thotë tekstin. Ai/ajo mund ta dramatizojë këngën edhe përmes përdorimit të fotove lëvizëse. Pas dëgjimit të parë, fëmijët ngrihen në këmbë dhe shoqërojnë me lëvizje tekstin e këngës.</p> <p>Teksti i këngës "Pesë shqisat" mund të shqipërohet ose të përshtatet nga vetë edukatori/ja.</p>



Pas këndimit të këngës dhe shoqërimit me lëvizje, edukatori/ja paraqet përpara fëmijëve shportën me materialet e sjella prej tyre. Në shportën e shqisës së të parit, ai/ajo shton një kaleidoskop, teleskop, syze etj.

Të gjithë së bashku eksplorojnë materialet dhe diskutojnë për to. Edukatori/ja kërkon nga fëmijët që të mbyllin sytë dhe të mendojnë se si do të orientoheshin nëse do t'i kishin sytë e mbyllur. Më tej, edukatori/ja u flet për informacionet që merren përmes shqisës së të parit. Fëmijët kalojnë dorë më dorë kaleidoskopin dhe teleskopin dhe shohin përmes tyre; pastaj të gjithë së bashku diskutojnë përshtypjet e tyre.

Më pas, edukatori/ja kërkon nga fëmijët që të ndahen në çifte sipas dëshirës për të luajtur lojën "Më shoqëro".

Udhëzimet për lojën:

- Fëmijët ndahen në dyshe.
- Edukatori/ja shpërndan shamitë.
- Në secilën dyshe, njëri nga fëmijët lidh sytë.
- Fëmija tjetër udhëzon fëmijën me sytë mbyllur, të ecë nga njëri kënd i klasës në tjetrin pa u penguar.
- Ndërrohen rolet. Fillon loja sërish.
- Në fund diskutohen përshtypjet.

Më pas, fëmijët ftohen për të eksploruar me shqisën e të parit dhe ndahen në dy grupe të vogla:

Fëmijët e grupit të parë vizatojnë portretin e tyre duke përdorur pasqyrën.

Fëmijët e grupit të dytë ndërtojnë nga një palë syze me materialet e ofruara.



Secili fëmijë mund të realizojë që të dyja aktivitetet.

Takimi përmbyllës zhvillohet në oborrin e institucionit parashkollor/shkollës. Së bashku me fëmijët zhvillohet përsëritja e aktivitetëve të zhvilluara dhe edukatori/ja i nxit ata të vëzhgojnë natyrën përreth.

Fëmijëve u ofrohet mundësia të shohin me kaleidoskop dhe teleskop, për të kuptuar se si funksionojnë dhe duken gjërat edhe në natyrë.

Vlerësimi:	Përmes fletë-vlerësimeve, edukatori/ja vëzhgon fëmijët sipas planit të vëzhgimit.
Më shumë për të bërë:	Kërkohet bashkëpunimi i prindërve në nxitjen e fëmijëve për të zbuluar dhe për të zgjeruar informacionin mbi shqisën e të parit.
Reflektimi:	_____

Prek e ndiej

Fusha kurrikulare:	Matematika
Kurrikula lëndore:	Matematika
Tema nga plani dymujor:	Numrat natyrorë
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):	I-3 ;II-7; III-2, 3, 4, 6; V-5; VI-6
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):	Matematika: 5.1 Gjuhët dhe komunikimi: 1.1; 1.3 Edukim fizik, sportet dhe shëndeti: 2
Rezultati i të nxënit të temës:	Kopjon, vizaton, modelon numrat nga 1 deri në 10.
Rezultatet e të nxënit të aktiviteteve:	<ul style="list-style-type: none"> • Dallon simbolin e numrit 1 • Përcakton me këmbë vetitë e materialeve të ndryshme (e fortë, e butë, e lëmuar etj.). • Modelon numrin 1.
Kriteret e suksesit:	<ul style="list-style-type: none"> • Dallo simbolin e numrit 1. • Përcakto me këmbë vetitë e materialeve të ndryshme (e fortë, e butë, e lëmuar, etj) • Modelo numrin 1.
Burimet dhe materialet:	Shportë me materiale: copëza materiali, materiale të natyrës, lodra dhe objekte të ndryshme, kubi i shqisave, tabelë magnetike, lapustilë; shirit për ecje, libri i fëmijës, plastelinë.
Integrimi ndërfaqor:	Gjuhë shqipe, Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti.
Çështjet ndërkurrikulare:	Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.
Fjalë kyçe:	Shqisa e të prekurit, prekja, numri 1, i fortë, i butë, i vrazhdë, i lëmuar, rrëshqitës etj.

Organizimi i aktiviteteve:

Edukatori/ja në takimin e përbashkët u kërkon fëmijëve të thonë si ndihen sot dhe me çfarë energjie kanë ardhur në klasë. Më pas, ai/ajo i fton ata që të luajnë së bashku lojën me kub. (Kubi gjendet në shtojcën e librit, printohet, pritët, ngjitet dhe është i gatshëm për përdorim).

Përgjatë lojës me kub, secili fëmijë rrotullon kubin dhe varësisht nga fotoja tregon një funksion ose jep një të dhënë për shqisën përkatëse, p.sh.: dora. Përmes dorës kapim lodrën.

Edukatori/ja nxjerr përpara fëmijëve shportën me materialet që ata kanë sjellë për shqisën e prekjes. (Shporta pasurohet me materiale edhe nga edukatori/ja, në mënyrë që të ketë mjaftueshëm për të gjithë fëmijët.)

Shporta qarkohet në rreth dhe secili fëmijë merr diçka prej saj. Edukatori/ja nxit me radhë fëmijët që të flasin për vetitë e atij materiali, nëpërmjet prekjes: i fortë, i butë, i ashpër, i lëmuar, rrëshqitës etj. Diskutimi zhvillohet në varësi të materialeve.




Në vijim, edukatori/ja kërkon nga fëmijët të gjejnë se sa është numri i objekteve që mban në dorë secili. Kështu, ai/ajo u shpjegon fëmijëve sasinë e numrit 1: një fëmijë, një lodër, një gomë, një boçe pise etj.

Ata do të plotësojnë fletëzën e punës tek numri 1 dhe modelojnë numrin 1 me plastelinë.

Pas mbarimit të detyrës, fëmijët eksperimentojnë me shqisën e të prekurit, duke përdorur këmbët për të kuptuar vetitë e materialeve.

(Shih figurën.) Në fillim, ata ecin me të dyja këmbët në një fushë, pastaj ecin me një këmbë në një fushë dhe me këmbën tjetër në fushën tjetër dhe në fund ecin këmbadoras, duke lëvizur nga fusha në fushë. Edukatori/ja inkurajon fëmijët që gjatë gjithë kohës të flasin për ndjesitë që u krijohen gjatë prekjes së materialeve të ndryshme, dallimet që ata ndiejnë për të njëjtin material kur e prekin me dorë ose me këmbë etj.

Takimi përmbyllet në natyrë, ku edukatori/ja kërkon nga fëmijët që të numërojnë objektet që shohin përreth dhe diskutojnë me ta rreth numrit 1. (Edukatori/ja, sipas mundësive, i lejon fëmijët që të prekin barin me duar apo me këmbë.)

**Vlerësimi:**

Edukatori/ja përmes dëgjimit aktiv kupton të shprehurit e fëmijëve në përshkrimin e objektit përmes prekjes dhe vëzhgimit. Përmes pyetjeve, ai/ajo kupton përvetësimin e konceptit mbi numrin 1.

Më shumë për të bërë:

Edukatori/ja zhvillon më tepër aktivitete në varësi të interesimit të fëmijëve.

Reflektimi:

Nuhas dhe shjoj


Fusha kurrikulare:	Jeta dhe puna
Kurrikula lëndore:	Shkathësia për jetë
Tema nga plani dymujor:	Mjedisi shtëpiak, kopshti dhe shkolla
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):	I-3; II-7; III-2, 3, 4, 6; V-5; VI-6
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):	Jeta dhe puna: 1.1.2 Gjuhët dhe komunikimi: 1.1; 1.4 Matematika: 2.2
Rezultati i të nxënit të temës:	Realizon aktivitete në bashkëpunim me të tjerët përmes lojës (gatuan ushqime, rregullon ambientin, përgatit tryezën...).
Rezultatet e të nxënit të aktiviteteve:	<ul style="list-style-type: none"> • Përdor nuhatjen për të identifikuar aromat e ndryshme. • Kupton se si funksionon shqisa e shijimit.
Kriteret e suksesit:	<ul style="list-style-type: none"> • Përdor nuhatjen për të identifikuar aromat e ndryshme. • Praktiko se si funksionon shqisa e shijimit.
Burimet dhe materialet:	Shporta për shqisën e nuhatjes dhe të shijimit, kavanoza të vegjël me erëza të ndryshme, pjata letre, kripë, sheqer, limon, çokolatë e zezë ose kakao.
Integrimi ndërfaqor:	Gjuhë shqipe, Matematikë.
Çështjet ndërkurrikulare:	Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.
Fjalë kyçe:	Nuhatje, hundë, aromë, shijimi, goja, e ëmbël, e njelmët, e thartë, e hidhur.
Organizimi i aktiviteteve:	<p>Në takimin e përbashkët, edukatori/ja vendos përpara fëmijëve shportën me objekte për nuhatjen dhe shijimin. Fillimisht, ai/ajo ua ofron objektet e shportës së nuhatjes të gjithë fëmijëve, duke i pyetur për aromat. Fëmijët nxiten me pyetje të tjera për të menduar dhe për të diskutuar. Më pas, edukatori/ja vendos në mes të rrethit një fletë, në të cilën fëmijët klasifikojnë aromat: aromat që vijnë nga produktet ushqimore dhe aromat e tjera.</p> <p>Edukatori/ja ndërlidh erëzat apo produktet tjera të vendosura te rubrika e produkteve ushqimore dhe më pas u shpërndan fëmijëve gjërat që ndodhen te shporta e shijimit.</p> <p>Edukatori/ja nxit zhvillimin e diskutimit për shijet dhe zonat e ndryshme të shijimit, të cilat gjenden në gjuhë.</p> <p>Përpara fëmijëve, edukatori/ja vendos katër pjata, në të cilat ka hedhur: sheqer, kripë, copëza limoni, çokolatë të zezë ose kakao.</p>

Edukatori/ja paraqet një model të gjuhës me 4 zonat e shijimit dhe kërkon nga fëmijët që të shijojnë secilin produkt një nga një. Diskutimi zhvillohet për secilën shije veç e veç.

Fëmijët diskutojnë për shijet dhe përpiqen të kuptojnë se cila pjesë e gjuhës së tyre aktivizohet gjatë shijimit të shijeve të ndryshme.

Më pas, fëmijët hulumtojnë individualisht në hapësirat përreth për të plotësuar fletëzën e tyre të punës duke prerë, duke ngjitur, duke vendosur apo duke vizatuar ndonjë objekt që i përgjigjet secilës shqisë.

Në takimin përmbyllës bëhet përmbledhja e tërë javës, duke kërkuar nga fëmijët që të tregojnë se cili nga informacionet/aktivitetet ka qenë i rëndësishëm dhe argëtues për ta.

**Vlerësimi:**

Edukatori/ja bën vlerësimin e fëmijëve bazuar në shpjegimin që ata japin dhe punën e bërë gjatë aktiviteteve.

Më shumë për të bërë:

Gama e aktiviteteve që kanë të bëjnë me shqisat mund të zgjerohet në mënyra të ndryshme, duke bërë edhe ndërlidhjen me temat e tjera të mëdha.

Reflektimi:

Higjiena personale


Fusha kurrikulare:	Edukata fizike, sportet dhe shëndeti
Kurrikula lëndore:	Edukata fizike, sportet dhe shëndeti
Tema nga plani dymujor:	Shëndeti dhe higjiena personale
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):	I -3; II -3, 7; III -1, 2, 3, 6; IV -4; V -5; VI -6, 7
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):	Edukata fizike, sportet dhe shëndeti: 3.2 Gjuhët dhe komunikimi: 1.1; 1.4 Artet: 1 Matematikë: 3.4
Rezultati i të nxënit të temës:	Tregon mënyrat e duhura për mirëmbajtjen e higjienës personale.
Rezultatet e të nxënit të aktiviteteve:	<ul style="list-style-type: none"> • Bashkëbisedon për higjienën personale në lojën “Prite topin dhe përgjigju”. • Formon shkronjën “H” me flluskatore shumëngjyrëshe. • Simulon një situatë për mbajtjen e higjienës, në lojën me role.
Kriteret e suksesit:	<ul style="list-style-type: none"> • Bashkëbisedo për higjienën personale në lojën “Prite topin dhe përgjigju”. • Formo shkronjën “H” me flluskatore shumëngjyrëshe. • Përmes lojës me role paraqit një situatë për mbajtjen e higjienës.
Burimet dhe materialet:	Sapun duarsh, brushë dhe pastë për larjen e dhëmbëve, një krehër për flokë, qese për trup, fleta të bardha, ngjyra të ujit, një fletë e madhe.
Integrimi ndërfaqor:	Gjuhë shqipe, Edukatë figurative, Matematikë.
Çështjet ndërkurrikulare:	Zhvillimi personal dhe aftësitë për jetë.
Fjalë kyçe:	Higjienë, shëndet, mikrobe, shkronja “H”.
Organizimi i aktiviteteve:	<p>Edukatori/ja siguron disa produkte për higjienën personale, si: sapun duarsh, një brushë dhe një pastë dhëmbësh, një krehër për flokë, qese për trup etj.</p> <p>Të gjitha materialet vendosen në mes të rrethit, ku bëhet takimi i përbashkët. Këto produkte higjienike nxisin kureshtjen e fëmijëve, të cilëve pritet t’u lindin pyetje të ndryshme si: “Pse janë këto gjëra në mes të rrethit? Për çfarë na duhen? Etj.”</p> <p>Pyetjet e fëmijëve janë gjithmonë një mënyrë e mirë për të kaluar në temën e ditës. Në këtë mënyrë, edukatori/ja paraqet temën dhe pas leximit të kalendarit fillon dhe emërton bashkë me fëmijët një e nga një produktet që janë në mes të rrethit. Flet për higjienën e përgjithshme, duke i përmendur me radhë: higjienën e gojës, të duarve, të trupit, të ushqimeve</p>

që konsumojmë, duke e kthyer gradualisht nga fëmijët fokusin e diskutimit. Në vijim ofrojmë një top në rreth dhe japim udhëzimet e lojës.


- Fëmija që pason topin, do t'i bëjë një pyetje shokut/shoqes që e pret atë.
- Ai/ajo përgjigjet, pason topin dhe bën pyetje për fëmijët e tjerë.
- Pyetjet duhet të jenë përvoja dhe shprehi personale të fëmijëve që lidhen me higjienën.

Pasi të jenë shprehur të gjithë fëmijët, edukatori/ja e vendos një fletë konstruktive të bardhë në këndin e artit dhe ndërton mbi të shkronjën "H" me shirita prej flete.

Hapi 1: Ndërtoni me fleta të bardha një "H" sipër fletës së madhe konstruktive.



Hapi 2: Fëmijët, me fluskatore të mbushura me ujë, sapun dhe ngjyra të ndryshme, bëjnë fluska sipër fletës së madhe, duke lënë gjurmë shumëngjyrëshe.



Hapi 3: Largoni fletëzat me të cilat keni formuar shkronjën "H" dhe do të përfitonit një vepër të këndshme arti me shkronjën që do të njihen fëmijët sot.

Punimi vendoset në këndin e ekspozimit. Fëmijët vëzhgojnë veprën e tyre artistike dhe kalojnë në punën në qendrat e aktivitetit.

Fëmijët ndahen në grupe pune. Njëri grup do të bashkojë produktet higjienike me shkronjën që takon; një grup do të plotësojë fletëzën e punës të shkronja H; një grup do të vizatojë me ngjyra pasteli me temë të lirë.

Në takimin përmbyllës diskutohet për të gjitha gjërat e mësuar, theksohet sërish rëndësia e higjienës, llojet dhe mënyrat e ruajtjes së saj.

Fëmijët shprehin përvojën e punës në grup, për artin e fluskave të sapunit me ngjyrë, për ndjesitë që kishin gjatë aktivitetit etj. Bëhet edhe një lojë për gjetjen e sa më shumë fjalëve që fillojnë me shkronjën "H". Përsëriten të gjitha aktivitetet që bëjnë sot, dhe në këtë mënyrë përmbyllim ditën me përshëndetje të ngrohta.

Vlerësimi:

Edukatori/ja vëzhgon pjesëmarrjen aktive të fëmijëve në diskutimet për higjienën personale, sa janë të gatshëm t'u adresojnë pyetje shokëve/shoqeve të grupit etj.

Më shumë për të bërë:

Fëmijët mund të argëtohen me lojëra edukative elektronike në linkun e mëposhtëm:

<http://pbskids.org/games/healthy-habits/>

Reflektimi:

Mikrobet gjithandej

Fusha kurrikulare:	Shkencat e natyrës
Kurrikula lëndore:	Njeriu dhe natyra
Tema nga plani dymujor:	Bimët, kafshët dhe njeriu
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):	I -3, 4, 5; II -3.4, 7; III -2, 3, 4, 6; IV -4; V -3, 5; VI - 6, 7
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):	Shkencat e natyrës: 1 Gjuhët dhe komunikimi: 1.1; 1.3; 1.7 Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti: 3.2
Rezultati i të nxënit të temës:	Tregon nevojat themelore jetësore të njeriut.
Rezultatet e të nxënit të aktiviteteve:	<ul style="list-style-type: none"> • Komenton mesazhin nga videoja e parë. • Eksperimenton me xhelin me xixa për të parë shpërndarjen e mikrobeve nëpërmjet prekjës.
Kriteret e suksesit:	<ul style="list-style-type: none"> • Komento mesazhin nga videoja e parë. • Eksperimento me xhelin me xixa për të parë shpërndarjen e mikrobeve.
Burimet dhe materialet:	Xhel i tejdukshëm për dezinfektimin e duarve, xixa, sapun për duar, video vetëdijesuese për mikrobet, poster për mënyrën e drejtë të larjes së duarve, xhama zmadhues.
Integrimi ndërfaqor:	Gjuhë shqipe, Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti.
Çështjet ndërkurrikulare:	Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.
Fjalë kyçe:	Mikrobe, dezinfektim, higjienë, mbrojtje, larje.
Organizimi i aktiviteteve:	<p>Edukatori/ja pret fëmijët që vijnë, duke tokur dorën me secilin prej tyre. Pasi mblidhen të gjithë, këndohet një këngë mirëseardhjeje dhe vazhdohet me leximin e kalendarit.</p> <p>Kujtohen bashkërisht aktivitetet e ditës së kaluar dhe fillohet diskutimi për higjienën personale, duke i pyetur fëmijët se çka ndodh nëse nuk e mbajmë atë si duhet. Cilat janë ato krijesa të padukshme që shkaktojnë dëme të mëdha në shëndetin tonë?</p> <p>Në këtë mënyrë, flitet për ekzistencën e trupave të dëmshëm mikroskopikë të quajtur MIKROBE.</p> <p>Për ta konkretizuar dhe për ta bërë sa më të qartë aktivitetin e ditës, edukatori/ja mund t'u tregojë fëmijëve një video vetëdijesuese për botën mikroskopike dhe ekzistencën e mikrobeve gjithandej.</p> <p>(Mund të përzgjidhet një video sipas dëshirës ose mund të përdoret ky link: https://youtu.be/JZjzQhFG6Ec etj.)</p>

Pas përfundimit të filmit të shkurtër, Edukatori/ja nxjerr informacion nga fëmijët, nxjerr mesazhin, shtron pyetje dhe nxit bashkëbisedimin rreth mikrobeve dhe ndikimit të tyre në organizmin e njeriut, rreth mënyrës se si shpërndahen gjithandej edhe pse nuk mund të shihen me sy. Nëse vetëdijesohemi dhe marrim njohuri, ne mund të mbrohemi në forma të ndryshme. Për ta konkretizuar shpërndarjen e mikrobeve, ftohen fëmijët tek këndi i shkencës për një eksperiment.

Te këndi i shkencës, edukatori/ja ka përgatitur materialet e nevojshme për eksperiment:

- xhel i tejudkshëm për dezinfektimin e duarve;
- xixa.

Ecuria:

- Edukatori/ja përzien xhelin dezinfektues me xixat dhe me të fërkon duart. Xheli avullon dhe xixat mbeten gjithandej nëpër duar.
- Ai/ajo u tregon fëmijëve se xixat paraqesin mikrobet që mbeten në duart tona. Mikrobet nuk shihen me sy, prandaj xixat ndihmojnë për të treguar si ndodh përhapja e tyre.
- Edukatori/ja tok me radhë duart me fëmijët dhe ata me njëri-tjetrin. Ai/ajo prek me duar një laps, pastaj një gomë, tavolinën etj. Në të gjitha gjërat që preken do të mbeten gjurmët e xixave - mikrobeve.
- Fëmijët mund të përdorin xhama zmadhues për të vëzhguar gjurmët e edukatorit/es.
- Pasi vëzhgojnë të gjitha gjurmët, ata i provojnë xixat në duart e tyre, tokin duart me njëri-tjetrin dhe shohin se çfarë ndodh më tej.

Në fund të aktivitetit ftohen fëmijët në rreth dhe demonstron mënyra efektive e larjes së duarve duke bërë sikur (gjoja) (Edukatori/ja vepron dhe fëmijët imitojnë). Pas këtij ushtrimi, fëmijët shkojnë me radhë për të larë duart si duhet. (Mund të vendoset një tabelë për larjen e drejtë të duarve, pranë lavamanit.)

Pasi lajnë duart, fëmijët do të ndahen në grupe në tri qendra të aktiviteteve:

Njëri grup do të plotësojë fletëzën e punës për higjienën.

Grupi tjetër do të presë nga gazeta imazhet me produktet higjienike dhe do të përpiqet t'i emërtojë ato.

Grupi i tretë do të ndërlidhë numrin dhe sasinë e tij nga materialet e ofruara.

Në takimin përmbyllës përsëriten aktivitetet që u bënë gjatë ditës dhe u kërkohet fëmijëve që të komunikojnë edhe me anëtarët e familjes mbi rëndësinë e larjes së duarve.

Vlerësimi:

Fëmijët vlerësohen në bazë të informacionit që edukatori/ja nxjerr prej tyre pas shikimit të filmit vetëdijesues për mikrobet dhe për rezultatet gjatë aktiviteteve.

Më shumë për të bërë:

Fëmijëve mund t'u ofrohen lojëra edukative për higjienën personale dhe luftimin e mikrobeve në linkun e mëposhtëm:

<https://www.brainpop.com/games/mobpersonalhygiene/>

Reflektimi:

Higjiena e gojës

Fusha kurrikulare:	Gjuhët dhe komunikimi
Kurrikula lëndore:	Gjuhë shqipe
Tema nga plani dymujor:	Tregime, përralla, përrallëza, gjëegjëza, poezi
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):	I-3, 5; II-3, 7; III-2, 3, 6; V-5; VI-6
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):	Gjuhët dhe komunikimi: 1.1; 1.2; 1.4 Jeta dhe puna: 2.8.1 Matematikë: 5.1
Rezultati i të nxënit të temës:	Flasin, parafrazojnë, ritregojnë dhe recitojnë.
Rezultatet e të nxënit të aktiviteteve:	<ul style="list-style-type: none"> • Dëgjon këshillat e dentistit/es për rëndësinë e higjienës së gojës. • Ritregon mesazhin e vjershës "Dhëmbët e mi". • Lidh numrin e dëgjuar me atë të shkruar në lojën me kub, duke vendosur dhëmbët prej plasteline në vendin e duhur.
Kriteret e suksesit:	<ul style="list-style-type: none"> • Dëgjo këshillat e dentistit/es për rëndësinë e higjienës së gojës. • Ritrego me fjalët e tua mesazhin e vjershës. "Dhëmbët e mi". • Lidh numrin e dëgjuar me atë të shkruar në lojën me kub, duke vendosur dhëmbët prej plasteline në vendin e duhur.
Burimet dhe materialet:	Fletë A4 ngjyrë rozë, gërshërë, lapsa, plastelinë, kub me numra, top i ndërtuar me letër, brenda të cilit gjendet një dhëmb lodër (ose foto dhëmbi).
Integrimi ndërfaqor:	Shkathtësi për jetë, Matematikë.
Çështjet ndërkurrikulare:	Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.
Fjalë kyçe:	Higjiena e gojës, dhëmbë, dentist, karies.
Organizimi i aktiviteteve:	<p>Edukatori/ja jep udhëzimet për krijimin e kaushëve prej letre. Secili fëmijë bën kaushin e tij prej letre dhe ulet në rreth për takimin e përbashkët (fëmijëve që kanë vështirësi u ofrohet ndihmë).</p> <p>Numërohen sa fëmijë janë në grup dhe pas kalendarit fillon loja në rreth.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Secili fëmijë mban pranë tij kaushin prej letre. • Edukatori/ja mban një top të vogël në dorë, të cilin ia kalon fëmijës që ka në anën e tij/saj të djathtë duke ia futur në kaush. • Fëmija që ka topin në kaush, duhet të ndajë me grupin një përvojë nga dita e kaluar. • Kështu vazhdon radha derisa topi të përfundojë në kaushin e edukatorit/es. <p>Edukatori/ja hap topin nga letra dhe përpara fëmijëve shfaqet dhëmbi (ose fotografia e dhëmbit). Kështu fillon rrjedhshëm diskutimi për temën ditore.</p>

Për t'i vetëdijesuar fëmijët për rëndësinë e higjienës së gojës dhe për dëmet që i shkaktohen shëndetit nëse ajo nuk mbahet si duhet, ftohet një dentist/e në klasën përgatitore (ai/ajo mund të jetë një prind me profesionin e dentistit ose dentisti i shkollës).

Për pritjen e të ftuarit mendoni ndonjë mënyrë argëtuese që i ndihmon fëmijët të krijojnë pozitivitet për të. (Në klasë mund të vihet muzikë, mund të duartrokitet, të thuhet përshëndetje mirëseardhjeje, ndërsa të ftuarit mund t'i jepni të mbajë në duar një lodër pelushi dhe një brushë dhëmbësh, për të krijuar raporte shoqërore me fëmijët.)

Gjatë demonstrimit të mënyrës së duhur të larjes së dhëmbëve, edukatori/ja mund të përdorë vargjet e vjershës së dhënë.

"Dhëmbët e mi"

*Në mëngjes dhe në mbrëmje
Brushën unë marr në dorë,
Sipër pastën unë ia hedh
Dhe me të dhëmbët fërkoj.
Fëshk e fëshk, lart e poshtë,
Majtas, djathtas rrotulloj
Si nga jashtë dhe nga mbrenda
Dhëmbët fort unë fërkoj.
Gojë të pastër kam tani
Shkëlqejnë bukur dhëmbët e mi.*

Vargjet mund të përsëriten disa herë, më pas kalohet në punë individuale "Loja e dhëmbëve me kub".


Materialet:

Fletëza nga libri i fëmijës, plastelinë e bardhë dhe kub me numra.

Ecuria:

- Fëmija do të marrë fletëzen e punës, plastelinën dhe kubin me numra.
- Fëmija hedh zarin dhe aq sa është numri i pikave në zar, aq dhëmbë do të mbushë me plastelinë.
- Veprimtaria vazhdon derisa të mbushen të gjitha hapësirat e dhëmbëve.

Kur të kenë përfunduar të gjithë fëmijët bëhet takimi përmbyllës, ku përsëriten këshillat e dentistit, vjersha dhe merret informacion nga fëmijët për përvojën e ditës së sotme.



Vlerësimi:

Fëmijët vlerësohen në bazë të lojës me kub, për aftësinë e lidhjes së numrit të parë me atë të shkruar.

Më shumë për të bërë:

Mund të kërkoni nga dentisti/ja të bëjë një kontroll sipërfaqësor të dhëmbëve të fëmijëve dhe t'u shkruajë një rekomandim për vizitë atyre që kanë nevojë për kontroll mjekësor. Rekomandimi duhet të jetë joformal, si formë ftese, dhe t'u dërgohet prindërve.

Po ashtu, ju mund ta përdorni tabelën javore për përforcimin e shprehive të larjes së dhëmbëve në shtëpi.

Reflektimi:

Teshtima

Fusha kurrikulare:	Shoqëria dhe mjedisi
Kurrikula lëndore:	Shoqëria dhe mjedisi
Tema nga plani dymujor:	Përgjegjësitë e mia
Rezultatet e të nxëniet për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):	I -3, 5; II -1, 2, 3, 4, 7; III -1, 2, 3, 4, 6; IV -4; V -5; VI -6, 7
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):	Shoqëria dhe mjedisi: 3.3.2 Gjuhët dhe komunikimi: 1.1; 1.4; 1.5 Matematika: 6.2
Rezultati i të nxëniet të temës:	Tregon për fjalët, sjelljet dhe veprimet e veta në raport me të tjerët dhe mban përgjegjësi për to.
Rezultatet e të nxëniet të aktiviteteteve:	<ul style="list-style-type: none"> • Eksperimenton mënyrën e shpërndarjes së mikrobeve në ajër me shembullin e teshtimës. • Ndërton histori në bazë të fotografive dhe e komenton para grupit. • Rendit figurat e mikrobeve në bazë të madhësisë.
Kriteret e suksesit:	<ul style="list-style-type: none"> • Eksperimento mënyrën e shpërndarjes së mikrobeve në ajër me shembullin e teshtimës. • Ndërto histori në bazë të fotografive dhe komentoje atë para grupit. • Rendit figurat e mikrobeve në bazë të madhësisë.
Burimet dhe materialet:	Fotografi të ndryshme të prera nga gazetatat, top, shishe me spërkatëse, fletë A4, ujë, ngjyrë, libri i fëmijës.
Integrimi ndërfaqshor:	Gjuhë shqipe, Matematikë.
Çështjet ndërkurrikulare:	Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.
Fjalë kyçe:	Teshtimë, mikrob, përhapje mikrobesh, virus, vend publik.
Organizimi i aktiviteteteve:	<p>Fëmijët mblidhen në takimin e përbashkët ku këndojnë një këngë mirëseardhjeje dhe pas leximit të kalendarit të gjithë bashkohen në lojë.</p> <p>Edukatori/ja mban në dorë një lodër, të cilën e quan “mikrob” (mund të jetë një lodër çfarëdo) dhe jep udhëzimet.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Edukatori/ja kthehet me shpinë (nuk shikon nga fëmijët) dhe thotë: Hidhe mikrobin, hidhe mikrobin, hidhe mikrobin... NDAL! (Edukatori/ja përshpejton dhe ngadalëson ritmin e dhënies së udhëzimeve në mënyrë që fëmijët të mos dinë me saktësi se kur ai/ajo do të thotë NDAL). • Gjatë kësaj kohe fëmijët pasojnë “mikrobin” nga njëri te tjetri në rreth. • Kur thuhet NDAL, fëmijët ndalojnë dhe “mikrobi” mbetet në dorën e njërit prej tyre, i cili largohet nga rrethi.

- Fëmija që largohet nga rrethi, i afrohet edukatorit/es dhe e ndihmon atë gjatë dhënies së udhëzimeve.
- Loja vazhdon derisa të mbetet vetëm një fëmijë.

(Ky aktivitet është i modifikuar nga modeli origjinal i lojës "Hot potato", të cilën mund ta gjeni në linkun: <https://youtu.be/qdtTjdQ0NoQ>

Pas përfundimit të lojës, edukatori/ja vendos një maskë në gojë për mbrojtjen nga mikrobet dhe u drejtohet fëmijëve duke i pyetur nëse e dinë pse vendoset një maskë e tillë, për çfarë na shërben, kush e vendos etj.

Flasim me fëmijët për shpërndarjen e mikrobeve në ajër, si pasojë e të cilave marrim viruse të ndryshme dhe sëmuremi. Ku dhe kur jemi të rrezikuar prej tyre; diskutojmë për vendet publike, cilat mund të jenë ato; periudhat e vitit, në të cilat jemi të rrezikuar; çfarë ndodh kur ftohemi dhe jemi me virus etj.

Edukatori/ja bën gjoja se teshtin me të madhe dhe pyet fëmijët: *A e dini se çfarë ndodh kur ne teshtijmë?*

Për të demonstruar në mënyrë konkrete pasojat e teshtimës, edukatori/ja:

- Merr një shishe spërkatëse, të cilën e mbush me ujë dhe pak ngjyrë (çfarëdolloj ngjyre).
- Vizaton një portret njeriu në një fletë të bardhë.
- Bën sikur teshtin dhe spërkat me ujin me ngjyrë portretin e vizatuar që ka përballë.
- Për çdo teshtimë dhe spërkatje, fëmijët shohin gjurmët që paraqiten në portret.
- Në fund, edukatori/ja demonstroi se si mund të teshtijmë në mënyrë të sigurt.

Pas këtij demonstrimi fëmijëve u ofrohen fotografi të prera nga revistat, ku paraqiten pamje të ndryshme të vendeve publike, të vendeve me shumë njerëz, të spitaleve, të personave të sëmurë, të ilaçeve, të mikrobeve etj.

Fëmijët përzgjedhin disa nga fotografitë dhe krijojnë histori me to. Ata e paraqesin historinë e tyre në bazë të fotografive para grupit.

Në vijim, fëmijët kalojnë në punën individuale në librin e punës për fëmijë, në të cilin presin llojet e mikrobeve dhe i rendisin sipas madhësisë, duke ndjekur modelin e dhënë.

Dita përmbyllet atëherë kur të gjithë së bashku përsëritin udhëzimet se si mbahen duart gjatë teshtitjes, duke mbrojtur të tjerët dhe veten. Fëmijët janë të lirë të japin propozimet dhe idetë e tyre.

Vlerësimi:

Fëmijët vëzhgohen përgjatë zhvillimit të aktiviteteve dhe sipas nevojës edukatori/ja mban shënime narrative.

Më shumë për të bërë:

Ju mund të vendosni një kuti me peceta letre dezinfektuese në një kënd të klasës suaj (lehtësisht të arritshëm nga fëmijët), me një shënim për përdorimin e tyre në mbrojtje të shokëve dhe shoqeve të klasës nga shpërndarja e mikrobeve.



Reflektimi:

Mikrobet n'kërcim

Fusha kurrikulare:	Artet
Kurrikula lëndore:	Edukatë muzikore
Tema nga plani dymujor:	Lojërat muzikore
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):	I -3, 5; III -2, 3, 6; V -2, 5; VI -3, 6
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):	Artet: 1 Gjuhët dhe komunikimi: 1.1; 1.2; 1.4 Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti: 1
Rezultati i të nxënit të temës:	Luan lojëra të ndryshme ku sinkretizohet fjala, muzika, mimika, lëvizja, ana vizuale etj. (tematika e lojërave përshtatet me tematikat e lojërave të tjera mësimore në klasë).
Rezultatet e të nxënit të aktiviteteve:	<ul style="list-style-type: none"> • Krijon fjalorin e fjalëve të panjohura. • Vizaton lloje të ndryshme të mikrobeve duke u frymëzuar nga muzika e dëgjuar në aktivitetin e bashkimit të pikave në fletë. • Lëviz sipas udhëzimeve të edukatorit/es, duke ndjekur ritmin e muzikës.
Kriteret e suksesit:	<ul style="list-style-type: none"> • Krijoi fjalorin e fjalëve të panjohura. • Vizato lloje të ndryshme të mikrobeve duke u frymëzuar nga muzika e dëgjuar në aktivitetin e bashkimit të pikave në fletë. • Lëviz sipas udhëzimeve të edukatorit/es, duke ndjekur ritmin e muzikës.
Burimet dhe materialet:	Fletë të bardha A4, lapsa, ngjyra dylli, një fjalor, kapëse fletësh, fotografi që paraqesin forma të ndryshme mikrobesh.
Integrimi ndërfaqor:	Gjuhë shqipe, Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti.
Çështjet ndërkurrikulare:	Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.
Fjalë kyçe:	Mikrob, lloj, fjalorth, fjalë të panjohura, kërcim, udhëzim.
Organizimi i aktiviteteve:	<p>Në takimin e përbashkët, lexohet kalendari dhe secili nga fëmijët ndan me grupin nga një përshtypje të ditës së kaluar, pastaj të gjithë ngrihen në këmbë për të zhvilluar një aktivitet lëvizor.</p> <p>Edukatori/ja vë muzikë dhe jep udhëzimet që fëmijët të ndjekin lëvizjet që ai/ajo bën, të cilat mund të jenë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Ngrini duart lart dhe shkundini. • Nga lartë-poshtë, prekni majat e gishtave të këmbëve disa herë. • Vendosni duart në bel dhe bëni lëvizje harkore. <p>Ndalon muzika dhe të gjithë përqendrohen te frymëmarrja çlodhëse për një minutë. (Edukatori/ja mat kohën.)</p>

Në vijim, fëmijët ulen në rreth, ku diskutohet për të gjitha temat e trajtuara për higjienën gjatë javës. Edukatori/ja mban një top në dorë, të cilin ua pason fëmijëve me radhë, duke u shtruar pyetje të ndryshme dhe duke i nxitur për të diskutuar.

Gjatë kësaj përsëritjeje do të vëreni që fëmijët kanë mësuar fjalë të reja që kanë të bëjnë me higjienën, shëndetin dhe kujdesin. Ky fakt u bëhet i ditur edhe atyre dhe u shpjegohet se çfarë mund të krijohet me fjalët e reja: “Qenkemi pasuruar me fjalë të reja, të cilat dikur ishin fjalë të panjohura për ne”; “A e dini që ka një libër, i cili është i mbushur vetëm me fjalë dhe për secilën ka shpjegime? Ky quhet fjalor”. (Mund të sillni një fjalor në klasën tuaj përgatitore.)

Pasi fëmijët njihen me fjalorin, edukatori/ja pyet se cilat ishin fjalët e panjohura që u mësuan gjatë javës dhe i shkruan ato. Përgëzohen fëmijët për pasurimin e fjalorit dhe drejtohen për te këndi i shkencës, ku edukatori/ja ka sjellë fotografi të mikrobeve të llojeve të ndryshme. Ata udhëzohen të analizojnë llojet e mikrobeve dhe pas disa minutave vëzhgimi, ulen për punë individuale.

Edukatori/ja vë muzikë klasike në klasë dhe udhëzon fëmijët që për disa sekonda të mbyllin sytë dhe ta shijojnë atë që po dëgjojnë. Pastaj, me laps, ata bëjnë pika në fletën që kanë pranë (A4) duke ndjekur ritmin e muzikës. Pasi të ketë mjaftueshëm pika në fletë, fëmijët udhëzohen të ndalojnë dhe të bëjnë bashkimin e pikave, duke vizatuar secili nga një figurë mikrobi të madh.

Për ngjyrosje, fëmijëve u ofrohen 4 ngjyra dylli: e kuqe, e gjelbër, e kaltër dhe vjollcë. (Vetëm katër lloje ngjyrash, në mënyrë që të dalin katër grupe mikrobesh me të njëjtën ngjyrë.) Çdo fëmijë zgjedh ngjyrën që i pëlqen.

Secili fëmijë e pret mikrobin që ka vizatuar dhe e ngjit atë me kapëse në bluzën e vet për të zhvilluar lojën:

“Mikrobet n’kërcim”

(Fëmijët mund të luajnë jashtë ose, në pamundësi, edhe brenda klasës.)

- Edukatori/ja bën një vizë të gjatë në dysheme (jashtë klase mund të vizatoni një vizë me shkumës, kurse brenda saj mund të bëni një vizë me shirit ngjites).
- Fëmijët qëndrojnë në vizë, të gatshëm për të marrë udhëzimet e lojës.
- Ata udhëzohen të jenë të vëmendshëm, sepse ndjekja e udhëzimeve është kriteri kryesor i lojës.
- Kur fillon muzika, edukatori/ja jep udhëzime për lëvizje (orientim).
- Mikrobet e kuqe kërcenë tre hapa para, NDAL! (Fëmijët ndalojnë aty ku janë.)
- Mikrobet ngjyrë vjollcë: pesë kërcime duke tundur duart lart.
- Mikrobet e gjelbra: tri kërcime para me një këmbë.
- Mikrobet e kuqe: dy hapa prapa etj.
- Të gjitha këto kërcime bëhen duke ndjekur ritmin e muzikës në sfond.

Në përfundim të aktivitetit i ftojmë fëmijët të formojnë grupet e mikrobeve të tyre, sipas ngjyrave dhe ulemi të pushojmë duke vazhduar pastaj me takimin përmbyllës.

Fëmijët na japin informata kthyesë për aktivitetet e sotme, si janë ndier, ku kishin vështirësi, çka do të donin të ndryshonin, cila ishte pjesa më e bukur, çka mësuam sot etj.

Bashkërisht këndohet kënga përshëndetëse dhe përmbyllet dita.

Vlerësimi: Fëmijët vëzhgohen përgjatë zhvillimit të aktiviteteve, mbahen shënime anekdotike sipas rasteve.

Te loja "Mikrobet n'kërcim", edukatori/ja vëzhgon ndjekjen e udhëzimeve për lëvizje, ndjekjen e ritmit muzikor nga fëmijët.

Më shumë për të bërë: <https://www.youtube.com/watch?v=Rb0UmrCXxVA>

Reflektimi: _____

Si të jemi të shëndetshëm

Fusha kurrikulare:	Matematikë
Kurrikula lëndore:	Matematikë
Tema nga plani dymujor:	Puna me të dhëna
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):	I -3, 5; II -1, 2, 7; III -2, 3, 4, 6; IV -2, 3, 6; V -1, 2, 5, 7; VI -3, 6
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):	Matematikë: 6.2 Gjuhët dhe komunikimi: 1.1; 1.4 Artet: 1
Rezultati i të nxënit të temës:	Vendos të dhëna të thjeshta me vizatime të grumbulluara nga jeta e përditshme.
Rezultatet e të nxënit të aktiviteteve:	<ul style="list-style-type: none"> • Diskuton për shprehitë që duhen zhvilluar për të qenë i shëndetshëm. • Vendos objektet sipas nënndarjeve në tabelën e vendosur në rreth. • Dramatizon situata, të cilat kanë të bëjnë me jetesën e shëndetshme.
Kriteret e suksesit:	<ul style="list-style-type: none"> • Diskuto për shprehitë që duhen zhvilluar për të qenë i shëndetshëm. • Vendos objektet sipas nënndarjeve në tabelën e vendosur në rreth. • Dramatizo situata, të cilat kanë të bëjnë me jetesën e shëndetshme.
Burimet dhe materialet:	Brushë dhëmbësh, pastë, peshqir, sapun, jastëk, kokore dhe mbrojtëse të gjunjëve për fëmijë, litar kërcimi, shami xhepi, shishe uji, fruta, perime, kuti të drithërave, shishe qumështi, kosi, top, fletë e madhe A0, CD, radio, libri i fëmijës, ngjitës, revista, gërshërë.
Integrimi ndërfaqor:	Gjuhë shqipe, Edukatë muzikore.
Çështjet ndërkurrikulare:	Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.
Fjalë kyçe:	Shëndet, ruajtje e shëndetit, ushqim i shëndetshëm, pushim, aktivitete fizik, pastërti, kujdes, siguri.
Organizimi i aktiviteteve:	<p>Takimi i përbashkët fillon me përshëndetjen dhe kalendarin.</p> <p>Më pas bëhet një përsëritje e aktiviteteve të zhvilluara javën e kaluar.</p> <p>Edukatori/ja krijon një mjedis të përshtatshëm, që fëmijët të diskutojnë lirshëm lidhur me rëndësinë e të qenit i pastër dhe çfarë duhet bërë për ta mbajtur pastërtinë. Për të parë nëse fëmijët vërtet e kanë kuptuar se sa e rëndësishme është pastërtia për shëndetin e tyre, edukatori/ja shtron pyetje për mënyrën si ata i kanë praktikuar shkathtësitë e tyre të reja gjatë ditëve të pushimit. Diskutimi zhvillohet në mënyrë të atillë që secili fëmijë të marrë fjalën.</p> <p>Në vijim, edukatori/ja sjell përpara fëmijëve një shportë të mbuluar brenda së cilës ka: brushë për dhëmbët, pastë, peshqir, sapun, jastëk, kokore dhe mbrojtëse të gjunjëve për fëmijë, litar kërcimi, shami xhepi,</p>

shishe uji, fruta, perime, kuti, shishe qumështi, jogurt, top etj. Sillen aq materiale, sa ka dhe fëmijë (në mënyrë që secili të ketë nga një element në dorë).

Pasi fëmijët marrin objektin e përzgjedhur fshehtas, edukatori/ja diskuton për mënyrën se si gjërat që mbajmë në duar na ndihmojnë të jemi të shëndetshëm. Fëmijët përmes diskutimit inkurajohen të zgjerojnë më tepër të dhënat rreth përzgjedhjes në mënyrë të rastësishme.

Edukatori/ja i nxit fëmijët drejt rëndësisë që ka fitimi i shprehive për jetë të shëndetshme.

Pas diskutimit luhet loja “Në rreth lodrojmë”:

Udhëzimet e lojës: Edukatori/ja vë muzikë dhe të gjithë fëmijët lëvizin dhe kërcëjnë të lirë në rreth. Më pas, ai/ajo ndalon muzikën dhe i thërret të gjithë të grupohen. P.sh.: grupohuni sipas funksioneve të objekteve që mbani në duar; grupohuni sipas ngjyrave të objekteve; sipas formave të objekteve që mbani në duar etj. (Edukatori/ja mund të japë edhe ndonjë udhëzim shtesë deri sa të verifikojë që fëmijët e kanë kuptuar, p.sh., se çfarë do të thotë fjala *funksion* etj.) Edhe fëmijët mund të japin ndonjë ide për grupimin. Loja përfundon pas disa raundeve.

Pas përfundimit të lojës, edukatori/ja fton fëmijët që përsëri të afrohen në rreth dhe në mes të rrethit sjell një fletë të bardhë me pesë ndarje të përgatitura paraprakisht:

HIGJIENA	USHQIMI	SPORTI	PUSHIMI	SIGURIA

Fëmijët, në mënyrë të pavarur, tregojnë se në cilën hapësirë duhet të vendoset objekti që ata kishin në dorë, pse ai i ndihmon për ruajtjen e shëndetit dhe pse është i rëndësishëm.

Pasi të vendosen të gjitha objektet në rubrikat përkatëse, fëmijët mund t'i numërojnë, të diskutojnë për to apo edhe të shpërndahen në klasë, duke kërkuar për objektet të tjera që bëjnë pjesë në secilin grupim.

Fëmijët ndahen në grupe për lojëra dramatike me temë ruajtjen e shëndetit, ndërkohë që edukatori/ja i inkurajon që të përdorin njërin nga 5 fushat që ndihmojnë ruajtjen e shëndetit.

Në takimin përmbyllës diskutohet puna e bërë gjatë ditës dhe edukatori/ja shpërndan fletëzat nga libri i fëmijës, në të cilat ata përcjellin shprehitë e tyre për shëndet të mirë gjatë tërë javës.

Vlerësimi:

Edukatori/ja i vlerëson në mënyrë joformale aftësitë e fëmijëve, duke i inkurajuar që të shprehen përgjatë aktiviteteve.

Më shumë për të bërë:

Ju mund të përdorni edhe revista, prej të cilave fëmijët mund të presin dhe ngjitin fotografi që kanë të bëjnë me shprehitë e të qenit të shëndetshëm.

Reflektimi:

Sporti i sigurt

Fusha kurrikulare:	Gjuhët dhe komunikimi
Kurrikula lëndore:	Gjuha shqipe
Tema nga plani dymujor:	Tinguj, shkronja, rrokje, fjalë, fjali
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):	I -3, 5; II -1, 2, 7; III -2, 3, 4, 6; IV -2, 3, 6; V -1, 2, 3, 7; VI -3, 6
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):	Gjuhët dhe komunikimi: 1.1; 1.2; 1.4 Artet: 1 Matematikë: 3.1
Rezultati i të nxënit të temës:	Shqiptojnë drejt tingujt (zanore, bashkëtingëllore) gjatë të shprehurit.
Rezultatet e të nxënit të aktiviteteve:	<ul style="list-style-type: none"> • Njeh rekuizitat përkatëse për sporte të caktuara. • Bisedon për masat mbrojtëse dhe mbrojtjen nga lëndimet sportive. • Modelon shkronjën S me materialet e ofruara.
Kriteret e suksesit:	<ul style="list-style-type: none"> • Dallo rekuizitat përkatëse për sporte të caktuara. • Bisedo për masat mbrojtëse dhe mbrojtjen nga lëndimet sportive. • Modelo shkronjën S me materiale të ndryshme.
Burimet dhe materialet:	Kaskë dhe mbrojtëse të gjunjëve për fëmijë, rekuizita të ndryshme sportive sipas mundësive: topa futbollit, basketbolli, tenisi, pingpongu; syze uji, pajisje për ski, litar kërcimi dhe pajisje të tjera sportive sipas mundësive; libri i fëmijës, revista të ndryshme, ngjites, gërshtë, penj, kapëse letrash.
Integrimi ndërfaqor:	Edukimi figurativ, Matematikë.
Çështjet ndërkurrikulare:	Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.
Fjalë kyçe:	Sporte (futboll, basketboll, volejball, hendboll, xhudo, karate, tenis, shah, alpinizëm) siguri, tingulli S, shkronja S.
Organizimi i aktiviteteve:	<p>Dita fillon me përshëndetjet dhe atmosferën sportive. Edukatori/ja në rreth i mundëson çdo fëmije që të marrë fjalën dhe të tregojë se çfarë ka zbuluar nga prindërit e tij/saj për sportin. Ai/ajo inkurajon fëmijët të flasin, duke i nxitur me pyetje përkatësisht.</p> <p>Për nxitje, edukatori/ja sjell në rreth të gjitha rekuizitat sportive dhe kërkon nga fëmijët që të gjithë së bashku të imitojnë lëvizje të ndryshme sportive, karakteristike për sportet e caktuara. Pasi fëmijët qetësohen, edukatori/ja ndërton bisedën duke i nxitur fëmijët të mendojnë për rregullat e sigurisë. Ai/ajo thotë se duhet pasur parasysh që gjatë aktiviteteve fizike dhe sportive, mbrojtja nga lëndimi është shumë e rëndësishme.</p>

Në vijim, të gjithë së bashku përpiqen të ndërtojnë një tregim lidhur me sportet. Secili fëmijë vazhdon fjalën e tjetrit, p.sh.: edukatori/ja fillon: "Ishte një skuadër..." fëmija në radhë vazhdon: "Ishte një skuadër, që luante futboll..."; fëmija tjetër vazhdon: "Ishte një skuadër, që luante futboll, por një ditë..." e kështu me radhë. Tregimi vazhdon derisa të gjithë fëmijët flasin dhe radha vjen përsëri tek edukatori/ja.

Pas përfundimit të tregimit nxirret një ide e përgjithshme rreth tij e më pas edukatori/ja njofton fëmijët për shkronjën S dhe u kërkon të modelojnë me gisht në dorën e tyre modelin e shkronjës S. Edukatori/ja inkurajon fëmijët të gjejnë fjalë me shkronjën S: sporti, siguri, ski etj.

Aktivitetet vazhdojnë me punë në grupe të vogla:

Në njërin kënd, fëmijët do të ndërtojnë një libër me sporte të ndryshme: ata kërkojnë për fotografi të sporteve të ndryshme, rekuizita, terrene sportive, vizatojnë sporte të ndryshme etj.

Në këndin tjetër, në tabelën magnetike me shkronja të mëdha të shtypit, fëmijët do të përshkruajnë fjalën S P O R T I. (Fëmijët, të cilët janë të gatshëm mund edhe t'i modelojnë ato.)

Në këndin tjetër, fëmijët do të plotësojnë individualisht librin e punës te faqja e shkronjës S.

Në këndin tjetër, fëmijët mund të luajnë në lojëra konstruktive.

Grupet ndërrohen në formë rrotacioni sipas përzgjedhjes individuale. Në takimin përmyllës bisedohet sërish për masat e sigurisë që duhet të ndërmerren gjatë pjesëmarrjes në sporte të ndryshme, pajisjet që duhet të përdoren etj. Rishikohen dhe komentohen librat e ndërtuar nga grupet e fëmijëve, ku secili grup prezanton punën e tij, si dhe rikujtohet shkronja S dhe mënyra e ndërtimit të saj.

Vlerësimi: Përmes planit të vlerësimit, edukatori/ja vlerëson fëmijët gjatë veprimtarisë grupe dhe punës individuale të fëmijës.

Më shumë për të bërë: Ju mund të vizitoni ndonjë dyqan të veshjeve sportive apo ndonjë klub të afërt sportiv, për t'u njohur më mirë me sportet e ndryshme dhe tërësinë e mjeteve mbrojtëse.

Reflektimi: _____

Sporti më jep shëndet

Fusha kurrikulare:	Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti
Kurrikula lëndore:	Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti
Tema nga plani dymujor:	Kujdesi dhe siguria për veten dhe të tjerët
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):	I -3, 5; II -1, 4; III -1, 2, 3, 4; IV -3, 4, 5, 6; V -1, 2, 5, 7; VI -3, 6
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):	Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti: 1 Gjuhët dhe komunikimi: 1.1; 1.4 Matematikë: 3.1
Rezultati i të nxënit të temës:	Njih dhe respekton udhëzimet për përdorimin e mjeteve, rekuizitave dhe pajisjeve të ndryshme.
Rezultatet e të nxënit të aktiviteteve:	<ul style="list-style-type: none"> • Diskuton në grup për sportet që njih. • Bashkëpunon me anëtarët e skuadrës për të gjetur objektet e fshehura. • Luan në ekip së bashku me shokët dhe shoqet në sportin e zgjedhur.
Kriteret e suksesit:	<ul style="list-style-type: none"> • Diskuto në grup për sportet që njih. • Bashkëpunon me shokët/shoqet për të gjetur objektet e fshehura. • Luaj në ekip së bashku me shokët dhe shoqet në sportin e zgjedhur.
Burimet dhe materialet:	Topa të ndryshëm sipas mundësive (futbolli, basketbolli, tenisi, pingpongu); rekuizita të ndryshme sportive, si: syze uji, pajisje për ski, litar kërcimi dhe pajisje tjera sportive, sipas mundësive.
Integrimi ndërfaqor:	Gjuhë shqipe, Matematikë.
Çështjet ndërkurrikulare:	Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.
Fjalë kyçe:	Sport, aktivitet fizik, lloj sporti, futboll, basketboll, hendboll, volejboll, atletikë, tenis dhe sporte të tjera që fëmijët mund të dinë.
Organizimi i aktiviteteve:	<p>Përpara se fëmijët të vijnë në klasë, edukatori/ja ka fshehur nëpër të mjetet sportive (shih burimet dhe materialet) me qëllim zhvillimin e aktivitetit. Po ashtu, do të ishte e pëlqyeshme që ai/ajo të vishej sot me rroba sportive dhe të ketë një pamje prej sportisti/eje, dhe pritja e fëmijëve të bëhet më e ndryshme se ditët e tjera.</p> <p>Në përshëndetjen e ditës, edukatori/ja kërkon nga fëmijët që të përshëndesin shoqet dhe shokët e grupit me ndonjë përshëndetje sportive që mund të njohin (një kalim duarsh të të gjithë, përshëndetje karateje etj.) Fëmijët që nuk kanë ndonjë informacion paraprak mbi përshëndetjet sportive, mund të përshëndesin të tjerët me një veprim sportiv apo sipas dëshirës së tyre.</p> <p>Pas kalendarit, edukatori/ja dhe fëmijët luajnë një lojë në rreth, ku fëmijët imitojnë veprime të sporteve të ndryshme: gjuajnë topin me këmbë, hedhin topin me dy duar në kosh, gjuajnë topin me raketën e tenisit, notojnë në ujë, ngjitin shkëmbinj të etj. Edukatori/ja fton fëmijët që të japin ide mbi veprime të ndryshme sportive.</p>



Më pas, edukatori/ja u kërkon fëmijëve të ndahen në katër skuadra dhe të hulumtojnë nëpër klasë të gjitha gjërat që lidhen me sportin. Pasi përfundojnë hulumtimin, të gjitha skuadrat/fëmijët ulen në rreth dhe ekspozojnë rekuizitat e gjetura.

Edukatori/ja kërkon nga fëmijët që të japin më shumë të dhëna rreth rekuizitave që kanë gjetur: *Në cilin sport përdoren? Çfarë rregullash ka ky sport? Cili sport ju pëlqen? Pse është i nevojshëm sporti? Etj.*

Pas bashkëbisedimit, edukatori/ja kërkon nga fëmijët që në rreth të vendosin vetëm foto/rekuizitat e sporteve ku kërkohen nga dy lojtarë. Kështu, gradualisht, edukatori/ja njofton fëmijët me konceptin e numrit 2.

Edukatori/ja thekson rolin dhe rëndësinë e shëndetit për trupin e njeriut; fëmijët ndahen në grupe dhe zhvillojnë lojëra të ndryshme sportive sipas dëshirës së grupit. Ai/ajo duhet të inkurajojë zgjedhjen e lirë të grupit. (Rekomandohet që aktivitetet sportive të zhvillohen jashtë klasës përgatitore.)

Në takimin përmbyllës, edukatori/ja i nxit fëmijët që të diskutojnë për aktivitetet e ditës dhe i porosin ata që së bashku me prindërit të hulumtojnë edhe më shumë të dhëna për sportet e ndryshme dhe rëndësinë e tyre për shëndetin e njeriut.

Vlerësimi:

Edukatori/ja vëzhgon punën në skuadër, ndërveprimin e fëmijëve me njëri-tjetrin për të gjetur rekuizitat e fshehura. Gjithashtu, mund të mbajë shënime për ndonjë fëmijë në veçanti apo për disa prej tyre.

Më shumë për të bërë:

Për të plotësuar rekuizitat mund të kërkonin ndihmën e prindërve ose të anëtarëve të komunitetit.

Mund të ftoni ndonjë prind që merret me sport, për të diskutuar apo për të demonstruar shkathtësitë e ndryshme sportive.

Plotësimi i modeleve në librin e fëmijës të fusha e edukatës fizike mund të jetë një tjetër mundësi.

Reflektimi:

Siguria në lojë

Fusha kurrikulare:	Jeta dhe puna
Kurrikula lëndore:	Shkathësi për jetë
Tema nga plani dymujor:	Mjedisi shtëpiak, kopshti dhe shkolla
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):	I -3, 5; II -1, 4; III -7; IV -3, 6; V -1, 2, 5, 7; VI -3, 6
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):	Jeta dhe puna: 1.1.2 Matematikë: 3.3 Gjuhët dhe komunikimi: 1.1; 1.4; 1.6
Rezultati i të nxënit të temës:	Realizon aktivitete në bashkëpunim me të tjerët përmes lojës (gatuan ushqime, rregullon ambientin, përgatit tryezën etj.).
Rezultatet e të nxënit të aktiviteteve:	<ul style="list-style-type: none"> • Përshkruan disa nga situatat që përbëjnë rrezik gjatë lojës. • Hulumton në grup mënyrat si duhet vepruar kur gjendet në situatë rreziku. • Përmes lojës me role paraqet situatën e ndërhyrjes në rast lëndimi gjatë lojës.
Kriteret e suksesit:	<ul style="list-style-type: none"> • Përshkruaj disa nga situatat që përbëjnë rrezik gjatë lojës. • Bisedo me shokët/shoqet për mënyrat si duhet vepruar në situatë rreziku. • Luaj në role duke dramatizuar një situatë të ndërhyrjes gjatë lëndimit në lojë.
Burimet dhe materialet:	Copëza letre me ngjyra (për ndarjen e fëmijëve në grupe), veshje të ndryshme sipas roleve, rrathë, litar, topa dhe mjete të tjera, sipas nevojës së fëmijëve gjatë dramatizimit.
Integrimi ndërfaqshor:	Matematikë, Gjuhë shqipe.
Çështjet ndërkurrikulare:	Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.
Fjalë kyçe:	Sheshi i lojërave, mbrojtje, kujdes, lojë e sigurt, lëndim.
Organizimi i aktiviteteve:	<p>Në takimin e përbashkët pas përshëndetjes dhe kalendarit, luhet “Loja me top”, ku fëmija që zotëron topin, tregon për lojën e tij të parapëlqyer në këndin e lojërave, topi kalon nga njëri fëmijë te tjetri, derisa të gjithë fëmijët të përfundojnë fjalën.</p> <p>Pas përfundimit të lojës, të gjithë ulen në rreth dhe edukatori/ja, përmes bashkëbisedimit, hap diskutimin për situatën, në të cilat ata mund të jenë lënduar gjatë lojës. Fëmijët tregojnë përvojat e tyre dhe edukatori/ja, përmes bashkëbisedimit, u kërkon atyre të japin mendimin e tyre se si duhet të kishte vepruar shoku/shoqja që të mos lëndohej.</p> <p>Edukatori/ja mund të vizualizojë (paraqesë përmes ilustrimeve, të cilat mund të vendosen në një vend të dukshëm) disa nga rregullat bazë të sigurisë në lojë, si: respektimi i radhës, kujdesi gjatë bartjes së objekteve, distanca e nevojshme për lojë brenda dhe jashtë klasës etj.</p>

Fëmijët e ndarë në grupe do të luajnë lojëra me role në ambient të jashtëm.

Fëmijët e mendojnë vetë një situatë në sheshin e lojërave, rregullojnë hapësirën, ndajnë rolet, gjejnë rekuizitat dhe ndërtojnë një ngjarje apo zgjidhin një situatë në sheshin e lojërave përmes luajtjes së roleve dhe dramatizimit.

Pasi fëmijët të kenë sistemuar gjërat në vendet përkatëse, organizohet takimi përmbyllës, ku diskutohet mbi lojërat e përzgjedhura, ndarja e roleve, vendimmarrja, rrjedha e lojës, si dhe përmes ilustrimit të rregullave të sigurisë fëmijët tregojnë se çfarë veprimesh kanë bërë ata gjatë lojës për t'u kujdesur për respektimin e këtyre rregullave.

Vlerësimi:

Edukatori/ja mund të regjistrojë lojën e fëmijëve dhe të vëzhgojë aftësitë e tyre drejt zgjidhjes së problemit.

Regjistrimi mund të përdoret për të dokumentuar punën që zhvillohet në grupin edukativ ose, në situata të caktuara, mund të ndahet edhe me prindërit.

Më shumë për të bërë:

Ju mund të dilni në sheshin e lojërave dhe t'i ushtroni praktikisht masat mbrojtëse që merren për të mos u lënduar ose çfarë duhet bërë nëse dikush prej fëmijëve lëndohet.

Sheshi i lojërave mund të përdoret edhe për zhvillimin e lojërave dramatike, që kanë për qëllim aftësimin e fëmijës për të reaguar në situata rreziku.

Reflektimi:

Siguria ndaj zjarrit

Fusha kurrikulare:	Shoqëria dhe mjedisi
Kurrikula lëndore:	Shoqëria dhe mjedisi
Tema nga plani dymujor:	Përgjegjësitë e mia
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):	I-3; II-3, 7; III-1, 2, 3, 6; IV-3, 4, 6; V-2, 5, 7; VI-3, 4, 6, 7
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):	Shoqëria dhe mjedisi: 2 Njeriu dhe natyra: 3.1 Gjuhët dhe komunikimi: 1.1; 1.4; 1.6; 1.7 Edukata fizike, sportet dhe shëndeti: 1
Rezultati i të nxënit të temës:	Tregon për fjalët, sjelljet dhe veprimet e veta në raport me të tjerët dhe mban përgjegjësi për to.
Rezultatet e të nxënit të aktiviteteve:	<ul style="list-style-type: none"> • Klasifikon fotografitë në situata të sigurta dhe të pasigurta. • Shpjegon rezultatet e eksperimentit pas vëzhgimit që bën. • Analizon masat e sigurisë që duhen ndërmarrë kundër zjarrit.
Kriteret e suksesit:	<ul style="list-style-type: none"> • Klasifiko fotografitë në situata të sigurta dhe të pasigurta. • Shpjego rezultatet e eksperimentit pas vëzhgimit që bën. • Diskuto për masat e sigurisë që duhen ndërmarrë kundër zjarrit.
Burimet dhe materialet:	Fotografi të prera prej gazetave që paraqesin situata të sigurta dhe të pasigurta; kuti kartoni, fletë e madhe A2, ngjites, qirinj, kavanoz, plastelinë, pjata letre/plastike, libri i fëmijës.
Integrimi ndërfaqor:	Njeriu dhe natyra, Gjuhë shqipe, Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti.
Çështjet ndërkurrikulare:	Edukimi për qytetari demokratike.
Fjalë kyçe:	Siguri, mbrojtje, rrezik, ndihmë, zjarr, kujdes.
Organizimi i aktiviteteve:	<p>Edukatori/ja ka përgatitur një kuti, brenda së cilës ka vënë fotografi të ndryshme që tregojnë veprime të ndryshme, si p.sh.: një fëmijë në biçikletë pa kokore, një fëmijë në biçikletë me kokore, një i rritur duke gatuar në kuzhinë, një enë në zjarr etj., (foto që tregojnë situata të sigurta ose të pasigurta, të rrezikshme). Kur të gjithë fëmijët të kenë në dorë nga një fotografi, edukatori/ja u kërkon që të flasin për to, i nxit që t'i përshkruajnë në mënyrë të tillë që ata vetë të arrijnë në një përfundim rreth situatave të sigurta ose të pasigurta.</p> <p>Edukatori/ja sjell në rreth një fletë të madhe A2 dhe fëmijët vendosin vetë se cila situatë është e sigurt dhe cila jo.</p> <p>Ata ngjisin fotografitë me ngjites në fletën e madhe: fotografitë e sigurta te fytyra e gëzuar dhe ato të pasigurta te fytyra e mërzitur.</p>




Nga situatat e paraqitura, edukatori/ja bën një përmbledhje të situatave të treguara në fotografi dhe së bashku me fëmijët udhëheq eksperimentin me qirinjtë dhe flakën.

Ndërton tri situata të ndryshme:

1. Flaka e qiriut nuk fiket, kur ky ka afër një karburant.
2. Flaka fiket kur mbi të hidhet ujë.
3. Flaka fiket kur mbi të vendoset një kavanoz (krijohet hapësira pa ajër).

Të tri rastet, veç e veç, diskutohen me fëmijët. Nëse ata kanë nevojë, edukatori/ja i përsërit, duke i kushtuar kujdes secilit detaj. Kështu, fëmija kupton se cila situatë është e rrezikshme dhe informohet se çfarë duhet bërë që të shuhet zjarri.



Fëmijët së bashku me edukatorin/en ushtrojnë lëvizjet për rregullën bazë të mbrojtjes kundër zjarrit, që është: "Ndalo, rrotullohu dhe zvarritu". Ushtrimi praktikohet nga edukatori/ja dhe më pas nga të gjithë fëmijët. Është e rëndësishme që fëmijët të udhëzohen t'i mbajnë sytë me duar gjatë rrotullimit.

Në vijim, fëmijët plotësojnë fletëzat e punës për masat e sigurisë, në mënyrë që të aftësohen të kuptojnë situatat që paraqesin rrezik për jetën.

Në takimin përmbyllës diskutohet puna e bërë gjatë ditës.

Vlerësimi:




Fëmijët vëzhgohen gjatë pjesëmarrjes aktive në aktivitete dhe diskutimet për rezultatet e eksperimentit.

Më shumë për të bërë:

Mund të ftoni në aktivitete prindër që kanë profesionin e zjarrfikësit etj.
Mund t'i dërgoni fëmijët për vizitë te zjarrfikësit.

Reflektimi:

Historia e Rinës dhe Redonit

Fusha kurrikulare:	Gjuhët dhe komunikimi
Kurrikula lëndore:	Gjuha shqipe
Tema nga plani dymujor:	Tinguj shkronja, rrokje, fjalë, fjali
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):	I -3, 5; II -7; III -2, 3, 6; IV -3; V -5, 6; VI -3, 6
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):	Gjuhët dhe komunikimi: 1.1; 1.2; 1.4; 1.5; 3.2 Jeta dhe puna: 2.6.1 Matematikë: 3.5
Rezultati i të nxënit të temës:	Pyesin e përgjigjen për tema të ndryshme me fjalë e fjali të thjeshta.
Rezultatet e të nxënit të aktiviteteve:	<ul style="list-style-type: none"> • Përshkruan sjelljet e paraqitura në imazhe përmes lojës me pantomima. • Identifikon se me cilin tingull fillojnë emrat e personazheve të paraqitura. • Shoqëron objektin përkatës me shkronjën përkatëse përmes lojës.
Kriteret e suksesit:	<ul style="list-style-type: none"> • Përmes lojës me pantomima përshkruaj sjelljet e paraqitura në imazhe. • Identifikon se me cilin tingull fillojnë emrat e personazheve të paraqitura. • Përmes lojës shoqëro objektin përkatës me shkronjën përkatëse.
Burimet dhe materialet:	Tabela për fëmijë, librat e punës, tabela.
Integrimi ndërfaqor:	Shkathtësi për jetë, Matematikë.
Çështjet ndërkurrikulare:	Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.
Fjalë kyçe:	Sjellje e mirë, faleminderit, të lutem, më fal, shkronja R.
Organizimi i aktiviteteve:	Edukatori/ja ka përgatitur paraprakisht disa fotografi të printuara, të cilat paraqesin fëmijët në situata të ndryshme.
	Edukatori/ja shpërndan fletëzat (nga 1 fletëz për dy fëmijë) dhe u kërkon që përmes pantomimave ta paraqesin fletëzën e tyre përpara shokëve dhe shoqeve.
	Kështu, gradualisht, përgjatë lojës arrijmë deri te fjalët TË LUTEM, FALEMINDERIT, MË FAL etj.
	Pas përfundimit të lojës me pantomima, edukatori/ja tregon që fotografitë paraqesin historinë e dy fëmijëve, Rinës dhe Redonit, kështu edukatori/ja radhit fotot sipas historisë dhe rrëfen historinë përpara tyre. Edukatori/ja nxit me pyetje bashkëbisedimin: <i>Si mendoni për sjelljet e tyre? Po juve, a ju ka ndodhur një gjë e tillë? Si do të kishit vepruar nëse do t'ju ndodhte?</i> Etj.
Mendoni për sjelljet e mira!	



Pas bashkëbisedimit, edukatori/ja integron shkronjën R, duke kërkuar nga fëmijët që të tregojnë se me cilin tingull fillon emri: Rina, Redoni (fëmijët japin mendimet e tyre). Dhe paraqet shkronjën R në tabelë. Fëmijët gjejnë fjalë me këtë shkronjë. Edukatori/ja u jep tabela të vogla (nëse ka të tilla në institucion) ose fletë të plastifikuara dhe ata praktikojnë shkronjën R.

Edukatori/ja ka organizuar mjedisin e punës me grupe të vogla.

Në një kënd, fëmijët do të dramatizojnë tregimin “Rina dhe Redoni” me kukulla dore.

Në një kënd tjetër, fëmijët do të plotësojnë fletëzën e punës për shkronjën R.

Në një kënd, fëmijët do të mund të vizatojnë sipas mënyrës së tyre historinë e treguar apo të ndërtojnë një tregim të ri.

Në një kënd tjetër, edukatori/ja ka përgatitur një material pune, ku në një shportë ka vendosur objektet dhe në një shportë tjetër do të vendosen shkronjat. Fëmijët do të shoqërojnë objektin me shkronjën përkatëse.

Në takimin përmbyllës, edukatori/ja thekson se njerëzit duhet t’i respektojnë rregullat për të pasur jetën më të mirë dhe u kërkon fëmijëve që, së bashku, t’i rishikojnë rregullat e mirësjelljes brenda në klasë, duke u bazuar në sjelljet e Rinës dhe Redonit, gjithashtu edhe t’i numërojnë ato.

Rregullat e klasës:

Dëgjojmë njëri-tjetrin.

Ngre dorën për të dhënë mendime.

Flasim me zë të butë e të ulët.

Ecim ngadalë.

Ndihmojmë njëri-tjetrin.

Vlerësimi:

Fëmijët vëzhgohen gjatë të shprehurit me gojë, edukatori/ja mund të mbajë shënime për fëmijë të caktuar.


Më shumë për të bërë:

Edukatori/ja njofton fëmijët dhe prindërit se në aktivitetin e ardhshëm do të jetë në klasë një polic/e e trafikut rrugor dhe i fton ata të marrin pjesë në aktivitet.

Reflektimi:

Ecim të sigurt në rrugë

Fusha kurrikulare:	Shoqëria dhe mjedisi
Kurrikula lëndore:	Shoqëria dhe mjedisi
Tema nga plani dymujor:	Unë dhe rregullat
Rezultatet e të nxëniet për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):	I-3, II-5, 7; III-2, 3, 6; IV-3; V-5, 6; VI-3, 6
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):	Gjuhët dhe komunikimi: 1.1; 1.4; 1.6; 1.7 Shkencat e natyrës: 1 Matematikë: 4.1 Shoqëria dhe mjedisi: 3.2
Rezultati i të nxëniet të temës:	Zbaton rregullat për veprimtari të caktuara në situata të ndryshme jetësore, si: në familje, lagje, kopsht/shkollë, rrugë/komunikim etj.
Rezultatet e të nxëniet të aktiviteteve:	<ul style="list-style-type: none"> • Tregon si quhet vendi ku ecin këmbësorët në rrugë. • Dallon ngjyrën e semaforit që lejon kalimin. • Plotëson librin.
Kriteret e suksesit:	<ul style="list-style-type: none"> • Trego si quhet vendi ku ecin këmbësorët në rrugë. • Dallo ngjyrën e semaforit që lejon kalimin. • Plotëso librin.
Burimet dhe materialet:	Projektor, laptop, ilustrime, libri i punës.
Integrimi ndërfaqësor:	Gjuha shqipe, Njeriu dhe natyra, Matematika.
Çështjet ndërkurrikulare:	Edukimi për qytetari demokratike.
Fjalë kyçe:	Rregull, sjellje, rrugë, semafor, polici.
Organizimi i aktiviteteve:	<i>(Edukatori/ja fton një punonjës nga Policia e trafikut rrugor, me qëllim që fëmijët të njihen me rregullat e qarkullimit në rrugë.)</i> Edukatori/ja i prezanton fëmijët me policin/en e trafikut rrugor dhe i njofton për qëllimin e vizitës së tij/saj në klasën përgatitore. <i>(Në aktivitet është mirë të marrin pjesë edhe prindërit.)</i>



Fillimisht, polici/ja rrugor/e i njofton fëmijët me pajisjet e punës që duhet t'i ketë gjithmonë me vete, sikurse: shenja STOP, bilbili, uniforma dalluese, kapela, jeleku etj.

Fëmijët pasojnë pajisje te njëri-tjetri dhe janë të lirë të bëjnë pyetje.

Më pas, ai/ajo mban një sesion të shkurtër informues, ku fëmijët njihen me punën që bën Policia rrugore.

Polici/ja rrugor/e u drejtohet fëmijëve:

Ai/ajo flet për rregullat e qarkullimit në rrugë dhe sjelljet në rrugë.



Pse është e rëndësishme të ndiqen gjithmonë ato.

Respektimi i rregullave të qarkullimit.

Kërkimi për ndihmë në rast rreziku:


NUMRI 192.

Edukatori/ja u kërkon fëmijëve që të ngrihen nga rrethi dhe të marrin një fletë të vogël të përgatitur në shportat e vendosura te këndi i artit, paraprakisht, dhe një ngjyrë sipas dëshirës. Bashkë me fletën dhe ngjyrën ata kthehen përsëri në rreth. Fëmijët në këtë mënyrë praktikojnë se si shkruhet saktë numri i policisë.

Më pas, polici/ja i/e trafikut rrugor në bashkëveprim me edukatorin/en paraqet imazhet e përgatitura me projektor. (Edukatori/ja në pamundësi të projektorit mund të sigurojë disa ilustrime.)

- Në trotuare ecin këmbësorët – pra, ju dhe unë.
- Lojërat bëhen në park dhe jo në rrugë.
- Rrugët janë për të ecur makinat, autobusët, kamionët.

Pas çdo prezantimi të paraqitur nga polici, edukatori/ja nxit përmes pyetjeve diskutimin dhe i motivon fëmijët me shprehje lavdëruese për të dhënë përgjigje më tutje.



Pasi përfundojmë prezantimin, fëmijët ndahen në grupe të vogla.

Njëri grup do të paraqesë rrugën dhe mjetet e trafikut përmes lojës me blloqe (loja zhvillohet në grup).

Njëri grup do të plotësojë fletëzën e punës.

Njëri grup do të bashkojë shkronjën përkatëse me fotografitë e mjeteve të komunikacionit (aktivitet i përgatitur nga edukatori/ja).

Në takimin përmbyllës do të bëhet një përsëritje e aktiviteteve të zhvilluara gjatë ditës.

Në procesin e edukimit të fëmijëve, edukatori/ja duhet të marrë parasysh se:

- Është shumë e rëndësishme që fëmijëve të mos u kërkohet të mësojnë përmendësh (mekanikisht) rregullat që duhet të ndiqen në rrugë, por t'u mësohen sjelljet e sigurta në rrugë.
- Me këto, fëmijët aftësohen më së miri përmes lojërave praktike, prerjes së fotografive, kubeve, attributeve për lojëra me role "shoferët dhe këmbësorët" (ku përfshihen makina, emblema, shenja etj.).

Vlerësimi: Edukatori/ja dokumenton aktivitetet e bëra gjatë ditës dhe në bazë të planit të vëzhgimit, vëzhgon fëmijët.

Më shumë për të bërë: Prindërit mund të përdorin këtë adresë për rregullat në rrugë: <https://www.youtube.com/watch?v=VorVTs1esLQ>

Reflektimi:

Semafor, ndriço!

Fusha kurrikulare: Matematika

Kurrikula lëndore: Matematika

Tema nga plani dymujor: Numrat natyrorë

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): **I-3; II-1, 3, 5, 7; III-1, 2, 3, 4, 6; IV-3, 5; V-2, 5; VI-3, 6**

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): Matematikë: 5.1
Gjuhët dhe komunikimi: 1.1; 1, 4; 1, 5
Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti: 1

Rezultati i të nxënit të temës: Kopjon/vizaton, modelon numrat nga 1 deri në 10.

Rezultatet e të nxënit të aktiviteve:

- Krijon semaforin duke bashkuar pjesët e dhëna.
- Numëron me gishtërinj ngjyrat e semaforit.
- Plotëson numrin në librin e punës.

Kriteret e suksesit:

- Krijon semaforin duke bashkuar pjesët e dhëna.
- Numëron me gishtërinj ngjyrat e semaforit.
- Plotëso numrin në librin e punës.

Burimet dhe materialet: Letra me ilustrim semafori, libra, bileta me makina, kapakë etj.

Integrimi ndërfaqor: Gjuha shqipe, Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti.

Çështjet ndërkurrikulare: Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

Fjalë kyçe: Semafor, ngjyrë, numri 3, vetura, anije, aeroplan.

Organizimi i aktiviteteve:

Edukatori/ja dhe fëmijët e fillojnë ditën me takimin në rreth. Për të ndarë fëmijët në grupe, edukatori/ja përgatit bileta ndarëse dhe i shpërndan ato në formë loje.

Pasi fëmijët formojnë grupe të vogla, edukatori/ja u shpërndan materialet (formuese të ndara në 8 pjesë me imazhet e semaforëve për makina dhe këmbësorë). Fëmijët bashkojnë pjesët e ndara dhe me to në duar kthehen përsëri në rrethin e madh. Në këtë mënyrë, ata janë të gatshëm për të filluar diskutimin mbi shenjat sinjalizuese me drita.



Fëmijët nxiten për bisedë: *Për çfarë na shërben semafori? Ku vendoset një semafor? Cilat rregulla duhen ndjekur kur ka semafor? Cila dritë na lejon të ecim? Cila nuk na lejon? (Fëmijët shprehin mendimet e tyre.) A mund të tregoni pra, sa ngjyra ka semafori? (E gjelbër, verdhë, e kuqe.) Numëroni me gishtërinj sa ngjyra janë.*

Në vijim, edukatori/ja u jep fëmijëve nga një fletë A4 dhe kërkon prej tyre që të vendosin aq kapakë sa ngjyra ka semafori dhe t'i numërojnë duke i vendosur. Paraqet modelin e numrit 3 dhe kërkon nga fëmijët që ta bëjnë me gisht në shpinën e shokut/shoqes që kanë afër.

Fëmijët vazhdojnë të plotësojnë librin e punës në mënyrë individuale, sipas kritereve të vendosura në libër, duke plotësuar dhe ngjyrosur.

Pasi fëmijët përfundojnë aktivitetin, ata kthehen në rreth, ku edukatorja ka krijuar një hapësirë për lojën "Ndërmerr një udhëtim me mua" si dhe ka krijuar tri vende parkimi: për makina, aeroplan dhe anije. (Edukatori/ja duhet të krijojë bileta me imazhe të mjeteve të udhëtimit tokësor, ajror dhe ujor.)

Edukatori/ja jep udhëzimet për rregullat e lojës. Të gjithë fëmijët marrin bileta sipas dëshirës dhe me të filluar muzika imitojnë mjetet dhe, kur ajo ndalon, ata "parkohen" sipas biletës përzgjedhëse.

Ndalja e muzikës i ndan fëmijët në tri grupe. Bisedohet se sa grupe u fituan, cilat janë ato. Në përfundim nxisim bashkëbisedimin për aktivitetet e zhvilluara sot. Sa iu kanë pëlqyer, si janë ndier gjatë lojës etj.

Vlerësimi:

Edukatori/ja mund të incizojë fëmijët gjatë lojës dhe t'i analizojë incizimet më vonë. E njëjta gjë mund të shërbejë edhe për të dokumentuar punën e bërë.

Më shumë për të bërë:

Ju mund të dilni për shëtitje në hapësirën rreth shkollës dhe të praktikoni se si fëmijët duhet të kalojnë rrugën. Që kjo të realizohet, kujdesuni të keni edhe shoqëruar të tjerë me vete, fëmijët të jenë të veshur me uniforma me ngjyra dalluese, po ashtu edhe ju me një jelek fluoreshent.

Reflektimi:

Unë jam shofer

Fusha kurrikulare:	Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti
Kurrikula lëndore:	Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti
Tema nga plani dymujor:	Kujdesi dhe siguria për veten dhe të tjerët
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):	I-3; II-3, 5, 7; III-1, 2, 3, 6; IV-3; V-2, 5; VI-3, 6
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):	Gjuhët dhe komunikimi: 1.1; 1.3; 1.4; 3.2 Matematika: 3.5 Artet: 1 Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti: 1
Rezultati i të nxënit të temës:	Shpjegon sjelljen e drejtë dhe sjelljen e gabuar në raste të ndryshme.
Rezultatet e të nxënit të aktiviteteve:	<ul style="list-style-type: none"> • Shpjegon rastin e gabuar në lojën ku merr pjesë. • Dallon sjelljet e drejta në aktivitetin ku merr pjesë. • Paraqet me anë të vizatimit lagjen ku banon.
Kriteret e suksesit:	<ul style="list-style-type: none"> • Shpjego rastin e gabuar në lojën ku merr pjesë. • Trego sjellje të drejta në aktivitetin ku merr pjesë. • Paraqit me anë të vizatimit lagjen ku banon.
Burimet dhe materialet:	Veshje policore, shenja, blloqe nga shtëpia, çarçaf me imazhe të ndryshme, makina, kukulla.
Integrimi ndërfaqor:	Gjuha shqipe, Matematika, Edukatë figurative.
Çështjet ndërkurrikulare:	Zhvillimi personal dhe aftësitë për jetë.
Fjalë kyçe:	Rrugë, shofer, lojë, makinë, këmbësor, semafor, polic.
Organizimi i aktiviteteve:	<p>Pas përshëndetjes me fëmijët dhe ndërrimit të kalendarit përpara tyre, edukatori/ja lexon vjershën "Semafori". Gjatë kësaj faze, fëmijët përsërisin pas edukatores disa herë rregullat e qarkullimit, të cilat i kanë mësuar ditë më parë nga vizita e policit/es.</p> <p>Cila nga ngjyrat e semaforit na lejon kalimin? Ku duhet të ecim?</p> <p>Edukatori/ja ka përgatitur paraprakisht hapësirat në klasë: rrugë, semafor, trotuare, pallate. (<i>Mund të vizatohen në një çarçaf shtëpi: shkolla, pallate ose të vizatohen në tapet me shirit ngjites.</i>) Qëllimi është që të ngjasojë me një rrugë dhe fëmijët të luajnë në role të ndryshme.</p> <p>Edukatori/ja i fton ata që të luajnë në role. Fëmijët do të kenë mundësi të përzgjedhin ndonjërin nga rolet, si: polic, këmbësor (me kukulla në duar), shofer (makine, autobusi, kamioni) ndonjë shenjë semafori etj.</p> <p>Fëmija që luan rolin e policit, orienton fëmijët që ecin në rrugë. Disa fëmijë bëjnë rolin e shoferit të makinës, disa rrinë si këmbësorë me</p>



kukulla në duar, një tjetër mban semaforin, kurse edukatorja me kohëmatës u tregon se kur duhet të ndryshojnë ngjyrat e semaforit. Pas çdo ndalese, edukatori/ja nxit diskutimin me pyetje si: *Cilat janë ngjyrat e semaforit? Pse duhet të ecni vetëm në trotuar dhe të kaloni vetëm te vijat e bardha?*

Kështu veprohet disa herë, derisa të gjithë fëmijët të marrin pjesë me rolet e tyre.

Fëmijët vazhdojnë aktivitetin të ndarë në tri grupe të vogla dhe ndërtojnë lagjen e tyre. Ata mund të zgjedhin ta ndërtojnë atë me materiale të ripërdorshme, blloqe ndërtuese, apo me rivendosjen e disa prej orendive të klasës. Gjithashtu, mund të zgjedhin edhe ta vizatojnë atë. Kjo mund të jetë një zgjedhje e lirë e grupeve, në varësi të hapësirës që ka klasa përgatitore.

Vlerësimi: Edukatori/ja vëzhgon fëmijët se sa të gatshëm janë të përballen me trafikun; sa i njohin të drejtat e tyre si këmbësorë dhe sa janë të gatshëm të marrin përgjegjësinë për veten e tyre në trafik.

Më shumë për të bërë: Në mënyrë të vazhdueshme, edukatori/ja i inkurajon fëmijët të flasin dhe të komunikojnë, të shprehin me fjalë atë që ata dinë dhe ndiejnë, si dhe të përpiqen për të bërë më shumë.

Reflektimi: _____

Loja ritmike më gëzon

Fusha kurrikulare: Artet

Kurrikula lëndore: Edukatë muzikore

Tema nga plani dymujor: Lojërat muzikore

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I-3, 5, 8; II-7; III-2, 6; V-5

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): Artet: 1
Gjuhët dhe komunikimi: 1.1; 1.3; 1.4; 3.2
Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti: 1

Rezultati i të nxënit të temës: Luan lojëra të thjeshta muzikore të shoqëruara me këngë dhe lëvizje trupore, me vegla muzikore fëmijërore që trajtojnë tema të ndryshme por edhe elemente didaktike të gjuhës artistike muzikore (ritmi, melodia, vetitë e tingullit muzikor etj.).

Rezultatet e të nxënit të aktiviteteve:	<ul style="list-style-type: none"> • Këndon së paku një varg të lojës muzikore. • Shoqëron me lëvizje trupore këndimin. • Plotëson modelin në fletëz.
Kriteret e suksesit:	<ul style="list-style-type: none"> • Këndo së paku një varg të lojës muzikore. • Shoqëro me lëvizje trupore këndimin. • Plotëso modelin në fletëz.
Burimet dhe materialet:	CD, radio, libri i punës, penj, kapak, pulla, fasule.
Integrimi ndërfushor:	Gjuhë shqipe, Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti.
Çështjet ndërkurrikulare:	Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.
Fjalë kyçe:	Rrotat, autobusi, shkronja RR, makarona në formë rrote, kavanoz i vogël.
Organizimi i aktiviteteve:	<p>Dita fillon me përshëndetje dhe edukatori/ja kërkon nga fëmijët që secili prej tyre të gjejë një mënyrë të veçantë krijuese për të përshëndetur shokët/shoqet dhe atë vetë. Pas përshëndetjes bëhet leximi i kalendarit.</p> <p>Në një kuti veze ose kavanoz të vogël, edukatori/ja ka vendosur disa makarona në formë rrote. Kavanozi ose veza përcillet nga secili fëmijë dorë më dorë, në rreth, për ta gjetur se çfarë ka brenda. Fëmijët japin opsionet e tyre dhe kur e përfundojnë radhën të gjithë, edukatori/ja hap kavanozin ose vezën, në mënyrë që të kuptohet nëse ata e kanë zbuluar ose jo se çfarë kishte brenda.</p> <p>Në këtë mënyrë, edukatori/ja bën ndërlidhjen me mjetet e transportit, ndalet tek autobusi dhe rrotat e tij, duke nxitur bashkëbisedimin përmes pyetjeve:</p> <p><i>A keni hipur në autobus ndonjëherë? Pse? Çfarë ju ka pëlqyer?</i></p> <p><i>Pas diskutimit, edukatori/ja ofron materiale të ndryshme në disa kënde dhe fton fëmijët që secili prej tyre të krijojë një perkusion, të cilin do ta përdorin në lojën ritmike "Rrotat e autobusit".</i></p> <p><i>Ofrohen: tasa kartoni, kavanozë të zbrazët, karton në formë cilindrike, oriz, fasule, rruaza etj.</i></p> <p><i>Fëmijët konstruktojnë dhe dekorojnë perkusionet e tyre, pastaj kthehen për të marrë pjesë në lojë.</i></p> <p>Më pas zhvillohet loja muzikore "Rrotat e autobusit".</p> <p>Bashkë me fëmijët, edukatori/ja vendos karriget në rresht si në autobus dhe i ul ata si pasagjerë.</p> <p>Edukatorja vë këngën dhe këndon së bashku me fëmijët:</p>

“Rrotat e autobusit”

*Rrotat e autobusit rrotullohen - rrotullohen - rrotullohen
 Rrotat e autobusit rrotullohen - rrotullohen - rrotullohen
 Rreth e qark qytetit hapen e mbyllen, hapen e mbyllen
 Dyert e autobusit hapen e mbyllen
 Rreth e qark qytetit
 Fshesat e xhamit bëjnë fësh-fësh-fësh
 Fësh-fësh-fësh rreth e qark qytetit
 Buria e autobusit bën bib-bib-bib
 Bib-bib-bib rreth e qark qytetit
 Shoferi i autobusit thotë shko nga mbrapa, shko nga mbrapa
 Shko nga mbrapa rreth e qark qytetit
 Shokët n'autobus thonë: Si je ti? Si je ti? Si je ti?
 Shokët n'autobus thonë: Si je ti? rreth e qark qytetit
 Bebi n'autobus bën ue-ue-ue
 Bebi n'autobus bën ue-ue-ue rreth e qark qytetit
 Mami n'autobus bën shshshsh
 Mami n'autobus bën shshshshsh rreth e qark qytetit.*

Fëmijët përdorin përkursionet e krijuara gjatë këndimit të këngës.

Pasi vendosen prapë të gjithë në rreth, edukatorja pyet fëmijët: *Me çfarë ecën autobusi? Çfarë ecën tjetër me rrota? Ai/ajo kërkon nga fëmijët të tregojnë se me cilin tingull fillon fjala “Rrota” dhe të gjejnë fjalë të tjera që fillojnë po njësoj. Në vijim edukatori/ja paraqet modelin e shkronjës RR.*

Fëmijëve u ofrohen materiale të ripërdorshme (penj, kapakë, pulla, fasule) dhe u kërkohet të modelojnë shkronjën RR.

Fëmijët punojnë në librat e punës, duke i plotësuar ata sipas kriterëve të dhëna.

Në takimin përmbyllës fëmijët do të luajnë lojën muzikore “Rrotat e autobusit”, apo sipas përzgjedhjes së tyre ndonjë lojë tjetër ritmike.

Vlerësimi:

Fëmijët vlerësohen në bazë të kriterëve të vendosura për zhvillimin e aktivitetit.

Më shumë për të bërë:

Prindërve u ofrohet adresa e lojës muzikore në internet, që ta dëgjojnë fëmijët (nëse kanë dëshirë). (<https://www.youtube.com/watch?v=cfTcm2VC26o>)

Reflektimi:

Nëntori i Dytë

Fusha kurrikulare:	Gjuhët dhe komunikimi
Kurrikula lëndore:	Gjuha shqipe
Tema nga plani dymujor:	Tregime, përralla, përrallëza, gjëegjëza, poezi
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):	I-3, 7, 8; II-3, 7; III-1, 2, 3, 6; IV-3, 4; V-2, 5; VI-1, 3, 4, 6
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):	Gjuhët dhe komunikimi: 1.1; 1.2; 1.4; 1.7; 2.8 Jeta dhe puna: 2.8.1 Matematikë: 3.1 Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti: 1
Rezultati i të nxënit të temës:	Përqendrohen në të dëgjuar e të folur për të kuptuar informatën, këshillën, ngjarjen, tregimin, përrallën, përrallëzën etj.
Rezultatet e të nxënit të aktiviteteve:	<ul style="list-style-type: none"> • Përshkruan flamurin e kombit shqiptar. • Tregon se cili personazh e ngriti flamurin në Vlorë. • Krijon flamurin me materialet që i ofrohen.
Kriteret e suksesit:	<ul style="list-style-type: none"> • Përshkruaj flamurin e kombit shqiptar. • Trego se cili personazh e ngriti flamurin në Vlorë. • Krijo flamurin me materialet që të ofrohen.
Burimet dhe materialet:	Letër, librat, materiale ndihmëse për punimin e flamurit.
Integrimi ndërfaqor:	Shkathtësi për jetë, Matematikë, Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti.
Çështjet ndërkurrikulare:	Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.
Fjalë kyçe:	Flamur, liri, 28 Nëntori, Marigona, Vlorë.
Organizimi i aktiviteteve:	<p>Pas përshëndetjes dhe leximit të kalendarit të ditës, edukatori/ja i fton fëmijët të marrin pjesë në lojë garuese me flamuj. Fëmijët ndahen në dy skuadra dhe menjëherë pas dhënies së sinjalit duhet të shkojnë me vrap deri te caku, që të marrin nga një flamur dhe të kthehen me shpejtësi në vendin e mëparshëm, për ta vendosur flamurin aty.</p> <p>Pas kësaj, të gjithë ulen në rreth dhe edukatori/ja sjell me vete të gjithë flamujt, ndër të cilët veçon flamurin kuq e zi. Ai/ajo nxit bashkëbisedimin rreth flamurit. <i>Cilën festë kemi pranë? Çfarë është një flamur? Pse secili vend ka nga një flamur?</i> Në këndin e dramatizimit edukatori/ja ka përgatitur një shfaqje, e cila paraqet tregimin e historisë së 28 Nëntorit përmes teatrit me kukulla. Historia paraqitet në formë të thjeshtëzuar me anë të kukullave të dorës. Në fund të shfaqjes, ai/ajo tregon se kjo ishte një histori e vërtetë dhe se tani, ata mund t'i shohin prej vërteti personazhet e historisë. Edukatori/ja paraqet në projektor sekuenca të shkurtra të filmit "Nëntori i Dytë".</p>



Në vijim fëmijët e ritregojnë dhe diskutojnë ngjarjen me fjalët dhe mënyrën e tyre. Edukatori/ja ofron edhe mjaft materiale si libra, broshura dhe elementet të tjera kombëtare.

Kështu fëmijët mund të hulumtojnë më tepër për flamurin dhe simbolet kombëtare.

Edukatori/ja ofron materiale në tri kënde të ndryshme:

Në një kënd ofrohen librat dhe broshurat e ndryshme, ku fëmijët mund të hulumtojnë mbi simbolet kombëtare. Po ashtu, ata mund të shkruajnë fjalë apo vizatojnë sipas interesimit të tyre.

Në këndin tjetër ofrohen materiale të ndryshme me ngjyrat kuq e zi, ku fëmijët të ndarë në grupe, do të krijojnë flamurin përmes kolazhit.

Në këndin tjetër ofrohen ngjyra uji, ku fëmijët në mënyrë individuale mund të ngjyrosin modelin e flamurit.

Gjatë kësaj kohe fëmijët dëgjojnë në sfond Himnin e Flamurit kombëtar, me zë shumë të ulët.

Pas përfundimit të aktiviteteve, fëmijët ekspozojnë punimet e tyre individuale dhe ato në grup (nëse dëshirojnë të ndajnë punën e tyre me të tjerët).

Në takimin përmbyllës, të gjithë së bashku shohin edhe një herë punën e bërë.

Vlerësimi:

Fëmijët vlerësohen sipas planit të vlerësimit për shkathtësitë motorike dhe ato shprehëse.

Më shumë për të bërë:

Linku i sekuencave të shkurtra të filmit mund t'u shpërndahet prindërve, në mënyrë që ata të mund t'i zhvillojnë më tepër njohuritë e fëmijëve mbi historinë kombëtare. <https://www.youtube.com/watch?v=BuXu5yuNiZE>

Reflektimi:

Nën ritmin tonë festojmë 28 Nëntorin

Fusha kurrikulare:	Artet
Kurrikula lëndore:	Edukimi muzikor
Tema nga plani dymujor:	Këngët, ritmet dhe ligjërimet ritmike, meloditë, shoqërimet
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):	I -3, 7, 8; III -3, 6; IV -3, 4; V -2, 5; VI -1, 3, 4, 6
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):	Artet: 3 Gjuhët dhe komunikimi: 1.1; 1.2; 3.2 Matematika: 3.4
Rezultati i të nxënit të temës:	Këndon këngë të thjeshta (në grup) sipas imitimit (këngë që trajtojnë tema të përshtatshme për moshën e tyre: për natyrën, shkollën, familjen, dëshirat, lodrat, stinët, festat etj.).
Rezultatet e të nxënit të aktiviteteve:	<ul style="list-style-type: none"> • Këndon së paku një varg të këngës së dëgjuar. • Shoqëron me lëvizje trupore këndimin. • Ndërton instrumentin e tij ritmik me material të ripërdorshëm.
Kriteret e suksesit:	<ul style="list-style-type: none"> • Këndo së paku një varg të këngës së dëgjuar. • Shoqëro me lëvizje trupore këndimin. • Ndërto instrumentin tënd ritmik me material të ripërdorshëm.
Burimet dhe materialet:	CD, radio, shishe plastike ose qelqi, kavanoza të ndryshëm, oriz, fasule, misër, pulla, shirita dekorativë, letër dekorative, ngjitës, gërshërë.
Integrimi ndërfaqor:	Gjuha shqipe, Matematika.
Çështjet ndërkurrikulare:	Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.
Fjalë kyçe:	Festa e Flamurit, 28 Nëntori, shkronja N.
Organizimi i aktiviteteve:	<p>Bëhet takimi i përbashkët, përhëndetja me fëmijët, ndërrimi i kalendarit. Edukatori/ja kërkon nga fëmijët të tregojnë përshtypjet e tyre për shfaqjen me kukulla dhe sekuencat e filmit: "Nëntori i dytë".</p> <p>Fëmijët shprehin mendimet e tyre.</p> <p>Ata do të dëgjojnë një këngë. Fëmijët mbyllin sytë që të mendojnë se ku e kanë dëgjuar këngën. Edukatori/ja e vë këngën në CD dhe pret përfundimin e saj, ndërkohë vëzhgon fëmijët si e dëgjojnë këngën dhe përpiqen ta kujtojnë atë.</p> <p>Kjo është kënga e kombëtares së futbollit, kënga që e dëgjuan dje gjatë aktivitetit me zë të ngadalshëm. Edukatori/ja shpjegon se çfarë është një himn kombëtar dhe se si duhet të veprohet kur ne e dëgjojmë atë. Edukatori/ja bashkë me fëmijët ngrihen në këmbë dhe e dëgjojnë himnin.</p>

Pas dëgjimit të himnit, fëmijët ndërtojnë instrumentin e tyre muzikor për përcjelljen e ritmit. Meqë fëmijët janë ende në fazën e mësimit të tekstit, një gjë e tillë praktikohet edhe një herë në fund të ditës.

Fëmijëve u ofrohen materialet e listuara, si: shishe qelqi, shishe plastike, kavanoza të ndryshëm, oriz, fasule, misër, pulla, shirita dekorativë, letër dekorative, ngjitës, gërshërë për të ndërtuar instrumentet e tyre muzikore. Edukatori/ja ndan materialin në disa qendra, në mënyrë që fëmijët të mund të ndërveprojnë. Edukatori/ja porosit fëmijët që përpara dekorimit të shisheve me motive kombëtare, të provojnë tingujt e instrumentit të tyre.

Kur të gjithë fëmijët të kenë përfunduar instrumentin dhe dekorimin e tij me motive kombëtare, edukatori/ja i këshillon të pastrojnë hapësirën ku punuan dhe t'i kthejnë materialet nëpër vendet e tyre.

Fëmijët me instrumentet e tyre muzikore përcjellin ritmin e himnit të flamurit dhe e shoqërojnë atë me tekst me ndihmën e edukatorit/es.

Aktiviteti vazhdohet në rreth, duke kërkuar nga fëmijët që të tregojnë tingullin e parë të fjalës Nëntori. Edukatori/ja paraqet shkronjën N dhe bashkë me fëmijët gjejnë fjalë me këtë tingull, ndajnë në rrokje, krahasojnë rrokjet *më shumë, më pak*. Dita vazhdon nëpër qendrat e aktivitetit ku:

Njëri grup do të plotësojë fletëzën e shkronjës N. Njëri grup do të provojë shkrimin e shkronjës në rërë, miell etj. Gjatë kësaj faze fëmijët dëgjojnë këngën e mësuar.

Pas përfundimit të aktivitetit, fëmijët kthehen në rreth sërish dhe këndojnë këngën me melodi, duke e shoqëruar me instrumentet e tyre muzikore.

Vlerësimi:


Fëmijët vlerësohen për aftësitë e tyre gjatë ndërveprimit me materiale të ndryshme për ndërtimin e instrumentit të tyre.

Më shumë për të bërë:

Edukatori/ja, në bashkëpunim dhe bashkëveprim me prindërit, i dërgon të nesërmen fëmijët në muzeun e qytetit.


Reflektimi:

Festa e Flamurit - vizitë në muzeun e qytetit

Fusha kurrikulare:	Shoqëria dhe mjedisi
Kurrikula lëndore:	Shoqëria dhe mjedisi
Tema nga plani dymujor:	Festat
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):	I-3, 7, 8; III-3, 6; IV-3, 4; V-2, 5; VI-1, 3, 4, 6
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):	Shoqëria dhe mjedisi: 3.3.1 Gjuhët dhe komunikimi: 1.1; 1.4; 1.6 Artet: 3
Rezultati i të nxënit të temës:	Emërton disa nga festat familjare e shoqërore dhe përshkruan organizimet dhe manifestimet e tyre sipas mënyrës së vet.
Rezultatet e të nxënit të aktiviteteve:	<ul style="list-style-type: none"> • Emërton festat që kremton në familjen e tij/saj. • Përshkruan përdorimin e së paku pesë prej eksponateve që ka muzeu i qytetit. • Këndon së paku një varg të himnit kombëtar.
Kriteret e suksesit:	<ul style="list-style-type: none"> • Emërto festat që kremton në familjen tënde. • Përshkruaj përdorimin e së paku pesë eksponateve që ka muzeu i qytetit. • Këndo së paku një varg të himnit kombëtar.
Burimet dhe materialet:	Uniformat e fëmijëve, shirit i kuq për ecje, shenja STOP.
Integrimi ndërfaqor:	Gjuha shqipe, Edukatë figurative.
Çështjet ndërkurrikulare:	Edukimi për qytetari demokratike.
Fjalë kyçe:	Flamur, 28 Nëntori, muze, veshje, eksponate etj.
Organizimi i aktiviteteve:	Edukatori/ja në bashkëveprim me prindërit i dërgon fëmijët në Muzeun Etnografik, i cili përmban eksponate të vjetra qytetare: mjete dhe veshje të ndryshme shumë të hershme. Fëmijët njihen nga afër me historinë e paraardhësve të tyre. Edukatori/ja së bashku me ciceronin e muzeut u flet për eksponatet e ndryshme, për përdorimin e tyre në periudha të ndryshme, për mënyrën e jetesës, kulturën e paraardhësve dhe për vlerat e trashëgimisë kulturore të qytetit. Në përfundim të vizitës, fëmijët recitojnë vjersha për flamurin, këndojnë këngë dhe Himnin e Flamurit Kombëtar.
	
Vlerësimi:	Fëmijët vlerësohen për të shprehurit me gojë, për përshkrimin e eksponateve dhe veshjeve të ndryshme.
Më shumë për të bërë:	Ju mund të vizitoni edhe një institucion tjetër kulturor, ndonjë zonë arkeologjike apo mund të merrni pjesë në ndonjë ngjarje të shënuar për këtë ditë.
Reflektimi:	_____

Sa flamuj kemi ne?

Fusha kurrikulare:	Matematika
Kurrikula lëndore:	Matematika
Tema nga plani dymujor:	Numrat natyrorë
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):	I-3; II-3, 4, 8; III-1, 2, 3, 4, 6; V-2, 5; VI-6
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):	Matematikë: 5.1 Gjuhët dhe komunikimi: 1.1; 1.2; 1.4 Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti: 2.2
Rezultati i të nxënit të temës:	Vlerëson me mënyra të ndryshme (përmes shikimit, të prekurit) një grup me 2-5 objekte.
Rezultatet e të nxënit të aktiviteteve:	<ul style="list-style-type: none"> • Emërton numrat 1-3 të paraqitur me objekte. • Numëron flamujt në mënyrë të pavarur.
Kriteret e suksesit:	<ul style="list-style-type: none"> • Emërto numrat 1-3 të paraqitur në lojë. • Numëro sa flamuj ke.
Burimet dhe materialet:	Fletë të plastifikuara, kapakë, ilustrime, ngjyra, lapsa, teatri i hijeve, kukullat etj.
Integrimi ndërfaqor:	Gjuha shqipe, Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti.
Çështjet ndërkurrikulare:	Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.
Fjalë kyçe:	Flamur, numri 3, pallat, teatër i hijeve.
Organizimi i aktiviteteve:	<p>Dita fillon me takimin e përbashkët në rreth.</p> <p>Edukatori/ja fton fëmijët të luajnë lojën "Vallëzimi me flamuj".</p> <p><i>Ecuria:</i> Fëmijët janë në rreth, në mes vendosen flamuj (një më pak se numri i fëmijëve, p.sh.: 9 flamuj për 10 fëmijë), vihet muzika dhe fëmijët vallëzojnë. Në momentin e ndaljes së muzikës fëmijët marrin nga një flamur; ai/ajo që mbetet pa flamur vjen afër edukatorit/es dhe e ndihmon për muzikën). Në radhën tjetër largohet një flamur e kështu me radhë. Loja vazhdon deri në lojtarin e fundit.</p> <p>Përmes teatrit me hije, edukatori/ja paraqet një tregim ku pjesë e tij janë flamujt.</p> <p>Përgatiten tiketa për shfaqjen dhe fëmijët zënë vend te këndi i dramatizimit; në sfond lëshohet një melodi shoqëruese dhe pas shfaqjes, diskutohet mbi ngjarjen.</p> <p>Edukatori/ja ka përgatitur qendrat e aktiviteteve me materiale:</p> <p>Në një kënd janë vendosur dy shporta, në njërin janë vendosur numrat, në tjetrën janë vendosur flamuj. Fëmijët do të shoqërojnë numrin me sasinë. Në një kënd tjetër, fëmijët përmes fotografive do të ndërtojnë një histori.</p>



Në këndin tjetër do të vizatojnë sipas kriterit: Kriter do të jetë që punimi i tyre të ketë tri elemente.

Në këndin e lojërave konstruktive do të luajnë.

Pas përfundimit të aktiviteteve, fëmijët kthehen përsëri në rreth për takimin përmbyllës, për të luajtur lojën me kub (kubi duhet të ketë nga 1, 2 dhe 3 pika. Ata numërojnë pikët dhe ecin në drejtëzën numerike.

Vlerësimi:

Fëmijët vëzhgohen gjatë pjesëmarrjes në aktivitete.

Më shumë për të bërë:

Ju mund të kërkonte nga fëmijët që të numërojnë flamujt gjatë rrugës për në shkollë/institucion dhe anasjelltas, ku janë të vendosur etj.

Kërkonte nga prindërit që t'i nxisin fëmijët e tyre për të përdorur fjalorin matematikor dhe të aftësohen në ndërlidhjen e veprimeve matematikore gjatë aktiviteteve të përditshme.

Reflektimi:

Simfonia e kafshëve

Fusha kurrikulare:	Artet
Kurrikula lëndore:	Edukim muzikor
Tema nga plani dymujor:	Këngët, ritmet dhe ligjërimet ritmike, meloditë, shoqërimet
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):	I-3, 5, 8; II-7; III-2, 6; V-5
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):	Artet: 1 Gjuhët dhe komunikimi: 1.1; 1.3; 1.7 Matematikë: 3.5
Rezultati i të nxënit të temës:	Këndon këngë të thjeshta muzikore (në grupe) sipas imitimit.
Rezultatet e të nxënit të aktiviteteve:	<ul style="list-style-type: none"> • Identifikon tingujt e zërave të kafshëve. • Këndon së paku një varg të këngës. • Përshkruan karakteristikat e kafshës së përzgjedhur.
Kriteret e suksesit:	<ul style="list-style-type: none"> • Identifikoj tingujt e zërave të kafshëve. • Këndoj së paku një varg të lojës muzikore. • Përshkruaj karakteristikat e kafshës së përzgjedhur.
Burimet dhe materialet:	Këngë për kafshët në CD, lojëra zbavitëse, shportë e madhe, mbulesë, lodra të vogla dhe të mëdha me kafshë të ndryshme, që gjenden në institucion/shkollë, libri i fëmijës.
Integrimi ndërfaqësor:	Gjuhë shqipe, Matematikë.
Çështjet ndërkurrikulare:	Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.
Fjalë kyçe:	Kafshë, tinguj, zëra, kushtet e jetesës.
Organizimi i aktiviteteve:	<p>Pas përshëndetjes dhe leximit të kalendarit, fëmijët shohin se fillon një muaj i ri; së bashku kontrollojnë tabelën e ditëlindjeve për të parë nëse kanë ndonjë ditëlindje atë muaj. Po ashtu shohin edhe kalendarin e festave, për të paracaktuar festat që i takojnë asaj periudhe. Priten reagimet e fëmijëve për festën e Vitit të Ri. Më pas, edukatori/ja sjell përpara fëmijëve një shportë të madhe, të mbuluar (në të cilën ka vendosur të gjitha lodrat e buta, lodrat e vogla, libra dhe gjithçka tjetër që ka në kopsht e që lidhet me kafshët).</p> <p>Ai/ajo kërkon nga fëmijët që secili të fusë dorën në shportë e të tërheqë nga një lodër, pa e parë. (Edukatori/ja kujdeset që të ketë aq kafshë sa është numri i fëmijëve.) Kur çdo fëmijë të ketë përpara një kafshë, edukatori/ja hap diskutimin për kafshët, duke pyetur se cila është e preferuara, ku jetojnë ato, çfarë bëjnë gjatë dimrit etj. Fëmijët mund të tregojnë për kafshën që kanë, por edhe për ndonjë tjetër karakteristikë që ai/ajo di për kafshët e tjera.</p>

Kur të gjithë të kenë përfunduar diskutimin, edukatori/ja kërkon nga fëmijët që të shtrihen, të ulen apo të shkojnë në një vend që u pëlqen, për të luajtur lojën e radhës. Edukatori/ja do të vendosë CD-në me tinguj që imitojnë zërat e kafshëve, dhe fëmijët duhet ta gjejnë se cila kafshë ishte. Edukatori/ja lëviz nëpër hapësirën e klasës, në mënyrë që të jetë afër me të gjithë fëmijët.

Pas dëgjimit të zërave e të tingujve, fëmijët do të mësojnë këngën e titulluar "Simfonia e kafshëve". Edukatori/ja duhet të thotë vargjet dhe fëmijët të përsërisin; pas çdo vargu, edukatori/ja drejton pyetje lidhur me atë varg.

Dëgjohet kënga një ose dy herë, duke e shoqëruar me tekstin (mund ta gjeni atë në linkun <https://www.youtube.com/watch?v=ZBr5uNR9IU>).

Me lodrat që kanë përzgjedhur qysh në fillim, por edhe me të tjera, fëmijët do të ndërtojnë mjedisin ku jetojnë kafshët. Lodrat formuese, ata mund t'i kombinojnë edhe me materiale të tjera që gjenden në klasën përgatitore. Kështu, fëmijët do të shprehin lirshëm imagjinatën e tyre dhe do të luajnë lojë të lirë. Nëse ajo hapësirë përdoret vetëm nga një grup edukativ, hapësirat e ndërtuara mund të lihen ashtu, në mënyrë që fëmijët t'i përdorin përsëri, e nëse klasa përdoret nga më shumë se një grup edukativ, atëherë të gjitha hapësirat e lojës në fund duhet të jenë të rregulluara. Përpara përfundimit të ditës organizohet "Turi i galerisë", për të parë punën e të gjitha grupeve.

Vlerësimi:

Vëzhgon fëmijët përgjatë zhvillimit të lojërave dhe mban shënime për situata të veçanta. Ai/ajo dokumenton punën e fëmijëve përmes fotografive apo videove të shkurtra.

Më shumë për të bërë:

Mund të kërkonte për libra që flasin për jetën e kafshëve, në mënyrë që të zgjeroni njohuritë e fëmijëve, por edhe interesin e tyre për kafshët. Kërkonte prej prindërve t'u lexojnë fëmijëve përralla dhe tregime që flasin për jetën e kafshëve.

Reflektimi:

Ku jetojnë kafshët?

Fusha kurrikulare:	Shkencat natyrore
Kurrikula lëndore:	Njeriu dhe natyra
Tema nga plani dymujor:	Bimët, kafshët dhe njeriu
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):	I -3, 6; II -1, 7; III .-2, 3, 6; IV -3; V -5; VI -6
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):	Shkencat natyrore: 3 Gjuhët dhe komunikimi: 1.1; 1.2; 1.4 Matematikë: 6.2
Rezultati i të nxënit të temës:	Përshkruan lidhjen reciproke mes kafshëve dhe njeriut (ushqim, veshmbathje dhe kujdes).
Rezultatet e të nxënit të aktiviteteve:	<ul style="list-style-type: none"> • Emërton së paku 3 kafshë të paraqitura në maket. • Dallon kafshët shtëpiake nga ato të egra.
Kriteret e suksesit:	<ul style="list-style-type: none"> • Emërto së paku 3 kafshë të paraqitura në maket. • Dallo kafshët shtëpiake nga ato të egra.
Burimet dhe materialet:	Ilustrime ose maket me kafshë, kubi me kafshë, kafshët e vogla (lojëra), enciklopedi për kafshët.
Integrimi ndërfaqor:	Gjuhë shqipe, Matematikë.
Çështjet ndërkurrikulare:	Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.
Fjalë kyçe:	Kafshë, shtëpiake, të egra, të buta, fermë, pyll, habitat.
Organizimi i aktiviteteve:	Pasi krijon një rreth të madh, edukatori/ja përshëndet fëmijët, kurse ata përshëndesin njëri-tjetrin. Pas përfundimit të kalendarit, edukatori/ja sjell përpara fëmijëve kubin me 6 kafshë të ndryshme (gjendet në shtojcë, në librin e edukatorit/es) dhe fton fëmijët në "Lojën me kub". Në faqet e kubit janë imazhet e kafshëve; fëmijët rrotullojnë kubin dhe nisin të imitojnë kafshën që paraqitet aty. Edukatori/ja paraqet para fëmijëve një maket me kafshë të ndryshme. Kërkohet nga fëmijët që të mendojnë se si mund t'i klasifikojnë këto kafshë për nga vendi ku ato jetojnë (habitatit i tyre). <i>(Kafshë të egra dhe kafshë shtëpiake)</i>



Ndërsa dëgjon përgjigjet e fëmijëve, tërheq vëmendjen e tyre në karakteristikat dalluese: kafshët shtëpiake jetojnë me njerëz, nuk kanë frikë nga njerëzit; njerëzit krijojnë kushte për jetën e tyre: u ndërtojnë mjedise të përshtatshme për të jetuar, i ushqejnë dhe kujdesen për to. Edukatori/ja përdor termin "habitat". Ai/ajo shpjegon kuptimin e termit dhe vazhdon pyetjet për kafshët e egra, si: "Po kafshët e egra, ku jetojnë? Cilat prej tyre njihni? Kush kujdeset për to?" (Fëmijët shprehin mendimet e tyre, numërojnë kafshët, edukatori/ja thekson se kafshët e egra jetojnë në mënyrë të pavarur, në natyrë, larg njerëzve; e sigurojnë vetë ushqimin, ndërtojnë strofull dhe fole; kujdesen për pasardhësit e tyre).

Edukatori/ja përdor enciklopedinë e kafshëve që fëmijët të shohin llojet e ndryshme të habitateve dhe kërkon prej tyre që të vërejnë se jo të gjitha kafshët e egra jetojnë në të njëjtin vend.

Puna vazhdon nëpër qendrat e aktiviteteve, ku fëmijët do të ndahen në katër grupe:

Grupi i parë do të bëjë klasifikimin e lodrave - kafshët që jetojnë me njeriun dhe ato larg njeriut.

Grupi i dytë do të klasifikojë fotografitë e kafshëve në varësi të habitateve ku jetojnë.

Njërit grup, edukatori/ja i ofron libra/enciklopedi që flasin për jetën e kafshëve. Fëmijët mund t'i përdorin këto informacione dhe të bëjnë një përmbledhje të tyre përmes vizatimit.

Me grupin e katërt, edukatori/ja përgatit një aktivitet, i cili ka të bëjë me sasinë e numrit dhe numërimin.

Në takimin përmbyllës edukatori/ja bashkë me fëmijët bëjnë një përmbledhje të punës së bërë gjatë ditës.

Vlerësimi:

Vëzhgon fëmijët përgjatë zhvillimit të lojërave dhe mban shënime për situata të veçanta.

Më shumë për të bërë:

Fëmijët mund të shfletojnë libra në formë të pavarur, për t'u njohur më shumë me jetesën e kafshëve, me mënyrën se si rriten dhe ushqehen.

Reflektimi:

Dhuratat që marrim nga kafshët shtëpiake

Fusha kurrikulare:	Gjuhët dhe komunikimi
Kurrikula lëndore:	Gjuha shqipe
Tema nga plani dymujor:	Tinguj, shkronja, rrokje, fjalë, fjali
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):	I-3, 5; II.1, 7; III-2, 6; IV.4; V-2, 5; VI.6
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):	Gjuhët dhe komunikimi: 1.1; 1.2; 1.3; 1.4; 3.2 Artet: 1 Matematikë: 3.1
Rezultati i të nxënit të temës:	Flasin, parafrazojnë, ritregojnë dhe recitojnë.
Rezultatet e të nxënit të aktiviteteve:	<ul style="list-style-type: none"> • Tregon së paku tri produkte që vijnë prej kafshëve. • Modelon me materiale të ndryshme shkronjën K. • Gjen fjalë sipas tingullit të kërkuar.
Kriteret e suksesit:	<ul style="list-style-type: none"> • Trego së paku tri produkte që vijnë prej kafshëve. • Gjej fjalë sipas tingullit të kërkuar. • Modelo me materiale të ndryshme shkronjën K.
Burimet dhe materialet:	Libri "Të shoqërohem me kafshët" nga Mirela Kraja, libri "Enciklopedia e kafshëve", shkopinj të vegjël, kokrra misri, guralecë, penj të trashë, petëza të vogla katrore, libri i fëmijës.
Integrimi ndërfaqor:	Edukatë figurative, Matematikë.
Çështjet ndërkurrikulare:	Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.
Fjalë kyçe:	Ferma, kafshët (lopa, delja, kali, gomari etj.), shkronja K, produktet (dhuratat që marrim) nga kafshët (qumështi, djathi, kosi, mishi, lesi etj.).
Organizimi i aktiviteteve:	Në fillim të ditës, edukatori/ja i mbledh fëmijët në rreth; pas përshëndetjes dhe kalendarit ditor, ftohen fëmijët të luajnë lojën "Macja dhe minjtë".
	<p>Rregullat e lojës:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Njëri nga fëmijët do të luajë rolin e maces, kurse fëmijët e tjerë do të jenë në rolin e minjve. • Macja do të "flejë" në një kënd të klasës, ndërsa fëmijët e tjerë do të fshihen pas objekteve të ndryshme (nën banka, nën karrige, prapa ndonjë rafti etj.). Edukatori/ja do të sigurohet që fëmijët të gjejnë një kënd, i cili nuk përbën rrezik lëndimi për ta. • Minjtë dalin nga vrimat kur edukatori/ja i bie borisë. Macja "zgjohet nga gjumi" dhe përpiket të zërë ndonjërin. • Fëmija që kapet, vendoset në rolin e maces. • Loja përfundon atëherë kur zihen të gjithë fëmijët.

Pas përfundimit të lojës, fëmijët kthehen përsëri në rreth. Edukatori/ja merr librin "Enciklopedia e kafshëve" dhe së bashku me fëmijët interpreton atë që sapo shohin të paraqitur, duke bërë krahasim cila është kafshë e egër, cila shtëpiake dhe çfarë dobish kemi nga kafshët shtëpiake.

Më pas, edukatori/ja ua lexon fëmijëve tregimin "Dhuratat nga kafshët shtëpiake" (libri "Të shoqërohemi me kafshët" nga Mirela Kraja). (Ju mund të lexoni edhe ndonjë tregim tjetër, që flet për dobinë nga kafshët shtëpiake). Gjatë fazës së leximit të tregimit, ai/ajo u drejton pyetje fëmijëve: Ku zhvillohet ngjarja? Për cilën kafshë flitet? Ç'dhurata marrim nga kafshët? Apo edhe pyetje për personazhet e tregimit.

Nga tregimi, edukatori/ja kalon te shkronja K, duke pyetur fëmijët se me cilin tingull fillon fjala "kafshë". Gjejnë së bashku fjalë që fillojnë me këtë tingull, fjalët e gjetura i ndajnë në rrokje, duke ecur dhe duke numëruar sa rrokje janë. Edukatori/ja parqet simbolin e shkronjës K dhe fëmijët ndahen në grupe të vogla.

Një grup do të modelojë me materiale të natyrës (shkopinj të vegjël, kokrra misri, guralecë, penj të trashë) për modelimin e shkronjës K.

Njëri grup do të plotësojë fletëzat tek shkronja K.

Grupi tjetër, me materialet e përgatitura nga edukatori/ja, do të shoqërojë "dhuratat" me kafshët nga të cilat i marrim ato.

Ndërsa grupi tjetër do të presë fotografi me produktet ushqimore që merren nga kafshët dhe do t'i klasifikojë.

Pas përfundimit të detyrës, fëmijët kthehen përsëri në rreth dhe vjen çasti për të rikujtuar aktivitetet e bëra gjatë ditës.

Vlerësimi: Fëmijët do të vlerësohen bazuar në kriteret e vendosura në fletëzat vlerësuese, sipas planit të vlerësimit të hartuar nga edukatori/ja.

Më shumë për të bërë: Mund të sillni në klasën përgatitore kuti bosh qumështi, djathi, kosi e të tjera produkte si këto, dhe të diskutoni mbi ushqimet që marrim nga kafshët. Kërkoni nga fëmijët që një ditë më parë të përgatiten për të sjellë në klasën përgatitore ndonjë paketim ushqimi që ka të bëjë me "dhuratat" që na japin kafshët.

Reflektimi:

Kafsha ime e preferuar

Fusha kurrikulare:	Shoqëria dhe mjedisi
Kurrikula lëndore:	Shoqëria dhe mjedisi
Tema nga plani dymujor:	Unë vendos për veten time
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):	I-3; II. 1, 7; III. 1, 2, 3, 6; IV. 3; V 2, 5; VI. 6
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):	Shoqëria dhe mjedisi: 4.1 Gjuhët dhe komunikimi: 1.1; 1.2; 1.3; 1.4 Edukim fizik, sportet dhe shëndeti: 1; Jeta dhe puna: 2.9.1
Rezultati i të nxënit të temës:	Argumenton në mënyrën e vet vendimet e tij/saj gjatë lojës dhe aktiviteteve të tjera të përditshmërisë.
Rezultatet e të nxënit të aktiviteteve:	<ul style="list-style-type: none"> • Ritregon me fjalët e tij/saj tregimin e dëgjuar. • Argumenton në mënyrën e tij/saj përse i pëlqen një kafshë e caktuar. • Krijon me materiale të ndryshme kafshën e preferuar.
Kriteret e suksesit:	<ul style="list-style-type: none"> • Ritrego me fjalët e tua tregimin e dëgjuar. • Argumento në mënyrën tënde përse të pëlqen një kafshë e caktuar. • Krijon me materiale të ndryshme kafshën e preferuar.
Burimet dhe materialet:	Ilustrime kafshësh, letra të bardha dhe me ngjyra, kuti qumështi, kuti/shishe kosi, role letre të butë, sy plastikë, gërshtë, ngjitës, copëza materialesh, pambuk, karton i trashë, kuti vezësh, ngjyra uji, furça.
Integrimi ndërfaqor:	Gjuhë shqipe, Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti, Shkathtësi për jetë.
Çështjet ndërkurrikulare:	Edukimi për qytetari demokratike.
Fjalë kyçe:	Lloj kafshe, krijim, plan i krijimit, materiale të ndryshme, e preferuar.
Organizimi i aktiviteteve:	<p>Dita fillon me përshëndetje miqësore me njëri-tjetrin, edukatori/ja pyet fëmijët se si janë, dhe bashkërisht zhvillojnë kalendarin ditor. Më pas, edukatori/ja fton fëmijët për të luajtur lojën “Çfarë është pikturuar?”. Para tyre paraqiten imazhe të kafshëve, ku $\frac{3}{4}$ e ilustrimit është e mbuluar me letër të bardhë dhe fëmijët duhet ta gjejnë cila kafshë është.</p> <p>Fëmijët ndahen në dy skuadra dhe zënë vendet e tyre në karrige. Edukatori/ja shpjegon rregullat e lojës. Duhet të zbulohet sa më shpejt të jetë e mundur ç’pikturë është mbuluar me fletë. Lojën e fiton ekipi që ka gjetur më shumë kafshë.</p> <p>Më pas, edukatori/ja u lexon tregimin “Kafsha shtëpiake e preferuar” (libri “Të shoqërohem me kafshët” nga Mirela Kraja), leximi bëhet me ndalesa, duke diskutuar për personazhet e tregimit dhe veprimet e tyre kundrejt kafshëve. Fëmijët do të ritregojnë me fjalët e tyre tregimin, do të diskutojnë rreth dëshirave të tyre dhe do të argumentojnë: Cilën kafshë do të donit t’ju dhuronin për ditëlindje?</p>

Fëmijët japin përgjigje dhe motivohen vazhdimisht për të vijuar më tej me përgjigjet e tyre.

Fëmijët do të ndërtojnë me materiale të ndryshme kafshën e tyre të preferuar. Edukatori/ja i vendos të gjitha materialet në një hapësirë të dukshme, në mënyrë që fëmijët të kenë mundësi t'i zgjedhin vetë ato që u duhen për ndërtimin e kafshës së tyre. Edukatori/ja kërkon nga fëmijët që fillimisht të bëjnë një plan ndërtimi, ku do të mendojnë për mënyrën e ngjitjes, mbështjelljen, ngjyrën dhe më pas të fillojnë nga puna.

Edukatori/ja ndihmon fëmijët (sipas nevojës) gjatë prerjes së kutive të kartonit.

Në fund të ditës, fëmijët mund të ekspozojnë punën e tyre dhe ta ndajnë atë me të tjerët.



Vlerësimi: Fëmijët do të vlerësohen sipas kriterëve të vendosura në listat e kontrollit, sipas planit të vlerësimit nga edukatori/ja.

Më shumë për të bërë: Edukatori/ja, në bashkëveprim dhe bashkëpunim me prindërit, mund të organizojë një ditë vizite me fëmijët në fermë. Fëmijët mund të njihen nga afër me trajtimin e kafshëve, karakteristikat e tyre, si dhe me dobitë që kemi nga to.

Reflektimi: _____

Ndajmë kafshët në grupe

Fusha kurrikulare:	Matematikë
Kurrikula lëndore:	Matematikë
Tema nga plani dymujor:	Numrat natyrorë
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):	I-3; II-1, 7; III-1, 2, 3, 6; IV-3; V 2, 5; VI-6
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):	Matematikë: 5.1 Gjuhët dhe komunikimi: 1.1; 1.4 Edukim fizik, sportet dhe shëndeti: 1
Rezultati i të nxënit të temës:	Kopjon/vizaton, modelon numrat nga 1 deri në 10.
Rezultatet e të nxënit të aktiviteve:	<ul style="list-style-type: none"> • Identifikon paraqitjen grafike me përbërjen sasiore të numrit 4. • Realizon përbërjen sasiore të numrit 4. • Identifikon kafshët në varësi të habitatit ku jetojnë.
Kriteret e suksesit:	<ul style="list-style-type: none"> • Identifikon paraqitjen grafike me përbërjen sasiore të numrit 4. • Realizo përbërjen sasiore të numrit 4. • Identifikon kafshët në varësi të habitatit ku jetojnë.
Burimet dhe materialet:	Foto ilustruese të kafshëve (të prera nga revistat e ndryshme), ngjyra, materiale të ndryshme, fletë A4 dhe fletë e madhe A0, libri i punës, tabela plastike e fëmijës.
Integrimi ndërfaqor:	Gjuhë shqipe, Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti.
Çështjet ndërkurrikulare:	Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.
Fjalë kyçe:	Kafshë, numri 4, grafiku i numrit 4, grupim, produkt.
Organizimi i aktiviteve:	<p>Takimi fillon me përshëndetjet në rreth, më pas bëhet ndërrimi i kalendarit të ditës, moti. Edukatori/ja paraqet përpara fëmijëve një kuti dhe, për t'u tërhequr vëmendjen, drejton pyetjen:</p> <p>“Si mendoni, çfarë mund të ketë në këtë kuti?”</p> <p>Edukatori/ja fton fëmijët të luajnë lojën “Ndajmë kafshët në grupe”. Ai/ajo ka përgatitur më parë foto të kafshëve të ndryshme dhe i ka vendosur në një kuti. Fëmijët do të marrin nga një secili dhe më pas do të emërtojnë kafshën. Do të flasin për të dhe do ta klasifikojnë në grupin përkatës, si: Kafshët shtëpiake që jetojnë nëpër ferma; Kafshët e egra të pyllit; Kafshët që jetojnë në zona polare; si dhe Kafshët që jetojnë në mjedis ujor. Kështu do të krijohen katër grupe kafshësh.</p> <p>Edukatori/ja fillimisht kërkon që fëmijët të grupohen sipas grupit të kafshës që kanë në dorë. Në këtë mënyrë, ata do të formojnë katër grupe kafshësh që jetojnë në habitate të ndryshme.</p>

Pasi fëmijët shprehin mendimet e tyre, edukatori/ja u kërkon të tregojnë sa grupe janë gjithsej, duke numëruar me gishtërinj. Sipas grupeve, fëmijët i ngjisin kafshët në një fletë dhe më pas fletët nga katër grupet bashkohen në një të madhe dhe ekspozohen në një kënd të klasës.

Mbi modelin e katër habitateve të ndryshme, edukatori/ja integron numrin 4, duke pyetur fëmijët që të listojnë 4 kafshë që atyre iu pëlqejnë më shumë. Për ushtrimin e grafikut 4 ofrohen katër pjata me miell, sheqer etj., dhe pas praktikimit, fëmijët do të ndahen në grupe të vogla pune:

Njëri grup do të plotësojë fletëzën tek numri katër.

Njëri grup do të bashkojë shkronjat me kafshët.

Njëri grup do të bashkojë kafshët me të vegjlit e tyre.

Dhe grupi tjetër do të bashkojë kafshët me habitatet e tyre.

Në fund të ditës, në takimin përmbyllës luhet "Loja me pantomima", ku njëri/a nga fëmijët do të imitojë lëvizjen e një kafshe, ndërsa fëmijët e tjerë do të përpiqen ta gjejnë atë.

Vlerësimi:

Fëmijët do të vlerësohen për shkathtësitë e tyre ndërvepruese gjatë aktivitetit për përcaktimin e fotografive të kafshëve që jetojnë në të njëjtin habitat. Edukatori/ja vëzhgon po ashtu edhe shkathtësitë e fëmijëve në aktivitetet e tjera.

Më shumë për të bërë:

Mund të luani edhe ndonjë lojë dramatike me kukulla, me kafshë të vogla, me të cilat fëmijët mund të ndërtojnë një histori të shkurtër.

Reflektimi:

Receta e miqësisë fantastike

Fusha kurrikulare:	Shoqëria dhe mjedisi
Kurrikula lëndore:	Shoqëria dhe mjedisi
Tema nga plani dymujor:	Përgjegjësitë e mia
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):	I -3.8; II -7; III -1, 2, 3, 6; IV -3. 4; V -5, 6; VI -4, 6
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):	Shoqëria dhe mjedisi: 1.1.2 Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti: 2.2 Gjuhët dhe komunikimi: 1.1; 1.4; 1.6 Matematikë: 3.1
Rezultati i të nxënit të temës:	Tregon për fjalët, sjelljet dhe veprimet e veta në raport me të tjerët dhe merr përgjegjësi për to.
Rezultatet e të nxënit të aktiviteve:	<ul style="list-style-type: none"> • Identifikon faktorët që ndikojnë në krijimin e raporteve të mira shoqërore të "receta e shoqërisë fantastike". • Vlerëson situatat problematike në shoqëri, gjatë lojërave që krijon edukatori/ja. • Kërçen në çift duke mbajtur topin lart.
Kriteret e suksesit:	<ul style="list-style-type: none"> • Identifikoj faktorët që ndikojnë në krijimin e raporteve të mira shoqërore të "receta e shoqërisë fantastike". • Vlerëso situatat problematike në shoqëri, gjatë lojërave që krijon edukatori/ja. • Kërce në çift duke mbajtur topin lart.
Burimet dhe materialet:	Dy kukulla për dramatizim (<i>puppets</i>), fletë A2, revista të vjetra për prerje, gërshërë, topa.
Integrimi ndërfaqor:	Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti, Gjuhë shqipe, Matematikë.
Çështjet ndërkurrikulare:	Edukim për qytetari demokratike.
Fjalë kyçe:	Miqësi, recetë, përbërës, mirësi, sjellje, besim.
Organizimi i aktiviteve:	<p>Mblidhemi në takimin e përbashkët, ku pas leximit të kalendarit dhe ndarjes së përvojave individuale nga dita paraprake, vazhdojmë me lojën "Lëvizjet e shokut/shoqes".</p> <ul style="list-style-type: none"> • Fëmijët ngrihen në këmbë dhe formojnë një rreth. • Ju futeni në rreth dhe e filloni lojën duke kënduar këngën "A do t'jesh shoku im?" (përdorni melodinë e këngës "Meri ka një qengj të vogël") dhe, duke e drejtuar gishtin nga njëri prej fëmijëve të grupit, i cili ju bashkohet brenda rrethit: <p><i>A do t'jesh shoku im?</i> <i>Shoku im, shoku im;</i> <i>A do t'jesh shoku im?</i></p>

Eja _____ me mua në rreth.

(Mbushe hapësirën më sipër me veprime, si: kërcen, rrotullohet, tundet, vallëzon etj.)

- Fëmija i dytë që hyn në rreth këndon këngën dhe fton fëmijën e tretë.
- Kështu vazhdon loja, derisa të gjithë fëmijët të jenë duke kërcyer brenda në rreth.

Pas këtij aktiviteti, fëmijët ulen dhe, për një minutë, qetësohen duke praktikuar frymëmarrjen e thellë (këshillohet që në përshtatshmëri me klimën që keni, dritaret e klasës të jenë të hapura, kur përdorim teknika qetësuese me frymëmarrje). Kur fëmijët të kenë qetësuar frymëmarrjen, paraqitni para tyre dy kukulla, me të cilat do të improvizoni një situatë problematike që e keni vërejtur te fëmijët e grupit.

Kjo ju jep mundësinë të përcillni në mënyrë të tërthortë mesazhin që dëshironi të marrin fëmijët për sjelljen e mirë shoqërore.

Për shembull: mund të luani rolin e dy fëmijëve të cilët nuk kanë dëshirë t'i ndajnë gjërat, apo një rast kur dy fëmijë nuk pranojnë një fëmijë të tretë në shoqëri; dy fëmijë duan të njëjtën lodër, apo situata të tilla që ndeshen shpesh te fëmijët.

Kur të ketë përfunduar shfaqja me kukulla, fëmijët bisedojnë rreth saj dhe se çfarë kanë mësuar nga situata. Edukatori/ja bën pyetje të hapura dhe nxit fëmijët për pjesëmarrje aktive në bashkëbisedim.

Bashkërisht vendosim të shpikim një recetë, e cila do të ketë disa përbërës. Me bashkimin e këtyre përbërësve, ne do të kemi një shoqëri fantastike. Kjo recetë do të qëndrojë e varur në murin e klasës, në mënyrë që fëmijët ta shohin dhe ta rikujtojnë sa herë të kenë nevojë.

Edukatori/ja merr një fletë A2, në të cilën shkruan titullin "Receta e shoqërisë fantastike", dhe tok me fëmijët vendosin se cilët përbërës nevojiten për të pasur një shoqëri të mirë, si: për shembull:

- Mirësjellje;
- Dashuri;
- Sinqeritet;
- Dëshirë e mirë për t'i ndarë gjërat me njëri-tjetrin;
- Tolerancë.

Përmes ilustrimeve të ndryshme, fëmijët së bashku me edukatorin/en vizualizojnë përbërësit e përmendur.

Tani numërojmë përbërësit që na duhen e fillojmë t'i numërojmë sipas radhës: i pari, i dyti, i treti etj. Kur të gjithë fëmijët t'i kenë numëruar dhe thënë sipas rendit, e vendosim punimin në një kënd të dukshëm për fëmijët.

Shpjegohet për rëndësinë e shoqërisë dhe se si ka rrjedhur historikisht, qysh në kohët e lashta, kur njerëzit filluan të jenë më të dobishëm me krijimin e shoqërive. Sa e rëndësishme është të jemi qytetarë të përgjegjshëm si pjesëtarë të shoqërisë sonë? Si ndikon në jetën tonë prania e miqve, cilat janë dobitë?

Fëmijët marrin revista te këndi i materialeve të ripërdorshme dhe presin fotografi të ndryshme, me të cilat do të krijojnë nga një histori miqësie. Kriteri është që historia të ndërtohet vetëm me pesë fotografi. Kur

fëmijët të kenë përfunduar punën e tyre, edukatori/ja i fton me radhë të komentojnë historinë e tyre para grupit.

Në takimin e përbashkët diskutojmë rreth përbërësve të recetës së shoqërisë fantastike, kujtojmë, numërojmë dhe flasim për miqtë secili me radhë. Tani secili fëmijë i jep një mesazh pozitiv shokut/shoqes që ka në krahun e djathtë dhe me marrjen e mesazheve pozitive, lëshojmë muzikë argëtuese dhe ftojme fëmijët të kërcëjnë.

- Fëmijët kërcëjnë dy nga dy, duke mbajtur një top bashkë me shokun/shoqen.

Pas kërcimit, përshëndetemi miqësisht dhe përmbjllim ditën.

Vlerësimi:

Fëmijët vëzhgohen gjatë pjesëmarrjes aktive në bashkëbisedim gjatë aktivitetit "Receta e shoqërisë fantastike". Po ashtu përgëzohen dhe për aftësinë e përshtatjes në grup e në çift.

Më shumë për të bërë:

Në një kënd të klasës, edukatori/ja mund të vendosë një kavanoz qelqi, në të cilin do të fusë fletëza ku janë shkruar sjelljet vërtet të veçanta në kontributin për ta bërë shoqërinë më të mirë. Këto letra mblidhen dhe lexohen një herë në muaj. Kjo ndikon në vlerësimin e sjelljes së mirë dhe nxit të tjerët për të vepruar njësoj.

Reflektimi:

“M” për miqësinë

Fusha kurrikulare:	Gjuhët dhe komunikimi
Kurrikula lëndore:	Gjuhë shqipe
Tema nga plani dymujor:	Tinguj, shkronja, rrokje, fjalë, fjali
Rezultatet e të nxëniet për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):	I -3, 4, 5, 8; II -7; III -1, 2, 3, 6; V -5, 6; VI -6
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):	Gjuhët dhe komunikimi: 1.1; 1.2; 1.4; 1.5; 3.2 Matematikë: 3.1 Shkencat e natyrës: 3.1 Artet: 2
Rezultati i të nxëniet të temës:	Identifikojnë mjetet e komunikimit dhe të teknologjisë. Me ndihmën e të rriturve, i përdorin ato.
Rezultatet e të nxëniet të aktiviteteve:	<ul style="list-style-type: none"> • Ritregon historinë “Macja dhe miu” duke dhënë vlerësim mbi miqësinë e tyre. • Plotëson librin e fëmijës për shkronjën “M”. • Identifikon zërat e incizuar me përdorimin e teknologjisë.
Kriteret e suksesit:	<ul style="list-style-type: none"> • Ritrego historinë “Macja dhe miu”. Si ishte miqësia e tyre? • Plotëso librin e punës për shkronjën “M”; • Duke përdor teknologjinë qëllo zërin e shokut/shoqes.
Burimet dhe materialet:	Tregimi “Macja dhe miu”, fletë, laps shënjues, ngjyra, një aparat për incizimin e zërit (celular, tablet etj.)
Integrimi ndërfaqshor:	Matematikë, Njeriu dhe natyra, Edukatë muzikore.
Çështjet ndërkurrikulare:	Edukimi për media.
Fjalë kyçe:	Shkronja “M”, miqësi, incizim, identifikim, zëri.
Organizimi i aktiviteteve:	<p>Takimi i përbashkët fillon me një përshëndetje mirëseardhjeje dhe me një këngë ritmike, pas së cilës lexojmë kalendarin dhe flasim për: rrugën që bëjnë fëmijët nga shtëpia në klasën përgatitore, me çfarë udhëtojnë, më kë vijnë, a kanë ndonjë shok/shoqe me vete, kush janë ata, a sillen gjithmonë mirë me njëri-tjetrin, a janë gjithmonë të një mendjeje, nëse jo, a gjejnë lehtësisht një zgjidhje të mirë për të dyja palët etj. Pasi fëmijët të japin komentet e tyre, lexojmë tregimin “Historia e macës dhe e miut” dhe pas leximit ftojme fëmijët në komentimin e ngjarjes dhe nxisim bashkëbisedim rreth miqësisë.</p> <p>M-macja, M-miu, M-miqësia. A mund të thoni se me cilën shkronjë fillojnë këto fjalë? “Shkronja jonë e re është shkronja M”.</p> <p>Fëmijët përmendin fjalë me shkronjën “M”, Edukatori/ja së bashku me fëmijët numëron numrin e fjalëve që ata thonë.</p> <p>Më pas fëmijët do të punojnë në mënyrë individuale për plotësimin e librit të punës, shkronja “M”.</p>

Pasi të kenë përfunduar punën në libër, fëmijët mund të luajnë me blloqet ndërtuese, duke punuar në grupe nga një park lodrash për fëmijë. Pas ndërtimit të parkut, ata/ato do të luajnë brenda parkut që kanë ndërtuar.

Pas përfundimit të lojës, edukatori/ja bashkë me fëmijët shkojnë te këndi i shkencës, ku së bashku do të luajnë lojën "Zëri i kujt është ky?".

Materialet e nevojshme:


Një incizues zëri (mund të jetë telefon celular, tablet etj.);

Fletë e bardhë;

Laps shënjuës (marker);

Ngjyra.

Ecuria:



- Edukatori/ja shpjegon në mënyrë të qartë dhe të thjeshtë përdorimin e pajisjes elektronike për incizimin e zërit. Të gjithë fëmijët me radhë e provojnë/testojnë para fillimit të lojës.
- Vizatojmë një tabelë me aq rubrika sa ka fëmijë në grup, dhe në secilën rubrikë shkruhet emri i secilit fëmijë.
- Fëmijët me radhë incizojnë zërin e tyre duke thënë: "Përshëndetje! Jam shoku/shoqja juaj i/e klasës, a mund ta gjeni se kush jam?"
- Fëmijët që identifikojnë zërin e shokut/shoqes, mbushin me ngjyrë nga një hapësirë në rubrikën e emrit të tyre në tabelë.
- Në fund shikojmë dhe analizojmë të dhënat që na kanë dalë nga kjo lojë, i numërojmë dhe i krahasojmë, përsërisim hapat e përdorimit të teknologjisë dhe diskutojmë për çfarë tjetër hyn në punë një pajisje teknologjike për incizimin e zërit.

Në takimin e përbashkët përsërisim tregimin për miqësinë e maces dhe miut. Fëmijët rikujtojnë historinë dhe e interpretojnë mesazhin; përsërisim shkronjën e mësuar dhe diskutojmë për eksperimentin e identifikimit të zërit. A është e vështirë të përdoret teknologjia? Përse shërben incizimi i zërit? Si dallojnë zërat nga njëri-tjetri? Etj.

Vlerësimi:

Komentet e historisë "Macja dhe miu" na mundësojnë të vlerësojmë sa janë fëmijët dëgjues aktivë, sa mendojnë në mënyrë kritike, sa mund t'i ripërsërisin historitë e dëgjuara, si dhe a mund të nxjerrin mesazhin që përcjell kjo histori.

Vlerësohet puna e fëmijëve te libri i punës. Mbikëqyren fëmijët gjatë punës së tyre në përdorimin e teknologjisë, sa janë në gjendje të identifikojnë zërat e dëgjuar etj.

Më shumë për të bërë:

Fëmijët mund të modelojnë shkronjën "M" me materiale të ndryshme në shtëpi.

Reflektimi:

5 fjalë të bukura për mikun tim


Fusha kurrikulare:	Matematikë
Kurrikula lëndore:	Matematikë
Tema nga plani dymujor:	Numrat natyrorë
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):	I-3; II-7; III-1, 2, 3, 4, 6; IV-2; V-5; VI-6
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):	Matematikë: 5.1 Gjuhët dhe komunikimi: 1.1; 1.4; 1.5; 3.2 Artet: 1
Rezultati i të nxënit të temës:	Vlerëson përmes formave të ndryshme (shikimit, të prekurit) një grup prej 2-5 objektesh.
Rezultatet e të nxënit të aktiviteteve:	<ul style="list-style-type: none"> • Stampon dorën në punimin “Ne jemi një rreth me miq”. • Konstrukton me pesë blloqe duke u bazuar në modelin e dhënë. • Lidh numrin me sasinë përkatëse.
Kriteret e suksesit:	<ul style="list-style-type: none"> • Stampo dorën me ngjyrë duke formuar kështu rrethin tënd miqësor. • Ndiq modelin e dhënë dhe konstrukto me blloqe. • Lidh numrin e miqve me numrin përkatës.
Burimet dhe materialet:	Katron i madh me ngjyrë të lehtë, ngjyra uji, libri i fëmijës, fletëza pune, fletë e madhe, blloqe të vogla ndërtimi.
Integrimi ndërfaqor:	Gjuhë shqipe, Edukatë figurative.
Çështjet ndërkurrikulare:	Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.
Fjalë kyçe:	Numri 5, stampim dore, model, miq.
Organizimi i aktiviteteve:	<p>Në takimin e përbashkët mbledhemi me përshëndetje miqësore dhe flasim për përvojat e fëmijëve nga dita e kaluar, duke e vënë theksin te miqësia. Diskutojmë për faktorët që na bëjnë miq të mirë dhe se sa i rëndësishëm është rrethi shoqëror.</p> <p>“Ne sot, bashkërisht, do të lëmë gjurmët e rrethit shoqëror në klasën tonë përgatitore, duke dhënë premtime për miqësi të mirë, bashkëpunim dhe mirëbesim te njëri-tjetri”.</p> <p>“Ne jemi një rreth me miq”</p> <p><i>Materialet:</i></p> <p>Një fletë e madhe konstruktive, ngjyra për stampim.</p> <p><i>Ecuria:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • Në mes të rrethit vendosim një fletë të madhe konstruktive, në të cilën fëmijët do të stampojnë duart e tyre me ngjyra në formë rrethore, ku



si përfundim do të shfaqet një rreth i madh me duar shumëngjyreshe që paraqet rrethin tonë shoqëror.

- Secili fëmijë shkruan emrin e tij pranë dorës që ka stampuar.
- Punimin e analizojmë bashkërisht dhe e komentojmë.
- Secili fëmijë jep nga pesë komente pozitive për shokun/shoqen.
- Në përfundim, punimi ekspozohet në këndin e artit.

Duke iu drejtuar punimit të bërë, edukatori/ja bashkë me fëmijët numërojnë duart e stampuara dhe duke u bazuar në renditjen e duarve siç janë në punim, fillon dhe ndan fëmijët në grupe me nga pesë pjesëtarë për aktivitetin e radhës.



Pasi të kemi formuar grupe me nga pesë fëmijë (varësisht nëse kjo është e realizueshme për grupin tuaj, në të kundërtën i ndani sipas strukturës që ka grupi), iu japim fëmijëve fletëzën nga libri i fëmijës, në të cilën do të ndërtojnë me blloqe sipas modelit të dhënë.

Kur të gjithë të kenë përfunduar punën me blloqe, fëmijët mblidhen bashkë me edukatoren/in dhe analizojnë rezultatet. Kështu arrihet te numri me të cilin do të njihen sot numri "5". Fëmijët kalojnë në punë individuale të libri i punës. Pas punës individuale, mblidhen të gjithë për takimin përmbyllës, diskutojmë punën e bërë, rrethin miqësor, komentet që morën nga njëri-tjetri.

Përsërisim numrin, duke numëruar para dhe pas deri në pesë, dhe bashkërisht, si një rreth miqsh, përhëndetemi për t'u takuar sërish të nesërmen.

Vlerësimi:

Sipas planit të vlerësimit, edukatori/ja plotëson lista të kontrollit sipas planifikimit të tij/saj.

Më shumë për të bërë:

Fëmijët mund të argëtohen me lojëra matematikore kompjuterike në linkun e bashkëngjitur: <https://pbskids.org/games/math>

Reflektimi:

Gara miqësore

Fusha kurrikulare:	Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti
Kurrikula lëndore:	Edukim fizik, sportet dhe shëndeti
Tema nga plani dymujor:	Lojërat dhe pushimi
Rezultatet e të nxënimit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):	I-3; III. 3, 7; IV-3; V- 2, 5; VI- 3, 6
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):	Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti: 2, 2 Gjuhët dhe komunikimi: 1.1; 1.4; 1.5 Matematikë: 3.5 Artet: 1
Rezultati i të nxënimit të temës:	Praktikon lojëra dhe aktivitete fizike në bashkëpunim në çift dhe në grup.
Rezultatet e të nxënimit të aktiviteteve:	<ul style="list-style-type: none"> • Luajnë lojë sfiduese si ekip, duke bërë lëvizje në hapësirë sipas numrit të kubit. • Gjen shokun/shoqen në lojën "Gjeje kush mungon". • Përshkruan çfarë e bën të veçantë mikun/en e tij/saj.
Kriteret e suksesit:	<ul style="list-style-type: none"> • Gjuaj kubin dhe lëviz aq hapësira sa numri i rënë. • Gjej shokun/shoqen që mungon në lojën "Gjeje kush mungon". • Përshkruaj çfarë e bën të veçantë mikun/en tënd/e.
Burimet dhe materialet:	Kube, litar, lodra.
Integrimi ndërfaqor:	Gjuhë shqipe, Matematikë, Edukatë muzikore.
Çështjet ndërkurrikulare:	Globalizimi dhe ndërvarësia.
Fjalë kyçe:	Miq, lojë, garë, sfidë, miqësore.
Organizimi i aktiviteteve:	<p>Në takimin e përbashkët, menjëherë pas leximit të kalendarit, fëmijët ngrihen dhe formojnë një rreth, duke u kapur dorë për dorë.</p> <p>Sqarojmë që dita e sotme është e mbushur plot me lojëra miqësore. Luhet loja: "A do t'jesh ti shoku im?"</p> <ul style="list-style-type: none"> • Fëmijët qëndrojnë të kapur dorë për dorë në një rreth dhe ngrenë duart për të bërë dritare. • Një fëmijë pastaj endet brenda dhe jashtë dritareve, ndërsa të gjithë këndojnë një këngë. • Në fund të çdo përsëritjeje të këngës fëmija tregon për personin që ka më afër, e kap për dorë dhe bashkë me të kalon përmes dritares. • Përsëriteni në këtë mënyrë, me fëmijën e sapozgjedhur, secili që ka një kthesë për të udhëhequr zinxhirin në rritje të miqve përmes dritareve, derisa të zgjidhen të gjithë.



- Edukatori/ja , i/e cili/a ka mbetur e fundit, mund të bëjë një "urë" mbështetur në mur. Pastaj fëmijët kalojnë nën këtë "urë".

(Përdor melodinë e këngës "Meri ka një qengj të vogël".)

Mund të këndonit këngën:

*"A do t'jesh ti shoku im?
shoku im, shoku im?
Nëse je ti shoku im,
Kapu, eja ti pas meje."*

Kur të kemi fëmijët e rrethuar në formë gjarpërore e ndalim muzikën dhe ngrijmë. Ndajmë rreshtin në gjysmë dhe fitojmë dy skuadra që emërtohen vetë dhe kalojmë në lojën:

"Loja me tabelë"

Përdorni tabelën dhe kubin e bashkëngjitur të materialeve të edukatorit/es.

Në hapësirat e ndryshme vendosni skeda me pyetje që ju mendojnë se janë të përshtatshme për temën e miqësisë (p.sh.: Cilët janë përbërësit e recetës së miqësisë fantastike? Çfarë rëndësie ka rrethi shoqëror të ne? Nëse dy miq duan të ulen në të njëjtin vend dhe për këtë arsye janë gati të zihen, çfarë do t'u rekomandonit ju? Etj.)

Në fund të lojës kemi një skuadër fituese, dhe kjo është një mundësi e mirë që të nxiten fëmijët ta pranojnë fitoren e njëri-tjetrit dhe të edukohen të përgëzojnë skuadrat e tjera. Një mënyrë e mirë për të mbajtur klimën pozitive në klasë edhe pas humbjes është të filloni një lojë të re dhe të përzieni grupet, për të mos fuqizuar vetëm një skuadër. Pas lojës me skuadra vazhdojmë me lojën "Kush mungon?"

Nën ritmin e muzikës, fëmijët vallëzojnë në rreth me sytë mbyllur. Pas pak, edukatori/ja fsheh njërin nga fëmijët dhe ndal muzikën. Së bashku me muzikën fëmijët ndalin lojën dhe hapin sytë. Tregojnë emrin e shokut/shoqes që mungon nga grupi.

Pas lojës me muzikë, fëmijët luajnë lojë të lirë nëpër qendrat e aktiviteteve. Edukatori/ja ka pajisur qendrat me materiale stimuluese, të cilat mund të përdoren nga fëmijët sipas interesave të tyre.

Në takimin përmbyllës, nxitim fëmijët të tregojnë përvojën e tyre gjatë asaj dite me lojërat miqësore: si ndihen kur fitojnë/humbin; a ndihen më rehat në lojën individuale apo në grupe; a e mbështetën sa duhet njëri-tjetrin; pse është e rëndësishme kjo, dhe pyetje të ngjashme.

Vlerësimi:

Fëmijët vlerësohen për shkathtësitë e tyre komunikuese/shprehëse në lojën me tabelë dhe për shkathtësitë e tyre sociale në lojërat grupore; a arrijnë të përshtaten në grupe, sa ndërveprojnë me njëri-tjetrin etj.

Më shumë për të bërë:

Nxiten prindërit që të lexojnë ndonjë libër apo të shikojnë ndonjë film, i cili ka për temë miqësinë.

Reflektimi:

Byzylyku i miqësisë

Fusha kurrikulare:	Jeta dhe puna
Kurrikula lëndore:	Shkathësi për jetë
Tema nga plani dymujor:	Materialet dhe riciklimi
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):	I-3; II-3, 7; III-6; IV-3, 5; V-2, 5; VI-6
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):	Jeta dhe puna: 2.3.2 Gjuhët dhe komunikimi: 1.1; 1.4 Artet: 1 Matematikë: 2.1
Rezultati i të nxënit të temës:	Krijon punime të ndryshme duke përdorur materiale që përdoren në përditshmëri (materiale natyrale, artificiale).
Rezultatet e të nxënit të aktiviteteve:	<ul style="list-style-type: none"> • Imiton lëvizjet e shokut/shoqes. • Krijon byzylyk punëdore për shokun/shoqen e grupit.
Kriteret e suksesit:	<ul style="list-style-type: none"> • Imito lëvizjet e shokut/shoqes. • Krijon byzylykun me rruaza për shokun/shoqen tënde.
Burimet dhe materialet:	Fleta, ngjyra, pulla, lapsa, muzikë, pipëza, makarona, litar i hollë ose llastik, rruaza.
Integrimi ndërfaqor:	Gjuhë shqipe, Matematikë.
Çështjet ndërkurrikulare:	Edukimi për qytetari demokratike.
Fjalë kyçe:	Rreth miqësor, punë në grup, byzylyk, punëdore.
Organizimi i aktiviteteve:	<p>Fëmijët formojnë një rreth dhe edukatori/ja thërret njërin prej tyre të fillojë i pari, duke hyrë në mes të rrethit dhe duke thënë:</p> <p><i>Përshëndetje, miq! Si jeni sot? A e bëni dot edhe ju këtë? (fëmija në rreth bën ndonjë lëvizje/veprim që di, si: hedhje, fishkëllimë, qëndrim në ekuilibër etj.).</i></p> <p>Grupi i fëmijëve të tjerë thërrasin njëzëri:</p> <p><i>Përshëndetje, Toni! Ne jemi mirë. Edhe ne mund të bëjmë si ti! (fëmijët e grupit imitojnë veprimin e Tonit)</i></p> <p>Pastaj Toni del nga mesi i rrethit dhe fton në rreth shokun/shoqen që ka pranë. Kështu secili fëmijë bën ndonjë veprim dhe e ndan me grupin.</p> <p>Pas një jave të tërë pune për miqësinë, edukatori/ja i përgëzon fëmijët për bashkëpunimin, sjelljen e mirë etj. Merr kavanozin me shënimet e sjelljes së mirë shoqërore dhe i lexojnë së bashku. I komentojnë, flasin për rëndësinë e rrethit shoqëror në jetën e secilit, si ndikon</p>

bashkëpunimi me të tjerët, cilët janë faktorët që kontribuojnë në një shoqëri të mirë etj. Fëmijët nxiten vazhdimisht për bashkëbisedim dhe të flasin për ato që u kanë ndodhur.

Byzlyku i miqësisë

Fëmijët sot do të bëjnë punë dore nga një byzlyk për shokun/shoqen e tyre të grupit, në shenjë miqësie. Në mënyrë që të gjithë fëmijët të marrin nga një byzlyk, duhet që të bëhen çift, pasi secili do të punojë nga një të tillë për shokun/shoqen. (Ju mund të përdorni mënyra të ndryshme për të formuar çiftet punuese, si për shembull: ndajini sipas rastësisë, ngjyrës së rrobave, shkronjës së parë të emrit etj.)

Materialet:


Rruaza, pulla, litar i hollë ose llastik, makarona, ngjyra të lëngshme, gërshërë.

Ecuria:

Edukatori/ja ndan në grupe materialet e punës, për shembull: grupi i rruazave, i pullave, i makaronave etj., dhe i vendos në kënde të ndryshme. Fëmijët i zgjedhin vetë materialet që u duhen për të krijuar byzlykun. Së pari, secili fëmijë pret me gërshërë aq sa i duhet nga litari apo llastiku, pastaj merr disa nga materialet që i pëlqejnë dhe fillon punën individuale.

Punimi i byzlykëve është një aktivitet që, përveçse i mëson fëmijët të ndajnë gjërat, të bashkëveprojnë me njëri-tjetrin i nxit edhe të bëjnë dhurata për të tjerët; i ndihmon në zhvillimin e muskujve të vegjël, në koordinimin e dorës dhe syrit, si faktorë shumë të rëndësishëm në zhvillimin e fëmijës.

Kur të kenë mbaruar të gjithë nga puna, mblidhen në rreth për takimin përmbyllës dhe të gjithë mbajnë në dorë byzlykët e përfunduar, i tregojnë para grupit, i numërojnë copëzat e materialeve që kanë përdorur, ndajnë përvojën e tyre gjatë punës dhe, dy nga dy, hyjnë në mes të rrethit dhe i dhurojnë kujtimin e shoqërisë shokut/shoqes së grupit. Duke i përsëritur përbërësit e "recetës së shoqërisë fantastike" përmbyllim ditën e sotme.



Vlerësimi:

Fëmijët vlerësohen nga të tjerët dhe vlerësojnë veten për punën e dorës. Edukatori/ja vëzhgon me kujdes procesin e krijimit të byzlykëve, shkathtësitë dhe vështirësitë e punës me copëza të vogla, koordinimin sy dhe dorë, shkathtësitë sociale për të punuar në çift, si dhe mënyrën e prezantimit të punës së bërë.

Më shumë për të bërë:

Fëmijët mund të krijojnë më shumë se një byzlyk edhe për shokun/shoqen që kanë jashtë institucionit, në emër të vlerësimit të shoqërisë.

Reflektimi:

Festa në familjen time

Fusha kurrikulare:	Shoqëria dhe mjedisi
Kurrikula lëndore:	Shoqëria dhe mjedisi
Tema nga plani dymujor:	Festat
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):	I -3, 5, III -2, 3, 6; IV -4; V 5; VI -1, 4, 6
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):	Shoqëria dhe mjedisi: 3.1 Gjuhët dhe komunikimi: 1.1; 1.4; 3.2 Matematikë: 3.3 Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti: 2.2
Rezultati i të nxënit të temës:	Emërton disa festa familjare dhe shoqërore; përshkruan në mënyrën e vet organizimin dhe përgatitjet festive për to.
Rezultatet e të nxënit të aktiviteteve:	<ul style="list-style-type: none"> • Emërton festat që kremton në familjen e tij/saj. • Përshkruan si i organizon festat në familjen e tij/saj. • Praktikon forma të ndryshme të modelimit të shkronjës.
Kriteret e suksesit:	<ul style="list-style-type: none"> • Emërto festat që kremton në familje. • Përshkruaj si i organizoni festat në familje. • Praktiko forma të ndryshme të modelimit të shkronjës.
Burimet dhe materialet:	Letër A4, librat e punës, ngjyra, letër me ngjitës, gërshërë.
Integrimi ndërfaqor:	Gjuhë shqipe, Matematikë, Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti.
Çështjet ndërkurrikulare:	Edukim për qytetari demokratike.
Fjalë kyçe:	Festa, Viti i Ri, shkronja F, dëshira, dhurata.
Organizimi i aktiviteteve:	<p>Dita fillon duke u përshëndetur me fëmijët e ulur në formë rrethi. Edukatori/ja hap diskutimin me fëmijët, duke u drejtuar pyetje (<i>Nëse ndonjëri ka shkruar një letër më parë dhe kërkon nga personeli ndihmës të sjellin letrën e shkruar nga "Babagyshi i Vitit të Ri" pasi fillon aktivitetin me fëmijë</i>) mbi festën që po afron, si e festojnë në familjen e tyre. Teksa bisedojnë, troket dera e klasës dhe dikush sjell "Letrën nga Babagyshi i Vitit të Ri". Edukatori/ja hap zarfin dhe u lexon fëmijëve letrën ku Babagyshi kërkon nga fëmijët të tregojnë dëshirat e tyre për Vitin e Ri. Fëmijët, të entuziazmuar, shprehin dëshirat e tyre.</p> <p>Pastaj vijon biseda për festat që i njohin fëmijët, minuta gjatë të cilave ata përshkruajnë mënyrat si i festojnë. Duke e vënë theksin te fjalë, si: FESTA, FAMILJA, FËMIJA, edukatori/ja kërkon nga fëmijët të tregojnë tingullin e parë të fjalës FESTA. Paraqet grafikisht shkronjën dhe u kërkon atyre të thonë një fjalë me këtë tingull. Më pas, i fton fëmijët të luajnë</p>

lojën “Treni i tingujve”; lokomotiva është fëmija i parë që gjen fjalë me këtë tingull:

*Tren, tren pipi tren,
Ti që ikën e na vjen
Plot tinguj po na sjell. NDALO!*

Në çastin e ndalimit, fëmijët duhet të gjejnë fjalë me këtë shkronjë. Treni niset pasi të gjithë fëmijët të kenë gjetur nga një fjalë që fillon apo ka në përbërje shkronjën F.

Puna vazhdon nëpër qendrat e aktiviteteve:

Njëri grup do të vizatojë dhuratën që do të dëshironte.

Grupi i dytë do të plotësojë fletëzën e punës.

Grupi i tretë do të praktikojë modelimin e shkronjës me materiale të ndryshme.

Grupi i katërt do të punojë me materialet e përgatitura nga edukatori/ja, ku fëmijët përmes lojës do të ndërlihin numrin me sasinë.

Në takimin përmbyllës, të gjitha vizatimet e fëmijëve me emrat përkatës futen në një zarf dhe përgatiten për t’u dërguar në postë. (Në bashkëpunim me prindërit, shqyrtohen mundësitë për plotësimin e dëshirave që fëmijët kanë vizatuar; nëse kjo nuk është e mundur, mund t’iu dërgojmë një letër urimi.)

Vlerësimi: Fëmijët do të vlerësohen në të shprehurit me gojë për përshkrimin e festave në familjet e tyre.

Më shumë për të bërë: Fëmijët udhëzohen që të nesërmen të sjellin ndonjë dekor, shirit dekorues apo materiale të ndryshme, të cilat mund të shërbejnë për të zbukuruar klasën për festën e Vitit të Ri.

Në bashkëpunim me prindërit, fëmijët mund të praktikojnë dërgimin e një letre në postë.

Reflektimi:

Dekorojmë së bashku

Fusha kurrikulare:	Jeta dhe puna
Kurrikula lëndore:	Shkathtësi për jetë
Tema nga plani dymujor:	Materiali dhe riciklimi
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):	I -3, 5; II -3, 7; III -1, 2, 3, 6; IV -4; V -5; VI -1, 4, 6
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):	Jeta dhe puna: 2.3.2 Gjuhët dhe komunikimi: 1.1; 1.3; 1.4 Matematikë: 3.3 Artet: 1
Rezultati i të nxënit të temës:	Krijon punime të ndryshme duke përdorur materiale të riciklueshme (materiale natyrale dhe artificiale).
Rezultatet e të nxënit të aktiviteteve:	<ul style="list-style-type: none"> • Krijon një zbukurim për të dekoruar klasën për festë. • Punon në grup për ndërtimin e shiritave zbukurues. • Ndhmon aktivisht në dekorimin e klasës përgatitore.
Kriteret e suksesit:	<ul style="list-style-type: none"> • Krijon një zbukurim për të dekoruar klasën për festë. • Puno në grup për ndërtimin e shiritave dekorues. • Ndhmo në dekorimin e klasës sate.
Burimet dhe materialet:	Letër punëdore me ngjyra (e kuqe, e gjelbër, e bardhë), fletë A4 me ngjyrë të gjelbër, gërshtë, ngjitës, letër zbukuruese, xixa, modele të prera, letra me ngjitës, pulla, kapak.
Integrimi ndërfaqor:	Gjuhë shqipe, Matematikë, Edukatë muzikore.
Çështjet ndërkurrikulare:	Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.
Fjalë kyçe:	Planifikim, pemë e Vitit të Ri, shirit dekorues, zbukurime, dekor, festë.
Organizimi i aktiviteteve:	<p>Dita fillon me takimin e përbashkët në rreth, përshëndetjen me fëmijët dhe ndërrimin e kalendarit. Edukatori/ja kërkon nga fëmijët që të sjellin në rreth të gjitha materialet dhe gjërat që kanë marrë me vete për zbukurimin e klasës. Përpara se të fillojnë punën, edukatori/ja kërkon që fëmijët të bëjnë paraprakisht një plan për dekorimin e klasës përgatitore dhe të ndajnë detyrat, në mënyrë që çdo fëmijë të ndihet mirë me ndihmën që do të japë. Fillimisht përcaktohet ideja e ndërtimit të pemës dhe më pas vendi ku do të vendoset.</p> <p>Pasi është bërë plani, fëmijët fillojnë punën në mënyrë të pavarur për të ndërtuar pjesët e pemës. Marrin letër me ngjyrë të gjelbër dhe formojnë me të forma konike (kaushë). Letrat duhet të jenë prerë në madhësi të ndryshme, sepse vetëm kështu figurat mund të kenë përmasa të ndryshme e të ngjajnë bukur në pemë. Pasi të jetë zbukuruar bredhi, edukatori/ja vendos muzikë në sfond, këngën "Ja na erdhi Viti i Ri!"</p>

dhe fton fëmijët që të vallëzojnë të gjithë sipas dëshirës. Gjatë kësaj kohe, edukatori/ja këndon tekstin, që fëmijët të mësojnë fjalët dhe rimat. Më pas fëmijët, të ndarë në grupe me nga tre, nisin të presin shirita me ngjyra sipas dëshirës, të cilët do t'i varin në klasë me ndihmën e edukatorit/es.



Pasi të jenë vendosur shiritat zbukurues me ngjyra, edukatori/ja fton përsëri fëmijët të vallëzojnë nën tingujt e këngëve festive.

Fëmijët, sipas imagjinatës së tyre, punojnë dekorime të ndryshme, të cilat më pas vendosen në pemë, në mjediset brenda dhe jashtë klasës. Gjatë kohës që ata punojnë, edukatori/ja i vëzhgon dhe ofron mbështetje duke i përgëzuar dhe vlerësuar për punën që bëjnë.



Gjatë punës, në mjediset e klasës mund të vendoset muzikë me zë shumë të ulët. Në fund, fëmijët vendosin zbukurimet në vendet që dëshirojnë, pastrojnë hapësirat e punës, vendosin materialet në vendet e tyre dhe tashmë dekorimi i klasës quhet i përfunduar. Edukatori/ja kërkon nga fëmijët që të vëzhgojnë me kujdes mjedisin, në mënyrë që t'u tregojnë prindërve për punën që kanë bërë.

Vlerësimi:

Edukatori/ja i vëzhgon gjatë gjithë kohës fëmijët në aktivitet dhe mban shënime sipas nevojës. Ai/ajo mund të mbajë shënime narrative për veprimet e ndonjë fëmije në veçanti.

Më shumë për të bërë:

Zbukurimet mund të krijohen me materiale dhe mjete të ndryshme. Mund të përdoren edhe materiale plastike, por është shumë e rëndësishme që të gjitha dekorimet e krijuara të vendosen në vende të dukshme, që fëmijët të ndihen të vlerësuar.

Reflektimi:

Të gëzojmë zogjtë për festë

Fusha kurrikulare:	Shkencat natyrore
Kurrikula lëndore:	Njeriu dhe natyra
Tema nga plani dymujor:	Bimët, kafshët, njeriu
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):	I -3, 5; II -1, 3, 7; III -2, 3, 6; IV -4; V . 5; VI -1, 4, 6
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):	Shkencat natyrore: 1 Gjuhët dhe komunikimi: 1.1; 1.4 Edukim fizik, sportet dhe shëndeti: 1 Matematikë: 4.1
Rezultati i të nxënit të temës:	Tregon nevojat themelore jetësore të kafshëve.
Rezultatet e të nxënit të aktiviteteve:	<ul style="list-style-type: none"> • Krijon histori me ilustrimet e librit, duke përdorur fjalë, fjali të thjeshta. • Tregon nevojat themelore të zogjve në dimër. • Ndërton shtëpizën për të ushqyer zogjtë në dimër.
Kriteret e suksesit:	<ul style="list-style-type: none"> • Krijohet historinë tënde përmes ilustrimeve në libër. • Përshkruaj nevojat themelore të zogjve në dimër. • Ndërto shtëpizën për të ushqyer zogjtë në dimër.
Burimet dhe materialet:	Libër me ilustrime, letër e bardhë, gërrshërë, ngjitës, ngjyra, libri i fëmijës, kuti qumështi, shishe plastike, lugë druri, grurë, fara të ndryshme.
Integrimi ndërfaqor:	Gjuhë shqipe, Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti, Matematikë.
Çështjet ndërkurrikulare:	Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.
Fjalë kyçe:	Kushte dimërore, i ftohtë, zogj, harabeli, kanarina, pëllumbat, ushqim, ndërtim.
Organizimi i aktiviteteve:	<p>Në takimin e përbashkët pas përfundimit të përshëndetjes dhe kalendarit, edukatori/ja fton fëmijët të luajnë së bashku lojën:</p> <p><i>"Fluturon, noton, kërcen!"</i></p> <p><i>Ecuria:</i></p> <p>Edukatori/ja përmend një emër kafshe, fëmijët duhet të përshkruajnë mënyrën se si lëviz ajo. Për shembull: kur dëgjojnë fjalën "lepur", fëmijët fillojnë të kërcëjnë në vend; sapo dëgjojnë fjalën "peshk", fillojnë të imitojnë lëvizjet e peshkut, siç lëviz ai në ujë; me të dëgjuar fjalën "harabel", ata imitojnë një zog që fluturon.</p> <p>Edukatori/ja sjell përpara fëmijëve një libër me ilustrime dhe përshkruan historinë e shtëpizës së harabelit dhe jetën e tij në stinën e dimrit. Pyet fëmijët për ushqimin e zogjve gjatë stinës së dimrit dhe kërkon prej tyre të tregojnë ndonjë histori personale që lidhet me zogjtë.</p>

Pas përfundimit të diskutimit, edukatori/ja sjell në mesin e fëmijëve materialet e riciklueshme, si: kuti qumështi, shishe plastike, lugë druri dhe një qese me grurë. I pyet fëmijët nëse dinë të ndërtojnë fole zogjsh, për t'i ndihmuar të kenë një vend të ngrohtë e ushqim gjatë dimrit.

Edukatori/ja mirëpret idetë e fëmijëve për ndërtimin e shtëpizës; fëmijët mund ta ndërtojnë atë sipas imagjinatës së tyre apo të ndjekin udhëzimet në fletëzën e punës.

Dita përfundon në oborrin e institucionit/shkollës, ku edukatori/ja së bashku me fëmijët vendosin shtëpizat e ndërtuara për të ushqyer zogjtë.

Vlerësimi: Fëmijët vëzhgohen gjatë aktivitetit në grup, për të parë aftësitë e tyre krijuese. Puna që ata bëjnë, dokumentohet përmes fotografive.

Më shumë për të bërë: Prindërit mund të udhëzohen të ndërtojnë një shtëpizë të vërtetë për zogjtë. Në këtë mënyrë, fëmijët jo vetëm që do të kalojnë kohë me ta, por do të mësojnë më shumë për natyrën dhe botën e kafshëve. Për ndërtimin e shtëpizës së zogjve, ata mund të ndjekin modelin e paraqitur në fletëzën e punës, në librin e fëmijës.

Reflektimi: _____

Një dhuratë për ty

Fusha kurrikulare: Artet

Kurrikula lëndore: Edukatë figurative

Tema nga plani dymujor: Krijimet e figurave

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): **I**-3, 5; **II**-1, 7; **III**-1, .2, 3, 6; **IV**-2, 4; **V**- 5; **VI**-4, 5, 6

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): Artet: 1
Edukim fizik, sportet dhe shëndeti: 2.2
Gjuhët dhe komunikimi: 1.4; 1.7
Matematikë: 3.4

Rezultati i të nxënit të temës: Me materiale të ndryshme krijojnë dhe riciklojnë sipas fantazisë dhe imagjinatës, vizatojnë, ngjyrosin, modelojnë, shtypin, për tema të ndryshme që trajtohen në shkollë dhe jashtë saj duke përdorur: format me ngjyra, pemët, lodrat apo edhe temat e lira, ku shprehet imagjinata dhe kreativiteti i tyre individual.

Rezultatet e të nxënit të aktiviteteve:	<ul style="list-style-type: none"> • Zbulon gjëgjëzën. • Përshkruan ilustrimin e paraqitur me projektor. • Ndërton kartolinën për t'ua dhuruar personave që do.
Kriteret e suksesit:	<ul style="list-style-type: none"> • Zbulon gjëgjëzën. • Përshkruaj ilustrimin e paraqitur me projektor. • Ndërto kartolinën për t'ua dhuruar personave që do.
Burimet dhe materialet:	Karton, fletë A4, shirita dekorativë, letër shkëlqyese, letër me ngjitës, gërshërë të zakonshme, gërshërë me forma, ngjitës, pulla, shkopinj me ngjyra, copëza të vogla letre me ngjyra zbukuruese.
Integrimi ndërfaqor:	Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti, Gjuhë shqipe, Matematikë.
Çështjet ndërkurrikulare:	Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.
Fjalë kyçe:	Kartolinë, dhuratë, gëzim, kënaqësi.
Organizimi i aktiviteteve:	<p>Edukatori/ja vendos muzikë për fëmijë, derisa të gjithë të kenë zënë vendet e të jenë thënë përshëndetjet dhe kalendari i ditës. Edukatori/ja njofton fëmijët për pushimet dimërore dhe ndërrimin e viteve, si dhe kur do të kthehen përsëri në klasën përgatitore.</p> <p><i>Luhet loja "Nxehtë-ftohtë"</i></p> <p><i>Ecuria:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • Një nga fëmijët del jashtë dhe i bëhet e ditur objekti pas të cilit do të fshihet; ndërkohë fëmijët e tjerë qëndrojnë në klasë. • Fëmijët që janë brenda, fshehin një objekt/lodër diku në një cep të klasës dhe thërrasin fëmijën që është jashtë. • Kur fëmija t'i afrohet objektit të fshehur, fëmijët e tjerë do të thërrasin "Nxehtë-nxehtë!", ndërsa kur i largohet, ata do të thërrasin "Ftohtë-ftohtë!". • Sapo fëmija të gjejë objektin e fshehur, të gjithë duartrokin. • Loja vazhdon disa raunde, sipas kërkesës së fëmijëve. Që askush të mos mbesë pa e përfunduar lojën, mund të luhet edhe me dy fëmijë në të njëjtën kohë, me kushtin që ata të lëvizin së bashku. Mjafton të ndiqet i njëjti rregull që nga fillimi. <p>Fëmijët kthehen pas lojës përsëri në rreth dhe edukatori/ja u lexon një gjëgjëzë:</p> <p><i>Një lis me dymbëdhjetë degë, gjashtë të buta, gjashtë të egra...</i></p> <p><i>(Muajt e vitit)</i></p> <p>(Gjëgjëzat mund të jenë më shumë se një, në varësi të kërkesave të fëmijëve.)</p> <p>Pasi fëmijët të zbulojnë gjëgjëzën, përsërisin me edukatorin/en muajt e vitit. Më pas ftohen të tregojnë ndonjë gjëgjëzë sipas dëshirës. Edukatori/ja hap diskutimin për kartolinat, duke i pyetur fëmijët se çfarë</p>

dinë për kartolinat dhe përse përdoren ato. Pastaj bëjnë prova të gjithë së bashku me një letër format A4, për të parë sa letra mund të përftohen kur ajo ndahet në mes. Aktiviteti vazhdon duke u thënë fëmijëve se do të krijojnë një kartolinë për njerëzit e afërm. Edukatori/ja ka shënuar më parë emrat e fëmijëve në biletëza, të cilat i fut në një kuti. Fëmijët do të kenë mundësi të zgjedhin një biletëz, ku është shkruar emri i shokut/shoqes, të cilit/së cilës do t'i shkruajnë një kartolinë.

Në përfundim, fëmijët i marrin kartolinat në dorë dhe vijën në rreth, ku diskutojnë së bashku për punën që është bërë atë ditë.

(Edukatori/ja mund të përgatitë në *PowerPoint* disa imazhe të festës, stinës së dimrit, festimit në familje, etj. Në të njëjtën kohë u kërkon fëmijëve të tregojnë mendimet e tyre, si dhe të japin përshtypjet për pamjen e fundit, që mund të jetë Babagjyshi i Vitit të Ri. Pas këtij momenti troket dera dhe vjen njëri nga prindërit, i veshur si Babagjyshi, me një thes plot me dhurata, që do t'u shpërndahen secilit. Fëmijët hapin dhuratat dhe shkëmbejnë kartolinat mes tyre. Edukatori/ja i përgëzon për kartolinat dhe i uron për festën e Vitit të Ri, duke u uruar pushime të mbara dimërore.

Vlerësimi: Edukatori/ja bën vlerësimin përmes teknikës së vëzhgimit. Aktivitetet dokumentohen përmes videove dhe fotografive.

Më shumë për të bërë: Fëmijët mund të krijojnë zbukurime të ndryshme në shtëpi dhe t'i sjellin më pas në klasë, për t'i përdorur për dekorimin e mjedisit të saj.

Reflektimi:

Todi ka ftohtë

Fusha kurrikulare:	Gjuhët dhe komunikimi
Kurrikula lëndore:	Gjuha shqipe
Tema nga plani dymujor:	Tinguj, shkronja, rrokje, fjalë, fjali
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):	I-3; II-3, 7; III-1, 2, 3, 4, 6; IV-2; V-2, 5; VI-6
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):	Gjuhët dhe komunikimi: 1. 1; 1. 2; 1. 4; 2. 2; 3. 2 Matematikë: 5. 1 Artet: 1 Shoqëria dhe mjedisi: 1.2
Rezultati i të nxënit të temës:	Lexojnë dhe interpretojnë ilustrime, fotografi, figura dhe objekte me fjalë e fjali të thjeshta.
Rezultatet e të nxënit të aktiviteteve:	<ul style="list-style-type: none"> • Ndërton histori në bazë të fotografive. • Eksperimenton me përzierjen e materieve të ndryshme për krijimin e "dëborës" me plastelinë.
Kriteret e suksesit:	<ul style="list-style-type: none"> • Ndërto një histori duke u bazuar në fotografitë e dhëna. • Eksperimento me përzierjen e materieve të ndryshme për krijimin e "dëborës" plastelinë.
Burimet dhe materialet:	Fotografi të ndryshme të ariut, acarit; niseshte, zbutës flokësh, libri i punës.
Integrimi ndërfaqor:	Matematikë, Edukatë figurative, Shoqëria dhe mjedisi.
Çështjet ndërkurrikulare:	Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.
Fjalë kyçe:	Acari, akulli, dëbora, shkronja "T", ariu Todi, gjumë letargjik, eksperiment, plastelinë.
Organizimi i aktiviteteve:	<p>Kur planifikoni takimin e përbashkët në rreth, duhet të mendoni gjithmonë që të jetë një takim interaktiv, ku të gjithë fëmijët do të kenë qasje aktive. Asnjë nga fëmijët nuk duhet të mbesë vëzhgues pasiv, le të jetë përvojë e këndimit dhe lojës së përbashkët, rikujtim i temave të mësuara më parë dhe fëmijët duhet të bashkëveprojnë vazhdimisht me njëri-tjetrin, po ashtu edhe me ju (dhe me materialet që sillni në rreth).</p> <p>Sot, takimi i përbashkët nis me përshëndetjen individuale, të cilën secili fëmijë e bën nëpërmjet lojës.</p> <p>Fëmijët formojnë një rreth dhe edukatori/ja thërret njërin prej tyre të fillojë i pari, duke hyrë në mes të rrethit dhe duke thënë:</p> <p><i>"Përshëndetje miq, si jeni sot? A e bëni dot edhe ju këtë?"</i> (fëmija në rreth bën një lëvizje a veprim që di, për shembull: hedhje, fishkëllimë, qëndrim në ekuilibër etj.).</p>

Fëmijët e tjerë thërrasin njëzëri:

“Përshëndetje Zani, ne jemi mirë. Po, edhe ne mund të bëjmë si ti” (dhe imitojnë veprimin e Zanit).

Pastaj Zani del nga rrethi dhe fton aty shokun/shoqen që ka pranë. Kështu secili fëmijë bën ndonjë veprim dhe e ndan me grupin.

Më pas, edukatori/ja u paraqet disa imazhe të një historie që flet për një ari që quhet Todi, dhe për gjumin e tij letargjik gjatë dimrit. Imazhet mund të jenë çfarëdo (të marra nga revistat, të printuara apo edhe të vizatuara).

- Një ari në vjeshtë, duke siguruar ushqim për dimër
- Pamje dëbore
- Një shtrat
- Batanije të ngrohtë
- Acar
- Shpellë
- Pamje pranvere

Imazhet vendosen në formë të çrregullt në mes të rrethit dhe fëmijët i rendisin sipas mendimit të tyre. Komentohet historia e ariut Todi.

Theksi i diskutimit bie te ngrica, acari, stina e ftohtë e dimrit, si ndikon në jetën tonë, në jetën e kafshëve dhe të bimëve. Çfarë ndodh me natyrën në këtë stinë etj.

Pas komentimit, edukatori/ja mund të shtojë sfida gjuhësore, duke e filluar historinë e ariut Todi në një mënyrë tjetër.

- Edukatorja fillon historinë dhe fëmijët me radhë e vazhdojnë pas saj, duke shtuar sa më shumë fjalë që fillojnë me shkronjën “T” (pas jush fillon fëmija që keni në anën e djathtë dhe kështu historia ndërtohet derisa të kenë përfunduar të gjithë me radhë) p.sh.: Ariu Todi, Tok dorën Timit Të cilit i pëlqen Torta dhe i cili ka një Triko Të Trashë për Të mos mërdhirë, etj.

Pra, kështu ata formojnë një histori gazmore, ku dominon shkronja “T” dhe ju i pyesni se cila shkronjë mbizotëron në këtë histori. Pra, kjo është shkronja me të cilën do të njihemi sot.

Edukatori/ja njofton fëmijët për grafikun e shkronjës T duke përdorur fletëza të plastifikuara dhe marker. Pasi fëmijët ta praktikojnë disa herë, mund të plotësojnë librat e tyre.


Pas përfundimit të punës te libri i fëmijës kalojmë te këndi i shkencës. Edukatorja me fëmijët do të bëjnë një eksperiment me bashkimin e dy përbërësve, nga të cilët do të përftojnë një materie të ngjashme me plastelinën (ajo do të jetë bora, me të cilën fëmijët do të luajnë dhe do të krijojnë gjëra të ndryshme që paraqesin dimrin).

Receta:

- 1 sasi zbutës flokësh
- 2 sasi niseshte

Shënim:

Ju mund ta shumëfishoni masën e plastelinës në varësi të madhësisë së grupit tuaj.



Kur fëmijët të jenë argëtuar me plastelinën “dëborë”, mund të vazhdojnë me aktivitetet e tjera.

Fëmijët do të modelojnë topa “bore” me plastelinë dhe do të ndërveprojnë me fletën e punës duke vendosur në rubrikën përkatëse aq topa sa kërkon numri i dhënë.

Takimi i përbashkët na mbledh për të reflektuar për aktivitetin e sotëm, ku përsërisim historinë e Todit, marrim komente nga fëmijët për ndryshimet e motit, acarit dhe ndikimet e tij në jetën e Todit, dhe në jetën tonë gjithashtu. Diskutojmë për shkronjën e mësuar, gjejmë fjalë me shkronjën “T” dhe tokim duart për t’u përshëndetur e për të përmbyllur ditën e sotme.

Vlerësimi: Fëmijët vlerësohen në bazë të ndërtimit të historisë së Todit, fondit të fjalëve përshkruese dhe mbajtjen e një lidhjeje logjike gjatë ndërtimit të historisë.

Më shumë për të bërë: Plastelinën e krijuar në klasë, fëmijët mund ta marrin me vete në shtëpi (për shkak të kohës së shkurtër të qëndrueshmërisë) dhe me të të modelojnë shkronjën “T” që mësuan sot.

Reflektimi:

Akullnaja

Fusha kurrikulare: Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti

Kurrikula lëndore: Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti

Tema nga plani dymujor: Lojërat lëvizore dhe popullore

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I-3; II-4; III-3; V-2, 5; VI-6

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti: 2. 1
Gjuhët dhe komunikimi: 1. 1; 1. 7
Matematikë: 2. 1

Rezultati i të nxënit të temës: Demonstron mënyra të ndryshme të ecjes, vrapimit, kërcimit, hedhjes etj.

Rezultatet e të nxënit të aktiviteteve:

- Bisedon për njohuritë paraprake mbi akullnajat.
- Kërcen nga njëra akullnajë te tjetra duke ndjekur renditjen numerike nga 1-10 në lojën “Kërcim në akullnajë”.
- Identifikon fjalët e panjohura dhe i vendos bashkë me shokët/shoqet në murin e fjalëve.

Kriteret e suksesit:

- Përshkruan akullnajat me fjalë të tij/saj.
- Kërce nga akullnaja në akullnajë duke ndjekur renditjen numerike nga 1-10 në lojën "Kërcim në akullnajë".
- Gjej fjalët e panjohura dhe vendosi në fjalorin e klasës.

Burimet dhe materialet:

Video-prezantim për akullnajat, enciklopedi, fletë konstruktive e bardhë, marker, materiale me ngjyrë të kaltër, letra, blloqe, revista të vjetra për prerje, gërshërë, ngjyra.

Integrimi ndërfaqor:

Gjuhë shqipe, Matematikë.

Çështjet ndërkurrikulare:


Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

Fjalë kyçe:

Akullnajë, copë e madhe akulli, lundrim, ngricë, acar.

Organizimi i aktiviteteve:

Në takimin e përbashkët në rreth, edukatori/ja paraqet para fëmijëve udhëzuesin e motit dhe i pyet për motin sot dhe motin në stinën e dimrit. Fëmijët nxiten drejt diskutimit për acarin, të ftohtin, ku bashkërisht nxirren njohuritë e tyre rreth akullnajave, pyeten se çfarë është një

**Udhëzimet:**

- Kërce nga akullnaja në akullnajë duke ndjekur renditjen numerike nga 1-10.
- Kërce me ritëm.

akullnajë, çfarë dinë për to etj. Edukatori/ja nxit fëmijët të pyesin mbi ato që duan të dinë për akullnajat apo për gjërat që janë kureshtarë të kuptojnë rreth tyre.

Për t'i njohur fëmijët me akullnajat, shkaqet e krijimit, vendndodhjen e tyre, shkaqet e shkrirjes, strukturën e tyre etj., ju mund të përdorni një enciklopedi dhe fotografi të ndryshme.

Pas diskutimit të përbashkët përgatiten disa forma të çrregullta "akullnajash" në fletë të bardhë konstruktive, ku në secilën prej tyre shënojmë nga një numër përkatës 1-10 dhe i vendosim në dysheme (duhet t'i organizojmë në mënyrë të tillë, që distancat midis akullnajave të jenë të arritshme për fëmijët kur këta të kërcejnë nga njëra te tjetra). (Në varësi të kushteve atmosferike, mund ta modifikojmë këtë lojë për t'u luajtur në ambientin e jashtëm.)

Pasi përfundimit të lojës, fëmijët mund të luajnë të lirë në këndet ku ata kanë interes, sipas temës ditore.

Në fushën e gjuhës: Do të shfletojnë libra për të zbuluar më shumë informacione mbi akullnajat.

Në këndin e lojërave konstruktive:

Do të ndërtojnë një akullnajë të madhe në formë të parregullt, në tri dimensione.

Në këndin tjetër: Me ndihmën e materialeve, ata do të ndërtojnë një relief akullnajash.

Fëmijët do të ndryshojnë qendrat e aktiviteteve në formë rotacioni, për t'u mbledhur më vonë në takimin e përbashkët ku u rikthehemi dhe bëjmë një përsëritje të aktiviteteve që zhvilluam sot, diskutojmë për akullnajat dhe identifikojmë të gjitha njohuritë e reja që morën.

Në këtë formë, fëmijët shikojnë dhe klasifikojnë konkretisht njohuritë që kishin, ato që donin të dinin dhe ato që kuptuan sot.

Fjalët e reja që mësuam gjatë kësaj dite i diskutojmë së bashku dhe edukatori/ja i shënon te "Fjalorthi i fjalëve të panjohura".

Vlerësimi:

Edukatori/ja vëzhgon në mënyrë aktive dhe mban shënime narrative për shkathtësitë e fëmijëve në lojën "Kërcim në akullnajë" duke vënë theksin te ndjekja e udhëzimeve, identifikimi i numrave dhe mbajtja në mend e tyre duke ndjekur renditjen 1-10.

Fëmijët vlerësohen gjatë informatave kthyese që japin për akullnajat.

Më shumë për të bërë:

Edukatori/ja e gjuhës angleze mund të përdorë link-un e mëposhtëm të filmit të shkurtër muzikor: *Icebergs and Glaciers (Musical version)*

<https://www.youtube.com/watch?v=YNNLkUZKdew>

Reflektimi:

Fjollë bore

Fusha kurrikulare: Shkencat natyrore

Kurrikula lëndore: Njeriu dhe natyra

Tema nga plani dymujor: Toka dhe hapësira

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): **I**-3, 5, 7; **II**-1, 2, 3, 4, 7; **III**-1, 2, 3, 4, 6; **IV**-2; **V**-2, 5; **VI**-6

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): Shkencat natyrore: 1
Gjuhët dhe komunikimi: 1. 1; 1. 2; 1. 4
Matematikë: 2. 2

Rezultati i të nxënit të temës:	Tregon karakteristikat themelore të stinëve gjatë vitit.
Rezultatet e të nxënit të aktiviteteve:	<ul style="list-style-type: none"> • Mban ekuilibrin teksa ecën në vijat e fjollës së borës, duke ndjekur udhëzimet për orientim. • Formon ngjyrë nga përbërësit ushqimorë për pikturimin e fjollës së borës.
Kriteret e suksesit:	<ul style="list-style-type: none"> • Përpiqu të ecësh në vijën e fjollës së borës, duke ndjekur udhëzimet e edukatorit/es për orientim. • Përziej përbërësit e duhur ushqimorë, për të krijuar ngjyrën me të cilën do të pikturosh fjollën e borës.
Burimet dhe materialet:	Libër me temë për dimrin, top, shirit ngjitës, kripë, miell, ujë, fletë konstruktive me ngjyrë të zezë, brusha për ngjyrosje.
Integrimi ndërfaqor:	Gjuhë shqipe, Matematikë.
Çështjet ndërkurrikulare:	Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.
Fjalë kyçe:	Akull, fjollë bore, ngrirje.
Organizimi i aktiviteteve:	Dita e sotme nis me lojën "Copë akulli".

Fëmijët ulen në rreth dhe edukatori/ja fillon lojën duke kaluar me radhë nga njëri te tjetri një top të bardhë, për të cilin do të imagjinojnë se është një copë akulli. Pasi e bëjnë një provë të lojës, edukatori/ja kthehet me shpinë për të qenë sa më transparent/e gjatë lojës.



Kur loja fillon, edukatori/ja thërret: akull, akull, akull, ... NGRIJ! Kur thuhet NGRIJ, fëmijët ndalen. Fëmija që ka topin në dorë, largohet nga rrethi dhe afrohet tek edukatori/ja.

Kështu loja vazhdon derisa të mbetet një fëmijë në fund. Shokët dhe shoqet e klasës e përgëzojnë për qëndrueshmërinë në lojë.

Marrim informata kthyesë nga fëmijët, se si janë ndier gjatë lojës, kur loja filloi të bëhej më e ngushtë dhe më e shpejtë, dhe si janë ndier kur ngriheshin dhe dilnin nga rrethi etj. (Pyetje të tilla i bëjnë fëmijët më të çiltër, në këtë formë ata edukohen t'i shprehin ndjenjat e tyre, fakt ky që i mbron ata nga shpërthimet emocionale të akumuluar. Është mirë që fëmijët ndonjëherë të përballen edhe me lojëra sfiduese, duke i edukuar ata të pranojnë sfidën dhe të përgëzojnë shoku-shoqen.)

Pas qetësimit të atmosferës në klasë, edukatori/ja bashkë me fëmijët plotësojnë kalendarin e ditës duke vënë theksin te stina e dimrit dhe moti që mbizotëron. Kështu bëjnë një përsëritje të shkurtër të ditës së kaluar, duke rikujtuar informacionet e marra për akullnajat.

Lexohet një libër/tregim për stinën e dimrit dhe e diskutojmë historinë bashkërisht, duke i nxitur fëmijët të komentojnë dhe të ndajnë me grupin ndonjë histori personale që kanë me borën.


Loja: "Fjollë-bora jonë"

Në dyshemenë e klasës formoni një model të fjollës së borës (me shirit ngjites), në të cilin fëmijët do të ecin sipas udhëzimeve orientuese të edukatorit/es. Për shembull: Ec drejt deri te cepi! Kthehu tre hapa pas! Shko te cepi i kundërt i fjollës së borës! Etj. Të gjitha lëvizjet duhen të bëhen brenda shiritit ngjites.

Kjo lojë i ndihmon fëmijët në zhvillimin e ekuilibrit, orientimit në hapësirë/shkathësive matematikore.

Kur të gjithë fëmijët të kenë provuar lëvizjet në linjat e fjollës së borës marrim informatat kthyesë për lojën.

Në përfundim të lojës, fëmijët do të analizojnë strukturën e fjollës në dyshe dhe me përzierjen e disa përbërësve do të krijojnë një të tillë të këndi i shkencës.



Eksperimenti: "Pikturo me ngjyrë bore"

Materialet:

- Një gotë kripë
- Një gotë miell
- Një gotë ujë
- Një fletë konstruktive me ngjyrë të zezë
- Brushë për ngjyrosje

Përzihen të gjithë përbërësit bashkë dhe formohet një masë e rrjedhshme, e njëtrajtshme, të cilën mund ta shumëfishoni në varësi të numrit të fëmijëve në klasën tuaj.

Masën e fituar ndajeni në sasi të mjaftueshme për secilin grup të fëmijëve.

Secili fëmijë me ngjyrën e krijuar do të pikturojë një flluskë bore.

Vizatimet e përfunduara lihen për t'u tharë deri ditën e nesërme, për t'u ekspozuar më pas në këndin e artit.

Pasi t'i kenë përfunduar të gjithë punimet e tyre, shikojnë punimet e njëri-tjetrit dhe bashkërisht pastrojnë ambientin e punës.

Pastaj mblidhen në takim e përbashkët, ku bëjnë një përmbledhje të ditës së sotme, duke reflektuar për secilin aktivitet, çfarë mësuam sot, çfarë kanë provuar për herë të parë, si janë ndier gjatë eksperimentit me krijimin e ngjyrës për fjollën e borës, sa përbërës na janë nevojitur, me çka i kemi matur masat e duhura, çfarë ndodhi me përzierjen e përbërësve etj.

Pasi edukatori/ja të jetë siguruar që të gjithë fëmijët kanë pasur mundësinë të shprehin mendimin e tyre, përshëndeten për t'u takuar të nesërmen, në një ditë të re me aventura, lojëra dhe plot gjëra të tjera.

Vlerësimi: Edukatori/ja mban shënime narrative gjatë lojës "Fjollë-bora jonë" për ndjekjen e udhëzimeve lidhur me mbajtjen e ekuilibrit, ndjekjen e renditjes numerike nga 1 te 10, si dhe me orientimin në hapësirë.

Ju vëzhgoni edhe punën e fëmijëve te pikturimi i fjollës së borës, si përdorimi i brushës, kopjimi i modelit në mënyrë vizuale etj.

Më shumë për të bërë: Loja "Copë akulli" është modifikuar nga loja "Hot potatos":

<https://youtu.be/qdtTjdQ0NoQ>

Bashkëngjitur do të gjeni këngën "Fjollë-bora", në gjuhën angleze, të cilën mund t'ua mësoni fëmijëve.

<https://youtu.be/tbbKjDjMDok>

Reflektimi:

Dordoleci

Fusha kurrikulare: Artet

Kurrikula lëndore: Edukatë muzikore

Tema nga plani dymujor: Këngët, Rimet dhe ligjërimet ritmike, Meloditë, Shoqërimet

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): **I-3; II-3, 7; III-1, 2, 3, 4, 6; IV-2; V-2, 5; VI-6**

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): Artet: 1
Gjuhët dhe komunikimi: 1. 3; 1. 4
Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti: 2. 2

Rezultati i të nxënit të temës: Këndon këngë të thjeshta (në grup) sipas imitimit (këngët që trajtojnë tema të përshtatshme për moshën e tyre: për natyrën, shkollën, familjen, dëshirat, lodrat, stinët, festat etj.).

Rezultatet e të nxënit të aktiviteteve:

- Këndon këngën duke e shoqëruar me lëvizje trupore.
- Demonstron hedhjen e topit në drejtimin e caktuar.

Kriteret e suksesit:

- Këndo këngën duke e shoqëruar me lëvizje trupore.
- Demonstron hedhjen e topit në drejtimin e caktuar.

Burimet dhe materialet:	Karton, ngjyra, fleta me ngjyra, radio, CD, fleta të bardha (për riciklim), shportë, shall, kapelë, një karotë dhe disa pulla ose guralec të vegjël, ngjitës shirit.
Integrimi ndërfaqor:	Gjuhë shqipe, Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti.
Çështjet ndërkurrikulare:	Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.
Fjalë kyçe:	Dimër, acar, dordolec/njeri prej bore, poshtë-lart.
Organizimi i aktiviteteve:	Dita fillon me përshëndetje mirëseardhjeje, të cilat edukatori/ja mund t'i modifikojë çdo ditë, për t'i bërë tërheqëse dhe jo gjithmonë të njëjta. Për shembull: një ditë, fëmijët përshëndesin me radhë duke hyrë në rreth dhe duke e shoqëruar përshëndetjen me lëvizje trupore; një ditë tjetër mund t'i pasojnë topin njëri-tjetrit duke përshëndetur me një mesazh pozitiv shoqëror. Një formë tjetër përshëndetjeje mund të jetë edhe kjo: edukatori/ja i pret fëmijët me një kukull dore, e cila u uron mirëseardhjen dhe i fton në bashkëbisedim.

Pas leximit të kalendarit dhe përsëritjes nga dita e kaluar, vendosni në mes të rrethit një shall, një kapelë, një karotë dhe disa pulla ose guralecë, dhe nxitini fëmijët të japin mendime pse i kemi në rreth këto gjëra, çfarë mund të ndërtojmë me to etj. Në këtë mënyrë vijmë tek ideja e njeriut prej bore. Kështu natyrshëm hyjmë në temën ditore dhe bashkërisht mësojmë këngën e dimrit, të cilën mund ta gjejmë në burime *online*. Teksti i këngës lexohet, përsëritet disa herë me fëmijët dhe më pas dëgjohet kënga. Ajo mund të shoqërohet edhe me lëvizje trupore, në varësi të nevojave të fëmijëve në grupin tuaj edukativ.

Më pas luhet loja "Prite dordolec".

Materialet:

- Karton i fortë
- Fleta me ngjyra
- Marker
- Fletë të bardha (ripërdorni fletëza të bardha që nuk ju duhen më).
- Shirit ngjitës
- Një kosh

Ecuria:

Me materialet e renditura më sipër, edukatori/ja mund të përgatitë paraprakisht një njëri prej bore, të ngjashëm me fotografinë e bashkëngjitur, ndërsa me fletat e bardha (të ripërdorshme) fëmijët krijojnë "topa bore" thjesht duke e mbledhur fletën në formë topi. Topat e formuar, fëmijët i vendosin në shportë.

Edukatori/ja vendos shirit ngjitës në dysheme, në një distancë prej 2,5 m larg njeriut prej bore.

- Fëmijët rreshtohen pas shiritit në dysheme.
- Secili merr nga dy topa "bore" në shportë.
- Edukatori/ja jep udhëzime për gjuajtjen, si: një top hidhe lart, një top hidhe poshtë, dy topat poshtë, dy topat lart etj.

Pas përfundimit të lojës, fëmijët kalojnë në punë individuale me fletëzën e punës te libri i fëmijës.

Pasi të kenë mbaruar punën individuale, fëmijët luajnë të lirë nën tingujt e këngës së mësuar sot, nëpër këndet e aktiviteteve të preferuara.



Në fund mblidhen për takimin e përbashkët ku bëjnë një përsëritje të ditës së sotme, duke reflektuar për aktivitetet e zhvilluara, si janë ndier gjatë aktivitetëve, a kanë bashkëpunuar me njëri-tjetrin, si janë ndier kur dikush nga shokët-shoqet i ka mbështetur etj.

Këndojmë bashkërisht këngën e mësuar dhe përhëndetemi.

Vlerësimi: Duhet të vëzhgoni fëmijët gjatë këndimit të këngës, a kanë vështirësi në ndjekjen e ritmit etj. Mund të përdorni listat e kontrollit për të mbajtur shënime.

Më shumë për të bërë: Në varësi të kushteve atmosferike dhe karakteristikave të grupit tuaj, mund ta realizoni lojën “Prite dordolec” në ambientin e jashtëm.

Reflektimi: _____

Shtëpia prej akulli

Fusha kurrikulare: Matematikë

Kurrikula lëndore: Matematikë

Tema nga plani dymujor: Modelet

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): **I**-3, 4, 6; **II**-3, 7; **III**-1, 2, 3, 4, 6; **IV**-2; V-2, 5; **VI**-6

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): Matematikë: 4. 2
Gjuhët dhe komunikimi: 1. 1; 1. 7 2. 8
Jeta dhe puna: 2. 8. 1

Rezultati i të nxënit të temës: Radhit objektet duke zbuluar rregullin në modelin e dhënë, sipas formës, ngjyrës ose madhësisë.

Rezultatet e të nxënit të aktivitetëve:

- Tregon për filmin “Pingu ndërton një shtëpizë prej akulli”.
- Konstrukton shtëpizën prej akulli në këndin e dramatizimit.
- Luan me role duke simuluar situata jete dhe pune në viset e ftohta.

Kriteret e suksesit:

- Komento filmin “Pingu ndërton një shtëpizë prej akulli”.
- Në këndin e dramatizimit konstrukto shtëpizën prej akulli.
- Luaj në role se si punojnë dhe veprojnë njerëzit në viset e ftohta.

Burimet dhe materialet: Filmi i animuar “Pingu Builds an Igloo” (“Pingu ndërton një shtëpizë prej akulli”) (<https://youtu.be/6yiPjJZHEto>), kuti këpucësh, fletë mbështjellëse e bardhë ose e kaltër (mund të jetë edhe qese najloni) fletë me ngjyra, gërshërë, ngjitës, shkëlqyes.

Integrimi ndërfushor: Gjuhë shqipe, Shkathtësi për jetë.

Çështjet ndërkurrikulare: Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

Fjalë kyçe: Shtëpi akulli, acar, jeta në Antarktidë, puna, mbijetesa, Pingu, pinguinët, konstruktim, bllok.

Organizimi i aktiviteteve:

Pas takimit të përbashkët, diskutimit rreth motit, plotësimin të kalendarit dhe luajtjes së një loje për ngrohje, fëmijëve iu vihet për të parë filmin "Pingu ndërton një shtëpizë prej akulli" (<https://youtu.be/6yiPjLZHEto>). Filmi në fjalë paraqet jetën e Pingut vetëm nëpërmjet lëvizjeve dhe tingujve, pra, nuk përmban fjalë të folura, andaj fëmijët informohen më herët për këtë karakteristikë. Në fund të filmit do të përshkruhet filmi me fjalë.

Filmi është një formë e mirë konkretizuese e jetës dhe punës në vendet me temperatura të ulëta ekstreme. Kështu, edukatori/ja, pas komentimit të filmit iu flet fëmijëve për vendet e ftohta, për jetën dhe punën atje, si mbijetojnë njerëzit, me çfarë ushqehen etj. Pastaj ata ftohen të ndërtojnë një shtëpi akulli te këndi i dramatizimit, ku më pas do të luajnë me role duke simuluar situata jete dhe pune në vendet e ftohta.

"Shtëpiza prej akulli"

Materialet:

Kuti këpucësh, letër mbështjellëse me ngjyrë të bardhë ose të kaltër (mund të përdorni edhe qese najloni), ngjitës, fleta me ngjyra, gërrshërë, shkëlqyes/xixa.

Ecuria:

Mbështillen kutitë e këpucëve me letër ose qese najloni (mund të përdorni qese najloni të marra nga kutia e materialeve të ripërdorshme dhe t'i lini në një kënd, që fëmijët të ndërtojnë me to një shtëpizë prej "akulli".

Edukatori/ja mund të kryejë mbështjelljen e kutive me ndihmën e fëmijëve ose mund ta bëjë këtë një ditë më parë, me ndihmën e ndonjërit prej prindërve.

Disa fëmijë merren me ndërtimin e shtëpizës, disa të tjerë presin fleta për të dekoruar shtëpizën, si p.sh.: akullishte, flokë bore etj. Të tjerët merren me përgatitjen e ambientit të brendshëm të shtëpizës ku fëmijët do të luajnë me role.

Edukatori/ja nxit fëmijët duke i pyetur sa blloqe kanë gjithsej, sa përdorën për pjesën e përparme, të pasme, anësore etj. Sa akullishte kanë prerë, sa do të ngjisin në pjesën e përparme dhe sa mbesin për anësoret. Fëmijët do të luajnë të lirë lojën me role, në shtëpizën prej akulli.

Pas përfundimit të lojës me role mblidhen për takimin e përbashkët, ku diskutojnë për aktivitetet e realizuara gjatë ditës së sotme, për përshtypjet e tyre, çfarë iu ka pëlqyer, si janë ndier dhe si ishte bashkëpunimi me të tjerët. Rikomentojnë filmin e Pingut dhe thonë mendimin e tyre rreth lojës me role duke i nxitur të shpjegojnë se çfarë roli kishin, si ishte të jetoje dhe të punoje në një vend me kushte ekstreme atmosferike, si është jeta në vendin tonë gjatë periudhës së dimrit, si jetojmë dhe punojmë ne, me çfarë mjetesh lëvizim etj.



(gjithmonë duke bërë krahasimin e jetës dhe punës në vendin tonë me vendet me temperatura të ulëta).

Vlerësimi:

Komentimi i filmit të Pingut ju ndihmon të vlerësoni shkathhtësitë e fëmijëve për të ritransmetuar një histori të parë dhe jo të dëgjuar, për fondin e fjalëve përshkruese, për vetëvlerësimin dhe aftësinë e tyre për të prezantuar punën para grupit etj.

Gjatë ndërtimit të shtëpisë prej akulli mbani shënime narrative për bashkëveprimin në grup, për numërimin dhe grupimin e elementeve të punës, kreativitetin e shprehur etj.

Puna në lojën me role ju ndihmon të vlerësoni se sa janë informuar fëmijët për jetën dhe aktivitetet e njerëzve që jetojnë në temperatura të ulëta.

Më shumë për të bërë:

Shtëpia prej akulli mund të qëndrojë te këndi i dramatizimit gjatë gjithë stinës së dimrit, si kënd i lojës së lirë të fëmijëve.

Reflektimi:

Toka, planeti ynë

Fusha kurrikulare:	Shkencat e natyrës
Kurrikula lëndore:	Njeriu dhe natyra
Tema nga plani dymujor:	Toka dhe hapësira
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):	I -3, 5; II -1, 3, 7; III -1, 2, 4, 6; IV -2, 3; V -2, 5; VI -6
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):	Shkencat e natyrës: 1 Gjuhët dhe komunikimi: 1. 4; 1. 7; 2. 8 Matematikë: 3. 4 Artet: 1
Rezultati i të nxënit të temës:	Emërton pjesë të relievit të mjedisit ku jeton (male, fusha, kodra, lumenj dhe liqene).
Rezultatet e të nxënit të aktiviteteve:	<ul style="list-style-type: none"> • Modelon me plastelinë te fletëza e punës planetin Tokë. • Bashkon me format ndërtuese shtatë kontinentet e planetit Tokë.
Kriteret e suksesit:	<ul style="list-style-type: none"> • Modelo me plastelinë planetin Tokë në fletëzën e punës. • Bashko format ndërtuese me shtatë kontinentet e planetit Tokë.
Burimet dhe materialet:	Glob, harta e Tokës, plastelinë e gjelbër dhe e kaltër (ju mund të përdorni plastelinë ekologjike të përgatitur vetë).
Integrimi ndërfaqor:	Gjuhë shqipe, Matematikë, Edukatë figurative.
Çështjet ndërkurrikulare:	Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.
Fjalë kyçe:	Tokë, planet, kontinent, det, lum, liqen, male, kodra, glob, hartë.
Organizimi i aktiviteteve:	<p>Në takimin e përbashkët në rreth, edukatori/ja vendos një glob, një hartë, një xham zmadhues dhe nxit fëmijët të komentojnë rreth objekteve që kanë pranë, duke iu shtruar pyetjet: Kush nga ju e di se çfarë janë këto? Për çfarë shërbejnë? Ku jetojnë të gjithë njerëzit, kafshët dhe bimët?</p> <p>Kështu vijmë natyrshëm te tema e ditës "Toka, planeti ynë". Fëmijët njihen me globin, hartën dhe xhamin zmadhues, pastaj diskutojnë të gjithë me radhë.</p> <p>Ju mund të përgatisni një prezantim në <i>PowerPoint</i> apo mund të siguroni një dokumentar të shkurtër që ta paraqitni konkretisht planetin Tokë në hapësirë. Mund të bëni gjithashtu konkretizimin edhe me fotografi që i keni siguruar më parë.</p> <p>Përmes globit, fëmijët njihen me planetin Tokë, me sipërfaqet blu dhe të gjelbra që paraqiten aty. Njihen gjithashtu me shtatë kontinentet dhe me emërtimet e tyre.</p>



Bashko me format ndërtuese shtatë kontinentet.

Materialet:

Një fletë A2, marker, fleta me ngjyra.

Ecuria:

Në fletën e bardhë vizatoni shtatë kontinentet e Tokës dhe për secilin kontinent bëni edhe nga një kopje tjetër me fletë me ngjyra. Secilin kontinent ngjyroseni me ngjyrë të ndryshme.

Fëmijët provojnë t'i vendosin kontinentet në vendin e duhur, duke ndjekur modelin që është vizatuar në fletën e bardhë. Në të njëjtën kohë, edukatori/ja lexon me zë të lartë secilin kontinent që fëmija vendos në vendin e duhur. "Të lumtë Zana, e vendose Evropën në vendin e duhur! Kush jeton në Evropë?". Pra, gjatë lojës nxitini fëmijët me pyetje dhe ndihmohjini. Në këtë mënyrë, ata do të fillojnë të familjarizohen me emrat e kontinenteve dhe të marrin njohuritë fillestare për ta.

Pas përfundimit të aktivitetit për kontinentet, fëmijët kalojnë në punën individuale me fletëzën e punës te libri i fëmijës (Shkencat e natyrës).

Fëmijët do të modelojnë me plastelinë hapësirat ujore dhe ato tokësore të planetit Tokë, me ngjyrat përkatëse.

Fëmijët dëgjojnë këngën për shtatë planetët, në gjuhën angleze, "Seven continents song" (<https://youtu.be/K6DSMZ8b3LE>).

Në takimin e përbashkët bëni një përsëritje të aktiviteteve të zhvilluara dhe merrni informata kthyesë nga fëmijët, për çfarë përdoret harta, globi, xhami zmadhues, ku jetojmë ne, çfarë e dallon planetin Tokë nga planetët e tjerë, sa kontinente ka në Tokë, cili është më i madhi, cili më i vogli, renditi sipas madhësisë etj.

Vlerësimi:

Edukatori/ja vëzhgon fëmijët gjatë pjesëmarrjes së tyre aktive në bashkëbisedim rreth temës. Gjithashtu, i vëzhgon ata gjatë punës për bashkimin e kontinenteve me format ndërtuese (puzzle) dhe fletëza e punës te Libri i fëmijës.

Më shumë për të bërë:

Ju mund t'i referoheni link-ut të mëposhtëm për aktivitete rreth planetit Tokë.

<https://spaceplace.nasa.gov/all-about-earth/en/>.

Reflektimi:

Qarkullimi i ujit në natyrë

Fusha kurrikulare:	Gjuhët dhe komunikimi
Kurrikula lëndore:	Gjuhë shqipe
Tema nga plani dymujor:	Tregime, përralla, përrallëza, gjëegjëza, poezi
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):	I -3, 5; II -1, 7; III -2, 6; IV -2, 3; V -5; VI -6
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):	Gjuhët dhe komunikimi: 1. 1; 1. 3; 1. 4; 1. 6; 1. 7; 2. 8 Jeta dhe puna: 4. 9 Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti: 5
Rezultati i të nxënit të temës:	Shkëmben ide me të tjerët për gjëra të ndryshme që i interesojnë, si: fotografi, ilustrime, lodra etj.
Rezultatet e të nxënit të aktiviteteve:	<ul style="list-style-type: none"> • Vëzhgon procesin e qarkullimit të ujit në eksperimentin me ujë të nxehtë. • Plotëson fletëzat interaktive për qarkullimin e ujit në natyrë, në librin e fëmijës. • Ndërton një tregim të përbashkët me grupin, duke kontribuar me nga një fjali secili.
Kriteret e suksesit:	<ul style="list-style-type: none"> • Vëzhgo procesin e qarkullimit të ujit në natyrë gjatë eksperimentit me ujë të nxehtë. • Plotëso fletëzën e punës për qarkullimin e ujit në natyrë. • Na thuaj një fjali dhe bashkë me shokët/shoqet ndërto një tregim.
Burimet dhe materialet:	Një video/dokumentar, pajisje për vlimin e ujit, një gotë, folie najloni, poster për qarkullimin e ujit në natyrë, ngjitës, gërrshërë.
Integrimi ndërfaqor:	Shkathtësi për jetë, Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti.
Çështjet ndërkurrikulare:	Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.
Fjalë kyçe:	Cikël, qarkullim, ujë, avullim, kondensim, absorbim, nëntokësor, reshje.
Organizimi i aktiviteteve:	<p>Duke i përsëritur konceptet me të cilat fëmijët u njohën një ditë më parë për Tokën dhe hapësirën, natyrshëm edukatori/ja i njofton fëmijët me ciklin e ujit në natyrë.</p> <p>Pastaj fëmijët shohin dokumentarin e shkurtër "Cikli i ujit në natyrë". Edukatori/ja jep shpjegime shtesë rreth dokumentarit https://www.youtube.com/watch?v=TWb4KIM2vts https://www.youtube.com/watch?v=s0bS-SBAgJI. Pas përfundimit të dokumentarit, fëmijët interpretojnë procesin e parë dhe nxiten që të komentojnë procesin me fjali të thjeshta.</p> <p>Pasi fëmijët njihen me procesin e qarkullimit të ujit në natyrë, është koha që të eksperimentojnë dhe ta vërtetojnë këtë proces.</p>


Procesi i qarkullimit të ujit në natyrë

Materialet e nevojshme:

- Pajisje për vlimin e ujit
- Gotë qelqi
- Folie të tejdukshme (plastmase)

Ecuria:

Vlohet uji dhe hidhet në gotën e qelqit, të cilën e mbulojmë me folie plastmase (najloni). Fëmijët vëzhgojnë procesin e qarkullimit të ujit, si avullimin, kondensimin dhe "reshjet".



Pas përfundimit të eksperimentit, fëmijët kalojnë në punë individuale te libri i fëmijës, për plotësimin e fletëzës interaktive për ciklin e ujit në natyrë.

Kur të gjithë fëmijët të kenë mbaruar punën individuale, kthehen te këndi i shkencës dhe shikojnë rezultatet përfundimtare të eksperimentit. Pastaj mbledhen për takimin e përbashkët, ku bashkërisht diskutojnë për qarkullimin e ujit në natyrë. Edukatori/ja lidh të dhënat me mënyrën e konkretizimit duke iu referuar eksperimentit të zhvilluar.

Edukatori/ja shpjegon se në vazhdim do të krijojmë bashkërisht një tregim që ka të bëjë me qarkullimin e ujit në natyrë. Ai/ajo i jep disa kriteret për ndërtimin e tregimit, si p.sh.: duhet të kemi një fillim të ngjarjes që e përshkruan vendin, duhet të kemi disa personazhe, një problem dhe një zgjidhje të problemit në fund. Kështu, edukatori/ja e fillon tregimin me një fjali dhe pas tij/saj vazhdojnë me radhë fëmijët, ku secili e plotëson historinë me nga një fjali. Kështu vazhdohet deri te fëmija i fundit në rreth, i cili e përfundon tregimin.

Vlerësimi:

Edukatori/ja vëzhgon fëmijët gjatë komentimit të dokumentarit, sa janë në gjendje të diskutojnë për ato çka kanë parë, si e përshkruajnë procesin e qarkullimit të ujit etj. Vlerësohet fletëza e punës në librin e fëmijës dhe shkathtësitë e tyre për të ndërtuar një histori në grup, duke e plotësuar kuptimin e tregimit pa i anashkaluar kriteret që keni vënë.

Më shumë për të bërë:

Ju mund t'u ofroni fëmijëve një film të animuar në gjuhën angleze, për temën e qarkullimit të ujit në natyrë.

<https://www.youtube.com/watch?v=s0bS-SBAgJI>

Reflektimi:

Sistemi diellor

Fusha kurrikulare:	Matematikë
Kurrikula lëndore:	Matematikë
Tema nga plani dymujor:	Numrat natyrorë
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):	I -3, 5; II -1, 3, 7; III -1, 2, 4, 6; IV -2, 3; V -2, 5; VI -6
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):	Matematikë: 6.4 Gjuhët dhe komunikimi: 1.2; 1.7; 2. 8 Artet: 1
Rezultati i të nxënit të temës:	Përdor numrat natyrorë për të identifikuar pozicionet në një rresht (lodrash ose objektesh- i pari- e para- i dyti - e dyta e pesta - i pesti etj.
Rezultatet e të nxënit të aktiviteve:	<ul style="list-style-type: none"> • Imiton llojet e lëvizjeve të trupave hapësinorë në lojën muzikore “Ne jemi trupa hapësinorë”. • Numëron planetët duke i vendosur sipas radhës. • Vendos tiketat përkatëse për secilin planet.
Kriteret e suksesit:	<ul style="list-style-type: none"> • Nën tingujt e muzikës, lëviz si trup qiellor sipas udhëzimeve në lojën “Ne jemi trupa hapësinorë”. • Numëro planetët duke i sistemuar sipas renditjes së tyre. • Vendosi tiketat për secilin planet.
Burimet dhe materialet:	Një instrument muzikor, poster për sistemin diellor, pjata letre, një qese me misër (për gjuajtje) kartat e numrave të pakos edukative (1-6), fleta të bardha, libri i punës për fëmijë.
Integrimi ndërfaqshor:	Gjuhë shqipe, Edukatë muzikore.
Çështjet ndërkurrikulare:	Ngrohja globale
Fjalë kyçe:	Sistemi diellor, planet, Dielli, Hëna, hapësirë, Toka, numri 6
Organizimi i aktiviteve:	<p>Loja “Ne jemi trupa hapësinorë”</p> <p>Edukatori/ja jep udhëzimet e lojës.</p> <p>Teksa ai/ajo luan një melodi ritmike me instrument, fëmijët qëndrojnë në rreth dhe kur edukatori/ja ndal muzikën, thotë: “Besa është Dielli, ndërsa fëmijët e tjerë janë planetë”, dhe vazhdon të luajë melodinë instrumentale ndërsa fëmijët kërcëjnë. Besa qëndron në mes të rrethit dhe fëmijët e tjerë vallëzojnë rreth saj. Kështu edukatori/ja vepron disa herë me radhë, duke iu dhënë mundësi fëmijëve të provojnë role të ndryshme.</p> <p>Pas lojës me muzikë, fëmijëve iu tregohet një poster i sistemit diellor, ku edukatori/ja shpjegon për përbërjen e tij dhe flet për:</p>

- Diellin dhe rëndësinë e tij;
- planetët, emërtimin, renditjen dhe karakteristikat e tyre;
- rrugën që planetët bëjnë rreth Diellit;
- udhëtimet në hapësirë;
- astronautët, pajisjet e tyre dhe rrugën që bëjnë ata etj.



(Ju mund të plotësoni konkretizimin e temës mësimore me një video-dokumentar të shkurtër.)

Fëmijët do të punojnë me radhë me shkathtësitë matematikore, duke iu referuar posterit të sistemit diellor, ku ata:

- do të numërojnë planetët me numra rendorë: i pari, i dyti etj.;
- do të identifikojnë distancën nga Dielli, më afër, më larg.

Loja “Numërojmë yjet”

Materialet: pjata letre, zar, kartat e numrave deri në numrin gjashtë, një qese me misër.

Ecuria: Pjatat vendosen në dyshe me sipër tyre vendosen kartat me numra nga 1-6. Secili prej fëmijëve do të hedhë zarin dhe, duke u bazuar në numrin që i ka rënë, gjuan qesen me misër te pjata me numrin përkatës.



Ju mund të krijoni një qese me misër duke prerë një xhep të vjetër të ndonjë rrobe të këndi i materialeve të ripërdorshme. Për të krijuar peshë, mbusheni atë me misër dhe qepeni sipër.

Përmes lojës, edukatori/ja i njeh natyrshëm fëmijët me konceptin e numrit 6. Pas përfundimit të lojës, ata mund të plotësojnë fletëzën e numrit 6 në librin e fëmijës.

Pas përfundimit të punës në libër, fëmijët mblidhen në takimin e përbashkët, ku bëjnë një përsëritje të temës së sotme. Edukatori/ja siguron fletëza të vogla, në të cilat janë të shkruara emrat e planetëve, dhe bashkë me fëmijët i vendosin ato poshtë secilit planet, te posterit të sistemit diellor.

Vlerësimi: Edukatori/ja vëzhgon ndërveprimin e fëmijëve me njëri-tjetrin dhe me materialet e punës.

Më shumë për të bërë: Fëmijët mund të mësojnë këngën për sistemin diellor, në gjuhën angleze. <https://www.youtube.com/watch?v=mQrlgH97v94>

Reflektimi: _____

Unë jam astronaut

Fusha kurrikulare:	Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti
Kurrikula lëndore:	Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti
Tema nga plani dymujor:	Lojërat dhe pushimi
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):	I -3, 5; II -3, 7; III -1, 2, 4, 6; IV -2, 3; V -2, 5; VI -6
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):	Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti: 2. 2 Gjuhët dhe komunikimi: 1. 1; 1. 4 Matematikë: 3. 4
Rezultati i të nxënit të temës:	Praktikon lojëra dhe aktivitete fizike duke bashkëpunuar në çift dhe në grup.
Rezultatet e të nxënit të aktiviteteve:	<ul style="list-style-type: none"> • Imiton lëvizjet e astronautit në hapësirë. • Identifikon fjalë të panjohura. • Ndërton pajisje hapësinore me materiale të ripërdorshme.
Kriteret e suksesit:	<ul style="list-style-type: none"> • Lëviz si astronauti në hapësirë. • Identifikoj fjalët e panjohura. • Ndërto pajisje hapësinore me materiale të ripërdorshme.
Burimet dhe materialet:	Materiale të ndryshme nga kutia e materialeve të ripërdorshme, kosh letre, karton i hollë, fleta me ngjyra, ngjitës, gërvanë, shkëlqyes, folije, tub plastik.
Integrimi ndërfaqësor:	Gjuhë shqipe, Matematikë.
Çështjet ndërkurrikulare:	Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.
Fjalë kyçe:	Astronaut, gravitet, hapësirë, raketë, peshë.
Organizimi i aktiviteteve:	<p>Dita fillon me lojëra të lira deri sa të gjithë fëmijët të jenë të pranishëm. Takimi i përbashkët fillon me përshëndetjen.</p> <p>Pas leximit të kalendarit, edukatori/ja prezanton para fëmijëve diçka nga pajisjet e astronautit (kjo mund të jetë kapelë astronauti apo diçka tjetër, të cilën e ka përgatitur paraprakisht).</p> <p>Pyeten fëmijët se kujt i përkasin këto pajisje, për çka nevojiten etj. Pastaj edukatori/ja prezanton temën e ditës: Sot do të mësojmë për astronautët</p>



Ju mund të krijoni pajisje astronauti me materiale nga kutia e materialeve të ripërdorshme.

dhe të gjithë do të jemi nga pak astronaut, nëpërmjet lojërave dhe aktiviteteve që do të zhvillojmë.

Edukatori/ja shpjegon profesionin e astronautit, mënyrën si praktikohen para nisjes, sa të rëndësishme janë ushtrimet trupore, si ushtrohen ata, si ushqehen, rëndësia që i japin mënyrës së ushqyerjes, pse udhëtojnë në hapësirë, me çfarë mjedesh pajisen për të kryer rrugëtimin etj.

Fëmijët luajnë lojën "Unë jam astronaut".

Ata krijojnë një rreth të madh, edukatori/ja hyn në mes dhe jep udhëzimet përkatëse:

- astronauti lëviz në hapësirë (fëmijët imitojnë lëvizjet e ngadalësuara të astronautit në hapësirë);
- astronauti kërcen në Tokë (fëmijët kërcenë lart e poshtë me shpejtësi);
- astronauti ulet dhe ngrihet në hapësirë (fëmijët imitojnë në mënyrë të ngadalësuar uljet dhe ngritjet e ngadalësuara të edukatorit/es në mes të rrethit).




Kështu ju shtoni lëvizje të ndryshme, të cilat bëhen më sfiduese dhe nxisin zhvillimin e muskujve të mëdhenj të fëmijëve.

Fëmijët kalojnë në punën në grup, ku bashkërisht do të krijojnë pajisje astronauti ose hapësinore. Ata mund të krijojnë:

- helmeta astronauti;
- pajisjet për oksigjen;

një pajisje për identifikimin e gurëve hapësinorë.



(Gjatë kësaj loje, fëmijët identifikojnë gurët duke i numëruar dhe ndarë ata sipas madhësisë.)

Të gjitha këto pajisje vendosen te këndi i dramatizimit, ku fëmijët do të luajnë një lojë me role, gjatë së cilës do të pretendojnë se janë në një stacion hapësinor, ku do të kryejnë veprime të ndryshme ndërvepruese (artistike dhe shprehëse në të njëjtën kohë).

Më pas, fëmijët mblidhen në takimin e përbashkët për të shprehur përvojat e tyre gjatë punës në grup, mendimet për bashkëveprimin me njëri-tjetrin etj. Përsëriten karakteristikat e një astronauti, rëndësia e ushtrimeve trupore në përgatitjet e astronautit, rëndësia e mirushqyerjes etj.

Vlerësimi: Fëmijët vëzhgohen gjatë lojës "Unë jam astronaut".

Ata vëzhgohen edhe gjatë krijimit të pajisjeve hapësinore, në mënyrën se si manipulojnë materiale të ndryshme, si ndërveprojnë me njëri-tjetrin etj. Edukatori/ja dokumenton përmes videos apo fotografive punën e fëmijëve.

Më shumë për të bërë: Ju mund t'i referoheni *link*-ut të mëposhtëm për lojëra kompjuterike edukative që i referohen temës së ditës së sotme.

<https://spaceplace.nasa.gov/menu/play/>

Reflektimi: _____

Toka, thesari ynë i çmuar

Fusha kurrikulare:	Shoqëria dhe mjedisi
Kurrikula lëndore:	Shoqëria dhe mjedisi
Tema nga plani dymujor:	Kujdesi për mjedisin përreth
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):	I -3, 5; II -1, 3, 7; III -1, 2, 4, 6; IV -2, 3; V -2, 5; VI -6
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):	Shoqëria dhe mjedisi: 5. 1 Gjuhët dhe komunikimi: 1. 7; 2. 8; 3. 2 Matematikë: 2. 3
Rezultati i të nxënit të temës:	Tregon mënyrat e udhëtimit dhe ndikimin e tyre në mjedisin përreth (transporti publik dhe ai privat).
Rezultatet e të nxënit të aktiviteteve:	<ul style="list-style-type: none"> • Ndërvepron me shokët dhe shoqet në punimin grupor "Toka, thesari ynë i çmuar". • Identifikon objekte me shkronjën "Th" brenda kutisë me rërë. • Plotëson fletën e punës të libri i fëmijës për shkronjën "Th".
Kriteret e suksesit:	<ul style="list-style-type: none"> • Ndërvepro me shokët dhe shoqet e grupit në punimin e përbashkët "Toka, thesari ynë i çmuar". • Nga kutia me rërë identifikoj objektet që fillojnë me shkronjën "Th". • Plotëso fletën e punës të libri i fëmijës për shkronjën "Th".
Burimet dhe materialet:	Libri "Përrallat e nënës Tokë" (seria <i>Edukimi Ekologjik</i>), lapsa, ngjyra, revista, gërshërë, kuti me rërë, tabelë, objekte që fillojnë me shkronjën "Th".
Integrimi ndërfaqor:	Gjuhë shqipe, Matematikë.
Çështjet ndërkurrikulare:	Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.
Fjalë kyçe:	Toka, thesare, shkronja "TH".
Organizimi i aktiviteteve:	<p>Në rrethin e takimit të përbashkët mund të vendosni një glob për të bërë një lidhje me temën e ditës dhe vazhdoni me leximin e librit "Përrallat e nënës Tokë" (seria <i>Edukimi Ekologjik</i>). Pas kësaj, edukatori/ja fillon pjesën interaktive duke përdorur topin pasues për pyetje rreth tregimit, ku fëmijëve iu pasohet topi dhe drejtohet një pyetje rreth tregimit të lexuar. Me këtë rast, fëmijët nxiten të ndajnë me grupin edhe përvoja individuale që kanë rreth kujdesit për Tokën.</p> <p>Pasi është arritur një përfshirje aktive e fëmijëve në diskutim, edukatori/ja fillon shpjegimin për kujdesin ndaj planetit Tokë.</p> <p>Ai/ajo flet për faktorët që ndikojnë në dëmtimin e planetit tonë dhe faktorët që ndihmojnë në ruajtjen e tij.</p>

Konkretizon shpjegimin me fotografi përkatëse ose me ndonjë film të shkurtër.

Pra, mesazhi kryesor që duhet të përcillet në këtë rast, është: “Toka është një thesar i çmuar dhe ne duhet të kujdesemi për të”. Edukatori/ja u kërkon fëmijëve të japin idetë e tyre apo të përsërisin ato që dëgjuan prej tij/saj për faktorët që kontribuojnë në ruajtjen e planetit Tokë.

Në një kuti me rërë vendosen objekte, lodra dhe fotografi të cilat fillojnë me shkronjën “Th”. Fëmijët kërkojnë në rërë dhe sendet që gjejnë i demonstrojnë para klasës duke i emërtuar. Vazhdojnë me radhë dhe në fund, objektet e nxjerra nga rëra i rendisin duke i numëruar dhe krahasuar.

Fëmijët identifikojnë shkronjën dominuese në emërtimin e objekteve nga kutia me rërë, dhe më pas kalojnë në punë individuale në librin e fëmijës, me plotësimin e shkronjës “Th”.

Pas përfundimit të punës, edukatori/ja organizon lojën garuese: “Kërcim me thes”.

Punë në grup


Fëmijët ndahen në grupe për të punuar së bashku një ushtrim që ka për qëllim të paraqesë elementet shkatërrues të planetit tonë dhe elementet që ndikojnë në mbrojtjen e tij.

Materialet: Tabela për secilin grup punues, revista të ndryshme, materiale të ripërdorshme, gërshërë, ngjites.

Ecuria: Edukatori/ja përgatit një ndarje në mes të tabelave dhe shkruan titullin për secilin grup: “Toka, thesari ynë i çmuar”. Fëmijët do të grupojnë elementet shkatërruese dhe ato të mbrojtjes së ambientit, duke vizatuar apo prerë dhe ngjitur fotografi që paraqesin faktorët përkatës.

Në takimin e përbashkët, të gjitha grupet punuese mblidhen në rreth dhe prezantojnë me radhë punimet e bëra; flasin për dy bashkësitë me elemente të ndryshme; japin shpjegime përse i kanë vendosur, si ndikojnë ato etj. Punimet e tyre demonstrohen tek ekspozita e klasës.

Toka, thesari ynë i Çmuar



Vlerësimi:

Fëmijët vëzhgohen gjatë punës në grup për ndërveprimin me njëri-tjetrin dhe shkathtësitë e tyre shprehëse në prezantimin e punës së bërë.

Më shumë për të bërë:

Fëmijët mund të argëtohen me lojërat edukative kompjuterike që përkojnë me temën e planetit Tokë. <https://spaceplace.nasa.gov/menu/play/>

(Gjithmonë duke pasur parasysh respektimin e një orari për përdorimin e pajisjeve teknologjike.)

Reflektimi:

Shtyj e tërhiq

Fusha kurrikulare:	Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti
Kurrikula lëndore:	Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti
Tema nga plani dymujor:	Lojërat dhe pushimi
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):	I-3; II-1, 3, 4, 7, 8; III-1, 2, 3, 4, 6; IV-2; V-2, 5; VI-6
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):	Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti: 2. 1 Gjuhët dhe komunikimi: 1. 1; 1. 4 Matematikë: 3. 5
Rezultati i të nxënit të temës:	Demonstron shkathtësi të lëvizjeve elementare gjatë kapjes dhe hedhjes së objekteve.
Rezultatet e të nxënit të aktiviteteve:	<ul style="list-style-type: none"> • Hedh topin në drejtimin e caktuar. • Tërheq litarin në drejtim të vetes. • Vendos ilustrimet në vendet përkatëse.
Kriteret e suksesit:	<ul style="list-style-type: none"> • Hidh topin në drejtimin e caktuar. • Tërhiq litarin në drejtim të vetes. • Vendos ilustrimet sipas kriterit të kërkuar.
Burimet dhe materialet:	Top, litar, letër A2, materiale të shtypura, gërshërë, ngjitës etj.
Integrimi ndërfaqshor:	Gjuhë shqipe, Matematikë.
Çështjet ndërkurrikulare:	Zhvillim personal dhe aftësitë për jetë.
Fjalë kyçe:	Lëvizje, forcë, tërhiq, shtytje, ndikim.
Organizimi i aktiviteteve:	<p>Edukatori/ja përshëndetet me fëmijët në rreth dhe bashkërisht plotësojnë kalendarin e motit. Më pas, ai/ajo fton fëmijët të luajnë lojën "Hidhe topin në shportë".</p> <p>Fëmijët ndahen në dy skuadra. Secilës skuadër i vendoset një emër i preferuar dhe shënohen në tabelë (pas çdo shënimi në shportë shënohen pikët në tabelë; nëse jemi jashtë, në oborr, shënimet mbahen në një fletë).</p> <p>Loja fillon me sinjalin e dhënë. Fëmijët do të hedhin topin dhe, kur të përfundojë loja, do të numërohen pikët.</p> <p>Uleni përsëri në rreth. Edukatori/ja nxit diskutimin me fëmijët:</p> <p><i>Si ndiheni? Ju pëlqeu loja? Si vepruat për të lëvizur topin deri te shporta?</i> Edukatori/ja rrotullon topin në drejtim të fëmijës duke e pasuar nga njëri te tjetri. Fëmijët japin mendimet e tyre.</p>

Ai/ajo udhëzon fëmijët të marrin nga një lodër në dorë (makinë, tren, motor, çfarëdo që gjejnë në klasë) dhe u kërkon që të tregojnë se si do t'i vënë në lëvizje këto mjete. Duke praktikuar aftësitë e vëzhgimit do të diskutojnë se si veprojnë shtytjet dhe tërheqjet. Fëmijëve do t'u shpjegohet se të gjithë trupat lëvizin duke i shtyrë ose tërhequr.

Edukatori/ja i fton fëmijët në një lojë tjetër: "Tërheqje me litar". Klasa ndahet në dy grupe dhe pas sinjalit të dhënë fillon tërheqja e litarit. Gjatë lojës, edukatori/ja kërkon nga fëmijët që të vërejnë se si trupi i tyre dhe litari nën ndikimin e forcës, shtyhet dhe tërhiqet.

Pastaj ulen në rreth dhe diskutojnë për lojën dhe se si vepruan për realizimin e saj. Duke diskutuar, dalin në përfundim se *litarin e tërheqën*. Me anë të tërheqjes vëmë në lëvizje trupat. Fëmijëve u shpjegohet se për të lëvizur objektet (trupat) nevojitet jo vetëm shtytja, por edhe tërheqja.

Aktiviteti vazhdon me fëmijët e ndarë në dy grupe. Atyre u jepet nga një letër formatit A2 dhe materiale me ilustrime të ndryshme. Njëri grup do të presë dhe do të vendosë me ngjitës trupat në shtytje, kurse grupi tjetër trupat në tërheqje. Pasi të përfundojnë punimet, i sjellin në rreth. Mblidhen të gjithë së bashku, ekspozohen në një kënd të dukshëm të klasës dhe përshkruajnë mënyrat e lëvizjes së trupave.

Vlerësimi: Fëmijët do të vlerësohen përmes vëzhgimit dhe mbajtjes së shënimeve anekdotike për idetë që ata japin mbi lëvizjen e trupave.

Më shumë për të bërë: Edukatori/ja kërkon nga prindërit që, për aktivitetin e radhës, të sjellin nga një lodër me rrota që mund të kenë në shtëpi. Fletëzën e punës për "Shtyj dhe tërhiq", fëmijët mund ta marrin me vete, për ta plotësuar në shtëpi.

Reflektimi:

Rrotat në lëvizje

Fusha kurrikulare:	Shkencat natyrore
Kurrikula lëndore:	Njeriu dhe natyra
Tema nga plani dymujor:	Trupat dhe lëvizjet e tyre
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):	I -3, 5, 7; II -1, 3, 4, 7, 8; III -1, 2, 3, 4, 6; IV -4; V -2, 5; VI -6
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):	Gjuhët dhe komunikimi: 1. 1; 1. 3 Matematikë: 2. 2 Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti: 2. 2 Shkencat e natyrës: 1
Rezultati i të nxënit të temës:	Dallon trupat në qetësi dhe në lëvizje (shpejt, ngadalë).
Rezultatet e të nxënit të aktiviteteve:	<ul style="list-style-type: none"> • Interpreton lëvizjet sipas kërkesës së lojës. • Tregon çfarë duhet të bëjë për të vënë në lëvizje makinën lodër në tatëpjetë. • Përshkruan me fjalë mesazhin e fabulës.
Kriteret e suksesit:	<ul style="list-style-type: none"> • Interpretu lëvizjet sipas kërkesës së lojës. • Trego çfarë duhet të bësh për të vënë në lëvizje makinën lodër në tatëpjetë. • Trego me fjalë mesazhin e fabulës.
Burimet dhe materialet:	Libër me fabula, makina lodra, librat e fëmijëve, materiale përmes së cilave mund të krijojnë pjerrina (kuti kartoni, dërrasa pak më të gjata, kapakë të mëdhenj plastikë etj.)
Integrimi ndërfaqor:	Gjuhë shqipe, Matematikë, Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti.
Çështjet ndërkurrikulare:	Edukimi për media.
Fjalë kyçe:	Lëviz, forcë, shtytje, tërheqje, ngadalë, shpejt.
Organizimi i aktiviteteve:	Dita fillon me lojën "Shpejt-ngadalë".

Fëmijët ulen në rreth dhe edukatori/ja u jep shpjegimet e lojës: unë do të emërtoj një trup, ju do të bëni në vend lëvizjet e atij trupi, shpejt ose ngadalë p.sh.: kërmilli (fëmijët do të imitojnë lëvizjet e kërmillit) kali, breshka, leopardi, milingona, lepuri etj. Kështu përgjatë imitimit të lëvizjeve të kafshëve, fëmijët do të kuptojnë edhe mënyrën e lëvizjes së tyre. Dita vijon me leximin e fabulës "Breshka dhe lepuri". Pas leximit, edukatori/ja do të nxitë diskutimin me pyetje: *Kush ishte më i shpejti? Cili e fitoi garën?* Fëmijët shprehin mendimet e tyre. Ata inkurajohen për të dhënë përgjigje.

Më pas, edukatori/ja ofron në katër kënde të klasës materiale të ndryshme të ripërdorshme dhe natyrore, me të cilat fëmijët do të konstruktojnë pjerrina të ndryshme sipas imagjinatës së tyre. Fëmijët



duhet të kenë hapësirat në dispozicion për lëvizjet e tyre, do të hetojnë lëvizjet e mjeteve që përdorin; në tatëpjetë duhet të kenë tërheqje, ndërsa në pjerrina shtytje. Gjatë lojës, ata diskutojnë për trupat që lëvizin (makinat) dhe për forcën që i vë ata në lëvizje.

Në takimin përmbyllës organizohet "Turi i galerisë", ku grupet do të prezantojnë punën e bërë dhe rezultatet e arritura.

Vlerësimi: Edukatori/ja mban shënime të personalizuar, në varësi të ndërveprimit të fëmijës me materiale gjatë lojës.

Më shumë për të bërë: Edukatori/ja mund të mbajë shënime në formë tabele për mjetet që janë në lëvizje. Nxiten fëmijët që bashkërisht të plotësojnë tabelën me ilustrime.

Reflektimi:

Balona ime

Fusha kurrikulare: Jeta dhe puna

Kurrikula lëndore: Shkathtësi për jetë

Tema nga plani dymujor: Materialet dhe riciklimet

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): **I-3, 7; II-1, 3, 4, 7, 8; III-1, 2, 3, 6; V-2, 5; VI-6**

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): Jeta dhe puna: 2. 8. 1
Gjuhët dhe komunikimi: 1. 1; 1. 4
Matematikë: 3. 5

Rezultati i të nxënit të temës: Krijon punime të ndryshme duke përdorur materiale të riciklueshme (materiale natyrale, artificiale).

Rezultatet e të nxënit të aktiviteteve:

- Krijon balonën me materialin që ka para.
- Ngjit me kujdes pipëzat me gotën e letrës.
- Eksperimenton me balonë duke e lëvizur.

Kriteret e suksesit:

- Krijon një balonë me materialin që ke para.
- Ngjit me kujdes pipëzat me gotën e letrës.
- Eksperimenton me balonën duke e lëvizur.

Burimet dhe materialet: Birila, topa, gota letre, balona, pipëza, ngjitës, etj.

Integrimi ndërfaqor: Gjuhë shqipe, Matematikë.

Çështjet ndërkurrikulare: Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

Fjalë kyçe: Lëvizje, ndikimi i forcës, elektricitet, gjendje e qetësisë.

Organizimi i aktiviteteve:



Pasi bëhet përshëndetja e zakonshme me fëmijët, edukatori/ja i fton të luajnë "Lojën me birila". Fëmijët ndahen në dy skuadra (nëse nuk keni birila, mund t'i krijoni me shishe plastike të ngjyrosura). Ata do të numërojnë duke luajtur (sa birila u rrëzuan dhe sa kanë mbetur). Edukatori/ja do të pyesë se kush e shkakton lëvizjen e birilave dhe fëmijët do të shprehin mendimet e tyre. Edukatori/ja shpjegon se forca e goditjes së topit bën që birilat të lëvizin.

Pastaj edukatori/ja i fton fëmijët në rreth dhe diskuton me ta për llojet e lëvizjeve. Fëmijët tregojnë idetë e tyre. Ata udhëzohen që në grupe të vogla të krijojnë lodra të ndryshme, të vëzhgojnë se si lëvizin ato dhe se çfarë e shkakton lëvizjen e tyre.

Fëmijëve u jepen udhëzimet si të krijojnë "balona" me tullumbace, pipëza dhe gota letre. Pasi t'i krijojnë, do të eksperimentojnë duke i lëshuar ato të fluturojnë në klasë dhe do të flasin për lëvizjet e tyre.

Më pas, secili prej tyre ka ndërtuar balonën e tij. Edukatori/ja kërkon që fëmijët të ndahen në çifte dhe secili të fërkojë balonën në një cep të kokës së tij, ndërkohë që fëmija tjetër do të vëzhgojë se çfarë ndryshimi do të ndodhë. Nën ndikimin e forcës së fërkimit dhe elektricitetit, flokët do të ngrihen lart. Fëmijët do të vërejnë se çfarë ndodh me flokët e shoqes/shokut dhe në këtë mënyrë edukatori/ja i nxit fëmijët që të vijnë në përfundime të përbashkëta se si lëvizin trupat dhe që përdorimi i forcës nuk qenka e vetmja mënyrë për t'i lëvizur ata.



Pas eksperimentit me balona, fëmijët mblidhen në rreth për të treguar se si kanë kaluar sot, çfarë iu pëlqeu më shumë dhe të tjera diskutime që mund të lindin nga nevojat e tyre. Balonat mund t'i marrin me vete dhe të kërkojnë nga anëtarët e familjes që ta eksperimentojnë së bashku aktivitetin e sotëm.

Vlerësimi: Edukatori/ja mund të mbajë shënime anekdotike për fëmijët. Dokumentohet puna e fëmijëve me anë të fotografive.

Më shumë për të bërë: Ju mund të filloni ditën me llojet e lëvizjeve dhe ndryshimet që mund të ndodhin nga njëri trup në tjetrin, nën ndikimin e së njëjtës forcë.

Reflektimi: _____

Llamba magjike

Fusha kurrikulare:	Gjuhët dhe komunikimi
Kurrikula lëndore:	Gjuhë shqipe
Tema nga plani dymujor:	Tinguj, shkronja, rrokje, fjalë, fjali.
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):	I-3, 4, 5; II-7; III-1, 2, 3, 6; V-5, 6; VI-6
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):	Gjuhët dhe komunikimi: 1. 1; 1. 2; 3. 2 Shoqëria dhe mjedisi: 1 Artet: 1
Rezultati i të nxënit të temës:	Shqiptojnë drejt zanoret dhe bashkëtingëlloret gjatë të shprehurit.
Rezultatet e të nxënit të aktiviteteve:	<ul style="list-style-type: none"> • Gjen së paku dy fjalë që kanë në përbërje tingullin Ll. • Krijon në grup llambën me materiale të ripërdorshme. • Shpjegon me fjalët e tij/saj sjelljet e personazheve të përrallës.
Kriteret e suksesit:	<ul style="list-style-type: none"> • Gjej së paku dy fjalë që kanë në përbërje tingullin Ll. • Me materiale të ripërdorshme, në grup të vogël ndërto një llambë. • Shpjego sjelljet e personazheve të përrallës.
Burimet dhe materialet:	Libri i edukatorit/es, libri i punës, fasule, mjete ndihmëse etj.
Integrimi ndërfaqor:	Shoqëria dhe mjedisi, Edukatë figurative.
Çështjet ndërkurrikulare:	Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.
Fjalë kyçe:	Xixëllonja, ariu, nata, dita, llamba, qiri, shkronja LL.
Organizimi i aktiviteteve:	<p>Takimi i përbashkët fillon me lojën “Natë-ditë” (fëmijët mbyllin sytë kur themi <i>natë</i> dhe i hapin kur themi <i>ditë</i>). Pas lojës, edukatori/ja nxit diskutimin me fëmijët: <i>Si e ndriçojmë ambientin natën? Kush na bën dritë? Si mendoni, kush ndriçon më shumë: qiri apo llamba?</i> Pasi merr mendimet e fëmijëve, ata vlerësohen pozitivisht me fjalë inkurajuese për të vazhduar më tej. Edukatori/ja lexon përrallën “Llamba magjike”.</p> <p><i>Në thellësi të pyllit, në mes të një shkurreje jetonte një ari i vogël me prindërit e tij. Ariu i vogël doli me nënën të mblidhte fruta. Teksa ai hante gjithë kënaqësi boronica, nëna mblidhte ca fruta nga pema dhe e porositi të voglin e saj mos të largohej shumë, se mund të humbte rrugën.</i></p> <p><i>Ariut të vogël i erdhi një flutur mbi hundë. Ai u përpoq ta largonte, por ajo prapë fluturoi mbi veshin e tij. Ariu filloi ta ndiqte nga pas. Ajo fluturonte lule më lule, ai u lodh duke e ndjekur dhe për një moment kur kthehet, nëna e tij nuk ishte askund. Ariu filloi të qante, sepse e kuptoi që kishte humbur. Për një kohë të gjatë eci nëpër pyll. Ishte i lodhur dhe</i></p>



i uritur e kur pa një koshere bletësh, deshi të merrte pak mjaltë. Posa vendosi dorën për të marrë mjaltë, të gjitha bletët e sulmuan. Ai u largua me vrap, hyri në një shkurre dhe ra në gjumë. Kur u zgjua ishte mbrëmje dhe pylli ishte shumë i errët. Filloi të thoshte me vete: "O mami, si do ta gjej unë shtëpinë? Të betohem, nuk do të largohem më!". Ariu i mërzhitur pa një dritë misterioze, që dukej si një llambë magjike në mes të pyllit dhe vendosi ta ndiqte nga pas. Duke u afruar, pa se nuk ishte llambë magjike, por një xixëllonjë.

- Përshëndetje, xixëllonjë! - tha ariu duke qarë me hidhërim.

- Përshëndetje, ari! Pse po qan? - e pyeti xixëllonja.

- Kam humbur, kështu e gjej unë kur nuk dëgjoj! Nuk mund të gjej nënën time, - foli ariu i vogël.

- Ku është shtëpia jote? - e pyeti xixëllonja.

- Shtëpia ime është te pishat e prera, aty janë disa shkurre dhe një llambë e madhe.

- Unë e di, unë e di se ku është! Eja me mua! - fluturoi xixëllonja.

Ariu e ndoqi xixëllonjën nga pas, e cila bënte dritë në pyllin e errët. Kështu xixëllonja me dritën e saj e ndihmoi ariun të gjente shtëpinë e tij. Prindërit e ariut të vogël e falënderuan xixëllonjën për veprimin e saj.

(tregim i modifikuar dhe i përkthyer nga portugalishtja)

Edukatori/ja gjatë leximit drejton pyetje për të kuptuar sa e kuptueshme është pjesa nga ana e fëmijëve. Pas përfundimit të leximit, pyet fëmijët se me çfarë i ngjasonte ariut të vogël xixëllonja, duke përsëritur fjalën LLAMBA. Ai/ajo kërkon nga fëmijët të tregojnë se me cilin tingull fillon fjala LLAMBA, kërkon ta ndajnë në rrokje dhe të numërojnë sa rrokje ka ajo. Edukatori/ja paraqet grafikun e shkronjës LL; kërkon nga fëmijët të krijojnë shkronjën LL me fasule, si dhe të gjejnë fjalë që fillon apo ka në përbërje bashkëtingëlloren LL (të ndajnë dhe të numërojnë rrokjet në fjalët e gjetura).

Fëmijët ndahen për punë në grupe të vogla:

Njëri grup do të ndërtojë me material të ripërdorshëm një llambë.

Njëri grup do të plotësojë fletëzat e punës.

Njëri grup do të dramatizojë përrallën me kukulla dore.

Fëmijët e grupit tjetër do të vizatojnë sipas mënyrës së tyre ngjarjen e treguar.

Në takimin përmbyllës diskutohet për punën e bërë gjatë ditës.

Vlerësimi: Fëmijët vlerësohen përgjatë realizimit të aktiviteteve përmes vëzhgimit dhe mbajtjes së shënimeve nga ana e edukatorit/es.

Më shumë për të bërë: Fëmijët mund ta praktikojnë shkrimin e shkronjës LL në tabakatë me rërë.

Reflektimi: _____

Ky/kjo jam unë

Fusha kurrikulare:	Artet
Kurrikula lëndore:	Edukatë muzikore
Tema nga plani dymujor:	Lojërat muzikore
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):	I. 3, 4, 5; II. 1, 7; III. 2, 3, 6; IV. 4; V. 5; VI. 6
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):	Artet: 1 Gjuhët dhe komunikimi: 1. 2; 1. 4 Jeta dhe puna: 2. 8. 1
Rezultati i të nxënit të temës:	Luan lojëra të ndryshme, ku sinkronizohen fjala, muzika, mimika, lëvizja, ana vizuale etj. (tematika e lojërave përshtatet me tematikat nga fushat e tjera mësimore për këtë klasë).
Rezultatet e të nxënit të aktiviteteve:	<ul style="list-style-type: none"> • Këndon së paku një varg të këngës së mësuar. • Shoqëron me lëvizje trupore këndimin. • Krijon modelin e tij trupor me materialet që disponon.
Kriteret e suksesit:	<ul style="list-style-type: none"> • Këndo së paku një varg të këngës së mësuar. • Shoqëro me lëvizje trupore këndimin. • Krijo modelin trupor në tabelë.
Burimet dhe materialet:	CD, tabelë (letër e hollë e madhësisë A0), enciklopedi për trupin e njeriut ose poster me trupin e njeriut, ngjyra druri, ngjyra uji, gërshërë, materiale zbkuruese, ngjitës, kukull dore.
Integrimi ndërfaqor:	Gjuhë shqipe, Shkathësitë për punë.
Çështjet ndërkurrikulare:	Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.
Fjalë kyçe:	Model trupor, koka, krahët, gjunjët, gishtat, veshët, sytë, hunda, goja.
Organizimi i aktiviteteve:	<p>Sot, edukatori/ja përshëndetjen dhe kalendarin e motit do ta zhvillojë me anë të kukullës së dorës.</p> <p>Më pas, së bashku me fëmijët luajnë lojën ritmike “Koka, krahët, gjunjët dhe gishtat”. Edukatori/ja thotë tekstin me melodi dhe e shoqëron me lëvizje trupore. Niset me ritëm të ngadaltë, duke e përshpejtuar pak nga pak. Fëmijët janë të ulur në formë rrethi dhe ndjekin edukatorin/en. Pas lojës, të gjithë rrinë disa minuta në qetësi.</p> <p>Edukatori/ja sjell përpara fëmijëve një enciklopedi (mund të jetë edhe poster i pjesëve të trupit) dhe së bashku me fëmijët bisedojnë rreth tyre. Edukatori/ja nxit fëmijët të flasin, përmes pyetjeve dhe perifrazimeve.</p> <p>Fëmijët do të ndihmojnë njëri-tjetrin në ndërtimin e modelit të tyre trupor. Këtë kanë mundësi ta bëjnë në tabelën e madhe me fletë të bardha, ose në blloqet e tyre të vizatimit. Edukatori/ja i lë fëmijët të lirë të mund të gjejnë materiale alternative, përmes së cilave mund të</p>

ndërtojnë modelin e tyre trupor. Fëmijët do të vizatojnë, dekorojnë dhe paraqesin veten si të kenë dëshirë. Në fund, pasi kanë pastruar hapësirën e punës, mblidhen të gjithë bashkë për takimin përmbyllës. Secili prej tyre do të tregojë punën që ka bërë për të paraqitur modelin e vet trupor.

Vlerësimi: Edukatori/ja do të vëzhgojë fëmijët gjatë zhvillimit të aktivitetit dhe do të mbajë shënime narrative mbi situatat që vlerëson se duhet të mbahen shënime. Po ashtu, ai/ajo mund të dokumentojë përmes regjistrimit punën që fëmijët janë duke bërë.

Më shumë për të bërë: Fëmijëve mund t'u mësohet në gjuhën angleze loja ritmike "Head, Shoulders, Knee s& Toes - Exercise Song Fo Kids".

Nëse në grupin tuaj edukativ keni fëmijë me nevoja të veçanta, mund të modifikoni aktivitetin, në mënyrë që t'u përgjigjeni edhe nevojave të tij/saj. Krijoni hapësirë për ekspozimin e punës së bërë, nëse fëmijët e dëshirojnë një gjë të tillë. Modelet trupore të fëmijëve mund t'i vendosni edhe në hyrje të institucionit apo në korridor.

Reflektimi:

Njoh trupin tim

Fusha kurrikulare: Shkenca dhe natyra

Kurrikula lëndore: Njeriu dhe natyra

Tema nga plani dymujor: Bimët kafshët dhe njeriu

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I. 3, 4, 5; II. 1, 7; III. 2, 3, 6; IV. 4; V. 5; VI. 6

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): Shkenca dhe natyra: 1
Gjuhët dhe komunikimi: 1. 2; 1. 4
Matematikë: 3. 1
Shoqëria dhe mjedisi: 1. 1. 1

Rezultati i të nxënit të temës: Dallon pjesët kryesore të trupit të njeriut.

Rezultatet e të nxënit të aktiviteteve:

- Emërton pjesët e jashtme të trupit përgjatë aktivitetit.
- Krijon trupin duke bashkuar pjesët tij.
- Përshkruan funksionin e disa prej pjesëve të trupit.

Kriteret e suksesit:

- Emërto pjesët e jashtme të trupit përgjatë aktivitetit.
- Krijto trupin duke bashkuar pjesët e tij.
- Përshkruaj funksionin e disa prej pjesëve të trupit.

Burimet dhe materialet:

Libër me tregime (mbi trupin e njeriut), shami, ngjites, gërshërë, ngjyra, domino, materiale të përgatitura nga edukatori/ja.

Integrimi ndërfaqor:

Gjuhë shqipe, Matematikë, Shoqëria dhe mjedisi.

Çështjet ndërkurrikulare:

Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

Fjalë kyçe:

Trupi, koka, syri, veshi, goja, hunda, qafa, krahu, dora, gjuri, këmba, shputa e këmbës, gishtat etj.

Organizimi i aktiviteteve:

Edukatori/ja fton fëmijët ta fillojnë ditën në këndin ku janë ekspozuar modelet trupore të fëmijëve. Edukatori/ja u kërkon të ritregojnë mënyrën se si kanë punuar dhe se si kanë luajtur me njëri-tjetrin gjatë finalizimit e punës. Edukatori/ja nxit fëmijët të flasin për mënyrën sesi kanë arritur deri në përfundimin e punës. Më pas, u kërkon të tregojnë se cila pjesë e trupit ka shërbyer për të përfunduar një veprim të caktuar. Në këtë mënyrë, fëmijët kanë mundësinë të bëjnë lidhjen e secilës pjesë të trupit me funksionin që ajo kryen. Edukatori/ja duhet të ketë kujdes që gjatë diskutimit t'i përfshijë të gjithë fëmijët.

Fëmijët nxiten të dëgjojnë një tregim (tregimi duhet të jetë i ndërlidhur me pjesët e trupit dhe funksionin e tyre). Gjatë leximit, edukatori/ja u bën pyetje fëmijëve dhe kërkon nga ata të bëjnë parashikime se çfarë do të ndodhë më tej. Ndalesat mund të bëhen në varësi të gjatësisë dhe të natyrës së tregimit. Edukatori/ja kërkon nga fëmijët të ritregojnë me fjalët e tyre tregimin dhe të thonë pse u ka pëlqyer. Pas kësaj, dita vazhdon me lojën "Gjeje dhe trego".

Ecuria e lojës: një fëmijë i lidh sytë me shami, dhe përmes prekjës duhet të identifikojë shokun ose shoqen e tij. Fëmijës me sy të mbyllur i lejohe të bëjë pyetje, ndërsa përgjigjet mund të jepen nga një shok/shoqe tjetër. Fëmija i tretë, i cili po qëndron para shokut/shoqes me sy të mbyllur, nuk ka të drejtë të flasë, pasi mund të identifikohet prej zërit. Loja zgjat aq sa fëmijët kanë interes për të luajtur.

Më tej, fëmijët ndahen në grupe të vogla. Njëri grup do të luaj me domino me pjesët e trupit.

Grupi tjetër do të vizatojë vetëveten.

Ndërsa grupi i fundit do të bashkojë pjesët e trupit sipas vendit përkatës (material i përgatitur nga edukatori/ja).

Pasi të përfundojnë aktivitetet, fëmijët kthehen në rreth dhe kujtojnë e thonë me fjalë të thjeshta se cilat janë pjesët e trupit të njeriut. Edukatori/ja thekson: "Edhe pse në pamjen e jashtme ndryshojmë nga njëri-tjetri nga ngjyra e syve, flokëve apo nga gjatësia, trupi ynë është ndërtuar njësoj."

**Vlerësimi:**

Edukatori/ja vëzhgon fëmijët përgjatë aktiviteteve për të parë se sa kanë qenë në gjendje të paraqesin e të bëjnë lidhjen e pjesëve të trupit.

Më shumë për të bërë:	Nëse mjafton koha, mund të luhet edhe loja ritmike “Koka, krahët, gjunjët dhe gishtat”. Nëse ndonjëri nga fëmijët nuk ka dëshirë të mbyllë sytë me shami gjatë lojës, asaj/atij duhet t’i respektohet kërkesa, në të njëjtën kohë edukatori/ja mund ta mbajë shënim një të dhënë të tillë. Mund të përdorin linkun në gjuhën angleze për pjesët e trupit: https://www.youtube.com/watch?v=SUt8q0EKbms
-----------------------	--

Reflektimi:

Dora e dëshirave

Fusha kurrikulare:	Gjuhët dhe komunikimi
Kurrikula lëndore:	Gjuhë shqipe
Tema nga plani dymujor:	Tinguj, shkronja, rrokje, fjalë, fjali
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):	I. 3, 4, 5; II. 1, 7; III. 2, 3, 6; IV. 4; V. 5; VI. 6
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):	Gjuhët dhe komunikimi: 1. 1; 3. 2 Matematikë: 3. 4 Artet: 1
Rezultati i të nxënit të temës:	Shqiptojnë drejt tingujt, zanoret dhe bashkëtingëlloret gjatë të shprehurit.
Rezultatet e të nxënit të aktiviteteve:	<ul style="list-style-type: none"> • Identifikon së paku tri fjalë me tingullin D. • Vizaton dorën e tij/saj në materialet që ka.
Kriteret e suksesit:	<ul style="list-style-type: none"> • Gjej së paku tri fjalë me tingullin D. • Vizato dorën në materialet që mund të përdorësh.
Burimet dhe materialet:	Letër, gërshërë, ngjyra, karta të vogla të plastifikuara me gjërat që fillojnë me shkronjën D, libri i punës së fëmijës, mjete ndihmëse, domino.
Integrimi ndërfaqor:	Matematikë, Edukatë figurative.
Çështjet ndërkurrikulare:	Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

Fjalë kyçe: Duar, krijim, tingulli D, paraqitja grafike e shkronjës D.

Organizimi i aktiviteteve: Dita fillon me përshëndetjen me fëmijët dhe lojën ritmike "Hapni-mbyllni".
Ecuria e lojës: Të gjithë fëmijët, së bashku me edukatorin/en, të ulur në rreth, përsërisin fjalët dhe veprimet me duar.

Fjalët përsëriten nga dy herë:

*Hapni-mbyllni!
Hapni-mbyllni duart!
Vendosni duart në gjunjë!
Lart-poshtë
E madhe - e vogël
E ftohtë - e nxehtë!*

Kështu, fëmijët imitojnë lëvizjet dhe i kryejnë së bashku me edukatorin/en. Edukatori/ja kërkon nga fëmijët të bëjnë një përshkrim të shkurtër të ditëve të kaluara dhe dalëngadalë përmes diskutimit nxjerr në pah se sa shumë punë kreative kanë bërë gjatë asaj kohe, duke vendosur theksin në punëdoret e krijuara me materiale të ndryshme.

Në një kuti, edukatori/ja ka përgatitur paraprakisht disa fotografi të vogla, të cilat janë të ndryshme për nga përmbajtja (dora, dardha, dielli, dera, daullja, dimri, dordoleci, dëshira, dorashka, delja etj.), por të gjitha kanë një karakteristikë të përbashkët: sendet që ndodhen në fotografi, fillojnë me shkronjën D. Edukatori/ja shpërndan fotografitë dhe çdo fëmijë zgjedh një në mënyrë rastësore. Pas kësaj, fëmijët përpiqen të ndërtojnë një histori të plotë me figurat që kanë në duar. Historitë e krijuara në këtë mënyrë janë përherë gazmore dhe krijojnë një klimë harmonie mes fëmijëve. Në fund, edukatori/ja i përgëzon fëmijët për punën e mirë dhe për imagjinatën dhe u kërkon të gjejnë se çfarë kanë të përbashkët letrat që mbajnë në duar. Kështu integrohet diskutimi për tingullin D, edukatori/ja kërkon nga fëmijët të tregojnë cili është tingulli i parë, i njuh me grafikun e shkronjës D, dhe i nxit të gjejnë fjalë të tjera që fillojnë me këtë tingull apo që e përmbajnë atë. Në tabelat magnetike apo në ato të thjeshtat, fëmijët, sipas dëshirës praktikojnë shkrimin e shkronjës D.

Edukatori/ja organizon punën në tri grupe, ku fëmijët do të ndahen sipas dëshirës. Njëri grup do të vizatojë "dorën e dëshirave", duke vizatuar brenda dëshirat e veta dhe duke e zbukuruar; një tjetër grup do të plotësojë fletëzën e punës për shkronjën D; një tjetër do të luaj me domino. Më pas, fëmijët mund të ndryshojnë vendet e tyre me rotacion, në mënyrë që të gjithë të marrin pjesë në të tria aktivitetet.

Punimet do të varen në këndin e ekspozitës. Pas përfundimit të aktiviteteve, fëmijët, bashkë me edukatoren, do të mblidhen për takimin përmblyllës pranë këndit ku janë ekspozuar punimet e tyre.

Vlerësimi: Edukatori/ja plotëson fletët e vlerësimeve bazuar në planin e vlerësimit, duke vëzhguar përparimin e fëmijëve.

Më shumë për të bërë: Nëse kushtet e motit ju lejojnë, mund të dilni në oborrin e institucionit dhe të zhvillonin ndonjë lojë ritmike që ka të bëjë me duart, por edhe me pjesët e trupit.

Reflektimi: _____



Trupi im në lëvizje

Fusha kurrikulare:	Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti
Kurrikula lëndore:	Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti
Tema nga plani dymujor:	Lojërat dhe pushimi
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):	I. 3, 4, 5; II. 1, 7; III. 2, 3, 6; IV. 4; V. 5; VI. 6
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):	Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti: 2. 1 Gjuhët dhe komunikimi: 1. 1; 1. 4 Matematikë: 2. 1
Rezultati i të nxënit të temës:	Praktikon lojëra dhe aktivitete fizike në bashkëpunim, në çifte dhe grupe.
Rezultatet e të nxënit të aktiviteteve:	<ul style="list-style-type: none"> • Kërçen me thes gjatë lojës. • Tërheq litarin në drejtim të vetës me të dyja duart. • Ndërton maketin e mënyrës së funksionimit të mushkërive.
Kriteret e suksesit:	<ul style="list-style-type: none"> • Kërce me të dyja këmbët në thes. • Tërhiq litarin në drejtim të vetes me të dyja duart. • Ndërto maketin e mënyrës së funksionimit të mushkërive.
Burimet dhe materialet:	Libër enciklopedik për organizmin e njeriut, litar, thes, gërshtë, ngjitës shirit, tiketa me numra nga 1-4, pipëza, qese të vogla plastike.
Integrimi ndërfaqor:	Gjuhë shqipe, Matematikë.
Çështjet ndërkurrikulare:	Zhvillim personal dhe aftësitë për jetë.
Fjalë kyçe:	Ndryshime, frymëmarrje, lodhje, çlodhje, muskuj, shëndet.
Organizimi i aktiviteteve:	Edukatori/ja përshëndetet me fëmijët në rreth, fton fëmijët të luajnë lojën ritmike.

"Përshëndetje! Përshëndetje!"
Përshëndetje! Përshëndetje! Duart t'i shtrëngojmë.
Erdhi koha, erdhi koha ne të mësojmë.
Të gjithë duartrokasim tri herë: një, dy, tre.
Të gjithë të hidhemi tri herë: një, dy, tre.
Të gjithë të rrotullohemi: një, dy, tre.
Të gjithë të hidhemi tri herë: një, dy, tre.
Përshëndetje! Përshëndetje!
Erdhi koha, erdhi koha ne të mësojmë.
Të gjithë të rrotullohemi tri herë: një, dy, tre.
Përshëndetje! Përshëndetje!
Të gjithë të përqafohemi.
Tani të ulemi.

Kur fëmijët ulen, edukatori/ja u kërkon të vendosin dorën në kraharor dhe të dëgjojnë rrahjet e tyre të zëmres; rikujtojnë pjesët e trupit, të cilat i kanë mësuar gjatë këtyre ditëve. Në këtë pikë, edukatori/ja u shpjegon edhe për organet e brendshme të trupit të njeriut, për mënyrën se si funksionojnë dhe na mundësojnë kryejmë të gjitha funksionet jetike.

Së bashku diskutohet për rëndësinë e aktivitetit fizik, ushqimit dhe çlodhjes së organizmit, në mënyrë që trupi të funksionojë sa më mirë.

Më pas, fëmijët do të zhvillojnë aktivitete lëvizore.

Edukatori/ja fton fëmijët të luajnë "Gara me thes". Grupi ndahet në dy skuadra; fëmijët futen në thes dhe në çastin kur bie sinjali, nis gara. Në përfundim, edukatori/ja u kërkon fëmijëve të dëgjojnë me kujdes ritmin e frymëmarrjes së tyre dhe rrahjet e zëmres. Pas garës, të gjithë fëmijët ulen të pushojnë e të bisedojnë për 3-4 minuta për rëndësinë e lëvizjes, si janë ndier etj.

Fëmijët ndahen sërish në katër skuadra të tjera, në bazë të etiketave me numrat nga 1-4, që kanë zgjedhur. Do të luajnë lojën "Tërhiq litarin" në skuadra sipas numrave. Pas përfundimit të lojës, fëmijët do të çlodhen për 2-3 minuta dhe gjatë kësaj kohe do të mendojnë se çfarë ndodh me trupin e tyre në gjendje qetësie e lëvizjeje.

Në vazhdim, edukatori/ja u parqet fëmijëve një enciklopedi, e cila shpjegon organizmin e njeriut dhe u tregon se si ajri i pastër që futet në organizëm, na ndihmon të jemi shëndetshëm.

Sillen në tryezë pipëza, qese plastike të vogla të tejdukshme dhe ngjitës. Përmes dy pipëzave të lidhura me ngjitës me nga një qese të vogël plastike, të tejdukshme, fëmijët mund të kuptojnë si dhe pse lëviz kraharori gjatë frymëmarrjes, si futet oksigjeni në trupin e njeriut dhe si qarkullon në mushkri. Pasi edukatori/ja ndërton një sistem të tillë, fëmijët marrin materialet e nevojshme që ta ndërtojnë edhe ata (duke qenë se fëmijët duhet ta mbushin qesen me ajër, për arsye higjienike këshillohet që secili të ketë modelin e vet). Edukatori/ja jep udhëzimet e nevojshme dhe ndihmë atëherë kur fëmijët e kërkojnë.

Kur të kenë përfunduar punimet, fëmijët do të kthehen në rreth për takimin përmbyllës, që të bisedojnë për aktivitetet e ditës së sotme.

Vlerësimi:

Edukatori/ja plotëson fletët e vlerësimeve bazuar në planin e vlerësimit, duke vëzhguar përparimin e fëmijëve.

Më shumë për të bërë:

Nëse fëmijët shfaqin interes për të ditur më tepër për mënyrën se si funksionon organizmi, mund të planifikoni një javë të plotë aktivitete, për t'i ndihmuar të kuptojnë mënyrën se si funksionon secili organ më vete dhe si funksionon organizmi si tërësi. Kjo mund të jetë lehtësisht e realizueshme nëse përdorim një enciklopedi për fëmijë, që shpjegon në mënyrë të qartë; mund të përdoren edhe materiale ilustruese shpesh. Edukatori/ja mund të sigurojë edhe një stetoskop, përmes së cilit mund të dëgjojnë rrahjet e zëmres së njëri-tjetrit.

Reflektimi:

Nga një, në asnjë

Fusha kurrikulare:	Matematikë
Kurrikula lëndore:	Matematikë
Tema nga plani dymujor:	Numrat natyrorë
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):	I. 3, 4, 5; II. 1, 7; III. 2, 3, 6; IV. 4; V. 5; VI. 6
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):	Matematikë: 5. 1 Gjuhët dhe komunikimi: 1. 1; 1. 4 Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti: 1
Rezultati i të nxënit të temës:	Numëron të paktën nga 1 deri në 10 dhe anasjellas me anë të mjeteve të konkretizimit.
Rezultatet e të nxënit të aktiviteteve:	<ul style="list-style-type: none"> • Identifikon numrin 0 si numrin që tregon zero elemente. • Zhvillon aktivitete përmes së cilave kupton vlerën e zeros. • Përshkruan ilustrimet nga enciklopedia/libri i paraqitur gjatë takimit.
Kriteret e suksesit:	<ul style="list-style-type: none"> • Identifiko numrin 0 si numrin që tregon zero elemente. • Merr pjesë në aktivitete përmes së cilave kupton vlerën e zeros. • Përshkruaj ilustrimet nga enciklopedia/libri i paraqitur gjatë takimit.
Burimet dhe materialet:	Letër e madhe A2, libër enciklopedik (ose poster me trupin e njeriut), kuti me karamelle me mbështjellës (aq karamelle sa fëmijë ka në grup), tapa shishesh, shportë, numra të mëdhenj nga 0-6 të printuar në fletë A4.
Integrimi ndërfaqor:	Gjuhë shqipe, Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti.
Çështjet ndërkurrikulare:	Zhvillim i qëndrueshëm.
Fjalë kyçe:	Trupi, pjesët e trupit, numri 0, petëza gjeometrike.
Organizimi i aktiviteteve:	<p>Në takimin e përbashkët, pas përshëndetjes, diskutimit rreth motit dhe plotësimit të kalendarit, edukatori/ja fton fëmijët në një lojë të përbashkët ritmike "Koka, krahët, gjunjët dhe gishtat". Loja fillon me lëvizje të ngadalshme, duke u përshpejtuar në vazhdim të lojës. Pas përfundimit të lojës, fëmijët çlodhen për 2-3 minuta.</p> <p>Edukatori/ja merr një kuti me karamelle (aq sa ka fëmijë) dhe secili fëmijë merr nga një për vete. Kutinë e zbrazët të karamelleve e vendos në mes të rrethit, në mënyrë që ta shohin të gjithë.</p> <p>Përmes diskutimit, edukatori/ja u shpjegon fëmijëve se në matematikë, kur nuk ka asnjë send, përdorim shifrën zero. Shkruan grafikisht numrin 0 në një fletë të madhe A3. U tregon fëmijëve shportën e zbrazët të karamelleve. Të gjithë fëmijët udhëzohen të hanë karamellet që kanë në dorë. Në fillim kishin nga një karamelle, tani në dorë kanë zero. Kështu, ata mund ta kuptojnë më lehtësisht çfarë nënkupton ky koncept. Me</p>

letrat mbështjellëse të karamelëve do të zbukurojnë formën e numrit zero. Fleta e madhe me numrin 0 do të ekspozohet në këndin e klasës. Fëmijët ndahen në tri grupe.

Njëri grup do të formojë me kripë numrat nga 0-5.

Një tjetër grup do të plotësojë fletëzën e aktivitetit të numri 0.

Grupi i fundit do të ndërtojnë me petëza trupin e njeriut.

Në takimin përfundimtar, do të kryhet një aktivitet lëvizor, kku kërkohet nga fëmijët që të marrin përpara një sasi tapash shisheje, që do t'i kalojnë nga njëra shportë te tjetra. Edukatori/ja jep udhëzimin pa folur, por duke ngritur lart grafikun e një numri; fëmija nis të veprojë në bazë të numrit të treguar. Për shembull: nëse tregohet numri gjashtë, fëmija do të kalojë 6 tapa, nëse tregohet numri zero, nuk duhet të kryhet asnjë veprim, fëmijët nuk lëvizin nga vendi. Loja përfundon derisa të kenë luajtur të gjithë.

Vlerësimi:

Vlerësimi bëhet ndërmjet evidencës së vazhdueshme në listat e kontrollit për fëmijët e caktuar sipas planit të vlerësimit.

Më shumë për të bërë:

Mund të përdorni edhe aktivitete të tjera të individualizuara, që fëmijët të kuptojnë me mirë konceptin e zeros. Kjo mund të funksionojë shumë mirë nëse përgatiten aktivitete për grupe të vogla me nga 3-5 fëmijë.

Reflektimi:

Të gjithë në festë!

Fusha kurrikulare:	Shoqëria dhe mjedisi
Kurrikula lëndore:	Shoqëria dhe mjedisi
Tema nga plani dymujor:	Festat
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):	I. 3, II. 2, 7; III. 1, 2, 6; IV. 3, 4; V. 2, 5; VI. 5, 6
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):	Shoqëria dhe mjedisi: 3. 1 Gjuhët dhe komunikimi: 1. 1; 1. 4 Matematikë: 2. 1 Artet: 3
Rezultati i të nxënit të temës:	Emërton disa festa familjare dhe shoqërore dhe në mënyrën e tij, përshkruan organizimin dhe festimin e tyre.
Rezultatet e të nxënit të aktiviteteve:	<ul style="list-style-type: none"> • Përshkruan me fjalë mënyrën se si festohet në familjen e tij/saj. • Emërton festën e 17 Shkurtit si festë shoqërore. • Njihet me simbolet shtetërore.
Kriteret e suksesit:	<ul style="list-style-type: none"> • Përshkruaj se si i feston festat në familjen tënde. • Emërto së paku një festë shoqërore. • Diskuto mbi simbolet shtetërore.
Burimet dhe materialet:	Shirita dekorativë të kaltër, të verdhë dhe të bardhë, flamur, CD-himni shtetëror, hartë, letra, ngjyra, lojë (simbolet shtetërore).
Integrimi ndërfaqor:	Gjuhë shqipe, Matematikë, Edukatë muzikore.
Çështjet ndërkurrikulare:	Edukim për qytetari demokratike.
Fjalë kyçe:	Simbol shtetëror, flamur, festa, himni shtetëror, harta, Kosova.
Organizimi i aktiviteteve:	<p>Në derën e klasës përgatitore, edukatori/ja vendos disa shirita para se të vijin fëmijët. Gjatësia duhet të jetë e tillë që fëmijët të duhet t'i largojnë përpara se të hyjnë brenda.</p> <p>Takimi i përbashkët fillon me përshëndetjen me fëmijët, duke i pyetur se si kanë kaluar gjatë ditëve të pushimit dhe kohës që kanë kaluar në familje. Këtu mund të krijohen dy situata: fëmijët të pyesin për shiritat dekorativë ose edukatori/ja pyet fëmijët. Në të dyja situatat, edukatori/ja nxit fëmijët të mendojnë arsyen pse ata shirita do të jenë pjesë e zbukurimit të sallës gjatë asaj jave. Luhet loja me memorie me simbolet shtetërore, të përgatitura paraprakisht nga edukatori/ja. Ata/ato njihen me disa nga simbolet shtetërore, si: flamuri shtetëror, stema shtetërore, harta e Kosovës, plisi, figura historike etj.</p> <p>Edukatori/ja bën një përshkrim në formë tregimi për festën e 17 Shkurtit dhe u tregon fëmijëve se çfarë do të thotë fjala festë, e ndërlidh me ditëlindjet e fëmijëve dhe mënyrën se si Kosova u formua si shtet. Po</p>

ashtu, tregon edhe historinë se si u formua shteti i Kosovës (ky shpjegim duhet të jetë i thjeshtuar e më së shumti të përsërisë dijet e fëmijëve). Në këtë mënyrë, fëmijët mësohen pak nga pak edhe me simbolet shtetërore. Edukatori/ja lëshon himnin shtetëror për ta dëgjuar të gjithë së bashku.

Më pas, edukatori/ja ka sistemuar katër kënde për punë artistike, duke ofruar materiale të ndryshme në secilin prej tyre. Fëmijët ndahen në katër grupe, në mënyrë rastësore, ku do të punojnë flamuj dhe simbole shtetërore me materiale dhe teknika të ndryshme. Në përfundim të aktivitetit, punimet ekspozohen në këndin e klasës dhe pasi të pastrohet hapësira ku fëmijët kanë punuar, të gjithë mbledhen në rreth për të diskutuar gjërat që zhvilluan gjatë ditës e të bëjnë planifikim për aktivitetet që do të kryejnë të nesërmen. Fëmijët japin ide nga më të ndryshmet për mënyrën se si mund të festojmë festën e 17 Shkurtit në grupin edukativ.

Vlerësimi:

Fëmijët do të inkurajohen në mënyrë të vazhdueshme nga edukatori/ja në të shprehurit me gojë për përshkrimin e festave në familjet e tyre.

Më shumë për të bërë:

Kërkoni nga prindërit të bisedojnë me fëmijët për rëndësinë e respektimit të festave shtetërore, veçanërisht të festës së shtetformimit të Kosovës. Bisedoni me ta për historinë e vendit; nxisni prindërit t'u tregojnë fëmijëve fotografi të vjetra të vendit të tyre, familjes, mënyrës së jetesës.

Reflektimi:

17 Shkurti

Fusha kurrikulare:	Gjuhët dhe komunikimi
Kurrikula lëndore:	Gjuha shqipe
Tema nga plani dymujor:	Tinguj, shkronja, rrokje, fjalë, fjali
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):	I. 3, 5; II. 1, 2, 7; III. 1, 2, 6; IV. 3, 4; V. 2, 5; VI. 5, 6
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):	Gjuhët dhe komunikimi: 1. 1; 1. 2; 1. 7; 2. 5; 3. 2 Matematikë: 2. 2 Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti: 2. 2
Rezultati i të nxënit të temës:	Shqiptojnë drejt tingujt, zanoret dhe bashkëtingëlloret, gjatë të shprehurit.
Rezultatet e të nxënit të aktiviteteve:	<ul style="list-style-type: none"> • Zbulon figurën e fshehur gjatë lojës në rreth. • Krijon modelin matematikor sipas ngjyrave të flamurit. • Modelon me materiale të ndryshme shkronjën SH.
Kriteret e suksesit:	<ul style="list-style-type: none"> • Zbulon figurën e fshehur. • Krijon modelin matematikor sipas ngjyrave të flamurit. • Përzgjedh materialin për të modeluar shkronjën SH.
Burimet dhe materialet:	Letër, shirita zbukurues, fije peri, kapak, oriz, grurë, gërshërë, ngjitës i lëngshëm, materiale me zgjedhje të lirë të fëmijëve parashuta, balona.
Integrimi ndërfaqor:	Matematikë, Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti.
Çështjet ndërkurrikulare:	Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.
Fjalë kyçe:	Kosova, 17 Shkurti, festë shtetërore, tingulli SH, shkronja SH.
Organizimi i aktiviteteve:	<p>Takimi i përbashkët fillon me përshëndetjen e fëmijëve, ku edukatori/ja përdor teknika të ndryshme të mirëseardhjes. Fëmijët priten me muzikë festive në rreth dhe pas leximit të kalendarit, ndalemi te data 17 Shkurt dhe të veçantat e saj.</p> <p>Edukatori/ja përgatit disa karta/fotografi me simbole, të cilat paraqesin festën e 17 Shkurtit. I rendit në mes të rrethit dhe sipër tyre vendos një mbulesë. Fshehurazi largon një nga kartat dhe i zbulon ato. Fëmijët duhet të identifikojnë kartën që mungon. Kështu vazhdon loja duke e rritur nivelin e vështirësisë. Brenda kartave është edhe shkronja SH. Edukatori/ja qëllimisht tërheq të fundit nga kartat shkronjën SH; identifikohet tingulli. Identifikohen karakteristikat e shkronjës dyshe. Më pas, fëmijët do të gjejnë fjalë me shkronjën SH. Edukatori/ja lexon vjershën për 17 Shkurtin dhe bashkërisht me fëmijët komentojnë mesazhin e saj.</p> <p>Edukatori/ja ka përgatitur mjedisin për punë me grupe të vogla.</p> <p>1. Modelon me materiale të ndryshme shkronjën SH.</p>

2. Në bazë të ngjyrave të flamurit, fëmijët do të ndjekin radhën e modeleve matematikore.

3. Të plotësojnë fletëzat e punës për shkronjën Sh.

Dita përfundon me takim përmblyës, ku së bashku do të përsërisin vjershën e 17 Shkurtit, si dhe do të rikujtojnë përsëri aktivitetet e zhvilluara. Të gjithë së bashku do të dalin në oborrin e institucionit parashkollor/shkollës dhe do të luajnë lojëra me parashutë me balona. Dita përfundon me një atmosferë festive.

Vlerësimi: Fëmijët do të mbikëqyren përgjatë aktiviteteve nga edukatori/ja dhe në bazë të planit të vlerësimit, do të vlerësohen.

Më shumë për të bërë: Fëmijët, me ndihmën e prindërve, do të gjejnë figura me shkronjë SH dhe do t'i ngjisin në fletë A4.

Reflektimi:

Në kërkim të flamujve

Fusha kurrikulare: Artet

Kurrikula lëndore: Edukatë figurative

Tema nga plani dymujor: Krijimet figurative

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): **I. 3; II. 3, 7; III. 1, 2, 6; IV. 2; V. 2, 5; VI. 6**

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): Artet: 1
Gjuhët dhe komunikimi: 1. 1; 1. 4
Matematikë: 2. 1

Rezultati i të nxënit të temës: Me materiale të ndryshme krijojnë dhe riciklojnë sipas fantazisë e imagjinatës, vizatojnë, ngjyrosin, modelojnë, shtypin, për tema të ndryshme që trajtohen në shkollë dhe jashtë saj, duke përdorur: format me ngjyra, pemët, lodrat dhe tema të lira ku shprehet imagjinata dhe kreativiteti i tyre vetjak.

Rezultatet e të nxënit të aktiviteteve:

- Dallon flamurin e Kosovës nga flamujt e tjerë.
- Ndërton kapelën festive sipas modelit të dhënë.
- Ndërton flamurin e Kosovës me materiale të ndryshme, në grup.

Kriteret e suksesit:

- Dallo cili është flamuri i Kosovës.
- Ndiq modelin e dhënë për të ndërtuar kapelën festive.
- Me materiale të ndryshme, në grup, ndërto flamurin e Kosovës.

Burimet dhe materialet:	Fletë e madhe A0, ngjitës, gërshërë, letra të bardha dhe me ngjyra, ngjyra, (modele të printuara kapelash), materiale të ndryshme ku dominon ngjyra e kaltër, e bardhë dhe e verdhë, materiale letre, kapak, materiale pambuku, flamuj tavoline të vendeve të ndryshme.
Integrimi ndërfushor:	Gjuhë shqipe, Matematikë.
Çështjet ndërkurrikulare:	Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.
Fjalë kyçe:	Festa e 17 Shkurtit, Dita e Pavarësisë, Kosova, flamuri.
Organizimi i aktiviteteve:	<p>Dita fillon me përshëndetje mirëseardhëse; edukatori/ja në varësi të kushteve të motit mund ta zhvillojë takimin në ambientet e brendshme ose jashtë.</p> <p>Fëmijët do të luajnë lojën “Në kërkim të flamujve”. Edukatori/ja fillimisht ka shpërndarë nëpër klasë (në varësi të vendit ku do të zhvillohet aktiviteti) flamuj të vendeve të ndryshme (7 copë) edhe flamuj të Kosovës (në numër të njëjtë). Flamujt fshihen aty ku fëmijët kanë mundësi të eksplorojnë. Caktohen rregullat e lojës, ndërsa grupi ndahet në dy skuadra, që kanë detyra të ndryshme. Njëra skuadër do të mbledhë flamujt e Kosovës, tjetra flamujt e tjerë. Gara e flamujve përfundon atëherë kur të jenë gjetur të gjithë flamujt.</p> <p>Më pas fëmijët qetësohen dhe çlodhen pak nga loja, ndërsa edukatori/ja sjell para tyre flamujt dhe u kërkon të dallojnë cilat janë ngjyrat, sa yje ka; e krahasojnë me flamujt e vendeve të tjera. Në varësi të interesave të fëmijëve, aktivitetet për flamujt e vendeve të tjera mund të zgjaten edhe në ditët në vijim.</p> <p>Edukatori/ja prezanton përpara fëmijëve një kapelë festive, të cilën do ta vendosin në shëtitjen në qytet për 17 Shkurtin. Fëmijët kanë mundësinë që të ndërtojnë kapelën sipas modelit të printuar.</p> <p>Më pas, ata do të ndahen në katër grupe për të ndërtuar një flamur me materiale të ndryshme. Mund ta ndërtojnë mbi tavolinë apo në dysheme, duke përdorur një gamë të gjerë materialesh që gjenden në klasë. Kjo bëhet me qëllim që fëmijët të mund të shfaqin anën e tyre artistike në formë të lirë dhe në të njëjtën kohë të mësohen të marrin vendime së bashku.</p> <p>Në përfundim të ditës, kur të gjithë fëmijët të kenë në kokë kapelat e tyre festive, do të afrohen te grupet e tjera për të parë punën që ka bërë secili grup.</p>
Vlerësimi:	Edukatori/ja përdor fotografi ose video për të dokumentuar punën që është bërë, duke qenë se nuk mund të dokumentohet në dosjen e fëmijës në formë fizike.
Më shumë për të bërë:	Mund të kërkoni mbështetje nga prindërit për të dërguar fëmijët në ndonjë ekspozitë ose ngjarje tjetër kulturore, e cila organizohet në vendin tuaj me rastin e 17 Shkurtit, dhe që është e përshtatshme për fëmijët.
Reflektimi:	_____

I pari unë, i dyti ti, por pas teje, kush do të vijë?

Fusha kurrikulare:	Matematikë
Kurrikula lëndore:	Matematikë
Tema nga plani dymujor:	Numrat natyrorë
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):	I. 3; II. 1, 2, 3, 7; III. 1, 2, 3, 4, 6; IV. 2, V. 2, 5; VI. 6
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):	Matematikë: 5. 1 Gjuhët dhe komunikimi: 1. 1 Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti: 2. 2
Rezultati i të nxënit të temës:	Numëron të paktën nga 1 deri në 10-të dhe anasjelltas, me anë të mjeteve të konkretizimit.
Rezultatet e të nxënit të aktiviteteve:	<ul style="list-style-type: none"> • Paraqet sasinë e numrit 7 përmes objekteve të ndryshme. • Plotëson fletëzën e punës te numri 7. • Sheh mjedisin përreth për të identifikuar flamujt.
Kriteret e suksesit:	<ul style="list-style-type: none"> • Paraqit sasinë e numrit 7 përmes objekteve të përzgjedhura. • Plotëso fletëzën e numrit 7. • Shih mjedisin përreth për të gjetur flamujt.
Burimet dhe materialet:	7 flamuj të Kosovës, fletëza pune (të plastifikuara), libri i fëmijës, fasule, shkopinj, makarona rrethore, pulla, lapsa, ngjyra.
Integrimi ndërfaqor:	Gjuhë shqipe, Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti.
Çështjet ndërkurrikulare:	Zhvillim të qëndrueshëm.
Fjalë kyçe:	Festë, flamuj, tradicionale, numri 7, i pari, i dyti... i shtati, i teti; më shumë-më pak.
Organizimi i aktiviteteve:	Edukatori/ja ka vendosur qëllimisht 7 flamuj të Kosovës në një kënd të dukshëm të klasës, përpara se fëmijët të vijnë në institucion. Dita nis me përshëndetjen. Edukatori/ja fton fëmijët në një lojë të përbashkët ritmike; fëmijët ndjekin ritmin e edukatorit/es dhe thonë tekstin bashkërisht:

*Të kapemi për dore për dore e një rreth ta formojmë,
bëjmë një rreth të madh, të madh, të madh.
Të vogël, të vogël, të vogël, të vogël.
Përshëndetje për të gjithë!
Bëjmë një rreth dhe rrotullohemi rrotull-rrotull-rrotullohemi
Ngjisim një mal të lartë, të lartë, të lartë!
Poshtë, poshtë, poshtë dhe ulemi.*

Vargjet përsëriten duke i shoqëruar me lëvizje trupore sipas tekstit.

Edukatori/ja pyet fëmijët nëse kanë vërejtur ndonjë ndryshim të ri në mjedisin e klasës. Fëmijët tashmë kanë identifikuar flamujt, kështu ata sjellin në rreth flamujt dhe i numërojnë bashkërisht.


Edukatori/ja i udhëzon të shpërndahen nëpër klasë, të gjejnë 7 gjëra (të njëjta ose të ndryshme) dhe t'i sjellin në rreth. A do të mund të numërojnë secili objektet që ka sjellë?

Më pas, edukatori/ja paraqet grafikisht numrin 7. Aktivitetet organizohen nëpër qendrat e aktivitetit, të përgatitura paraprakisht nga edukatori/ja.

Në njërin kënd, fëmijët do të plotësojnë fletëzat e punës së numrit 7.

Në këndin tjetër, fëmijët do të kenë mundësi që në fletëzat e plastifikuara me hapësirat nga 0-7, fëmijët të vendosin materiale (fasule, shkopinj, makarona) sipas numrit të dhënë.

Në një tjetër kënd, fëmijët ngjyrosin makaronat me ngjyrat e flamurit dhe me to ndërtojnë varëse. Pas përfundimit të aktiviteteve, të gjithë së bashku do të dalin në oborrin e institucionit dhe do të shohin flamujt që janë vendosur për festë. Fëmijët do të numërojnë me numra rendorë, do të përdorin konceptet më shumë/më pak, larg/afër, poshtë/lart etj. Ata do të shkëmbejnë varëset me njëri-tjetrin dhe kështu bëhet përmbyllja e ditës së sotme.



Vlerësimi:

Edukatori/ja vëzhgon për të vlerësuar fëmijët në fushën e matematikës.

Më shumë për të bërë:

Ju mund të kërkoni leje nga prindërit për të bërë një ekskursion në qytet në ditët festive, që fëmijët të kenë mundësi të shohin qytetin në festë.

Reflektimi:

Qyteti im

Fusha kurrikulare:	Shoqëria dhe mjedisi
Kurrikula lëndore:	Shoqëria dhe mjedisi
Tema nga plani dymujor:	Vendi/ mjedisi ku jetoj
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):	I. 3, 7, 8; II. 1, 7; III. 2, 3; IV. 3; 4, 6; V. 2, 5; VI. 1, 4, 5, 6, 7
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):	Shoqëria dhe mjedisi: 2. 1 Gjuhët dhe komunikimi: 1. 1; 1. 4; 1. 7 Matematikë: 6. 1 Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti: 1
Rezultati i të nxënit të temës:	Identifikon shërbimet që i ofrohen në familje, lagje, kopsht, shkollë, mjedisin rrethues (kujdesin prindëror, shërbimet mjekësore dhe rekreative etj.).
Rezultatet e të nxënit të aktiviteteve:	<ul style="list-style-type: none"> • Tregon si quhet vendi ku jeton. • Përshkruan së paku tri gjëra që i pëlqejnë më shumë në vendin e tij/saj. • Krahason karakteristikat e vendit të tij me ato të vendeve të tjera.
Kriteret e suksesit:	<ul style="list-style-type: none"> • Trego si quhet vendi ku jeton. • Përshkruaj së paku tri gjëra që të pëlqejnë më shumë në vendin tënd. • Krahaso karakteristikat e vendit tënd me ato të vendeve të tjera.
Burimet dhe materialet:	Projektor, laptop, PPP të përgatitur nga edukatori/ja, libri i fëmijës, mjete ndihmëse.
Integrimi ndërfaqor:	Gjuha shqipe, Matematikë, Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti.
Çështjet ndërkurrikulare:	Edukim për qytetari demokratike.
Fjalë kyçe:	Vendi, qytetet e Kosovës (Prishtina, Prizreni, Gjakova, Peja, Mitrovica, Gjilani, Ferizaj, edukatori/ja zgjedh vendet që janë familjare për fëmijët, udhëtim, karakteristikë).
Organizimi i aktiviteteve:	Mblidhemi në takimin e përbashkët, ku pas leximit të kalendarit luhet loja me "Pantomime". Fëmijët zgjedhin kërkesat e lojës dhe sipas kërkesave të tyre zhvillohen disa raunde. Për raundin e fundit të lojës, edukatori/ja kërkon që personazhi i fshehur të jetë shoferi. Ftohen fëmijët në një udhëtim imagjinar me autobus. Të gjithë fëmijët marrin pozicionet sikur janë në autobus dhe edukatori/ja reciton vargjet ritmike:

*Ne morëm autobusin së bashku,
dhe po shihnim nga dritarja.
Shoferi ynë shtypi pedalin,
dhe autobusi u nis.
Sot do të vizitojmë qytetin tonë!
Si quhet qyteti ynë, cila është kjo pjesë e qytetit?
Ndalo se drita e kuqe!*

Fëmijët do të shohin në projektor qytetet e Kosovës. I pyesim nëse i kanë vizituar ndonjëherë, dhe nëse po, a kanë ndonjë kujtim për të treguar. Në fund do të paraqitet qyteti i lindjes ose vendi ku banojnë, dhe do të diskutohet për muzetë, për këndet e lojërave, bibliotekën a vende të tjera që u pëlqejnë e i kanë vizituar shpesh. Në vijim, klasa do të ndahet në grupe më të vogla, për të vazhduar me aktivitetet e ditës.

- **Në qendrën e gjuhës**, ata do të gjejnë dhe presin fotografi të vendeve të ndryshme, të njohura dhe të panjohura për ta. Edukatori/ja shkruan shkronjën e parë, e kështu nis diskutimi për të gjetur qytetet.
- **Në qendrën e artit** do të vizatojnë vendin që ju pëlqen më së shumti në vendin e tyre.
- **Në qendrën e matematikës** do të plotësojnë faqen në librin e punës.
- **Në qendrën e blloqeve** do të ndërtojnë qytetin e tyre me blloqe.

Takimi përmbyllës do të shërbejë për të vlerësuar punën e fëmijëve, për të rikujtuar aktivitetet e zhvilluara atë ditë, duke përfshirë edhe emrat e disa qyteteve të Kosovës.

Vlerësimi:

Edukatori/ja përdor shkrimet anekdotike për të mbajtur shënime mbi mënyrën se si fëmijët përshkruan qytetet e Kosovës që tashmë njohin.

Më shumë për të bërë:

Nga prindërit kërkohet të bisedojnë me fëmijët për të kaluarën e qytetit, për monumentet historike e kulturore. Gjithashtu, u kërkohet të sjellin kuti qumështi e lëngjesh bosh, për aktivitetin vijues.

Reflektimi:

Lagjja ime

Fusha kurrikulare: Matematikë

Kurrikula lëndore: Matematikë

Tema nga plani dymujor: Modelet

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): **I.** 3, 5; **II.** 1, 7; **III.** 1, 2, 3, 5, 6; **IV.** 3, 4, 5; **V.** 2, 5; **VI.** 6

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): Matematikë: 2. 1
Gjuhët dhe komunikimi: 1. 1; 3. 2
Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti: 1

Rezultati i të nxënit të temës: Ndërto sipas modelit, sipas vetive të objekteve.

Rezultatet e të nxënit të aktiviteteve:

- Përshkruan shërbimet që ofrohen në lagjen e tij/saj.
- Krijon planin e punës për ndërtimin e maketit të qytetit.
- Ndërton objektin e caktuar për ta vendosur në maketin e qytetit.

Kriteret e suksesit:

- Përshkruaj shërbimet që ofrohen në lagjen tënde.
- Merr përgjegjësi për ndërtimin e objektit të caktuar për maketin e qytetit.
- Ndërton objektin e caktuar për maketin e qytetit

Burimet dhe materialet:

Fletë e madhe, kuti të pastra qumështi ose kosi, kuti drithërash të madhësive të ndryshme, letër dekoruese, letër me ngjitës, gërshërë, ngjyra, letër e bardhë, letër me ngjyra, karton dhe materiale të tjera të disponueshme në klasë, që fëmijët mund t'i përdorin.

Integrimi ndërfaqor:

Gjuhë shqipe, Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti.

Çështjet ndërkurrikulare:

Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

Fjalë kyçe:

Shtëpi, pallat, fqinjë, dyqane, parqe, lagje, qytet, maket.

Organizimi i aktiviteteve:

Takimi i përbashkët në rreth duhet të jetë i gëzueshëm, i këndshëm për të gjithë fëmijët. Edukatori/ja nxit bisedën dhe u kërkon të mendojnë se çfarë shohin rrugës për në shtëpi: nëse kalojnë përpara ndonjë dyqani, nëse ka ndonjë ambulancë, si quhet rruga ku banojnë, ku gjendet shtëpia e tyre dhe ta përshkruajnë si duket. Përmes pyetjeve, edukatori/ja nxit fëmijët të shprehin; gjatë diskutimit duhet t'u jepet mundësi të gjithë fëmijëve të flasin e të përshkruajnë në disa fjali rrugën që bëjnë për në institucionin shkollor. Pasi e kanë marrë fjalën të gjithë, edukatori/ja bën një përmbledhje për t'u shpjeguar se tërësia e shtëpive formon një lagje, e shumësia e lagjeve formon qytetin.

Edukatori/ja nxit fëmijët të mendojnë sesi mund t'i paraqesim lagjet tona, në mënyrë që me to të ndërtojmë qytetin, prej nga lind edhe ideja e ndërtimit të maketit të qytetit.

Fëmijët ndahen në grupe të vogla që të bëjnë planin e punës, për mënyrën si do të ndërtojnë shtëpitë apo pallatet, si dhe institucionet e shërbimeve: dyqane, ambulanca, farmaci, posta, banka, salla sportive etj.

Ata marrin materialet e nevojshme të punës dhe, duke bashkëpunuar, arrijnë të krijojnë maketin e qytetit. Pas përfundimit të punës, fëmijët luajnë të lirë me maketet e krijuara.

Në fund, maketet e krijuara vendosen në një bazament të përbashkët. Kështu krijohet qyteti me lagjet. Në takimin përmbyllës do të shohin rezultatet e punës së përbashkët. Kur prindërit të vijnë për të marrë fëmijët, ftohen të vijnë të shohin punën e krijuar gjatë asaj dite.

Vlerësimi:

Fëmijët do të vëzhgohen gjatë aktivitetit që do të zhvillojnë, aftësive krijuese për aftësitë në zgjidhjen e problemeve.

Më shumë për të bërë:

Kjo veprimtari mund t'u nxisë dëshirën fëmijëve të provojnë diçka të ngjashme edhe në shtëpitë e tyre. Nxitini të provojnë të bëjnë gjëra të reja me materiale të zakonshme. Informojini prindërit për këtë aktivitet, në mënyrë që fëmijët të punojnë edhe në shtëpi.

Reflektimi:

Jonida, shoqja e re në lagjen tonë

Fusha kurrikulare:	Gjuhët dhe komunikimi
Kurrikula lëndore:	Gjuha shqipe
Tema nga plani dymujor:	Tinguj, shkronja, rrokje, fjalë, fjali
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):	I. 3, 7, 8; II. 1; III. 3; IV. 3. 4; V. 2, 5; VI. 1, 4, 5, 6, 7
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):	Gjuhët dhe komunikimi: 1. 1; 1. 2; 1. 4; 1. 5 Matematikë: 3. 3 Artet: 1
Rezultati i të nxënit të temës:	Shqiptojnë drejt tingujt, zanoret dhe bashkëtingëlloret, gjatë të shprehurit.
Rezultatet e të nxënit të aktiviteteve:	<ul style="list-style-type: none"> • Tregon ngjarjen në bazë të ilustrimit me fjalët e tij/saj. • Gjen së paku 2 fjalë me shkronjën J. • Modelon shkronjën J me materialin e përzgjedhur.
Kriteret e suksesit:	<ul style="list-style-type: none"> • Trego ngjarjen në bazë të ilustrimit me fjalët e tua. • Gjej së paku 2 fjalë me shkronjë J. • Modelo shkronjën J me materialin e përzgjedhur.
Burimet dhe materialet:	Tregim i ilustruar në fotografi të mëdha A4, libri i fëmijës, copëza të teksteve të shkurtra (nga gazetat ditore), ngjyra, plastelinë.
Integrimi ndërfaqor:	Matematikë, Edukatë muzikore.
Çështjet ndërkurrikulare:	Arsimi dhe zhvillim i qëndrueshëm.
Fjalë kyçe:	Shkolla, shtëpia, Jonida, lagje e re, shkronja J, fëmijët e lagjes, mikpritje.
Organizimi i aktiviteteve:	<p>Edukatori/ja nis takimin duke kërkuar nga fëmijët që të përshëndesin njëri-tjetrin me përshëndetjen më të shpeshtë që përdorin në lagjet ku ata jetojnë. Kështu nga fëmijët jepen ide nga më të ndryshme, edukatori/ja inkurajon fëmijët të kujtojnë se si i përshëndesin personat që janë më të vjetër me moshë, po shoqet dhe shoket e tyre etj.</p> <p>A kanë pasuar ata rast të jenë banorë të rinj në ndonjë lagje? Po në lagjen ku jetojnë, a kanë ardhur banorë të rinj?</p> <p>Për të vazhduar takimin e përbashkët, edukatori/ja ka sjellë para fëmijëve foto të cilat paraqesin një personazh në 6 situata të ndryshme (kjo mund të punohet nga vetë edukatori/ja përmes ilustrimeve apo të shkarkohet e gatshme dhe të printohet). Edukatori/ja prezanton përpara fëmijëve ilustrimin e parë dhe ndërton hyrjen e historisë. Ngjarja ka të bëjë me Jonidën, një vajzë 5-vjeçare, e cila ka shkuar të jetojë në një lagje të re. Tregohet ilustrimi i dytë, pas të cilit fëmijët mund të vazhdojnë të ndërtojnë ngjarjen.</p>

Më pas, edukatori/ja nxit bisedën me pyetje: “Si mendoni se u sollën fëmijët e lagjes me Jonidën? Kush i erdhi në ndihmë asaj? Si do të vepronit ju? Po juve, ju ka ndodhur të transferoheni apo të vijë dikush i ri në lagjen tuaj? Si ndiheni ju kur shkoni në një rreth të panjohur?”

Fëmijët shprehin mendimet e tyre dhe inkurajohen për përgjigjet e dhëna. Duke përsëritur emrin “Jonida”, dhe duke theksuar tingullin “J”, edukatori/ja i njuh fëmijët me shkronjën e parë të fjalës, pastaj eksperimentojnë me tingullin J dhe u kërkon të gjejnë fjalë që fillojnë me tingullin J.

Luhet loja: “Vrapojmë në lagjen tonë”. Secilit fëmijë i ka ndërtuar (përcaktuar) një vend të caktuar në dhomë; më pas lëshohet muzikë dhe fëmijët do të lëvizin/kërcejnë sipas dëshirës. Në momentin që muzika ndalet, fëmijët duhet të kthehen në vendet e tyre. Loja luhet disa herë në varësi të interesit të fëmijëve. Dita vazhdon në qendrat e aktiviteteve.

Në qendrat e aktivitetit, fëmijët, në grupe të vogla, do të zhvillojnë këto aktivitete:

Te fusha e gjuhës do të punojnë në librin e fëmijës faqen e shkronjës J.

Në fushën e matematikës, edukatori/ja ka përgatitur copëza të shkurtra tekstesh (prerë nga revistat për secilin fëmijë), ku do të qarkojnë shkronjën J dhe do të numërojnë sa herë është përdorur ajo në këtë pjesë të tekstit.

Në fushën e artit do të modelojnë me plastelinë grafikun e shkronjës J dhe gjërave/dukurive që fillojnë me shkronjën J.

Pas përfundimit të aktiviteteve, fëmijët ndërrojnë vendet derisa të gjithë të kenë kryer aktivitetin.

Në takimin përmbyllës, fëmijët kthehen në rreth dhe kujtojmë përsëri aktivitetin ditor: çfarë i ndodhi Jonidës, shkronjën J dhe veprimet që duhet bërë për të mirëpritur një fëmijë të ri në lagje.

Vlerësimi: Fëmijët do të vlerësohen përmes vëzhgimit për punën e bërë nëpër qendrat e aktiviteteve. Edukatori/ja mban shënime në ditarin reflektiv.

Më shumë për të bërë: Fëmijët mund të bëjnë shkronjën J me materiale të ndryshme (misër, letër me ngjyra, oriz) edhe në shtëpitë e tyre.

Reflektimi:

Tokë, ujë dhe ajër

Fusha kurrikulare:	Shkencat e natyrës
Kurrikula lëndore:	Njeriu dhe natyra
Tema nga plani dymujor:	Toka dhe hapësira
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):	I. 3, 5, 8; II. 1, 3, 7; III. 1, 2, 4, 6; IV. 2, 3; V. 2, 5; VI. 6
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):	Shkencat natyrore: 1 Gjuhët dhe komunikimi: 1. 4; 2. 8 Jeta dhe puna: 2. 8. 1
Rezultati i të nxënit të temës:	Emërton pjesë të relievit të mjedisit ku jeton (male, fusha, kodra, lumenj, liqene).
Rezultatet e të nxënit të aktiviteteve:	<ul style="list-style-type: none"> • Përshkruan një vend natyror që ka vizituar. • Dallon malin nga fusha, lumin nga liqeni në ilustrimet e paraqitura. • Krijon me materialet të ndryshme një reliev.
Kriteret e suksesit:	<ul style="list-style-type: none"> • Përshkruaj një vend natyror që ke vizituar. • Dallo malin nga fusha, lumin nga liqeni në ilustrimet e paraqitura. • Krijohet me materialet të ndryshme një reliev.
Burimet dhe materialet:	Material të ndryshme: kuti kartoni, qese plastike, gazeta të vjetra, shishe qelqi, shishe plastike, letër, brusha, ngjyra të lëngshme. Libër enciklopedik, top, fotografi të vendeve të ndryshme turistike të Kosovës.
Integrimi ndërfaqësor:	Gjuhë shqipe, Shkathtësi për jetë.
Çështjet ndërkurrikulare:	Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.
Fjalë kyçe:	Relief, mali, fusha, lumi, liqeni, burimi.
Organizimi i aktiviteteve:	<p>Dita nis me përshëndetjen me fëmijët dhe leximin e kalendarit. Fëmijët ftohen në një lojë të përbashkët, e cila quhet: "Tokë, ujë dhe ajër".</p> <p>Ecuria e lojës: edukatori/ja merr një top dhe, në çastin që dëshiron ta hedhë, thotë njëren nga elementet: tokë, ujë ose ajër. Fëmija që pret topin, duhet të thotë një kafshë ose një send apo çfarëdo që i përgjigjet kërkesës që ka dhënë edukatori/ja. Për shembull: nëse fëmija që hedh topin thotë <i>ajër</i>, atëherë fëmija që e pret, mund të thotë <i>re</i>.</p> <p>Me përfundimin e lojës, fëmijët ulen në rreth; më pas edukatori/ja hap enciklopedinë dhe kërkon nga fëmijët që të diskutojnë për vendet që kanë vizituar me familjet e tyre. Pas diskutimit, edukatori/ja hap enciklopedinë, në mënyrë që të shohin se çfarë mund të mësojnë të re për relievin e tokës. Pasi tregohen edhe fotografitë e tjera ilustruese të maleve, lumenjve, liqeneve, u shpjegon rëndësinë e tyre për jetën e njeriut. Fëmijët pyeten nëse kanë qenë ndonjëherë pranë një mali, një lumi, liqeni a deti. Cili vend u ka pëlqyer më shumë dhe pse. Fëmijët që shprehin</p>

mendimet e tyre, vlerësohen pozitivisht dhe inkurajohen për më tej.

Duke qenë se fëmijët tashmë i dinë dallimet mes fushës, kodrës dhe malit, si dhe dallimet mes lumenjve dhe liqeneve, ata do të ndahen në grupe me nga 4-5 veta, për të ndërtuar një reliev sipas njohurive që kanë. Mund të përdorin edhe fotografi ilustruese, nëse dëshirojnë. Grupet do të krijojnë hapësirën e tyre të punës dhe fillojnë të mbledhin materialet e duhura. Edukatori/ja ofron mbështetje të vazhdueshme, duke kaluar nga njëri grup në tjetrin, për të inkurajuar punën e grupit, për të bërë pyetje apo edhe për të ndihmuar fëmijët që kanë nevojë.

Puna zhvillohet në grup, dhe në përfundim të ditës, maketet e relievit vendosen në një kënd të dukshëm të klasës. Përmes "Turit të galerisë", fëmijët tregojnë procesin e ndërtimit të tyre. Ata luajnë lojëra tavoline deri në përfundimin e ditës.

Vlerësimi: Edukatori/ja përmes vëzhgimit mbledh të dhëna për fëmijët sipas planit të vlerësimit. Gjithashtu bën fotografi të punës me relievin dhe i ruan ato për dokumentim.

Më shumë për të bërë: Ju mund të paraqisni një video me projektor e të zhvilloni një bisedë për relievin.

Reflektimi:

Unë dhe vendi im

Fusha kurrikulare: Artet

Kurrikula lëndore: Edukatë figurative

Tema nga plani dymujor: Vizatimi

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): **I.** 3, 5, 7; **II.** 1, 7, 8; **III.** 1, 2, 3, 6; **IV.** 2; **V.** 5; **VI.** 6

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): Artet: 1
Gjuhët dhe komunikimi: 1. 1; 1. 5
Matematikë: 3. 3

Rezultati i të nxënit të temës: Prezanton ndjenjat dhe idetë nëpërmjet artit dhe ndërtimit. Bën shkarravina, vizatime dhe më pas u tregon të tjerëve punën e vet.

Rezultatet e të nxënit të aktiviteteve:

- Jep ide se çfarë ka brenda kutisë, gjatë lojës me kuti.
- Vizaton vetën dhe vendin ku jeton.

Kriteret e suksesit:	<ul style="list-style-type: none"> • Jep ide se çfarë ka brenda gjatë lojës me kuti. • Vizato veten dhe vendin ku jeton.
Burimet dhe materialet:	Lapsa shënjes me 4 ngjyra të ndryshme, gërshërë, letër, ngjitës, 4 kuti me madhësi të ndryshme, fotografi flamuri, fotografi të qytetit, fotografi të familjes, lodër.
Integrimi ndërfaqshor:	Gjuhë shqipe, Matematikë.
Çështjet ndërkurrikulare:	Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.
Fjalë kyçe:	Unë, familja ime, qyteti im, shteti im.
Organizimi i aktiviteteve:	<p>Dita fillon me përshëndetjen me fëmijët, përfundohet kalendari dhe më pas edukatori/ja i jep në dorë një fëmijë një kuti (të përgatitur paraprakisht) dhe e pyet nëse mund të gjejë se çfarë ka brenda, pa e hapur. Fëmijët e kalojnë kutinë nga njëri te tjetri dhe japin ide të ndryshme. Kur radha vjen përsëri tek edukatori/ja, ai/ajo e hap kutinë dhe në fund gjendet flamuri i Kosovës, si dhe një tjetër kuti më e vogël. Edukatori/ja diskuton me fëmijët se çfarë përfaqëson një flamur, fëmijët japin mendimet e tyre dhe radha vazhdon përsëri me kutinë tjetër më të vogël, ku secili jep mendimin e vet. Kur radha shkon tek edukatori/ja, në kuti del një fotografi e qytetit, e kështu nis diskutimi se brenda një shteti ka disa qytete, përfshirë edhe qytetin ku ata jetojnë (edukatori/ja e emërton).</p> <p>Loja vazhdon përsëri me kutinë tjetër më të vogël, e cila po ashtu kalon dorë më dorë te fëmijët, që japin ide të ndryshme. Kur hapet kapaku i kutisë, aty është fotografia e familjes, diskutohet përsëri për të dhe në fund, edukatori/ja nxjerr nga kutia e madhe, kutinë e fundit, që fëmijët ia kalojnë shokut/shoqes, edhe këtë herë duke dhënë ide të ndryshme.</p> <p>Kur kutia kthehet në dorën e edukatorit/es, brenda saj është një fëmijë lodër, kështu fëmijët e kuptojnë se bëhet fjalë për ta. Tashmë janë hapur të gjitha kutitë dhe në mes të rrethit kemi një flamur, një fotografi të qytetit, një fotografi të familjes dhe një fëmijë-lodër. Kështu konkretizohet përpara fëmijëve koncepti nga fëmija deri te vendi ku jeton.</p> <p>Fëmijët ndahen në grupe të vogla:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Në njërin kënd do të vizatojnë vetëvetën. • Në tjetrin do të vizatojnë familjen. • Në një kënd tjetër do të vizatojnë qytetin. • Në këndin e fundit do të vizatojnë shtetin (hartën e Kosovës). <p>Në fund, me ndihmën e edukatorit/es, fëmijët do të bashkojnë pjesët me një lidhëse të lirë, në mënyrë që të mund ta shfletojnë. Pasi të kemi pastruar hapësirën e punës, mbledhemi në takim e përbashkët dhe secili prej fëmijëve mban në duar punën e bërë gjatë ditës. Punën mund ta mbajnë përpara vetes e ta ndajnë me shokët, ose edhe mund ta marrin në shtëpi për t'ua treguar pjesëtarëve të familjes, por duhet ta kthejnë të nesërmen për ta vendosur në dosjen personale.</p>
Vlerësimi:	Edukatori/ja do të vëzhgojë fëmijët gjatë realizimit të aktiviteteve dhe do të mbajë shënime bazuar në planin e vlerësimit.
Më shumë për të bërë:	Nëse fëmijët kanë interes për të vazhduar më tej, mund ta zgjeroni rrethin e aktivitetit duke vazhduar me kontinentin, planetin apo edhe njësi të tjera.
Reflektimi:	_____

Njihu me familjen time

Fusha kurrikulare:	Shoqëria dhe mjedisi
Kurrikula lëndore:	Shoqëria dhe mjedisi
Tema nga plani dymujor:	Unë dhe të tjerët
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):	I. 3; II. 3, 7; III. 1, 2, 3, 6; IV. 4; V. 2, 5; VI. 1, 2, 3, 4, 5, 6
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):	Shoqëria dhe mjedisi: 1. 1 Gjuhët dhe komunikimi: 1. 1; 1. 3; 1. 7; 2. 8 Matematikë: 1. 1 Artet: 1
Rezultati i të nxënit të temës:	Dallon ndryshimet - moshë, gjinia - dhe të përbashkëtat ndërmjet tij dhe të tjerëve në familje e në shoqëri.
Rezultatet e të nxënit të aktiviteteve:	<ul style="list-style-type: none"> • Numëron anëtarët e familjes, gjatë lojës në rreth. • Shprehet me fjali të thjeshta, duke dhënë shembuj për rregullat dhe përgjegjësitë në familje. • Krijon portretin familjar.
Kriteret e suksesit:	<ul style="list-style-type: none"> • Numëron anëtarët e familjes gjatë lojës në rreth. • Jep disa shembuj për rregullat dhe përgjegjësitë në familje. • Krijon portretin familjar.
Burimet dhe materialet:	Fletë, lapsa ngjyra, shkopinj, ngjitës, fotografi të familjes, blloqe ndërtimi, CD, radio.
Integrimi ndërfaqor:	Gjuhë shqipe, Matematikë, Edukatë muzikore.
Çështjet ndërkurrikulare:	Edukimi për qytetari demokratike.
Fjalë kyçe:	Familje, pjesëtar, përgjegjësi, rregulla familjare, portret familjar.
Organizimi i aktiviteteve:	<p>Në takimin e përbashkët plotësohet kalendari, bisedojnë për motin dhe hamendësojnë si do të jetë në ditët në vijim. Edukatori/ja paraqet përpara fëmijëve "Dorën me pjesëtarët e familjes", në mënyrë që të këndojnë bashkërisht këngën "Familja e gishtave" (ju mund ta gjeni modelin e familjes të shtojca e librit të edukatorit/es). Këngën "Familja e gishtave" mund të gjeni në linkun https://youtube/181f6UDCpus</p> <p>Kënga mund të përsëritet disa herë.</p> <p>Në klasë krijohet një atmosferë e këndshme pune, edukatori/ja kërkon nga fëmijët që secili të prezantojë anëtarët e familjes së tij/saj në fotografinë e printuar.</p> <p>Pasi të përfundojnë, fëmijët do të ndahen në dy grupe.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Në njërin grup, secili do të pres dhe ngjitë fotografitë e printuara të anëtarëve të familjes në kubet formuese (fotografia e çdo anëtari të

familjes vendoset në faqen e njërit kub konstruktiv, kështu vazhdohet edhe me anëtarët e tjerë dhe në fund, kubet me anëtarët e familjes vendosen njëri mbi tjetrin).

- Në grupin tjetër, fëmijët do të vizatojnë anëtarët e familjes sipas mënyrës së tyre dhe do t'i ndërtojnë një kornizë punimit të tyre.



Punimet me portretin familjar ekspozohen në njërin kënd të klasës. Kubet formuese me anëtarët e familjes, fëmijët do t'i sjellin në rreth, në takim përmbyllës. Aty do të shohim cila familje ka më shumë anëtarë, cila ka më pak etj. Bashkërisht këndojnë edhe një herë këngën e familjes.

Vlerësimi:

Fëmijët vëzhgohen gjatë punës sipas planit të vlerësimit. Edukatori/ja mban shënime anekdotike, sipas mundësive që krijohen në grup.

Më shumë për të bërë:

Ju mund t'i referoheni linkut të mëposhtëm për lojërat edukative me temë familjen.

<https://www.freddiesville.com/games/family-members-crossword-puzzle-online/>

Fëmijët mund të këndojnë këngën "We Are A Family".

Reflektimi:

Trungu im familjar

Fusha kurrikulare:	Artet
Kurrikula lëndore:	Edukatë figurative
Tema nga plani dymujor:	Krijimet figurative
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):	I. 3; II. 3, 7; III. 1, 2, 3, 6; IV. 4; V. 2, 5; VI. 1, 2, 3, 4, 5, 6
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):	Artet: 1 Matematikë: 3. 1 Gjuhët dhe komunikimi: 1. 1; 1. 4
Rezultati i të nxënit të temës:	Me materiale të ndryshme krijojnë dhe riciklojnë sipas imagjinatës. Vizatojnë, ngjyrosin, modelojnë, shtypin, për tema të ndryshme që trajtohen në shkollë dhe jashtë saj, duke përdorur forma me ngjyra, lodrat dhe fletë me ngjyra ku të shprehin krijimtarinë e tyre.
Rezultatet e të nxënit të aktiviteteve:	<ul style="list-style-type: none"> • Krijon trungun familjar. • Përshkruan përbërjen e familjes së tij/saj.
Kriteret e suksesit:	<ul style="list-style-type: none"> • Krijon trungun familjar. • Përshkruaj përbërjen e familjes sate.
Burimet dhe materialet:	Materiale të ndryshme, letër, shkopinj të vegjël, libri i fëmijës, kornizë kartoni në formë pasqyre.
Integrimi ndërfaqor:	Matematikë, Gjuhë shqipe.
Çështjet ndërkurrikulare:	Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.
Fjalë kyçe:	Familje, trungu familjar, pjesëtarët e familjes, prindër, gjyshër, motra, vëllezër, kujdes, dashuri familjare.
Organizimi i aktiviteteve:	<p>Në takimin e përbashkët, pas plotësimit të kalendarit, diskutimit për motin dhe përsëritjes së aktiviteteve të zhvilluara ditën e kaluar, luhet loja "Pasqyra".</p> <p>Me një rreth kartoni formohet një kornizë pasqyre. Fëmija që mban pasqyrën në dorë do të bëjë një shprehje fytyre (p.sh. i gëzuar, i lumtur, i mërziur, i habitur, i shqetësuar, i mahnitur etj.) dhe fëmijët e tjerë në rreth do të përpiqen të identifikojnë shprehjen e fytyrës.</p> <p>Loja vazhdon deri kur "pasqyra" të kthehet përsëri te fëmija prej nga fillojë loja.</p> <p>Dita vazhdon me leximin e tregimit për familjen (edukatori/ja mund të zgjedh një tregim me ilustrime apo të ndërtojë vetë një histori për</p>

familjen). Bashkëbisedohet mbi tregimin e lexuar, rreth familjes së përmendur aty, sa vëllezër e motra janë. Pyeten fëmijët për përbërjen e familjes së tyre dhe flitet për:

- familjen e ngushtë dhe atë të gjerë, duke bërë një krahasim;
- kujdesin dhe dashurinë për njëri-tjetrin;
- përbërjen e familjes, duke filluar nga brezat e kaluar, duke i shtuar në tringun familjar.



Fëmijët kalojnë te këndi i artit dhe fillojnë punën me krijimin e tringut familjar. Mund të përdorni teknika të ndryshme të artit, si: kolazh, vizatim etj. Fëmijët zgjedhin vetë mënyrën se si do ta bëjnë tringun familjar, marrin materialet që u nevojiten për punë, duke vazhduar kështu në punë individuale.



Punimet e fëmijëve i ekspozojmë te këndi i artit secili fëmijë paraqet punën e bërë. Flitet për:

- përbërjen e familjes së tyre;
- sa pjesëtarë janë;
- rolin e tyre në familje etj.

Fëmijët kalojnë në lojë të lirë, ku mund të konstruktojnë, luajnë me kukulla apo lojëra tavoline.

Në takimin e përbashkët bëhet përsëritje e përgjithshme e aktiviteteve të ditës, duke i pyetur fëmijët si janë ndier, cili aktivitet u ka pëlqyer më shumë, cili çast i lojës u ka pëlqyer më shumë dhe cili më pak gjatë lojës. Përse? Përmendet edhe tringun familjar dhe këndohet kënga "Familja e gishtave".

Vlerësimi:

Vlerësohen punimet e fëmijëve me tringun familjar, aftësia për të numëruar pjesëtarët e familjes e për të bërë krahasimin më shumë - më pak. Merret parasysh prezantimi i punimeve, përdorimi i fjalive përshkruese, fondi i fjalëve, shkathtësia në paraqitje.

Më shumë për të bërë:

Fëmijët marrin me vete fletëzën - nga libri i fëmijës - me tringun familjar, për ta plotësuar bashkërisht me prindërit, duke marrë informacione shtesë për tringun familjar.

Reflektimi:

Gatujmë me prindërit

Fusha kurrikulare:	Shkenca dhe natyra
Kurrikula lëndore:	Njeriu dhe natyra
Tema nga plani dymujor:	Bimët, kafshët dhe njeriu
Rezultatet e të nxëniet për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):	I. 3; II. 4; IV. 4, 5; V. 2, 5; VI. 4, 5, 6
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):	Shkenca dhe natyra: 1 Gjuhët dhe komunikimi: 1. 1; 3. 2 Matematikë: 3. 1 Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti: 3. 1; 2
Rezultati i të nxëniet të temës:	Tregon nevojat themelore jetësore të njeriut (strehim, ushqim, ujë, ajër dhe dritë).
Rezultatet e të nxëniet të aktiviteve:	<ul style="list-style-type: none"> • Lexon recetën sipas figurave. • Peshon përbërësit. • Eksperimenton me përzierjen e përbërësve.
Kriteret e suksesit:	<ul style="list-style-type: none"> • Lexo recetën sipas figurave. • Pesho përbërësit. • Eksperimento me përzierjen e përbërësve.
Burimet dhe materialet:	Një libër gatimi, një recetë e thjeshtë pa pjekje, gotë, lugë, enë për përzierjen e përbërësve, biskota të bluara, sheqer pluhur, qumësht, kakao, gjalpë, pluhur kokosi.
Integrimi ndërfaqor:	Gjuha shqipe, Matematikë, Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti.
Çështjet ndërkurrikulare:	Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.
Fjalë kyçe:	Recetë, përbërës, kuzhinier/e, përbërës, peshim, përzierje.
Organizimi i aktiviteve:	<p>Takimi i përbashkët fillon me prezantimin e prindërve që kanë ardhur atë ditë për të gatuar bashkërisht me fëmijët. Edukatori/ja paraqet përpara fëmijëve një libër me receta dhe flet për artin e gatimit, sa i rëndësishëm është për jetën e njeriut, si njerëzit krijojnë receta të ndryshme, si është krijuar një libër gatimi si krijohet një recetë si duhet bërë peshimi i përbërësve dhe se sa e rëndësishme është që të jenë në masën e duhur.</p> <p>Shpjegohet për sigurinë në kuzhinë, duke u ofruar një poster me shembuj, të cilin mund ta ilustroni dhe prezantoni para fëmijëve.</p> <p>Sot në klasë do të gatuhet bashkë me prindërit e ardhur enkas atë ditë. Do të bëhen biskota, që nuk kanë nevojë për t'u pjekur.</p> <p>Receta:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. 700 g biskota të bluara i vendosim në një enë të thellë, ku kemi shtuar 5 lugë kakao dhe 5 lugë sheqer. <p>Përziejmë përbërësit.</p>

2. Gjalpin e shkrijmë së bashku me 500 ml qumësht, dhe këtë masë e vendosim mbi biskotat e bluara, i përziejmë derisa të bëhet një masë kompakte.
3. Masës së formuar i japim forma të ndryshme dhe i lyejmë me pluhur kokosi (masat e dhëna hidhni në gota, e më pastaj bashkoni ato, në mënyrë që nga gota natyrshëm të arrijmë deri te tingulli G).

Masa mund të dyfishohet në varësi të përbërjes së grupit. Fëmijët ndjekin recetën dhe me ndihmën e prindërit të ftuar realizojnë ëmbëlsirat e tyre. Gjatë procesit të punës, fëmijët bëjnë matje me gota, mbushin dhe zbrazin përbërësit, përziejnë dhe krijojnë forma të ndryshme.

Në përfundim, bëhet pastrimi i vendit të punës dhe fëmijëve u shpjegohet rëndësia e përgjegjësive. Më tej, fëmijët bashkë me prindin mund të shijojnë ëmbëlsirat nën tingujt e muzikës argëtuese për fëmijë. Pastaj fëmijët do të vallëzojnë bashkërisht (edukatori/ja nxit fëmijët në lëvizje të shpejta dhe të ngadalta, në ulje dhe ngritje, në hedhje dhe rrotullime, pra në vallëzim nxisim fëmijët të kenë lëvizje të ndryshme trupore). Edukatori/ja pyet fëmijët se cilat gjëra kanë përdorur për të bërë matjen e përbërësve. Përgjigjja është "gotë". Pas shqiptimit të këtij tingulli, fëmijët nxiten të gjejnë fjalë të tjera që fillojnë me tingullin "G". Do të ndahen në grupe të vogla dhe do të plotësojnë fletëzën e shkronjës G. Në takimin përmbyllës do të rikujtohen aktivitetet e ndodhitë e ditës, duke shijuar biskotat e përgatitura së bashku.

**Vlerësimi:**

Fëmijët vlerësohen për shkathtësitë për të punuar me materiale të ndryshme, mbushjen dhe zbrazjen e gotës, përzierjen e përbërësve dhe ndjekjen e recetës.

Më shumë për të bërë:

Fëmijët marrin me vete në shtëpi fletëzën e punës të fusha Jeta dhe puna: "Receta e lëngut me fruta".

Reflektimi:

Gjyshërit na vizitojnë në kopsht

Fusha kurrikulare:	Gjuhët dhe komunikimi
Kurrikula lëndore:	Gjuhë shqipe
Tema nga plani dymujor:	Tinguj, shkronja, rrokje, fjalë dhe fjali
Rezultatet e të nxëniet për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):	I. 3; II. 3, 7; III. 1, 2, 3, 6; IV. 4; V. 2, 5; VI. 1, 2, 3, 4, 5, 6
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):	Gjuhët dhe komunikimi: 1.1; 1.3; 3.2 Matematikë: 3. 4 Jeta dhe puna: 2. 8. 1
Rezultati i të nxëniet të temës:	Vizatojnë dhe modelojnë sipas modeleve me materiale të ndryshme; i emërtojnë ato me fjalë dhe u tregojnë të tjerëve çfarë kanë dashur të paraqesin ndërmjet vizatimeve, figurave etj.
Rezultatet e të nxëniet të aktiviteteve:	<ul style="list-style-type: none"> • Zbulon shkronjën sekrete gjatë ngjyrosjes me ngjyra uji. • Punon kartolinë për gjyshërit. • Dëgjon historinë e gjyshit në klasë.
Kriteret e suksesit:	<ul style="list-style-type: none"> • Zbulon shkronjën sekrete gjatë ngjyrosjes me ngjyra uji. • Puno kartolinë për gjyshërit. • Dëgjo historinë e gjyshit në klasë.
Burimet dhe materialet:	Fletë të bardha vizatimi, ngjyrë e bardhë qiri, ngjyra uji, një top, libri i punës për fëmijë, fletë me ngjyra, gërshërë, ngjitës, ngjyra, shkëlqyes dhe copëza nga mbetjet pas prerjes së lapsave/ngjyrave.
Integrimi ndërfaqor:	Matematikë, Shkathtësi për jetë.
Çështjet ndërkurrikulare:	Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.
Fjalë kyçe:	Familja, gjyshërit, kujdesi, dashuria, jeta, puna, koha e mëparshme.
Organizimi i aktiviteteve:	Takimi i përbashkët fillon me përshëndetjen, leximin e kalendarit dhe vazhdohet me lojën: "Paso topin".



Ecuria e lojës: Fëmijët ulen të gjithë në një rresht, e duke pasur pas vete një shok/shoqe. Edukatori/ja ka një top në dorë dhe atë ia pason fëmijës së parë. Topi kalon nga njëri te tjetri pa e lënë të bie në tokë duke numëruar. Kjo lojë kërkon përqendrim dhe i ndihmon fëmijët në shtendosjen e kafazit të kraharorit dhe në zhvillimin e muskujve të mëdhenj.

Ju mund ta bëni më sfidues ushtrimin, duke rritur shpejtësinë e pasimit të topit. Pas përfundimit të ushtrimit, fëmijët ngrihen në këmbë, shkundojnë krahët dhe bëjnë lëvizje rrethore të duarve. Kjo i ndihmon të shtendosin muskujt e duarve, sidomos para punëve krijuese. Këtë aktivitet mund ta përdorni shpesh para ose pas aktiviteteve të punëdores.

Pasi fëmijët të jenë qetësuar, mblidhen në rreth dhe edukatori/ja nis përshkrimin e një personi të cilin nuk do ta emërtojë, por fton fëmijët të gjejnë se për kë bëhet fjalë.

Si për shembull:

Kush është ai person që:

- na fal shumë dashuri;
- i do fort edhe prindërit tanë;
- kujdeset për ne, aq sa ia lejon shëndeti;
- na tregon histori të bukura nga e kaluara;
- di përrallat më të bukura;
- gëzohen pa masë kur i vizitojmë.

Kur fëmijët të kenë zbuluar se për kë bëhet fjalë, nis diskutimi për gjyshërit, si jetonin ata në të kaluarën, sa i çmuar është kujdesi dhe dashuria jonë për ta, përse kanë nevojë për ne e kështu me radhë. Në vazhdim luhet loja: "Shkronja misterioze".

Materialet: Një ngjyrë e bardhë qiri, fletë vizatimi, bojëra uji, furçë dhe ujë.

Ecuria: Edukatori/ja, në fletë të bardha, me bojëra qiriri të bardhë, ka vizatuar shkronjën GJ, për secilin fëmijë. Ai/ajo u shpërndan fletët dhe fëmijët do ta ngjyrosin atë sipas dëshirës me ngjyra uji. Kështu ata do të zbulojnë shkronjën sekrete, me të cilën do të njihen sot (Vizatimi me bojëra qiriri do të krijojë rezistencë në përzierjen me bojërat e ujit dhe gjurma e shkronjës GJ do të mbetet e dukshme).

Kur të gjithë të kenë përfunduar, edukatori/ja tregon që përveç shkronjës sekrete, do të kenë edhe një të ftuar sekret, që do të tregojë histori nga e kaluara. Ftohet gjyshi/gjyshja vullnetare.

Ai/ajo do të prezantohet dhe para fëmijëve flet për jetën në të kaluarën, si ishte të jetoje në atë kohë, si mësonin ata, si luanin, çfarë lloj lojërash kishin, si e kalonin kohën e lirë etj. Në fund, u tregon fëmijëve një përrallë.

"Kartolina për gjyshërit"

Materialet: fletë me ngjyra, laps, gërshtë, ngjytës, copëza nga mbetjet e prerjes së lapsave/ngjyrave.

Fëmijët zgjedhin materialin e punës dhe në mënyrë të pavarur e sipas dëshirës, krijojnë kartolina, qëllimi i të cilave është të përcjellin një mesazh dashurie për gjyshërit. Në takimin e përbashkët bëhet përsëritje e njohurive të marra gjatë ditës. Kartolinat e përfunduara u tregohen shokëve/shoqeve të grupit dhe gjithsecili tregon kartolinën e punuar.

Vlerësimi:

Fëmijët vëzhgohen për ndërveprim me top dhe ndjekjen e udhëzimeve. Po ashtu, vlerësohen për mënyrën e ndërveprimit me gjyshin/gjyshen që ishte në grupin edukativ, pyetjet e bëra etj.

Më shumë për të bërë:

Fëmijët që nuk jetojnë me gjyshërit, udhëzohen t'i vizitojnë ata dhe t'u dërgojnë kartolina. Në varësi të kohës, fletëzat e shkronjës GJ mund të plotësohen në klasë ose në shtëpi.

Reflektimi:

Me prindërit në lojë

Fusha kurrikulare:	Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti
Kurrikula lëndore:	Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti
Tema nga plani dymujor:	Lojëra dhe pushimi
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):	I. 3; III. 7; V. 5; VI. 1
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):	Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti: 2. 1. 2. 2 Gjuhët dhe komunikimi: 1. 1 Matematikë: 3. 5
Rezultati i të nxënit të temës:	Praktikon lojëra dhe aktivitete fizike në bashkëpunim në çifte dhe grupe.
Rezultatet e të nxënit të aktiviteteve:	<ul style="list-style-type: none"> • Realizon aktivitete fizike në park. • Numëron gjatë lojërave. • Përshkruan me fjalë format e reve/qiellin.
Kriteret e suksesit:	<ul style="list-style-type: none"> • Luaj lojëra fizike në park. • Numëro gjatë lojërave. • Përshkruaj me fjalë format e reve/qiellin.
Burimet dhe materialet:	Mjete transporti, një litar, rrathë plastike rrotullues, topa, pengesa (mund të jenë çfarëdo materiali, si shishe plastike me ngjyra, kona etj.).
Integrimi ndërfaqor:	Gjuhë shqipe, Matematikë.
Çështjet ndërkurrikulare:	Globalizimi dhe ndërvarësia.
Fjalë kyçe:	Lojë, sfidë, prindër, skuadër, kërcim, para, pas, hedhje, saktësi, siguri.
Organizimi i aktiviteteve:	<p>Dita fillon me pritjen e fëmijëve bashkë me prindërit. Ulen të gjithë, fëmijët pranë prindërve të tyre. Duke qenë se formohet një rreth i madh dhe në grup ka anëtarë të rinj, nis loja e prezantimeve, ku secili thotë emrin e tij dhe diçka për veten.</p> <p>Pas prezantimit, edukatori/ja jep udhëzime për aktivitetet që do të zhvillohen atë ditë. Të gjithë do të shkojnë në parkun e qytetit, ku do të zhvillojnë lojëra dhe aktivitete sportive në bashkëpunim me prindërit.</p> <p>Organizimi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Në bashkëpunim me prindërit, siguroni mjete transporti të sigurta për fëmijët. • Fëmijët do të kapen të gjithë te një litar i gjatë, rrugës nga klasa përgatitore te makinat dhe nga makinat në park (kjo teknikë i mban ata të bashkuar dhe lëvizin në një linjë të vetme, çka e bën më të lehtë kontrollimin e grupit që lëviz). • Sigurohuni që secili fëmijë të ketë më vete shishe me ujë. • Siguroni pajisjet për realizimin e lojërave.



Mund të zhvillohen një sërë aktivitete sportive/argëtuese, nga ato që keni planifikuar dhe aktivitete shtesë, të cilat mund t'i propozojnë prindërit-vullnetarë, që kanë ardhur me ju.

Lojëra të mundshme:

Loja me litar - ndahemi në dy skuadra, ku secila zgjedh vetë emrin e saj. Skuadrat tërheqin litarin, kush kalon vijën e mesit, të shënuar në tokë, humb lojën.

Loja me rreth plastik - rendisni në një vijë disa rrethë plastikë, ku fëmijët dhe prindërit kërcëjnë me dy këmbë, me një këmbë, para dhe pas etj. Gjatë kërcimit, fëmijët numërojnë rrethët dhe kujtojnë numrat.

Kërce në figurat gjeometrike - vendosni disa figura gjeometrike me distancë nga njëra-tjetra, aq sa janë të arritshme për kërcim nga fëmijët e kësaj moshe. Edukatori/ja ose njëri nga prindërit jep udhëzimet për kërcim, duke shënjuar figurat ku duhet kërcyer. Për shembull: kërcë nga rrethi në trekëndësh, nga trekëndëshi kthehu te rrethi, nga rrethi në katror e kështu me radhë.

Mbajmë topin pa duar - loja luhet në çifte, ku secili çift merr topin nga vija e fillimit deti te koshi në fund. Fëmijët kanë dy mundësi të provojnë lojën, një herë e marrin topin duke e mbajtur ballë me ballë dhe radhën tjetër shpinë me shpinë. Kështu vazhdojmë me aktivitete të ndryshme. Në përfundim, të gjithë fëmijët shtrihen në batanijet e piknikut, praktikojnë qetësinë dhe frymëmarrjen e thellë me stomak, për të vazhduar pastaj me soditjen e qiellit dhe përshkrimin e formave të reve për disa minuta, duke përdorur imagjinatën dhe fjalitë përshkruese.

Në takimin e përbashkët diskutohet se si ka kaluar dita në fjalë, përgëzohen fëmijët për lojërat e zhvilluara dhe pyeten se si janë ndier në prani të prindërve gjatë lojërave. Falënderohen prindërit pjesëmarrës dhe bashkërisht përmbillet dita.


Vlerësimi: Fëmijët vëzhgohen gjatë pjesëmarrjes aktive në lojëra, për ndjekjen e udhëzimeve, ndërveprimin me të tjerët dhe realizimin e lojërave.

Më shumë për të bërë: Aktiviteti mund të përsëritet shpesh, sa herë të jetë mot i përshtatshëm. Edukatori/ja shpërndan te prindërit listën me materiale të cilat duhen në javët në vazhdim.


Reflektimi: _____

Fasulja magjike

Fusha kurrikulare:	Shkencat e natyrës
Kurrikula lëndore:	Njeriu dhe natyra
Tema nga plani dymujor:	Bimët, kafshët dhe njeriu
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):	I. 3, 5; II. 1, 2, 3, 4, 7; III. 1, 2, 3, 4, 6; IV. 4; V. 5. VI. 6
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):	Shkencat e natyrës: 1 Gjuhët dhe komunikimi: 1. 3; 1. 4 Matematikë: 3. 4
Rezultati i të nxënit të temës:	Tregon nevojat themelore të bimëve.
Rezultatet e të nxënit të aktiviteteve:	<ul style="list-style-type: none"> • Komentojnë tregimin “Fasulet magjike”. • Kujdesen për rritjen e farës së fasules. • Numërojnë me fara fasuleje.
Kriteret e suksesit:	<ul style="list-style-type: none"> • Komento tregimin “Fasulet magjike”. • Kujdesu për rritjen e farës së fasules. • Numëro me fara fasuleje.
Burimet dhe materialet:	Poster për ciklin e rritjes së fasules, tregimi “Fasulet magjike”, qese najloni, pambuk, fara fasuleje, një enë me ujë, fletë, gërrshërë, ngjitës.
Integrimi ndërfaqor:	Gjuhë shqipe, Matematikë.
Çështjet ndërkurrikulare:	Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.
Fjalë kyçe:	Bimë, fasule, cikël i rritjes, farë, filiz, fidan, kërcelli, rrënja, gjethet.
Organizimi i aktiviteteve:	<p>Në takimin e përbashkët, edukatori/ja lexon tregimin “Fasulet magjike”. Më tej hap diskutimin për tregimin e lexuar, duke nxitur fëmijët të përqendrohen te procesi i rritjes së fasules. U tregohet një poster me ilustrim të ciklit të rritjes së fasules.</p> <p>Këshillohet të flitet për:</p> <ul style="list-style-type: none"> • ciklin e rritjes së një bime; • çfarë i nevojitet një bime për t’u rritur; • brenda çdo fare ka një filiz; • si rritet fara e fasules në faza të ndryshme. • lidhjen me historinë e lexuar “Fasulet magjike”. <p>Fëmijët do të provojnë praktikisht eksperimentin e rritjes së bimës.</p> <p><i>Materialet:</i> qese najloni me mbërthyes (ose cohë të thjeshtë najloni), fara fasuleje, pambuk, një enë me ujë, ngjitës, fletë, marker.</p>



Ecuria: Duke qenë se çdo fëmijë është lajmëruar paraprakisht për eksperimentin, ai/ajo ka qesen vetjake, në të cilën vendos pambuk të lagur (sqaroni që pambuku nuk duhet të përmbajë shumë ujë). Vendosin nga dy-tri fara në pambukun e lagur brenda qeses (këshillohet të vendoset më shumë se një farë, në rast se ndonjëra nuk çel). Në pjesën e sipërme ngjitet një fletë me shënimin përkatës (ju mund të shtypni fletët paraprakisht ose t'i shkruani vetë). Qesja duhet të jetë pak e hapur (ose mund t'i bëni disa vrima), për të qarkulluar ajri. Qeset me fara vendosen në dritaren e klasës, që fëmijët të kenë mundësi të shohin procesin e rritjes së bimës.



Unë jam _____ dhe kjo është
bima ime, që do të çelë për _____ ditë.

Secili fëmijë mund të ketë një shënim të tillë sipër qeses së tij.

Loja matematikore "Numërojmë me fasule".

Fasulet janë një mënyrë shumë e përshtatshme për të kryer veprime matematikore dhe ju mund të integroni tregimin e mësuar "Fasulet magjike", në aktivitetin e radhës për shkathtësitë numerore. Në klasë ofrohen katër-pesë lojëra të tilla dhe fëmijët luajnë në grupe.




Fëmijët duhet të kapin fasulet me pincetë, (duhet kapje e saktë dhe përqendrim, por ky proces zhvillon muskujt e vegjël të dorës dhe koordinimin dorë/sy) për t'i vendosur atë sa udhëzon numri në gjethe.

Në takimin përmbyllës përsëritet tregimi "Fasulja magjike", nxiten fëmijët të bëjnë komente rreth tregimit. Mund t'i inkurajoni të imagjinojnë një përfundim tjetër të tregimit, apo të komentojnë karakteristika të personazheve, si: "Çfarë njeriu ishte gjiganti? A ishin të drejta veprimet e tij? Po djali, a veproi drejt?". Komentohet eksperimenti me farat e fasuleve, duke pyetur fëmijët se për sa ditë mendojnë se çel bima e fasules. Lista me numrat e thënë prej tyre vendoset në xhamin e dritares dhe në fund fëmijët i fotografojnë bimët e tyre për të krahasuar procesin gjatë rritjes.

Vlerësimi: Fëmijët vlerësohen për komentimin e tregimit dhe për lojën matematikore "Numërojmë me fasule".

Më shumë për të bërë: Mund të përdorni forma të ndryshme të eksperimentimit që tregojnë rritjen e fasules. Fëmijëve mund t'u ofrohen disa forma dhe ata të zgjedhin mënyrën që u përshtatet më shumë.




Reflektimi: _____

Art me fasule

Fusha kurrikulare:	Artet
Kurrikula lëndore:	Edukatë figurative
Tema nga plani dymujor:	Krijimet figurative
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkollës (të synuara):	I. 3; II. 1, 2, 3, 4, 7. III. 1, 2, 3, 4, 6; IV. 4; V. 5. VI. 6
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):	Artet: 1 Gjuhët dhe komunikimi: 1. 1; 1. 4 Jeta dhe puna: 2. 8. 1 Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti: 2
Rezultati i të nxënit të temës:	Me materiale të ndryshme krijojnë dhe riciklojnë sipas fantazisë dhe imagjinatës, vizatojnë, ngjyrosin, modelojnë, shtypin, për tema të ndryshme që trajtohen në shkollë dhe jashtë saj duke përdorur: format me ngjyra, pemët, lodrat edhe tema të lira, ku shprehet imagjinata dhe kreativiteti vetjak.
Rezultatet e të nxënit të aktiviteteve:	<ul style="list-style-type: none"> • Emërton fazat e rritjes së bimëve në lojën me tabelë. • Krijon kolazh me fara dhe materiale të ndryshme. • Rregullon ambientin e punës.
Kriteret e suksesit:	<ul style="list-style-type: none"> • Emërto fazat e rritjes së bimëve në lojën me tabelë. • Krijon kolazh me fara dhe materiale të ndryshme. • Rregullo ambientin e punës.
Burimet dhe materialet:	Loja me tabelë dhe kubi (bashkangjitur te Shtojca e edukatorit/es), fletë me ngjyra, laps, ngjitës, gërhërë, fara të ndryshme, materiale nga kutia e riciklimit (që mund të përdoren për realizimin e kolazhit).
Integrimi ndërfaqor:	Gjuhë shqipe, Shkathtësi për jetë, Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti.
Çështjet ndërkurrikulare:	Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.
Fjalë kyçe:	Kolazh, vepër arti, teknikë arti, bimë, rrënja, kërcelli, gjethja, lulja, materiale të ndryshme.
Organizimi i aktiviteteve:	Në takimin e përbashkët, pas leximit të kalendarit dhe këndimit të një kënge mirëseardhjeje, bëhet përsëritje nga ditët e kaluara, ku fëmijët përsërisin fazat e rritjes së fasules dhe faktorëve që ndikojnë në të. Për të kryer përsëritjen, mund të përdoret "Loja me tabelë". "Loja me tabelë" - Do ta gjeni lojën me tabelë të bashkangjitur te ky libër. <i>Ecuria:</i> Fëmijët ndahen në dy grupe të barabarta (bëhet kujdes që grupet të jenë të barabarta për nga gjinia), dhe fëmijëve u jepet detyrë të mblidhen si skuadër e bashkërisht t'i vënë një emër grupit të tyre. Vendoset tabela në mes të klasës, kurse dy grupet e fëmijëve rrinë anash.

(Loja me tabelë ka edhe formatin e kubit, të cilin ju duhet ta prisni dhe ta ndërtoni.)



Secila skuadër vendos bashkërisht për një objekt identifikues me të cilin do të lëvizin në tabelë gjatë lojës. Objekti mund të jetë kuti ngjyrash, gomë, ngjitës apo diçka tjetër. Çdo fëmijë hedh kubin dhe në varësi të numrit që i bie, lëviz në tabelë. Kur objekti ndalet te kutia në të cilën fillojnë shkallët, skuadra ngjitet lart aty ku përfundojnë shkallët. Kur objekti ndalet te bishti i gjarprit, ai duhet të zbresë te goja e tij. Ndërsa kur objekti ndalet te rubrika në të cilën edukatori/ja ka ngjitur skedën me pyetje, fëmija që ka hedhur kubin, duhet t'u përgjigjet pyetjeve.

Edukatori/ja duhet të hartojë disa pyetje që lidhen me fazat e rritjes së bimëve, si:

- Çfarë i nevojitet një fare për t'u rritur?
- Emërto pjesët e një bime.
- Çfarë ndodh me një bimë, nëse nuk i japim ujë?

Pas përfundimit të lojës, fëmijët qetësohen për disa minuta.

Edukatori/ja i njeht fëmijët me teknikën e kolazhit, çfarë quajmë kolazh, si mund të krijojmë një të tillë, çfarë na nevojitet etj. (mund të sillen në klasë lloje të ndryshme kolazhesh, në formë albumesh apo ilustrimesh).

Edukatori/ja shton: "Në këtë rast do të bëjmë kolazh me lloje të ndryshme farash, duke i kombinuar ato me materiale të tjera, që mund t'i marrim nga kutia e materialeve të ripërdorshme".

Aktivitetet zhvillohen në tri qendra:

Në njërin grup, fëmijët do të bëjnë punëdore, duke përdorur materiale të ndryshme për të krijuar kolazh me fara. Në grupin tjetër do të identifikojnë pjesët e bimës dhe do t'i emërtojnë ato sipas tiketave.

Në grupin e rradhës, përmes vizatimit, ata do të vëzhgojnë dhe mbajnë shënim dallimet mes 3-4 lloje të farave të ofruara.

Punimet ekspozohen te këndi i artit dhe ftohen fëmijët që të shohin punimet. Me ta bashkëbisedohet edhe për të veçantat e llojeve të ndryshme të farave që vëzhguan.

Pas përfundimit të aktiviteteve, fëmijët udhëzohen që në grup të sistemojnë të gjitha mjetet e mbetura nga aktiviteti paraprak (duke marrë parasysh se nga puna me kolazh ka shumë mbetje/copëza dhe rrëmujë në klasë). Kështu, ata edukohen për mirëmbajtjen e ambientit dhe sistemimin e materialeve në vendet përkatëse.



Vlerësimi:

Fëmijët vëzhgohen përgjatë zhvillimit të aktiviteteve dhe sipas planit të vlerësimit, edukatori/ja mban shënime të vazhdueshme. Puna e fëmijëve mund të dokumentohet edhe përmes fotografive dhe videove të shkurtra.

Më shumë për të bërë:

Mund të paraqisni para fëmijëve videot e mëposhtme, me të cilat ata do të njihen me teknikën e kolazhit. <https://youtu.be/5pqvLjqfQF4>
https://youtu.be/5_A0JNXTh5Q

Reflektimi:

1, 2, 3, sa fara kemi ne?

Fusha kurrikulare:	Matematikë
Kurrikula lëndore:	Matematikë
Tema nga plani dymujor:	Numrat natyrorë
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):	I. 3; II. 1, 2; III. 1, 2, 3, 4; IV. 4; V. 5. VI. 6
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):	Matematikë: 5. 1 Gjuhët dhe komunikimi: 1. 1; 14 Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti: 2. 1
Rezultati i të nxënit të temës:	Krahason numrat deri në 10, duke u bazuar në dy grupe objektesh dhe përdor shprehjet: <i>më shumë - më pak; më i madh - më i vegël - po aq.</i>
Rezultatet e të nxënit të aktiviteteve:	<ul style="list-style-type: none"> • Bën lidhjen mes rafikut të numrit me sasisë së farave të fasules. • Imiton lëvizjet trupore të shokut/shoqes në lojë. • Krahason <i>më pak - më shumë</i> fasule te fletëza e punës.
Kriteret e suksesit:	<ul style="list-style-type: none"> • Bëj lidhjen e numrit të shënuar në gjethe, me sasinë e farave të fasules. • Imito lëvizjet trupore të shokut/shoqes në lojën ndjek liderin; • Krahason <i>më pak - më shumë</i> fasule te fletëza e punës.
Burimet dhe materialet:	Fletë me ngjyrë të gjelbër, kartat e numrave (nga pakoja edukative), laps, gërshërë, zare, libri i punës për fëmijë.
Integrimi ndërfaqor:	Gjuhë shqipe, edukatë fizike, sportet dhe shëndeti.
Çështjet ndërkurrikulare:	Zhvillim i qëndrueshëm.
Fjalë kyçe:	Numërim, sasi, fara, çift, punë grupore, bimë, më pak, më shumë.
Organizimi i aktiviteteve:	<p>Në takimin e përbashkët, fëmijët priten me një këngë mirëseardhjeje dhe bashkëbisedohet se si e kanë kaluar pasditen e djeshme. Plotësohet kalendari dhe flitet për motin, si dhe për ndryshimet që ndodhin në këtë stinë. Edukatori/ja mund të kthejë vëmendjen te fëmijët, t'i pyesë si ndihen dhe a e pëlqejnë stinën e re; të përshkruajnë gjendjen emocionale (emërtojnë një emocion) dhe të japin një arsyetim të shkurtër pse ndihen ashtu. Nxiten fëmijët të përshkruajnë si ndihen, kur punojnë në punë individuale, në grup apo në çift.</p> <p>Loja: "Ndjek shokun"</p> <p><i>Ecuria:</i> Një fëmijë hyn në mes të rrethit dhe bën një lëvizje (ai mund të imitojë një bimë në faza të ndryshme të rritjes, ndërsa grupi e imiton lëvizjen e fëmijës në mes të rrethit. Radha i kalohet një shoku/shoqeje, që bën lëvizjen paraprake, por shton edhe një lëvizje tjetër. Grupi ndjek lëvizjet që shtohen me radhë nga secili fëmijë. Loja vazhdon për aq kohë sa fëmijët mund të ndjekin lëvizjet e treguara. Pas disa minutash, vendoset muzikë dhe fëmijët këndojnë së bashku.</p>

Fëmijët përshkruajnë aktivitetin me nga një fjalë secili (për mënyrën si janë ndierë gjatë lojës, ku kishin vështirësi, a i ndoqën lehtësisht lëvizjet e shokëve etj.). Edukatori/ja u shpërndan kartat e numrave fëmijëve në rreth, numrat duhet të jenë gjithmonë nga dy të njëjtë. Secili fëmijë merr një kartë me një numër. Kur të gjithë fëmijët të kenë marrë nga një numër, edukatori/ja i udhëzon të lëvizin dhe të kërkojnë për numrat e përbashkët. Secili fëmijë gjen shokun/shoqen me numër të njëjtë dhe bëhen çift. Fëmijët përfshihen në lojë dhe argëtohen.

Loja "1, 2, 3, sa fara kemi ne?"



Edukatori/ja me fleta të gjelbra ka përgatitur gjethet me numra (vizatohet gjethja në fletë dhe ndahet në pjesëza të ndryshme me numrat nga 1-6). Gjethja mund të plastifikohet për përdorim më afatgjatë.

Kjo lojë matematikore zhvillohet në çift; fëmijët marrin gjethen e tyre gjigante dhe një kub. Njëri prej tyre hedh zarin dhe tregon numrin e rënë, tjetri vendos farat e fasuleve në rubrikat përkatëse. Pasi t'i ketë mbushur të gjitha hapësirat me numra, fëmijët ndërrojnë vendet dhe luajnë sërish. Kujdesuni që të keni aq gjethë sa ka çifte fëmijësh në lojë.

Fëmijët praktikojnë shkathtësitë matematikore për të krahasuar sasinë e fasuleve, te fletëza në librin e fëmijës.

Në takimin përmbyllës, fëmijët ndajnë përshtypjet e ditës, duke i përshkruar ndjesitë e tyre gjatë aktiviteteve që janë realizuar, se si janë ndier në punën grupore, atë në çift dhe në individuale. Në përmbyllje të diskutimit, fëmijët këndojnë këngën "Nëse je vërtet i lumtur".

Vlerësimi:

Fëmijët vlerësohen për ndërveprimin në punë grupore dhe në çift. Vlerësohen shkathtësitë në numërimin me fasule.

Më shumë për të bërë:

Fëmijët mund të argëtohen me lojërat edukative kompjuterike për shkathtësitë matematikore në linkun e mëposhtëm.

<http://pbskids.org/games/math/>

Reflektimi:

Historia e luleve në shkretëtirë

Fusha kurrikulare:	Gjuhët dhe komunikimi
Kurrikula lëndore:	Gjuhë shqipe
Tema nga plani dymujor:	Tinguj, shkronja, rrokje, fjalë, fjali
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):	I. 3, 4, 5. III. 2, 6; IV. 4; V. 5. VI. 6
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):	Gjuhët dhe komunikimi: 1. 1; 1. 2; 1. 4; 1. 7 Matematikë: 3. 4 Artet: 1
Rezultati i të nxënit të temës:	Shqiptojnë drejt tingujt, zanoret dhe bashkëtingëlloret gjatë të shprehurit.
Rezultatet e të nxënit të aktiviteteve:	<ul style="list-style-type: none"> • Komenton historinë "Shkretëtira dhe lulet". • Plotëson fletëzën për shkronjën "Y" të libri për fëmijë. • Bën lëvizje trupore duke ndjekur ritmin muzikor të loja me pjata.
Kriteret e suksesit:	<ul style="list-style-type: none"> • Komento historinë "Shkretëtira dhe lulet". • Plotëso fletëzën për shkronjën "Y" të libri për fëmijë. • Bëj lëvizje trupore duke ndjekur ritmin muzikor të loja me pjata.
Burimet dhe materialet:	Libri "Përrallat e Nënës Tokë" nga seria: Edukimi ekologjik, pjata letre, kartat me shkronja (nga pakoja edukative), muzikë.
Integrimi ndërfaqor:	Matematikë, Edukatë muzikore.
Çështjet ndërkurrikulare:	Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.
Fjalë kyçe:	Shkronja "Y", shkretëtira, rërë, bimë, lule.
Organizimi i aktiviteteve:	<p>Në takimin e përbashkët në rreth, vendosni një kuti me rërë në të cilën ka disa objekte: yje, lule të ndryshme dhe shkronja "Y" (magnetike, karta, druri etj.). Pas përshëndetjeve mirëseardhëse dhe diskutimit të kalendarit, lexohet historia "Shkretëtira dhe lulet" (Libri "Përrallat e nënës Tokë" nga seria: Edukimi ekologjik).</p> <p>"Shkretëtira dhe lulet"</p> <p><i>Na ishte një shkretëtirë me rërë. Ditën ajo ngrohej nën diellin e nxehtë, ndërsa netëve shihte yjet. Shkretëtira bënte shoqëri edhe me erën. Kjo ndërtonte me rërë kodra të mëdha e me kreshta. Një ditë, era i solli shkretëtirës një aromë të këndshme.</i></p> <p>- Sa aromë e mirë! - u gëzua shkretëtira.</p> <p>- Është aroma e luleve. Erdhi pranvera dhe ato çelin kudo, - u përgjigj era.</p> <p>- Ç'janë lulet? Nuk i kam parë kurrë, - tha shkretëtira.</p>

- Lulet ngjajnë si yje të vegjël shumëngjyrësh. Ato rriten në pranverë nga farat që rrinë në tokë, - i shpjegoi era.

- Me siguri në tokën time të thatë, nën rërë, gjithashtu ka fara, por ato flenë! - tha e trishtuar shkretëtira.

Era u largua. Të nesërmen shkretëtira pa miken e saj, erën, që po shtynte një re të madhe ngjyrë plumbi.

- Nënë Re, pse na solli era këtu? Këtu s'ka asnjë fije bari për ta ujitur, - dëgjoi shkretëtira pëshpërimën e pikave të vogla të shiut.

- Era e di vetë punën e saj. Fluturoni poshtë, bijëza, - u tha ëmbël nënë Reja.

Pikëzat iu bindën. Ato ranë në rërë në tokën e thatë dhe aty takuan farat. Farat pinë me etje të madhe pikat dhe rritën lule.

- Faleminderit, erë! Faleminderit, re! Ju më dhuruat lule-yje, - pëshpëriti e gëzuar shkretëtira.

(Libri "Përrallat e Nënës Tokë" nga seria: Edukimi ekologjik).

Pas përfundimit të historisë, fëmijët komentojnë historinë që sapo kanë dëgjuar. Nxiten të thonë mendimin e tyre dhe të bëjnë pyetje. Më pas, fëmijët ftohen të gjurmojnë brenda kutisë me rërë, për të parë se çfarë fshihet aty. Nxjerrin lulet, yjet dhe shkronjën Y (mund të jetë nga kartat e përgatitura nga edukatori/ja apo ndonjë shkronjë magnetike), i grupojnë dhe identifikojnë shkronjën e re me të cilën do të njihen atë ditë, shkronja "Y". Fëmijët gjejnë fjalë që fillojnë me shkronjën "Y". Fëmijët do të ndahen në dy grupe: njëri grup do të bëjë plotësimin e fletëzave, ndërsa grupi tjetër do të modeloj shkronjën Y me materiale të ripërdorshme. Grupet ndërrohen në formë rrotacioni. Pasi fëmijët të kenë përfunduar, luhet loja muzikore me shkronja me tërë grupin.

Edukatori/ja vendos muzikë ritmike në klasë dhe fëmijët kërcëjnë qark rrethit me pjata letre dhe shkronja. Kur ndalon muzika, fëmijët qëndrojnë në vend dhe identifikojnë shkronjën pranë së cilës janë. Loja vazhdon duke e ndryshuar kohë pas kohe tempin e muzikës (përdorni disa lloje të melodive të ndryshme). Në varësi të karakteristikave të grupit, vendoset kohëzgjatja e aktivitetit, aq sa mendohet se fëmijët kanë përsëritur shkronjat e njohura, kanë identifikuar shkronjën e re dhe kanë bërë lëvizje trupore mjaftueshëm.

Pas lojës me pjata, fëmijët lihen të lirë të luajnë lojën me role apo të dramatizojnë historinë "Shkretëtira dhe lulet".

Në takimin e përbashkët, fëmijët japin informata kthyesë për aktivitetet e realizuara, duke shprehur përjetimet, përshtypjet dhe njohuritë e reja.

Vlerësimi: Edukatori/ja mund të mbajë shënime narrative për fëmijët gjatë aktiviteteve.

Më shumë për të bërë: Mund të përdoret një tabaka me rërë për të praktikuar modelin e shkronjës "Y".

Reflektimi: _____

Lulet e qytetit tim

Fusha kurrikulare:	Shoqëria dhe mjedisi
Kurrikula lëndore:	Shoqëria dhe mjedisi
Tema nga plani dymujor:	Kujdesi për mjedisin rrethues
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):	I. 3; II. 1, 2, 7. III. 1, 2, 3, 6; IV. 2. 4; V. 5. 7; VI. 6
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):	Shoqëria dhe mjedisi: 5. 2 Gjuhët dhe komunikimi: 1. 1; 1. 5; 2. 8 Matematikë: 3. 4 Shkencat e natyrës: 1
Rezultati i të nxënit të temës:	Identifikojnë sjelljet që lidhen me mbrojtjen dhe dëmtimin e mjedisit. Tregojnë mënyrat e sjelljes (të drejtë dhe të gabuar) për kujdesin ndaj mjedisit në rrugë, në lagje, park etj.
Rezultatet e të nxënit të aktiviteteve:	<ul style="list-style-type: none"> • Identifikon lulen që mungon te koshi i luleve. • Mbjell farat e luleve në vazo.
Kriteret e suksesit:	<ul style="list-style-type: none"> • Identifiko lulen që mungon te koshi i luleve. • Mbill farat e luleve në vazo.
Burimet dhe materialet:	Fara lulesh, dorëza të kopshtarisë (ose najloni), vazo dhe lopatë.
Integrimi ndërfaqor:	Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti, gjuhë shqipe, matematikë.
Çështjet ndërkurrikulare:	Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.
Fjalë kyçe:	Kujdes, mirëmbajtje, mjedis, kopsht, lule, aromë, përgjegjësi.
Organizimi i aktiviteteve:	<p>Në takimin e përbashkët, vendosni kuti farash nga lulet, lopatë, vazo etj., dhe nxisni fëmijët të futen në temë duke u përpjekur të gjejnë se çfarë aktiviteteve do të zhvillohen sot ose si do ta kalojnë ditën. Në këtë mënyrë, natyrshëm arrihet te tema e ditës. Në rreth, luhet loja e luleve.</p> <p><i>Materialet:</i> pesë lule letre, shkopinj druri, ngjitës.</p> <p><i>Ecuria:</i> Ftoni një fëmijë në mes të rrethit dhe jepini të zgjedhë një nga pesë lulet e letrës, por vetëm duke e parë, pa folur. Fëmijët e tjerë në rreth mbyllin sytë, ndërkohë që ju fshihni lulen e zgjedhur. Fëmijët hapin sytë dhe përpiqen të kujtojnë se ç'lule është fshehur.</p> <p>Fëmijët njihen me farat e luleve, pjesët përbërëse, llojet, kujdesin për të cilin kanë nevojë dhe rëndësinë e tyre, jo vetëm në oborrin e shtëpisë, por edhe në qytet/parqe/lagje etj. (Konkretizoni shpjegimin tuaj me fotografi të ndryshme ose ndonjë video.) Për të rritur ndjenjën e përgjegjësisë dhe për t'u kujdesur për ambientin që na rrethon, fëmijët do të mbjellin vetë lulet për qytetin e tyre, do të kujdesen për to dhe pasi të jenë rritur, do t'i mbjellin jashtë oborrit të kopshtit.</p>

Te këndi i shkencës, sistemoni mjetet e punës për mbjelljen e farave të luleve dhe ftoni fëmijët të marrin mjetet që u duhen.



Edukatori/ja jep udhëzimet e qarta për ecurinë e procesit dhe përgjegjësitë gjatë procesit të mbjelljes së farave të luleve. Pasi fëmijët mbjellin farat e tyre të luleve, shkruajnë emrat e tyre në vazo dhe i vendosin në një kënd të ndritshëm të klasës.

Në takimin përmbyllës merren informata kthyesë nga fëmijët për aktivitetet e zhvilluara gjatë ditës së sotme. Bëjmë një përsëritje të përgjithshme duke e vënë theksin te mirëmbajtja e ambientit, si dhe çfarë mund të kontribuojmë ne si qytetarë, që qyteti të jetë më i bukur.

Vlerësimi:

Vëzhgohet pjesëmarrja aktive në diskutim rreth kujdesit dhe përgjegjësiwe që kemi për qytetin tonë dhe puna e fëmijëve gjatë mbjelljes së farave të luleve, ndjekja e udhëzimeve e mirëmbajtja e ambientin të punës. Përmes fotografive dokumentohet puna e fëmijëve.

Më shumë për të bërë:

Ju mund të zhvilloni lojën e klasifikimit të pjesëve të lules, duke u ofruar tri gota me shënim: *Kërçelli*, *Gjethet* dhe *Petalet*. Më pas tregojuni pjesët e ndara të luleve dhe fëmijët vendosini në gotat përkatëse, duke i klasifikuar (mund të jenë lule të gjalla, ose në pamundësi mund t'u ofroni pjesët e luleve të vizatuara/printuara).

Inkurajoni fëmijët që të hulumtojnë se ç'lloj lulesh kanë ata në shtëpi. Kërkoni ndihmën e prindërve që t'i ndihmojnë në emërtimin e llojeve të luleve.

Reflektimi:

Kush do të jetë mësues/e sot?

Fusha kurrikulare:	Artet
Kurrikula lëndore:	Edukatë muzikore
Tema nga plani dymujor:	Ngjarjet artistike
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):	I. 3, 5, 8; II. 3, 7; III. 1, 2, 3, 6; V. 5; VI. 4, 5, 6
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):	Artet: 4 Gjuhët dhe komunikimi: 1. 3; 1. 4; 2. 7 Matematikë: 3. 3
Rezultati i të nxënit të temës:	Nxitet që të shpreh mendimin e vet për krijimet dhe për formimet vetjake dhe të bashkëmoshatarëve.
Rezultatet e të nxënit të aktiviteteve:	<ul style="list-style-type: none"> • Krijon kukullat prej letre për lojën "Kush do të jetë mësues/e sot". • Aktron në teatrin me kukulla rolin e zgjedhur. • Këndon këngën "Mësuesit".
Kriteret e suksesit:	<ul style="list-style-type: none"> • Krijon kukullat prej letre për lojën "Kush do të jetë mësues/e sot". • Aktro në teatrin me kukulla rolin e dhënë. • Këndo këngën "Mësuesit".
Burimet dhe materialet:	Foto/libër për shkollën e parë shqipe, qese letre, laps, ngjyra, gërshtë, ngjitës, copëza dekorative, instrumente të thjeshta për ndjekjen e ritmit të këngës.
Integrimi ndërfaqor:	Gjuhë shqipe, Matematikë.
Çështjet ndërkurrikulare:	Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.
Fjalë kyçe:	Mësues/e, mëson, edukon, jep njohuri, dashuri, kujdes, shfaqje me kukulla, aktrim, imagjinatë.
Organizimi i aktiviteteve:	<p>Pas përshëndetjeve dhe aktiviteteve të para ditore, në rreth zhvillohet loja "Kur isha një vjeç".</p> <p><i>Ecuria: Hapni bashkëbisedimin me fëmijët për gjërat që mund t'i bënin dhe ato që nuk mund t'i bënin kur ishin të vegjël; si kanë ndryshuar ata ndër vite dhe çfarë mund të bëjnë tani.</i></p> <p>Biseda do të përqendrohet te mosha gjashtë vjeç, duke i pyetur për përshtypjet që kanë për parashkollorin, si e imagjinojnë shkollën, si e presin këtë ndryshim, si ndihen që do të kenë mësues/e të ri/re etj.</p> <p>"Vitin që vjen ju mund të bëni edhe më shumë gjëra të reja, ndër to edhe të shkoni në shkollë dhe të takoni mësuesen/in tuaj. A më thotë dikush se si e imagjinoni një mësues/e?"</p>

Flisni për:

- shkollën e parë shqipe (siguroni fotografi ose libra);
- rolin e mësuesit/es;
- dashurinë dhe kujdesin që falin ata për fëmijët.

Kështu, edukatori/ja gradualisht njofton fëmijët për ditën e tyre të veçantë që kanë të gjithë edukatorët/mësimdhënësit në vendin tonë.

Fëmijët do të ndahen në grupe të vogla për lojëra dramatike.

Për shfaqjen me kukulla, fëmijët do t'i krijojnë vetë personazhet e shfaqjes dhe pastaj do të luajnë, duke krijuar një ngjarje imagjinare në shkollë, ku njëri do të luaj rolin e mësuesit/es ndërsa të tjerët, nxënësit. Shfaqjen e japin nga katër-pesë fëmijë, të cilët do të kenë një kohë të caktuar për të bashkëpunuar në krijimin e ngjarjes dhe vënien e titullit të shfaqjes. Secili nga grupet mendon një situatë në klasë dhe e aktrojnë para të tjerëve. Shfaqjet duhet të jenë të ndryshme dhe fëmijët nxiten të jenë sa më krijues e pa drojë. Në fund, të gjithë mblidhemi për t'i shpalosur idetë për shfaqjet e para; fëmijët i vetëvlerësojnë ato dhe edukatori/ja bën komente shtesë.

Materialet: Këndi i shfaqjes me kukulla, qese letre, lapsa ngjyra, gërshërë, fletë me ngjyra dhe copëza dekorative.

Fëmijët mund të krijojnë kukulla të ndryshme sipas imagjinatës së tyre thjesht duke vizatuar në fletë me ngjyra: sytë, hundë, gojën, të cilat i presin dhe i ngjisin në qesen prej letre, apo duke prerë fije të holla letre për flokët. Megjithatë, ju mund të printoni modelin e gatshëm te linku i mëposhtëm.

<https://www.yellowblissroad.com/free-printable-paper-bag-puppets>



(Personazhet mund të jenë edhe kafshë, fëmijët janë të lirë të imagjinojnë.) Kur të kenë përfunduar kukullat, fëmijët do t'i prezantojnë para grupit, duke treguar punën që kanë bërë dhe materialet që kanë përdorur; kjo do të shoqërohet me numërim të materialeve përkatëse. Ju mund t'i nxitni fëmijët që të prezantojnë punën e tyre dy nga dy dhe pas numërimit mund të bëjnë krahasimin e materialeve të përdorura: më shumë, më pak etj. Fëmijët këndojnë këngën për mësuesen. Edukatori/ja lexon një herë tekstin e këngës, që fëmijët të familjarizohen me të dhe të kuptojnë mesazhin që përcjell ajo, pastaj dëgjohet kënga me melodi dhe herën tjetër, fëmijët përpiqen të ndjekin ritmin e këngës me instrumentet e tyre ritmike të krijuara ditë më parë.



Në takimin e përbashkët bëjnë përmbledhje ditore dhe japin përshtypjet. Flasim për profesionin e mësuesit dhe rolin e tij në jetën tonë, përsërisim këngën dhe përgatim fëmijët që për ditën e edukatorit/es do të kemi aktivitete të veçanta me të cilat do të shënojmë këtë ditë.

Vlerësimi:

Vlerësohen fëmijët gjatë krijimit të shfaqjes së tyre teatrale me kukulla, puna e tyre organizative, ndërveprimi me grupin, fjalori i përdorur gjatë aktrimit dhe intonacioni. Ju vlerësoni edhe punën e bërë me krijimin e kukullave prej letre.

Më shumë për të bërë:

Në linkun e mëposhtëm, mund të gjeni ide për krijimin e instrumenteve muzikore të thjeshta.

<https://meaningfulmama.com/20-diy-musical-instruments.html>

Reflektimi:

Vajza që e donte fort shkollën

Fusha kurrikulare:

Shoqëria dhe mjedisi

Kurrikula lëndore:

Shoqëria dhe mjedisi

Tema nga plani dymujor:

Festat

Rezultatet e të nxëniet për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):

I. 3, 5, 8; **II.** 7; **III.** 7; **V.** 5; **VI.** 4, 5, 6

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):

Shoqëria dhe mjedisi: 3. 3. 1
Gjuhët dhe komunikimi: 1. 2; 1. 3
Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti: 2. 1

Rezultati i të nxëniet të temës:

Emërton disa festa familjare dhe shoqërore dhe në mënyrën e vet përshkruan organizimin dhe manifestimin e tyre.

Rezultatet e të nxëniet të aktiviteteve:

- Ritregon tregimin me fjalët e tij/saj.
- Pret copëzat e mozaikut për të formuar shkollën e parë shqipe.
- Ndjek udhëzimet përgjatë lojës "Rrugës për në shkollë".

Kriteret e suksesit:

- Ritrego tregimin me fjalët tua.
- Prit copëzat e mozaikut për të formuar shkollën e parë shqipe.
- Ndjek udhëzimet përgjatë lojës "Rrugës për në shkollë".

Burimet dhe materialet:

Historia e Shkollës së Vajzave, karrige, kona, litar, blloqe.


Integrimi ndërfaqor:

Gjuhë shqipe, Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti.

Çështjet ndërkurrikulare:	Edukimi për qytetari demokratike.
Fjalë kyçe:	Shkollë, shkollim, edukim, forcë, trimëri, femër e fortë.
Organizimi i aktiviteteve:	<p>Në takimin e përbashkët, pas plotësimit të kalendarit dhe një kënge mirëseardhjeje, lexoni historinë e shkollës së parë shqipe për vajza. Ju mund ta përshtatni historinë për fëmijët e grupmoshës 5-6 vjeçare, duke siguruar një version, ku përcillet koncepti i dashurisë për shkollën dhe vendosmërinë për t'ia dalë mbanë. Pas leximit, komentoni dhe analizoni tregimin, për të dëgjuar përshtypjet e fëmijëve.</p> <p>Flisni për:</p> <ul style="list-style-type: none"> • përpjekjen për shkollën shqipe; • si ka ndikuar hapja e shkollës jetën e shumë vajzave; • përse është e rëndësishme që fëmijët të shkojnë në shkollë; • se si femrat luajnë rol të rëndësishëm në shoqëri etj. <p>Fëmijët ndahen në qendrat e aktiviteteve:</p> <p>Njëri grup do të formojë mozaikun e shkollës së parë shqipe. (Edukatori/ja ka përgatitur fotografi të prera, të cilat formohen nga fëmijët.)</p> <p>Grupi tjetër do të vizatojë shkollën.</p> <p>Grupi i tretë luan lojën “Kush ku takon” (lojë e përgatitur nga edukatori/ja, fëmija bashkon ilustrimet fëmija-çanta, shkolla-fëmijët etj.).</p> <p>Grupit të fundit i ofrohet material për bashkimin e grafikut të numrit me sasinë (material i përgatitur nga edukatori/ja).</p> <p>Loja: “Rruga për në shkollë”</p> <p><i>Materialet:</i> karrige, kona, litar, blloqe.</p> <p><i>Ecuria:</i> Në ambientin e klasës krijoni një hapësirë me pengesa, duke improvizuar një shkollë në një kënd të klasës; fëmijët duhen të ndjekin udhëzimet e edukatorit/es për të kaluar përgjatë pengesave, si: shko rreth e rrotull konit, ec majtas karriges, ec nën litarin ndarës, hidhu mbi litar etj.</p> <p>Në takimin e përbashkët, mblidhemi për të diskutuar për aktivitetet e zhvilluara, bëhet një përsëritje dhe ritregim i shkurtër nga ana e fëmijëve për historinë e shkollës shqipe.</p>
Vlerësimi:	Fëmijët vëzhgohen gjatë ritregimit të historisë, në krijimin e mozaikëve me pjesë formuese dhe në aktivitetin fizik me lëvizje përgjatë pengesave.
Më shumë për të bërë:	Ju mund të paraqitni ndonjë dokumentar të shkurtër për shkollën shqipe. Inkurajoni prindërit të bisedojnë me fëmijët e tyre mbi mënyrën se si kanë qenë shkollat në të kaluarën. Po ashtu inkurajoni fëmijët të pyesin gjyshërit e tyre për vështirësitë që kishin ata për të shkuar në shkollë.
Reflektimi:	_____

7 Marsi – Dita e Mësuesit

Fusha kurrikulare:	Gjuhët dhe komunikimi
Kurrikula lëndore:	Gjuhë shqipe
Tema nga plani dymujor:	Tinguj, shkronja, rrokje, fjalë, fjali
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):	I. 3, 8; II. 7; III. 1, 2, 6; V. 5; VI. 4, 5, 6
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):	Gjuhët dhe komunikimi: 1. 1; 1. 2; 1. 4; 1. 7; 3. 2; 2. 8 Artet: 3 Matematikë: 6. 1
Rezultati i të nxënit të temës:	Lexojnë dhe interpretojnë ilustrime, fotografi, figura dhe objekte me fjalë e fjali të thjeshta.
Rezultatet e të nxënit të aktiviteve:	<ul style="list-style-type: none"> • Parafrazon, duke përshkruar fotografit e paraqitura. • Tregon emrin e shkollës së tij/saj. • Krijon veprën artistike, duke bashkëvepruar me grupin.
Kriteret e suksesit:	<ul style="list-style-type: none"> • Përshkruaj fotografitë e paraqitura. • Trego emrin e shkollës sate. • Krijoj veprën artistike, duke bashkëvepruar me grupin.
Burimet dhe materialet:	Projektor, laptop, <i>PowerPoint</i> , prezantim i përgatitur nga edukatori/ja, 4 fletë të mëdha të formatit A3, ngjites, ngjyra (uji, pasteli etj.) tasa plastikë me ujë, furça.
Integrimi ndërfaqor:	Edukatë figurative, Matematikë.
Çështjet ndërkurrikulare:	Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.
Fjalë kyçe:	Shkollë, mësimdhënës, ditë e shënuar, mirënjohës, pikturë.
Organizimi i aktiviteve:	Edukatori/ja së pari përshëndet, formon rrethin dhe fton fëmijët të luajnë lojën “Shkolla në të kundërt”. Fëmijët duhet të marrin rolin e edukatorit/es, ndërsa edukatori/ja rolin e fëmijës. Loja vazhdon për sa kohë që fëmijët kanë interes; pasi përfundojnë, ulen në formë rrethi. Edukatori/ja nxit bisedën me pyetje: “Pse duhet të shkojmë në shkollë? Çfarë mësojmë në shkollë? Çfarë ju pëlqen më shumë?”. Fëmijët shprehin mendimet e tyre. Edukatori/ja u shpjegon se shkolla është një institucion i veçantë, ku edukohen dhe mësohen fëmijët që të përgatiten për jetë. Edukatori/ja inkurajon fëmijët të tregojnë historitë që ata kanë dëgjuar nga gjyshërit/prindërit e tyre për shkollat në të kaluarën. U shpjegon se shumë kohë më parë njerëzit kanë mësuar nëpër shtëpi, pastaj janë hapur shkollat. Shkolla e parë shqipe është hapur në qytetin e Korçës, më 7 mars 1887, dhe që nga ajo ditë festohet si ditë kombëtare e mësuesit/es. Për këtë arsye, në shkolla organizohen festime. (Edukatori/ja mund të përgatitë me <i>PowerPoint</i> disa ilustrime, ku fëmijët do të shohin pamje të asaj kohe. Mund të flasin e të diskutojnë për to, të krahasojnë si



ka qenë dhe si janë sot shkollat, të përshkruajnë shkollën e tyre.)

Piktura jonë për edukatorin/en

Materialet: 4 fletë të mëdha të formatit A2, ngjites, ngjyra (uji, pasteli, etj.), tasa plastikë me ujë, furça.

Ecuria: Fletët e mëdha ngjitni me njëra-tjetrën dhe krijoni një formë të gjatë drejtkëndore, ndërsa në varësi të grupit, shtoni numrin e fletëve të ngjitura. Fëmijët do të punojnë si një grup i vetëm artistik, për të krijuar një punim për edukatorin/en në ditën e veçantë. Në të, fëmijët do të shprehin një mesazh falënderues.

Pas përfundimit të pikturës, fëmijët pastrojnë mjedisin përreth, duke sistemuar mjetet e përdorura dhe duke vënë rregull. Puna e sapokrijuar, diskutohet në grup. Fëmijët tregojnë me radhë pjesën që kanë punuar, çfarë shprehin ngjyrat që kanë përdorur, sa ngjyra kanë përdorur, si e kanë bërë matjen e hapësirës punuese në veprën e përbashkët etj.

Në takimin në fund të ditës, do të bëhet një përsëritje e temës ditore, ku fëmijët ritregojnë pjesë nga puna për krijimin e veprës së përbashkët artistike kushtuar edukatorit/es; si e krijuan, mesazhin që përcjell, si punuan me shokët/shoqet për ta realizuar, a patën vështirësi etj. Këndohet një këngë për mësuesin/en dhe fëmijët përshëndeten për t'u larguar.

Vlerësimi:

Fëmijët vëzhgohen gjatë pjesëmarrjes aktive në diskutimin për rëndësinë e shkollës. Vlerësohet puna e përbashkët artistike, loja me ngjyra, përcaktimi i hapësirës punuese brenda veprës dhe ndërveprimi me të tjerët. Edukatori/ja mban shënime anekdotike gjatë ditës në varësi të situatave të krijuara.

Më shumë për të bërë:

Mund të kërkoni për teknika të tjera artistike për punë në grup në linkun e mëposhtëm.

<http://dripdripsplattersplash.blogspot.com/2014/04/collaborative-watercolor-painting.html>

Reflektimi:

Gratë që ndryshuan historinë

Fusha kurrikulare:	Matematikë
Kurrikula lëndore:	Matematikë
Tema nga plani dymujor:	Numrat natyrorë
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):	I. 3, 5; II. 1, 3, 4, 7; III. 1, 2, 6; IV. 5; V. 5; VI. 4, 6
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):	Matematikë: 5. 1 Gjuhët dhe komunikimi: 1. 1; 1. 2 Shkencat e natyrës: 1 Jeta dhe puna: 2. 8. 1
Rezultati i të nxënit të temës:	Krahason numrat deri në 10, bazuar në dy grupe objektesh, si dhe përdor shprehjet: më shumë/më pak, më i madh/më i vogël, po aq sa.
Rezultatet e të nxënit të aktiviteteve:	<ul style="list-style-type: none"> • Ritregon historitë e grave që bënë ndryshime në shoqëri. • Plotëson fletëzën e punës për numrin "8". • Sheh procesin kromotografik të filtri të kafesë.
Kriteret e suksesit:	<ul style="list-style-type: none"> • Ritrego historitë e grave që sollën ndryshime. • Plotëso fletëzën e punës për numrin "8". • Shih procesin kromotografik të filtri të kafesë.
Burimet dhe materialet:	Poster/fotografi, filtër kafeje apo letra për pjekjen e ëmbëlsirave, ngjyra që pastrohen lehtësisht, pipëza, ngjitës, enë me ujë.
Integrimi ndërfaqor:	Gjuhë shqipe, Njeriu dhe natyra, Shkathtësi për jetë.
Çështjet ndërkurrikulare:	Zhvillim i qëndrueshëm.
Fjalë kyçe:	8 Marsi, ditë ndërkombëtare, grua, guxim, forcë, numri "8", kromotografi, thithje, ngjyrë.
Organizimi i aktiviteteve:	Në takimin e përbashkët, fëmijët do të luajnë me pjesëzat formuese, pas së cilave fshihet fotografia që na shpie te tema ditore. <i>Materialet: një poster me fotografi të grave që kanë lënë gjurmë në histori, si: (Mund të kërkoni dhe përshtatni për moshën e fëmijëve të tjera personalitete femra të cilat kanë lënë gjurmë në zhvillimin tonë, Ju mund të gjeni të dhëna në librin "Vepra e saj, 100 gratë pioniere të Kosovës", autore Alketa Xhafa Mripa.)</i>



MOTRAT QIRIAZI

Prisni posterin në aq copëza sa ka fëmijë në grupin tuaj, që secili të ketë një copëz. Pjesëzat futini në një kuti dhe vendoseni në mes të rrethit. Secili fëmijë do të marrë nga një copëz dhe e vendos në mes të rrethit, ku, duke i bashkuar, zbulohet portreti për të cilin do të bashkëbisedohet sot.

Bëhet fjalë për portrete të disa grave, të cilat kanë bërë ndryshime dhe kanë lënë gjurmë të rëndësishme e domethënëse, duke ndihmuar për mirë brezat e ardhshëm. Bëni nga një shpjegim të thjeshtë për secilën. Pas diskutimit të jetës dhe të veprimtarisë së këtyre grave, fëmijëve u tregohet se 8 Marsi është Dita Ndërkombëtare e Gruas dhe lidhet me guximin, lirinë dhe forcën e gruas. Fëmijët shprehin nga një

koment për ndonjë grua të fortë në jetën e tyre, si për shembull: nëna, gjyshja, motra, tetoja, shoqja etj.

Pas diskutimit, edukatori/ja fton fëmijët për plotësimin e kalendarit ditor, dhe gradualisht me fëmijët zbulojnë se dita e sotme është dita për të cilën po flasim, data 8. Edukatori/ja nxit fëmijët të flasim rreth grafikut të numrit tetë, të numërojnë deri në tetë dhe të përshkruajnë me gisht në ajër grafikun e numrit 8. Fëmijët plotësojnë fletën e punës me numrin 8 te libri i fëmijës. Pas përfundimit të punës, fëmijët do të realizojnë një eksperiment e do të krijojnë nga një lule për t'ia dhuruar nënës, gjyshes apo ndonjë gruaje që duan shumë.

Materialet: filtër kafeje apo letër për pjekje ëmbëlsirash, ngjyra që lahen, pipëza për lëngje, ngjitës, enë të vogla me ujë.

Ecuria:

Fëmijët vizatojnë rrahë në mënyrë të çrregullt me ngjyra të ndryshme në filtrat e kafesë apo letrat për pjekjen e ëmbëlsirave e më pas i lagin me ujë dhe shohin reaksionin kromotografik. Proces ky të cilin fëmijët do ta mësojnë nëpërmjet punës kreative. Fletët do të thithin lagështinë e kështu do të fillojë të jetë i qartë procesi i shkrirjes së bojërave në letër. Nga ky proces, fëmijët përfitojnë fletë shumëngjyrëshe, të cilat, pas tharjes, do t'i kapin në mes, duke e bërë një lidhje me një pipëz. Do të formohet kështu lulja që do ta marrin me vete në shtëpi.

Në takimin e përbashkët ritregohen ngjarje për gratë të cilat kanë bërë ndryshime në botë. Diskutohet edhe për gratë e dashura në jetën tonë, bashkëbisedojnë për lulet e krijuara dhe bëhet përshëndetja për t'u larguar në shtëpi.

Vlerësimi:

Edukatori/ja mban shënime të vazhdueshme bazuar në planin e vlerësimit.

Më shumë për të bërë:

Mund të përdorni edhe mënyra të tjera për të ndërtuar lulet, duke vënë në zbatim aftësitë dhe njohuritë e fëmijëve. Pra, mund të krijohen lule me numrat që dinë fëmijët, një lule me tetë petale, ose një lule me tri ngjyra që i pëlqejnë. (Ju mund të përzgjidhni edhe personalitete të grave të tjera, duke bërë një gërshetim të ndryshimeve në botë dhe ndryshimeve në vendin tonë.)

Reflektimi:

Çfarë do të thotë të votosh?

Fusha kurrikulare:	Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti
Kurrikula lëndore:	Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti
Tema nga plani dymujor:	Lojërat dhe pushimi
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):	I. 3; II. 1, 4, 7; III. 1, 2; IV. 2. ; V. 2, 5; VI. 3, 4, 6
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):	Edukimi fizik, sportet dhe shëndeti: 2. 2 Gjuhët dhe komunikimi: 1. 1; 1. 4 Matematikë: 2. 1
Rezultati i të nxënit të temës:	Praktikon lojëra dhe aktivitete fizike në bashkëveprim, në çift dhe grupe.
Rezultatet e të nxënit të aktiviteteve:	<ul style="list-style-type: none"> • Ndërton një shkollë me blloqe. • Voton frutën e parapëlqyer. • Numëron frutat më të votuara, duke krahasuar: më shumë/më pak.
Kriteret e suksesit:	<ul style="list-style-type: none"> • Ndërto një shkollë me blloqe. • Voto për frutën e parapëlqyer. • Numëro frutat më të votuara, duke krahasuar: më shumë/më pak.
Burimet dhe materialet:	Blloqe, portokall, mollë, banane, dardhë, pjeshkë, blloqe të vogla (një për secilin fëmijë), tabelë e bardhë, marker, projektor, laptop.
Integrimi ndërfaqshor:	Gjuhë shqipe, matematikë.
Çështjet ndërkurrikulare:	Globalizimi dhe ndërvarësia.
Fjalë kyçe:	Ndërto, votë, votim, përzgjedhje, numëro, fruta.
Organizimi i aktiviteteve:	<p>Në takimin e përbashkët, pas plotësimit të kalendarit, edukatori/ja nxit fëmijët të bashkëbisedojnë për faktet dhe të dhënat e mësuara gjatë javës për 7-8 Marsin. Diskutoni për:</p> <ul style="list-style-type: none"> • shkollën e parë shqipe; • rolin e mësuesit/es; • gratë që ndryshuan botën; • ditën ndërkombëtare të gruas. <p><i>Materialet:</i> blloqe ndërtimi.</p> <p><i>Ecuria:</i> Fëmijët ndahen në grupe dhe secili grup do të bëjë një plan paraprak për ndërtimin e shkollës së vet. Nxiten për punë në grup dhe ndërveprim. Numërojnë blloqet që u nevojiten, i grupojnë dhe secili grup punon shkollën e tij.</p> <p>Pasi fëmijët të kenë përfunduar shkollat me blloqe, ata do të tregojnë për mënyrën e realizimit, përzgjedhjen dhe kombinimin e materialeve të tjera me blloqet etj.</p>

Edukatori/ja përgëzon grupet për punën e bërë dhe e dokumenton atë përmes fotografisë. Më pas kërkon nga fëmijët që secili prej tyre të marrë nga një bllok dhe të përgatitet për një lojë të përbashkët në rreth.

Loja "Hidh votën!"

Materialet: Blloqe, portokall, mollë, banane, dardhë, pjeshkë, blloqe të vogla (një për secilin fëmijë), tabelë e bardhë, marker.

Ecuria:

- Secili fëmijë ka nga një bllok. Tregojuni pesë zgjedhjet e frutave dhe flisni rreth procesit të votimit dhe të hedhjes së votës në kuti.
- Lejoni secilin fëmijë të vendosë bllokun e vet pas frutës së preferuar.
- Numëroni votat, duke parë se cila frutë ka marrë më shumë vota.
- Shënoni rezultatet në tabelë.

Pasi të keni marrë rezultatet përfundimtare, shpjegohet rëndësia e procesit të votimit, se si ky proces ndikon në respektimin e të drejtave të njeriut. Nga ky aktivitet, fëmijët njihen me konceptin bazik të procesit të votimit dhe i përforcojnë aftësitë e tyre matematikore, siç është numërimi. Pas përfundimit të votimit, fëmijët së pari do të hanë frutën më të votuar, e më pas të gjitha frutat e tjera. Vendosni në projektor video nga linku më poshtë; fëmijët do të imitojnë lëvizjet ritmike që paraqiten. <https://www.youtube.com/watch?v=14SABodqXC8>

Në takimin e përbashkët mblidhemi për të bërë një përsëritje të aktiviteteve të ditës, ku fëmijët diskutojnë punën e bërë për ndërtimin e shkollave të tyre me blloqe, flasin për punën në grup, ndërveprimin me njëri-tjetrin etj. Përsëritet procesi i votimit në grup.

Vlerësimi: Fëmijët vëzhgohen gjatë ndërtimit të shkollave me blloqe dhe gjatë aktivitetit për votimin e frutit më të pëlqyer.

Më shumë për të bërë: Për lojëra edukative, mund t'i referoheni linkut të mëposhtëm.

Reflektimi: <https://toytheater.com/category/>

Çanta e mirësisë

Fusha kurrikulare:	Gjuhët dhe komunikimi
Kurrikula lëndore:	Gjuha shqipe
Tema nga plani dymujor:	Tinguj, shkronja, rrokje, fjalë fjali
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):	I. 3, 5; II. 1, 7; III. 1, 2, 3, 6; IV. 3, 4; V. 2, 5; VI. 1, 2, 4, 5, 6
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):	Gjuhët dhe komunikimi: 1. 1; 1. 4; 1. 5; 1. 6 Matematikë: 1. 2 Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti: 1
Rezultati i të nxënit të temës:	Shkëmbejmë ide me të tjerë për gjëra të ndryshme që u interesojnë, si: fotografi, ilustrime, figura, lodra.
Rezultatet e të nxënit të aktiviteteve:	<ul style="list-style-type: none"> • Përshkruan fotografinë që ka tërhequr nga "Çanta e mirësisë". • Luan rolin sipas përzgjedhjes në "Çantën e mirësisë".
Kriteret e suksesit:	<ul style="list-style-type: none"> • Përshkruaj fotografinë që ke tërhequr nga "Çanta e mirësisë". • Luaj rolin sipas përzgjedhjes në "Çantën e mirësisë".
Burimet dhe materialet:	Fotografi ilustruese të ndryshme, të cilat shprehin akte mirësie, libri i fëmijës, mjete e materiale për dramatizim, shirit ngjitës, çantë. Fotografi ilustruese të ndryshme, të cilat shprehin akte mirësie, libri i fëmijës, mjete e materiale për dramatizim, shirit ngjitës, çantë.
Integrimi ndërfushor:	Matematikë, Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti.
Çështjet ndërkurrikulare:	Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.
Fjalë kyçe:	Çantë, magjike, tingulli "Ç", paraqitja grafike e shkronjës "Ç", akt mirësie, dhurimi i lodrave, dhurimi i robave, më fal, faleminderit, të lutem, buzëqeshja, përçafimi, sjellja e mirë me të tjerët, ndihma e dhënë të tjerëve.
Organizimi i aktiviteteve:	Në takimin e përbashkët, pas përshëndetjes dhe plotësimit të kalendarit, diskutimit për motin dhe rikujtimit të aktiviteteve të bëra nga java e kaluar, edukatori/ja fton fëmijët të marrin pjesë në lojën "Kalo vijën". <i>Ecuria e lojës:</i> <i>Edukatori/ja vizaton në dysHEME një vijë me shirit ngjitës dhe të gjithë fëmijët, së bashku me edukatorin/en, qëndrojnë në njërin anë të vijës. Në varësi të temës, edukatori/ja jep udhëzimet (në këtë rast):</i> <ul style="list-style-type: none"> - Të kalojnë vijën fëmijët që sot, kur erdhën në klasë, përshëndetën njëri-tjetrin (fëmijët kalojnë në anën tjetër të vijës). - Të kalojnë vijën fëmijët që kanë rregulluar robat e tyre te gardëroba (disa kalojnë, disa mund të mbesin). - Të kalojnë vijën fëmijët që përdorin shprehjen "Më fal" kur lëndojnë tjetrin. - Kur ndihmojnë të tjerët. - Kur thonë faleminderit...

Vazhdohet kështu derisa fëmijët të jenë përfshirë thuajse në të gjitha çështjet që do të hapen për diskutim. Në përfundim të lojës, edukatori/ja u zgjat fëmijëve një çantë dhe u kërkon që në mënyrë rastësore të tërheqin një fletëz. Siç janë të vendosur në rreth, çdo fëmijë do të përshkruajë atë që sheh në fletëzën e tërhequr: flitet për akte mirësie, dhurim lodrash, fjalët magjike: “më fal, faleminderit, të lutem”, buzëqeshja, përqaqimi, sjellja e mirë me të tjerët, ndihma dhënë të tjerëve. Prej këtu, fëmijët nxiten të ndahen në grupe, të bashkojnë fletëzat që kanë në dorë dhe ndërtojnë një situatë për dramatizim. Pasi të përfundojnë lojën me situatën e hamendësuar, edukatori/ja fton fëmijët për një bisedë të përbashkët. Fletëzat kthehen sërish te “Çanta e mirësisë”. Edukatori/ja pyet fëmijët se me çfarë tingulli fillon fjala “çantë”.

Gradualisht fëmijët njihen me tingullin “Ç”. Edukatori/ja kërkon nga fëmijët të shkruajnë në kurrizin e shokut/shoqes me gisht shkronjën “Ç”, të gjejnë fjalë me këtë shkronjë, kurse fjalët e përmendura do të ndahen në rrokje.

Fëmijët ndahen në grupe: Njëri grup do të ndërtojë histori me fletëzat nga çanta e mirësisë. Një tjetër grup do të plotësojë fletëzën e punës. Një tjetër grupi, edukatori/ja i jep një lojë matematikore dhe te grupi i fundit, përmes petëzave, fëmijët do të ndërtojnë objekte të ndryshme (vendet ndryshohen pas përfundit të aktivitetit të përzgjedhur, në mënyrë që çdo fëmijë të marrë pjesë në të gjitha aktivitetet ditore).

Në takimin përmbyllës do të flasim për ditën që sapo kaloi e çfarë u pëlqeu më shumë, rikujtohet se si shkruhet grafikisht shkronja “Ç”, e të sillen sërish ndër mend veprimet e mira, mirësjellja e rëndësia e bamirësisë për çdo ditë.

Vlerësimi:

Edukatori/ja observon fëmijët gjatë lojërave dramatike dhe regjistron sekuenca të caktuara, të cilat mund të përdoren për qëllime vlerësimi ose të ndarjes së informacionit me prindërit.


Më shumë për të bërë:

Mund të kërkonit nga prindërit që të bisedojnë me fëmijët për rëndësinë e sjelljes së mirë, jo vetëm për fëmijën, por edhe për familjen e shoqërinë. Kërkonit nga prindërit t’u lexojnë fëmijëve tregime dhe përralla që flasin për mirësinë, dashurinë, vullnetarizmin dhe ndihmën për të tjerët. Mund të organizoni një veprim bamirësie, që ka për qëllim të angazhojë fëmijët në punë vullnetare dhe t’i bëjë të ndërgjegjshëm për kontributin që mund të japin në shoqëri.

Reflektimi:

Gjyshërit e mi janë të veçantë

Fusha kurrikulare:	Artet
Kurrikula lëndore:	Edukatë figurative
Tema nga plani dymujor:	Krijimet figurative
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):	I. 3, 5; II. 1, 7; III. 1, 2, 3, 6; IV. 3, 4; V. 1, 2, 4, 5; VI. 1, 5, 6
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):	Artet: 1 Gjuhët dhe komunikimi: 1. 2; 1. 4 Matematikë: 2. 1
Rezultati i të nxënit të temës:	Me materiale të ndryshme krijojnë dhe riciklojnë sipas fantazisë dhe imagjinatës, vizatojnë, ngjyrosin, modelojnë, shtypin, për tema të ndryshme që trajtohen në shkollë dhe jashtë saj, duke përdorur: format me ngjyra, pemët, lodrat, tema të lira ku shprehet imagjinata dhe kreativiteti i tyre individual.
Rezultatet e të nxënit të aktiviteteve:	<ul style="list-style-type: none"> • Krahason historinë e librit me gjërat që ata bëjnë me gjyshin/gjyshen. • Ndërton kartolinën e veçantë për gjyshin/gjyshen.
Kriteret e suksesit:	<ul style="list-style-type: none"> • Krahaso historinë e librit me gjërat që bëni me gjyshin/gjyshen tuaj. • Ndërto kartolinën e veçantë për gjyshin/gjyshen.
Burimet dhe materialet:	Libri "Gjyshërit e mi janë të veçantë" ose libër tjetër që flet për marrëdhëniet mes gjyshërve me nipërit dhe mbesat e tyre (në mungesë të librit, mund të ndërtoni edhe vetë një histori), fotografi të formatit A4, të cilat paraqesin ngjarje nga jeta, duke e vënë theksin te ndërveprimi mes gjyshërve dhe fëmijëve, letër e bardhë, letra me ngjyra, ngjyra, gërvshërë, materiale me zgjedhje të fëmijëve (shirita zbukurues, xixa, letër me ngjithës etj.).
Integrimi ndërfaqshor:	Gjuhë shqipe, Matematikë.
Çështjet ndërkurrikulare:	Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.
Fjalë kyçe:	Gjysh, gjyshe, stërgjyshe, stërgjysh, argëtim, ndihmë, mirëkuptim.
Organizimi i aktiviteteve:	<p>Dita fillon me përshëndetjen mirëseardhëse, leximin e kalendarit të motit, pasi edukatori/ja pyet fëmijët se si janë; ai/ajo fton fëmijët në lojën "Cila fotografi është zhdukur?".</p> <p>Ecuria e lojës: Edukatori/ja prezanton 4-5 fotografi (në varësi të grupit të fëmijëve) ku diskutohet përmbajta e secilës. Fotografitë vendosen në tabelë ose në mes të rrethit, më pas edukatori/ja udhëzon fëmijët të mbyllin sytë. Edukatori/ja heq ose kthen në anën e kundërt një fotografi dhe udhëzon fëmijët të hapin sytë. Fëmijët do të zbulojnë se cila fotografi është hequr ose është e mbuluar, duke e përshkruar. Kjo lojë përsëritet derisa të përfundojnë fotografitë e vëna përpara fëmijëve. Më pas, edukatori/ja lexon për fëmijët librin "Gjyshërit e mi janë të veçantë".</p>



Pas leximit të librit, i cili mund të lexohet i plotë ose me ndalesa, diskutohet mbi historinë e treguar dhe raportet që kanë ata me gjyshërit dhe gjyshet, aktivitetet dhe gjërat që bëjnë së bashku; si sillen dhe çfarë i bënë të veçantë, çfarë aktivitete bëjnë dhe çfarë gjërash mësojnë nga ata dhe si i ndihmojnë gjyshet dhe gjyshërit kur kanë nevojë. Më pas, fëmijët do të ndërtojnë kartolinat e veçanta për gjyshin/gjyshen dhe t'ua dhurojnë atyre, për të shprehur mirënjohjen dhe dashurinë ndaj tyre. Fëmijët janë të lirë në përzgjedhjen e materialeve dhe mënyrën e paraqitjes së kartolinës.

Pas përfundimit të kartolinës, fëmijët pastrojnë hapësirën e punës dhe më pas mund të shkojnë përmes zgjedhjes së lirë në ndonjërin nga këndet e aktiviteteve. Këndi i qetë, për të "lexuar"/shfletuar ndonjë libër, të shkojnë te këndi i lojërave dramatike ku fëmijët në grup mund të luajnë me role, të shkojnë te këndi i kuzhinës të përgatisin ushqimin e preferuar që gjyshi/ja iu përgatit, te këndi i matematikës ofrohen lojëra për zhvillimin e memories, ku fëmijët do të luajnë në grup.

Në takimin përmbyllës, fëmijët do t'i tregojnë njëri-tjetrit kartolinat e punuara dhe do të tregojnë se çfarë kanë paraqitur. Edukatori/ja nxit fëmijët të mendojnë dhe të bëjnë një planifikim se si mund të ndihmojnë gjyshërit dhe gjyshet e tyre kur janë me ta në shtëpi. Edukatori/ja mban shënim për mënyrat sesi fëmijët do të ndihmojnë gjyshërit e tyre. Atë fletë, edukatori/ja e vendos në një kënd të dukshëm, në mënyrë që në ditët në vazhdim të plotësohet me të dhënat nga fëmijët.

Vlerësimi:

Edukatori/ja mban të dhëna përshkruese për komentet që japin fëmijët dhe i vëzhgon ata gjatë kohës së aktivitetit për shkathtësitë në manipulimin me materiale.

Më shumë për të bërë:

Kërko nga prindërit që të lejojnë fëmijët e tyre të marrin përgjegjësi dhe t'i nxisnin ata që të ofrojnë ndihmën e tyre në situata të ndryshme, të cilat mund të jenë në familje e më gjerë.

Reflektimi:

Duart tona ndryshojnë botën!

Fusha kurrikulare:	Shkenca dhe natyra
Kurrikula lëndore:	Njeriu dhe natyra
Tema nga plani dymujor:	Bimët, kafshët dhe njeriu
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):	I. 3, 5; II. 1, 7; III. 1, 2, 3, 6; IV. 4; V. 2, 5; VI. 1, 4, 5, 6
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):	Shkenca dhe natyra: 1 Gjuhët dhe komunikimi: 1. 1; 3. 2 Matematikë: 6. 2
Rezultati i të nxënit të temës:	Tregon nevojat themelore jetësore të njeriut (strehim, ushqim, ujë, ajër dhe dritë).
Rezultatet e të nxënit të aktiviteteve:	<ul style="list-style-type: none"> • Bën pyetje mbi veprimtarinë humanitare të Nënë Terezës. • Bashkëvepron me shokët/shoqet për riorganizimin e lodrave në vendin e tyre. • Klasifikon lodrat së bashku, duke ndarë ato që do të dhurohen për bamirësi.
Kriteret e suksesit:	<ul style="list-style-type: none"> • Bëj pyetje mbi veprimtarinë humanitare të Nënë Terezës. • Bashkëvepro me shokët/shoqet për riorganizimin e lodrave në vendet e tyre. • Klasifiko lodrat së bashku, duke ndarë ato që do të dhurohen për bamirësi.
Burimet dhe materialet:	Lodrat që janë në institucion, librat i fëmijës, mjetet ndihmëse, çanta me fotografi që tregojnë situata, persona, organizata që ndihmojnë njerëzit në vështirësi.
Integrimi ndërfaqor:	Gjuhë shqipe, matematikë.
Çështjet ndërkurrikulare:	Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.
Fjalë kyçe:	Lodra, shkëmbim, vullnetar, lloj, lule, ambient, tingulli "V" grafiku i shkronjës "V".
Organizimi i aktiviteteve:	<p>Dita fillon me përshëndetje të ngrohtë dhe plot mirësjellje. Pas përfundimit të kalendarit dhe motit, edukatori/ja sjell përpara fëmijëve "Çantën e mirësisë", por përpara se ta hapë, pyet fëmijët nëse kanë patur rast të bëjnë ndonjë veprim mirësie, të ndihmojnë të tjerët apo t'i mbështesin.</p> <p>Edukatori/ja u kërkon fëmijëve të tërheqin një fotografi nga "Çanta e mirësisë", duke i pyetur rreth fotografive. Në mesin e fotografive, edukatori/ja ka vënë portretin e Nënë Terezës.</p> <p>Kështu theksohet puna e saj në ndihmë të të varfërve. Përmendet origjina shqiptare. U shpjegohet fëmijëve rëndësia e bamirësisë dhe akteve të mira e punës vullnetare në shoqëri. U shpjegon për Kryqin e Kuq të Kosovës, fton fëmijët që të shprehin mendimet e tyre rreth</p>

ndihmës konkrete që kanë dëshirë të japin për njerëzit në vështirësi. Fëmijëve duhet t'u shpjegohet dhe fjala dhe koncepti "vullnetar/vullnetarizëm". Nga fotografitë e çantës është edhe grafiku i shkronjës "V" dhe fotografi të tjera të cilat ndërlidhen me shkronjën "V". Kjo e ndihmon edukatorin/en që nga vullnetarizmi të kalojë në grafikun e shkronjës "V".



Vlerësimi:

Dita vazhdon në punën me grupe të vogla:

- Njëri grup plotëson fletëzën e shkronjës "V".
- Grupi tjetër pret dhe ngjit për të krijuar fotografinë e Nënës Terezës në librin e fëmijës.
- Një tjetër grup do të luajë lojëra për memorie, të përgatitura nga edukatori/ja me simbolet nga "Çanta e mirësisë".

Në takimin përmbyllës, fëmijët do të diskutojnë dhe vendosin cilat lodra do t'i dhurojnë për fëmijët në nevojë.

Fëmijët do të vëzhgohen për mënyrën e bashkëveprimit me të tjerët, aktivitetin grupor dhe të shprehurit. Merren parasysh edhe idetë e tyre për veprime bamirësie.

Më shumë për të bërë:

Edukatori/ja fton prindërit në takim (paraprakisht, së bashku me bordin e prindërve ka bërë një projekt "Duart tona ndryshojnë botën!" për të bërë ëmbëlsira, ushqime të ndryshme tradicionale në shtëpi, të cilat do të shiten brenda institucionit dhe me to do të blihen gjëra që do t'i dërgohen Kryqit të Kuq apo në ndonjë familjeje në nevojë).

Reflektimi:

Ëmbëlsi për bamirësi

Fusha kurrikulare: Jeta dhe puna

Kurrikula lëndore: Shkathtësi për jetë

Tema nga plani dymujor: Planifikimi i buxhetit familjar

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): **I.** 3; **II.** 1; **III.** 4; **IV.** 4; **V.** 2, 5; **VI.** 1, 2, 4, 5, 6

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): Jeta dhe puna: 5.5.1
Gjuhët dhe komunikimi: 1.4; 1.6
Matematikë: 1.2
Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti: 3.1

Rezultati i të nxënit të temës: Nxit shitjen e sendeve, duke krijuar tregun dhe duke luajtur rolin e shitësit dhe blerësit.

Rezultatet e të nxënit të aktiviteteve:	<ul style="list-style-type: none"> • Klasifikon ushqimet sipas llojit. • Llogarit, duke mbledhur produktet gjatë kryerjes së shërbimit të shitjes. • Kryen veprime të shitjes së ushqimeve.
Kriteret e suksesit:	<ul style="list-style-type: none"> • Klasifiko ushqimet sipas llojit. • Llogarit, duke mbledhur produktet gjatë kryerjes së shërbimit të shitjes. • Kryej shitjen e ushqimeve.
Burimet dhe materialet:	Tavolina, mbulesa, produktet ushqimore; (ëmbëlsira, ushqime të ndryshme - sjellë nga prindërit), enë letre, doreza, arka kursimi.
Integrimi ndërfaqor:	Gjuhë shqipe, matematikë, edukatë fizike, sportet dhe shëndeti.
Çështjet ndërkurrikulare:	Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.
Fjalë kyçe:	Ëmbëlsira, sa kushton, shitje, blerje, dhuratë, bamirësi.
Organizimi i aktiviteteve:	<p>Takimi i përbashkët fillon me përshëndetjet dhe prezantimin e prindërve që kanë ardhur vullnetarisht. Edukatori/ja së bashku me fëmijët dhe disa nga prindërit vullnetarë do të rregullojnë tavolinat në korridorin e shkollës/institucionit parashkollor; fëmijët do të jenë aktivë gjatë gjithë procesit të rregullimit të mjedisit dhe shitjes së ushqimeve. Tavolinat duhen të jenë të mbuluara, të ketë pjata dhe peceta letre, pirunë, dorëza kur u shërbejnë të tjerëve. Ëmbëlsirat, ushqimet tradicionale, frutat të blihen nga të gjithë ata që janë në mjedisin e shkollës. Fëmijët do të marrin pjesë në gjithë procesin e shitjes dhe të mbledhjes së të hollave në udhëzimet e edukatorit/es dhe të prindërve vullnetarë. Të gjithë edukatorët/et e shkollës së bashku me klasat e tyre do të vijnë në mënyrë të organizuar për të blerë ëmbëlsirat. Secili është i lirë të paguajë aq sa ka mundësi. Po ashtu, ftohen edhe prindërit e tjerë të marrin pjesë (gjyshërit, gjyshet, anëtarët e tjerë të familjes, në mënyrë që fëmijët të kenë mundësi të shfaqin përpara të tjerëve punën e mirë që janë duke bërë).</p> <p>Pas përfundimit të aktivitetit, të gjithë merren me pastrimin e tavolinave, sistemimin e ushqimeve që nuk janë shitur, që do t'u shërbehen fëmijëve të grupeve/klasave të tjera (ose do të dhurohen).</p> <p>Fëmijët kthehen në klasë për të planifikuar gjërat që do të blihen dhe vizitën e ditës së nesërme. Fëmijët japin idetë e tyre, bëhet një listë me materialet që konsiderohen të domosdoshme. Lodrat, veshmbathjet e sjella nga fëmijët bëhen gati dhe lihen të gatshme për nesër.</p>
Vlerësimi:	Edukatori/ja vëzhgon punën e fëmijëve dhe aftësitë e tyre në zgjidhjen e problemave.
Më shumë për të bërë:	Mënyra më e mirë do të ishte që blerja të bëhej nga vetë fëmijët, sipas listës së përcaktuar të gjërave që ata kanë planifikuar. Kjo formë e blerjes do të ishte më e mira nëse edukatori/ja do të kishte mundësi praktike për ta realizuar. Një mundësi tjetër është që të hollat e mbledhura të menaxhohen nga bordi i prindërve, të cilët në bashkëpunim me edukatorin/en do të bëjnë blerjet.
Reflektimi:	_____

Vullnetarët e vegjël

Fusha kurrikulare:	Shoqëria dhe mjedisi
Kurrikula lëndore:	Shoqëria dhe mjedisi
Tema nga plani dymujor:	Unë dhe të tjerët
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):	I. 3, 5, 8; II. 1, 3; III. 2, 3, 7; IV. 2, 3; V. 2, 3; VI. 1, 2, 4, 6
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):	Shoqëria dhe mjedisi: 1.1.1 Gjuhët dhe komunikimi: 1.1; 1.6; 2. 8 Artet: 1
Rezultati i të nxënit të temës:	Identifikon njerëzit që kanë nevojë për ndihmë dhe tregon gatishmëri për t'i ndihmuar.
Rezultatet e të nxënit të aktiviteteve:	<ul style="list-style-type: none"> • Merr pjesë aktive gjatë procesit të dërgimit të pakove. • Bën pyetje për aktivitetin e Kryqit të Kuq.
Kriteret e suksesit:	<ul style="list-style-type: none"> • Përfshihet aktivisht gjatë procesit të dërgimit të pakove. • Bën pyetje për aktivitetin në Kryqin e Kuq.
Burimet dhe materialet:	Pako të vogla me ushqime, pako me lodra, pako me veshmbathje, uniforma, kapelë apo simbolet identifikuese për daljen e fëmijëve jashtë institucionit.
Integrimi ndërfaqor:	Gjuhë shqipe, Edukatë muzikore.
Çështjet ndërkurrikulare:	Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.
Fjalë kyçe:	Kryq i Kuq, punë vullnetare, vullnetarizëm, familje në nevojë, ndihmë, shpresë, bamirësi.
Organizimi i aktiviteteve:	<p>Dita fillon me përshëndetje me fëmijët dhe prindërit, që do t'ju shoqërojnë te ndërtesa e Kryqit të Kuq. Fëmijët, së bashku me edukatorin/en, bëjnë përgatitjet për të shkuar aty: veshja e uniformave, kapelat apo simbolet identifikuese që përdoren kur fëmijët dalin jashtë institucionit. Edukatori/ja me fëmijët dhe disa nga prindërit vullnetarë shkojnë në mënyrë të organizuar. Institucioni ku fëmijët dërgohen, është informuar paraprakisht dhe janë bërë përgatitjet për pritjen e tyre.</p> <p>Fëmijët marrin me vete pakot e përgatitura; kur shkojnë në institucion, priten nga personat përgjegjës dhe u tregojnë rëndësinë e të qenit solidarë me njëri-tjetrin.</p> <p>Bisedohet për vullnetarizmin dhe rëndësinë e tij dhe po ashtu kërkohet nga fëmijët të bëjnë pyetje për gjërat që u ngjallin kuriozitet.</p> <p>Sipas mundësive, mund të ofrohet ndonjë sesion i shkurtër informues në formë video nga vullnetarët e Kryqit të Kuq, që i përgjigjet moshës së fëmijëve. Pas kësaj, fëmijët kthehen në institucionin parashkollor. Edukatori/ja ka përgatitur me material prej letre nga një medalje për</p>

secilin fëmijë, si shpërblim për ndihmën që ata kanë dhënë dhe punën vullnetare që kanë realizuar. Gjatë rrugës, fëmijët mund të këndojnë këngë të ndryshme.

Vlerësimi:

Edukatori/ja dokumenton përmes videove/fotografive aktivitetin e fëmijëve sot. Këto video mund të shërbejnë edhe për observimin e fëmijëve nga ana e edukatorit/es.

Më shumë për të bërë:

Përveç vizitës në Kryqin e Kuq, mund t'i çoni fëmijët edhe në ndonjë institucion tjetër, ku kanë mundësi të japin ndihma apo të shoqërohen me anëtarët e tjerë të shoqërisë, si në Shtëpinë e të moshuarve, në Repartin e Pediatrisë ose në shoqatën "HendiKOS" e institucione të tjera.

Reflektimi:

Të njihemi me insektet

Fusha kurrikulare:	Shkencat e natyrës
Kurrikula lëndore:	Njeriu dhe natyra
Tema nga plani dymujor:	Toka dhe hapësira
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):	I.3; II.1; III.1, 2, 4; V.2, 5. VI.6
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):	Shkencat e natyrës: 1 Gjuhët dhe komunikimi: 1.1 Matematikë: 5.1
Rezultati i të nxënit të temës:	Tregon karakteristikat e stinëve gjatë vitit.
Rezultatet e të nxënit të aktiviteteve:	<ul style="list-style-type: none"> • Identifikon insektet nga kavanozi. • Luan lojën "bingo me insekte". • Numëron insektet e gjetura përmes lojës.
Kriteret e suksesit:	<ul style="list-style-type: none"> • Identifikon insektet nga kavanozi. • Luaj lojën "bingo me insekte". • Numëro insektet e gjetura përmes lojës.
Burimet dhe materialet:	Loja bingo, fotografi të insekteve ose insekte plastike, guralec, pulla, një kavanoz qelqi, xhamat zmadhuese, bllok për shënime, lapsa, libër/tregim që ka për temë insektet.
Integrimi ndërfaqor:	Gjuhë shqipe, Matematikë.
Çështjet ndërkurrikulare:	Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.
Fjalë kyçe:	Insekt, habitat, përshtatje, mbijetesë.
Organizimi i aktiviteteve:	<p>Aktivitetet në takimin e përbashkët në rreth:</p> <p>Në klasë fshihen 10 insekte plastike ose fotografi insektesh në vende të ndryshme, përpara se të kenë ardhur fëmijët (mund të jenë vende që fëmijët i vizitojnë zakonisht para uljes në rreth).</p> <p>Fëmijët gjejnë insektet dhe i vendosin në një kavanoz qelqi, që do të quhet "Kavanozi i insekteve". Uleni së bashku në rreth dhe nxirrni insektet nga kavanozi, duke u shpjeguar fëmijëve për secilin insekt me radhë. Përfshijini fëmijët në diskutim për insektet, duke i emërtuar, numëruar, përshkruar; ndërlidhni këto të dhëna me stinën e pranverës etj. Shpjegoni që insektet janë të llojeve të ndryshme, dokumentoni këtë fakt me anë të fotografive të llojeve të ndryshme të insekteve. Pyesni fëmijët për ngjashmëritë dhe ndryshimet mes insekteve, ndihmoni fëmijët t'u japin përgjigje pyetjeve, si: "Sa krah kanë?", "A kanë të gjithë ngjyra të njëjta?", "Ku jetojnë?". Vazhdoni me pyetje të tjera për madhësinë, formën, numrin e këmbëve, numrin e pjesëve të trupit etj.</p>

Edukatori/ja përdorë një kukull dore dhe me të lexon një libër/tregim i cili ka të bëjë me insektet. Më pas, fëmijët do të luajnë lojën “Bingo me insekte”. Loja “Bingo me insekte” (bashkangjitur në shtojcën e edukatorit/es) ofrohet në katër qendra, në mënyrë që fëmijët të luajnë në grupe të vogla.

Materialet: Loja e bashkangjitur te shtojca (guralecë, pulla, apo diçka e ngjashme për të shënjuar hapësirat që kanë kapur.)

Ecuria: Vendoset tabela e lojës “Bingo” dhe priten kartat me insekte, të cilat i ktheni pas. Fëmijët marrin kartën, emërtojnë insektin dhe e përshkruajnë, pastaj vendosin një guralec sipër insektit të njëjtë në tabelën bingo. Fëmija arrin të rendisë në vijë të drejtë insektet nga këndi në kënd (horizontalisht apo vertikalisht). Bashkë me fëmijët dalim jashtë dhe marrim me vete: xhamat zmadhues, blloqet e shënimeve dhe lapsat për secilin fëmijë. Fëmijët do të eksplorojnë për të gjetur insekte, i vëzhgojnë ato dhe mbajnë shënime (me anë të vizatimit, përshkruajnë insektet që kanë gjetur). Mblidhemi, diskutojmë dhe i ndajmë të dhënat me njëri-tjetrin.

Pas përfundimit të eksplorimit, fëmijët kërcejnë me muzikë, duke bërë disa lloje kërcimesh, si:

- kërcim karkaleci;
- fluturim i lehtë fluture;
- milingonat rresht nisen për punë;
- bleta lule më lule etj.

Në takimin e përbashkët bëhet një përsëritje e aktiviteteve, duke diskutuar për insektet, emërtimet, ngjashmëritë dhe ndryshimet, format, karakteristikat etj. Numërojmë pjesët e trupit, këmbët dhe klasifikojmë sipas ngjashmërisë. Përdoret kavanozi i insekteve në mes të rrethit ose kartat e lojës “Bingo me insekte”.

Vlerësimi:

Vëzhgohen fëmijët për pjesëmarrje aktive në diskutimin dhe eksplorimin e insekteve dhe në lojën “Bingo me insekte” për përshkrimin e insekteve, numërimin dhe krahasimin e tyre.

Më shumë për të bërë:


Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni më shumë informacion.

<https://www.youtube.com/watch?v=nqkUVfRxQY>

Reflektimi:

Bzz, bzz - Bleta

Fusha kurrikulare:	Gjuhët dhe komunikimi
Kurrikula lëndore:	Gjuhë shqipe
Tema nga plani dymujor:	Tinguj, shkronja, rrokje, fjalë fjali
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):	I. 3, 5; II. 7; III. 1, 2, 3, 6; IV. 2, 6; V. 2, 5; VI. 6
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):	Gjuhët dhe komunikimi: 1.1; 1.2; 1.4; 1.5; 2. 8 Matematikë: 2.1 Jeta dhe puna: 4.8
Rezultati i të nxënit të temës:	Shqiptojnë drejt tingujt, zanore dhe bashkëtingëllore, gjatë të shprehurit.
Rezultatet e të nxënit të aktiviteteve:	<ul style="list-style-type: none"> • Ndërton histori të përbashkët për bletët. • Luan lojën matematikore "Hojëzat e dyllit".
Kriteret e suksesit:	<ul style="list-style-type: none"> • Ndërto histori të përbashkët për bletët. • Luaj lojën matematikore "Hojëzat e dyllit".
Burimet dhe materialet:	Poster me ciklin e jetës së bletëve, fletë me ngjyrë të zezë dhe të verdhë, ngjitës, gërshërë, sy zbukurues, materiale nga kutia e ripërdorshme, libra/ fotografi për bletët, enciklopedi.
Integrimi ndërfaqor:	Matematikë, Shkathtësi për jetë.
Çështjet ndërkurrikulare:	Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.
Fjalë kyçe:	Bletë, insekt, mjaltë, cikli i jetës, bletar, shkronja "B".
Organizimi i aktiviteteve:	<p>Për temën ditore, edukatori/ja mund të përgatitë një dekorim në derën e klasës, që të nxis kureshtjen e fëmijëve me ardhjen e tyre.</p> <p>Modele të mundshme:</p> <p>Zbukurimi i derës së klasës përgatitore është një mënyrë mjaft e mirë për t'i familjarizuar fëmijët e grupit me temën përkatëse. Kjo teknikë mund të përdoret herë pas herë në përputhje me temat. Në takimin e përbashkët, edukatori/ja lexon një histori për bletët, pastaj para fëmijëve prezanton një poster me ciklin e jetës së bletëve dhe u shpjegon procesin e rritjes.</p> <p>Flisni për:</p> <ul style="list-style-type: none"> • ciklin e jetës së bletës; • mënyrën e ushqyerjes; • jetën dhe punën e tyre; • mjaltin dhe bletarët; • rëndësinë e tyre në jetën e njeriut dhe planetit tokë. <p>Pasi fëmijët të njihen me bletët, edukatori/ja i nxit fëmijët të krijojnë një</p>



histori që fillon me një bletë, me kusht që shumica e fjalëve të fillojnë me shkronjën "B", si në rastin: "Na ishte një herë një Bletë, që e quanin Bika, e cila, bashkë me Bletën Bobi, shkoi në Ballon e Bukur të Bletëve, rrugës Biseduan për Biskotat me Bajame të Bobit". Kështu fëmijët në rreth krijojnë historinë, duke vendosur theksin te tingulli "B".

Pasi fëmijët të identifikojnë tingullin e ri, ju mund t'u ofroni punë të pavarur në qendra të ndryshme:

Këndi i qetë - Ofroni libra, enciklopedi, fotografi për bletët, ku fëmijët mund të lexojnë në bazë të fotografive dhe formojnë ciklin e rritjes së bletës te fletëza e punës.

Matematikë - Fëmijët mund të praktikojnë kapjen me pincetë, duke improvizuar vëniën e vezëve në hoje. Këtë e bëjnë duke numëruar. Ata mund të përdorin hedhjen e kubit me numra në hojëzat e dyllit. Loja "Hojëzat e dyllit".

Art - Jepuni fëmijëve fletë me ngjyrë të verdhë dhe të zezë, gërshërë, ngjitës, sy plastikë dhe materiale të ndryshme nga kutia e materialeve të ripërdorshme dhe nxitni të krijojnë punë artistike, duke krijuar bletë në mënyra të ndryshme, sipas imagjinatës së tyre.

Gjuhë - Plotësoni shkronjën "B" te libri i fëmijës në punë individuale.

Siguroni mundësinë që të gjithë fëmijët të kalojnë në të gjitha aktivitetet, në të gjitha qendrat e aktiviteteve.

Në takimin e përbashkët përmbyllës, nën tingujt e një muzike ritmike, fëmijët kërcëjnë duke imituar bletët në natyrë. Kur edukatori/ja ndal muzikën, fëmijët ngrijnë për disa sekonda, pastaj muzika dhe vallëzimi vazhdojnë sërish. Në fund përsëriten njohuritë që ata morën për bletët, ciklin e jetës së bletëve etj. Vazhdohet në këndin e artit, për të parë punimet e fëmijëve.

Vlerësimi:

Vëzhgohet pjesëmarrja aktive e fëmijëve në diskutim, puna e tyre në qendrat e aktiviteteve. Edukatori/ja mund të mbaj shënime narrative, sipas planit të saj të vëzhgimit.


Më shumë për të bërë:

Nxitni fëmijët të hulumtojnë më tej për bletën. Shikoni së bashku ndonjë dokumentar dhe komentojeni.

Reflektimi:

Si rritet një flutur?

Fusha kurrikulare:	Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti
Kurrikula lëndore:	Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti
Tema nga plani dymujor:	Lojërat dhe pushimi
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):	I. 3; II. 1; III. 1, 3, 4; V. 2, 5; VI. 6
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):	Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti: 1 Gjuhët dhe komunikimi: 1.1; 1.2; 2. 8 Matematikë: 3.4
Rezultati i të nxënit të temës:	Praktikon lojëra dhe aktivitete fizike në bashkëpunim në çifte dhe në grupe.
Rezultatet e të nxënit të aktiviteteve:	<ul style="list-style-type: none"> • Imiton historinë e rritjes së fluturës me duar. • Ndjek udhëzimet për lëvizjet në hapësirën me pengesa.
Kriteret e suksesit:	<ul style="list-style-type: none"> • Imito historinë e rritjes së fluturës me duar. • Ndiq udhëzimet për lëvizjet në hapësirën me pengesa.
Burimet dhe materialet:	Fotografi të fluturave në faza të ndryshme të rritjes, karrige, kona, balona, blloqe.
Integrimi ndërfaqor:	Gjuhë shqipe, Matematikë.
Çështjet ndërkurrikulare:	Arsiim për zhvillim të qëndrueshëm.
Fjalë kyçe:	Veze, vemje, flutur, cikli i jetës.
Organizimi i aktiviteteve:	<p>Në takimin e përbashkët, pas plotësimit të kalendarit luajmë lojën "Fjala misterioze". Edukatori/ja jep shpjegime të tërthorta për temën ditore (fluturën) si për shembull: "Çfarë është një gjë me dy krahë? E lehtë si era? E bukur? Shumëngjyrëshe? Arrihet kështu te tema ditore. Dramatizohet me duar tregimi në vijim: <i>Një vezë e vockël jam unë, qëndroj pa lëvizur (bëni gishtin në formën e vezës).</i></p> <p><i>Pas një kohe, kokën nxjerr jashtë dhe dal botën ta shoh (imitoni vezën që thyhet).</i></p> <p><i>Tash jam një vemje, zvarritem si krimb, degë me degë s'le gjethe pa ngrënë (bëni sikur po zvarriteni mbi një gjethe).</i></p> <p><i>Pasi barkun ta mbush plot, sillem, mbështillen, varem me kokën poshtë (bëni dorën grusht dhe e vareni poshtë).</i></p> <p><i>Brenda unë filloj ndryshoj dhe kur dal jashtë, botën mrekulloj (në fund paraqisni me duar fluturën duke dalë jashtë krisalidës dhe me bashkimin e dy duarve, imitoni një flutur që rreh krahët në fluturim).</i></p> <p>Pas përfundimit të historisë, fëmijët ritregojnë me fjalët e tyre edhe një herë, bashkë me edukatorin/en, veprimet e ciklit të jetës së fluturës.</p>



Paraqisni para fëmijëve fotografi të ndryshme të fluturës në fazat e ndryshme të rritjes. Flisni për:

- llojet e fluturave;
- vendin ku jetojnë;
- si ushqehen;
- si rriten;
- dobitë nga flutura e mëndafshit etj.

Lojëra lëvizore - Nën tingujt e muzikës klasike, fëmijët do të lëvizin duke imituar fluturat në fluturim. Pastaj fëmijët bëhen dy nga dy dhe kthehen përballë njëri-tjetrit, ku njëri bëhet pasqyra dhe tjetri flutura. Pasqyra ka për detyrë të imitojë lëvizjet e fluturës.

Vezët në kosh - vendosni një vijë fillimi në dysheme dhe në anën tjetër, në një distancë të përshtatshme, vendosni dy kosha, çdo fëmije i jepni një balon të fryrë, i cili do të jetë veza e fluturës. Fëmijët, duke e mbajtur me gjunjë, do të lëvizin nga vija e fillimit për t'i vendosur në koshin në anën e kundërt.

Fluturat në udhëtim - në hapësirën e klasës vendosen disa pengesa: karrige, kona, topa etj. Fëmijët do të marrin udhëzime nga edukatori/ja për lëvizje në hapësirë, si: tre, gati fillo, flutura fluturon sipër konit, rrotullohet rreth karriges, zvarritet vemja nën karrige, vemja ngjitet mbi top etj.

Në takimin përmbyllës këndojnë një këngë për fluturën dhe flasim për konceptet e reja me të cilat u njoftuan fëmijët sot.

Vlerësimi:

Fëmijët vëzhgohen për shkathtësitë në lojën lëvizore, ndjekjen e udhëzimeve, orientimin në hapësirë dhe saktësinë në lëvizjet e kërkuara.

Më shumë për të bërë:

Fëmijët mund të kërkojnë për flutura, t'i vëzhgojnë ato, t'i fotografojnë, vizatojnë etj. Ju mund të mbani shënime me ndonjë listë, për të dhënat e fluturës.

Reflektimi:

Sa insekte kemi ne?

Fusha kurrikulare:	Matematikë
Kurrikula lëndore:	Matematikë
Tema nga plani dymujor:	Numrat natyrorë
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):	I. 3, 5; II. 1, 2, 7; III. 1, 2, 3, 6; IV. 2, 6; V. 2, 5; VI. 6
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):	Matematikë: 5.1 Gjuhët dhe komunikimi: 1.1; 1.4 Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti: 1
Rezultati i të nxënit të temës:	Numëron të paktën nga 1 deri në 10 dhe anasjellas me anë të mjeteve të konkretizimit.
Rezultatet e të nxënit të aktiviteteve:	<ul style="list-style-type: none"> • Zbaton mbledhje/zbritje/klasifikim te loja "Rrjeta e insekteve". • Ndjek rrugën e dhënë me qesen me misër në kokë.
Kriteret e suksesit:	<ul style="list-style-type: none"> • Zbato mbledhje/zbritje/klasifikim te loja "Rrjeta e insekteve". • Ndiq rrugën e dhënë me qesen me misër në kokë.
Burimet dhe materialet:	Një kuti, fotografi insektesh të ndryshme, kartë me numrin 9, libri i punës për fëmijë, loja "Rrjeta me insekte" te libri i fëmijës, gërshërë, kubet me numra për secilin fëmijë, qese me misër.
Integrimi ndërfaqor:	Gjuhë shqipe, edukatë fizike, sportet dhe shëndeti.
Çështjet ndërkurrikulare:	Zhvillim i qëndrueshëm.
Fjalë kyçe:	Numri "9", insekte, numërim, klasifikim, balancë.
Organizimi i aktiviteteve:	Në takimin e përbashkët në rreth, edukatori/ja sjell para fëmijëve një kuti në të cilën paraprakisht ka vendosur fotografi insektesh të ndryshme dhe një kartë me numrin 9. Fëmijët me sy mbyllur do të tërheqin një fotografi nga kutia dhe do ta përshkruajnë me fjalë insektin (mund të bëjnë përshkrimin fizik, apo të ndajnë ndonjë informacion rreth insektit). Fëmija që tërheq kartën me numrin 9, e identifikon numrin dhe në fund të lojës rendit nëntë insekte në mes të rrethit.

Loja me balancë

Materialet: qese me misër.

Ecuria:

Në hapësirën e klasës krijoni disa viza në dysheme dhe një vizë fillimi. Fëmijët do të ecin sipas udhëzimeve që ju jepni, duke mbajtur në kokë qesen me misër. Krijohet ideja sikur janë milingona që bartin ushqim. Ju mund të ndryshoni rregullat e lojës, për të rritur nivelin e vështirësisë, si për shembull: duke ndryshuar llojin e insektit nga milingona e ngadalshme te bleta punëtore. Fëmijët praktikojnë baraspeshimin, kur mbajnë në kokë qesen me misër e duke e kaluar përtej vizës së fillimit.





Këtë rrugë e bëjnë duke ndjekur vizat në dysheme. Dita vazhdon dhe organizohet me aktivitete nëpër qendra:

1. Fëmijët do të shfletojnë libra dhe materiale të ndryshme; të flasin për rritjen dhe jetën e insekteve. Ata mund të mbajnë shënime përmes vizatimit.
2. Fëmijët do të plotësojnë fletëzat e punës për numrin "9".
3. Fëmijët do të luajnë lojën "Rrjeta me insekte".

Loja "Rrjeta me insekte", e gjeni të bashkangjitur te libri i fëmijës

Ecuria: Fëmijët presin me gërshërë ilustrimet e insekteve dhe shkëpusin ilustrimin e rrjetës së zbrazët.

- Emërtojnë insektet.
- I numërojnë.
- Përdorin hedhjen e kubit me numra dhe vendosin aq insekte në rrjetë.
- Ndryshoni udhëzimet e lojës kohë pas kohe, duke nxitur mbledhjet dhe zbritjet e insekteve brenda kavanozit. Për shembull: kemi 5 insekte në rrjetës, një na iku, sa na kanë mbetur? Rrjeta u mbush plot me insekte (fëmijët vendosin të gjitha insektet brenda rrjetës) ndani të kuqet nga ana e majtë dhe të gjelbrat nga ana e djathtë.

Në takimin e përbashkët diskutojmë për aktivitetet e zhvilluara gjatë ditës dhe nxisim fëmijët të bashkëbisedojnë rreth insekteve. Këndojmë një këngë përshëndetëse dhe përmyllim ditën.

Vlerësimi:

Vëzhgohet puna individuale e fëmijëve te fletëza e punës për njohjen me numrin 9, dhe shkathtësitë matematikore për numërim, mbledhje, zbritje dhe klasifikim në lojën "Rrjeta me insekte".

Edukatori/ja mund të mbajë shënime narrative për disa fëmijë gjatë lojës.


Më shumë për të bërë:

Nëse fëmijët kanë sjellë kavanozat me insekte nga shtëpia, ju mund t'i vendosni te këndi i shkencës dhe me xhamat zmadhues, mund të observojnë dhe mbajnë shënime (ilustrime) për përshkrimet e insekteve, apo në formë të një liste kontrolli ku fëmijët praktikojnë punën me të dhëna. Mos harroni që në fund, t'i lini të lira në natyrë insektet e mbledhura.

Reflektimi:

Shfaqja me insekte

Fusha kurrikulare:	Artet
Kurrikula lëndore:	Edukatë figurative
Tema nga plani dymujor:	Ngjarjet artistike
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):	I. 3, 5; II. 7; III. 1, 2, 3, 6; IV. 2, 6; V. 2, 5; VI. 6
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):	Artet: 4 Gjuhët dhe komunikimi: 1.6; 1.4 Shoqëria dhe mjedisi: 4.4.1
Rezultati i të nxënit të temës:	Fëmijët inkurajohen që të përshkruajnë ndonjë ngjarje artistike në familje, në shkollë e më gjerë.
Rezultatet e të nxënit të aktiviteteve:	<ul style="list-style-type: none"> • Krijon maskat/kukullat insekte për shfaqje. • Aktron në shfaqjen e kukullave në rolin e insektit të zgjedhur.
Kriteret e suksesit:	<ul style="list-style-type: none"> • Krijoi maskat/kukullat insekte për shfaqje. • Aktro në shfaqjen e kukullave në rolin e insektit të zgjedhur.
Burimet dhe materialet:	Letra me ngjyra, letër e trashë, sy dekorativ, gërshtë, ngjitës, pipëza, shkopinj të vegjël, qese letre.
Integrimi ndërfaqor:	Gjuhë shqipe, Shoqëria dhe mjedisi.
Çështjet ndërkurrikulare:	Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.
Fjalë kyçe:	Shfaqje teatrale, aktrim, insekt, publik.
Organizimi i aktiviteteve:	Në takimin e përbashkët, edukatori/ja paraqet lojën me tabelë ku në hapësira të ndryshme vendos nga një fotografi të insekteve. Fëmijët i emërtojnë dhe i përshkruajnë ato (udhëzimet e lojës i gjeni bashkëngjitur me modelin e lojës, te Shtojca).



Në këndin e artit, jepuni fëmijëve materiale të ndryshme, që ata të krijojnë maska insektesh apo kukulla insekte me të cilat do të luajnë me role në teatrin e klasës.

Fëmijët ndahen në grupe me nga katër-pesë fëmijë dhe udhëzohen të bëjnë një planifikim për shfaqjen që do të japin. Fëmijët, në grupe, ndërveprojnë me njëri-tjetrin dhe krijojnë një histori, të cilën do ta demonstrojnë.

Secili grup e emërton shfaqjen e tij dhe e paraqet para grupit; të tjerët ndjekin shfaqjen, në mënyrë që në fund të diskutohet:

- morali i shfaqjeve;
- mënyra si aktruan;
- intonacioni, si tingëlluan zërat, a ishin të qartë etj.

Pas diskutimit dhe komentimit të shfaqjeve, të gjithë mblidhen te këndi i artit dhe ekspozohen punimet e fëmijëve. Mund të bëni një përsëritje të tërë javës rreth informacioneve që fëmijët kanë marrë për insektet. Fëmijët këndojnë këngën "O buburrec" dhe e shoqërojnë me lëvizje ritmike.

Vlerësimi:

Fëmijët vëzhgohen gjatë aktrimit në shfaqjen me insekte, për mënyrën e shprehjes, ndërveprimin në grup, intonacionin, shprehjen artistike etj.


Më shumë për të bërë:

Fëmijët mund të argëtohen me lojërat edukative kompjuterike rreth insekteve në linkun <https://www.pestworldforkids.org/for-kids/games/>

Reflektimi:

Unë mundem!

Fusha kurrikulare:	Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti
Kurrikula lëndore:	Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti
Tema nga plani dymujor:	Unë dhe mjedisi
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):	I. 3, 8; II. 1, 7; III. 1, 2, 6; IV. 4, 6; V. 2, 5, 7; VI. 4, 5, 6
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):	Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti: 5 Gjuhët dhe komunikimi: 1.1; 1.7 Matematikë: 6.1
Rezultati i të nxënit të temës:	Njeh konceptet elementare për mjedisin e pastër.
Rezultatet e të nxënit të aktiviteteve:	<ul style="list-style-type: none"> • Bashkëbisedon për rëndësinë e mjedisit të pastër. • Klasifikon ilustrimet në mjediset e pastra dhe ato të papastra. • Pret me kujdes figurat.
Kriteret e suksesit:	<ul style="list-style-type: none"> • Bashkëbisedo për rëndësinë e mjedisit të pastër gjatë lojës. • Vendos në një rën anë mjediset e pastra e në tjetrën ato të papastra. • Prit me kujdes figurat, ujitëse, dorashka, qese, vegla të vogla pune etj.
Burimet dhe materialet:	Burime të materialeve <i>online</i> , maket i një pylli, kafshë, ngjitës, gërshërë, ngjyra, fletë të ndryshme.
Integrimi ndërfaqor:	Gjuhë shqipe, Matematikë.
Çështjet ndërkurrikulare:	Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.
Fjalë kyçe:	Mjedisi, natyra, uji, ajri, njerëzit.
Organizimi i aktiviteteve:	<p>Edukatori/ja fillon takimin së bashku me fëmijët në oborrin e institucionit parashkollor. Së bashku do të bëjnë veprime që ndihmojnë në mbrojtjen e mjedisit (ujitja e luleve, e bimëve, pastrimi i oborrit etj.).</p> <p>Pasi kthehen në klasë, fëmijët ulen në rreth; edukatori/ja paraqet në projektor një video në linkun https://www.youtube.com/watch?v=gEk6JLJNgOU ku përmes imazheve, do të kuptojnë kush bën pjesë në mjedis.</p> <p>Kush bën pjesë në mjedis?</p> <p>Nxit diskutimin me pyetjet: “Pse natyra ka kaq shumë rëndësi për ne? Si duhet të veprojmë për të mbrojtur mjedisin? Fëmijët japin mendime.</p> <p>Edukatori/ja sjellë përpara fëmijëve në rreth maketin e natyrës, kërkon nga fëmijët të heqin insektet nga pylli, fton grupin tjetër të largojnë zogjtë, kafshët, kërpudhat, pemët etj. Çfarë ndodh me natyrën tani?</p> <p>Shpjegohet rëndësia e natyrës në jetën në tokë. Puna vazhdon në qendrat e aktiviteteve:</p>



Në njërin grup, fëmijët në formë grupore do të gjejnë në revista, fotografi që paraqesin mjedisin e pastër/ndotur, do t'i presin dhe ngjisin ato.

Në një tjetër grup do të luajnë me role të vogla me maketin e natyrës. Në takimin përmbledhës do të rikujtohet edhe një herë aktiviteti ditor; fëmijët sjellin punimet e tyre dhe do të flasim duke u bazuar në ilustrime.

Vlerësimi: Fëmijët do të vëzhgohen gjatë bashkëveprimit me të tjerët, për aktivitetin grupor dhe të shprehur.

Më shumë për të bërë: Mund t'i referoheni linkut të mëposhtëm për mjedisin.
<https://www.youtube.com/watch?v=gEk6JLJNg0U>

Reflektimi:

Thesari ynë

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi

Kurrikula lëndore: Shoqëria dhe mjedisi

Tema nga plani dymujor: Kujdesi për mjedisin që na rrethon

Rezultatet e të nxëniet për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): **I.** 3, 5, 8; **II.** 1, 3, 7; **III.** 1, 2, 4, 6; **IV.** 2, 3, 6; **V.** 2, 5, 7; **VI.** 1, 2, 4, 6

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): Shoqëria dhe mjedisi: 5.1; 5.2
Gjuhët dhe komunikimi: 1.1; 2.2
Artet: 4

Rezultati i të nxëniet të temës: Identifikon disa nga ndotësit e mjedisit dhe tregon shkathtësi në kujdesin ndaj mjedisit që e rrethon (familje, shkollë/kopsht, lagje).

Rezultatet e të nxëniet të aktiviteteve:

- Përshkruan me fjalë ilustrimet e paraqitura.
- Argumenton veprimet e personazheve në ilustrim.
- Tregon tre shembuj, duke bazuar te përvoja e tij/saj.

Kriteret e suksesit:

- Përshkruaj me fjalë ilustrimet e paraqitura.
- Argumento veprimet e personazheve në ilustrim.
- Trego tre shembuj nga përvoja jote.

Burimet dhe materialet: Libra për fëmijë me temë mjedisin, ilustrime të ndryshme të mjedisit të prera, *flipchart*, ngjitës, instrumente muzikore etj.

Integrimi ndërfaqshor: Gjuhë shqipe, Edukim muzikor.

Çështjet ndërkurrikulare: Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

Fjalë kyçe: Mjedis, pastër, kujdes, mbeturina.

Organizimi i aktiviteteve: Dita fillon me takimin e përbashkët, përshëndetjen me fëmijët, me ndryshimin e kalendarit dhe më pas luhet loja "Hapet-mbyllet" (ky aktivitet është përdorur edhe në ditët e mëparshme).

Edukatori/ja ka përgatitur ilustrime të ndryshme të mjedisit. Secilës dyshe të fëmijëve u jepet nga një ilustrim dhe kërkojmë prej tyre që të përshkruajnë atë që shohin. Edukatori/ja nxit fëmijët në bashkëbisedim përmes pyetjeve dhe perifrimeve.

Fëmijët japin përgjigje duke u bazuar nga përvojat e tyre, motivohen për të vazhduar më tej, tregojnë shembuj kur kanë mbajtur pastër mjedisin. Arrihet në përfundimin se: "Njerëzit duhet të kujdesen për mjedisin, për të pasur jetë sa më të shëndetshme". Bashkërisht me fëmijët vendosim për një rregull të re: TË MBROJMË MJEDISIN!



Edukatori/ja vendos *flipchart*-in në mes të rrethit dhe shënon rregullën, fëmijët në dyshe do të vendosin ilustrimet që paraqesin mjedisin e pastër. Posteri vendoset në një kënd të dukshëm të klasës.

Më pas, fëmijët ndahen në grupe të vogla, me aktivitete të ndara:

1. Njëri grup do të plotësojë fletëzat e punës me temë mjedisin.
2. Grupi tjetër do të klasifikojë fotografitë në mes të faktorëve ndotës dhe mbrojtës të ambientit.
3. Vizatojnë sipas imagjinatës si do të dukej bota pa ndotësit.

Pas përfundimit të aktiviteteve, fëmijët kthehen përsëri në rreth për takimin përmbyllës dhe këndojnë disa këngë ritmike të shoqëruara me instrumentet muzikore që kemi në klasë dhe përshëndetemi.



Vlerësimi: Fëmijët vëzhgohen dhe vlerësohen në bazë të aftësive për të krijuar fraza e për të dhënë shpjegime, si dhe për veprimet e tyre në mbrojtje të mjedisit.

Më shumë për të bërë: Për Ditën e Tokës, më 22 prill mund të mbjellin fidanë me fëmijët në mjediset e institucionit parashkollor/shkollës.

Reflektimi: _____

P për PYLLIN!

Fusha kurrikulare:	Gjuhët dhe komunikim
Kurrikula lëndore:	Gjuha shqipe
Tema nga plani dymujor:	Tinguj, shkronja, rrokje, fjalë, fjali
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):	I. 3, 5; II. 7; III. 1, 2, 3, 6; IV. 2, 6; V. 2, 5, 7; VI. 6
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):	Gjuhët dhe komunikimi: 1.1, 1.2; 1.4; 1.5 Artet: 4 Matematikë: 3.5
Rezultati i të nxënit të temës:	Shqiptojnë drejt tingujt, zanore dhe bashkëtingëllore gjatë të shprehurit, shqiptojnë drejt rrokjen e fjalës.
Rezultatet e të nxënit të aktiviteteve:	<ul style="list-style-type: none"> • Ritregon mesazhin nga vjersha. • Modelon me plastelinë shkronjën P-ë. • Numëron rrokjet në fjalët e gjetura.
Kriteret e suksesit:	<ul style="list-style-type: none"> • Ritrego mesazhin nga vjersha. • Modelon me plastelinë shkronjën P-ë. • Numëro rrokjet në fjalën e gjetur.
Burimet dhe materialet:	Libri me gjëgjëza, plastelinë, libri i fëmijës, fije peri, plastelina, maketi i natyrës, shkronja P magnetike.
Integrimi ndërfaqor:	Edukim figurativ, Matematikë.
Çështjet ndërkurrikulare:	Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.
Fjalë kyçe:	Natyra, pemët, rritet, lule, shkronja P-ë.
Organizimi i aktiviteteve:	Në takimin e përbashkët, pas plotësimit të kalendarit, diskutimit për motin dhe temën e ditës së mëparshme, fëmijët bëhen gati për lojën "Rritet-rritet". Fëmijët mbledhen në rreth. Zgjidhet një udhëheqës dhe kur ai/ajo thotë "Rritet-rritet" bari, (lulja, pema, fletorja, karrige, çanta etj.), fëmijët duhet të ngrenë dorën lart nëse bëhet fjalë për gjallesa, ndërsa do të mohojnë me kokë, nëse bëhet fjalë për sende a dukuri. Loja vazhdon derisa në rreth mbetet vetëm një fëmijë. Kjo lojë u jep ide fëmijëve edhe për dallimin e botës së gjallë dhe jo të gjallë. Pas mbarimit të lojës, edukatori/ ja tërheq vëmendjen e fëmijëve me një gjëgjëzë. Nëse ndonjëri prej tyre ka dëshirë të thotë një gjëgjëzë, edukatori/ja ia jep fjalën. Më tej i vjen radha leximit të një vjershe për natyrën. Vjersha mund të shoqërohet edhe me maketin e pyllit, të cilën fëmijët e kanë përdorur ditë më parë; brenda maketit edukatori/ja fsheh edhe disa shkronja P (mund të jenë magnetike, të drurit, karta etj.), të cilat i zbulojnë bashkë me fëmijët.

Kështu ata njihen me tingullin dhe grafikun e shkronjës "P" dhe e praktikojnë atë në forma të ndryshme. Dita organizohet nëpër qendra të aktiviteteve:

Edukatori/ja lexon një vjershë, e cila flet për pyllin.

Në njëren qendër, fëmijët do të modelojnë me plastelinë, do të gjejnë fjalë të tjera që fillojnë me P, ta ndajnë në rrokje e të krahasojnë se cila ka më shumë e më pak etj.

Në një tjetër, fëmijët do të plotësojnë fletëzat e punës mbi modelin e shkronjës "P". Te një qendër tjetër mund të ndërtojnë modelin e shkronjës P-ë, duke përdorur fije peri të trasha për qepje, të cilat mund të priten në copëza më të vogla e të modelohen në formën e shkronjës P-ë. E rëndësishme është që fëmijëve t'u ofrohen materialet, ndërsa metodën e punës, mund ta zgjedhin vetë. Pas përfundimit të punimeve nëpër qendra, ata do të ekspozojnë punimet e tyre dhe organizohet "Turi i galerisë". Në takimin përmbyllës do të flitet për mënyrën si kanë kaluar ditën. Rikujtohet vjersha dhe shkronja e ditës.

Vlerësimi:

Fëmijët do të vëzhgohen përgjatë zhvillimi të aktiviteteve sipas planit të vlerësimit të edukatorit/es.

Më shumë për të bërë:

Këngë në gjuhën angleze për pemët:

<https://www.youtube.com/watch?v=FJqy967xs1c>

<https://www.youtube.com/watch?v=H6GyjepUD50>


Reflektimi:

Bëhu superhero në mbrojtje të mjedisit!

Fusha kurrikulare:	Shkencat e natyrës
Kurrikula lëndore:	Njeriu dhe natyra
Tema nga plani dymujor:	Materialet dhe vetitë e tyre
Rezultatet e të nxëniet për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):	I. 3, 5, 8; II. 1, 3, 7; III. 1, 2, 4, 6; IV. 2, 3, 6; V. 2, 5, 7; VI. 6
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):	Shkencat e natyrës: 1 Gjuhët dhe komunikimi: 1.1 Jeta dhe puna: 2.8.1 Matematikë: 6.2
Rezultati i të nxëniet të temës:	Hulumton material nga objektet e njohura për ta (letër, dru, metal, plastikë, tekstil, shkëmbinj të etj.).
Rezultatet e të nxëniet të aktiviteve:	<ul style="list-style-type: none"> • Përshkruan materialet sipas përbërjes. • Dallon materiet e tretshme nga ato të patretshme. • Krijon një kolazh grupor me materiale të ripërdorshme.
Kriteret e suksesit:	<ul style="list-style-type: none"> • Përshkruaj materialet sipas përbërjes. • Dallo materialet e tretshme nga ato të patretshme. • Krijon një kolazh në grup me materiale të ripërdorshme.
Burimet dhe materialet:	Fotografi të ndryshme ilustruese me temë mjedisin, kutiza, letra, ngjyra uji, enë plastike, ujë, vaj, letër, libri "Përrallat e nënës Tokë".
Integrimi ndërfaqor:	Gjuhë shqipe, Shkathtësi për jetë, Matematikë.
Çështjet ndërkurrikulare:	Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.
Fjalë kyçe:	Ujë, vaj, plastikë, letër, ndotje, bota ujore.
Organizimi i aktiviteve:	Në takimin e përbashkët plotësojmë kalendarin dhe diskutojmë për motin. Pastaj edukatori/ja lexon një tregim nga libri "Përrallat e Nënës Tokë"; diskutohet së bashku dhe ftohen fëmijët të luajnë lojën: "Toka bën një pyetje". Udhëheqësi e hedh topin dhe bën një pyetje; ai që pret topin jep përgjigjen.

*Toka bën një pyetje dhe hedh topin:
Kush jeton në tokë? (Kafshët, insektet, lule, bimët)
Kush jeton nën tokë? (Krimbat, milingonat)
Kush fluturon mbi Tokë? (Zogjtë, insektet)
Pse kemi nevojë për ujë? (Pije, pastërti, bimë)
Për çfarë është ajri? (Për të kryer procesin e frymëmarrjes)
Çfarë bëjnë bletët? (Mbledhin nektarin)*

Edukatori/ja u flet për mjedisin dhe ndotësit, më pas mund të paraqesë një video të shkurtër, ku fëmijët do të vëzhgojnë se si plastika dhe materiale të tjera të patretshme janë shumë të dëmshme si për tokën,



ashtu edhe për qeniet e gjalla, sidomos për peshqit dhe gjallesat që jetojnë në ujë. Aktiviteti vazhdohet me enë plastike, me ujë, vaj, letër me materiale që treten dhe nuk treten në mjedis. Merret një enë e tejdukshme e mbushet me eksperimentin mbi materialet plastike. Fëmijët do të eksperimentojnë, do të nxjerrin përfundime, duke hedhur aty vaj, letra, baltë, kripë. Enën e qelqtë do ta vendosin në një kënd deri në fund të ditës. Do të shohin se plastika dhe vaji nuk treten në ujë, ndërsa letra është e riciklueshme dhe e padëmshme për tokën.



Pas eksperimentit, fëmijët, në grupe të vogla me nga katër vetë, do të punojnë me materiale të ripërdorueshme një kolazh në grup mbi mjedisin e pastër. Ata janë të lirë në ndërtimin e idesë së kolazhit.

Fëmijët ekspozojnë punën e bërë në grup, rregullojnë hapësirën e punës dhe kalojnë në këndin e shkencës tek eksperimenti për të parë rezultatet e tij. Në takimin përmbyllës, edukatori/ja nxit fëmijët që secili prej tyre të imagjinojë vetën si një superhero, dhe thonë nga një premtim se çfarë do të bëjnë ata për planetin tokë.

Vlerësimi:

Edukatori/ja përmes observimit do të vlerësojë fëmijët për punën që realizojnë dhe bashkëveprimin në grup gjatë punës me të tjerët.

Më shumë për të bërë:

Ju mund të kërkonin nga prindërit që të bisedojnë me fëmijët e tyre mbi ndotjen dhe mënyrën më të mirë të parandalimit të saj. Kjo mund të realizohet në mënyrë shumë të natyrshme, duke i mundësuar fëmijës të flasë dhe diskutojë për çështje që kanë të bëjnë me mjedisin.

Reflektimi:

Kush e ndot ambientin tonë?

Fusha kurrikulare: Matematikë

Kurrikula lëndore: Matematikë

Tema nga plani dymujor: Numrat natyrorë

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):

I. 3, 5, 8; **II.** 1, 3, 7; **III.** 1, 2, 4, 6; **IV.** 2, 3, 6; **V.** 2, 5, 7; **VI.** 6

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):

Matematikë; 1. 4
Gjuhët dhe komunikimi: 1. 1; 2.2; 1. 4
Edukatë fizike, sportet dhe shëndet: 2. 1

Rezultati i të nxënit të temës:

Zbret dy numra natyrorë, duke i konkretizuar në grupe objektsh.

Rezultatet e të nxënit të aktiviteteve:	<ul style="list-style-type: none"> • Numëron ilustrimet duke krahasuar më shumë/më pak. • Zbret, duke hequr elemente sipas kërkesës. • Praktikon procesin e zbritjes.
Kriteret e suksesit:	<ul style="list-style-type: none"> • Numëro ilustrimet duke krahasuar më shumë/më pak. • Zbrit, duke hequr elementet sipas kërkesës. • Praktiko procesin e zbritjes.
Burimet dhe materialet:	Fletë të plastifikuara, materiale të ripërdorshme, lodra formuese, ilustrim, ngjyra, lapsa.
Integrimi ndërfaqor:	Gjuhë shqipe, Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti.
Çështjet ndërkurrikulare:	Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.
Fjalë kyçe:	Zbritje, baras, më pak, largo, heq.
Organizimi i aktiviteteve:	<p>Dita fillon me përshëndetjen me fëmijët, lexohet tregimi “Kush e zbukuron tokën” (Libri: “Përrallat e nënës Tokë”) dhe diskutohet së bashku. Luajmë lojën: “Vallëzimi me karrige”.</p> <p><i>Ecuria:</i> Nëse janë dhjetë lojtarë, duhet të jenë nëntë karrige, të vendosura në formë rrethi. Fëmijët do të vallëzojnë nën tingujt e muzikës rreth karrigeve dhe, në çastin e ndaljes, ata duhet të ulen; njëri prej tyre mbetet pa karrige, ai/ajo kalon nga rrethi te muzika dhe detyra e tij/saj është të ndalë muzikën për raundin e ardhshëm të lojës. Loja luhet derisa në rreth mbetet vetëm një fëmijë. Sa herë që ndalet muzika, numërohet sa karrige janë dhe theksohet se kur heqim një karrige, sasia zvogëlohet. Tregohet numri. Me anë të kësaj loje jepet ideja e zbritjes, duke hequr nga një karrige pas çdo raundi, zvogëlohet deri në një.</p> <p>Përmes materialeve, edukatori/ja në rreth konkretizon konceptin e zbritjes. Fëmijët praktikojnë aftësinë për zbritje përmes materialeve konkrete.</p> <p>Dita vazhdon me punën në qendra të aktiviteteve:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Në këndin e gjuhës, edukatori/ja ka përgatitur një shportë me ilustrime të ndryshme; fëmijët do t’i komentojnë dhe klasifikojnë ato. - Në këndin e matematikës, fëmijët do të plotësojnë fletëzën e punës me veprimet e zbritjes. - Në këndin e konstruktimit u ofrohen guralec, boçe pishe, kapak, blloqe druri, me të cilat fëmijët do të praktikojnë veprimin e zbritjes. - Ndërsa në këndin e artit, do të pikturojnë përrallën “Kush e zbukuron tokën”. <p>Edukatori/ja vëzhgon punën e fëmijëve dhe kur ata të kenë përfunduar, i nxit të kalojnë nga njëra qendër në tjetrën në formë rotacioni, në mënyrë që të gjithë fëmijët të punojnë në të gjitha qendrat. Në takimin përmbyllës këndojnë një këngë ritmike dhe përshëndetemi.</p>
Vlerësimi:	Edukatori/ja përmes vëzhgimit dhe punës së drejtpërdrejtë me fëmijët vlerëson nevojat e tyre dhe se ku qëndrojnë pikat e forta të tyre, duke marrë parasysh mbledhjen dhe zbritjen. Planifikon edhe hapat e mëtejshëm për zhvillimin e aktiviteteve logjike në funksion të të nxënit të qëndrueshëm të fëmijëve, bazuar në nevojat individuale të tyre.
Më shumë për të bërë:	Aktivitete me problema me veprimin e zbritjes: https://www.youtube.com/watch?v=VMC-olUJCy0
Reflektimi:	_____



Bota magjike e librit

Fusha kurrikulare:	Gjuhët dhe komunikim
Kurrikula lëndore:	Gjuhë shqipe
Tema nga plani dymujor:	Tregime, përralla, përrallëza, gjëegjëza, poezi
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):	I. 3, 5; II. 3, 7; III. 1, 2, 3, 6; IV. 4, 5; V. 5; VI. 6
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):	Gjuhët dhe komunikimi: 1.1; 1.2; 1.4; 1.5 Artet: 1 Shkenca dhe natyra: 1 Matematikë: 3.1
Rezultati i të nxënit të temës:	Shkëmbejnë ide me të tjerë për gjëra të ndryshme që u interesojnë si fotografi, ilustrime, figura, lodra.
Rezultatet e të nxënit të aktiviteteve:	<ul style="list-style-type: none"> • Prezanton librin e tij/saj të preferuar para grupit. • Eksperimenton me cilindrin e letrës dhe peshën me libra.
Kriteret e suksesit:	<ul style="list-style-type: none"> • Prezanto librin tënd të preferuar para grupit. • Eksperimento me cilindrin e letrës dhe peshën me libra.
Burimet dhe materialet:	Librat e preferuar të çdo fëmije, libra të ndryshëm: me përralla, gjëegjëza, me fotografi, pa fotografi, historik, enciklopedi, fjalor, fletë e bardhë A4, e fortë.
Integrimi ndërfaqor:	Edukatë muzikore, Njeriu dhe natyra, Matematikë.
Çështjet ndërkurrikulare:	Edukimi i qëndrueshëm.
Fjalë kyçe:	Libër, autor/e, dituri, eksperiment, cilindër letre, peshë, konstruksion, inxhinieria.
Organizimi i aktiviteteve:	<p>Në takimin e përbashkët, fëmijët do të sjellin nga shtëpia librin e tyre të preferuar, dhe së bashku këndojnë këngën:</p> <p>(përdorni melodinë e këngës “Nëse je vërtet i lumtur”)</p> <p><i>“Nëse ti ke një libër që e do, nëse ti ke një libër që e do, sjelle ti në grup, dhe me shokët e lexo, nëse ti ke një libër që e do”. (2X)</i></p> <p>Secili nga fëmijët mban në dorë librin e vet dhe e tregon para grupit, në atë mënyrë që titulli i librit të jetë i dukshëm. Ata thonë emrat e librave të tyre (ose edukatori/ja lexon titullin dhe fëmija e përsërit).</p> <p>Pasi fëmijët të kenë ndarë titujt e librave të tyre, me radhë tregojnë faqen e preferuar në libër dhe flasin për të. Nxitini fëmijët të shprehin se çfarë u pëlqen në historinë e librit të tyre. Pasi fëmijët të kenë prezantuar librat e tyre, pyetini nëse kanë dëshirë t’i shkëmbejnë librat me njëri-tjetrin. Nëse fëmijët bëjnë shkëmbim librash, diskutoni për rregullat</p>

e mirëmbajtjes së librit të huazuar dhe bëni një listë me të dhëna për fëmijët që shkëmbyen librat. Caktoni bashkërisht kohën e kthimit të librave.

Edukatori/ja prezanton librat e ndryshëm që ka sjellë para fëmijëve dhe flet për:



- librat me përralla – tregojnë një libër të tillë;
- librat historikë – tregojnë dhe shpjegojnë se përmes tyre bartet historia njerëzore dhe në këtë formë ne nuk e harrojmë atë;
- librat enciklopedikë – tregojnë dhe shpjegojnë se si ne marrim njohuri të shumta për çdo fenomen në botë dhe jashtë saj.

Fëmijët eksplorojnë librat e mësipërm lirisht. Bashkërisht përzgjedhin një libër për lexim.

Eksperimenti: “Sa libra mund të mbaj një cilindër letre?”

Materialet: një fletë kartoni, mund të jetë fletë nga blloku i vizatimit dhe disa libra me kopertinë të fortë dhe jo shumë të rëndë.

Ecuria: Krijoni një cilindër duke e palosur fletën në formë të tillë që ta fiksoni me ngjitës.



Pyetini fëmijët se çfarë është inxhinieria. Të tregojnë çfarë dinë rreth saj. Shpjegoni se si inxhinierët bëjnë ndërtime, ndërtesa, shtëpi etj., duke bërë llogaritje për ndërtim, matje. Eksperimenti me cilindrin e letrës do të na japë një shembull se si një formë letre në formë të

caktuar mund të mbaj disa libra mbi vete. Kërkoni mendime nga fëmijët se sa libra mendojnë që do t'i mbajë cilindri prej letre. Vendosni një nga një librat dhe lejon fëmijët të shohin dhe të provojnë edhe vetë konstruktimin e cilindrit dhe provën me libra. Fëmijët mund ta provojnë edhe në formë të pavarur zhvillimin e eksperimentit.



Në takimin e përbashkët, fëmijët ndajnë përvojat e tyre me librat, përshtypjet dhe interesin që kanë shfaqur për librat e caktuar, diskutojmë për rezultatin e eksperimentit me cilindrin e letrës, duke nxitur pyetje dhe bashkëbisedim. Bashkë me fëmijët luhet loja me memorie “Cili libër mungon”. Të gjithë librat e sjella nga fëmijët vendosen në dysheme, fëmijët vëzhgojnë me kujdes dhe më pas mbyllin sytë. Edukatori/ja tërheq njërin nga librat dhe më pas i udhëzon fëmijët të hapin sytë dhe të identifikojnë se cili libër mungon. Loja vazhdon derisa të gjithë fëmijët ta kenë përfunduar.

Vlerësimi:

Fëmijët vëzhgohen për përfshirje aktive në bashkëbisedim për librat, në prezantimin e librave të preferuar dhe në ndërtimin e cilindrit.

Më shumë për të bërë:

Shkëmbimin e librave me njëri-tjetrin mund ta bëni si praktikë të rregullt javore, ku fëmijët do të edukohen për t'i ndarë librat dhe rrisin përgjegjësinë për kujdesin dhe respektimin e rregullave për kthimin e librit me kohë, duke iu referuar listës në të cilën mbani shënimet për librat e shkëmbyer.

Reflektimi:

Libri im simetrik

Fusha kurrikulare:	Matematikë
Kurrikula lëndore:	Matematikë
Tema nga plani dymujor:	Figurat gjeometrike
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):	I. 3, 5; II. 3, 7; III. 1, 2, 3, 4, 6; IV. 4, 5; V. 5; VI. 6
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):	Matematikë: 3.1 Gjuhët dhe komunikimi: 1.1; 3.2 Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti: 1
Rezultati i të nxënit të temës:	Dallon me anë të palosjes, vijën e simetrisë së figurave të thjeshta.
Rezultatet e të nxënit të aktiviteteve:	<ul style="list-style-type: none"> • Krijon librin me figura simetrike. • Ndërton figura simetrike.
Kriteret e suksesit:	<ul style="list-style-type: none"> • Krijoi librin me figura simetrike. • Ndërto figura simetrike.
Burimet dhe materialet:	Ngjitës, fletë të bardha, laps, gërshërë, ngjyra, kube formuese (<i>Lego</i>).
Integrimi ndërfaqor:	Gjuhë shqipe, Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti.
Çështjet ndërkurrikulare:	Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.
Fjalë kyçe:	Simetri, libër, figurë, konstruktim, palosje.
Organizimi i aktiviteteve:	<p>Në takimin e përbashkët, pas plotësimit të kalendarit, edukatori/ja fton fëmijët në lojën "Bëhu gjysma ime". Fëmijët do të gjejnë një partner me të cilin mendojnë se janë të ngjashëm për nga shtatlartësia, flokët, sytë etj., dhe në mes të rrethit, secili çift fëmijësh kapet krah për krah dhe marrin një pozicion të njëjtë në të dyja anët, për të krijuar një figurë simetrike. Pyesni fëmijët nëse figurat që po përpiqen të paraqesin, janë të njëjta/simetrike në të dyja anët. Në fund u shpjegoni se, sado të ngjashëm ta gjeni partnerin, dhe sado të përpiqeni të qëndroni në të njëjtën pozitë, është e pamundur të jeni simetrikë. Nxitini fëmijët të mendojnë se çfarë mund të jetë simetrike; shtroni pyetje dhe kërkoni ide. Edukatori/ja organizon dhomën e punës në qendra të aktiviteteve dhe u jep materiale pune në tri qendra:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Me materialet si: letra të ndryshme, laps, gërshërë, vizore, ngjyra, fëmijët do të krijojnë libra në forma të ndryshme me anë të palosjes së fletës. Më pas do të vizatojnë figura të ndryshme simetrike në të. 2. Me lodra formuese apo petëza, fëmijët do të krijojnë figura të ndryshme simetrike (ato mund të fotografohen dhe dokumentohen nga edukatori/ja).



3. Në librin e fëmijës fëmijët do të mund të vizatojnë dhe ngjyrosin figurën simetrike.

Në takimin e përbashkët diskutojmë për simetrinë, shikojmë në ambientin përreth dhe identifikojmë objekte, të cilat janë simetrike në të dyja anët. Paraqesim librat e krijuar dhe secili fëmijë prezanton punën tij/saj.

Vlerësimi:

Edukatori/ja mban shënime mbi veprimtarinë e zhvilluar nga fëmijët, sipas planit të vlerësimit bënë vëzhgimin e tyre.

Më shumë për të bërë:

Mund t'i referoheni linkut më poshtë për lojëra edukative kompjuterike: <https://www.topmarks.co.uk/symmetry/symmetry-sorting>

Reflektimi:

Vizitojmë bibliotekën

Fusha kurrikulare:

Shoqëria dhe mjedisi

Kurrikula lëndore:

Shoqëria dhe mjedisi

Tema nga plani dymujor:

Vendi/mjedisi ku jetoj!

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):

I. 3, 5; **II.** 1; **III.** 3; **IV.** 3, 4; **V.** 2, 5; **VI.** 1, 3, 4, 5, 6

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):

Shoqëria dhe mjedisi: 2.2.1
Gjuhët dhe komunikimi: 1.1; 1.6
Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti: 1

Rezultati i të nxënit të temës:

Identifikon shërbimet që ofrohen në familje, lagje, kopsht, shkollë, mjedisin rrethues (kujdesin prindëror, shërbimet mjekësore dhe rekreative etj.).

Rezultatet e të nxënit të aktiviteteve:

- Njihet me rregullat e qëndrimit në bibliotekë.
- Kupton rëndësinë e kujdesit për librin e huazuar.
- Praktikon lëvizjet në hapësirës, duke ndjekur udhëzimet.

Kriteret e suksesit:

- Njihet me rregullat e qëndrimit në bibliotekë.
- Kupto rëndësinë e kujdesit për librin e huazuar.
- Praktiko lëvizjet në hapësirë, duke ndjekur udhëzimet.

Burimet dhe materialet: Një dokument/rregullore të bibliotekës, tabelë, marker, një litar (për mundësinë e udhëtimit në këmbë), mjet transporti (nëse biblioteka gjendet larg institucionit tuaj).

Integrimi ndërfaqshor: Gjuhë shqipe, Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti.

Çështjet ndërkurrikulare: Edukimi për qytetari demokratike.

Fjalë kyçe: Bibliotekë, libër, huazim, zhanër, autor, rregullore.

Organizimi i aktiviteteve: Për vizitën në bibliotekën e qytetit, prindërit dhe fëmijët janë njoftuar ditë me parë dhe vijnë të përgatitur për temën ditore.



Në takimin e përbashkët, edukatori/ja u prezanton fëmijëve dokumentin e rregullores së bibliotekës (siguroni paraprakisht një dokument të tillë). Fëmijët njoftohen për rregullat bazë, si:

- qetësinë;
- ruajtjet e inventarit, librave;
- kohën e kthimit të librave etj.

Pastaj fëmijët njoftohen për rrugën që do të bëjnë. Nëse do të jetë një ecje nëpër qytet, njoftoni fëmijët me rregullat e udhëtimit në grup nëpër qytet, me rreziqet e mundshme dhe me përgjegjësitë. Rekomandohet përdorimi i një litari në të cilin do të mbahen fëmijët gjatë rrugës. Kërkoni prindër vullnetarë për t'ju shoqëruar gjatë vizitës në bibliotekë. Fëmijët po ashtu veshin veshjet e posaçme për dalje të organizuar.

Gjatë qëndrimit aty, njihen me të gjitha hapësirat, por theksi duhet vënë te qetësia e brendshme e ambienteve. Njoftoni fëmijët me stafin drejtues, i ftoni t'ju flasin për profesionin e tyre, si: drejtori, bibliotekarja etj.

Vizitoni këndet e ndryshme të librave dhe ju flisnin për mënyrën e sistemimit të tyre. Flisni për:

- zhanret e librave;
- mënyrën e renditjes;
- librat shqip dhe ata të gjuhëve të huaja;
- librat e rrallë të cilët nuk jepen për huazim.

Në hapësirën e librave për fëmijë krijoni një rreth ku fëmijët do të mblidhen e do të dëgjojnë një histori të lexuar nga edukatori/ja. Gjatë rrugës së kthimit, fëmijët këngojnë këngët e mësuara.

Vlerësimi: Edukatori/ja sjelljen e fëmijëve në një ambient të ri të panjohur me parë dhe i përgëzon për sjelljen e mirë, pyetjet e bëra dhe mbajtjen e qetësisë.

Më shumë për të bërë: Ju mund t'i dërgoni ata në bibliotekën e qytetit, bibliotekën e institucionit parashkollor/shkollës, ose bibliotekën e shkollës më të afërt. Kjo ngjarje përkon edhe me ditën ndërkombëtare të librit.

Reflektimi: _____

Bëhu autor libri

Fusha kurrikulare:	Artet
Kurrikula lëndore:	Edukatë figurative
Tema nga plani dymujor:	Krijimet figurative
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):	I. 3, 5; II. 2, 3, 7; III. 1, 2, 3, 4, 6; IV. 4, 5; V. 5; VI. 6
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):	Artet: 1 Gjuhët dhe komunikimi: 1.2; 3.2 Matematikë: 5.1
Rezultati i të nxënit të temës:	Me materiale të ndryshme krijojnë dhe riciklojnë sipas fantazisë dhe imagjinatës, vizatojnë, ngjyrosin, modelojnë, shtypin, për tema të ndryshme që trajtohen në shkollë dhe jashtë saj, duke përdorur: format me ngjyra, pemët, lodrat dhe tema të lira ku shprehet imagjinata dhe kreativiteti i tyre individual.
Rezultatet e të nxënit të aktiviteteve:	<ul style="list-style-type: none"> • Krijon librin me ilustrime. • Komenton historinë para grupit.
Kriteret e suksesit:	<ul style="list-style-type: none"> • Krijoi librin me ilustrime. • Komento historinë para grupit.
Burimet dhe materialet:	Libra me ilustrime, materiale pune në fushën e artit, blloqe, materiale për dramatizim.
Integrimi ndërfaqor:	Gjuhë shqipe, matematikë.
Çështjet ndërkurrikulare:	Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.
Fjalë kyçe:	Autor/e libri, krijim i historisë, përcjellje e mesazhit, numri 10.
Organizimi i aktiviteteve:	<p>Në takimin e përbashkët, pas plotësimit të kalendarit, edukatori/ja fton fëmijët në lojën "Përcjell mesazhin". Kjo lojë i ndihmon fëmijët të kuptojnë rëndësinë e përcjelljes së mesazhit, si ndryshon ai. A mund të komunikojmë pa përdorur gjuhën e folur?</p> <p>Fëmijët kthehen në mënyrë të tillë që secili të ketë përpara shpinën e shoku/shoqes dhe fëmija i fundit në rreth vizaton në shpinën e tjetrit/tjetres një vizatim të thjeshtë, të cilin edukatori/ja ia thotë me zë të ulët. Ai/ajo "vizaton" me gisht në shpinën e shokut/shoqes që ka para dhe kështu vazhdojnë deri te fëmija i fundit, i cili do ta vizatojë në fletë atë çfarë ka perceptuar nga prekja në shpinën e tij/saj.</p> <p>Në fund kthehen në rreth dhe diskutojnë për lojën, si janë ndier fëmijët, nëse u përcoll mesazhi.</p> <p>Edukatori/ja paraqet para fëmijëve një libër me intonacionin e përshtatshëm ose ndonjë dramatizim të thjeshtë, me ndonjë kukull në dorë.</p>



Diskutoni për autorin e librit, si komunikon ai me lexuesit përmes historisë dhe mesazhit që përcjell. Fëmijëve u bëhet pyetja: “Po sikur edhe ne të provonim të krijojmë nga një histori fantastike, si mund ta nisim?”.

- Fëmijët do të provojnë të krijojnë librat e tyre, ku mund të vizatojnë historinë e tyre imagjinare, duke përdorur teknika të ndryshme artistike, si: vizatim, skicim, ngjyrosje, kolazh etj. Fëmijët do të ndërtojnë vet librat e tyre, edukatori/ja kujdeset që disa nga librat të kenë nga 10 fletë.

Fëmijët janë të lirë të zgjedhin formën dhe mënyrën e krijimit dhe paraqitjes së historisë së tyre. Pasi t’i kenë përfunduar historitë e tyre, i ndajnë me njëri-tjetrin, duke i prezantuar dhe ritreguar. Pasi fëmijët të kenë ritreguar historitë, edukatori/ja fton fëmijët të numërojnë se sa faqe kanë librat e tyre. Edukatori/ja fton fëmijët në lojën e përbashkët për njohjen me numrin 10.

Loja për njohjen e numrave

Materialet: kartat e numrave nga 0-9, muzikë.

Ecuria: vendosni kartat në rreth dhe vendosni muzikë. Fëmijët vallëzojnë dhe vijnë qark rrethit me numra. Kur muzika ndalet, fëmijët ngrijnë në vend dhe emërtojnë numrat që kanë pranë. Vazhdohet kështu disa herë dhe në fund, edukatori/ja rendit kartat e numrave në një vijë dhe numëron me fëmijët. Më pas, i pyet: “Me kartat që kemi këtu, a mund të krijojmë numrin që vjen në radhë?”. Kështu bën bashkimin e numrit 1 dhe 0; fëmijët njihen me numrin e ri “10”.

- Numërojnë objekte deri në numrin 10.
- Vizatojnë numrin në tabakatë me rërë.

Fëmijët mund të lihen të lirë të bëjnë zgjedhjen e tyre për punë të individualizuar rreth numrit të ri.

Në takimin e përbashkët mblidhemi për të bërë një përsëritje të aktiviteteve të ditës së sotme, duke i ndarë me grupin emocionet tona gjatë aktiviteteve të sotme, duke e ritreguar historinë e krijuar, se si e kanë zhvilluar atë, në sa hapa është ndërtuar, si dhe çfarë kanë paraqitur, çfarë teknike kanë përdorur etj.

Vlerësimi: Përmes vëzhgimit, edukatori/ja vlerëson punën individuale të fëmijëve për ndërtimin e historisë.

Më shumë për të bërë: Fëmijët mund të vizatojnë figura të animuara në numrin 10. Ju mund të ofroni edhe fletëzën e punës për numrin 10 për plotësim të pavarur. Fëmijët mund të krijojnë librin e tyre të numrave.

Reflektimi:

Libraria dhe biblioteka jonë

Fusha kurrikulare:	Jeta dhe puna
Kurrikula lëndore:	Shkathtësi për jetë
Tema nga plani dymujor:	Profesionet
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):	I. 3, 5; II. 2, 3, 7; III. 1, 2, 3, 4, 6; IV. 4, 5; V. 5; VI. 6
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):	Jeta dhe puna: 4.7.1 Gjuhët dhe komunikimi: 1.1; 1.6 Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti: 2.2 Matematikë: 3.1
Rezultati i të nxënit të temës:	Luan lojë me role, duke imituar një profesionist, shfaq prirjet e tij/saj për profesionin e parapëlqyer.
Rezultatet e të nxënit të aktiviteteve:	<ul style="list-style-type: none"> • Luan me role në këndin e bibliotekës dhe të librarisë. • Krijon mjetet e punës për lojën me role me materiale të ndryshme. • Ndjek udhëzimet për lëvizjet e duhura në rrugën për në librari.
Kriteret e suksesit:	<ul style="list-style-type: none"> • Luaj me role në këndin e bibliotekës dhe të librarisë. • Krijoi mjetet e punës për lojën me role me materiale të ndryshme. • Ndjek udhëzimet për lëvizjet e duhura në rrugën për në librari.
Burimet dhe materialet:	Fletëza e punës me monedha të libri i fëmijës, gërshërë, laps, fletë të bardha, arkë, lodër, libra të ndryshëm, lodra edukative.
Integrimi ndërfaqor:	Gjuhë shqipe, Matematikë, Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti.
Çështjet ndërkurrikulare:	Globalizimi dhe ndërvarësia.
Fjalë kyçe:	Librari, bibliotekë, lojë me role.
Organizimi i aktiviteteve:	<p>Në takimin e përbashkët në rreth, fëmijët kapen dorë për dorë, krijojnë një rreth të madh. Zgjidhni një këngë që fëmijët ta këndojnë në rreth dhe jepni udhëzime të ndryshme për t'i vënë në lëvizje nën ritmin e këngës, të bashkuar si një grup i vetëm.</p> <p>Rrethi i fëmijëve do të lëvizë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • gjashtë hapa jashtë rrethit; • pesë hapa brenda rrethit. • Rrethi rritet dhe lëviz dhjetë hapa djathtas; ndalet dhe pastaj dhjetë hapa majtas. • Uluni poshtë, ngrihuni lart. • Risni nivelin e vështirësive, duke i ndarë në dy rathë dhe duke dhënë udhëzime të ndryshme për të dy rathët në të njëjtën kohë. <p>Ju mund të risni edhe shpejtësinë e lëvizjeve dhe t'i ngadalësoni ato.</p>

Kështu, fëmijët gëzohen nga kërcimi në grup, bashkëpunimi me njëri-tjetrin, dhe aktivizohen fizikisht, duke u mbushur me energji për aktivitetet e radhës. Pas përfundimit, fëmijët ulen dhe diskutohet: "Çfarë forme formuam ne, kur u kapëm dorë për dore? Kë kishit pranë? Si jeni ndier kur ishit pjesë e rrethit të madh dhe kur ishit pjesë e rrethit më të vogël? Patët ndonjë vështirësi? Si është të marrësh udhëzime që kërkojnë bashkëpunim të të gjithë grupit? Ishte e vështirë kjo?"



Diskutohet me fëmijët për aktivitetet e bëra ditët paraprake; rikujtohen vizita dhe librat e ndërtuara dhe hapet tema ditore mbi bibliotekën e librarinë. Në klasë do të përgatishim dy kënde të lojës me role, një librari dhe një bibliotekë. Fëmijët do të kenë mundësi të zgjedhin lojërat.

Materialet: fletëza e punës me monedha te libri i fëmijës, gërshërë, laps, fletë të bardha, arkë lodër, libra të ndryshëm, lodra edukative dhe pajisje që i duhet një këndi të bibliotekës dhe librarisë.

Ecuria: Fëmijët presin me gërshërë monedhat në fletëzën e punës te libri i fëmijës, të cilat do t'i përdorin për shitblerje në librari, modelojnë karta anëtarësimi për në bibliotekë, pastaj modelojnë këndet e tyre të lojës, duke krijuar një ambient të përshtatshëm për bibliotekë dhe një për librari.

Fëmijët praktikojnë rolin e shitësit dhe të blerësit, të bibliotekarit dhe të lexuesit gjatë lojës. Me procesin e shitblerjes do të praktikojnë shkathtësitë matematikore me njohjen e numrave të parave dhe vënien në zbatim të mbledhje/zbritjes gjatë veprimeve me monedha. Ata do të ndryshojnë rolet herë pas here, duke praktikuar përvoja të ndryshme në role të ndryshme.



Vlerësimi: Fëmijët vëzhgohen gjatë marrjes së udhëzimeve për lëvizje në rreth. Vëzhgohet puna e fëmijëve në lojën me role për ndërveprim dhe bashkëpunim.

Më shumë për të bërë: Këndi i bibliotekës dhe librarisë mund të qëndrojë në klasë edhe për ditët në vijim, ku fëmijët mund të luajnë në kohën e tyre të lirë. Ata mund ta pasurojnë atë kohë pas kohe.

Reflektimi:

Ne fëmijët e botës


Fusha kurrikulare:	Shoqëria dhe mjedisi
Kurrikula lëndore:	Shoqëria dhe mjedisi
Tema nga plani dymujor:	Unë dhe të tjerët
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):	I. 3, 5; II. 3, 7, 8; III. 1, 3, 5; IV. 2; V. 2, 5, 6; VI. 1, 4, 6
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):	Shoqëria dhe mjedisi: 1.1.2 Gjuhët dhe komunikimi: 1.1; 1.4 Matematikë: 6.2 Shkencat e natyrës: 1
Rezultati i të nxënit të temës:	Dallon ndryshimet, si: mosha, gjinia dhe të përbashkëtat që janë ndërmjet tij dhe të tjerëve në familje dhe në shoqëri.
Rezultatet e të nxënit të aktiviteteve:	<ul style="list-style-type: none"> • Zbulon kartat me racat e ndryshme me anë të kujtesës. • Dallon ngjashmëritë dhe ndryshimet e dy vezëve.
Kriteret e suksesit:	<ul style="list-style-type: none"> • Zbulon kartat me racat e ndryshme me anë të kujtesës. • Dallo ngjashmëritë dhe ndryshimet e dy vezëve.
Burimet dhe materialet:	Loja "Multikulturore me memorie", një vezë e kuqe një e bardhë, një pjatë, plastelina, glob, enciklopedi, ngjyra, fletë A3, lojë tavoline me temë nga diversiteti mes njerëzve.
Integrimi ndërfaqor:	Gjuhë shqipe, Matematikë, Njeriu dhe natyra.
Çështjet ndërkurrikulare:	Edukimi për paqe.
Fjalë kyçe:	Diversitet, ndryshim, racë, ngjyrë, kulturë.
Organizimi i aktiviteteve:	Në takimin e përbashkët pas plotësimit të kalendarit, luhet "Loja multikulturore". Këtë lojë e gjeni të bashkëngjitur në shtojcën e librit të edukatorit/es.



Ecuria: Prisni lojën dhe plastifikojeni (për përdorim të shumëfishtë). Ju keni nga dy karta për secilën racë njerëzore, kështu, sigurohuni të përziemi mirë kartat dhe i vendosni në mes të rrethit, të kthyer prapa. Fëmijët, me radhë, do të hapin nga dy karta njëherësh. Nëse ato janë të njëjta, vendosen nga ana e kundërt dhe lihen të hapura. Nëse nuk kanë në dorë dy karta të njëjta, i kthejnë ashtu siç ishin për t'ia lënë radhën fëmijës tjetër. Gjatë hapjes së kartave, fëmijët ftohen të jenë të vëmendshëm për t'i mbajtur mend vendndodhjet e kartave, në mënyrë që të hapin të duhurat kur t'u vijë radha.

Pasi të kemi zbuluar të gjitha kartat, bashkërisht analizohen racat e ndryshme dhe pyeten fëmijë se çfarë paraqesin këto karta. Edukatori/ja vendos në rreth një glob dhe hap një enciklopedi, e cila flet për njerëzit në vende të ndryshme të botës.

Pas komenteve të fëmijëve, shpjegojmë ndryshimet e njerëzve në botë. "Ne jetojmë në një botë të madhe me shumë ngjyra, shumë kultura, tradita e ndryshime dhe prapëseprapë jemi të gjithë të njëjtë, kemi zemër që rreh, të gjithë ndihemi të lumtur e të mërzitur, të gjithë dashurojmë dhe brengosemi. Ne jemi të ndryshëm dhe të njëjtë, jemi të gjithë njerëz të planetit Tokë."



Eksperimenti me vezë

Materialet: një vezë e kuqe dhe një vezë e bardhë, një pjatë.

Ecuria: Tregoni vezët, pyesni fëmijët se çfarë shohin nga jashtë, dhe merrni mendimet e tyre se si mund të jenë nga brenda. Thyejeni vezët në një pjatë dhe kërkoni nga fëmijët t'i shohin me kujdes. "Siç janë vezët e ndryshme nga jashtë dhe të njëjta nga brenda, njësoj janë edhe njerëzit e botës: të ndryshëm nga jashtë dhe të njëjtë nga brenda. Lëkura jonë është vetëm një mbulesë, si një fletë mbështjellëse. Dhe ne nuk mund të vlerësojmë një njeri se çfarë është ai në bazë të ngjyrës së lëkurës. Të gjithë jemi banorë të planetit Tokë."

Edukatori/ja ka përgatitur 3 qendra të aktiviteteve:

- Fëmijët do të modelojnë njerëz me plastelinë dhe më pas do të luajnë me to.
- Fëmijët do të luajnë me lojën "Gjej dhe bashko" (edukatori/ja ka përgatitur një lojë tavoline ku ata do të bashkojnë fotografitë e ndara).
- Fëmijët do të punojnë një punim grupor përmes vizatimit me duar (përdor tone të ndryshme ngjyrash).

Në takimin e përbashkët mblidhemi për të bërë një përsëritje të ditës së sotme, duke vënë theksin te racat e ndryshme njerëzore, kulturat e ndryshme, doket dhe zakonet dhe të përbashkëtat e të gjithë njerëzve të botës. Rikujtoni eksperimentin me vezë dhe aktivitetet e tjera të zhvillura sot.

Vlerësimi:

Vlerësohet shkathtësia e fëmijës për të mbajtur mend, punimet e tyre me modelim plasteline dhe pjesëmarrja aktive në diskutim.

Më shumë për të bërë:

Diversiteti në fjalë është një temë mjaft komplekse për t'u thjeshtëzuar dhe kuptuar nga parashkollorët. Ai arrihet vetëm nëpërmjet aktiviteteve konkretizuese, andaj ju mund të përdorni metoda nga më të ndryshmet për konkretizim. Një mënyrë e mirë për të plotësuar këtë temë është edhe leximi i librave me ilustrime, të cilët përmbajnë personazhe të ndryshme.

Reflektimi:

Bota është shtëpia jonë e madhe

Fusha kurrikulare:	Jeta dhe puna
Kurrikula lëndore:	Shkathtësi për jetë
Tema nga plani dymujor:	Mjedisi shtëpiak, kopshti dhe shkolla
Rezultatet e të nxëniet për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):	I. 3, 5; II. 1. 8; III. 3, 5; IV. 2; V. 2, 5; VI. 1, 4, 6
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):	Jeta dhe puna: 1.1.4 Gjuhët dhe komunikimi: 1.1; 1.5; 3.2 Artet: 3
Rezultati i të nxëniet të temës:	Realizon aktivitete në bashkëpunim me të tjerët përmes lojës (gatuan ushqime, rregullon ambientin, përgatit tryezën).
Rezultatet e të nxëniet të aktiviteteve:	<ul style="list-style-type: none"> • Dallon karakteristikat e kulturave të ndryshme në botë. • Praktikon mënyra të ndryshme të të shprehurit artistik. • Kërcon nën tingujt e këngëve folklorike të shteteve të ndryshme.
Kriteret e suksesit:	<ul style="list-style-type: none"> • Dallo karakteristikat e kulturave të ndryshme në botë. • Praktiko thurjen, punën me argjilë dhe vizatimin me pika, zbulo cila është mënyra jote e shprehjes artistike. • Kërce nën tingujt e këngëve folklorike të shteteve të ndryshme.
Burimet dhe materialet:	Poster për paraqitjen e konceptit të kulturës, poster me ushqimet e vendeve të ndryshme, CD me muzikë ose mjete të tjera për të njëjtin qëllim (kompjuter, celular, tablet etj.), lista me përshëndetjet dhe ajo me ushqimet e vendeve të ndryshme të botës, argjilë, ngjyra, shkopinj me pambuk, pjata letre, fije peri.
Integrimi ndërfaqor:	Gjuhë shqipe, Edukatë muzikore.
Çështjet ndërkurrikulare:	Edukimi për paqe.
Fjalë kyçe:	Kulturë, ndryshim, traditë, muzikë folklor, veshje, ushqim.
Organizimi i aktiviteteve:	<p>Në takimin e përbashkët bëhet një përsëritje e shkurtër e ditës së kaluar, duke përsëritur popujt e ndryshëm që gjenden nëpër botë, se sa të ndryshëm dhe të ngjashëm jemi me njëri-tjetrin. Fëmijët nxiten të japin një vlerësim kritik për rezultatet e eksperimentit me vezë "Të ndryshëm nga jashtë, të njëjtë nga brenda". U përsëritet edhe një herë se "njerëzit nuk ndryshojnë vetëm nga pamja, ata kanë edhe kultura të ndryshme, në varësi të vendit ku jetojnë". Nga këto dallime arrijmë deri te koncepti "kulturë".</p> <p>"Çfarë është kultura?" Edukatori/ja paraqet para fëmijëve një poster të përshtatshëm për qartësimin e konceptit të kulturës dhe flet për:</p> <ul style="list-style-type: none"> • fëmijët në vendet e ndryshme të botës; • veshjet; • ushqimet; • muzikën;

- përshëndetjet;
- festat etj.

Diskutoni për kultura të ndryshme dhe këtë e bëni në formë të thjeshtë dhe të kuptueshme për fëmijët e kësaj moshe. Sigurohuni që shpjegimi juaj të jetë në formë të tregimit të një historie.

Ju mund të plotësoni konkretizimin e kulturave në mënyra të ndryshme, si:

- siguroni një listë me përshëndetje në gjuhë të ndryshme të botës;
- bëni një listë me fotografi të ndryshme të ushqimeve tradicionale;
- siguroni disa këngë tradicionale të vendeve të ndryshme dhe ftoni fëmijët të kërcëjnë nën ritmin e këtyre këngëve.

(Folklor shqiptar <https://www.youtube.com/watch?v=1xJuRbuwmNo>)

(Folklor afrikan <https://youtu.be/cYGIbyBfspY>)

(Folklor skocez <https://youtu.be/lpOoPQ6JmbM>)

(Folklor gjerman <https://youtu.be/8fCV2F6u5mU>)

Edukatori/ja vendos për kohëzgjatjen e secilës këngë në varësi të rrjedhës së aktiviteteve, për atë kohë sa fëmijët të kenë shijuar vallëzimin nën tinguj e folklorit të vendeve të ndryshme të botës. Edukatori/ja ka përgatitur tri kënde të aktiviteteve që ndërlidhen me kultura të ndryshme:

- fëmijët do të praktikojnë thurjen e qilimit (në një pjatë letre, hapin vrima të vogla, përmes së cilave krijohet një drejtëkëndësh për atë sa është pjata; nëpërmjet penjve praktikohet thurja);

- fëmijët do të krijojnë vazo dhe enë të ndryshme prej argjile;

- fëmijët do të praktikojnë vizatimin përmes pikave (Art me pika).

Në takimin e përbashkët bëjmë një përsëritje të ditës së sotme dhe përmbledhim karakteristikat e kulturave të ndryshme të botës. Bëhen përshëndetje përmbyllëse, duke sjellë në vëmendje fjalë përshëndetëse nga gjuhë të ndryshme.

Vlerësimi: Edukatori/ja mund të regjistrojë sekuenca të ndryshme të aktiviteteve, me qëllim vëzhgimi dhe dokumentimi.

Më shumë për të bërë: Në përputhje me ecurinë e aktiviteteve apo karakteristikave të grupit, ju mund të luani disa lojëra tradicionale të vendeve të ndryshme të botës. Kërkoni nga prindërit të bashkëbisedojnë me fëmijët për karakteristika të veçanta në kulturën tonë, por edhe në kulturat e tjera.

Reflektimi: _____

Festojmë të veçantat tona

Fusha kurrikulare:	Gjuhët dhe komunikimi
Kurrikula lëndore:	Gjuhë shqipe
Tema nga plani dymujor:	Tinguj, shkronja, rrokje, fjalë, fjali
Rezultatet e të nxëniet për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):	I. 3, 5; II. 3, 7, 8; III. 1, 2, 3, 6; IV. 2; V. 2, 5; VI. 1, 4, 6
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):	Gjuhët dhe komunikimi: 1.1; 1.2; 1.4; 1.5; 3.2 Artet: 3 Matematikë: 3.4
Rezultati i të nxëniet të temës:	Vizaton dhe modelon sipas modeleve me materiale të ndryshme, i emërton ato me fjalë dhe u tregon të tjerëve çfarë ka dashur të paraqesë ndërmjet vizatimeve, figurave.
Rezultatet e të nxëniet të aktiviteve:	<ul style="list-style-type: none"> • Dallon shenjat e gishtave të tij/saj. • Ilustron shenjat e stampimit të gishtave. • Modelon shkronjën "Dh".
Kriteret e suksesit:	<ul style="list-style-type: none"> • Dallo shenjat e gishtave të tij/saj. • Ilustro shenjat e stampimit të gishtave. • Modelo shkronjën "Dh".
Burimet dhe materialet:	Mbulesë e madhe shumëngjyrëshe, ngjyra të lëngshme, fleta, marker, plastelina, tabak me rërë, fletëza për shkronjën "Dh" te libri i punës për fëmijë.
Integrimi ndërfaqor:	Edukatë figurative, Matematikë.
Çështjet ndërkurrikulare:	Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.
Fjalë kyçe:	Tapet fluturues, ndryshime, ngjashmëri, pranim, i/e veçantë, shkronja "Dh".
Organizimi i aktiviteve:	Në takimin e përbashkët luajmë lojën "Tapeti fluturues". <i>Materialet:</i> një mbulesë e madhe shumëngjyrëshe. <i>Ecuria:</i> Të gjithë fëmijët ulen në "Tapetin fluturues", të cilin e kapin në kënde, dhe me anë të imagjinatës "fluturojnë" mbi shtete të ndryshme të botës, ku shohim vende dhe kultura të ndryshme, kafshë, kërcime, ushqime etj. Nxisni fëmijët të imagjinojnë vende të ndryshme të botës dhe të lëvizin me duar dhe trup sipas udhëtimit që janë duke bërë (kthehemi majtas, ktheni kursin djathtas, ngrihuni lart etj.). Pasi të ndalemi dhe të "zbrësim në tokë", u drejtohem fëmijëve: "Gjatë shëtitjes sonë me tapetin fluturues, pamë vende, kultura të ndryshme etj. Po ne që jemi në tapetin fluturues, a jemi të ndryshëm nga njëri-tjetri? Po. Nuk ndryshojnë vetëm kulturat në vende të ndryshme, por të gjithë ne jemi të ndryshëm dhe të veçantë, prandaj bota është e bukur, sepse ndryshimet tona e zbukurojnë atë, ne duhet të pranojmë njëri-tjetrin

bashkë me ndryshimet që kemi, dhe sot do të festojmë të veçantat tona.

Do të bëjmë punë artistike me gjurmët e gishtërinjve dhe do t'ia dhurojmë njëri-tjetrit si dhuratë, për të festuar të veçantat tona.

Dhuratat tona për njëri-tjetrin. Kur jemi te dhuratat, edukatori/ja vë theksin te tingulli "Dh"! Fëmijët gjejnë fjalë që fillojnë me shkronjën Dh, dhe njihen me modelin e shkronjës. Ju mund t'i organizoni disa aktivitete në kënde të ndryshme të klasës, që fëmijët të kenë mundësi të lëvizin në formë rotacioni, duke i provuar të gjitha aktivitetet.

Për të konkretizuar se secili nga fëmijët është i veçantë dhe se askush nuk është i njëjtë, realizoni disa aktivitete.

- Gjurmët e gishtërinjve:
- Fëmijët vizatojnë dorën e tyre, vendosin shenjat e gishtërinjve dhe i analizojnë ato me xhamin zmadhues.
- Krijimi i shkronjës "Dh" me stampim të gishtit.
- Modelimi i shkronjës me plastelina.
- Plotësimi i fletëzës së punës për shkronjën "Dh".
- Pikturojnë me anë të stampimit të gishtave.

Punimet e bëra i demonstrojnë dhe vizatimet artistike ia dhurojnë njëri-tjetrit.



Në takimin e përbashkët bashkëbisedojmë për ndryshimet dhe të veçantat tona, se si secili fëmijët është i ndryshëm, shohim shenjat e gishtave dhe fëmijët prezantojnë punimet e tyre me stampim, numërojnë shenjat e gishtave që kanë lënë dhe bëjnë një krahasim: më i madh, më i vogël etj.

Vlerësimi: Edukatori/ja mban shënime mbi observimin e bërë dhe nxit fëmijët të vetëvlerësojnë punën e tyre.

Më shumë për të bërë: Në përputhje me kushtet në ambientin tuaj, fëmijët mund të stampojnë edhe shputën e këmbës, dhe me gjurmët e saj të krijojnë figura artistike. Një aktivitet e tillë mund të realizohet edhe në shtëpi.

Reflektimi:

Ushqimet anekënd botës

Fusha kurrikulare:	Matematikë
Kurrikula lëndore:	Matematikë
Tema nga plani dymujor:	Njësitë matëse
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):	I. 3, 5; II. 1, 2, 3, 7, 8; III. 1, 3, 6; IV. 4; V. 2, 5; VI. 1, 4, 6
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):	Matematikë: 5.1 Gjuhët dhe komunikimi: 1.4; 1.6 Edukimi fizik, sportet dhe shëndeti: 1
Rezultati i të nxënit të temës:	Përdor monedhat nga 1-10 euro në situata jetësore, për blerje që lidhen me sasi të caktuar eurosh
Rezultatet e të nxënit të aktiviteteve:	<ul style="list-style-type: none"> Modelojnë me plastelinë ushqimet tradicionale të vendeve të ndryshme. Krahason sasinë e ushqimeve, ku ka më shumë dhe ku ka më pak, përgjatë lojës.
Kriteret e suksesit:	<ul style="list-style-type: none"> Modelo me plastelinë ushqimet tradicionale të vendeve të ndryshme. Krahaso sasinë e ushqimeve, ku ka më shumë dhe ku ka më pak, përgjatë lojës.
Burimet dhe materialet:	Poster/fotografi të ushqimeve tradicionale të shteteve të ndryshme, plastelina, pjata, gota, lugë, thika plastike, fletë me ngjyra, lapsa, gërshërë, ngjites, copëza materialesh ricikluese, kartat me numra.
Integrimi ndërfaqësor:	Gjuhë shqipe, Edukimi fizik, sportet dhe shëndeti.
Çështjet ndërkurrikulare:	Çështjet kulturore dhe ndërkulturore.
Fjalë kyçe:	Ushqim tradicional, shtete, të ndryshëm, të veçantë, restorant.
Organizimi i aktiviteteve:	<p>Dita fillon me përshëndetje të ngrohta dhe plotësimin e kalendarit. Këndohet një këngë mirëseardhjeje dhe edukatori/ja paraqet para fëmijëve disa fotografi me ushqime të kulturave/vendeve të ndryshme anekënd botës. Përsërisim njohuritë për kulturën e një vendi, duke theksuar se çdo vend ka gjuhën, muzikën, artin, humorin, veshjet tradicionale dhe gjithashtu kanë kuzhinën e tyre tradicionale. Duke iu referuar fotografive të ushqimeve tradicionale që keni vendosur në mes të rrethit, diskutoni me fëmijët për temat:</p> <ul style="list-style-type: none"> Secili vend ka ushqimet e veta tradicionale. Preferojnë shije specifike, dikush ushqime pikante, dikush ëmbëlsira, dikush oriz etj. Flisni për ushqimet e shteteve që ju vendosni t'i punoni sot në klasën tuaj, si p.sh.: picat italiane, sushi japonez, brioshi i Francës etj. <p>Rregulloni brenda klasës suaj përgatitore disa qendra për punimin e ushqimeve me plastelinë, siguron disa simbole të shteteve përkatëse</p>


në ato qendra, si: flamuri i shtetit, fotografi të ushqimeve tradicionale të tij, ndonjë shenjë identifikuese, që fëmijët të familjarizohen me karakteristikat e shtetit në fjalë.

Fëmijët do të jenë të lirë të lëvizin nga qendra në qendër duke pasur mundësi të provojnë përgatitjen e ushqimeve të secilit vend.

Materialet: plastelina (mund të jenë të gatshme ose të përgatitura vetë), flamuj të shteteve përkatëse, fotografi të ushqimeve tradicionale të tyre, pjata, thika, gota letre, fleta me ngjyra, copëza të materialeve ricikluese, laps, ngjyra, gërshërë, ngjitës, kartat e numrave.

Ecuria: Fëmijët ndahen në grupe dhe secili grup fillon punën në këndin e shtetit

përkatës, duke patur mundësi që pas përfundimit të punës të kalojnë te qendra tjetër. Ata nxiten për ndërveprim me njëri-tjetrin dhe punë të mirë në grup. Fëmijët përdorin monedhat nga fletëza e librit për të bërë shitjen dhe blerjen e ushqimeve.



Loja: "Rruga për në restorant"

Në fund të hapësirës së klasës suaj vendosni një tavolinë me ushqimet e përgatitura nga fëmijët, le të jetë një formë restoranti imagjinar. Fëmijët, duke mbajtur në duar ushqimin e përgatitur, do të ecin mbi viza të bëra me shirit ngjitës, për të praktikuar mbajtjen e balancës. Ju mund të rrisni nivelin e vështirësisë duke e rritur shpejtësinë e ecjes apo duke shtuar ndonjë element tjetër në të dyja duart e fëmijëve.

Në fund, në klasë mund të vendoset muzika e ndonjë prej vendeve nga vijën ato ushqime dhe fëmijët mund të vallëzojnë së bashku.

Vlerësimi:

Edukatori/ja mban shënime anekdotike dhe përmes planit të vlerësimit, observon punën e fëmijëve.

Më shumë për të bërë:

Ju mund të shihni bashkërisht videon me shembujt e drekës në shkollat e vendeve të ndryshme të botës.

<https://youtu.be/Po0O9tRXCyA>

Reflektimi:

Skuadra jonë e madhe

Fusha kurrikulare:	Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti
Kurrikula lëndore:	Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti
Tema nga plani dymujor:	Lëvizjet elementare dhe koordinimi i tyre
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):	I. 3, 5; II. 7, 8; III. 2, 3, 6, IV. 2; V. 2, 5; VI. 1, 4, 6
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):	Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti: 2.1 Gjuhët dhe komunikimi: 1.4; 2.2 Matematikë: 2.1
Rezultati i të nxënit të temës:	Merr pjesë në lojëra elementare dhe tregon shkathtësi gjatë poligoneve të thjeshta.
Rezultatet e të nxënit të aktiviteteve:	<ul style="list-style-type: none"> Nxjerr mesazhin nga vjersha "Fëmijët e botës". Luan lojëra ekipore sfiduese, duke iu referuar numërimit dhe njohjes së numrave.
Kriteret e suksesit:	<ul style="list-style-type: none"> Thuaj mesazhin nga vjersha "Fëmijët e botës". Luaj lojëra ekipore sfiduese, duke iu referuar numërimit dhe njohjes së numrave.
Burimet dhe materialet:	Një top me fije peri, vjersha "Fëmijët e botës", rrathë të mëdhenj, shami, balona, shirit ngjitës, qesja me misër, lopata plastike.
Integrimi ndërfaqor:	Gjuhë shqipe, Matematikë.
Çështjet ndërkurrikulare:	Globalizimi dhe ndërvarësia.
Fjalë kyçe:	Grup, të përbashkët, të ndryshëm, pranim, lojë, skuadër.
Organizimi i aktiviteteve:	<p>Në takimin e përbashkët pas plotësimit të kalendarit, edukatori/ja sjell në rreth një top me fije peri (mund të jetë top me shirit zbukurues apo diçka e ngjashme) dhe i drejtohet njërit prej fëmijëve me një pohim miqësor, p.sh.: sa me vlerë është shoqëria jonë, çfarë pëlqen te tjetri, apo si ne i pranojmë ndryshimet e njëri-tjetrit, e duam njëri-tjetrin ashtu siç jemi etj. Kështu fëmijët pasojnë topin duke dhënë komente te tilla dhe njëherazi topi krijon lidhje me fije nga fëmija në fëmijë. Në përfundim kemi një rrjetë lidhëse, që lidh secilin fëmijë me tjetrin, duke e bërë rrethin të bashkuar dhe fëmijët miq me njëri-tjetrin.</p> <p>Bashkëbisedohet për konceptet që kanë përdorur ata gjatë javës; flisni për diversitetin shoqëror, kulturat e ndryshme, për pranimin dhe tolerancën. Nxitni fëmijët të japin informata kthyesë për lojën në rreth, më së shumti duke bërë komente pozitive për njëri-tjetrin, për vlerat e gjithsecilit e për faktin se duhet t'i pranojmë miqtë për atë çka janë.</p> <p>Bashkërisht lexojmë dhe bisedojmë për vjershën "Fëmijët e botës".</p>

"Fëmijët e botës"

*Në këtë botë të madhe jetojnë aq shumë fëmijë,
dikush në Evropë, dikush në Afrikë,
dikush pranë kangurit në Australi,
ca tjerë shijojnë picat në Itali,
të ndryshëm nga jashtë por nga brenda të njëjtë
jetojmë në një botë, na ngroh i njëjti diell.*

Siguroni një hapësirë brenda klasës suaj, për disa lojëra në këndet e ndryshme të klasës ku fëmijët mund të argëtohen në secilin kënd, duke bërë vetë zgjedhjen.

Loja me numra

Materialet: numra nga 1-10 (plastike, letre, gome), një shirit ngjitës për të përcaktuar vizën e qëndrimit dhe një qese me misër.

Ecuria: Fëmija sistemohet pranë vizës në dysheme dhe gjuan qesen me misër në njërën nga hapësirat. Ai/ajo kërcen në njërën hapësirë me një këmbë dhe në hapësirën tjetër me dy këmbë. Këtë veprim e kryejnë duke numëruar numrat në të cilët kalon.

Loja: "Ec në linjë"

Materialet: shirit ngjitës, qesja me misër.

Ecuria: Bëni viza të çrregullta në dysheme dhe fëmijët do të ecin mbi të duke mbajtur balancën. Shtoni vështirësinë duke mbajtur një qese me misër në kokë gjatë ecjes në vijë, dhe duke e rritur shpejtësinë e ecjes.



Loja: "Grupi bashkëpunues"

Materialet: disa rrathë të mëdhenj plastikë, shami.

Ecuria: Fëmijët formojnë një grup me 5-6 pjesëtarë dhe kapen dorë për dore duke qëndruar në një linjë. Pastaj edukatorja lidh këmbët e një nxënësi me një tjetër, në mënyrë që fëmijët të ecin në një rresht me rrathë plastikë, duke shkelur në mes të hapësirave pa i prekur rrathët. Kështu fëmijët do të bashkëpunojnë duke i siguruar grupit fitoren. Kjo lojë nxit punën ekipore dhe rrit energjinë pozitive të skuadrës.



Loja: "Bart balonat me lopata"

Materialet: rrathë plastikë, lopata plastike, balona.

Ecuria: Vendosni disa balona brenda rrathëve dhe ftoni fëmijët t'i kapin ato me dy lopata dhe t'i bartin në një kënd tjetër të klasës.



Pas përfundimit të lojërave, fëmijët çlodhen me muzikë të qetë dhe vazhdojnë me punë individuale: Plotësimi i fletëzës për përsëritjen e shkronjave të mësuara dhe lojëra tavoline të cilat janë përgatitur nga edukatori/ja.

Në takimin e përbashkët mblidhemi dhe tregojmë se çfarë ka ndodhur gjatë punës ekipore, në skuadër, në çift dhe individuale.

Nxitni fëmijët të shprehen si janë ndierë kur fiton skuadra dhe sa mirë është kur skuadra të përkrah. Nëse ka pasur ndonjë situatë që ndonjë fëmijë është ndier i pa pranuar në lojë, shtjelloni këtë situatë, duke nxitur empatinë mes fëmijëve.

Vlerësimi:

Edukatori/ja mban shënime narrative për disa fëmijë gjatë realizimit të lojërave fizike. Dokumenton aktivitetet përmes videoinçizimeve dhe fotografive.

Më shumë për të bërë:

Lojërat mund të zhvillohen edhe jashtë, në varësi të motit. Për më shumë lojëra në grup dhe individuale referojuni linkut më poshtë:
<https://www.pre-kpages.com/indoor-recess-games-and-activities-for-preschoolers/>

Reflektimi:

Njerëz të ndryshëm...

Profesione të ndryshme!

Fusha kurrikulare:	Gjuhët dhe komunikimi
Kurrikula lëndore:	Gjuhë shqipe
Tema nga plani dymujor:	Tinguj, shkronja, rrokje, fjalë, fjali
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):	I. 3, 7; II. 1; III. 1, 2, 4; IV. 3, 4, 6; V. 2, 5; VI. 1, 4, 6
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):	Gjuhët dhe komunikimi: 1.1; 1.4; 1.5 Matematikë: 3.4 Artet: 1
Rezultati i të nxënit të temës:	Lexojnë dhe interpretojnë ilustrime, fotografi, figura dhe objekte me fjalë e fjali të thjeshta.
Rezultatet e të nxënit të aktiviteteve:	<ul style="list-style-type: none"> • Përshkruan profesionin e prindërve dhe profesione të tjera. • Modelon me materiale të ndryshme grafikun e shkronjës "NJ".
Kriteret e suksesit:	<ul style="list-style-type: none"> • Përshkruaj profesionin e prindërve dhe profesionet e tjera. • Modelo me materiale të ndryshme grafikun e shkronjës "NJ".
Burimet dhe materialet:	Libër që flet për profesionet ose fotografi ilustruese të profesioneve, materiale të ndryshme (guralec, penj, kapak, fasule, letër gërryerse, miell etj.), libri i fëmijës, ngjyra.
Integrimi ndërfaqor:	Matematikë, Edukatë muzikore.
Çështjet ndërkurrikulare:	Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.
Fjalë kyçe:	Profesione, njerëz, shkronja "NJ".
Organizimi i aktiviteteve:	<p>Dita fillon me përshëndetjen me fëmijët, formimin e rrethit, ndërrimin e kalendarit. Fëmijët nisin lojën: "Shok/Shoqe, eja të kërcejmë!" (Teksti dhe udhëzimet e së cilës janë dhënë; edukatori/ja tashmë i ka të njohura). Fëmijët ulen në rreth dhe qetësohen për disa minuta. Para fëmijëve sillen një kutizë, ku ka fotografi ose ilustrime të profesioneve të ndryshme. Secili prej tyre tërheq nga një ilustrim e më pas diskutohet për çka shohin në të. Në këtë mënyrë, fëmijët do të njihen me një mori profesionesh. Edukatori/ja gjithmonë krijon mundësi që fëmijët të shtojnë edhe profesione të tjera, që ata i dinë, por nuk janë të përfshira në listë.</p> <p>Nga të gjitha profesionet e përmendura, edukatori/ja kërkon nga fëmijët që bashkërisht të hartojnë një listë të profesioneve për të cilat ata do të dëshironin të dinin më shumë. (Në varësi të nevojave dhe interesave të fëmijëve, planifikohen ditët në vijim.)</p> <p>Edukatori/ja fton fëmijët për një shëtitje në mjediset e institucionit/shkollës për t'u njohur me profesionet e ndryshme që zhvillohen brenda</p>

të njëjtit mjedis. Për këtë arsye vizitojnë dhomën e edukatoreve/sallën e mësimdhënësve, personave administrues të institucionit/shkollës, kuzhinën e institucionit/mensën e shkollës, bibliotekën e institucionit/shkollës.

Fëmijët kthehen në klasë dhe ai/ajo pyet fëmijët që të japin mendimet e tyre për profesionet në mjedisin e institucionit/ shkollës. Njerëzit të ndryshëm, profesione të ndryshme, çfarë kanë të përbashkët të gjitha fotografit që i kishim në takim, (njerëzit) pas zbulimit të tingullit do të kërkojmë të gjejnë fjalë me këtë tingull, dhe paraqesim grafikun e shkronjës "NJ".

Më tej, fëmijët ndahen në katër grupe të vogla për të zhvilluar aktivitetet e mëposhtme:

- Praktikojnë grafikun e shkronjës në tabaka me rërë, në letër gërryese etj.
- Formojnë shkronjën me blloqe, kapakë shishesh, fasule, oriz apo shkopinj.
- Me materiale të ripërdorueshme, fëmijët do të krijojnë kukulla të vogla që i përgjigjen profesioneve të ndryshme.
- Plotësojnë fletëzën e punës të shkronja "NJ".

Në takimin përmbyllës, fëmijët ulen në rreth dhe diskutojmë së bashku për ato që bënë sot. Ata vendosin se për cilat profesione do të diskutojnë në ditët në vazhdim.

Vlerësimi:

Edukatori/ja fotografon punimet e fëmijëve të cilat mund t'i përdorë për reflektim dhe dokumentim.

Më shumë për të bërë:

Ftohet një prind vullnetar për ditën në vijim për të prezantuar punën e tij/saj para fëmijëve. Fëmijët mund të sjellin ilustrime të ndryshme nga fletushkat për profesionet. Loja me sajuese mund të ndërtohet nga vetë edukatori/ja me fotografi të ndryshme. Është shumë e rëndësishme që fëmijëve t'u ofrohet një gamë e gjerë e sajueseve, kjo nxit interesin e tyre për njohje më të thellë.

Reflektimi:

Puna e të rriturve

Fusha kurrikulare:	Artet
Kurrikula lëndore:	Edukatë figurative
Tema nga plani dymujor:	Krijimet figurative
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):	I. 3, 8; II. 3, 7; III. 1, 2, 3, 6, 7; IV. 3, 4; V. 1, 5; VI. 1, 6
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):	Artet: 1 Gjuhët dhe komunikimi: 1.1; 1.6 Matematikë: 3.4
Rezultati i të nxënit të temës:	Me materiale të ndryshme krijojnë dhe riciklojnë sipas fantazisë dhe imagjinatës, vizatojnë, ngjyrosin, modelojnë, shtypin, për tema të ndryshme që trajtohen në shkollë dhe jashtë saj, duke përdorur: format me ngjyra, pemët, lodrat edhe tema të lira ku shprehet imagjinata dhe kreativiteti i tyre vetjak.
Rezultatet e të nxënit të aktiviteve:	<ul style="list-style-type: none"> • Përshkruan profesionin e mjekut. • Pret me gërshërë ilustrimet që paraqesin një profesion. • Ngjit dhe krijon albumin e profesioneve.
Kriteret e suksesit:	<ul style="list-style-type: none"> • Përshkruaj profesionin e mjekut. • Prit me gërshërë ilustrimet që paraqesin një profesion. • Ngjit dhe krijo albumin e profesioneve.
Burimet dhe materialet:	Mjetet të punës të mjekësi, farmaci, stomatologji, fletushka, fletë të bardha, gërshërë, ngjitës.
Integrimi ndërfaqor:	Gjuhë shqipe, Matematikë.
Çështjet ndërkurrikulare:	Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.
Fjalë kyçe:	Profesion, mjekësi, farmaci, stomatologji, ngjyra, fletushka, ngjitës, fleta A4 etj.
Organizimi i aktiviteve:	<p>Dita fillon me përshëndetjen me fëmijët, formimi i rrethit, loja "Gjeje cili/a jam". Fëmijët janë të ulur në gjysmërreth, njëri është udhëheqësi i lojës dhe ai, pa folur, do të imitojë ndonjë profesion, kurse të tjerët do të zbulojnë; kush përgjigjet saktë, vazhdon si udhëheqës.</p> <p>Edukatori/ja ka ftuar në institucionin parashkollor/shkollën një prind vullnetar/e, me profesionin e mjekut, e cila ka marr mjete të punës me vete.</p> <p>I/e ftuari/a paraqet përpara fëmijëve të veçantat e profesionit të tij, rëndësinë e mjekut në jetën e njëjzve dhe iu flet për kujdesin ndaj shëndetit. Ai/a jo bënë kontrollimin e fëmijëve, duke i demonstruar funksionet e mjeteve që ka sjellë me vete.</p> <p>Përmes bashkëbisedimit dhe pyetjeve nga fëmijët zhvillohet diskutimi.</p>

Dita vazhdon nëpër qendrat e aktiviteteve ku fëmijët do të:

- luajnë lojëra me role, ku do të praktikojnë profesionin e mjekut;
- krijojnë albumin me profesione të ndryshme duke prerë dhe ngjitur fotografi nga fletushkat e ndryshme;
- luajnë lojëra tavoline (edukatori/ja ka përgatitur fletëza të plastifikuara për profesionet dhe mjetet e punës, fëmijët do të bashkojnë profesionin me mjetin përkatës).

Në takimin përmbyllës, secili nga fëmijët do të tregojë për pjesën e parapëlqyer të ditës.

Vlerësimi: Edukatori/ja vëzhgon fëmijët përgjatë lojës dhe mban shënime anekdotike.

Më shumë për të bërë: Ju mund të ftoni prindër të tjerë në varësi të profesioneve që kanë. Edukatorët/et gjatë kësaj jave mund të planifikojnë në varësi të nevojave të grupit dhe mundësisë që kanë prindërit për punë vullnetare në institucion. Së bashku me prindërit, ju mund të organizoni një vizitë në Qendrën e Zjarrfikësve, Stacionin Policor, në ambulancën e qytetit, në një bankë etj.

Reflektimi:

Zjarrfikësit

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi

Kurrikula lëndore: Shoqëria dhe mjedisi

Tema nga plani dymujor: Vendi/mjedisi ku jetoj

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): **I.** 3, 8; **II.** 8; **III.** 3; **IV.** 3, 4; **V.** 2, 5; **VI.** 1, 6, 7

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): Shoqëria dhe mjedisi: 2.2.1
Gjuhët dhe komunikimi 1.1; 1.4; 1.6
Shkencat e natyrës: 1
Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti: 1

Rezultati i të nxënit të temës: Tregon për profesionet e anëtarëve të familjes dhe personave që njeh.

Rezultatet e të nxënit të aktiviteteve:


- Përshkruan profesionin e zjarrfikësit.
- Tregon numrin e Qendrës së zjarrfikëseve - 193.
- Identifikon mjetet e shuarjes së zjarrit.

Kriteret e suksesit:	<ul style="list-style-type: none"> • Përshkruaj profesionin e zjarrfikësit. • Trego numrin e Qendrës së Zjarrfikëseve - 193. • Identifiko mjetet e shuarjes së zjarrit.
Burimet dhe materialet:	Qendra e zjarrfikëseve, mjetet për shuarjen e zjarrit.
Integrimi ndërfaqor:	Gjuhë shqipe, Njeriu dhe natyra, Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti.
Çështjet ndërkurrikulare:	Globalizimi dhe ndërvarësia.
Fjalë kyçe:	Zjarrfikës, mjete, rrezik, dobi, reagim etj.
Organizimi i aktiviteteve:	<p>Dita fillon me përshëndetjen me fëmijët dhe prindërit vullnetarë. Prindërit vullnetarë, së bashku me edukatorin/en, do të vizitojnë Qendrën e zjarrfikëseve në mënyrë të organizuar.</p> <p>Fëmijët, së bashku me edukatorin/en dhe prindërit, priten nga stafi i zjarrfikëseve dhe njihen nga afër me këtë profesion.</p> <p>Zjarrfikësit u flasin fëmijëve për:</p> <ul style="list-style-type: none"> • profesionin e zjarrfikësit; • dobitë dhe rreziqet që vijnë nga zjarri; • mjetet që shërbejnë për shuarjen e zjarrit; • rregullat që duhet të respektohen për të shmangur zjarrin; • çfarë veprimesh duhet të merren në rast zjarri; • numrin e telefonit të zjarrfikëseve 193. <p>Gjatë kësaj kohe, fëmijët pyesin dhe marrin përgjigje nga zjarrfikësit. Pas vizitës dhe marrjes së informacioneve të rëndësishme, falënderojnë stafin e qendrës. Fëmijët do të bëjnë pyetje rreth pajisjeve, do të provojnë disa prej tyre e do të praktikojnë lëvizjet mbrojtëse të mësuara kohë më parë në rast se bie zjarr, do të përpiqen të mbajnë mend numrin e zjarrfikësve dhe masat e sigurisë kundër rënies së zjarrit.</p>
Vlerësimi:	Edukatori/ja mund të mbajë shënime të shkurtra gjatë vizitës, në mënyrë që t'i përdorë për vlerësim e dokumentim.
Më shumë për të bërë:	Edukatori/ja mund t'u kërkojë fëmijëve të vizitojnë kostumin e një zjarrfikësi, apo sende të tjera që shërbejnë për fikjen e zjarrit.
Reflektimi:	_____



Kur të rritem, dua të bëhem...

Fusha kurrikulare:	Jeta dhe puna
Kurrikula lëndore:	Shkathtësi për jetë
Tema nga plani dymujor:	Profesionet
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):	I. 3, 7; II. 1, 2; III. 2, 6; IV. 4, 5, 6; V. 2, 5; VI. 1, 4, 6, 7
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):	Jeta dhe puna: 4; 7; 7.1 Gjuhët dhe komunikimi: 1.1; 1.6 Matematikë: 3.5
Rezultati i të nxënit të temës:	Luan me role, duke imituar profesionistët, shfaq prirjen e tij/saj për profesionin e parapëlqyer.
Rezultatet e të nxënit të aktiviteteve:	<ul style="list-style-type: none"> • Përshkruan rolin e profesionit të përzgjedhur. • Luan rolin sipas ilustrimit që ka zgjedhur.
Kriteret e suksesit:	<ul style="list-style-type: none"> • Përshkruaj rolin profesionit të përzgjedhur. • Luaj rolin sipas ilustrimit që ke zgjedhur.
Burimet dhe materialet:	Ilustrime të ndryshme, mjete të ndryshme të profesioneve, të cilat i kanë në institucion.
Integrimi ndërfaqor:	Gjuhë shqipe, Matematikë.
Çështjet ndërkurrikulare:	Globalizimi dhe ndërvarësia.
Fjalë kyçe:	Profesion, floktare, bukëpjekës, inxhinier, infermiere.
Organizimi i aktiviteteve:	<p>Dita fillon me përshëndetjen e përbashkët, të cilën edukatori/ja e ndryshon çdo ditë. Plotësohet kalendari dhe pastaj fillon loja: Hapet-mbyllet". Bëhet një përsëritje për ditën e kaluar, çfarë u ka pëlqyer më shumë te profesioni i zjarrfikësve, diskutohet për të. Edukatori/ja paraqet ilustrime të profesioneve të ndryshme, që mund të përgatiten në PowerPoint dhe fëmijët do të përshkruajnë secilin ilustrim individualisht; do të tregojnë cilin profesion pëlqejnë dhe çfarë duan të bëhen kur të rriten.</p> <p>Aktivitetet e tjera vazhdojnë me lojëra me role, ku edukatori/ja ka improvizuar paraprakisht qendra të ndryshme, si: arkitekt/e, bukëpjekës/e, inxhinier/e, infermier/e, polic/e.</p> <p>Fëmijët ndahen në grupe të vogla ku secili grup do të luajnë lojëra me role, në varësi të qendrave të profesioneve përkatëse.</p> <p><i>Arkitekt/e</i> - me letër, blloqe, shpageta e materiale të tjera; fëmijët do të konstruktajnë në grup ndërtesa të ndryshme.</p> <p><i>Bukëpjekës/e</i> - improvizohet një kuti në vend të furrës dhe mjete të ndryshme apo edhe pak miell; të gjitha këto vendosen te këndi i kuzhinës.</p>



Inxhinier/e, ndërtues/e - fëmijët, në grup, do të konstruktojnë një urë, kriteri është që ura duhet të mbajë 5 lodrat e vogla që gjenden në tavolinën e punës (kafshë, njerëz me madhësi 2-3 cm).

Infermier/e - gjëra që kanë të bëjnë me fushën e mjekësisë, kutia e ndihmës së shpejtë, stereoskop, fashë etj.

Policë/e - rroba të policisë, makina etj.

(Të gjitha rolet e luajtura duhet të jenë të bazuar në nevojat e fëmijëve për njohjen me profesionet e caktuara.)

Në takimin përmbyllës, fëmijët do të kthehen prapë në rreth e do të bisedojmë si e kanë kaluar ditën, çfarë u ka pëlqyer më shumë dhe cilat ishin karakteristikat e secilit profesion, bazuar në rolet që luajtën.

Vlerësimi: Edukatori/ja vëzhgon fëmijët gjatë lojës me role dhe mban shënime anekdotike për disa prej tyre.

Më shumë për të bërë: Kërkoni nga prindërit të ndihmojnë fëmijët të marrin të dhëna nga anëtarët e familjes për profesionet e tyre, duke i paraqitur me vizatime në formë tabelore, apo në formatin që ata kanë dëshirë.

Reflektimi: _____

Zbulo të veçantat e profesioneve

Fusha kurrikulare: Matematikë

Kurrikula lëndore: Matematikë

Tema nga plani dymujor: Puna me të dhëna

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): **I.** 3, 5; **II.** 1, 2, 3, 7; **III.** 1, 2, 3, 4, 6; **IV.** 2; **V.** 2, 5; **VI.** 1, 4, 6

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): Matematikë: 3.1
Gjuhët dhe komunikimi: 1.1; 1.7
Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti: 1

Rezultati i të nxënit të temës: Vendos të dhëna të thjeshta me vizatime të grumbulluara nga përditshmëria.

Rezultatet e të nxënit të aktiviteteve:

- Vendos vizatimin në vendin përkatës.
- Ngjyros aq kutiza sipas figurave në ilustrim.
- Krahason të dhënat, duke numëruar.

Kriteret e suksesit:

- Vendos vizatimin në vendin përkatës.
- Ngjyros aq kutiza sipas figurave në ilustrim.
- Krahaso të dhënat, duke numëruar.

Burimet dhe materialet:

Ilustrime të profesioneve të ndryshme, librat e fëmijës, ngjyra.

Integrimi ndërfaqor:

Gjuha shqipe, Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti.

Çështjet ndërkurrikulare:

Çështjet kulturore dhe ndërkulturore.

Fjalë kyçe:

Profesion, mjek, mësues, bankier, bujk, shitës, kuzhinier, rrobaqepës, shkencëtar etj.

Organizimi i aktiviteteve:

Dita fillon me takimin përshëndetës, e më pas edukatori/ja, kërkon nga fëmijët të mblidhen në rreth. Fëmijët do të luajnë "Lojën e kujtesës". Edukatori/ja ka printuar dy fotografi të njëjta për disa profesione; ato vendosen në anën e kundërt, në dysheme, në mes të rrethit, dhe fëmijët ndahen në dy grupe. Nga secili grup vjen një fëmijë, i cili kthen dy fotografi, i shikon ato dhe nëse janë të njëjta, i lë të hapura. Kur rastis të jenë dy fotografi të ndryshme, fëmija i kthen prapë ato për t'ia lënë radhën shokut/shoqes. Kështu loja vazhdon derisa të zbulohen të gjitha fotografitë.



Kur t'i kemi të gjitha fotografitë e zbuluara, kemi mundësi të fillojmë diskutimin mbi profesionet e ndryshme.

Pasi fëmijët japin mendimet e tyre, edukatori/ja paraqet në tabelë ilustrime të profesioneve të ndryshme, të cilat i simbolizojnë me ngjyra të ndryshme të përzgjedhura nga fëmijët. Fëmijët do marrin ngjyrën që simbolizon profesionin e preferuar (p.sh.: mjeku me ngjyrë portokalli, e bardha për shkencëtarin e kështu me radhë, në varësi nga profesionet që kanë zgjedhur fëmijët) dhe do ta vendosin në tabelë. Mblidhen të dhënat e të gjithë fëmijëve individualisht dhe pastaj do të numërohet e do të krahasohet se cili profesion pëlqehet më shumë e cili më pak.

Në fund, fëmijët punojnë në fletëzat e librit të punës, duke plotësuar pjesën që ka të bëjë me grumbullimin e të dhënave. Ata/ato që përfundojnë më shpejt, do të luajnë lojëra tavoline në këndin e lojërave të lira. Ju mund të shfrytëzoni edhe këndet e profesioneve që janë ngritur ditë më parë për të zhvilluar aktivitete dhe lojëra. Në takimin përmbyllës këndojmë një këngë ritmike dhe përshëndetemi.

Vlerësimi:

Edukatori/ja vëzhgon fëmijët bazuar në planin e vlerësimit. Ai/ajo gjithashtu mban shënime për ditarin reflektiv.

Më shumë për të bërë:

Kërkon nga prindërit të nxisin fëmijët të eksplorojnë profesione të ndryshme, të cilat mund të jenë edhe të panjohura për ta. Tregojuni të veçantat e secilit profesion dhe mjetet që duhen për ushtrimin e një profesioni të caktuar.

Reflektimi:

Transporti

Fusha kurrikulare:	Shoqëria dhe mjedisi
Kurrikula lëndore:	Shoqëria dhe mjedisi
Tema nga plani dymujor:	Kujdesi për mjedisin rrethues
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):	I. 3, 7; II. 1, 4; III. 1, 2, 4; IV. 2, 3, 4, 6; V. 2, 5; VI. 1, 4, 6
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):	Gjuhët dhe komunikimi: 1.4; 1.7 Artet: 2 Njeriu dhe natyra: 3.1 Shoqëria dhe mjedisi: 5.2
Rezultati i të nxënit të temës:	Diskuton për mënyrat e udhëtimit dhe ndikimin e tyre në mjedisin rrethues (transporti publik dhe privat).
Rezultatet e të nxënit të aktiviteteve:	<ul style="list-style-type: none"> • Tregon shembuj nga jeta e përditshme për mjetet e udhëtimit. • Vendos në vendin përkatës automjetin që ke në dorë. • Zbulon automjetin duke dëgjuar tingullin.
Kriteret e suksesit:	<ul style="list-style-type: none"> • Trego shembuj nga jeta e përditshme për mjetet e udhëtimit. • Vendos në vendin përkatës automjetin që ke në dorë. • Zbulon automjetin, duke dëgjuar tingujt përkatës.
Burimet dhe materialet:	Ilustrime (fotografi) të mjeteve të transportit aq sa është numri i fëmijëve (nga dy njëjta), fletë e madhe, e bardhë (A0), ngjitës, gërshëra, libri i fëmijës, CD, radio.
Integrimi ndërfaqor:	Gjuhë shqipe, Edukatë muzikore, Njeriu dhe natyra.
Çështjet ndërkurrikulare:	Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.
Fjalë kyçe:	Mjet, udhëtim, transport, tokësor, ujqor, ajror, makina, biçikleta, anije, aeroplan, helikopter.
Organizimi i aktiviteteve:	<p>Edukatori/ja fillon takimin me përshëndetjen dhe krijimin e një klime pozitive, ku secili fëmijë do të tregojë se si ka kaluar gjatë fundjavës. Pas plotësimit të kalendarit, edukatori/ja fton fëmijët në një lojë të përbashkët.</p> <p>Ecuria e lojës:</p> <p>Edukatori/ja ka përgatitur paraprakisht fotografi ilustruese të mjeteve të ndryshme të transportit dhe të vendosura të gjitha në një kuti, ua shpërndan fëmijëve (motor, makinë, tren, anije, aeroplan, helikopter, biçikleta etj.). Letrat janë dy nga dy të njëjta, kështu fëmijët do të lëvizin në rreth dhe do të gjejnë shokun/shoqen me të cilin kanë ilustrimin e përbashkët.</p> <p>Më pas, dy fëmijë do të imitojnë lëvizjen e atij mjeti udhëtimi, në mënyrë që të tjerët ta kuptojnë për çfarë mjeti bëhet fjalë.</p>

Edukatori/ja sjell në mes të rrethit një fletë A0 dhe kërkon nga fëmijët të afrohen dhe të vendosin njërën nga ilustrimet që ata kanë në rubrikën përkatëse në ndarjet: Ujë, Ajër, ose Tokë.

Kështu fitojmë një ndarje të mjeteve tokësore, ujore dhe ajrore. Me këtë ndarje të mjeteve të udhëtimit, arrijmë të konkretizojmë mënyrat e ndryshme përmes së cilave njerëzit udhëtojnë.

Shpjegohet çfarë do të thotë fjala "transport", përse u shërben njerëzve etj.

Shpjegohen llojet e mjeteve lëvizëse (makina të posaçme që na ndihmojnë në situata të vështira, emergjencat si policia, ambulanca, zjarrfikësit).

Edukatori/ja kërkon nga fëmijët të japin shembuj nga jeta e përditshme kur kanë udhëtuar, me çfarë kanë udhëtuar, me cilin mjet do të dëshironin të bënin shëtitje etj. Dita vazhdon me punë në grupe të vogla:

- ndërtim me blloqe dhe materiale të tjera;
- puna në fletëzat e punës "Mjetet e transportit";
- ndërtimi i sajueseve për mjetet e transportit.

Pasi fëmijët të kenë përfunduar, mbledhen në rreth, edukatori/ja vendos një CD me tinguj të mjeteve të ndryshme të transportit dhe fëmijët do të dallojnë se për cilin mjet bëhet fjalë. Përsëritet aktiviteti ditë dhe bëhet përsëritja e fundit për t'u larguar.

Vlerësimi: Përmes planit të vëzhgimit, edukatori/ja bën vlerësimin e disa prej fëmijëve gjatë aktivitetit në dyshe apo punës individuale.

Më shumë për të bërë: Kërkoni që fëmijët të pyesin gjyshërit e tyre se si kanë udhëtuar njerëzit në të kaluarën, dhe t'u tregojnë histori për mënyrat e udhëtimit kur ishin të vegjël. Po ashtu kërkoni nga prindërit të sjellin materiale të ripërdorshme, të cilat mund t'ju duhen gjatë ditës së nesërme.

Reflektimi: _____

Mjeti im i preferuar

Fusha kurrikulare:	Artet
Kurrikula lëndore:	Edukatë figurative
Tema nga plani dymujor:	Elementet bazike të gjuhës artistike
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):	I. 3, 7; II. 1, 4; III. 1, 2, 4; IV. 2, 3, 4, 6; V. 2, 5; VI. 6
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):	Artet: 2 Gjuhët dhe komunikimi: 1.2; 1.3; 1.4 Matematikë: 6.1
Rezultati i të nxënit të temës:	Me materiale të ndryshme krijojnë dhe riciklojnë sipas fantazisë dhe imagjinatës, vizatojnë, ngjyrosin, modelojnë, shtypin, për tema të ndryshme që trajtohen në shkollë dhe jashtë saj, duke përdorur: format me ngjyra, pemët, lodrat dhe tema të lira ku shprehet imagjinata dhe kreativiteti i tyre vetjak.
Rezultatet e të nxënit të aktiviteteve:	<ul style="list-style-type: none"> • Përshkruan modelin që ka përzgjedhur. • Krijon modelin e përzgjedhur të mjetit të transportit. • Eksperimenton me mjetet e ndërtuara, duke i përdorur ato në lojë.
Kriteret e suksesit:	<ul style="list-style-type: none"> • Përshkruaj modelin që ke përzgjedhur. • Krijoi modelin e përzgjedhur të mjetit të transportit. • Eksperimento me mjetet e ndërtuara, duke i përdorur ato në lojë.
Burimet dhe materialet:	“Libri i gabimeve” nga Xhani Rodari, letra me ngjyra, ngjites, gërshërë, enë e madhe me ujë, kuti kartoni, shishe plastike, kapak të madhësive të ndryshme, cilindër letre, shkopinj etj.
Integrimi ndërfaqor:	Gjuhë shqipe, Matematikë.
Çështjet ndërkurrikulare:	Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.
Fjalë kyçe:	Anije, veturë, aeroplan, lumë, qiell, rrugë, hekurudhë.
Organizimi i aktiviteteve:	<p>Dita fillon me përshëndetjen me fëmijët, bashkërisht plotësohet kalendari; në rreth, edukatori/ja kërkon nga fëmijët të propozojnë një lojë. Përzgjidhet loja e parapëlqyer e shumicës. Më pas, edukatori/ja u lexon fëmijëve tregimin “Gomari që fluturon” (nga librin “Libri i gabimeve” nga Xhani Rodari. Ju mund të lexoni tregime të tjera me tematikë të njëjtë). Pas leximit, edukatori/ja nxit fëmijët përmes pyetjeve: “Ku u zhvillua ngjarja? Për kë flitet? Po gomari, si fluturoi? Kush i shpëtoi nga uji?”</p> <p>Fëmijët shprehen me fjalët e tyre e më tej edukatori/ja u rikujton edhe një herë punën e ditës së kaluar, gjatë së cilës klasifikuan mjetet e transportit në ato tokësore, ujore dhe ajrore. Më pas kërkon që fëmijët të përzgjedhin mjetin që do të dëshirojnë të ndërtojnë.</p>



Dita vazhdon me punën në grupe të vogla.

Fëmijët do të ndahen në grupe me 2-4 vetë dhe sipas dëshirës do të konstruktojnë me materiale të ripërdorëshme mjete të tyre të preferuar të transportit. Ata do të jenë në gjendje të eksperimentojnë me materiale të madhësive dhe formave të ndryshme për të arritur në një produkt final. Edukatori/ja do t'i ndihmojë fëmijët vetëm nëse ata kërkojnë ndihmën e tij/saj. Më tej, secili mjet transporti mund të vihet "në punë", si për shembull: anijet do t'i vendosin në një enë me ujë do të eksperimentojnë, aeroplanët t'i hedhin në ajër, do të luajnë me makinat e krijuara. Kështu do të përmbyllet edhe dita e sotme.

Vlerësimi:

Fëmijët do të vëzhgohen gjatë konstruktimit të mjeteve, do të dokumentohet puna e bërë përmes fotografive. Edukatori/ja, në varësi të situatës, mban shënime anekdotike.

Më shumë për të bërë:

Kërkoni nga prindërit që të ndihmojnë fëmijët e tyre të hulumtojnë për mjetet transportuese në të kaluarën, të sjellin fotografi të vjetra të mjeteve të transportit.

Reflektimi:

Qyteti pa transport

Fusha kurrikulare:

Gjuhët dhe komunikimi.

Kurrikula lëndore:

Gjuhë shqipe

Tema nga plani dymujor:

Tinguj, shkronja, rrokje, fjalë, fjali

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):

I. 3, 7; **II.** 1, 4; **III.** 1, 2, 4; **IV.** 2, 3, 4, 6; **V.** 2, 5; **VI.** 5, 6

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):

Gjuhët dhe komunikimi: 1.1; 1.4; 1.5; 3.2
Matematikë: 3.4
Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti: 1

Rezultati i të nxënit të temës:

Lexojnë dhe interpretojnë ilustrimet, fotografi, figura dhe objekte me fjalë e fjali të thjeshta.

Rezultatet e të nxënit të aktiviteteve:

- Vazhdon tregimin me fjalët e tij/saj, duke u bazuar në ilustrime.
- Gjen fjalë që në përbërje (fillim, mes apo fund) kanë shkronjën "Q".
- Zbulon objektet e paraqitura në ilustrimin e dhënë.

Kriteret e suksesit:	<ul style="list-style-type: none"> • Vazhdo tregimin me fjalët e tua sipas ilustrimit. • Gjej fjalë që në përbërje (fillim, mes apo fund) kanë shkronjën "Q". • Zbulo objektet që gjenden në vizatim.
Burimet dhe materialet:	Fotografi të ndryshme, libri i fëmijës, letra, gërshërë, ngjitës.
Integrimi ndërfaqshëm:	Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.
Çështjet ndërkurrikulare:	Matematikë, Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti.
Fjalë kyçe:	Udhëtim, mjete, kafshë, qytet, shkronja "Q".
Organizimi i aktiviteteve:	<p>Takimi i përbashkët fillon me përshëndetjen e fëmijëve, më pas plotësojmë kalendarin ditor.</p> <p>Edukatori/ja sjell përpara fëmijëve disa fotografi të së kaluarës, për të parë mjetet e udhëtimit në ato kohë: në këmbë, me kafshë, me kafshë me qerre etj., të cilat i vendos në mes të rrethit. Më pas nxitet bashkëbisedimi dhe bëhen pyetjen:</p> <p>"Çfarë do të ndodhte nëse papritmas nuk do të kishte transport në qytet?" Fëmijët mund të japin përgjigje të ndryshme. Më pas, edukatori/ja udhëzon fëmijët si të ndërtojnë një histori me fotografitë që kanë përpara. Edukatori/ja nis të thotë (p.sh): "Na ishte një herë një djalosh që jetonte në qytet...". Fëmijët do të vazhdojnë të thurin me fjalët e tyre historinë e djaloshit, në bazë të fotografive, duke shtuar secili nga një fjalë, fjali apo copëz të historisë.</p> <p>Në përfundim të historisë e të diskutimit për të, duke përsëritur fjalën "qytet", edukatori/ja integron shkronjën Q, bën paraqitjen grafike të saj. Fëmijët luajnë lojën e tingujve "Tren-tren". Loja përfundon pasi të gjithë të gjejnë fjalë me shkronjën "Q".</p> <p>Më pas, fëmijët do të ndahen në katër grupe të vogla pune: njëri grup do të plotësojë librat e punës, grupi tjetër do të modelojë shkronjën Q, duke mbushur modelin e saj me litar të hollë. Grupi i tretë do të gjejë brenda vizatimit të ofruar objektet e paraqitura, ai/ajo mban shënime në formë ilustrimi për numrin e objekteve p.sh.: 3 makina, 5 njerëz, 2 biçikleta etj. Grupi i katër do të vizatojë sipas imagjinatës.</p> <p>Fëmijët do të kalojnë në të katra aktivitetet gjatë ditës.</p> <p>Pasi mbarojnë, ata do të kthehen në rreth, do të rikujtojnë historinë e ndërtuar me fotografi dhe punën e bërë gjatë ditës. Fëmijët përshëndeten me njëri-tjetrin për t'u takuar përsëri nesër.</p>
Vlerësimi:	Edukatori/ja do të vëzhgojë dhe mbaj shënim për të shprehurit me gojë gjatë aktivitetit për ndërtimin e historisë dhe punën e bërë përgjatë aktiviteteve të sotme.
Më shumë për të bërë:	Kërkoni nga prindërit që t'u japin me vete të nesërmen fëmijëve në institucion lojëra apo mjete që kanë një ndërlidhje me transportin.
Reflektimi:	_____

Parkojmë makinat

Fusha kurrikulare:	Matematikë
Kurrikula lëndore:	Matematikë
Tema nga plani dymujor:	Numrat natyror
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):	I. 3, 7; II. 1, 2; III. 1, 2, 3, 4; IV. 2, 4; V. 2, 5; VI. 6
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):	Matematikë: 1.4 Gjuhët dhe komunikimi: 1.1; 1.4 Jeta dhe puna: 4.8
Rezultati i të nxënit të temës:	Mbledh numrat që shuma të jetë deri në 10, dy numra natyror duke bashkuar dy grupe objektesh.
Rezultatet e të nxënit të aktiviteteve:	<ul style="list-style-type: none"> • Kryen veprimet e mbledhjes më objekte konkrete. • Bën lojëra të ndryshme duke ushtruar veprimet me mbledhje.
Kriteret e suksesit:	<ul style="list-style-type: none"> • Kryej veprime të mbledhjes më objekte konkrete. • Bën lojëra të ndryshme duke ushtruar veprimet me mbledhje.
Burimet dhe materialet:	Shirit ngjitës, makina të madhësive të ndryshme, fletë A4, materiale ricikluese, topëza të vegjël të butë.
Integrimi ndërfaqor:	Gjuha shqipe, Shkathtësi për jetë.
Çështjet ndërkurrikulare:	Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.
Fjalë kyçe:	Parkim, ndërtim, makinë, shto, mbledhje, numëro, krahaso.
Organizimi i aktiviteteve:	<p>Bëhemi bashkë në takimin e sotëm, ku këndojmë një këngë mirësearchjeje. Pas leximit të kalendarit, fëmijët bashkohen në lojë. Ata do të imitojnë lëvizje të profesioneve të ndryshme që ndërlidhen edhe me mjetet e transportit: piloti/ja, marinari/ja, makinisti/a, shoferi/ja etj.</p> <p>Pas aktivitetit, edukatori/ja krijon mundësinë që fëmijët të çlodhen. Për të nxitur diskutimin, edukatori/ja u lexon gjëgjëza (Një shtëpi që ka vetëm një dhomë, mbushet-zbrazet rrugëve gjithmonë... nga A. Mamaqi) ose u bën pyetje si: "Pse makinat nuk ecin në ujë? Çfarë është një rrugë hekurudhore?" etj. Në këtë mënyrë, fëmijët diskutojnë ndryshimet dhe mënyrat e ndërtimit, të cilat u përgjigjen kushteve të ndryshme në të cilat udhëtojnë. Edukatori/ja paraqet modelin si në fotografi dhe me mjetet që kanë sjellë fëmijët, praktikohen veprimet e mbledhjes.</p> <p>Më pas, fëmijët do të ndahen në grupe të vogla, ku do të vazhdojnë aktivitetet e tyre në mënyrë të pavarur. Në grupin e parë krijohen me shiritat ngjitëse parkingjet për makina, ku fëmijët do të vendosin makinat sipas shiritave ku shënohet numri i makinave të lejuara.</p>



Në grupin e dytë, fëmijët, në fletëzat e punës, të përgatitura nga edukatori/ja, do të ushtrojnë veprimet me mbledhje sipas kërkesës së fletëzës, duke përdorur materiale të ndryshme, si: topëza të vegjël të butë.

Grupi i tretë do të ndërtojë sajuese me mjete transporti. Fëmijët ndryshojnë vendet dhe secili prej tyre do të ketë mundësinë të zhvillojë të gjitha aktivitetet gjatë ditës.

Në takimin përmbyllës, fëmijët do të diskutojnë aktivitetet e zhvilluara, mund të luhet ndonjë lojë dhe të përgatiten për të përmbyllur ditën.

Vlerësimi:

Përmes vëzhgimit, edukatori/ja mban shënime mbi ndërveprimin e fëmijëve dhe veprimet me mbledhje për të parë nëse kanë arritur të kuptojnë konceptin e mbledhjes së objekteve apo të numrave.

Më shumë për të bërë:

Nxisioni prindërit që së bashku me fëmijët e tyre të ndërtojnë mjete transporti me materiale të ndryshme ricikluese.

Reflektimi:

Kush është më i shpejtë?

Fusha kurrikulare:

Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti

Kurrikula lëndore:

Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti

Tema nga plani dymujor:

Lëvizjet elementare dhe koordinimi i tyre

Rezultatet e të nxënimit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):

I. 3, 7; **II.** 1, 4; **III.** 1, 2, 4; **IV.** 2, 3, 4, 6; **V.** 2, 5; **VI.** 1, 2, 4, 5, 6

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):

Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti: 5
Gjuhët dhe komunikimi: 1.1; 1.4
Matematikë: 2.1

Rezultati i të nxënimit të temës:

Praktikon lojëra dhe aktivitete fizike në bashkëpunim, në çifte dhe grupe.

Rezultatet e të nxënimit të aktiviteteve:

- Përmes lojës "Gjej mjetin lëvizës" dallon mjetet e komunikacionit tokësor, ajror dhe ujor.
- Aftësohet të lëvizë brenda linjave të vizatuara.
- Luan lojëra të lira, duke ndërtuar mjete të ndryshme transporti.

Kriteret e suksesit:

- Përmes lojës "Gjej mjetin lëvizës" dallo mjetet e komunikacionit tokësor, ajror dhe ujor.
- Lëviz brenda linjave të vizatuara përgjatë aktivitetit fizik.
- Luaj lojëra të lira duke ndërtuar apo përdorur mjete të ndryshme transporti.

Burimet dhe materialet:	Tri ilustrime që paraqesin: tokë, qiell dhe ajër; shirit ngjitës, libra me ilustrime, materiale ricikluese.
Integrimi ndërfaqor:	Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.
Çështjet ndërkurrikulare:	Gjuhë shqipe, Matematikë.
Fjalë kyçe:	Mjete transportit, ujqor, tokësor, ajror, lëviz, gara, shpejt, ngadalë etj.
Organizimi i aktiviteteve:	<p>Takimi i përbashkët fillon me përshëndetjen me fëmijët e më pas dhe ndërrimin e kalendarit. Pyeten fëmijët si e kanë kaluar pasditen, pastaj ftohen në lojën e përbashkët. Loja e ditës është "Gjej mjetin lëvizës". Fëmija që drejton lojën, ka tri ilustrime të tokës, qiellit dhe ujit, ndërkohë që të tjerët janë ulur në formë gjysmërrethi. Në çastin kur udhëheqësi tregon ilustrimin e tokës, lojtari duhet të thotë një mjet tokësor, për shembull: treni, makina, autobusi; ose ujqor: anije, varkë, traget, nëndetëse ose ajror: balonë, aeroplan, raketë, parashutë etj. Loja përfundon derisa të gjithë të japin përgjigje. Edukatori/ja lexon tregimin që ka për temë mjetet e transportit ("Pepa pilote", nga seria e librave "Bleta punëtore" apo ndonjë libër tjetër që mund ta keni në institucion). Bashkë me fëmijët bisedohet për përmbajtjen.</p> <p>Edukatori/ja ka improvizuar disa linja sipas të cilave fëmijët do të lëvizin. Ata do të ndahen në tri skuadra dhe do të bëjnë gara me mjetet e udhëtimit. Garat fillojnë pas dhënies së sinjalit, pikët shënohen në tabelë dhe numërohen në fund.</p> <p>Kjo kohë shfrytëzohet për të parë se ku qëndrojnë fëmijët në përdorimin e koncepteve krahasuese, si: shpejt, ngadalë, më shpejt se, më ngadalë se, po aq sa etj.</p>



Pas përfundimit të lojës, edukatori/ja kërkon nga fëmijët që në grupe të vogla të luajnë lojëra të lira, përmes së cilave ata mund të integrojnë njohuritë e tyre mbi transportin. Ata mund të shfletojnë libra me ilustrime në fushën e gjuhës, të ndërtojnë një hapësirë për zhvillimin e komunikacionit të këndi i blloqeve, të ndërtojnë një maket komunikacioni të këndi i artit, duke zhvilluar lirisht talentet e tyre. Në takimin përmbyllës do të bëhet një "Tur i galerisë" për të parë punën e fëmijëve nëpër kënde.

Vlerësimi:	Fëmijët do të vëzhgohen për mënyrën e bashkëveprimit me të tjerët, aktivitetin në grup.
Më shumë për të bërë:	Nxisni fëmijët të zhvillojnë talentet e tyre, duke përdorur materiale të ndryshme, në mënyra të ndryshme; krijoni hapësirë që të zhvillojnë idetë e tyre në praktikë.
Reflektimi:	_____

Lodrat e mia

Fusha kurrikulare:	Artet
Kurrikula lëndore:	Edukim figurativë
Tema nga plani dymujor:	Krijimet figurative
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):	I. 3, 5, 6; II. 3, 4, 7, 8; III. 1, 2, 4, 6; IV. 2, 5; V. 2, 5; VI. 1, 6
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):	Gjuhët dhe komunikimi: 1.2; 1.3 Matematikë: 1.2 Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti: 1
Rezultati i të nxënit të temës:	Me materiale të ndryshme krijojnë dhe riciklojnë sipas fantazisë dhe imagjinatës, vizatojnë, ngjyrosin, modelojnë, shtypin, për tema të ndryshme që trajtohen në shkollë dhe jashtë saj, duke përdorur: format me ngjyra, pemët, lodrat dhe tema të lira ku shprehet imagjinata dhe kreativiteti i tyre individual.
Rezultatet e të nxënit të aktiviteve:	<ul style="list-style-type: none"> • Krahason Pinokun dhe robotin. • Peshon lodrat plastike, druri e metali përmes peshores. • Krijon me material të ripërdorshëm birilat për lojën përkatëse.
Kriteret e suksesit:	<ul style="list-style-type: none"> • Krahaso Pinokun dhe robotin. • Pesho lodrat prej plastike, druri e metali përmes peshores. • Krijon me material të ripërdorshëm birilat për lojën përkatëse.
Burimet dhe materialet:	Libër me përralla, përralla "Pinoku", fletë të prera në forma dhe ngjyra të ndryshme.
Integrimi ndërfaqor:	Gjuhë shqipe, Matematikë, Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti.
Çështjet ndërkurrikulare:	Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.
Fjalë kyçe:	Pinoku, lodër, druri, roboti, metal, plastik, peshë, matje, e rëndë e lehtë.
Organizimi i aktiviteve:	Dita fillon me përshëndetjen e përbashkët, pyesim fëmijët si kanë kaluar, a kanë diçka të ndajnë me grupin, luhet loja ritmike ku edukatori/ja fton fëmijët që të ndjekin ritmin e lëvizjeve në bazë të melodisë dhe kërkesës.

Ecim, ecim (2 herë)

Hop, hop, hop (hidhen me një këmbë)

Me vrap, me vrap (vrapim në vend -2 herë)

Tani erdhi koha (2 herë)

Të ndalojmë (2 herë)

Përsëriten fjalët me lëvizje trupore duke ecur, hedhur, vrapuar, sipas tekstit; teksti përsëritet dy herë, në herën e dytë me ritëm më të shpejtë. Pas lojës, edukatori/ja u lexon fëmijëve përrallën "Pinoku". Fillimisht i pyet nëse e njohin personazhin, sa dinë për Xhepeton marangoz (zdukthëtar), komentohet morali etj.

Më pas, edukatori/ja zgjeron diskutimin, duke nxitur fëmijët të mendojnë për dallimet në mes Pinokut dhe robotit, Pinokut dhe kukullave plastike etj.

Këtu fëmijët fillojnë të diskutojnë për vetitë e materialeve. Pas diskutimeve, edukatori/ja fton fëmijët për punë me grupe të vogla. Ku në kënde të ndryshme, do të kenë mundësi të:

- bëjnë matje të materialeve të ndryshme, më e lehtë/më e rëndë, krahasim, e butë/e fortë, e lëmuar/e vrazhdë etj.;
- ngjyrosin shishe plastike për të krijuar një lojë me birrila.

Me fletëza me ngjyra, të prera në forma gjeometrike do të krijojnë mozaikun e Pinokut ose Robotit. Grupet i ndërrojnë vendet në formë rotacioni, derisa të gjithë të kenë përfunduar aktivitetet. Pas përfundimit të ekspozimit, edukatori/ja fton fëmijët për aktivitet fizik, i cili mund të shoqërohet me muzikë ritmike dhe lëvizje të ndryshme trupore. Ditën e përmbyllim me diskutimin për punën e përbashkët dhe aktivitetet që u zhvilluan sot.

Vlerësimi: Edukatori/ja vëzhgon punën e fëmijëve dhe mban shënime sistematike për ta, bazuar në fletëzat e observimit.

Më shumë për të bërë: Ju mund të alternoni lojën ritmike në takimin e përbashkët, duke e kënduar këngën në gjuhën shqipe dhe angleze. Në këtë mënyrë do të integroni gjuhën angleze mjaft natyrshëm. Fëmijët do të përsërisin ose mësojnë disa nga konceptet që kanë të bëjnë me lëvizjen. Këngën në gjuhën angleze mund ta gjeni në linkun më poshtë. (<https://www.youtube.com/watch?v=fPMjnITEZwU>)

Reflektimi:

Materialet rreth nesh

Fusha kurrikulare:	Shkenca dhe natyra
Kurrikula lëndore:	Njeriu dhe natyra
Tema nga plani dymujor:	Materialet dhe vetitë e tyre
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):	I. 3, 5; II. 1, 4, 7, 8; III. 1, 2, 4, 6; IV. 2; V. 2, 5; VI. 1, 6
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):	Shkencat dhe natyra: 1 Matematikë: 6.2 Gjuhët dhe komunikimi: 1.1; 1.4
Rezultati i të nxënit të temës:	Hulumton material nga objektet e njohura për ta (letër, dru, metal, plastikë, tekstil, gurë).
Rezultatet e të nxënit të aktiviteteve:	<ul style="list-style-type: none"> • Krahason objektet për nga përbërja. • Grupon objektet sipas përbërjes së tyre.
Kriteret e suksesit:	<ul style="list-style-type: none"> • Krahaso objektet për nga përbërja. • Grupo objektet sipas përbërjes së tyre.
Burimet dhe materialet:	Lodra nga druri, plastika, tekstili, letra, metali, magnet etj.
Integrimi ndërfaqor:	Matematikë, Gjuhë shqipe.
Çështjet ndërkurrikulare:	Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.
Fjalë kyçe:	Duri, metal, plastik, tekstil, gomë, magnet.
Organizimi i aktiviteteve:	Takimi në rreth fillon me përshëndetjen me fëmijët, kalendarin ditor; ftohen fëmijët të luajnë lojën "Të kapemi për dore", të cilën e kanë luajtur edhe më parë.



Edukatori/ja ka vendosur paraprakisht në tavolina lodra të bëra nga materiale të ndryshme, si: dru, plastikë, gomë, metal, letër, magnet dhe fëmijët, në dyshe, do t'i përgjigjen pyetjes: "Prej çfarë materiali është bërë?". Njëri fëmijë, me sytë e mbyllur, i zgjat tjetrit lodrat për t'i prekur; fëmijët ndërrojnë rolet. Ata tregojnë se nga çfarë materiali janë bërë lodrat dhe i përshkruajnë ato: i fortë/i butë; i lëmuar/i vrazhdë; i ngrohtë/i ftohtë (objektet prej metali janë më të ftohta).

Përdorin shqisat për të eksploruar dhe përshkruar objektet; ndryshe janë kur i shohim ndryshe kur i prekim. Marrim një magnet dhe e afrojmë afër lodrave mbi tavolinë. Kërkojmë nga fëmijët të vërejnë se cilat tërheqin me magnet.

Ata/ato vërejnë se vetëm metalet tërhiqen nga magneti ndërsa druri, plastika e letra, jo.

Shpjegohen vetitë e magnetit dhe përdorimi i tyre në industri.



Më pas, fëmijët ndahen në pesë grupe të vogla. Edukatori/ja i udhëzon që të:

- grupojnë/klasifikojnë objektet sipas përbërjes së materialit: metal, plastikë, letër, tekstil, dru;
- në një enë me ujë do të eksperimentojnë për objektet që zhyten dhe pluskojnë;
- plotësohet fletëza e punës për klasifikimin e materialeve;
- kolazh nga materialet e ndryshme që kemi në institucion;
- bëjnë prova me magnet duke parë se cilat objekte tërhiqen dhe cilat jo.

Eksperiment:

Edukatori/ja merr 5 enë prej qelqi të tejdukshme, i mbush me ujë dhe kërkon nga fëmijët, nga secili grup, të sjellin nga një material të cilin do të lënë deri në fund të javës, për të vërejtur cilat prej tyre janë të tretshme e cilat jo.

Në takimin përmbyllës bashkëbisedojmë për aktivitetet e zhvilluara gjatë ditës.

Vlerësimi:

Edukatori/ja mban shënime përshkruese mbi objektet e identifikuara nga fëmijët. Dokumentohet eksperimenti.

Më shumë për të bërë:

Kërkoni nga prindërit që të nxisin fëmijët të vëzhgojnë dhe flasin për objektet që kanë në shtëpi. Diskutoni për përbërjen e materialeve si: dollapi, shtrati, makina, kompjuteri etj.

Reflektimi:

Eksplorojmë ndryshimet

Fusha kurrikulare: Matematikë

Kurrikula lëndore: Matematikë

Tema nga plani dymujor: Njësitë matëse

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): **I.** 3, 7; **II.** 1, 2, 4, 8; **III.** 1, 2, 3, 4, 6; **IV.** 2; **V.** 2, 5; **VI.** 1, 4, 6

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): Matematikë: 1.2
Gjuhët dhe komunikimi: 1.2; 1.4
Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti: 2.2

Rezultati i të nxënit të temës: Krahason peshën e sendeve, duke përdorur njësi jo standarde (molla, topi, libri, çanta etj.).

Rezultatet e të nxënit të aktiviteve:	<ul style="list-style-type: none"> • Shpjegon pse luga plastike qëndron mbi ujë. • Krahason objektet; cili është më i rëndë dhe cili më i lehtë. • Dallon objektet sipas përbërjes; cili është më i rëndë dhe cili më i lehtë.
Kriteret e suksesit:	<ul style="list-style-type: none"> • Shpjego pse luga plastike qëndron mbi ujë. • Krahaso objektet; cili është më i rëndë dhe cili më i lehtë. • Dallo objektet sipas përbërjes; cili është më i rëndë e cili më i lehtë.
Burimet dhe materialet:	Enë me ujë, objekte të përbëra nga materiale të ndryshme që gjenden në dhomën e punës.
Integrimi ndërfushor:	Gjuhë shqipe, Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti.
Çështjet ndërkurrikulare:	Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.
Fjalë kyçe:	Matje, metal, dru, plastik, ujë, kilogram, litër, metër.
Organizimi i aktiviteve:	<p>Dita fillon me përshëndetje me fëmijët, formimi i rrethit, luhet loja “<i>Ecim, ecim</i>”, të cilën e kemi mësuar më parë.</p> <p>Edukatori/ja ka vendosur paraprakisht në një tavolinë të madhe një enë të mbushur me ujë dhe disa lugë (metal, dru, plastik).</p> <p>Pas lojës, fëmijët ulen në rreth dhe ai/ajo u kërkon të marrin nga një lugë dhe ta fusin në enën e mbushur me ujë. Fëmijët nxiten të bëjnë pyetje.</p> <p>Pas vëzhgimit të eksperimentit, fëmijët arrijnë në përfundime se cilat materiale pluskojnë dhe cilat fundosen. Flasin për peshën e trupave dhe format e tyre.</p> <p>Edukatori/ja sjellë në rreth një peshore, një metër, një menzurë dhe kështu bashkëbisedohet për matjet.</p> <p>Fëmijët do të ndahen në qendra ku:</p> <ul style="list-style-type: none"> • ekperimentojnë me matjet me metër; • ekperimentojnë me matjet me litër; • ekperimentojnë me matjet me peshore; • ekperimentojnë me matjet jostandarde. <p>Fëmijët do të ndërrojnë grupet duke pasur mundësi të ekperimentojnë me katër format e matjes. Dita përfundon me një diskutim të përbashkët për të gjithë punën e bërë.</p>
Vlerësimi:	Bazuar në planin e vëzhgimit, edukatori/ja bën vëzhgimin e fëmijëve. Dokumentohet puna e bërë në qendrat e aktiviteve.
Më shumë për të bërë:	Ju mund të zgjeroni aktivitetet me matje në varësi të nevojave të fëmijëve dhe interesimeve të tyre, duke eksperimentuar me shumë forma të matjeve, përfshirë matjen e temperaturës. Mund të fletëza e punës për t’u punuar në shtëpi, si përmbledhje e punës së bërë.
Reflektimi:	_____

Befasia e X-së

Fusha kurrikulare:	Gjuhët dhe komunikimi
Kurrikula lëndore:	Gjuhë shqipe
Tema nga plani dymujor:	Materialet që na rrethojnë
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):	I. 3, 7; II. 1, 3, 7; III. 1, 2, 4, 6; IV. 2; V. 2, 5; VI. 6
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):	Gjuhët dhe komunikimi: 1.1; 1.4; 1.5 Matematikë: 3.1 Artet: 1
Rezultati i të nxënit të temës:	Vizatojnë dhe modelojnë sipas modeleve me materiale të ndryshme, i emërtojnë ato me fjalë dhe u tregojnë shokëve/shoqeve çfarë kanë dashur të paraqesin.
Rezultatet e të nxënit të aktiviteteve:	<ul style="list-style-type: none"> • Përshkruan ilustrimin e punuar. • Gjen fjalë që kanë në përbërje shkronjën "X". • Bashkon figurat me numrin përkatës.
Kriteret e suksesit:	<ul style="list-style-type: none"> • Përshkruaj ilustrimin e punuar. • Gjej fjalë që kanë në përbërje shkronjën "X". • Bashko xixëllonjat me numrin përkatës.
Burimet dhe materialet:	Materialet të ndryshme, letra, ngjyra, libri i fëmijës, tabelat magnetike.
Integrimi ndërfaqor:	Matematikë, Edukatë muzikore.
Çështjet ndërkurrikulare:	Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.
Fjalë kyçe:	Letër, lehtë, shkronja "X", xixa.
Organizimi i aktiviteteve:	<p>Pas takimit të përbashkët përshëndetës e formimit të rrethit, ndërrohet kalendari dhe fëmijët nisin të luajnë lojën: "Vallëzim me shkronja". Edukatori/ja vendos fletë me shkronja në formë rrethi, të ndara njëra nga tjetra. Në klasë vendoset muzikë dhe, kur ndalet pas disa sekondash, fëmijët do të kenë ndalur në një shkronjë e caktuar. Thuhen të gjitha fjalët që ata njohin, që fillon me atë shkronjë. Loja vazhdon derisa të arrijmë te shkronja X.</p> <p>Edukatori/ja paraqet grafikun e shkronjës X, kërkon nga fëmijët të gjejnë fjalë me këtë shkronjë e të ndajnë në rrokje. Në tabelat magnetike, fëmijët do të provojnë të shkruajnë grafikun; edukatori/ja pyet: Si mendoni që mbetet gjurma në tabelën magnetike.</p> <p>Në qendrat e aktiviteteve, edukatori/ja ka përgatitur mjedisin.</p> <p>Në qendrën e shkencës, përmes shiritave të letrës, fëmijët do të eksperimentojnë me ngjitës dhe letër, konkretisht me ndryshimet që pëson letra pas ngjitjes.</p>

Në qendrën e gjuhës do të modelojnë grafikun e shkronjës X, në qeset e mbushura me xhel dhe materialet e ofruara nga edukatori/ja.

Në qendrën e artit, fëmijët do të vizatojnë objekte, kafshë dhe të tjera që fillojnë me shkronjën X.

Në qendrën e matematikës, do të bashkojnë xixëllonjat dhe numrin përkatës në sajueset e ndërtuara nga edukatori/ja.

Fëmijët do të kthehen në rreth të rikujtojnë aktivitetet, për të bërë së fundmi përshëndetjen përmbyllëse.

Vlerësimi: Edukatori/ja mund të mbajë shënime për ecurinë gjatë aktivitetit të tërheqjes së letrës, që do ta ndihmojnë në vlerësimin përfundimtar.

Më shumë për të bërë: Ju mund të zgjeroni aktivitetet, duke u ofruar fëmijëve materiale të ndryshme të ripërdorueshme dhe shkollore, që ata të krijojnë paraqitjen grafike të shkronjës "X". Fëmijët do të plotësojnë në librat e tyre fletëzën e shkronjës X.

Reflektimi:

Vizitë në kabinetin e informatikës

Fusha kurrikulare: Jeta dhe puna

Kurrikula lëndore: Shkathtësi për jetë

Tema nga plani dymujor: Veglat, mjetet, e punës dhe pajisjet elektronike

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): **I.** 3, 7; **II.** 1, 7; **III.** 1, 2, 6, 7; **IV.** 4; **V.** 2, 5; **VI.** 1, 6

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): Jeta dhe puna: 2.3; 3.2
Gjuhët dhe komunikimi: 1.1; 1.4
Shoqëria dhe mjedisi: 3

Rezultati i të nxënit të temës: Përshkruan funksionin e disa pajisjeve elektronike në jetën e përditshme dhe i përdor për punë (p.sh.: përdor PC për të komunikuar me të afërmit, vendos rrobat në rrobalarëse, printon vizatimet e tij nga printeri etj.).

Rezultatet e të nxënit të aktiviteteve:

- Tregon së paku tri pjesë të kompjuterit.
- Hap dhe mbyll kompjuterin sipas udhëzimeve të mbikëqyrësit.
- Printon letrën me imazhin e parapëlqyer.

Kriteret e suksesit:	<ul style="list-style-type: none"> • Trego së paku tri pjesë të kompjuterit. • Hap dhe mbyll kompjuterin sipas udhëzimeve. • Printo letrën me imazhin e parapëlqyer.
Burimet dhe materialet:	Kompjuteri, printeri, fletëzat e punës etj.
Integrimi ndërfaqshor:	Gjuhë shqipe, Shoqëria dhe mjedisi.
Çështjet ndërkurrikulare:	Globalizimi dhe ndërvarësia.
Fjalë kyçe:	Kompjuteri, miu, tastiera etj.
Organizimi i aktiviteteve:	<p>Përshëndetja me fëmijët, luajmë lojën: “Të kapemi për dore”. Pastaj, edukatori/ja udhëzon fëmijët të rreshtohen në dyshe e të përgatiten për në kabinetin e informatikës. Diskutohet dore”. Pastaj, për rregullat që duhet të zbatohet gjatë vizitës. Edukatori/ja ka organizuar paraprakisht një vizitë në bashkëpunim me profesorin/profesoreshën e informatikës në kabinetin ku fëmijët do të njihen me kompjuterin dhe pjesët kryesore të tij.</p> <p>Në kabinet priten nga profesori/profesoresha, i cili/e cila nis t’u shpjegojë fëmijëve për:</p> <ul style="list-style-type: none"> • kompjuterët si pajisje në të cilët mund të shkruani, lexoni, numëroni, shikoni vizatime, video, komunikoni në Skype, internet, shkruani letra, luani, vizatoni, kërkoni informacione të ndryshme, zbuloni motin, lajm, të dëgjoni muzikën e parapëlqyer etj.; • disa nga elementet e caktuara të pajisjeve kompjuterike: monitori, miu, tastiera, njësia e sistemit (procesori); • printerin, me të cilën mund të printoni. <p>Fëmijët hapin individualisht kompjuterët dhe nën udhëzimet e profesorit/profesoreshës, nisin të printojnë imazhe, dëgjojnë muzikë, pikturojnë pak në programin përkatës, që u shpjegohet nga edukatori/ja. Pasi hapen imazhe të ndryshme edukative, secili fëmijë individualisht bën edhe printimin e imazhi të preferuar. Mbyllin me kujdes kompjuterin dhe përshëndetin e falënderojnë profesorin/profesoreshën. Pasi përfundojnë vizitën në kabinet, fëmijët do të kthehen në klasë ku do të plotësojnë fletëzat që printuan.</p> <p>Për takimin përmbyllës, fëmijët do të kthehen në rreth dhe së bashku bisedojmë si e kaluan ditën dhe çfarë iu pëlqeu më shumë.</p>
Vlerësimi:	Edukatori/ja mban shënime anekdotike në varësi të rasteve që krijohen gjatë vizitës, po ashtu dokumenton vizitën përmes videove të shkurtra.
Më shumë për të bërë:	Fëmijëve, me ndihmën e prindërve, do të përsërisin në shtëpi hapjen dhe mbylljen e kompjuterit. Në institucionin parashkollor, ky aktivitet mund të zhvillohet duke sjellë një kompjuter në dhomën e punës ose të dergohen fëmijët te zyrat ku ka kompjuter, në mënyrë që të mund të përdorin printerin.
Reflektimi:	_____

Pse duhet të kursejmë?

Fusha kurrikulare:	Shoqëria dhe mjedisi
Kurrikula lëndore:	Shoqëria dhe mjedisi
Tema nga plani dymujor:	Përgjegjësitë e mia
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):	I. 3, 5; II. 1, 3, 8; III. 1, 3, 7; IV. 2, 4; V. 2, 5; VI. 1, 4, 6
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):	Shoqëria dhe mjedisi: 3.3.2 Gjuhët dhe komunikimi: 1.1; 1.6 Matematikë: 1.2
Rezultati i të nxënit të temës:	Tregon me fjalë, sjellje dhe veprimet e veta në raport me të tjerët dhe merr përgjegjësi për to.
Rezultatet e të nxënit të aktiviteteve:	<ul style="list-style-type: none"> • Dallon nevojat nga dëshirat gjatë diskutimit mbi kursimin. • Bashkëpunon me shokun/shoqen gjatë aktiviteteve në grup të vogël. • Eksperimenton me procesin e pastrimit të parave metalike.
Kriteret e suksesit:	<ul style="list-style-type: none"> • Dallo nevojat nga dëshirat, mbi përdorimin e parave. • Luaj me shokun/shoqen duke respektuar njëri-tjetrin. • Eksperimento me procesin e pastrimit të parave metalike.
Burimet dhe materialet:	Tabelë, marker, para metalike, revista, libra të vjetër ku ka ilustrime parash, gërshërë, kubi me numra, arkë kursimi, fletë të bardha, ngjyra qiriri, një enë me uthull molle, enë me kripë, leckë.
Integrimi ndërfaqor:	Gjuhë shqipe, Matematikë.
Çështjet ndërkurrikulare:	Globalizimi dhe ndërvarësia.
Fjalë kyçe:	Para, kursim, huazim, arkë kursimi.
Organizimi i aktiviteteve:	<p>Në takimin e përbashkët, pas plotësimit të kalendarit, këndojmë një këngë mirëseardhjeje, pastaj vendosim në mes të rrethit një arkë kursimi dhe nxisim diskutimet rreth saj. “Çfarë kemi sot në mes të rrethit? Pse na shërben një arkë e tillë? A keni ju në shtëpi një të tillë? Nëse po, na tregoni se si kurseni ju, për çfarë qëllimi i ruani paratë?”.</p> <p>Pas komenteve të fëmijëve, edukatori/ja flet për paratë dhe rëndësinë e kursimit. Rikujtojmë “Nevojat dhe dëshirat”; nxiten fëmijët të mendojnë se ku dhe si duhet t’i shpenzojnë paratë.</p> <p>Edukatori/ja mban shënime ilustruese në një tabelë që e ndan në dy hapësira, një për nevojat, një për dëshirat. Bashkërisht me grupin nxjerrim një listë me dy nga këto grupe të gjërave. Bëhet një krahasim dhe diskutojmë për prioritetin e gjërave në listë, si ndikojnë ato në jetën tonë etj. Fëmijët njihen me përgjegjësitë që lidhen me vendimet personale financiare. Sillni në rreth një “mikrofon” të sajuar dhe jepjani</p>

fëmijës që keni pranë; pastaj ia kalojnë mikrofonin shokut e kështu me radhë (ata që kanë dëshirë të tregojnë një ndodhi të këndshme, që ka lidhje me paratë, mund të flasin). Paraqitni para fëmijëve një listë, ku të ilustroni një shembull të rritjes së fondit ndër muaj, për një vit.

Tregojuni një monedhë 5 centëshe dhe i pyesni sa vlerë ka ajo. Çfarë mund të blejnë me të? A i japin shumë rëndësi ata? Flisni për rëndësinë e kursimit, se si një monedhë kaq e vogël rritet me kalimin e kohës me "magjinë" e kursimit. Me anë të vizatimit, paraqisni dhe shpjegoni si rritet ndërkohë shuma.

P.sh.: $0,05 \text{ cent} \times 30 \text{ ditë} = 1,50 \text{ euro}$ në muaj.

Pyesni fëmijët:

- Çfarë do të kishin bërë me këto para, për çfarë mund të shpenzohen në fondin personal?
- Tregoni pse kurseni.
- Shpjegoni ndryshimet ndërmjet blerjes dhe huazimit.

Ju mund t'u mësoni fëmijëve konceptin e kursimit duke e krahasuar atë me kultivimin e një kopshti. Rritja e farave, kujdesi, ujitja, mbarështimi i bimëve që më vonë jep fruta dhe perime të shumta për t'i shijuar.

Fëmijët do të ndahen në këndet e aktiviteteve:


Në këndin e matematikës, ata do të manipulojnë me para metalike në lojën me kubin e numrave.

Në këndin e shkencës, fëmijët do të eksperimentojnë me procesin e larjes së monedhave metalike.

Materialet: një enë me uthull molle dhe një enë me kripë, një leckë për pastrim.

Në këndin e gjuhës do të presin çmimet në fletushka të ndryshme, që pastaj i vendosin në një kuti, të cilën do ta përdorin gjatë kësaj jave për aktivitete të ndryshme ku fëmijët do të manipulojnë me para.

Në këndin e artit, fëmijët do të luajnë me fërkimin e monedhave me ngjyra, duke lënë gjurmë dhe pastaj do të bëjnë bashkimin e gjurmës së monedhës me monedhën në fjalë, duke ia vendosur sipër. Në takimin përmbyllës diskutohen aktivitetet e realizuara gjatë ditës dhe së bashku me fëmijët bëjmë planifikimin e vizitës për ditën e nesërme.



Vlerësimi:

Edukatori/ja vëzhgon përfshirjen aktive të fëmijëve, sa ata e kanë kuptuar procesin e kursimit dhe konceptin e parasë. Vëzhgohet puna individuale e fëmijëve në qendrat e ndryshme.

Më shumë për të bërë:

Mund të adresoni për punë në shtëpi, diskutim me prindërit për procesin e kursimit, krijimin e një arke kursimi. Planifikoni me këshillin e prindërve vizitën në njërën nga bankat e qytetit tuaj.

Reflektimi:

Vizitojmë bankën e kursimeve

Fusha kurrikulare:	Jeta dhe puna
Kurrikula lëndore:	Shkathtësi për jetë
Tema nga plani dymujor:	Planifikimi i buxhetit familjar
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):	I. 3, 5; II. 1, 8; III. 3, 7; IV. 3, 4; V. 2, 5; VI. 1, 3, 4, 6
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):	Jeta dhe puna: 5.5.1 Gjuhët dhe komunikimi: 1.1; 1.6 Matematikë: 7.1 Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti: 5
Rezultati i të nxënit të temës:	Dallon vlerën e parasë sipas formës dhe përcakton dëshirën për ta blerë.
Rezultatet e të nxënit të aktiviteteve:	<ul style="list-style-type: none"> • Identifikon format e ndryshme të pagesës. • Njihet me profesionin e ekonomistit në bankë.
Kriteret e suksesit:	<ul style="list-style-type: none"> • Identifiko format e ndryshme të pagesës. • Njihet me profesionin e ekonomistit në bankë.
Burimet dhe materialet:	Një litar që do të përdoret për të mbajtur fëmijët në një vijë, broshura për hapjen e llogarive të fëmijëve, jelekë dhe tiketat ngjitëse me emrat e fëmijëve.
Integrimi ndërfaqësor:	Gjuhë shqipe, Matematikë, Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti.
Çështjet ndërkurrikulare:	Globalizimi dhe ndërvarësia.
Fjalë kyçe:	Bankë, kursime, kartë krediti, punonjës banke, bankomat, të ardhura.
Organizimi i aktiviteteve:	<p>Për t'i njohur fëmijët me procesin e punës në bankë, me rëndësinë e kursimit dhe proceset se si kursejmë, si deponojmë, si hapim xhirollogari etj. Edukatori/ja ka kontaktuar paraprakisht njëri nga bankat më të afërta dhe ka siguruar datën e përshtatshme për bankën dhe stafin që të presin fëmijët. Siguroni që dikush nga stafi i bankës t'i presë fëmijët dhe t'u shpjegojë punën në bankë. Prindërit mund të ndihmojnë në organizimin dhe pritjen e fëmijëve në bankë. Rrugës për në bankë, fëmijët ecin në rresht të mbajtur për litarin me të cilin dalin jashtë institucionit. Këndojnë këngë gjatë rrugës, dhe ju gjithashtu mund të përdorni numërimin duke ndjekur ritmin e hapave të ecjes. Gjatë vizitës në bankë, fëmijët do të:</p> <ul style="list-style-type: none"> • njihen me rëndësinë e procesit të kursimit; • me procesin e hapjes së xhirollogarisë për fëmijë; • shohin se si rriten kursimet nga viti në vit; • shohin si është puna e një ekonomisti në bankë, çfarë punohet në sportelet e bankës, me çfarë merret drejtori/drejtoresha etj.; • njohin forma të tjera të pagesës, kredit kartat;

- kuptojnë si kanë lidhje bankat me njëra-tjetrën anekënd botës;
- njihen me funksionet e bankomatit etj.

Siguroni një vend ku fëmijët të mund të sistemohen, të kenë mundësi të zhvillojnë një bashkëbisedim dhe të merrni informata kthyes nga ata. Në takim e përbashkët, edukatori/ja nxit fëmijët të pyesin për gjërat të cilat kanë interes. Pyesni fëmijët se si janë ndier, a kanë qenë me parë në ndonjë bankë, si paguajnë prindërit e tyre, a praktikojnë pagesën me kartë krediti etj.

Vlerësimi: Fëmijët vëzhgohen për orientimin në hapësirë, sjelljen e përshtatshme në hapësira publike, ndërveprimin me të tjerët dhe pjesëmarrjen aktive në diskutim.

Më shumë për të bërë: Ju mund të siguroni nga banka broshura për hapjen e llogarive të kursimeve për fëmijë, që ata t'ua japin prindërve.

Reflektimi: _____

Dyqani i klasës sonë

Fusha kurrikulare: Matematikë

Kurrikula lëndore: Matematikë

Tema nga plani dymujor: Njësitë matëse

Rezultatet e të nxëniet për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): **I.** 3, 5; **II.** 1, 8; **III.** 1, 3; **IV.** 3, 4; **V.** 2, 5; **VI.** 1, 4, 6

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): Matematikë: 1.2
Gjuhët dhe komunikimi: 1.1; 1.6
Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti: 5

Rezultati i të nxëniet të temës: Përdor monedhat nga 1-10 euro në situata jetësore, për blerje që lidhen me një sasi të caktuar malli.

Rezultatet e të nxëniet të aktiviteteve:

- Mban mend pozicionin e kartave me para në lojë.
- Organizon dyqanin në këndin e lojës me role.
- Kryen veprime me para në procesin e shitblerjes.

Kriteret e suksesit:

- Përpiqu të zbulosh dy karta të njëjta në "Lojën me memorie".
- Organizoj dyqanin në këndin e lojës me role.
- Kryej veprime me para në procesin e shitblerjes.

Burimet dhe materialet: Kartat me para për lojën, libri i punës për fëmijë/fletëza me modelet e parave, lodra dhe materiale të ndryshme për krijimin e dyqanit (materiale ekzistuese në klasë).

Integrimi ndërfushor: Gjuhë shqipe, Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti.

Çështjet ndërkurrikulare: Globalizimi dhe ndërvarësia.

Fjalë kyçe: Para, arkë, dyqan, shitblerje, shitës, kusur.

Organizimi i aktiviteteve:



Në takimin e përbashkët mblidhemi duke u përshëndetur miqësisht, plotësojmë kalendarin dhe flasim për motin. Për lojën për forcimin e memories, edukatori/ja ka përgatitur karta me kartëmonedha dhe monedha. Loja luhet në rreth me të gjithë fëmijët. Në çastin që i hap kartat, i emërton paratë në figurë dhe, nëse janë të njëjta i lë të zbuluara; në rastin tjetër, i kthen prapë nga ana e kundër, ndërkohë fëmijët e tjerë mbajnë mend pozicionet e kartave përkatëse dhe i zbulojnë kur u vjen radha. Kështu, fëmijët luajnë, argëtohen, rrisin shkathtësitë në të mbajturit mend dhe aftësinë për të dalluar kartëmonedhat.



Pasi t'i kemi zbuluar të gjitha kartat, na shfaqen kartëmonedhat dhe paratë metalike. Edukatori/ja flet për llojet e parave, duke i nxitur fëmijët t'i ndajnë kartat e parave sipas vlerës së tyre. Vazhdojnë me punë individuale te libri i fëmijës, ku do të presin me gërshtë paratë nga fletëza e punës. Me paratë e grumbulluara, fëmijët do të luajnë në kënde të ndryshme të klasës. Në klasë do të hapni dyqane të ndryshme, të cilat fëmijët do t'i modelojnë dëshirës. Aty, ata do të praktikojnë procesin e shitblerjes dhe do të kryejnë veprime me paratë e tyre. Ju mund t'i nxisni fëmijët t'i kategorizojnë dyqanet e tyre si:

- dyqan lulesh;
- dyqan lodrash;
- restorant;
- një librari.



Ndani fëmijët në disa grupe punuese duke patur mundësi që secili grup të vendos për dyqanin e vet. Ata do të shohin përreth dhe do të përdorin materialet dhe mjetet e ndryshme ekzistuese brenda klasës për të sistemuar dyqanin. Pasi të keni përfunduar punën me ndërtimin e dyqaneve, fillon procesi i shitblerjes, ku fëmijët do të praktikojnë njohjen me numrat e parave, mbledhje, zbritje dhe manipulimin me to.



Pas një kohe, fëmijët do të lëvizin dhe ndryshojnë vendndodhjen në formë rotacioni nga dyqani në dyqan. Është e rëndësishme që të gjithë fëmijët të provojnë rolin e shitësit dhe të blerësit.

Në takimin e përbashkët mblidhemi për të reflektuar për aktivitetet e zhvilluara. Nxitni fëmijët të shprehin përshtypjet e tyre në lojën e dyqaneve në klasë: Si ishte të manipulohet me para? Në cilin dyqan keni fituar më pak? Po më shumë? Etj.

Vlerësimi: Edukatori/ja mban shënime për shkathtësitë e fëmijëve në njohjen e parave, mbajtjen mend të letrave dhe veprimet e tyre me para gjatë procesit të shitblerjes.

Më shumë për të bërë: Ju mund të sajoni lojëra të tjera të ngjashme, ose të nxisni fëmijët që një pasdite të shoqërojnë prindërit e tyre në dyqan, e të tregojnë për atë vizitë ditën e nesërme.

Reflektimi:

Galeria jonë e artit

Fusha kurrikulare:	Artet
Kurrikula lëndore:	Edukatë figurative
Tema nga plani dymujor:	Veprat artistike
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):	I. 3, 5; II. 1, 3, 7, 8; III. 1, 2, 3, 7; IV. 2; V. 2, 5; VI. 1, 6
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):	Artet: 4 Matematikë: 3.5 Gjuhët dhe komunikimi: 1,1; 1.6
Rezultati i të nxënit të temës:	Fëmijët nxiten të shprehin mendimin e tyre për veprat artistike ndaj të cilave janë ekspozuar (në mënyrën pamore) me dy-tri fjali të thjeshta.
Rezultatet e të nxënit të aktiviteteve:	<ul style="list-style-type: none"> • Manipulon me monedha gjatë aktiviteteve në grupe të vogla. • Organizon galerinë e artit, me veprat e veta artistike.
Kriteret e suksesit:	<ul style="list-style-type: none"> • Përdor monedhat për të eksperimentuar. • Organizon galerinë e artit, me veprat e veta artistike.
Burimet dhe materialet:	Bojëra qiriri, fletë të bardha, lapsa, plastelinë, para metalike, kartëmonedha ngjites, fleta me ngjyra.
Integrimi ndërfaqor:	Matematikë, Gjuhë shqipe.
Çështjet ndërkurrikulare:	Ndërvarësia.
Fjalë kyçe:	Galeri, vepër artit, kolazh, para, shitblerje.
Organizimi i aktiviteteve:	<p>Në takimin e përbashkët përshëndetës, edukatori/ja pret fëmijët dhe pas plotësimit të kalendarit, bisedojnë bashkërisht për përvojat e tyre gjatë ditës së kaluar, flasin për kohën e tyre të lirë etj. Më tej, fëmijët, në rreth, luajnë lojën:</p> <p>“Cila ngjyrë je ti?”</p> <p><i>Ecuria:</i> Fëmijët qëndrojnë në rreth ku njëri nga ata hyn në mes dhe rrotullohet, duke drejtuar gishtin nga shokët dhe shoqet. Kur ai të ndalet, gjen shokun/shoqen tek i cili pozicionohet gishti drejtues dhe e pyet “Cila ngjyrë je ti?”. Fëmija përgjigjet me ngjyrën përkatëse duke shtuar një fjali që do ta plotësojë ngjyrën e thënë. Për shembull: “Jam ngjyra e verdhë dhe i verdhë është DIELLI që na ndriçon!”. Ju mund ta rrisni vështirësinë e lojës: kur fëmijët thonë ngjyrën e caktuar, ju mund t’i thoni të emërtojë një ushqim me atë ngjyrë, ndonjë objekt brenda klasës me atë ngjyrë, ose diçka në shtëpi etj.</p>



Edukatori/ja ka përgatitur një PowerPoint mbi veprat e ndryshme artistike dhe bisedon me fëmijët rreth artit, galerisë së artit, dhe rëndësisë së tyre. Po ashtu, edukatori/ja bënë dallimin mes muzeumeve dhe galerisë së artit. Përmes *PowerPoint*-it luhet një lojë me fëmijët "Kush ku takon"

Edukatori/ja paraqet fotografi të ndryshme të pikturave, skulpturave dhe ornamenteve, ndërsa fëmijët tregojnë se ku qëndrojnë ato objekte, në galeri apo muze.

Në një kënd vendosen bojëra qiriri, fletë të bardha dhe para metalike. Fëmijët vendosin paratë metalike nën fletën e bardhë dhe i ngjyrosin sipër me ngjyra të ndryshme, duke lënë kështu gjurmët e parave në letër. Pasi ta përfundojnë procesin e fërkimit të ngjyrave, ata do të marrin kutinë e parave dhe do të bëjnë bashkimin e parasë që ka në dorë me gjurmën në letër të bardhë.

Në një kënd me materiale sipas zgjedhjes së tyre, fëmijët do të ndërtojnë arkën e tyre të kursimit.

Në një kënd tjetër janë vendosur para metalike dhe plastelinë, ku fëmijët mund të modelojnë me para mbi plastelinë; ata mund të modelojnë numra me plastelinë dhe anash numrit në fjalë të vendosin vlerën e saktë të monedhave.

Në një kënd vendosen fleta me ngjyra, ngjitës dhemateriale të tjera që fëmijët të krijojnë kolazhe artistike sipas imagjinatës. Pasi secili fëmijë të ketë lëvizur dhe punuar në të gjitha qendrat, mbledhin veprat artistike të fëmijëve dhe i sistemojmë në një kënd të klasës, të cilin do ta quajmë "Galeria jonë e artit".

Në takimin përmbyllës vizitohet "Galeria jonë e artit", bëhen rregullimet e fundit dhe presim prindërit për ta vizituar atë.

Vlerësimi:

Edukatori/ja dokumenton përmes fotografive punën artistike të fëmijëve.

Më shumë për të bërë:

Në bashkëpunim me prindërit, fëmijët mund të punojnë librin e tyre mbi llojet e ndryshme të veprave artistike, të cilat mund t'i ndihmojnë të zgjojnë interesin për artin.


Reflektimi:

Me shkronjën “XH” njihemi ne

Fusha kurrikulare:	Gjuhët dhe komunikimi
Kurrikula lëndore:	Gjuhë shqipe
Tema nga plani dymujor:	Tinguj, shkronja, rrokje, fjalë, fjali
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):	I. 3, 5; II. 1, 3, 7; III. 1, 2, 3, 7; IV. 2; V. 2, 5; VI. 1, 6
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):	Gjuhët dhe komunikimi: 1.1; 1.4; 1.5; 3.2 Njeriu dhe natyra: 1 Artet: 1 Matematikë: 3.5
Rezultati i të nxënit të temës:	Shqiptojnë drejt tingujt, zanore dhe bashkëtingëllore, gjatë të shprehurit.
Rezultatet e të nxënit të aktiviteteve:	<ul style="list-style-type: none"> • Identifikon materiale të ndryshme të panjohura nga kutia. • Modelon shkronjën “XH” me materiale të ndryshme. • Krijon tinguj me monedha duke ndjekur ritmin e këngës së kënduar.
Kriteret e suksesit:	<ul style="list-style-type: none"> • Identifikon materiale të ndryshme të panjohura nga kutia. • Modelon shkronjën XH me materiale të ndryshme. • Gjej një mënyrë për të bërë monedhat të krijojnë tinguj.
Burimet dhe materialet:	Kuti kartoni, xhami zmadhues, letër gërryese, vezë plastike, top të butë, kub, cilindër, para metalike, sferë druri, fotografi të objekteve që fillojnë me shkronjën XH, disa shkronja XH, fletë të bardha, bojëra qiriri, bojëra uji.
Integrimi ndërfaqësor:	Njeriu dhe natyra, Edukatë muzikore, Matematikë.
Çështjet ndërkurrikulare:	Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.
Fjalë kyçe:	Shkronja XH, kuti, lojë.
Organizimi i aktiviteteve:	<p>Në takimin e përbashkët në rreth, edukatori/ja sjell para fëmijëve një kuti në të cilën është një vrimë dhe brenda saj ka vendosur objekte të ndryshme, të cilat kanë, peshë, sipërfaqe, materiale të ndryshme. Aty janë vendosur edhe disa letra me shkronjën “XH”, me të cilën do të njihen gjatë ditës, dhe disa fotografi të objekteve që fillojnë me këtë shkronjë.</p> <p>“Të zbulojmë të panjohurën”</p> <p><i>Materialet:</i> kuti kartoni, xhami zmadhues, letër gërryese, vezë plastike, top i butë, kub, cilindër, para metalike, sferë druri, fotografi të objekteve që fillojnë me shkronjën XH, disa shkronja XH.</p> <p><i>Ecuria:</i> Të gjitha materialet futen në kuti dhe fëmijëve do ta eksplorojnë. Flisni se si funksionon shkenca, si veprojnë shkencëtarët për të zbuluar të panjohurën, duke i studiuar objektet, duke i peshuar, duke i matur. Bëhet edhe eksperimenti praktik dhe edukatori/ja shpjegon: “Edhe ne</p>

në këtë kuti kemi objekte të ndryshme, që nuk i njohim. Do të fusim dorën e do të marrim një objekt, ta prekim, ta ndiejmë, ta peshojmë me dorë, të mendojmë çfarë mund të jetë. Procesin e përshkruajmë me fjalë.

Kur të kemi të gjitha objektet jashtë, përqendrohemi te shkronja "XH", të cilën fëmijët e kanë gjetur. Kërkoni që të ndajnë nga objektet tjera shkronjën "XH" dhe objektet/fotografitë që fillojnë me këtë shkronjë. Paraqisni para fëmijëve shkronjën e re me të cilën do të njihen. Gjeneroni fjalë me këtë shkronjë dhe kërkoni të emërtojnë objekte brenda klasës që fillojnë me shkronjën XH. Dita vazhdon me punën në grupe të vogla: Në këndin e matematikës, fëmijët mund të modelojnë shkronjën XH me paratë metalike. Gjatë procesit, ata zbatojnë numërimin dhe grupimin e parave.



Në këndin e gjuhës, fëmijët do të shkruajnë modelin e shkronjës në tabakatë me rërë dhe do të plotësojnë fletëzën e punës. Në këndin e shkencës, do të praktikojnë rezistencën e ngjyrave të ujit sipër sipërfaqes me bojëra qiriri. Në fletë të bardha, edukatori/ja paraprakisht ka vizatuar shkronjën XH, dhe fëmijët me bojëra uji do të ngjyrosin sipas dëshirës, duke formuar shkronjën e re.

Në takimin e përbashkët bëjmë një përsëritje duke marrë informata kthyesë për eksperimentin e zbulimit të së panjohurës dhe flasim për shkronjën e re. Gjenden sende të tjera që fillojnë me këtë shkronjë.

Të gjitha monedhat e përdorura, edukatori/ja i sjellë në rreth dhe kërkon nga fëmijët që të marrin 3-4 monedha para vetës. Edukatori/ja nxit fëmijët të mendojnë mbi tingujt që monedhat krijojnë kur përplasen me njëra-tjetrën; pas diskutimit, të gjithë së bashku këndojnë një këngë duke ndjekur ritmin me monedha. Lejoni fëmijët të gjejnë mënyrën e tyre për krijimin e tingujve (mund të mbajnë në dorë, në tasa plastike ose letre, në cilindra letre, në vezë plastike etj.).

Vlerësimi: Edukatori/ja vëzhgon punën e fëmijëve në qendrat e aktiviteteve dhe mban shënime të personalizuara për secilin.

Më shumë për të bërë: Në bashkëpunim me prindërit, fëmijët mund të krijojnë një vizatim ose punëdore me një send që fillon me këtë shkronjë: "XH" – xhepi; xhaketa; xhaxhi.

Reflektimi: _____

1 Qershori

Fusha kurrikulare:	Shoqëria dhe mjedisi
Kurrikula lëndore:	Shoqëria dhe mjedisi
Tema nga plani dymujor:	Festat
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):	I. 3, 5; II. 1; III. 1, 3; IV. 3, 4, 6; V. 2, 5; VI. 1, 2, 4, 5, 6
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):	Shoqëria dhe mjedisi: 3.3.1 Gjuhët dhe komunikimi: 1.1; 1.6 Artet: 3 Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti: 1
Rezultati i të nxënit të temës:	Emërton disa festa familjare dhe shoqërore dhe në mënyrën e vet i përshkruan organizimin dhe festimin e tyre.
Rezultatet e të nxënit të aktiviteteve:	<ul style="list-style-type: none"> • Marshon në qytet për festën e 1 Qershorit. • Sensibilizohet për mbështetjen e fëmijëve anekënd botës.
Kriteret e suksesit:	<ul style="list-style-type: none"> • Marsho në manifestimin e 1 Qershorit. • Shpreh dashuri dhe mbështetje për fëmijët anekënd botës.
Burimet dhe materialet:	Balona, qese letre, pjata letre/kartoni, fletë me ngjyra, shkëlqyes, ngjites, gërshërë, balona, shkopinj.
Integrimi ndërfaqor:	Gjuhë shqipe, Edukatë muzikore, Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti.
Çështjet ndërkurrikulare:	Edukimi për qytetari demokratike.
Fjalë kyçe:	Festa, 1 Qershori, fëmijët, të barabartë.
Organizimi i aktiviteteve:	<p>Në takimin e përbashkët, fëmijët plotësojnë kalendarin dhe fokusohemi te muaji i ri dhe data 1 Qershor. Çfarë e bën të veçantë? Dita e kujt është kjo? (Fëmijët duhen informuar paraprakisht disa ditë më herët për datën e shënuar).</p> <p>Dita ndërkombëtare e fëmijëve, "1 Qershori".</p> <p>Edukatori/ja flet shkurtimisht për historikun e kësaj dite:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Ditë për t'i rikujtuar botës se sa e rëndësishme është mirëqenia e fëmijës; • Ditë, kur të gjithë fëmijët marshojnë/protestojnë për paqe dhe respektim të të drejtave të të gjithë fëmijëve anekënd botës; • Kjo ditë festohet, sepse shumë kohë më parë, në një vend të largët, të quajtur Gjenevë, është bërë një mbledhje shumë e rëndësishme me pjesëmarrës mendjendritur, të cilët bashkërisht kanë vendosur t'i mbrojnë të gjithë fëmijët e botës, duke marrë vendime të cilat mbrojnë të drejtat e fëmijëve, i mbrojnë fëmijët nga çdolloj dhune, nga puna e vështirë etj.

- Kështu, edhe ne sot do të bëjmë një paradë në emër të kujdesit dhe dashurisë për fëmijët anembanë botës.

Paradë në rrugët e qytetit

Materialet: balona, fletë me ngjyra, qese letre, shkëlqyes, lapsa me ngjyra, gërshërë, shkopinj, ngjitës.

Ecuria: Për të dalë në paradë, edukatori/ja shfrytëzon një periudhë kohore prej një jave për të krijuar maska, dekore, balona për paradën e ditës së 1 Qershorit. Në paradë, fëmijët mund të jenë të maskuar apo të shoqëruar me ndonjë dekor që simbolizon botën shumëngjyrëshe imagjinare të tyre.

Le të jenë një grup fëmijësh, që paraqesin një mesazh sensibilizues për shoqërinë, të jenë të lumtur, të argëtohen në ditën e tyre.

Ju mund të krijoni maska të ndryshme duke përdorur qeset e letrës dhe duke i dekoruar ato me materiale shumëngjyrëshe, si letra, shkëlqyes etj.

Fëmijët mund të vendosin vetë për maskën e tyre. Ato mund të jenë maska lulësh, kafshësh, personazhe nga filmat vizatimorë, yje, ylbere etj.

Maska me pjata letre

Pjatat e letrës/kartonit mund t'i përdorni për krijimin e maskave për paradë, duke i dekoruar me materiale shumëngjyrëshe.



Parada e 1 Qershorit

Edukatori/ja kërkon persona mbështetës për t'i shoqëruar gjatë paradës; ata mund të jenë prindër apo vullnetarë nga komuniteti apo OJQ-të, të cilat kanë fushë veprimtarie edukimin dhe aktivitetet me fëmijë. Gjatë paradës, fëmijët kanë mundësi të shprehin përkrahjen e tyre për të gjithë fëmijët e botës, në mënyrë që ata të ndihen të vlerësuar dhe të përfshirë, të njihen me njëri-tjetrin dhe me komunitetin. Ju mund t'i dërgoni fëmijët në ndonjë hapësirë me lodra (parku i qytetit) apo në ndonjë organizim, që mund të jetë në kuadër të festimit të kësaj dite. Shoqëroni me këngë dhe recitime të ndryshme marshimin e paradës. Le të jetë kjo një ditë loje, gëzimi dhe sensibilizimi.

Vlerësimi:

Edukatori/ja vëzhgon ndërveprimin e fëmijëve jashtë ambientit të klasës përgatitore. Si reagojnë në ambiente të hapura, sa ndjekin udhëzimet për orientim, dhe sa janë të vëmendshëm për sigurinë në rrugë.

Më shumë për të bërë:

Në rast se moti është i papërshtatshëm, aktiviteti mund të realizohet edhe në ndonjë hapësirë publike të mbyllur, ku fëmijët mund të argëtohen dhe të sensibilizohen për këtë ditë të shënuar.

Reflektimi:

1, 2, 3, lojën fillojmë ne

Fusha kurrikulare:	Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti
Kurrikula lëndore:	Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti
Tema nga plani dymujor:	Lojëra elementare dhe koordinimi i tyre
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):	I. 3, 5; II. 1; III. 1, 3, 4; IV. 2, 4; V. 2, 5; VI. 1, 6
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):	Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti: 2.2.1 Gjuhët dhe komunikimi: 1.1; 1.4 Matematikë: 2.1
Rezultati i të nxënit të temës:	Merr pjesë në lojëra elementare dhe tregon shkathtësi gjatë aktiviteteve në poligone të thjeshta.
Rezultatet e të nxënit të aktiviteteve:	<ul style="list-style-type: none"> • Shkëmben vlerësime (opinion pozitiv) me shokët/shoqet në rrethin inkurajues. • Zbaton rregullat e lojës gjatë lojës me parashutë. • Zbaton mbledhjen dhe zbritjen e topave në parashutë.
Kriteret e suksesit:	<ul style="list-style-type: none"> • Thuaj një fjalë të mirë shokut ose shoqes. • Bashkohu me shokun/shoqen në lojën me parashutë. • Mblidh dhe zbrit topa në parashutë.
Burimet dhe materialet:	Një top me fije, parashutë (lojë), disa topa të madhësive të ndryshme.
Integrimi ndërfaqor:	Gjuhë shqipe, Matematikë.
Çështjet ndërkurrikulare:	Zhvillimi personal dhe aftësi për jetë.
Fjalë kyçe:	Rreth inkurajues, kompliment, shok/shoqe, miqësi, parashutë.
Organizimi i aktiviteteve:	Në takimin e përbashkët, edukatori/ja nxit fëmijët për një frymë pozitive, duke i ftuar ata në lojën e <i>rrethit inkurajues</i> .

Materialet: një top me fije.

- Kërkoni nga fëmijët të ulen në dysHEME në formë rrethore.
- Shpjegoni që secili fëmijë do të zgjedhë një fëmijë të cilit t'ia kalojë lëmshin me fill dhe në të njëjtën kohë t'i bëjë një koment pozitiv. Për shembull: "Unë zgjedh Zanën. Mua më pëlqen buzëqeshja e saj". E më tej ia pason topin Zanës. Aktiviteti vazhdon derisa të gjithë fëmijët të jenë përfshirë në rrethin inkurajues.
- Kujtojuni fëmijëve që të mendojnë për komplimentin e mundshëm që do të thonë kur t'u vijë radha.
- Me pasimin e lëmshit me fill, në mes të rrethit duke bërë një lidhje me gjithë secilin në grup.
- Shpjegoni që kur ne themi fjalë inkurajuese për njëri-tjetrin, bëhemi më të afërt dhe ndihemi mirë në grup.



Në këtë atmosferë pozitive, edukatori/ja fton fëmijët në lojëra të ndryshme në oborr. Në javën e lojës, fëmijët do të kenë mundësi të argëtohen në lojëra të ndryshme argëtuese dhe edukative njëherazi.

Lojëra me parashutë

Materialet: një parashutë, disa topa të madhësive të ndryshme.


Ecuria:

- “Prek qiellin” - të gjithë e ngrenë sa më lart që mundën parashutën.
 - “Prek dyshemenë” - të gjithë e zbresin parashutën në dysheme.
 - “Krijoni valë” - fëmijët valëvitin parashutën duke krijuar valë.
 - “Nën parashutë” - të gjithë nën parashutë.
 - “Sipër parashutës me një këmbë” - fëmijët ndjekin udhëzimet.
 - Risni vështirësinë duke i përsëritur sërish të njëjtat udhëzime, por duke vendosur disa topa në mes të parashutës, ku fëmijët do të ndjekin udhëzimet dhe do të përpiqen t’i mbajnë topat në parashutë.
 - Praktikoni mbledhje dhe zbritje me topat në parashutë, duke vendosur disa topa në mes të parashutës, fëmijët manovrojnë sipas udhëzimeve të edukatorit/es dhe kur topat bien jashtë, praktikojmë zbritjen “kishim pesë topa, na ka rënë një, sa kanë mbetur?”. Kështu vazhdojmë me mbledhjen, pasi edukatori/ja shton topat në parashutë.
- “Oqeani” - imagjinojmë që parashuta është një oqean. I vendosim një emër oqeanit. Pastaj fëmijët e lëvizin parashutën duke iu përgjigjur “raportimit të motit” që dëgjojnë.

P.sh.: “Kam dëgjuar që nesër do të ketë reshje të mëdha. - Fëmijët, duke iu përshtatur shpjegimit të motit, lëvizin parashutën me rrëmbim.

“Nesër do të jetë kohë me diell”. - Fëmijët rrotullohen bashkë me parashutën, duke pasur me vete imazhin e një dielli që rrezaton.

Pas përfundimit të lojërave me parashutë, fëmijët mbledhin topat dhe bashkërisht palosin parashutën; pastaj fëmijët qetësojnë frymëmarrjen, sipas udhëzimeve të edukatorit/es. Në takimin e përbashkët marrim informata kthyesë nga fëmijët se si janë ndier në rrethin inkurajues, si i kanë përjetuar lojërat, a kishte ndërveprim, a janë lodhur, cilat ishin sfidat me të cilat janë përballur gjatë lojës etj.



Vlerësimi:

Edukatori/ja vëzhgon shprehjen e fëmijëve në përdorimin e fjalëve inkurajuese për shoku/shoqen e grupit. Ata vëzhgohen gjatë ndërveprimit në lojërat me parashutë.

Më shumë për të bërë:

Ju mund të gjeni lloje të ndryshme të lojërave me parashutë te linku: <https://www.youtube.com/watch?v=uTrC4fIY7Co>

Reflektimi:

Kush fillon me Z?

Fusha kurrikulare:	Gjuhët dhe komunikimi
Kurrikula lëndore:	Gjuhë shqipe
Tema nga plani dymujor:	Tinguj, shkronja, rrokje, fjalë, fjali
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):	I. 3, 5; II. 1, 3, 7; III. 1, 2, 3, 6; IV. 4, 5; V. 2, 5; VI. 1, 6
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):	Gjuhët dhe komunikimi: 1.1; 1.4; 1.5; 3.2 Jeta dhe puna: 2.8.1 Matematikë: 3.5
Rezultati i të nxënit të temës:	Lexojnë dhe interpretojnë ilustrimet, fotografi, figura dhe objekte me fjalë e fjali të thjeshta.
Rezultatet e të nxënit të aktiviteteve:	<ul style="list-style-type: none"> • Luan me materiale të ndryshme për krijimin e shkronjës Z. • Praktikon kapjen me pincetë. • Plotëso shkronjën Z te libri i fëmijës.
Kriteret e suksesit:	<ul style="list-style-type: none"> • Luaj me materiale të ndryshme për krijimin e shkronjës Z. • Praktiko kapjen me pincetë. • Plotëson shkronjën Z te libri i fëmijës.
Burimet dhe materialet:	Kuti kartoni, objekte që fillojnë me shkronjën Z, karta të shkronjës Z, litar, ngjyra të lëngshme, fletë, gërsërë, ngjitës, materiale të ndryshme nga kutia me materialet e ripërdorshme, lojëra formuese/blloqe druri, <i>Lego etj.</i>
Integrimi ndërfaqor:	Shkathtësi për jetë, Matematikë.
Çështjet ndërkurrikulare:	Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.
Fjalë kyçe:	Shkronja Z, tingulli Z, objekte misterioze, identifikoj, kolazh, stampim.
Organizimi i aktiviteteve:	<p>Në takimin e përbashkët në rreth, edukatori/ja sjell “kutinë misterioze” dhe ia jep fëmijës që ka pranë. Ai/ajo, më pas, e kalon te fëmija ngjitur e kështu me radhë.</p> <p><i>“Kutia misterioze”</i></p> <p><i>Materialet:</i> një kuti kartoni, objekte të ndryshme që fillojnë me shkronjën Z, karta me shkronjën Z, fotografi të gjërave që fillojnë me shkronjën Z dhe një litar.</p> <p><i>Ecuria:</i> Në kutinë misterioze vendosni objekte të ndryshme që fillojnë me shkronjën Z dhe kaloheni te fëmijët, të cilët, pa e ditur çfarë ka brenda, do të përpiqen ta gjejnë në bazë të tingujve që shkaktojnë objektet. Më pas, ata mund të fusin dorën në të e të kuptojnë me anë të prekjes sendet, duke shpjeguar materialet dhe përbërjen e tyre: i butë, i fortë, plastikë, metal, letër, i lehtë, i rëndë etj. Pasi fëmijët të eksplorojnë materialet e ndryshme brenda kutisë, edukatori/ja nxjerr jashtë dhe vendos në mes të rrethit objektet e kutisë misterioze. Zemra, Zebër</p>

plastike, kartë me shkronjën Z, zinxhir, zarf, zile etj. Fëmijët emërtojnë objektet në mes të rrethit dhe bëjnë një përshkrim të tyre pa i prekur dhe pa i parë. Edukatori/ja hap diskutimin:

“Të gjitha fillojnë me të njëjtën shkronjë, e cila është shkronja e re me të cilën do të njihemi sot, shkronja Z. Z-zebra, Z-zinxhiri, Z-zarfi”. A mund të krijojmë një bashkësi me këto?

“Këto janë gjëra të ndryshme, por kanë një të përbashkët, se të gjitha fillojnë me të njëjtën shkronjë”. Numëroni objektet dhe futini në një rreth, duke formuar bashkësinë e gjërave që fillojnë me shkronjën Z. Fëmijët gjejnë fjalë që fillojnë me këtë shkronjë, jashtë dhe brenda objektit të klasës.

Në hapësirën e klasës përgatitni katër kënde me mundësi të ndryshme loje me shkronjën Z. Të gjitha aktivitetet të jenë të natyrave të ndryshme, por që të kenë për qëllim zhvillimin e muskujve të vegjël.


Stampimi - fëmijëve u jepet modeli i shkronjës Z, fletë dhe ngjyra uji. Me anë të stampimit të gishtave, fëmijët do të formojnë modelin e shkronjës Z.

Kolazhi - fëmijët krijojnë modelin e shkronjës Z me anë të kolazhit, duke përdorur materiale të ndryshme: me oriz, copëza revistash, shkopinj, pulla, rruaza etj. Mund të bëhet kolazh me shkronjën Z, të cilën edukatori/ja e përgatit në fletë të bardhë, ndërsa fëmijët presin copëza letre me ngjyrë të zezë dhe formojnë kolazhin e shkronjës Z në formë zebre me vija.

Ndërtim - formohet shkronja e re me anë të blloqeve formuese (Lego), druri, shkopinj druri etj., dhe komunikojnë me njëri-tjetrin mbi sasinë e materialeve të përdorura.

Shkrimi i shkronjës Z - jepuni fëmijëve disa forma të shkrimit të shkronjës me të cilën janë njohur, si:

- shkrimi në tabakanë me rërë;
- shkrimi në fletëzën e bardhë të plastifikuar;
- shkrimi me gisht sipër ndonjë sipërfaqeje të vrazhdë etj.



Nxitni fëmijët të diskutojnë mbi ndjesitë e krijuara gjatë përdorimit të rërës, sipërfaqes së vrazhdë, fletës së bardhë etj.

Në njërin kënd, fëmijët do të plotësojnë fletëzën e punës me shkronjën Z te libri i fëmijës. Përmes muzikës ritmike dhe kubit me kafshë, në takimin përmbyllës luajmë lojën “Imito lëvizjet e kafshëve”.



Vlerësimi:

Edukatori/ja vëzhgon fëmijët gjatë aktiviteteve me materiale të ndryshme në grupet e vogla.

Më shumë për të bërë:

Fëmijët mund të krijojnë një listë me prindërit, të cilën do ta plotësojnë në shtëpi, duke gjetur gjëra që fillojnë me shkronjën Z dhe duke i vizatuar, të renditura në formë liste.

Reflektimi:

Le të krijojmë plastelinë!

Fusha kurrikulare:	Matematikë
Kurrikula lëndore:	Matematikë
Tema nga plani dymujor:	Modelet
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):	I. 3, 5; II. 1, 3, 7; III. 1, 2, 3, 6; IV. 4, 5; V. 2, 5; VI. 1, 6
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):	Matematikë: 6.4 Gjuhët dhe komunikimi: 1.1; 1.4 Shkencat e natyrës: 1
Rezultati i të nxënit të temës:	Formon modele sipas vetive të objekteve.
Rezultatet e të nxënit të aktiviteteve:	<ul style="list-style-type: none"> • Ndjek udhëzimet për lëvizje, duke iu referuar ngjyrës që ka në trup. • Mat përbërësit gjatë procesit të krijimit të plastelinës. • Krijon modele të ndryshme me plastelinë.
Kriteret e suksesit:	<ul style="list-style-type: none"> • Ndiq udhëzimet për lëvizje, duke iu referuar ngjyrës që ke në trup. • Mat përbërësit gjatë procesit të krijimit të plastelinës. • Luaj e krijo modele me plastelinë.
Burimet dhe materialet:	Karta me ngjyra, përbërësit për krijimin e plastelinës (receta) kartat e numrave, kartat e formave, plastelinë, shkopinj druri.
Integrimi ndërfaqor:	Gjuhë shqipe, Njeriu dhe natyra.
Çështjet ndërkurrikulare:	Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.
Fjalë kyçe:	Ngjyra, përbërës, matje, plastelinë, recetë.
Organizimi i aktiviteteve:	Takimi i përbashkët fillon me plotësimin e kalendarit të motit, duke vazhduar me lojën "Ngjyrat tona". Edukatori/ja fillon lojën, duke i nxitur fëmijët të flasnin për ngjyrat që na rrethojnë, cilat janë ngjyrat kryesore, ç'ndodh pasi i përziejme këto ngjyra etj. Loja fillon duke thënë: "Të ngrihen më këmbë të gjithë ata që kanë ngjyrë të kuqe.". Të gjithë fëmijët me një veshje të kuqe në trup ngrihen në këmbë dhe lëvizin përreth, ndërsa fëmijët e tjerë qëndrojnë ulur. Jepni një kriter për lëvizjen, që fëmijët do ta bëjnë gjatë rrotullimit në rreth, si p.sh.: "Të gjithë ata që kanë diçka të kuqe, të ngrihen dhe të fluturojnë rreth rrethit" ose "Të gjithë ata që kanë diçka të kaltër, të ngrihen dhe të kërcëjnë me një këmbë rreth rrethit; kërcëjnë si kangur, lëvizin si astronauti në hapësirë, si bretkosa...". Kur të gjithë fëmijët të kenë pasur rastin të lëvizin në lojë, edukatori/ja i fton të ulen në rreth dhe sjell letrat me ngjyra të ndryshme, duke i nxitur fëmijët t'i emërtojnë ato, por këtë emërtim ta shoqërojnë me cilësime, si: kjo është ngjyra e verdhë, i verdhë është dielli etj. Te këndi i shkencës, edukatori/ja u prezanton fëmijëve materialet dhe ngjyrat me të cilat do të luajnë dhe prezanton recetën e plastelinës:

Receta e plastelinës:

- 2 gota miell;
- 1 gotë krip;
- 1/2 e gotës ujë të vakët;
- 2 lugë gjelle vaj;
- 2 lugë gjelle ngjyrë (ushqimi).

Filloni procesin e krijimit të plastelinës, duke treguar qartë matjet dhe recetën. Numëroni bashkërisht përbërësit dhe ndjekjen e hapave. Pasi të keni përfituar plastelinën, ndajeni në disa pjesë dhe shtojini ngjyra të ndryshme, pastaj mund të tregoni edhe përzierjen e disa ngjyrave (në varësi të grupit, masa mund të shumëfishohet). Ndani plastelinë të mjaftueshme për secilin grup punues dhe bashkë me të, u ofroni edhe materiale të tjera shtesë për të përdorur gjatë lojës. Ju mund të krijoni disa kënde në klasën tuaj dhe të shtoni materiale të ndryshme, që fëmijët të lëvizin nga njëri kënd në tjetrin, duke provuar teknika të ndryshme të punës me plastelinë. Ndërtojnë banesa dhe objekte me shkopinje e plastelinë; përdorin topëza plasteline për të bërë lidhjen e shkopinjve.



Grupi tjetër i fëmijëve krijojnë punë artistike sipas dëshirës. Një grup tjetër mund të luajë me lojëra matematikore duke përdorur kartat e numrave e të formave. Ata mund të modelojnë numra dhe forma gjeometrike duke u bazuar te modeli, ose të stampojnë numra sipër plastelinës, duke lënë gjurmët e numrit në të. Në takimin e përbashkët, nxisni fëmijët për diskutim, duke i pyetur se si u është dukur puna me plastelinë. Ata shpjegojnë procesin teksa rikujtojnë ecurinë e punës dhe ndjekjen e hapave. Bashkë me fëmijët këndohet një këngë përshëndetëse dhe përshëndetemi me njëri-tjetrin.

Vlerësimi: Fëmijët vëzhgohen për ndërveprimin në pjesën e lojës me ngjyra në rreth dhe te punët me plastelinë.

Më shumë për të bërë: Ju mund të bëni një kopje të recetës së plastelinës për çdo fëmijë, që ata ta marrin me vete në shtëpi.

Reflektimi: _____

Çfarë mund të gjejmë në natyrë?

Fusha kurrikulare:	Artet
Kurrikula lëndore:	Edukim figurativë
Tema nga plani dymujor:	Llojet e shprehjeve figurative
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):	I. 3, 5; II. 1, 3, 7; III. 1, 2, 3, 6; IV. 4, 5; V. 2, 5; VI. 1, 6
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):	Gjuhët dhe komunikimi: 1.1; 1.7 Matematikë: 3.5 Artet: 3
Rezultati i të nxënit të temës:	Fëmijët dallojnë se ka lloje të ndryshme të arteve, ose mënyrave të shprehjes figurative ndërmjet vizatimit, pikturës, skulpturës, grafikës, dizajnit, arkitekturës, fotografisë, instilacionit etj.
Rezultatet e të nxënit të aktiviteteve:	<ul style="list-style-type: none"> • Imiton lëvizjet trupore. • Plotëson listën e sendeve që vëzhgon nga natyrës. • Krijon art me materiale nga natyra.
Kriteret e suksesit:	<ul style="list-style-type: none"> • Bëj lëvizjet që bën ai/ajo në mes të rrethit. • Plotëso listën e sendeve të natyrës. • Krijoi punë artistike me materiale nga natyra.
Burimet dhe materialet:	Lista e sendeve të natyrës nga libri i fëmijës, lapsa, gërshërë, ngjitës, fletë, çekiç druri (ose blloqe druri) gjethe, lule, shkopin/degë dhe materiale zbukuruese.
Integrimi ndërfaqor:	Gjuhë shqipe, Matematikë, Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti.
Çështjet ndërkurrikulare:	Ndërmarrësi.
Fjalë kyçe:	Imitim, vëzhgim, natyrë, listë, të dhëna, kolazh.
Organizimi i aktiviteteve:	<p>Në takimin e përbashkët, fëmijët tregojnë për pasditen e tyre, flasin për kohën e lirë, miqtë e tyre, lojërat dhe librat që u kanë lexuar apo filmin që kanë parë. Nxitni fëmijët të cilët nuk janë shumë aktivë në diskutimet e hapura, duke u pasuar një top, që do të thotë se fëmija që pret topin, mund të përgjigjet.</p> <p>Koha e lëvizjeve në takimin e përbashkët në rreth.</p> <p><i>Ecuria:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • Kërkoni nga fëmijët të ngrihen në këmbë në rreth. • Edukatori/ja qëndron në mes të rrethit dhe tregon lëvizje trupore para fëmijëve, si kërcim poshtë e lart, prek shpatullat, majën e këmbëve, rrotullohet, imiton ndonjë kafshë, bën si balerinë, bën sikur është me ski etj. • Kërkoni nga fëmijët të imitojnë lëvizjet që ju bëni, duke thënë vargjet ritmike:


*“Kjo është lëvizja ime,
lëvizja që unë bëj,
Mund të bësh dhe ti si unë,
Fillo një, dy, tre!”*

- Zgjidhni një fëmijë që të hyjë në mes të rrethit dhe të thotë vargjet ritmike, duke pasuar pastaj me një lëvizje të tij/saj.
- Vazhdoni kështu derisa të kenë provuar të gjithë fëmijët që kanë dëshirë.

Pas përfundimit të lojës lëvizore, fëmijët çlodhen pak dhe rregullojnë frymëmarrjen. Edukatori/ja paraqet para tyre një peizazh natyre (vepër arti) dhe i nxit ta komentojnë atë që shohin, çfarë paraqet natyra për ta, në cilën stinë u pëlqen natyra më shumë, si ndryshon ajo nga stina në stinë, çfarë shohim në natyrë etj. Më tej u jep fëmijëve një listë me disa gjëra të cilat mund t’i shohin fëmijët në natyrë (fletëz pune te libri i fëmijës). Pasi fëmijët të marrin fletëzat për vëzhgimin e natyrës, dalin në oborrin e shkollës/institucionit dhe vrojtohet natyra përreth, duke kërkuar gjërat të cilat i kanë në fletëz, duke i shënuar me një shenjë. Fëmijët do të marrin lule, bar, copëza druri, gjethe etj., për të krijuar një vepër artistike me to. Fëmijët kthehen në klasë, në rreth, raportohen rezultatet e fletëzës të natyrës, duke bërë një vëzhgim të gjërave që kanë parë.

Koha për art!

Ndani fëmijët në grupe dhe secilin grup e pajisni me materialet që ata kanë mbledhur në natyrë, duke ju ofruar edhe fleta të forta, ngjites, gërshërë.



Njëri grup punon me shtypjen e luleve dhe gjetheve me çekiç druri, duke lënë gjurmë në fletën e bardhë. Të tjerët bëjnë kolazh, ose krijojnë dekorime nga natyra, punojnë me gjethe etj. Fëmijët mund të lihen të lirë të krijojnë me materialet e mbledhura. Punimet e realizuara shfaqen te këndi i artit dhe aty mblidhemi për takimin e përbashkët, ku bashkëbisedojmë për punën e bërë. Fëmijët mund të përdorin edhe aparat fotografik për të dokumentuar punimet e tyre artistike.

Vlerësimi:

Edukatori/ja ndjek punën e fëmijëve gjatë vëzhgimit të natyrës, mbajtjes së të dhënave dhe raportimit të tyre. Dokumentohet përmes fotografisë puna artistike e fëmijëve.

Më shumë për të bërë:

Ju mund të përgatisni një fletë për vëzhgimin e natyrës, që fëmijët që ta marrin me vete dhe të vëzhgojnë natyrën pranë shtëpisë së tyre. Të dhënat do t’i ndajnë të nesërmen para grupit. Inkurajoni fëmijët që me ndihmën e prindërve të tyre të përdorin aparat fotografik/telefonin që të dokumentojnë gjëra nga natyra që për ta kanë rëndësi.

Reflektimi:

Zhanret muzikore

Fusha kurrikulare:	Gjuhët dhe komunikimi
Kurrikula lëndore:	Gjuhë shqipe
Tema nga plani dymujor:	Tinguj, shkronja, rrokje, fjalë, fjali
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):	I. 3, 5, 6; II. 7, 8; III. 1, 2, 3, 6; IV. 2; V. 2, 5; VI. 1, 4, 5, 6
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):	Gjuhët dhe komunikimi: 1.1; 1.3; 1.4; 1.5; 3.2 Matematikë: 3.4 Edukatë fizike, sporte dhe shëndeti: 1
Rezultati i të nxënit të temës:	Vizatojnë dhe modelojnë me materiale të ndryshme, i emërtojnë ato me fjalë dhe u tregojnë të tjerëve çfarë ka dashur të paraqesë ndërmjet vizatimeve, figurave etj.
Rezultatet e të nxënit të aktiviteteve:	<ul style="list-style-type: none"> • I tregojnë shokut/shoqes për muzikën që i pëlqen. • Gjen fjalë me shkronjën "ZH". • Modelon shkronjën "ZH" me materialet që ka në dispozicion.
Kriteret e suksesit:	<ul style="list-style-type: none"> • Diskuto për llojin e muzikës që të pëlqen. • Gjej fjalë me shkronjën "ZH". • Modelo shkronjën "ZH" me materialet që ke në dispozicion.
Burimet dhe materialet:	"Enciklopedi e ilustruar për fëmijë" CD (magnetofon), libri i fëmijës, materiale të ndryshme ricikluese.
Integrimi ndërfaqor:	Matematikë, Edukatë fizike, sporte dhe shëndeti.
Çështjet ndërkurrikulare:	Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.
Fjalë kyçe:	Muzikë, këngë, valle, shkronja "ZH".
Organizimi i aktiviteteve:	<p>Dita fillon me përshëndetjen; bisedohet me fëmijët se si e kanë kaluar ditën e djeshme dhe vihet të dëgjojnë një pjesë muzikore të përzgjedhur nga vetë ata. Paraprakisht, edukatori/ja siguron lloje të ndryshme të stileve muzikore në CD. Kërkoni nga fëmijët të bëjnë përzgjedhjen e muzikës që duan të dëgjojnë, por zhanret mund të ndryshohen pas disa minutash. Vëzhgon fëmijët si po reagojnë në atë lloj muzike, nëse përpiqen të këndojnë së bashku dhe nëse po ndien mirë. <i>(Ju duhet të njihni fillimisht materialin muzikor dhe më pas ta përdorni atë me fëmijët, karakteri edukativ është elementi i parë që duhet të plotësojë secila këngë që do të vendosni.)</i></p> <p>Pas vallëzimit dhe këngës, fëmijët ulen në formë gjysmërrethi dhe flasin me të tjerët se cila lloj muzike u pëlqen më shumë. Rekomandohet që fëmijët gjatë gjithë javës të dëgjojnë muzikë të stileve të ndryshme, por do të ishte mirë që krahas muzikës për fëmijë, të vendosen edhe pjesë të muzikës klasike, popullore, në varësi të kërkesave të fëmijëve.</p>

Edukatori/ja u lexon pjesë nga libri “Enciklopedi e ilustruar për fëmijë”. Çfarë është muzika, pse duhet muzika, si shkruhet muzika, orkestra dhe bandat, zhanret muzikore? Flasin për zhanret muzikore që iu pëlqyen më shumë. Edukatori/ja u shpjegon fjalën “zhanër”, duke u integruar natyrshëm në shkronjën “ZH”. Kërkon nga fëmijët të gjejnë fjalë me këtë tingull, fjalët e gjetura, t’i ndajnë në rrokje. Ai/ajo paraqet grafikisht shkronjën e ditës; fëmijët do të bëjnë gjurmët e shkronjës në materiale të ndryshme: miell, kripë, oriz, sheqer. Pjatat vendosen në rreth dhe kalohen nga njëri fëmijë te tjetri në radhë. Dita vazhdon me aktivitetet nëpër qendra. Në njërën qendër vendosen materiale nga natyra ku fëmijët do të modelojnë grafikun e shkronjës ZH, ndërsa në një tjetër, ata do të plotësojnë fletëzën epunës. Në një qendrën tjetër, edukatori/ja ka përgatitur një lojë matematikore për grup të vogël, që ndërlidhet me shkronjën ZH. Gjatë zhvillimit të aktivitetit, edukatori/ja vendos muzikë me volum të ulët, duke bërë përpjekje që muzika të jetë e zhanreve të ndryshme. Fëmijët kthehen në rreth, diskutojnë mbi punën e bërë në qendra dhe luajnë një lojë ritmike së bashku.

Vlerësimi:

Fëmijët vëzhgohen gjatë zhvillimit të aktiviteteve, edukatori/ja mban shënime gjatë vëzhgimit. Ai/ajo mund të përdorë lista kontrolli në varësi të fokusit të vëzhgimit.

Më shumë për të bërë:

Pyesni prindërit nëse ndonjëri nga ata luan në ndonjë instrument të caktuar për ta përfshirë në veprimtarinë ditore ose së paku nëse në familjet e tyre kanë një instrument, në mënyrë që të ta sjellin në klasë. Kërkoni nga fëmijët të sjellin diçka nga shtëpia, që mund të përdoret për të krijuar muzikë ose për të lëshuar një tingull; ose oriz të ngjyrosur me bojëra uji.

Reflektimi:

Instrumentet tona muzikore

Fusha kurrikulare:	Jeta dhe puna
Kurrikula lëndore:	Shkathtësi për jetë
Tema nga plani dymujor:	Materialet dhe riciklimi
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):	I. 3, 5, 7, 8; II. 1, 3, 7; III. 1, 2, 3, 7; IV. 2; V. 2, 5; VI. 1, 4, 6
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):	Jeta dhe puna: 3.3.2 Gjuhët dhe komunikimi: 1.1; 1.7 Matematikë: 6.2 Artet: 2
Rezultati i të nxënit të temës:	Krijon punime të ndryshme duke përdorur materiale ricikluese (materiale natyrale, artificiale).
Rezultatet e të nxënit të aktiviteteve:	<ul style="list-style-type: none"> • Identifikon lloje të ndryshme të instrumenteve muzikore. • Dallon instrumentet frymore, me tela dhe ato me goditje. • Me material riciklues, krijon instrumentin e tij/saj muzikor.
Kriteret e suksesit:	<ul style="list-style-type: none"> • Identifiko lloje të ndryshme të instrumenteve muzikore. • Dallo instrumentet frymore, me tela dhe ato me goditje. • Me material riciklues, krijo instrumentin tënd muzikor.
Burimet dhe materialet:	Materiale të ripërdorëshme letre, qelqi, plastikë dhe metali, shishe të madhësive të ndryshme, lugë, vezë plastike, kuti këpucësh, hapëse vrimash, llastik, bojëra uji, shirita zbukurues, fletë A2.
Integrimi ndërfaqor:	Gjuhë shqipe, Matematikë, Edukatë figurative.
Çështjet ndërkurrikulare:	Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.
Fjalë kyçe:	Instrumente muzikore, me frymë, me goditje dhe me tela (daulle, fyelli, violina, violonçeli, piano, defi, kitara, flauti, klarineta).
Organizimi i aktiviteteve:	Dita fillon nën tingujt e muzikës, pasi edukatori/ja ka vendosur muzikë me zë të ulët në sfond. Përveç fëmijëve, sot kemi të ftuar edhe prindërit vullnetarë; luhet loja: "Shëtitja muzikore". Edukatori/ja ka shpërndarë në dhomë vezë, brenda të cilave ka vendosur fotografi të instrumenteve muzikore. Kështu, edukatori/ja kërkon nga fëmijët që nën tingujt e muzikës klasike, të bëjnë një shëtitje nëpër dhomë, me qëllim që të gjejnë surprizën. Fëmijët lëvizin të lirë nëpër dhomë, për të zbuluar se ku janë fshehur vezët. Nëse njëri prej tyre gjen një vezë, kthehet në rreth, e hap dhe pret të tjetrët. Kur të gjithë fëmijët të kenë gjetur nga një vezë, fillon bashkëbisedimi për fotografitë e zbuluara. Diskutohet për secilën nga fotografitë duke u përpjekur të shohim të veçantat dhe të përbashkëtat e instrumenteve. Edukatori/ja ia del që në fund, përmes diskutimit me fëmijët, të klasifikojnë instrumentet në instrumente frymore, me tela dhe me goditje. Fëmijët do ta vendosin ilustrimin e tyre në një

fletë A2, ku do të grupohen instrumentet sipas klasifikimeve në frymore, me tela dhe me goditje. Edukatori/ja, në bashkëveprim me prindërit, ka siguruar materiale ricikluese për punimin e instrumenteve muzikore. Fëmijët shprehin dëshirat për instrumentin që do të krijojnë, pastaj ndahen në grupe të vogla punuese për të punuar instrumentet. Në varësi të kërkesave të fëmijës ndërtohen edhe instrumentet. Çdo fëmijë me zgjedhje të lirë merr pjesë në grupin në të cilin dëshiron. Nëse në një grup, numri i fëmijëve është i madh, atëherë ky grup mund të ndahet në dy grupe të tjera përbërëse. Prindërit vullnetarë do t'i ndihmojnë fëmijët sipas nevojës në krijimin e instrumenteve muzikore.

Njëri grup do të krijojë instrumentet me goditje. Tjetri do të ndërtojë instrumente me tela.

Një tjetër grup do të krijojë instrument frymor, duke përdorur pipëzave të madhësive të ndryshme. Fëmijët janë të lirë të gjejnë mënyra krijuese të ndërtimit të instrumenteve, mjafton që të kenë ndihmën e nevojshme nga prindërit dhe nga edukatori/ja.

Pasi të krijojnë instrumentet, fëmijët kthehen në rreth për takimin përmbyllës dhe luajnë melodi të ndryshme me instrumentet e krijuara.

Vlerësimi:

Edukatori/ja vëzhgon fëmijët në mënyrë të vazhdueshme dhe mban shënime për punën e tyre, por edhe i nxit ata drejt zgjidhjes së situatave problemore.

Më shumë për të bërë:

Ju mund të kërkoni më shumë për ndërtimin e instrumenteve muzikore edhe në linkun: <https://feltmagnet.com/crafts/Music-Instruments-for-Kids-to-Make>

Nëse në mesin e prindërve ka nga ata që mund të luajnë në instrumente, krijoni hapësirën e duhur që ata të mund të luajnë para fëmijëve dhe po ashtu fëmijëve t'u krijohet mundësia ta eksplorojnë nga afër krijimin e tingujve nga instrumenti.

Reflektimi:

Gjuha e tingujve

Fusha kurrikulare:	Shkencat natyrore
Kurrikula lëndore:	Njeriu dhe natyra
Tema nga plani dymujor:	Trupat dhe lëvizja e tyre
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):	I. 3, 5, 7, 8; II. 1, 3, 7; III. 1, 2, 3, 7; IV. 2; V. 2, 5; VI. 1, 4, 6
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):	Shkencat natyrore: 1.1.2 Gjuhët dhe komunikimi: 1.1; 1.7 Matematikë: 1.4
Rezultati i të nxënit të temës:	Identifikon gjatë këndimit zërin më të lartë nga zëri më i ulët.
Rezultatet e të nxënit të aktiviteteve:	<ul style="list-style-type: none"> • Krijon tinguj, duke përdorur objekte të jetës së përditshme. • Përdor instrumentin e krijuar për të deshifruar tingujt. • Eksperimenton me materiale për të krijuar tinguj.
Kriteret e suksesit:	<ul style="list-style-type: none"> • Krijon tinguj, duke përdorur objekte të jetës së përditshme. • Përdor instrumentin e krijuar për të deshifruar tingujt. • Eksperimento me materiale për të krijuar tinguj.
Burimet dhe materialet:	Instrumentet e krijuara, fletë A1, ngjyra, fletëza e punës.
Integrimi ndërfushor:	Gjuhë shqipe, Matematikë.
Çështjet ndërkurrikulare:	Globalizimi dhe ndërvarësia.
Fjalë kyçe:	Dita e Paqes, këngë, instrument muzikor, tinguj, krijim i tingujve, tinguj të natyrës, botës rreth nesh, tinguj muzikor.
Organizimi i aktiviteteve:	<p>Dita fillon me përshëndetjen me fëmijët dhe ndërrimin e kalendarit. Edukatori/ja bashkëbisedon me fëmijët për Ditën e Paqes, më 12 qershor. Së bashku me fëmijët diskutohet kjo festë, rëndësia dhe domethënia e saj. Në kor këndohet kënga: “Nëse jemi vërtet të lumtur”, duke e shoqëruar me lëvizje.</p> <p>Edukatori/ja sjell në rreth 6 gota bosh dhe më pas i mbush me ujë me nivele të ndryshme. U kërkon fëmijëve që t’i godasin lehtësisht e të dëgjojnë tingujt e krijuar. Edukatori/ja flet për notat muzikore dhe shpjegon se edhe muzika ka gjuhën e saj të shkruar.</p> <p>DO_RE_MI_FA_SOL_LA_SI</p> <p>Edukatori/ja godet gotat dhe këndon lehtas notat muzikore. Pasi fëmijët të kenë krijuar një ide mbi mënyrën sesi funksionojnë notat muzikore, ata do të marrin instrumentet e tyre muzikore dhe do të praktikojnë notat. Më pas do të shpërndahen në qendrat e aktivitetit:</p>

Te këndi i gjuhës, edukatori/ja ka përgatitur ilustrimet e 15 instrumenteve muzikore. Fëmijët do ta shoqërojnë instrumentin me shkronjën e parë të emrit të tij.

Te këndi i matematikës, edukatori/ja ka përgatitur një aktivitet për grup të vogël. Ai/ajo ka përgatitur 7 kitara, në pjesën e ngushtë të së cilës është vendosur një numër. Fëmijët në grupe të vogla ose në dyshe do të ngjisin nëpër kitara aq "tela" (fije peri) sa tregon numri. Në këndin e shkencës do të eksperimentojnë me materiale të ndryshme, druri, plastike, metali për të eksploruar prodhimin e tingujve.

Fëmijët ndryshojnë këndet e aktiviteteve dhe secili do të ketë mundësi të provojë aktivitete nëpër qendra. Ata/ato kthehen në rreth dhe rikujtojmë aktivitetet e bëra gjatë ditës.

Vlerësimi: Edukatori/ja vëzhgon fëmijët gjatë punës dhe mban shënime të vazhdueshme, bazuar në planin e vlerësimit.

Më shumë për të bërë: Ju mund t'i dërgoni fëmijët në ndonjë shkollë muzike, teatër, ose ansambël muzikor në varësi të mundësive që mund të krijojë mjedisi ku jetoni. Është mjaft e rëndësishme që fëmijët të marrin një eksperiencë pozitive mbi muzikën e mirëfilltë.

Reflektimi:

Argëtohem me muzikën (vizitë)

Fusha kurrikulare: Artet

Kurrikula lëndore: Edukatë muzikore

Tema nga plani dymujor: Llojet e muzikës

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): **I.** 3, 5, 7, 8; **II.** 1; **III.** 3, 7; **IV.** 4; **V.** 2, 5; **VI.** 1, 4, 6

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): Artet: 3
Gjuhët dhe komunikimi: 1.1; 1.6
Edukatë fizike, sportet dhe shëndetit: 1

Rezultati i të nxënit të temës: Njeh institucion muzikor në vendin, qytetin/vendbanimin e tyre.

Rezultatet e të nxënit të aktiviteteve:

- Dallon muzikën instrumentale nga ajo vokale përmes dëgjimit.
- Përshkruan së paku tri instrumente muzikore.
- Këndon dhe vallëzon.

Kriteret e suksesit:	<ul style="list-style-type: none"> • Dallo muzikën instrumentale nga ajo vokale përmes dëgjimit. • Përshkruaj së paku tri instrumente muzikore. • Këndo dhe vallëzo.
Burimet dhe materialet:	Vizita në shkollën e muzikës.
Integrimi ndërfaqësor:	Gjuhë shqipe, Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti.
Çështjet ndërkurrikulare:	Globalizimi dhe ndërvarësia.
Fjalë kyçe:	Shkolla e muzikës, flaut, kitarë, piano, koncert.
Organizimi i aktiviteteve:	<p>Për vizitën në shkollën e muzikës, prindërit dhe fëmijët janë njoftuar ditë më parë. Në takimin e përbashkët, edukatori/ja u përsërit rregullat që duhen respektuar, kur bëjmë vizita në institucione. Të shoqëruar nga një prind, do të shkohet në pikëmbërritje me një mjet transporti të sigurt.</p> <p>Në shkollë, fëmijët priten nga disa mësues/e të shkollës së muzikës. Gjatë vizitës, ata njihen me ambientin, sallat e koncerteve dhe me klasat. Fëmijëve u jepet mundësia të takojnë muzikantë e të shohin nga afër instrumente muzikore; mund të jenë të pranishëm në ndonjë orë provash në flaut, kitarë, piano, violinë etj. Ata do të shohin, prekin dhe luajnë në instrumente të ndryshme. Mund të praktikojnë edhe gjetjen e notave muzikore nën shoqërimin e mësimitdhënësve përkatës. Fëmijët falënderojnë dhe duartrokasin muzikantët. Pas përshëndetjes, bëhet kthimi i sigurt për në mjediset e institucionit parashkollor/shkollës.</p>
Vlerësimi:	Përmes videove dhe fotografive, dokumentohen aktivitetet e fëmijëve.
Më shumë për të bërë:	Në linkun https://www.letsplaymusic.com/ mund t'u mësoni fëmijëve notat muzikore.
Reflektimi:	_____

Sa shumë gjëra mësuam ne!

Fusha kurrikulare:	Gjuhët dhe komunikimi
Kurrikula lëndore:	Gjuhë shqipe
Tema nga plani dymujor:	Tinguj, shkronja, rrokje, fjalë, fjali
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):	I. 3, 5; II. 7, 8; III. 1, 3, 6; IV. 2; V. 2, 5; VI. 1, 6
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):	Gjuhët dhe komunikimi: 1.1; 1.3; 1.4; 1.5 Matematikë: 1.4 Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti: 2.2
Rezultati i të nxënit të temës:	Shkëmbejnë ide me të tjerët për gjëra të ndryshme që u interesojnë, si: fotografi, ilustrime, figura, lodra.
Rezultatet e të nxënit të aktiviteteve:	<ul style="list-style-type: none"> • Gjen numrat e humbur dhe i vendos në zarfin me numrin përkatës. • Identifikon shkronjat te loja "Shporta e shkronjave". • Emërton muajt e vitit te plotësimi i kalendarit.
Kriteret e suksesit:	<ul style="list-style-type: none"> • Gjej numrat e humbur dhe vendosi në zarfin me numrin përkatës. • Identifiko cilën shkronjë ke pas shpine te loja "Shporta e shkronjave". • Emërto muajt e vitit te plotësimi i kalendarit.
Burimet dhe materialet:	10 zarfe, fletë të bardha, laps, gërshtë, kartat e formave, kartat e shkronjave, një kosh, një kuti.
Integrimi ndërfaqor:	Matematikë, Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti.
Çështjet ndërkurrikulare:	Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.
Fjalë kyçe:	Kalendar, viti, muaji, java, numrat, format gjeometrike, shkronjat.
Organizimi i aktiviteteve:	<p>Edukatori/ja nis takimin e përbashkët me përhëndetjen dhe luajnë lojën: "Të gjithë lepujt e vegjël"</p> <p><i>Ecuria:</i> Recitoni vargjet e mëposhtme për të vënë qetësi në fillim të takimit tuaj në rreth (përdorni melodinë e këngës "Rrotat e autobusit").</p> <p><i>Të gjithë lepujt e vegjël kërcejnë hop, hop, hop, hop, hop, hop - Hop, hop, hop.</i></p> <p><i>Të gjithë lepujt e vegjël kërcejnë hop, hop, hop, në këtë rreth.</i></p> <p><i>Të gjithë lepujt e vegjël ulen poshtë në rreth, poshtë në rreth - poshtë në rreth;</i></p> <p><i>të gjithë lepujt e vegjël ulen poshtë në rreth dhe pushooooojnë të qetë.</i></p> <p>(Vargjet i shoqëroni me veprime, mimikë dhe me një ton të veçantë të zërit). Dhe në atmosferë të gëzueshme i kthehemi plotësimit të kalendarit, duke u ndalur më gjatë dhe duke e analizuar tërë kalendarin</p>

në përgjithësi.

Këndojmë këngën “Java ka shtatë ditë” (Barni) dhe më pas diskutojmë pyetjet e mëposhtme:

- Sa ditë ka java?
- Sa ditë ka një muaj?
- Cilët janë muajt e vitit?
- Sa muaj ka viti?

“Në klasën tonë përgatitore kemi qenë bashkë për një vit. Një vit ky me plot aventura fantastike, shoqëri, aktivitete dhe njohuri të shumta. Tani ju dini aq shumë gjëra, të cilat më parë nuk i keni ditur, jeni rritur së bashku, jeni një grup fëmijësh të gatshëm për shkollë! Dita mund të jetë e mbushur me aktivitete të ndryshme, përmes të cilave fëmijët do të bëjnë një përsëritje të tërësishme të koncepteve kryesore, të cilat i kanë mësuar gjatë këtij viti.

Loja me numra “Gjuhëtarët e numrave”:

Materialet: 10 zarfe 2”x2”, letra katrore, laps.



Ecuria:

- Shkruani numrat nga 1-10 në pjesën e përparme të zarfeve. Shkruani numrat nga 1-10 në katrorët prej letre (sigurohuni që brenda zarfit të ketë disa kopje të secilit numër, që të ketë numra për secilin fëmijë).
- Paraqisni zarfet me numra në dysheme në mes të rrethit apo i ngjisni ato në mure. Sigurohuni që zarfet të jenë lehtësisht të arritshme.
- Fshihni numrat. Sigurohuni që fëmijët të mund t’i gjejnë ato me lehtësi. Procesi i gjetjes së numrave nuk duhet të jetë i vështirë dhe lodhës për fëmijët.
- Diskutoni aktivitetin me fëmijët. Kërkojuni atyre të gjejnë numrat dhe t’i vendosin në zarfet përkatëse.
- Pasi të jenë vendosur të gjithë numrat në zarfet përkatëse, zbrazini dhe verifikojini. Luani, numëroni, krahasoni, ku ka më pak, ku më shumë, përdorni numërimin rendor etj. (ju mund ta modifikoni aktivitetin edhe për gjuetinë e shkronjave.)

Së bashku me fëmijët, dalim në natyrë për të luajtur lojëra të tjera. Ju mund t’i zhvillonit të dyja lojërat apo të përzgjidhni njëren prej tyre.

Loja “Shporta me shkronja”

Materialet: kartat e shkronjave, një shportë.

Ecuria: Fëmijët ulen në rreth dhe ngrihet një vullnetar, i cili mban në dorë shportën me shkronja dhe rrotullohet nga ana e jashtme e rrethit, duke recituar:

*1, 2, 3, një shportë me shkronja kemi ne.
Një do t’ia lë shokut tim,
duhet ta gjej me nxitim!*

Fëmija me shportë ia vendos pas shpinës njërit prej fëmijëve një shkronjë dhe e prek në krah. Ai/ajo merr shkronjën, e identifikon atë dhe merr rolin e shpërndarësit të shkronjave. Vazhdohet kështu me fëmijët e tjerë derisa të mbarojnë të gjitha shkronjat.

Loja "Format rreth nesh"

Materialet: kartat e formave gjeometrike, një kuti.

Ecuria: Vendosni kartat e formave gjeometrike në një kuti dhe ftoni fëmijët që të marrin me radhë nga një kartë, të cilën do ta emërtojnë dhe do të shikojnë përreth për të gjetur objekte të cilave u përgjigjet forma që ka në kartë. P.sh.: "Unë kam kartën me formën drejtkëndore dhe dera e klasës sonë është drejtkëndore".

Vlerësimi: Fëmijët vëzhgohen për shkathtësitë në njohjen e kalendarit, stinëve të vitit, njohjen e numrave, figurave gjeometrike dhe të shkronjave.

Më shumë për të bërë: Edukatori/ja mund të përgatisë një material "Atëherë dhe tani" (PowerPoint, poster etj.) mbi aktivitetet e zhvilluara nga fëmijët gjatë vitit.

Reflektimi: _____

Si është të jesh në klasën e parë?

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi

Kurrikula lëndore: Shoqëria dhe mjedisi

Tema nga plani dymujor: Unë vendos për veten time

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I. 3; II. 7, 8; III. 1, 3, 6; IV. 2; V. 2, 5; VI. 1. 6

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): Shoqëria dhe mjedisi: 4
Gjuhët dhe komunikimi: 1.1; 1.4
Matematikë: 3.5

Rezultati i të nxënit të temës: Identifikon vendime që mund të marrë për veten, në raport me moshën.

Rezultatet e të nxënit të aktiviteteve:

- Zbulon rrugën e duhur të fshehur te loja me tabelë.
- Njihet me ambientin dhe ecurinë e klasës së parë.

Kriteret e suksesit:

- Zbulon rrugën e duhur të fshehur te loja me tabelë.
- Njihet me ambientin dhe ecurinë e klasës së parë.

Burimet dhe materialet: Shirit ngjitës, një zile.

Integrimi ndërfaqor: Gjuhë shqipe, Matematikë.

Çështjet ndërkurrikulare: Edukimi për qytetari demokratike.

Fjalë kyçe: Klasë e parë, mësuese, klasë përgatitore, profesion.

Organizimi i aktiviteteve: Në takimin e përbashkët, pas plotësimit të kalendarit dhe këngës përshëndetëse, edukatori/ja pyet fëmijët se si e shohin ata klasën e parë, çfarë do të thotë për ta shkolla, si e mendojnë se do të jetë etj. Shpjegoni si funksionon klasa e parë, çfarë do të thotë të kesh një mësues/e, si dallon klasa e parë nga klasa përgatitore e sqarime të këtij lloji, që do të ndihmojnë fëmijët në procesin e përshtatjes.

Loja "Nga klasa përgatitore për në klasë të parë"

Materialet: shirit ngjites, një zile.

Ecuria:

- Krijoni në dysheme një tabelë me 16 fusha 4x4.

-----KLASA E PARË-----

			5
		3	4
		2	
	1		

-----KLASA PËRGATITORE-----

Në formë gjysëmharku, fëmijët qëndrojnë në njërën anë të tabelës. Edukatori/ja jep udhëzimet e lojës.

- Tabela është e zbrazët pa numra, vetëm edukatori/ja e di shtegun e lojës (p.sh. si në fotografi).
- Fëmija do të shkelë në një fushë. Nëse fusha është pjesë e shtegut, ai do të vazhdojë të provojë fushën tjetër.
- Nëse fëmija ka shkelur fushën e gabuar, edukatori/ja do të përdorë një sinjal akustik (zile, bilbil apo di[ka tjetër), që tregon se ai ka gabuar.
- Nëse fëmija gabon, kthehet prapa te të njëjtat fusha ku ka shkelur; radha kalon te tjetri.
- Loja vazhdon derisa të gjithë fëmijët të kalojnë në anën tjetër të tabelës.

Kur të gjithë të kenë kaluar me sukses rrugën, pyesni fëmijët si janë ndier gjatë aktivitetit dhe a ishte i vështirë. Vazhdoni me pyetjet: "A jeni të kënaqur me përfundimin? A ju ndihmoi përqendrimi? Si ishte bashkëpunimi me shokët/shoqet?"

Kur të gjithë të kenë gjetur "rrugën për në klasë të parë", edukatori/ja i fton të vizitojnë një klasë të parë për të parë, si duket ajo, si funksionon, çfarë ka ndryshe nga klasa përgatitore. Bashkë me fëmijët shkojmë në një klasë të parë, brenda objektit të shkollës. (Në rastet kur nuk jeni në shkollë,

në shkollën më të afërt). Ju duhet të njoftoni paraprakisht një ditë më parë për vizitën tuaj. Fëmijët njihen me mësuesen, përshëndeten me nxënësit e klasës së parë dhe ulen bashkërisht me ta. Fëmijët mund të këndojnë një këngë mirëseardhjeje dhe në klasë krijohet një klimë e ngrohtë. Flisni për profesionin e mësueses, nxitni fëmijët e klasës së parë të prezantojnë punimet e tyre. Pas vizitës kthehemi në klasën tonë dhe marrim informata kthyesë: si janë ndier, cilat janë përshtypjet e tyre etj. Pastaj këndojmë një këngë përshëndetëse dhe përshëndetemi të gjithë tok.

Vlerësimi: Edukatori/ja vëzhgon fëmijët gjatë lojës me tabelë, shkathtësitë e tyre për të mbajtur mend rrugën e duhur, ndërsa provojnë njëri pas tjetrit, dhe pjesëmarrjen aktive në diskutim.

Më shumë për të bërë: Në varësi të kohës që keni për të realizuar vizitën në klasën e parë, ju mund të organizoni ndonjë rreth diskutimi ku nxiten fëmijët t'i shtrojnë pyetje njëri-tjetrit.

Reflektimi:

Portofoli im

Fusha kurrikulare: Matematikë

Kurrikula lëndore: Matematikë

Tema nga plani dymujor: Numrat natyrorë

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): **I. 3; II. 7, 8; III. 2, 6; IV. 2; V. 2, 5; VI. 1. 6**

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): Matematikë: 3.5
Gjuhët dhe komunikimi: 1.1; 1.5
Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti: 2.1

Rezultati i të nxënit të temës: Përdor numrat rreshtorë për të identifikuar pozicionet në një rresht (lodrash ose objekteve: i pari/e para; i dyti/e dyta; i pesti/e pesta).

Rezultatet e të nxënit të aktiviteteve:

- Ndjek udhëzimet për kërcim sipër gjurmëve të shputave.
- Prezanton punimin e tij/saj të veçantë para grupit.
- Sistemon portofolin e tij/saj.

Kriteret e suksesit:

- Kërce sipër gjurmëve të shputave duke ndjekur udhëzimet e dhëna.
- Prezanto punimin para grupit.
- Sistemo portofolin.

Burimet dhe materialet: Fletë me ngjyra, laps, gërshërë, plastifikues, rreth, portofolat e fëmijëve.

Integrimi ndërfaqor: Gjuhë shqipe, Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti.

Çështjet ndërkurrikulare: Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

Fjalë kyçe: Portofoli, kujtime, rritje, punime të veçanta.

Organizimi i aktiviteteve: Edukatori/ja këndon këngën “Rrotat e autobusit” dhe shëtit nëpër klasë, duke iu afruar fëmijëve e duke i marrë me vete. Të gjithë një nga një kapen pas tjetrit teksa këndojnë. “Autobusi” lëviz në klasë dhe “mbushet me fëmijë”. Kur të kemi të gjithë fëmijët në “autobus”, bashkërisht lëvizim deri në përfundim të këngës dhe në këtë formë sjellim fëmijët në rreth. Kur të jenë ulur, bëjmë përshëndetjet e shoqëruara me lëvizje specifike nga gjithsecili dhe fëmijët lihen sa të rregullojnë frymëmarrjen. Edukatori/ja sjellë një portofol në rreth, nxiten fëmijët për bashkëbisedim: si i kanë ruajtur ata punimet e tyre për një vit, sa të rëndësishme janë kujtimet dhe puna e bërë gjatë një viti, sa shumë gjëra kemi mësuar, sa shumë kujtime të bukura kemi krijuar etj.

Edukatori/ja zhvillon lojën “Shenjat e shputës”.

Materialet: fletë me ngjyrë, laps, gërshërë, rrathë plastikë.

Ecuria: Prisni gjurmë shputash me ngjyra të ndryshme. Vendosni në dysheme nga fillimi i rrethit deri te këndi i portofolave të fëmijëve. Secili prej tyre dhe me radhë do të ndjekë kërcimin mbi shputat e këmbëve.

Ju gjithashtu mund të përdorni gjurmë shputash të kafshëve, shpezëve etj., për të nxitur lëvizje fizike nga më të ndryshmet. Me lëvizje/kërcime të ndryshme trupore, fëmijët do të shkojnë te këndi i portofolit ku secili merr të vetin dhe e sjell në rreth. Kur të gjithë fëmijët të jenë mbledhur, shfletohen portofolat. Argëtohem duke parë punën e bërë për një vit.

- fëmijët praktikojnë numërim dhe krahasimin;
- flasin për punimet e tyre;
- prezantojnë punimet më të veçanta;
- komentojnë njëri-tjetrin;
- bëjnë krahasimin e shkrimit dhe vizatimit në fillim dhe në fund të klasës përgatitore;
- sistemojnë punimet e tyre për një vit, duke marrë dhe vendosur në portofol edhe ndonjë punim nga ato të treguara në klasë.

Në takimin përmbyllës, flasim për rëndësinë dhe kënaqësinë e kujtimeve tona. Ç’do të thotë për ne portofoli i punës për një vit? Si do të ndihemi kur t’i shohim punimet tona pas shumë viteve? Tok këndohet një këngë përshëndetëse dhe secili fëmijë merr portofolin e tij/saj me vete.



Vlerësimi: Fëmijët vëzhgohen për shkathtësitë e ndjekjes së udhëzimeve për kërcim në gjurmët e shputave, për prezantimin e punimeve, komentimin dhe shkathtësitë për të sistemuar, duke ndjekur një renditje të caktuar.

Më shumë për të bërë: Fëmijët mund të ilustrojnë kopertinën e portofolit të tyre, duke e personalizuar me ilustrime të ndryshme.

Reflektimi: _____

Kujtimet tona

Fusha kurrikulare:	Shkencat e natyrës
Kurrikula lëndore:	Njeriu dhe natyra
Tema nga plani dymujor:	Materialet dhe vetit e tyre
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):	I. 3; II. 7, 8; III. 1, 3, 6; IV. 2; V. 2, 5; VI. 1, 6
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):	Shkencat e natyrës: 1 Matematikë: 3.3 Gjuhët dhe komunikimi: 1.1; 1.5; 2.8 Artet: 1
Rezultati i të nxënit të temës:	Diskuton për përdorimin e materialeve të cilat përdoren në jetën e përditshme.
Rezultatet e të nxënit të aktiviteteve:	<ul style="list-style-type: none"> • Stampon me ngjyra tekstili sipër bluzave të shokut/shoqes. • Krijon një kujtim artistik te këndi i artit për shokun/shoqen e tij/saj.
Kriteret e suksesit:	<ul style="list-style-type: none"> • Stampo me ngjyra tekstili sipër bluzave të shokut/shoqes. • Krijon një kujtim artistik te këndi i artit për shokun/shoqen e tij/saj.
Burimet dhe materialet:	Një bluzë për secilin fëmijë, karton, ngjyra tekstili, pjata plastike/letre, sfungjer me forma të ndryshme për stampim, fletë, lapsa, ngjyra, ruaza, llastik i hollë ose litar i hollë.
Integrimi ndërfaqor:	Gjuhë shqipe, Matematikë, Edukatë figurative.
Çështjet ndërkurrikulare:	Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.
Fjalë kyçe:	Kujtim, stampim, shok/shoqe.
Organizimi i aktiviteteve:	<p>Në takimin e përbashkët plotësojmë kalendarin duke numëruar ditët deri në përfundim të klasës përgatitore, që fëmijët të krijojnë idenë e kohës së mbetur. Këndojmë një këngë mirëseardhjeje dhe e shoqërojmë me lëvizje trupore/vallëzim në rreth.</p> <p>Edukatori/ja ka përgatitur një surprizë për fëmijët. Përmes <i>MovieMaker</i> (ju mund ta përgatitni edhe në <i>PowerPoint</i>) ai/ajo prezanton përpara fëmijëve punën që ata kanë bërë gjatë vitit, duke përfshirë video, fotografi nga aktivitetet dhe lojrat e zhvilluara të shoqëruara me muzikë.</p> <p>Fëmijët do të vazhdojnë aktivitetin për krijimin e një kujtimi për shokun/shoqen e tij/saj.</p> <p>Loja "Bluza e kujtimeve"</p> <p><i>Materialet:</i> nga një bluzë për secilin fëmijë (mund të kërkonti që fëmijët të sjellin nga shtëpia ndonjë bluzë të tyre të thjeshtë), karton, ngjyra tekstili, pjata plastike/letre, sfungjer me forma të ndryshme për stampim.</p>

Ecuria: Edukatori/ja vendos në mes të rrethit disa pjata me ngjyra të ndryshme tekstili, disa sfungjerë me forma të ndryshme dhe çdo fëmijë merr me vete në rreth bluzën e tij/saj. Pastaj, edukatori/ja vendos tri nga tri bluza në mes të rrethit. Secilës bluzë i vendos një letër kartoni në mes. Fëmijët ndahen në grupe të vogla dhe stampojnë me sfungjer forma të ndryshme sipër bluzave të shokëve dhe shoqeve. Kur të keni mbaruar me stampimin e bluzave, ndryshoni përbërjen e grupeve punuese, duke përdorur ndonjë teknikë të përshtatshme.

Grupet e reja punuese ndahen në kënde të ndryshme, ku do të krijojnë një kujtim, sipas dëshirës, për njëri-tjetrin.

Këndi i vizatimit - ofrohen fleta, lapsa ngjyra, ku fëmijët mund të bëjnë ndonjë kujtim për shokun/shoqen, si: vizatim i dedikuar, gjurmët e duarve të tyre, të vizatojnë ndonjë ngjarje të veçantë që u kujton shoqërinë për njëri-tjetrin.

Këndi i punëdores - ofrohen rruaza, llastik i hollë, ose litar i hollë, ku fëmijët mund të krijojnë byzylykë për një nxënës tjetër. Fëmijët ndajnë kujtimet më të bukura dhe vazhdojnë në lojë të lirë.

Në fund mblidhemi për takimin përfundimtar, ku secili me radhë prezanton dhuratën që ka pranuar dhe tregon ndonjë kujtim që do ta kujtojë gjithmonë për shokun/shoqen nga i/e cila ka pranuar kujtimin. Rekomandohet të bëhen disa fotografi për të kujtuar përherë këtë çast.

Vlerësimi: Dokumentohet me fotografi puna e fëmijëve dhe idetë krijuese në procesin e stampimit.

Më shumë për të bërë: Ju mund të përdorni ndonjë shabllon për stampim me numrat e vitit shkollor.


Reflektimi: _____

Programi ynë festiv

Fusha kurrikulare:	Artet
Kurrikula lëndore:	Edukatë muzikore
Tema nga plani dymujor:	Ngjarjet artistike
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):	I. 3, 5, 8; III. 7; IV. 2; V. 2, 5; VI. 1, 6
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):	Artet: 4 Gjuhët dhe komunikimi: 1. 1; 1. 5; 1. 7 Jeta dhe puna: 4
Rezultati i të nxënit të temës:	Përshkruan ndonjë ngjarje muzikore në familje, në shkollë e më gjerë.
Rezultatet e të nxënit të aktiviteteve:	<ul style="list-style-type: none"> • Prezanton një pikë sipas dëshirës para publikut në programin festiv. • Këndon këngën përshëndetëse.
Kriteret e suksesit:	<ul style="list-style-type: none"> • Prezanto një pikë sipas dëshirës para publikut në programin festiv. • Këndo këngën përshëndetëse.
Burimet dhe materialet:	Një skenë e improvizuar, kënd i fotografimit, projektor, magnetofon, CD me fotografi dhe video të fëmijëve, punimet e ndryshme të fëmijëve.
Integrimi ndërfaqor:	Gjuhë shqipe, Shkathtësi për jetë.
Çështjet ndërkurrikulare:	Globalizimi dhe ndërvarësia.
Fjalë kyçe:	Programi festiv, prezantim, publik.
Organizimi i aktiviteteve:	<p>Për organizimin e programit festiv të klasës përgatitore, edukatori/ja i njofton prindërit disa ditë më përpara, ku i fton ata me ftesë formale, të shtypur ose të vizatuar, që të marrin pjesë në programin festiv me fëmijët. Edukatori/ja pret fëmijët në klasë dhe takohen me përshëndetje të ngrohta, bisedon me ta se si po ndihen në ditën e fundit të klasës përgatitore. Flet me fëmijët e u shpjegon që programi festiv është një ngjarje e bukur. U jep mundësi zgjedhjeje për pikën që do të prezantojnë në program. Ajo mund të jetë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • vjershë; • këngë; • kërcim; • prezantim i ndonjë loje, që fëmijët duan vërtet ta shfaqin para prindërve; • fëmijët që janë të shkathët në ndërtime, mund të paraqesin ndonjë krijim të veçantë me blloqe formuese apo çfarëdo që ata kanë interes;

- fëmijët që nuk kanë dëshirë të dalin para, publikut mund të paraqesin punimet e tyre artistike në këndin e artit;
- fëmijët që pëlqejnë lojën me role mund të paraqesin një pjesë të shkurtër para prindërve.

Mundësojini secilit fëmijë të paraqesë shkathtësitë e veta, dëshirat dhe prirjet. Le të jetë kjo një përvojë e bukur për t'u mbajtur mend. Pas interpretimeve të fëmijëve, edukatori/ja vendosnë projektor prezentimin e materialit përmbledhës për punën e fëmijëve, ku prindërit dhe fëmijët do ta shohin bashkërisht (një kopje e CD-së për secilin nga fëmijët do të ishte një kujtim i bukur nga klasa përgatitore). Në një kënd të klasës organizoni vendin për realizimin e fotografive ku prindërit, fëmijët dhe edukatorët/et mund të bëjnë disa fotografi për të krijuar kujtime të përbashkëta të kësaj dite. Në fund të programit, përshëndetemi së bashku duke kënduar një këngë.



Vlerësimi: Me fjalë inkurajuese e duartrokijte përcillen shkathtësitë prezantuese të fëmijëve para publikut.

Më shumë për të bërë: Ju mund të vendosni në një kënd të klasës vizatimin e një trugu peme pa kurorë. Kurorën do ta plotësojnë fëmijët, duke lënë gjurmën e gishtit të ngjyrosur, si kujtim për institucionin parashkollor.

Reflektimi: _____

3. Materiale ndihmëse për edukatorin/en

3.1 Lojëra për takimin në rreth

1. Prezantimi

Çdo fëmijë përshëndet shokun/shoqen që ka pranë e më pas edukatorin/en. Ai/ajo prezanton shkurtimisht veten dhe pastaj shokun/shoqen që ka pranë, si në rastin: "Unë jam Ylli dhe pranë kam Zanën, e cila është 5 vjeçe dhe e pëlqen shumë punën me plastelinë". Nëse nuk ka informacione për shokun/shoqen që ka pranë, mund të diskutojë me zë të ulët për pak çaste e më tej të bëjë prezantimin.

Ky është një aktivitet i përshtatshëm kur fëmijët të kenë një njohje fillestare për njëri-tjetrin, kurse përshëndetjet dhe mbledhja në rreth është aktivitet që rekomandohet çdo ditë. Ju mund të përdorni forma të ndryshme të përshëndetjeve, të cilat duhet të jenë në ndërlidhje me temën dhe aktivitetet ditore.

2. Nga kush vjen tingulli?

Fëmijët qëndrojnë në rreth, me sy mbyllur dhe mbajnë duart prapa. Edukatori/ja vendos në dorën e njërit prej fëmijëve një objekt, i cili mund të krijojë një tingull; mund të jetë një send çfarëdo: disa çelësa, një lodër me zë, një zile të vogël apo diçka të ngjashme. Ai/ajo bën fshehurazi një tingull ndërsa fëmijët qëndrojnë symbyllur dhe identifikojnë nga kush erdhi tingulli. Ai/ajo që e përcakton prej nga erdhi tingulli, merr radhën për udhëheqjen e lojës. Edukatori/ja fton fëmijët t'i mbyllin sytë sërish dhe të mbajnë duart prapa, për të vazhduar lojën derisa fëmijët të kenë interes.

3. Kërcim mbi format gjeometrike

Formoni disa forma gjeometrike dhe vendosini në dyshe me. Edukatori/ja jep udhëzimet për kërcim, si:

- kërcë mbi katror;
- nga katrori në rreth;
- nga rrethi kthehu në katror;
- nga katrori me një këmbë në drejtkëndor.

Loja mund të përdoret edhe me të tjera forma, në varësi të temës. Mund të jenë lule, akullishte, të jenë me numra etj.

4. Muaji yt i lindjes

Kur fëmijët janë të ulur në rreth, edukatori/ja udhëzon: "Lëvizin të gjithë ata që kanë lindur në muajin shtator". Sipas udhëzimeve, të gjithë fëmijët e lindur në këtë muaj lëvizin rreth e qark e më tej ulen. Loja vazhdon me një muaj tjetër lindjeje. Lëvizjet e tyre mund të shoqërohen me vallëzim e me muzikë, ose me ushtrime trupore. Loja mund të përshtatet edhe me aktivitete nga fusha të tjera.

5. Duartrokitjet

Loja synon vetëm veprimin në fjalë, për t'i gjallëruar fëmijët e për të krijuar një atmosferë të gëzueshme. Fillohet me një duartrokitje, ftohen fëmijët të lëvizin ritmiksht nga ana e majtë e më pas nga ana e djathtë. Në sfond vendoset muzikë ritmike. Zgjerimi i komandave me lëvizje poshtë - lartë, më shpejt - më ngadalë, nën shoqërimin e muzikës ritmike zgjerohet në varësi të asaj sa fëmijët janë në gjendje të realizojnë shkallën e vështirësisë.

6. Siç bën ti, bëjmë edhe ne!

Fëmijët qëndrojnë në rreth, ndërsa edukatori/ja prek në krah njërin nga ata. Fëmija fillon një veprim, p.sh.: duartroket, kërcet gishtat, këndon etj. Fëmijët e tjerë veprojnë njësoj. Edukatori/ja prek në krah një fëmijë tjetër dhe ai/ajo ia lë vendin shokut/shoqes.

7. Shkruajmë me gishta

Fëmijët e ulur në rreth kthehen të gjithë në një anë dhe vizatojnë në shpinën e njëri-tjetrit. P.sh., fëmija i parë vizaton një formë gjeometrike dhe të njëjtën formë do ta kalojë te shoku/shoqja. Kjo lojë zhvillohet pa folur. Në fund shihet nëse forma gjeometrike është njësoj si ajo që u vendos fillimisht.

8. Gjeni partnerin / shokun a shoqen

Edukatori/ja u jep fëmijëve kartat e numrave ose shkronjave (nëse në grupin tuaj keni 15 fëmijë, duhet të siguron numrat nga 1-15 në dy njësi) dhe vendos muzikë ritmike të përshtatshme për atë grup-moshë. Kur muzika ndalet, fëmijët gjejnë kush nga grupi ka numrat e njëjtë dhe kështu bëhen dy nga dy, për të filluar punën në çifte për aktivitetin e radhës.

9. Ndjek shokun/shoqen

Njëri nga fëmijët del me dëshirë në qendër të klasës përgatitore dhe kryen një veprim ose lëvizje ritmike. Fëmijët e tjerë e imitojnë aq sa arrijnë të mbajnë mend.

10. Ngjyrat

Njëri nga fëmijët hyn në mes të rrethit dhe me sy të mbyllur e gishtin drejtuar nga fëmijët e tjerë rrotullohet disa herë. Në çastin që ndalet, pyet fëmijën të cilit/së cilës i është drejtuar gishti tregues. Pyetja është: "Cila është ngjyra jote e dashur?". Fëmija tjetër përgjigjet dhe shton edhe një fjali argumentuese, si për shembull: "Ngjyra ime e preferuar është e verdha, sepse i verdhë është edhe dielli".

3.2 Loja me tabelë

Udhëzime për lojën:

1. Ndani fëmijët në grupe me nga 5-6 veta. Secili grup përbën një ekip në lojë. Ekipi mund të zgjedhë një përfaqësues për të luajtur dhe të tjerët të ndihmojnë me këshilla, ose mund të luajnë të gjithë me radhë. Secili ekip zgjedh një figurë që lëviz nëpër tabelë, si shenjë dalluese e ekipit.
2. Shpjegoni aktivitetin:
 - Përfaqësuesi i secilit grup hedh zarin. Fillon grupi me numrin më të madh.
 - Lojtari i ekipit të parë hedh zarin dhe lëviz para sipas numrit të paraqitur.
 - Loja në vijim varet nga katrori ku ka rënë lojtari:
 - nëse lojtari ka rënë në një katror që tregon fundin e shkallëve, lojtari lëviz lart në katrorin në fillim të shkallëve;
 - nëse lojtari arrin në një katror që përmban kokën e gjarprit, ai duhet të shkojë poshtë në katrorin që përmban bishtin e gjarprit;
 - nëse lojtari arrin në një katror në të cilën edukatori/ja ka vendosur një skedë me pyetje, duhet t'i përgjigjet pyetjes/pyetjeve, për të vazhduar më tutje lojën.

Shënim:

Loja mbaron kur njëri nga ekipet arrin në katrorin e fundit, ose kur hedh një numër në kub që e lëviz figurën e tij përtej katrorit të fundit. Loja mund të përdoret për tema të ndryshme përgjatë vitit. Edukatori/ja në varësi të temës përgatit tiketa të verdha me pyetje, të cilat vendosen në katror të ndryshëm brenda tabelës.

25	26	27	28	29	30
24	23	22	21	20	19
13	14	15	16	17	18
12	11	10	9	8	7
1	2	3	4	5	6

3.3 Ide për integrimin e gjuhës angleze gjatë punës me fëmijët

Përshëndetje!

Mirëmëngjesi! Mirëmbrema! Natën e mirë! Mirupafshim! / Hello! Good morning! Good evening! Good night! Goodbye!

Shprehjet e mirësjelljes, që përdoren për të përshëndetur kur takohemi ose kur ndahemi me dikë, mund t'i praktikoni me fëmijët kur ata/ato sapo vijnë në institucion, ose duke sajuar situata të ngjashme e duke thënë: "Hello! Is anybody home?". Mund të praktikoni shprehjen "Goodbye!", kur fëmijët largohen për në shtëpi.

Loja "Dita e nata". Këtë lojë mund ta përdorni për të përsëritur fjalë në gjuhën angleze që tashmë fëmijët i dinë, dhe për të mësuar shprehjet e kundërta, si: morning/evening, summer/winter, big/small etj.

Gjithmonë shpjegoni përdorimin dhe kuptimin e fjalëve, në mënyrë që fëmijët ta kenë të qartë domethënien. Shpjegimet shoqërojnë me shembuj, si: "Sapo zgjohemi nga gjumi në mëngjes, përshëndesim prindërit, që të fillojmë një ditë të re e të bukur", ose "Kur shkojmë në shtrat në darkë, u urojmë të gjithëve gjumë të qetë".

Ngjyrat/Colors

Për t'u mësuar fëmijëve të grupit tuaj ngjyrat, përdorni letrat me ngjyra, fotografi dhe objekte të tjera, si: lodra, mjete shkollore, veshje, libra etj. Ju mund t'i mbani 3-4 topa me ngjyra të ndryshme dhe t'ua pasoni fëmijëve, të cilët pasi i presin, gjejnë ngjyrën e saktë dhe ia kalojnë shokut/shoqes.

Merrni lapsa me ngjyra dhe emërtojini me radhë: red, yellow, pink, blue etj. Më tej vendosni lapsat me ngjyra para fëmijëve dhe nxitni t'i përsërisin ngjyrat e tyre me radhë.

Numrat/Numbers

Përdorni letrat me numra, shkruani numrat në tabelë ose luani lojëra të ndryshme me numra. Nëse përdorni letrat e vogla me numra, kthejini në anën e kundërt, kërkoni nga fëmijët të tërheqin një e më pas të mendojnë e të thonë shifrën e saktë. Rekomandohet të kombinoni numrat dhe ngjyrat, duke tërhequr copa të vogla letre ose një copë letre të madhe (ku vendosni të gjithë numrat). Pasi të mblidhni fëmijët në rreth, sajoni një veprimtari. Secili prej tyre të shkruajë një numër ose të vizatojë një objekt me marker me ngjyrë në tabelë. Shoku/shoqja që ka pranë, duhet të thotë ngjyrën dhe numrin. Për shembull: "Three! Red! Kjo është yellow/blue!"

Familja/Family

Përdorni vizatime/karta, fotografi të familjeve të ndryshme, flisni për familjen, kërkoni fëmijët emrat e prindërve, vëllezërve dhe të motrave të tyre. Fëmijët mësojnë këngën "Fingers Family" dhe e interpretojnë me kukulla. (Gjeni të bashkëngjitur në shtojcën e edukatorit/es kukullat për ta konkretizuar këngën e familjes.)

Ju mund të krijoni lojën e kujtesës, duke siguruar nga dy fotografi të njëjta për secilin anëtar të familjes, dhe ndonjë objekt që nuk përkon. Kthejini fotografitë në anën e kundërt, që fëmijët të përpiqen të gjejnë dy të njëjta. (Kur fëmija hap fotografinë, e emërton atë në gjuhë angleze, p.sh.: Mother, Sister, Baby, Father etj.)

Pjesët e trupit/ Body parts	Paraqituni fëmijëve pjesët e trupit duke i treguar nga afër. Shqiptoni disa herë, me ngadalë e me intonacionin e duhur, teksta jepni edhe shembuj. Pas kësaj, nisni të mësoni këngën "Head, Shoulders, Knees and Toes". Fëmijët kërcëjnë e këndojnë njëkohësisht, duke treguar pjesën e turpit. Teksti mund të kombinohet në gjuhën shqipe dhe angleze.
Kafshët/Animals	Mësimi i kafshëve në gjuhën angleze mund të fillojë me mësimin e këngës "Old McDonald had a Farm". Fëmijët këndojnë këngën, edukatori/ja emërton me zë të theksuar dhe intonacion të përshtatshëm, duke e vënë theksin tek emërtimi i kafshëve në këngë. Për ta konkretizuar më mirë, siguroni një projektor, që këngën e re ta shohin edhe në video, për të perceptuar më mirë kafshët. Përdorni fotografi/karta dhe bëni përsëritje me to. Ju mund ta përdorni kubin me kafshë, që e gjeni të bashkangjitur te shtojca e edukatorit/es. Kubin në fjalë, edukatori/ja e hedh në mes të rrethit dhe fëmijët emërtojnë kafshën që paraqitet në fotografinë e kubit.
Shtëpia dhe orenditë	Çatia, muri, dritarja, dera/House and Furniture – roof, wall, window, door Mund të filloni t'u mësoni fëmijëve fjalët e reja që lidhen me orenditë e shtëpisë: krevat, karrige, tavolinë, dollap etj. Së pari, u mësoni atyre fjalët themelore dhe më pas zgjeroni fjalorin, duke bërë lidhje me fjalë të tjera. Fëmijët luajnë me kube, ku ata mund të ndërtojnë një shtëpi dhe t'i emërtojnë objektet e mësuara.
Në kuzhinë:	Ushqimi, frutat dhe perimet/In the Kitchen: Food, Fruits, and Vegetables Meqenëse fjalori për ushqimet dhe frutat është shumë i gjerë, këto fjalë mund t'i shtroni në shumë njësi, të shtoni herë pas here fjalë të reja e t'ua tregoni fëmijëve me shembuj konkretë. Përdorni fletëza me ngjyra, vizatime, karta me ushqime. Flisni për tema specifike, si për shembull: filloni një bisedë për të prezantuar ndonjë çështje. Pyetni se çfarë pëlqejnë të hanë, çfarë nuk pëlqejnë, kush gatuan në shtëpi etj. Për të prezantuar një temë të gjerë, përdorni metodën e bashkëbisedimit, ku mund të flisni në gjuhën amtare, por gjithmonë kërkoni që fëmijët të kujtojnë fjalën në gjuhën angleze. Kur jeni duke mësuar ushqimet, ju mund të futni edhe fjalët: mëngjes, drekë, darkë dhe foljet: "ha", "pi", "pëlqej".
Veshjet/Clothes	Zgjidhni fjalët që keni parashikuar t'u mësoni dhe t'i kombinoni ose përshtatni me stinët. Përdorni materialet e zakonshme, lodra pelushi, veshje të kukullave ose fotografi ku paraqiten rroba të ndryshme/ose rrobat që ju keni veshur. Emërtoni qartë dhe ngadalë veshjet që përdorni si mjet konkretizimi. Sistemojini duke i ndarë në grupe sipas ngjyrave ose stinëve. Nxitni fëmijët t'i emërtojnë këto grupime, ngjyrat, stinët dhe gjithashtu numërimin e tyre në anglisht. Ju mund të përdorni edhe materiale të ndryshme, me të cilat fëmijët mund të bëjnë kolazhe që paraqesin veshje. Nxitni t'i prezantojnë punimet e tyre duke i emërtuar veshjet e veta dhe ngjyrat e tyre në gjuhë angleze.
Moti. Stinët e vitit/ Weather. Seasons of the Year	Trupa qiellorë dhe dukuri - Dielli, Hëna, re, shi, bubullimë, borë, flokëbore, yje/sun, moon, cloud, rain, thunder, snow, snowflakes, stars. Përsëritni fjalët: natë/dita - night/day dhe pjesët e ditës: mëngjes, pasdite, mëngjes/morning, afternoon, evening. Stinët - vjeshtë, dimër, pranverë, verë/Autumn, winter, spring, summer. Mund të përdorni kalendarin e motit për t'i konkretizuar stinët e vitit. Nëse fëmijët nuk i njohin asnjërën nga fjalët, tregojini më parë në gjuhën shqipe, pastaj në anglisht. Përdorni materialet dhe aktivitetet e

zakonshme (fotografi, karta, vizatim dhe ngjyrosje). Ju mund të shoqëroni me lëvizje ritmike këngën: "Rain, rain, go away, come again another day!"

Me fjalën shi/rain, futni fjalën çadër/umbrella.

Natyra/Nature

Përgatisni përpara nxënësve letra me ngjyra ose plastelinë dhe u kërkoni të paraqesin objektet: diellin, retë, zogun, pemën, lulen, fluturën etj. Pasi t'i kenë përfunduar punimet e tyre mbledhemi në rreth dhe secili e prezanton punimin që e ka bërë duke e emërtua bashkërisht në gjuhën angleze. Tregoni ndonjë gjëegjëze të thjeshtë, si:

"Çfarë ka në qiell;
që nuk është një re,
që nuk është një zog,
por në dimër dhe verë, na mban të ngrohtë?"
(Dielli/Sun)

Ju gjithashtu mund të dilni bashkërisht jashtë klasës dhe të vëzhgoni natyrën dhe objektet përreth. Nxitini fëmijët t'i emërtojnë në gjuhën angleze ato çfarë shohin.

Materialet janë përshtatur nga linku i mëposhtëm:

<https://owlcation.com/academia/Teaching-pre-school-English>

3.4 Vëzhgimi dhe vlerësimi

Vëzhgimi është procesi i mbikëqyrjes së fëmijës në punë apo në lojë, pa ndërhyrjen e të rriturve në aktivitetet që ai zhvillon (*Coughlin, 1997*), dhe si i tillë shërben që një edukator/e të mbledhë të dhëna për zhvillimin e fëmijës, mënyrën se si ai mëson dhe zhvillohet, interesat e tij, pikat e forta, sjelljet në situata të caktuara etj. Pra, përmes vëzhgimit, edukatori/ja mund ta njohë fëmijën më mirë. Kjo njohje i siguron bazën për të planifikuar dhe përcaktuar aktivitetet që i përgjigjen nevojave zhvillimore të fëmijës. Edukatorët/et dokumentojnë punën e fëmijës, cilësinë e punës dhe bashkëveprimet me grupin (*Coughlin, 1997*). Këto regjistrime mundësojnë matjen e progresit të fëmijëve dhe përshkruajnë rrugën që kalon një fëmijë gjatë procesit të tij zhvillimor dhe njohës. Mbledhja e të dhënave përmes vëzhgimit mund të shërbejë si bazë për vlerësimin e arritjeve të fëmijës në periudha të caktuara kohore, dhe si dëshmi e punës që bën një edukator/e gjatë gjithë vitit.

Si të vëzhgojmë?

Vëzhgimi, si proces, duhet të jetë i pandërprerë. Ai mund të jetë spontan, që do të thotë se kur edukatori/ja nuk ka një plan paraprak për vëzhgimin, mban shënim për një sjellje të fëmijës, mënyrën se si i qaset dhe zgjidh një problem, që konsiderohet me vlerë të argumentohet. Mund të jetë i planifikuar kur edukatori/ja ka një plan vëzhgimi për secilin fëmijë dhe i kushton kohë të barabartë procesit të vëzhgimit të secilit fëmijë. Këto dy drejtime duhet të jenë të alternuara me njëra-tjetrën, në mënyrë që procesi të quhet i plotë.

Edukatori/ja gjatë vëzhgimit të fëmijës duhet të ketë parasysh:

- të jetë objektiv/e në përshkrim;

- të mos përdorë etiketimet që mund të japin informacion të gabuar për sjelljen e një fëmije, si për shembull: *Beni është shumë aktiv. / Ana është qaramane.*

Këto nuk konsiderohen mënyra të sakta për të përshkruar sjelljen e një fëmije; gjatë shkrimit të shënohet vetëm informacioni i sigurt si në rastin: *Beni gjatë kohës së aktiviteteve me grupe të vogla, lëviz nga qendra e artit në atë të matematikës. / Ana qan kur prindi e sjell në institucion;*

- shënimet duhet të jenë të sakta e të pasqyrojnë situatën reale. Cilësimet: *i mirë, i shkëlqyeshëm*, nuk mund të vëzhgohen, prandaj rekomandohet të mos përdoren. Referojuni situatës: *Elena përdori kapelën dhe syzet nga qendra e dramatizimit për të luajtur rolin e gjyshes;*
- shënimet nga vëzhgimi duhet të shënohen sa më shpejt të jetë e mundur, meqë gjatë kalimit të kohës mund të mos kujtoni me saktësi si ka ndodhur ngjarja;
- ju nuk mund të vëzhgoni gjithçka në të njëjtën kohë, për këtë arsye sugjerohet të përqendroni vëmendjen tuaj, për ta bërë procesin më të thjeshtë;
- hartoni një plan se si do ta zhvilloni procesin e vëzhgimit, për të pasur mundësi të vëzhgoni të gjithë fëmijët në situata të ndryshme;
- vëzhgimi është proces, prandaj duhet të mbani parasysh se vlerësimi nuk mund të arrihet vetëm gjatë një dite;
- përdorni të njëjtat kritere vlerësimi për të gjithë fëmijët, duke alternuar format e vëzhgimit;
- një shënim pa datë dhe pa emër nuk mund të jetë asnjëherë një shënim i vlefshëm për hapat e mëtejme. Shënimet duhet të kenë të gjitha të dhënat që të mund të quhen të vlefshme.

Në varësi të asaj që duam të vëzhgojmë, duhet të bëhet edhe përzgjedhja e teknikave të vëzhgimit. Përzgjedhja e teknikave të përshtatshme ndihmon edukatorin/en të arrijë qëllimin e caktuar për vlerësimin e fëmijës në një fushë të caktuar. Llojet e mëposhtme janë ato që rekomandohen nga literatura didaktike:

Vëzhgimi me intervale të caktuara kohore

Edukatori/ja përcakton se cilin fëmijë do të vëzhgojë atë ditë dhe përdorë një interval të caktuar kohor çdo 1-15 minuta, duke mbajtur shënim sjelljen e tij. Ai/ajo përshkruan çfarë është duke bërë fëmija në atë pjesë kohe. Në fund të ditës, edukatori/ja përmbledh në formë narrative sjelljen e fëmijës përgjatë gjithë ditës.

Listat e kontrollit

Gjatë përdorimit të listave të kontrollit, edukatori/ja duhet të jetë sa më objektiv/e. Në rastet kur një tregues brenda listës së kontrollit nuk arrihet të vëzhgohet, atëherë edukatori/ja shënon që ai tregues nuk është vëzhguar.

Vëzhgimi vetëm i një fëmije

Edukatori/ja mund të vendosë të vëzhgojë vetëm një fëmijë në mënyrë specifike. Kjo teknikë, ashtu si edhe të tjerat, zhvillohet në mjediset ekzistuese (ju nuk keni nevojë të bëni përgatitje të veçanta në mjedisin tuaj). Fëmija mund të vëzhgohet nëse edukatori/ja kërkon ndonjë të dhënë në veçanti ose mund të bëhet edhe për të plotësuar një vëzhgim të bërë më parë (Neaum, 2016). Përveç të dhënave të mbledhura, mund të bëni edhe regjistrime (video) të shkurtra, ku fëmija ndërvepron me të tjerët dhe shfaq aftësitë gjuhësore. Të dhënat regjistrohen, kodohen për të dhënë një tablo më të plotë të vëzhgimit të bërë dhe përdoren për të analizuar dhe interpretuar gjetjet (Neaum, 2016). Në të tilla raste,

edukatori/ja gjithmonë duhet të mbajë parasysh parimet dhe rregullat e mbrojtjes së të dhënave, si dhe kodin etik.

Regjistrimet e shpejta

Janë regjistrime të shkurtra, të cilat tregojnë “një pikturë në fjalë” (Coughlin, 1997), të asaj që fëmija thotë ose vepron. Këto shënime na japin të dhëna për mënyrën se si fëmija zhvillon procesin e njohjes; po ashtu shërbejnë si pikë orientuese për fushat e tyre të interesit. Këto regjistrime mund të jenë të shkurtra ose të përshkruajnë në tërësi një veprimtari të një fëmije.

Dokumentimi i punës së fëmijëve

Regjistrimet me video dhe me fotografi mund të jenë pjesë e instrumenteve vëzhguese që edukatori/ja mund të përdorë. Ato tregojnë veprimtari të zhvilluara nga fëmijët dhe në raste të caktuara, mund të përdoren për të parë progresin e fëmijës në një fushë të caktuar zhvillimore.

Vizatimet dhe puna e fëmijëve

Koleksionimit të vizatimeve të fëmijës dhe aktiviteteve që ata zhvillojnë, duhet t’u kushtohet rëndësi e veçantë. Vizatimet e fëmijës mund të përdoren si mjet për të kuptuar më shumë rreth një çështjeje ose përmbajtje të caktuar, për të parë nevojat e fëmijës, pikat e forta të tij dhe mundësinë për mbështetje. Që vizatimet të jenë të vlefshme dhe të mund të përdoren për të matur progresin e fëmijës për një vit në institucion parashkollor, duhet të kenë të shënuar emrin dhe datën, ndërsa në rastet më të mira edhe një përshkrim objektiv të përmbajtjes së atij vizatimi rrëfyer nga vetë fëmijët.

Portofoli

Paraqet koleksionimin e gjithë punës së bërë nga fëmijët, edhe në rastet kur punët janë tredimensionale. Do të ishte mirë që fëmija të kishte një dollap personal (dollap personal të improvizuar me kuti këpucësh), ku të vendosë punën e tij. Portofoli mund të shërbejë për të parë përparimin e fëmijës, si dhe për të kujtuar punë të veçanta e domethënëse, që ai/ ajo ka krijuar. Shpesh, portofoli mund t’u tregohet edhe prindërve apo anëtarëve të tjerë të familjes, për të vlerësuar përpjekjet, ritjen dhe përparimin e fëmijës.

Bisedat dhe intervistat

Fëmijët ndihen mirë kur të rriturit kalojnë kohë me ta për të diskutuar çështje që janë me interes për ta. Përmes bisedës dhe intervistave mund të mbledhim të dhëna, të cilat ndihmojnë në planifikimin në të mirë të punës sonë, në raport me nevojat dhe interesat e tyre.

3.5 Lista e librave për lexim

Në përpjekje për t'u ofruar edukatorëve/eve mundësi zgjedhjeje e për t'i ndihmuar të përcaktojnë materialet e duhura për lexim, është hartuar një listë librash me tematika të shumëllojshme. Edukatori/ja mund të përdorë renditjen e mëposhtme si një listë fillestare materialesh, e më pas ta zgjerojë e ta pasurojë me materiale të reja.

Fëmijët e ciklit parashkollor e duan leximin dhe lundrimin në botën e fantazisë, prandaj është shumë e rëndësishme që t'u lexohen përralla e tregime, që përçojnë mesazhe dhe ndihmojnë fëmijën të kuptojë çështje të rëndësishme të përditshmërisë.

Leximi i përrallave/tregimeve/kuriozitetëve nga enciklopeditë janë burime të rëndësishme, me anë të të cilave fëmija mund të gjejë përgjigje për shumë pyetje e kureshti të moshës. Një fëmijë që rritet me dashuri për librin, domosdo që do të jetë një i rritur e individ më i mirë në shoqëri. Për këtë arsye mbetet në dorën tonë që, në bashkëpunim të ngushtë me familjen, të zgjojmë te fëmijët dashurinë për librin dhe për dijen.

Lista fillestare e librave:

- "Enciklopedia për fëmijë nga A-Zh", Botimet Eudalpa, Tiranë, Shqipëri
- "Enciklopedia gjithçka që duhet të dini", Aeditions, Tiranë, Shqipëri
- "Enciklopedi për fëmijë - Stinët", A. Vandevile, Botime Pegi, Tiranë, Shqipëri
- "Enciklopedi për fëmijë - Rroftë mirësjellja", F. de Giber, Botime Pegi, Tiranë, Shqipëri
- "Përrallat e nënës Tokë", përzgjedhi e ritregoi nga anglishtja F. Shuraja, Redona Publishing Tiranë, Shqipëri
- "101 Gjëgjëza", A. Mamaqi, Botimet Extra, Tiranë, Shqipëri
- "Unë e di - Gjeje ti!: 170 Gjëgjëza!", Arlinda R. Mamaqi, Botimet: "Extra-R" Tiranë, Shqipëri
- "Libri i gabimeve", G. Rodari, Botime Pegi, Tiranë, Shqipëri
- "Vëllezër e motra?", Dr. C. Dolto dhe C. Faure-Poitree, Botime Pegi, Tiranë, Shqipëri
- "Shtrati i prindërve", Ch. Naumann-Villemin, M. Barcilom, Botime Pegi, Tiranë, Shqipëri
- "Një sherrxi mustaqemi", Skënder Hasko, Botimet Pegi, Tiranë, Shqipëri
- "Të shoqërohem me kafshët", M. Kraja, Botimet Trimaks, Shkup, Maqedoni
- "Edhe kafshët kanë shqisa", M. Karara, Botimet Trimaks, Shkup, Maqedoni
- "Gjirafat s'vallëzojnë dot", G. Andreae dhe G. P. Rees, Botimet Botart, Tiranë, Shqipëri
- "Dinake me çorape", Dr. Seuss Botimet Botart, Tiranë, Shqipëri



"Zjarrfikësit vijnë", (2011) Botimet Toper, Tuz, Mal i Zi

"1, 2, 3 - të numërojmë së bashku", A. Beka, Botues: Rrota, Prishtinë, Kosovë

"Gjeometri për mua" A. Beka Botues: Rrota, Prishtinë, Kosovë

"Shtëpiza e iriqit të vogël", Aeditions, Tiranë, Shqipëri

"Miq të e dëborës", Aeditions, Tiranë, Shqipëri

"Unë po rritem", Botimet Efekos, Gjilan, Kosovë

"Trupi i njeriut", Botimet Efekos, Gjilan, Kosovë

"Sa është ora", Botimet Toper, Shkup, Maqedoni

"Vepra e saj: 100 gratë pioniere të Kosovës" 1, A. Xh. Mripa, Dukagjini, 2000

Seria e librave:

"Poku çamarroku" L. Bubani, Botimet Ideart

"Poku çamarroku 1"

"Poku çamarroku me skuadrën e tij 2"

Seria e librave:

"Bleta Punëtore"

<http://www.bletapunetore.org/>

"Kush jam unë"

"Pufi shkon në shkollë"

"Super pufi"

"Pufi në fermë"

"Pufi dhe Dodo"

dhe libra të tjerë të kësaj serie.

Seria e librave:

"Le të flasim hapur!" - për fëmijët e moshës mbi 4 vjeç, Shtëpia botuese Albas, Tiranë, Shqipëri

"Kur mami dhe babi harruan se ishin miq!"

"A ke ndonjë sekret?"

"Ngjyrat e ylberit"

"Kujtoj qenin tim"

"A je i turpshëm?"

"Babi do të martohet"

"Edhe mami punon!?"

"Atë ditë kur e humba dhe më gjetën"

"Vëllai im është autik"

"Shoqja ime ka sindromin Daun"

"Gjyshërit e mi janë të veçantë!"

"Mami është e sëmurë"

Seria e librave: *"Biblioteka për fëmijë - NEKTARI"*, A. Deva, Shtypi Twins, Prishtinë

"Unë jam unë"
"Numëroj"
"Biçikleta prej çokollate"
"Shtrati i kaprollit"
"Ora"
"Fëmijët"
"Sa shumë drurë"
"Topi"
"Duart e Arta"
"Loni dhe Liraku në pyll"
"Mali"

Seria e librave: *"Dora eksploruese"*, Shtëpia Botuese Extra-R, Tiranë, Shqipëri

"Aventurë në ditëlindjen e Dorës"
"Forca, Buts, Noto!"
"Një aventurë si në përrallë"
"Dora në botën e çudirave"

Seria e librave: *"Aventurat e Arushit Uini Puh"*, libra me ilustrime

"Festa e pranverës" / përshtatur nga A. Braybrooks
"Arushi Puh dhe pema me mjaltë" / përshtatur nga M. Packard
"Lumturinë e bëjmë vetë?" / përshtatur nga D. Ferguson

Seria e librave: *"Vlerat"* (ngritja e karakterit dhe e vetëdijes) Botimet Efekos, Gjilan, Kosovë

"Miqësia"
"Sakrifica"
"Sinqeriteti"
"Të falurit"
"Vetëbesimi"
"Trimëria"
"Virtytet"
"Xhelozia"
"Durimi"
"Zemërimi dhe grindjet"

Bibliografia

- Ashbrook, P. (2003), *Science is simple: over 250 activities for pre-schoolers*, Maryland, Gryphon House.
- Charner, K. (1996), *The Giant Encyclopedia of Circle Time and Group Activities for children 3 to 6: Over 600 favorite circle time activities created by teachers for teachers*, Maryland, Gryphon House.
- Charner, K., Murphy, M., & Clark, C. (2007), *The Giant Encyclopedia of Math activities for children 3 to 6: Over 600 activities written by teachers for teachers*, Lewisville, Gryphon House.
- Charner, K., Murphy, M., & Clark, C. (2008), *The Giant Encyclopedia of lesson plans for children 3 to 6: More than lesson plans created by teachers for teachers*, Lewisville, Gryphon House.
- Charner, K., Murphy, M., & Ford, J. (2004), *The Giant Encyclopedia of Kindergarten Activities: Over 600 activities created by teachers for teachers*, Maryland, Gryphon House.
- Coughlin, P. A., Hansen, K. A., Heller, D., Kaufmann, R. K., Stolberg, J. R., & Walsh, K. B. (1997), *Hap pas Hapi: Një program për fëmijët dhe familjet: Krijimi i klasave me fëmijët në epiqendër: fëmijët 3-5-vjeçarë*, Washington D. C.: Organizata Ndërkombëtare për Burimet e Fëmijëve.
- Dziengel, A. (2018), *Steam, play and learn: 20 fun step-by-step preschool projects about science, technology, engineering, art, and math!* California, USA, Quarto Publishing Group.
- Eckhoff, A. (2018), *Creative investigations in early Engineering and technology*, Lewisville, Gryphon House.
- ESL Kids (2017), *Teaching English to Children; (parë më 15. 09. 2018)*. <https://owlcation.com/academia/Teaching-pre-school-English>
- Feldman, J. & Karapetkova, H. (2009), *I love letters! - More than 200 Quick & easy activities to introduce young children to letters and literacy*, Maryland, Gryphon House.
- Hastings, K. & Schiller, P. (2016), *The complete resource book for preschools: over 2000 activities and ideas!*, Lewisville, Gryphon House.
- Homer, H. & Miller, R. (2014), *101 kids activities that are the best, funniest ever!*, Salem, MA. Page Street Publishing Co.
- Marschel, L. & al. (2014), *99 Fine Motor Ideas for Ages 1 to 5*, Middletown, USA.
- MASHT & IPK (2016), *Udhëzues për zbatimin e kurrikulës (Material ndihmës për mësuesit e klasës përgatitore dhe arsimin fillor)*, Prishtinë, MASHT & IPK.
- MASHT (2011), *Korniza e Kurrikulës e Arsimit Parauniversitar të Republikës së Kosovës*, Prishtinë, MASHT.
- MASHT (2011), *Standardet e Zhvillimit dhe të Mësuarit në Fëmijërinë e Hershme 6-0 vjeç*, Prishtinë, UNICEF.
- MASHT (2016), *Kurrikula bërthamë për klasën përgatitore dhe arsimin fillor të Kosovës (e rishikuar): (klasiat 5 ,4 ,3 ,2 ,1 ,0)*, Prishtinë.
- MASHT (2017), *Kurrikula lëndore/programet mësimore*, Prishtinë.
- Miller, B. (2005), *Komunikim me fëmijë*, Ferizaj, QPEA.

RRETH AUTOREVE



Prof. ass. dr. Rozafa Ferizi Shala, aktualisht është pedagoge në Departamentin Parashkollor, Fakulteti i Edukimit, Universiteti i Prishtinës. Ka përfunduar studimet e doktoratës në fushën e edukimit parashkollor në Fakultetin e Shkencave Sociale, në Universitetin e Tiranës. Ka marr pjesë më konferenca, trajnime të shumta dhe ka publikuar disa artikuj nga fushat e edukimit parashkollor. *Edukimi i fëmijëve në fëmijëri të hershme, Alternativat e metodologjive të edukimit parashkollor dhe Mjedisi i të nxënit* janë disa nga fushat e interesimit për studime të mëtejshme.



Msc. Delvina Dylazeka Hajdari është pedagoge e edukimit në fëmijëri të hershme. Aktualisht punon si drejtoreshë ekzekutive e OJQ-së *Education Comes First* dhe Master Trajnere në projektin *SHPRESE*. Hulumtuese në fushën e edukimit, me fokus të veçantë zhvillimin e inteligjencës emocionale të fëmijët. Hartuese e disa programeve edukative, si: *Të mësuarit nëpërmjet lojës; Zhvillimi holistik i fëmijëve në natyrë; Të kuptuarit e konfliktit dhe zgjidhja paqësore e tij; Zhvillimi i inteligjencës emocionale të fëmijët* etj.



Burbuqe Gojani Kuqi ka përfunduar Shkollën e Lartë Pedagogjike, drejtimi *Mësimi klasor*, në Gjakovë; Shkollën e Lartë Pedagogjike, drejtimi *Edukatore e enteve parashkollore*, Gjilan dhe Fakultetin e Edukimit, dega *Programi parafillor (PARK)*, në Gjakovë. Prej vitit 2000 e deri më tani punon në SHFMU "Selman Riza", Gjakovë. Është autore e librit "Integrimet me matematikën" dhe bashkautore e librit "Përrallëza, tregime, vjersha me alfabetin". Gjatë rrugëtimit të saj mbi 20-vjeçar, ka kryer shumë trajnime për zhvillimin e mëtejshëm profesional.

Katalogimi në botim - (CIP)

Biblioteka Kombëtare e Kosovës "Pjetër Bogdani"

37.016:373.21

Shala, Rozafa Ferizi

Libri i madh i planifikimeve : për punën me fëmijët e grup-moshës
5-6 vjeç / Rozafa Ferizi Shala, Delvina Dylazeka Hajdari, Burbuqe Gojani Kuqi.
- Prishtinë: Pegi, 2021. - 360. f. : ilustr. ; 31 cm.

1. Hajdari, Delvina Dylazeka 2. Kuqi, Burbuqe Gojani

ISBN 978-9951-786-39-3